

Përktheu: Mithat Hoxha
Design: Rasim Shakirov
Titulli original: *Îmândan Îhsâna* Tasavvuf

 **PROGRESI** sh.p.k _____

Adresa: L: Vasil Shanto Rr: Çajupi Shkodër / Shqipëri
Tel: +355 22 25 46 34 Fax: +355 22 25 46 33
Mob: +355 67 20 86767
http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797 e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Osman Nuri Topbash

TASAVVUFI ose MISTIKA ISLAME

nga besimi në mirësi

Shkodër, 2016



“Në emër të Individualitetit tim të lartë, betohem për diellin dhe ndriçimin e tij të paraditës, për hënën kur e ndjek diellin, për ditën që e nxjerr në dukje diellin dhe për natën që e fsheh diellin, për qiellin dhe për Atë që e ngriti qiellin, për tokën dhe për Atë që e shtriu tokën, për veten e njeriut dhe për Atë që, pasi e krijoi, ia mësoi të mirat e të këqijat, se:

kush e pastron veten nga të këqijat (nga papastërtitë materiale e shpirtërore), **sigurisht që ka shpëtuar, kurse kush e zhyt veten në të këqija, sigurisht që ka dështuar!**” (Shems, 1-10)

Betimi i Zotit jo vetëm ka për qëllim të bëjë të ditur vlerën dhe nderin e qenieve mbi të cilat bëhet betimi, por, në thelb, për të treguar rëndësinë dhe madhësitinë e synimit dhe qëllimit hyjnor të shprehur pas atij betimi. Kështu qëndron çështja edhe te betimi i bërë në këto ajete, por me këtë ndryshim:

Në këto ajete, Zoti betohet shtatë herë një pas një dhe, për ta fuqizuar kuptimin, përdor fjalën “kad” (sigurisht, absolutisht) dhe vetëm pas kësaj mbështetjeje dhe përforcimi të kuptimit, bën të ditur se **“kush e pastron veten, sigurisht që ka për të arritur shpëtimin; në të kundërt, kush e fëlliq veten me mëkate dhe kotësi, pa dyshim që do të pësojë disfatë...”**

Është për t’u theksuar se, në Kur’an, Zoti nuk betohet kështu, shtatë herë një pas një, veçse për pastrimin e vetes (frymës, egos njerëzore). Kjo e vërtetë është e mjaftueshme për të treguar se në ç’skallë është i domosdoshëm pastrimi i vetes për shpëtimin e njeriut.

Ja, pra, kjo vepër e shkruar nën titullin **“Tasavvufi ose mistika islame nga besimi në mirësi”** është shpjegimi i kësaj të vërtete kur’anore me anë të bukurive të fjalëve, sjelljeve dhe qëndrimeve të miqve të Zotit!



PARATHENIE

Lavdi të pafund Zotit që i ka dhuruar njeriut, të cilit i ka fryrë nga fryma e vet, thellësi ndjeshmërie e meditimi metafizik!

Paqja e Zotit qoftë mbi robin dhe të dërguarin e Tij, profetin Muhammed, të cilin Ai e bëri të merituarin e shfaqjeve më të përsosura të kësaj thellësie ndjeshmërie e meditimi dhe ia dhuroi njerëzimit si një personalitet shembullor, mbi familjen, shokët dhe të gjithë pasuesit e tij!

Nuk ka dyshim se tasavvufi ose mistika islame është jeta ndjesore, thelbi dhe aspekti shpirtëror i Islamit. E shprehur ndryshe, si rrjedhojë e shndërrimit veçanërisht të këtij thelbi dhe fryme të tij te njerëzit e aftë, në veprim, Islami i lartëson në kulm cilësitë e zemrës së besimtarit, si frymën shpirtërore, frymëzimin e begatshëm, dashurinë dhe afërsinë hyjnore dhe ekstatën. Kjo do të thotë se mistika është bërë njëra nga degët më frytdhënëse të pemës së diturisë dhe kulturës së lartë të kopshtit të Islamit. Kështu, gjer më sot, mbi mistikën janë shkruar shumë vepra të bukura që u janë drejtuar:

- më shumë njerëzve të aftë të meditimit të thellë e të lartë (elitës);
- edhe elitës, edhe shtresave të gjera popullore (masës);
- veçanërisht që i kanë folur masës.

Një pjesë e këtyre veprave, si *Fususul Hikem ve Insani Kamil*,¹ janë shkruar në një nivel që mund të kuptohet vetëm nga njerëzit kompetentë të meditimit të thellë e të lartë. Kurse një pjesë tjetër, si *Methnevija* e Mevlanait,² ka një përmbajtje që vende-vende u drejtohet mendjeve mediuete, kurse vende-vende, masave popullore të nivelit të zakonshëm. Këto janë për ata që i kanë plotësuar dituritë formale, që, duke u mbështetur në një meditim dhe frymëzim moralo-shpirtëror më të gjerë brenda përmbajtjes së dijenive që zotërojnë, të bëhen të merituarit e Zotit, e të vërtetës dhe e njohjes intuitive³ të Zotit. Krahas kësaj, ka edhe libra mistikë si *Envvarul Ashikin*, *Muhammedije* dhe *Nefehatul Uns*, të shkruara për masat e gjera

1 Vepër e Abdulkerim el-Xhiliut.

2 Poeti dhe mistiku i madh persian, Xhelaleddin Rumi. (Përkthyesi)

3 Në origjinal: marifetullah, njohja dhe afërsia intuitive e Zotit, e ndryshme nga intuita e psikologjisë materialiste. (Përkthyesi)





popullore. Këto kanë për qëllim për t'i përsosur, deri në një farë niveli, në ndjenja, mendësi dhe sjellje, masat e gjera popullore që kanë arritur t'i kuptojnë të vërtetat kanunore.

Kjo shumëllojshmëri në veprat mistike ka për qëllim ta bëjë edhe masën, edhe elitën, të cilët përbëjnë shoqërinë, që, me aq sa ta kenë mundësinë njohëse dhe zbatuese, të fitojnë aftësinë për ta kuptuar dhe praktikuar Islamin në përputhje me përsosmërinë e përmbajtjes së tij. Kështu, njerëzit, ashtu siç thonë të parët, bëhen me dy flatra.

Me të gjitha këto aspekte, mistika e cila i drejtohet dhe i flet çdo shtrese të shoqërisë, edhe në kohët e mirëqenies ekonomike e shoqërore, duke iu bërë pengesë ndjenjave të rehatisë dhe lëshimit, i ka dhënë vazhdimësi gjallërisë, edhe në kohët e vështira të pushtimeve dhe dhunës, u ka hapur dritare e u ka dhënë frymë zemrave të shtypura mes konfliktit dhe krizave, është bërë melhem për zemrat e plagosura, ngushëllim dhe qetësim për mendjet e lodhura dhe ujë jetëdhënës për shpirtat e etur. Ndërsa nga njëra anë, mistika, duke u sugjeruar thjeshtësi dhe përkorësi atyre që janë lartësuar në moralin e bukur dhe adhurim, i ka mbrojtur nga krenaria, vetëpëlqimi dhe mendjemadhësia, nga ana tjetër, shpirtave të mbytur në gropën e mëkatit, u ka zgjatur, si një gomë shpëtimi, falje të gjerë, mirëkuptim, mëshirë dhe dhembshuri.

Edhe sot, njerëzimi i tërë vërtitet në vorbullat e një shqetësimi të tmerrshëm dhe të anktheve të ndryshme. Nevoja që ndjehet në një kohë të tillë për bukuritë dhe virtytet mistike që u dhurojnë zemrave shërim, kurrë nuk mund të mohohet. Sepse shpirtat dhe zemrat e lodhura të sa e sa vëllezërve tanë të saposhpëtuar nga kulari i ateizmit, të cilët, si të ishin zogj të plagosur, kanë nevojë për mjekim moralo-shpirtëror, janë, në këtë përmbajtje, kërkues dhe pritës të një eliksiri. Me të vërtetë, si njerëzit në lindje, ashtu edhe ata në perëndim, me shpirtin të mbërthyer nga kriza e materializmit, me anë të forcës tërheqëse dhe bukurive të mistikëve të mëdhenj e njohin Islamin në fillim, pastaj e duan dhe, më në fund, kapen fort pas fesë së vërtetë që e ndan të mirën nga e keqja.⁴

Të gjitha këto tregojnë se, me strukturën dhe përmbajtjen e saj të thellë, mistika është, në duart e besimtarit, një ngushëllues e qetësues islamik

4 Në origjinal: dini mubin, feja diferencuese; kështu cilësohet feja islame që bën diferencim midis të mirës dhe të keqes, të vërtetës dhe gënjeshtërs.



i pamënjaueshëm, një dhunti frymëzimi, begatie e maturie. Prandaj mistika paraqet një rëndësi shumë të madhe edhe për përsosjen e muslimanëve, edhe si pretekst i orientimit të jomuslimanëve në rrugën e drejtë, edhe për ta reflektuar Islamit drejt tek ta.

Mistika e vërtetë është si një pasqyrë zemre që do t'ua reflektojë shekujve dhe brezave të ardhshëm gjer në kiamet jetën e bekuar të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Është për këtë arsye që frymëzimi, begatia dhe dashuria për Zotin dhe Profetin (s.a.s.) kanë jetuar për shekuj të tërë ndër zemra me të njëjtën gjallëri dhe freski, jetojnë dhe do të jetojnë!

Është për këtë arsye që Islami vazhdon ta ruajë fuqimisht qenien dhe ndikueshmërinë e tij pavarësisht nga dobësia e sotme materiale e muslimanëve!

Është për këtë arsye që armiq të e fshehur e të hapur të Islamit, duke e trajtuar çështjen sikur trupi dhe shpirti të ishin gjëra të ndara nga njëra-tjetra, përpiqen ta tregojnë mistikën si një sistem botëkuptimor të ndarë nga Islami. Për rrjedhojë, meqë personat që nuk e njohin çështjen, mund të gënjehen mbi mistikën dhe të zvarriten në një opozitë të pavend ndaj saj, shprehja dhe trajtimi i të vërtetave mistike gjithmonë në mënyrë të drejtë dhe korigjimi i gabimeve është bërë një domosdoshmëri shumë e rëndësishme. Gjithsesi, jo vetëm për shkak të kësaj domosdoshmërie, por edhe për t'ua ofruar të gjitha zemrave bukuritë për të cilat folëm pak më lart, fusha e mistikës është pothuaj si një det veprash.

Ja, pra, edhe ne, po me të njëjtin zell, u përpoqëm të derdhim në këtë det një pikë nga një zemër e varfër. Themi "një pikë" sepse, ngaqë mistika përbëhet jo aq sa nga "fjalët", nga "ndjenjat", po qe se me këtë vepër do të bënim punën e një ure në orientimin dhe shtytjen e zemrave drejt pranisë së lartë, do ta quanim veten tejet fatmirë!

Në këtë kontekst, në veprën tonë, pas dhënies në mënyrë të përgjithshme të përmbajtjes së mistikës, u përpoqëm t'i shpjegojmë specifikat e tilla si njohja intuitive e Zotit (marifetullah), ndjenja e dashurisë dhe afërsisë ndaj Zotit (muhabbetullah), pastrimi ose nxjerrja e pafajshme e vetes (tezkiye-i nefis), purifikimi i zemrës (tasfiye-i kalb), stili mistik, etj. U përpoqëm të jepnim shembuj së pari nga sjelljet e Profetit, pastaj edhe të njerëzve të mëdhenj të Islamit, trashëgimtarë të tij. Vende-vende parashtruam të dhëna në formën e përgjigjes ndaj një sërë lëkundjesh dhe pikëpamjesh opozitare





lidhur me thellësinë dhe delikatesat e mistikës jo duke atakuar personat, por vetëm në nivel ideje. Veçanërisht, në vepër, prekëm çështjen se praktikat e meta, të padenja e të pavend të disa personave të mangët nga edukata e dëshiruar nga mistika, si rrjedhojë ose e injorancës së tyre pavarësisht se me qëllim të mirë, ose e indiferencës dhe mosvlerësimit të gjërave, nuk kanë të bëjnë aspak me rrugën e bekuar të mistikës.

Përgjithësisht, me të gjitha këto aspekte, kjo vepër është formalisht një realizim i autorit, kurse vërtetësisht, e miqve të Zotit. E thënë ndryshe, të gjitha begatitë dhe bukuritë moralo-shpirtërore në këtë vepër janë reflektime të larta të arritura te ne nga bota ndjesore e njerëzve të Zotit. Detyra jonë ka qenë vetëm mbledhja dhe sistemimi i tyre sipas nevojave dhe kushteve të ditës. Prandaj, gjatë përgatitjes së veprës, jo vetëm që përfituam nga veprat e tjera të shkruara më parë, por edhe patëm ndihmën e shumë miqve tanë si “libra të gjallë”. Këtë fakt dëshirojmë ta nënvizojmë me kënaqësi dhe krenari për ta.

Duke u dhënë fund fjalëve tona, e quajmë për detyrë ndërgjegjeje t’u paraqesim lutjet dhe dashurinë tonë të kulluar njerëzve të Zotit, aktet e shquara të të cilëve janë përmendur në këtë vepër, si dhe miqve tanë akademikienë që kanë dhënë kontributin e tyre.

Zoti ynë! Begatisë dhe ndikueshmërisë së ndjenjave dhe mendimeve tona që patëm guximin t’i shprehim mbi botën e gjerë të mistikës pavarësisht nga pamjaftueshmëria e diturisë dhe njohjes sonë, dhuroju një varg të pambarim begatie që, me lejen Tënde, do të shfaqet te lexuesit tanë të nderuar!

Allahu im! Me pretekstin e këtij shërbimi të varfër të zemrës sonë, bëna ne dhe lexuesit tanë të nderuar të merituar të dhuntive të Tua të pafundme me favorin dhe bujarinë Tënde të pafundme! Dhe favorizoji këto dhunti me një përmbajtje të shkëlqyer siç e kërkon madhështia e famës Tënde të lartë!

Amin, ashtu qoftë!

Osman Nuri TOPBASH
YSKYDAR, 2002





PJESA E PARE



PERBERJA E TASAVVUFIT OSE MISTIKES ISLAME

A. LINDJA E TASAVVUFIT

B. PERKUFIZIMI I TASAVVUFIT

1. Tasavvuft është moral i bukur dhe edukatë
2. Tasavvuft është pastrimi i vetes dhe purifikimi i zemrës
3. Tasavvuft është një luftë moralo-shpirtërore pa paqe
4. Tasavvuft është principialitet dhe sinqeritet
5. Tasavvuft është orientim
6. Tasavvuft është pëlqim dhe nënshtrim

C. TEMATIKA E TASAVVUFIT

D. QELLIMI I TASAVVUFIT

E. NEVOJA E TASAVVUFIT

F. MARREDHENIET E TASAVVUFIT ME SHKENCAT DHE ARTET

1. Tasavvuft dhe shkencat e tjera islame
 - a) *Tasavvuft dhe Kelami*
 - b) *Tasavvuft dhe Tefsiri*
 - c) *Tasavvuft dhe Hadithi-Sijeri*
 - d) *Tasavvuft dhe Fikhu*
2. Tasavvuft dhe shkencat e natyrës
3. Tasavvuft dhe Letërsia
4. Tasavvuft dhe Artet e Bukura
 - a) *Muzika*
 - b) *Arkitektura*
 - c) *Bukurshkrimi i Kur'anit*
5. Tasavvuft dhe Filozofia

G. DIJA E DOBISHME





“Thuaj i besova Allahut, pastaj vihu në rrugë të drejtë!” (Muslim, *Iman*, 62)



PERBERJA E TASAVVUFIT

Pa dyshim, te i Dërguari i Allahut është modeli përsosur për ju, për besimtarët që shpresojnë se do të arrijnë takimin me Allahun dhe ditën e ahiretit, dhe që e përmendin Allahun shumë!” (el-Ahzab, 21)



A. LINDJA E TASAVVUFIT

Përveç dhuntive të pafundme që ia ka dhuruar njeriut dhe para së gjithash, Zoti i ka favorizuar atij nga lartësia e vet hyjnore, vlerën më të lartë, për të cilën shprehet kështu:

وَنَفَّخْتُ فِيهِ مِنْ رُوحِي

“Dhe i fryva (një të fshehtë) nga Shpirti Im (nga fuqia ime)!” (Hixhr, 29) Dhe, në shkëmbim të kësaj, ka dëshiruar prej njeriut ta adhurojë Individualitetin e Tij të Lartë me dashuri dhe, më në fund, duke përfituar nga afërsia ndaj Tij, të arrijë takimin me Të!

Për t’u mundësuar robve të Tij të arrijnë të vërtetën, Zoti i Lartë i ka favorizuar njeriut një sërë vetish të larta. Përveç kësaj, u ka bërë njerëzve mirësi duke ngarkuar me detyrën e profetit nga radhët e njerëzve disa nga robtë e Tij me krijim të posaçëm e të merituar të vahjit ose zbulesës hyjnore. Kurse në kohët e mungesës së profetëve, e ka vazhduar këtë mirësi ndaj njerëzve me anë të robve të Tij të mirë, trashëgimtarë të profetëve.

Specifika e dërgimit të profetëve që shpreh një ndihmë përjashtuese të Zotit për njerëzimin, ka nisur me Hz. Ademin (a.s.) me qëllim për ta përfshirë tërë njerëzimin. Hz. Ademi është edhe njeriu i parë, edhe profeti i parë.

Kjo rrugë orientimi e bekuar, duke u mbështetur dhe përforcuar për një kohë shumë të gjatë me anë të mëse njëqind e njëzet mijë profetëve të





ardhur varg si një tufë drite mes rrymave të fuqisë hyjnore, i ka përftuar një zhvillim paralel përparimit të shënuar nga njerëzimi. Ky varg që ka vazhduar të zgjatet me anë të një kumtimi në përshtatje me veçoritë e periudhave përkatëse dhe nivelin e bashkëbiseduesve e, më në fund, të gjejë përkryerjen te profeti i fundit, Hz. Muhammedi (s.a.s.), ka arritur kulmin më të lartë.

Duke u shfaqur me dritën e tij para Hz. Ademit dhe me trupin, pas të gjithë profetëve, Hz. Muhammedi (s.a.s.) është bërë fleta e parë dhe e fundit e kalendarit profetik. E thënë ndryshe, kalendarit profetik ka filluar me Dritën Muhammediane, krijesën e parë, dhe është mbyllur me Trupin Muhammedian. Prandaj, ai është, për nga koha, profeti i fundit, kurse, për nga krijimi, profeti i parë.

Ngaqë motivi i qenies i gjithë ekzistencës është Drita Muhammedia-
ne, Zoti e ka krijuar Hz. Muhammedin me një dinjitet të tillë që të meritojë të thirret prej Tij, “Habibi” (i dashuri im). Duke e edukuar në mënyrën më të bukur në përmbajtje e në formë jetën e zgjedhur dhe përjashtimore të Profetit (s.a.s.), Zoti ynë ia ka favorizuar atë si dhuratë tërë njerëzimit.

Karakterit dhe personaliteti i bekuar i të Dërguarit të Allahut, qoftë edhe vetëm me shfaqjet e tij që mund të rroken nga njohja njerëzore, përbën majën më të paarritshme të poetikës së sjelljeve njerëzore. Sepse Allahu (xh.xh.) e ka bërë atë qenie të bekuar një “Usve-i Hasene”, modelin e moralit më të përsosur për të gjithë njerëzimin. Është si rrjedhojë e kësaj që Zoti, duke e marrë atë nga fëmijëria e jetimit, nivelit më të ulët shoqëror për sa i përket dobësisë ekonomike e shoqërore dhe duke e kaluar, pastaj, nëpër të gjitha shkallët e jetës, e ka ngjitur në pikën më të lartë të fuqisë dhe kompetencës, në pozitën e profetit dhe kryetarit të shtetit, në mënyrë që çdokush që ndodhet në një shkallë çfarëdo të jetës njerëzore, duke i marrë për vete si model sjelljet e tij më të përsosura, të priret për t’i realizuar me aq sa t’i ketë aftësitë dhe mundësitë.

Në fakt, Zoti deklaroi se Profeti përbën për të gjithë njerëzit nga dërgimi i tij si profet e gjer në fundin e botës, një model:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ

لِمَن كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا





“Pa dyshim, te i Dërguari i Allahut është modeli më i përsosur për ju, për besimtarët që shpresojnë se do të arrijnë takimin me Allahun dhe ditën e ahiretit, dhe që e përmendin Allahun shumë!” (el-Ahzab, 21)

Kjo do të thotë se i gjithë njerëzimi është i detyruar që, për të arritur përsosmërinë e tij besimore dhe moralo-etike, e thënë në mënyrë më përgjithësuese, përsosmërinë e tij të sjelljes mistike, t’i mësojë denjësisht jetën dhe veprimtarinë e atij njeriu të bekuar. Në fillim, në raport me aftësitë e secilit, mësimi ka karakter imitues, pastaj, me kohë, duhet të synojë të ketë karakter logjik, gjë që, gjithashtu, realizohet në raport të drejtë me afërsinë dhe dashurinë që ndjehet ndaj Profetit dhe mundësinë për të hyrë në botën shpirtërore të tij. Në begatimin duke u emocionuar me të ka pjesë dhe shfaqje të panumërta. Përpjekja për të marrë pjesë, me sa kemi mundësi, nga personaliteti shembullor dhe jeta ndjesore e Profetit (s.a.s.), për t’u pajisur me moralin e tij, është nderi më i madh në këtë botë e në jetën e pasme, ahiret.

Zoti i botërave e ka krijuar dhe edukuar Profetin tonë, krenarinë e gjithësisë, me natyrën më të bukur të jashtme e të brendshme, gjë që ai vetë e ka shprehur me këto fjalë:

“Mua, Zoti im më edukoi dhe sa bukur më edukoi!” (Sujuti, *Xhamiu’s-Sagir*, I, 12)

Nga dita kur erdhi në këtë botë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) jetoi dyzet vjet mes një shoqërie tmerrësisht injorante. Pavarësisht nga kjo, ai u rrit nën mbrojtjen dhe edukimin hyjnor. Atij nuk iu ngjit asnjë prej mëkateve të periudhës së injorancës. Madje, në cilësinë e përgatitjes për profetësinë, iu hap gjoksi i bekuar dhe iu pastrua zemra profetike, e cila, pastaj, iu stolis me begati dhe bukuri moralo-shpirtërore.

Edhe para profetësisë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) bëri një jetë fisnike brenda përmbajtjes së tevhidit, besimit monoteist në një Zot të vetëm, veçanërisht në kohët afër ngarkimit me detyrën e profetësisë, ia kushtoi veten synimit për t’u bërë një rob i vërtetë i Allahut (xh.xh.). Ai u tërhoq në malin Nur në periudha të gjata vetmie dhe u kredh në meditime të thella. Shkaku i kësaj tërheqjeje ishte, në dukje, mëshira e tij gjithëpërfshirëse ndaj gjithë botës nëpërmjet vuajtjeve të reflektuara në zemër nga gjendja e perversitetit, mizorisë dhe mjerimit ku pat rënë populli, kurse në thelb dhe në të vërtetë, kalimi i një periudhe përgatitore që do të bënte të mundur përçjelljen e Kur’anit, pishtarit të përjetshëm të njerëzimit, nga lartësia hyjnore në njohjen njerëzore nëpërmjet zemrës së pastër muhammediane. Me këto





shfaqje, bota e tij e zemrës, duke arritur një kthjellim të vërtetë, arriti në një nivel që të mund ta kuptonte vahjin ose komunikimin hyjnor. Ajo zemër e bekuar që ishte bërë e gatshme për vahjin, gjatë gjashtë muajve mori shenja dhe frymëzime shpirtërore në formën e ëndrrave besnike. Kështu, atij iu hapën perdet e të fshehtave nga bota shpirtërore. Kjo gjendje ishte stina e daljes në dukje të kapacitetit krijimor për bartjen e një barre të rëndë, e pamundur, kjo, për njerëzit e zakonshëm, siç ishte pozita e bashkëbiseduesit të komunikimit hyjnor. Krejt si kthimi në çelik i hekurit me anë të kapacitetit në esencën e hekurit të papërpunuar...

Krenaria e gjithësisë, Profeti ynë (s.a.s.), bashkoi në personalitetin dhe sjelljet e tij tërë kompetencat dhe detyrat e të gjithë profetëve. Fisnikëria e prejardhjes dhe e edukatës, lumturia e bukurisë dhe e përkryerjes arritën kulmin tek ai. Ai parashtrroi konkluzione. Duke praktikuar purifikimin e zemrës dhe pastrimin gjer në pafajshmëri të unit (nepsit, egos), që janë thelbi i tasavvufit, mistikës islame, ai u mësoi të tjerëve adhurimin dhe lutjen ndaj Zotit me zemër të kulluar. Duke përjetuar moralin më të bukur, u bë modeli më i përsosur për njerëzimin. Kurse mosha detyzjeçare u bë pikë-kthesa më me rëndësi për të dhe për njerëzimin.



Në thelb, tasavvufi është përmirësimi cilësor i botës sonë ndjesore duke arritur në një nivel të tillë që të mund të marrë pjesë nga njohja intuitive e Zotit, dashuria dhe intimiteti ndaj Tij, për rrjedhojë, që të mund të vijë në konsistencën për t'u bërë i merituar i bashkimit hyjnor. Kjo konsistencë, fryma që ka për të na shpëtuar ne, është një trashëgim i shenjtë i mbetur nga Hira dhe Thevri. Sepse ky edukim moral-shpirtëror që e ka bërë Profetin (s.a.s.) qoftë në këto mjedise të posaçme, qoftë në mjedise dhe kohë të tjera, ta ndjekë në konceptim vahjin ose zbulesën hyjnore, përbën truallin e begatshëm të purifikimit të zemrës dhe pastrimit të unit gjer në pafajësi.

Profeti ynë (s.a.s.) i cili kishte arritur një nivel ndjesor dhe shpirtëror të caktuar para se t'i vinte vahji ose komunikimi hyjnor, bënte një jetë të shquar dhe kishte një moral të lartë. Por kur u kthye nga shpella e Hiras me një porosi hyjnore, kishte arritur një nivel të lartë që e kalonte shumë e shumë jetën e tij të vjetër. Ai kaloi në një lidhje ndjesore të thellë e të fuqishme me Zotin e tij të Lartë dhe, duke e thithur dritën e tevhidit dhe intuitës së njohjes së Zotit me të gjithë qenien e vet, arriti kulmin në devocionin dhe





përshpirtshmërinë në adhurim. Ai e vazhdoi adhurimin netëve mes lotëve gjersa i enjteshin këmbët, zemra i mbeti e zgjuar edhe nëse iu mbyllën sytë dhe nuk u largua për asnjë çast nga përmendja e Allahut, meditimi dhe vetëllogaria.

Me të vërtetë, me anë të përmbajtjes diturore dhe të urtësisë të parashtruar nga Kur'ani që iu zbulua, ajo Qenie e Lartë i la të paaftë edhe njerëzit e zgjedhur të kohës dhe me anë të jetës dhe veprimtarisë së tij, u shndërrua në një det mrekullie të paarritur gjer atë ditë dhe të pamundur për t'u arritur gjer në kiamet! Më në fund, asnjë zbulim që mund të bëhet gjer në kiamet nuk do të mund ta përgënjeshtrojë dot atë dhe asnjë edukator nuk do të mund ta arrijë kapacitetin e edukatës së tij!

Me kohë, kjo konsistencë ndjesore dhe shpirtërore te Profeti (s.a.s.) u ngjiti në cilësi edhe më të larta dhe ai, me miraxhin si dhurata e pashoqe e Zotit për njeriun më të dashur të Tij, u bë "udhëtar përjetësie". Atë natë ai, si i ftuari i posaçëm i Zotit të vet, kaloi përtej së përtejmi dhe, siç shprehet në Kur'an, meritoi të fshehtën:

قَابَ قَوْسَيْنِ أَوْ أَدْنَىٰ ۝ ٥

Kjo dhuratë e madhe hyjnore e emërtuar si Isra dhe Miraxh, është një favor i realizuar përtej njohjes njerëzore duke i ngritur të gjitha pengesat njerëzore dhe plotësisht me masa dhe kriterë hyjnore. Koncepti i hapësirës dhe kohës në kuptimin njerëzor u hoq, një udhëtim më i gjatë se jetëgjatësia e miliarda njerëzve dhe vëzhgimet përkatëse ngjanë brenda një kohe shumë të shkurtër. Profeti (s.a.s.) kapërceu botët, katedrën hyjnore, rezidencën hyjnore dhe sidretul muntehanë dhe, si i merituar i shfaqjes së shikimit të Zotit, meritoi dhuntinë përjashtimore të bisedës pa ndërmjetës me Zotin e vet.

Me këtë konsistencë dhe pjekuri ndjesore të arritur në sajë të favorit hyjnor, Profeti (s.a.s.) e vazhdoi kumtimin e fesë së drejtë me dëshirën passionante për ta orientuar dhe sjellë në rrugë të drejtë tërë njerëzimin dhe vetëdija e zbatimit të këtij amaneti hyjnor që i ishte dorëzuar, e bëri atë

5 **Kabe kavsejni ev edna.** Natën e miraxhit, Profeti (s.a.s.) u kalua përtej pozitës së quajtur Sidretul Munteha, kufirin e së cilës s'e pati kapërcyer asnjë krijesë përfshi edhe vetë Xhebrailin. Në distancën e cilësuar në përshtatje me aftësinë njohëse njerëzore si **sa gjatësia e dy harqeve të bashkuara ose më pak**, u realizua një takim pamundësisht i konceptueshëm e i njohshëm për njeriun. Shih. Kur'ani, Nexhm, 9.





kulmin e kulmeve. Ai i hodhi poshtë pa lëkundje të gjitha propozimet materiale të lidhura me këtë botë, të cilat do ta pengonin në kryerjen e detyrës dhe e konceptoi nënshtrimin dhe adhurimin ndaj Zotit mbi gjithçka. Kjo ngjarje që ka ndodhur në periudhën e parë të kumtesës profetike, e shpreh shumë bukur këtë të vërtetë.

Nëpërmjet Ebu Talibit, politeistët i dërguan fjalë Profetit (s.a.s.) për t'i kërkuar që të hiqte dorë nga çështja e tij. Dhe Profeti (s.a.s.) i foli kështu të ungjit duke i dhënë edhe përgjigje kërkesës së politeistëve:

“O im ungj, vallahi, edhe sikur të ma vënë diellin mbi dorën e djathtë dhe hënën, mbi të majtën për të hequr dorë nga kumtimi i fesë, unë prapë s’do të heq dorë nga kjo çështje! Ose Allahu i Lartë do ta përhapë atë në të gjithë botën, ose unë do të jap jetën në këtë rrugë!”⁶

Politeistët e shqetësuar nga lindja e dritës së Islamit, pasi nuk morën rezultat nga iniciativa duke përdorur si ndërmjetës Ebu Talibin, shkuan vetë te i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe guxuan t’i bëjnë këto propozime:

“Po deshe të bëhesh i pasur, të japim aq pasuri sa të mos ketë më të pasur se ti ndër të gjitha fiset!”

“Po deshe të bëhesh prijës, të të bëjmë prijësin tonë: bëhu sundues i Mekës!”

“Po të kesh ndërmend të martohesh me një femër fisnike, të të japim femrën më të bukur të kurejshve që të duash!”

“Jemi gati të bëjmë ç’të duash ti, mjafton që të heqësh dorë nga kjo çështje!”

Duke iu përgjigjur menjëherë të gjitha propozimeve të ulta dhe egoistike të atyre njerëzve që s’kuptonin gjë prej gjëje, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u tha kështu:

“Unë prej jush s’dua asgjë, as mall, as pasuri, as sundim, as prijësi, as femër! E vetmja gjë që kërkoj prej jush është që, duke hequr dorë nga idhujt që jeni duke i adhuruar, ta adhuronit vetëm Allahun!”⁷

Ky qëndrim dhe këto deklarata që, pa dyshim, janë model për gjithë njerëzimin, janë shfaqja më e mrekullueshme e vetëdijes së detyrës dhe vendosmërisë në besim. Është gjendja e pastër dhe ideale e pozitës së robit dhe adhurimit ndaj Zotit! Sepse këto lloj propozimesh dhe kërkesash të pavend për Profetin (s.a.s.) do të thoshin heqje dorë nga përjetësia në shkë-

⁶ Shih. Ibnul Ethir, *el-Kamil fi’t-Tarih*, II, 64.

⁷ shih. Ibni Hisham, *es-Sire*, I, 236.





mbim të kësaj bote. Me të vërtetë, historia e njerëzimit është e mbushur me thirrje e ftesa të botës ndaj egove për të shkuar pas saj si dhe me zhgënjime të panumërta dhe sa e sa vullnete të tretura përballë stolisjes së rreme të dëshirave dhe pasioneve të përkohshme e të vdekshme duke e mbuluar dhe fshehur të përjetshmen.

Në fakt, krahas Kur'anit i cili fillon me lavdërim dhe falenderim për Zotin e botërave dhe, duke i pastruar zemrat nga ndjenjat dhe mendimet negative e nga lëkundjet, mbaron me urdhrin për t'u mbështetur në kuptimin absolut të fjalës të Zoti i vetëm i krijesave, i cili është udhëzues teorik i rrugës së drejtë për njerëzimin gjër në kiamet, ecja në rrugën dhe gjurmët e Profetit (s.a.s.) i cili është udhëzuesi praktik i njerëzimit, është preteksti dhe mjeti i vetëm i lumturisë njerëzore që përfshin horizontet e dy botëve! Me ç'gjë do të ishte e mençur të shkëmbehej heqja dorë nga kjo dhunti?

Kur'ani i është dhuruar Profetit tonë (s.a.s.) dhe, nëpërmjet tij, gjithë njerëzimit. Kjo fjalë hyjnore e thërret njeriun që, duke e njohur veten, të kalojë nga vepra te autori, nga shkaku te shkaktari, nga arti te artisti dhe nga krijesa te Krijuesi! Më në fund, Kur'ani, e mëson njeriun që, duke e përmendur shumë Allahun, ta kalojë gjithë jetën mes ndjenjave të mirësisë dhe devocionit sikur ta kishte para e ta shihte Atë dhe, kështu, duke arritur vetëdijen e ndodhjes nën një vëzhgim dhe kontroll të vërtetë hyjnor, të gjejë rrugët për t'u bërë konfident i dashurisë dhe pëlqimit hyjnor.

Duhet të dihet se burimi i vetëm i mëshirës dhe dashurisë që çon në detin e afërsisë dhe dashurisë ndaj Allahut, është Profeti ynë, Hz. Muhammedi (s.a.s.), ashtu që afërsia dhe dashuria ndaj Profetit, është afërsi dhe dashuri ndaj Allahut, bindja ndaj tij është bindje ndaj Allahut, kurse kundërshtimi ndaj tij ka vlerën e kundërshtimit ndaj Allahut!

Siç e prekëm më lart, motivi i qenies së ekzistencës është dashuria e krijuesit të Dritës Muhammediane për atë dritë e cila është e para në krijim. Prandaj, tërë gjithësia është krijuar për nder të Dritës Muhammediane si krijimi i parë dhe si mjedis për të. Kulmi i kësaj gjithësie mjedis për Dritën Muhammediane, për sa i përket meritimit të favoreve hyjnore dhe si objekt i tyre, është njeriu. Dhe kulmi i tërësisë njerëzore është trupi muhammedian. Siç dihet, te njeriu përmbahet tërë gjithësia, prandaj njeriu quhet edhe mikrokozmos, gjithësi në miniaturë. Duke qenë një lis i madh i fshehur te fara, një trup qiellor i fshehur te molekula dhe një shoqëri njerëzore e fshehur te individ, njeriu është një qenie thelbësore që bart në trupin e vet për-





mbledhjen e formimeve pozitive e negative, të mëdha e të përgjithshme. Në oqeanin e molekulave të njeriut i cili, si rrjedhojë e këtyre vetive, është “qenie e nderuar”, është një kulm përtej imagjinatës, trupi profetik. Ata që janë bërë bashkëbisedues të tij, e kanë kuptuar Krenarinë e Gjithësisë në raport me kapacitetin dhe fuqinë e vet dhe sipas dashurisë apo armiqësisë së vet ndaj tij. Atyre që e duan, ai u duket dritë, kurse atyre që e urrejnë, zjarr. Te ky dallim cilësor është shfaqur dallimi në konceptimin e trupit muhammedian mes Hz. Ebu Bekrit dhe Hz. Aliut, nga njëra anë, dhe Ebu Xhehlit, nga ana tjetër. Pse kanë mundur ta shohin Zotërinë e Botëve me dashuri dhe afërsi të madhe, Hz. Ebu Bekri me Hz. Aliun, duke zbritur në esencë, kanë merituar nderin për të përbërë hallkën e parë në vargun e artë të tasavvufit ose mistikës islame.



Ja, pra, tasavvufi ose mistika islame është shkrirja me Profetin (s.a.s.) me një dashuri të thellë për të duke u bërë një nga ana e jashtme dhe në përmbajtje me jetën e tij të bekuar, sepse tasavvufi është ana e jashtme dhe përmbajtja e personalitetit të Profetit (s.a.s.), janë shfaqjet e jashtme e të brendshme të personalitetit të tij, është gjendja e tij shpirtërore. Prandaj tasavvufi është identiteti i mundësisë për të marrë pjesë nga bota shpirtërore e Profetit (s.a.s.) dhe sintetizim shpirtëror me të. E shprehur ndryshe, tasavvufi është bukuri e besimit të bashkuar me pasionin shpirtëror, bukuri e adhurimit dhe sjelljes së kryer me ekstazë. Përgjithësisht, tasavvufi është vesa begatuese e një dhuntie sublime të nisur me “fryrjen shpirt Ademit (a.s.)”, e cila u reflektohet zemrave të mbushura me dashuri nga shfaqjet e përsosmërisë tek Profeti i Kohës së Fundit!

Për ta kuptuar cilësinë e përcjelljes, në jetën e Profetit (s.a.s.), të kësaj kompetence dhe pushteti që përbën thelbin e tasavvufit, në këtë mënyrë, nga zemra në zemër dhe nga individi në individ, i duhet hedhur një vështrim i përgjithshëm tërësisë së jetës dhe veprimtarive të atij njeriu të bekuar.

Siç është personalitet shembullor në çdo fushë të jetës, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) është shembulli më i bukur edhe në edukimin dhe pastrimin e njerëzve. Si profet, ai ka shumë detyra dhe kompetenca, por mes tyre, këto katër detyra të dhëna atij nga Zoti, dalin në pah dhe fitojnë rëndësi edhe më të madhe:

1) Marrja e revelacionit ose zbulesës hyjnore. Profeti ynë (s.a.s.) ka merituar të marrë fjalën hyjnore të dërguar nga Allahu i Lartë përgjithësisht me anë të Xhebrilit (a.s.). Cilësia për të qenë bashkëbisedues i zbule-





sës hyjnore, që pati gjetur realitet me dëshirën volitive dhe favorin e Zotit, mori fund me transferimin e Profetit (s.a.s.) në vendin e përjetësisë.

2) Komentimi dhe shpjegimi i konkluzioneve, urdhrave dhe të vërtetave të zbritura me anë të Kur'anit, gjë që e shohim te hadithet profetike dhe biografia profetike. Kjo kompetencë ose autoritet shkencor i të Dërguarit të Allahut është vazhduar nga ana e muxhtehidëve ose ideatorëve.

Përballë nevojave dhe domosdoshmërive të reja të jetës njerëzore, komentimi dhe shpjegimi i konkluzionit hyjnor vazhdon të bëhet nën emërtimin "ideatim" (ixhtihad). Edhe nëse duket sikur kjo veprimtari disa herë është ngritur në raft kur nuk janë gjetur njerëz kompetentë për ta vazhduar, nevoja dhe domosdoshmëria për të kanë vazhduar të mbeten po të njëjta gjithmonë. Kjo detyrë u përket dijetarëve që arrijnë pozitën e ideatimit (ixhtihadit).

3) Zotërimi i autoritetit administrativ që i zbaton dhe i mban gjallë në formë institucioni dhe rregulli urdhrat dhe ndalimet fetare. Edhe kjo detyrë është marrë në dorëzim dhe ndjekur nga kalifët.

4) Pastrim dhe rregullim i botës së brendshme të njerëzve duke vepruar mbi shpirtat. Ashtu siç është detyrim dhe e detyrueshme që të gjitha detyrat e tjera që i takonin të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), me përjashtim të përcjelljes së vahjit ose zbulesës hyjnore, të vazhdohen nga ata që e ndjekin atë, ashtu është detyrim dhe e domosdoshme që edhe detyra e pastrimit dhe rregullimit të botës së brendshme të njerëzve të mos marrë fund por të vazhdohet gjer në kiamet nga ana e prijësve shpirtërorë. Sepse vetëm e vetëm në këtë mënyrë mund të bëhet pastrimi jo vetëm i botës së jashtme të besimtarëve, por edhe i botës së brendshme të tyre. Ja, pra, burimi kryesor i metodave dhe parimeve mistike përbëhet nga vazhdueshmëria në çdo kohë dhe mjedis i kësaj veprimtarie profetike, fryma e së cilës është e pranishme në Kur'an dhe në hadithe. Kjo domosdoshmëri dhe nevojë është burimi i prijësve shpirtërorë dhe i të vërtetës së vazhdueshmërisë së pandërprerë të tyre.



I Dërguari i Allahut (s.a.s.) është qendra dhe kulmi i vlerave dhe virtuteve formale e përmbajtësore të adhurimit, moral-etikës dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore. Kur ai u nis për të emigruar në Medine pas trembëdhjetë vjetësh veprimtarie kumtimi dhe edukimi të Mekës, iu tregua **shpella e Thevrit**. Aty u përjetuan disa shfaqje, sepse kjo shpellë ishte një mësonjëtoare për rrokjen e disa lloj urtësish hyjnore dhe për zhvillimin e ndjenjave.





Profeti bujti aty tri ditë e tri net. Por ai nuk ishte vetëm. Ai kishte për shok Hz. Ebu Bekrin (r.a.), më të lartin e njerëzve pas profetëve. Hz. Ebu Bekri (r.a.) kishte arritur nderin dhe virtytin për t'i bërë shoqëri Profetit (s.a.s.) në shpellë gjatë tri ditëve e netëve. Ai qe bërë “**i dyti ndër dy vetët** (pranë të cilëve i tretë qe Allahu)”. Të fshehtën e ndodhjes bashkë me Allahun, Profeti ia sugjeronte shokut të vet të çmuar duke i thënë:

لَا تَحْزَنْ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا

“... **mos u dëshpëro, Allahu është me ne!**” (et-Tevbe, 40) Ky sugjerim dhe ky transmetim ndjesor është interpretuar, në të njëjtën kohë, si fillimi i dhikrit (zikrit) dhe shfaqja e parë e ngopjes së zemrave me Allahun. E thënë ndryshe, në tasavvuf ose në mistikën islame, kjo njihet si shfaqja e parë në historinë islame e transmetimit të të fshehtës nga zemra në zemër, Hz. Ebu Bekri (r.a.), si partneri i parë fatlumtur i kësaj të fshehte dhe shpella e Thevrit, si mjedisi i parë i këtij transmetimi. Prandaj, Hz. Ebu Bekr Besniku (r.a.) është konsideruar si hallka e parë pas Profetit (s.a.s.), e **Vargut të Artë** që do të vazhdojë të zgjatet gjer në kiamet. Pra, shpella e Thevrit është bërë mjedisi i një etape të rëndësishme të edukimit ndjesor themelor për ta bërë robin konfident hyjnor nëpërmjet hapësirës së pafundme të të fshehtës.

Nga ana tjetër, përcillet se Profeti (s.a.s.) ia ka mësuar dhe praktikuar dhikrin e hapur edhe Hz. Aliut (r.a.). Mësimi dhe praktikimi i dhikrit i cili është njëri prej sugjerimeve më të rëndësishëm të tasavvufit, në këtë mënyrë, i është lënë, nga njëri krah, Hz. Ebu Bekrit (r.a.) dhe, nga krahu tjetër, Hz. Aliut (r.a.).

Për sa i përket faktit që, në të vërtetë, tasavvufi përbën thelbin e fesë, tasavvufi ka qenë i pranishëm në jetën e të gjithë profetëve nga Hz. Ademi (a.s.) gjer në shekullin e lumtur. Kështu, në jetën e çdo profeti mund të gjenden mjaft parime të tasavvufit. Por kompilimi i tasavvufit si një ditori sistematike me kuptimin e sotëm dhe shfaqja e tij si një rrugë e ndjekur ka filluar së pari në shekullin e dytë të hixhrit.

Në shekullin e lumtur ende nuk ishin formuar shkollat e kelamit (apologjetikës islame), akaidit (besimit) dhe fikhut (të drejtës juridike-fetare). Megjithëkëtë, konkluzionet besimore, juridike, etj. ekzistonin edhe para shfaqjes së shkollave në fjalë dhe u mësoheshin dhe praktikoheshin saha-beve nga Profeti (s.a.s.). Ndërkaq, ato ende nuk ishin kompiluar brenda metodave shkencore. Pas një periudhe të caktuar, për shembull, ideatimet





e dijetarëve të mëdhenj të konsideruar si autoritete në shkencën e fikhut, u përvetësuan dhe u sistemuan nga nxënësit e tyre dhe vijat apo metodat e ndryshme ideatore të tyre u emërtuan “shkolla” (medhhebe) dhe shkollat ose medhhebet morën emrat e atyre dijetarëve dhe ideatorëve të mëdhenj, si shkolla *hanefite*, shkolla *shafiite*, shkolla *malikite*, shkolla *hambelite*. Këto shkolla u pranuan nga masa të mëdha popullatash si metoda dhe rrugë të zgjidhjes së nevojave juridike-besimore.

Si në dituritë e tjera fetare, edhe jeta e adhurimit dhe devocionit e sugjeruar nga tasavvufi jetohej në të njëjtin drejtim në shekullin e lumtur. Me kalimin e kohës, Miqtë e të Vërtetës që e patën bërë të tyren këtë mënyrë jetese shpirtërisht të begatë dhe i jepnin vazhdimësi asaj, duke u nisur nga qëllimi për të penguar që njerëzit të jepeshin pas kësaj bote e të kridheshin në indiferentizëm, për pëlqim të Zotit i këshilluan ata dhe ua tërhoqën vëmendjen për t’i zgjuar nga indiferentizmi. Por këta persona nuk kishin ndonjë qëllim për të hapur një brazdë të re apo për të krijuar një rrugë dhe mënyrë jetese. Qëllimi ishte të jetohej bukur në përputhje me thelbin e Islamit dhe adhurimet të kryheshin me përshtetshmëri ashtu siç tregohej në Kur’an dhe Sunnet. Ndërkaq, njerëzit që deshën të përfitonin nga bisedat dhe këshillat e tyre dhe të merrnin për vete pjesë nga gjendja e tyre, i pranuan këta persona si prijës dhe mësues moralo-shpirtërorë për vete. Pastaj, duke i metodizuar këshillat e tyre, domethënë mënyrat e pastrimit dhe edukimit të vetvetes që e çojnë besimtarin në pjekuri shpirtërore dhe orientim, i shndërruan në disiplinë moralo-shpirtërore. Si përfundim, u krijuan **tariketet**, të cilave iu dedikuan emrat e prijësve dhe mësuesve në fjalë, si tarikati *kadirit*, tarikati *melevit*, tarikati *nakshibendit*, etj.

Mënyrës ose metodës që ndoqi çdo krah mistik në specifika të tilla si afrimi te Allahu, meditimi dhe fitimi i ndjenjës të së mirës, iu dha emri **tarik**. Sipas metodave të tyre, tariketet ndahen në tre lloje:

1) **Tariketet e rrugës Ahjar** (të virtuozyetit, kënaqësisë dhe bukurisë): tariketet e përqëndruara në adhurim dhe devocion.

2) **Tariketet e rrugës Ebrar** (të mirësisë): tariketet e përqëndruara në edukimin e vetvetes (unit) me anë të mundimit dhe shërbimit.

3) **Tariketet e rrugës Shuttar** (të forcës dhe aftësisë): tariketet që kanë vënë si qëllim të arrijnë synimin me anë të pasionit dhe ekstazës.

Me këtë pretekst, çdo besimtar, për pastrimin moralo-shpirtëror dhe pjekurinë shpirtërore, mund të futet në një tarikat që i përshtatet karakterit të vet. Meqë karakteret janë të ndryshme, është e natyrshme që edhe tariketet të jenë të ndryshme e të shumëllojshme.





Në Kur'an, Allahu thotë:

لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شُرْعَةً وَمِنْهَا جَا

“Për secilin nga ju caktuam një sheriat dhe minhaxh.” (el-Maide, 48)

Fjalës “minhaxh”, fjalorët i japin kuptimin “rrugë e ndritshme”, gjë që do të thotë rrugë adhurimi që do të ndiqet me qëllim për t’iu afruar Zotit. Edhe të mëdhenjtë e tasavvufit kanë thënë:

“Rrugët që çojnë te Zoti janë po aq sa numri i frymëve të krijesave (njerëzore)!”

Nga ana tjetër, konkluzionet kur'anore ndahen në tri lloje:

- 1) Itikad (bazat e besimit)
- 2) Fikh (e drejta juridike-besimore)
 - a) Ibadet (adhurimi)
 - b) Muamelat (marrëdhëniet ndërnjerëzore ose civile)
 - c) Ukubat (penaliteti)
- 3) Ahlak (moral-etika ose e drejta afektive)

E drejta afektive është përmirësimi i botës së brendshme, domethënë, morali dhe etika. E drejta afektive përbën anën e brendshme të bindjes dhe sjelljeve praktike përkatëse. Duke përfutur nivel me të drejtën ndjesore, aktet shndërrohen në akte të mira (salih amel). Në Kur'an, cilësitë më me rëndësi që tregojnë situatat e pranueshme ndjesore janë: devocioni (takva), adhurimi (zuhd) dhe mirësia (ihsan).

Takva (devocioni): Është, brenda ndjenjës së përgjegjësive ndaj Allahut, vetëmbrojtja e zemrës (ndjenjave) duke zbatuar me këmbëngulje urdhrat dhe ndalimet hyjnore.

Zuhd (adhurimi): Është humbja e rëndësisë në zemër nga vanitetet (të gjitha gjërat e tjera veç Zotit).

Ihsan (mirësia): Është, për besimtarin, ndjenja e ndodhjes nën vëzhgimin hyjnor dhe vazhdimi i sjelljes nën këtë ndjenjë.

Në hadithin profetik thuhet:

(الإِحْسَانُ) أَنْ تَعْبُدَ اللَّهَ كَأَنَّكَ تَرَاهُ فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ

“Ihsan është të adhurosh sikur ta shihje Allahun, sepse edhe nëse ti s’e sheh Atë, Ai patjetër që të sheh ty!” (Buhari, Iman, 37; Muslim, Iman, 1) Me fjalë të tjera, ihsani ose mirësia është që shpirti ta kthejë vëzhgimin e Allahut në një





gjendje vetëdijeje të vazhdueshme. Lartësimi i zemrës në nivele cilësore gjithmonë e më të larta është i mundur duke qenë çdo çast nën këtë ndjenjë dhe vetëdije dhe duke e rregulluar gjithë jetën sipas kësaj bindjeje. Ja, pra, me formimin e kësaj gjendjeje zemra arrin në purifikim. Nga ky aspekt, tasavvufi është shprehje e arritjes së purifikimit të zemrës.



Qëllimi final i fesë është të përgatisë njeri me shpirt të hollë dhe me botë të brendshme të pastër. Njeriu ideal sipas Islamit është personi i pajisur me moralin e të Dërguarit të Allahut, kurse rruga për të arritur këtë ideal kalon nëpër edukimin e zemrës (edukimin ndjesor).

Ta bësh elementin zemër (ndjenjë) vend të reflektimit të shfaqjeve të Zotit si të ishte një pasqyrë e shkëlqyer, është e mundur nëse zikri (përmendja e Zotit) gjen mjedis në të. Orientimi i zemrës me këtë gjendje të bukur në drejtim të Zotit, bëhet pretext për shfaqjet e shkëlqyera të besimit.

Po qe se nuk do të mbahej hapur rruga e përparimit shpirtëror me anë të *adhurimit (zuhd)*, *devocionit (takva)* dhe *mirësisë (ihсан)*, por do të urdhërohej në mënyrë kategorike mjaftimi vetëm me konkluzione formale, njerëzve me kapacitete të larta shpirtërore do t'u hiqej nga dora mundësia për t'u bërë konfidentë të Allahut, në të njëjtën kohë, kapaciteti shpirtëror maksimal i njeriut do të nënvleftësohej dhe mënjanohet. Në këto kushte, cilësisë rregulluese hyjnore të Zotit, i cili është zotëruesi i urtësisë në çdo vullnet dhe konkluzion, do t'i atribuohet relativitet.

Siç e shprehëm, koncepti **ihсан** (mirësi) që do të thotë vetëkorrigjimi sipas mendimit të vëzhgimit të Zotit në çdo çast dhe rregullimi i jetës nga njeriu në këtë drejtim, si dhe duke e fiksuar vëzhgimin hyjnor në zemër, shndërrimi i tij në vetëdije, është, në një aspekt, miraxhi shpirtëror i robve (njerëzve) të afërt të Allahut. Nga ky aspekt, *ihсан*-i është e vërtetë morale, shpirtërore, fshehtësie konfidenciale dhe hyjnore. Synimi ose objekti final i mistikëve është pikërisht arritja e kësaj të vërtete, gjë që shpreh lidhjen shpirtërore dhe të brendshme të ngritur me Allahun. Personi që e ngre këtë lidhje në mënyrë të shëndoshë, shndërrohet në rob të zgjedhur të Zotit. Në këtë mënyrë, ai pajiset dhe vishet me moralin hyjnor.

Por në kushtet kur nuk arrihet dot kjo e vërtetë, personi mbetet i dënuar të mjaftohet me formalitetin dhe imitimim që janë të pafuqishëm për të realizuar afrimin konfidencial me Zotin!





Morali i Profetit (s.a.s.) dhe jeta shpirtërore e jetuar prej tij, u muar shembull nga sahabet, tabiinët dhe tebei tabiinët dhe rezultatet formale e përmbajtësore, të dukshme e të padukshme, të shpjgueshme e të pashpjgueshme të kësaj jete u përcollën nga brezi paraardhës në brezin pasardhës. Ndërkaq, jeta moralo-shpirtërore që vazhdon në këtë mënyrë është pronë e gjithë ummetit (bashkësisë) ose i përket gjithë ummetit dhe jo një grupi të posaçëm.



Megjithëse botëkuptimi themelor islam është i tillë, më shumë ata që e shohin tasavvufin ose mistikën islame me një vështrim formal ose që mbajnë ndaj tij qëndrim negativ, kanë hedhur në shesh pretendime të ndryshme mbi burimin e tij.

Siç ka nga ata që, duke u nisur thjesht nga ngjashmëria tingullore, pretendojnë se kjo veprimtari e çmuar e ka prejardhjen nga “sofos”-i që greqisht do të thotë “urtësi”, “dituri”, “gojëtar”, ka edhe nga ata që kanë hedhur në shesh pikëpamje të ndryshme të pavend, nga ata që i sajojnë tasavvufit prejardhje supersticioze, gjer te ata që e lidhin me misticizmin indian. Të gjitha këto janë pikëpamje të gabuara të parashtruara duke u dhënë peshë ngjashmërive tingullore ose përmbajtësore.

E vërteta është se, për çështjen e prejardhjes së fjalës “tasavvuf”, pikëpamjet mes dijetarëve islamë parashtrojnë se tasavvufi është krejtësisht me burim islam. Në këtë specifikë, ndërsa thuhet se fjala “tasavvuf” mund të ketë prejardhje nga fjalët “safa”, “safvet” dhe “istifa” që do të thonë “purifikim” dhe “përzgjedhje”, pranim të përgjithshëm ka fituar pikëpamja sipas së cilës rrjedh nga emri “suf” i pelerinës prej leshi të hollë që vishnin disa asketë të përkushtuar adhurimit (të mbiquajtur “ubbad” dhe “zuhhad”), ndër sahabet, shokët e Profetit, të njohur me cilësimin e posaçëm “ehli suffe” (shokët e sufës), mënyra e jetesës dhe e të menduarit të të cilëve është bërë, pastaj, bazë teorike e mënyrës së të menduarit dhe jetesës së tasavvufit (ose mistike islame).

Grupi i sahabeve, shokëve të Profetit, të mbiquajtur “ehli suffe” që banonin në Faltoren Profetike me synimin për të marrë dituri, kulturë dhe pasuri shpirtërore, me nxitjen e Profetit (s.a.s.), u kualifikuan dhe u lartësuan në asketizmin adhurimor (zuhd) dhe devocion (takva). Për më tepër, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u pati kërkuar sahabeve të pasur që t’u jepnin ndihmë shokëve të sufës për ushqim dhe strehim. Këto rrethana janë një





e vërtetë historike që tregojnë pozicionin e sjelljeve dhe qëndrimeve mistike islame ndaj Sunnetit të Profetit (s.a.s.) dhe mbështetjen e tyre mbi një miratim profetik.

Përballë kontradiktave që nxorën krye mes brezit të sahabeve pas vdekjes së Profetit (s.a.s.), bashkëkohësit ndër shokët e sufës, duke mos treguar konsideratë për asnjërën anë, mbetën të paanshëm. Për më tepër, duke nxjerrë mësim nga dobësimi i vëllazërisë mes muslimanëve që patën shkaktuar kontradiktat dhe konfrontimet në fjalë, sufitët u thelluan edhe më tej në adhurim dhe devocion, gjë që u bë pretekst për shtimin e haresë mistike. Edhe disa sahabe që e patën parë moralisht dhe shpirtërisht të rrezikshme përzjerjen në kontradikta dhe konfrontim, u bashkuan me sufitët dhe, kështu, u vu re një shtim në numrin e atyre që zinin rrugën e adhurimit dhe devocionit.

Nga fjala *suf* që emërtonte atë pelerinën prej leshi të hollë, rodhi fjala *ehli sufe, sufitët*, që emërtonte sahabet që e vishnin, ata sahabe të varfër pa shtëpi e katandi që strehoheshin në faltoren profetike dhe ushqeheshin me lëmosha, por që, ndërkaq, shquheshin në dituri, kulturë, adhurim dhe devocion; pastaj, tradita diturore, kulturore, adhurimore dhe e devocionit, ose, e thënë ndryshe, rruga e mendësisë dhe e jetesës e krijuar prej tyre, mbështetur në besimin e fuqishëm ndjesor në Allahun sipas conceptualitetit islam, u emërtua *tasavvuf* ose, siç i themi ne ndryshe, *mistika islame*, kurse kompetentët dhe specialistët e tasavvufit u emërtuan *mutasavvifë* ose *mistikë islamë*. Gjatë zhvillimit historik, këto emërtime dhe terma fituan gjithmonë e më shumë qëndrueshmëri cilësore, kurse tasavvufi ose mistika islame u institucionalizua.



Meqë dijetarët islamë morën dhe mbajtën për parim besnikërinë ndaj Kur'anit dhe Sunnetit, Traditës Profetike të profetit Muhammed (s.a.s.), edhe mistikët islamë që ecnin në rrugën e devocionit, në veprat e tyre, ashtu siç bënë ideatorët (muxhtehidët), i mbështesnin pikëpamjet mistike me të vërtetat besimore-juridike (me të vërtetat e shariatit ose kanonike). Ndërkaq, në këtë rrugë, në një sërë tarikatesh ku prijësit shpirtërorë ose, sipas terminologjisë së mistikës së tarikateve dhe teqeve, shehlerët, nuk zgjidheshin ndër njerëzit që pranonin anën formale ose kanonike të besimit, ndodhën disa rrëshqitje (devijime) modalitetesh për shkak të haresë mistike, ndërkaq që vetëm prijësit shpirtërorë ose shehlerët e tarikateve të





zgjedhur ose të ardhur nga radhët e dijetarëve dhe njerëzve që e pranoin anën formale ose kanonike të besimit, arritën të mbrohen nga këto devijime modalitetesh. Konkluzioni figurativ i famshëm, “këmba e palëvizshme (gjilpëra) e kompasit është sheriat (ligji kanonik)” mbi besnikërinë ndaj të vërtetave kanonike të nakshilizmit dhe të të tjerëve të ngjashëm me të që ecën gjatë zhvillimit historik brenda kuadrit të përmbajtjes së Kur’anit dhe Sunnetit, është bërë një parim i dobishëm për të gjithë.

Kështu, poeti Mevlana Xhelaleddin Rumi shprehet:

“Ne jemi si kompas: me këmbën e fiksuar në shariat, me këmbën e lëvizshme shëtisim të gjitha kombet!”

“Sheriati i përngjet qiririt: bën dritë dhe tregon rrugën. Por rruga nuk kapërcëhet vetëm duke e marrë qiririn në dorë; po kështu, pa marrë qiririn në dorë, nuk dilet në rrugë. Nëse ke dalë në rrugë dhe ke nisur të ecësh nën dritën e shariatit, ja, kjo ecja jote është tarikat!”





Tasavvufi është përpjekja për ta jetuar fenë në një mënyrë cilësore në përshtatje me thelbin e saj duke u zhveshur nga papastërtitë materiale-shpirtërore dhe duke fituar moralin dhe cilësitë e bukura.



B. PERKUFIZIMI I TASAVVUFIT

Meqë tasavvufi ose mistika islame është një dituri që njihet dhe shihet duke u jetuar ose sa më tepër që të jetohet, shpjegimi i tij i përkryer brenda mundësive të kufizuara të fjalëve është i vështirë. Për këtë shkak, miqtë e Allahut i kanë bërë përkufizime të ndryshme kristalit të tasavvufit që reflekton dritëra të ndryshme nga çdo faqe e tij, duke mbajtur parasysht faqen që sheh nga ta.

Miqtë e Zotit dhe ndjekësit e kësaj rruge moralo-shpirtërore e virtuale kapërcejnë distanca në zhvillimin e tyre virtual në raport të drejtë me kapacitetet dhe mundësitë e veta si dhe shfaqjet situative që dalin në pah në zemrat e tyre. Prandaj dhe e kuptojnë ndryshe nga njëri-tjetri tasavvufin sipas shfaqjes tek ta të frymëzimeve ndjesore të botës shpirtërore. Ndërkaq, të gjithë këta persona që e kanë përkufizuar tasavvufin, sipas këndvështrimit të tyre, kanë të drejtë. Kurse ne, duke parë këto lloj përkufizimesh, mund të kemi vetëm një ide të përgjithshme mbi përbërjen dhe natyrën e tasavvufit.

Sipas aspekteve të përbashkëta të këtyre përkufizimeve të ndryshme, mund të themi se tasavvufi është dituria e cila, duke i rregulluar botët e brendshme të besimtarëve, i zhvillon ata shpirtërisht, duke e bërë robin të arrijë moralin e lavdëruar, e afron atë te Zoti dhe, kështu, e bën të arrijë njohjen intuitive të Zotit, të cilësuar marifetullah.



Disa nga përkufizimet e panumërta të tasavvufit të bëra nga miqtë e Zotit sipas shfaqjeve shpirtërore për të cilat kanë qenë të merituar, janë këto:





1. Tasavvufi është moral i bukur dhe edukatë

Morali i bukur është, duke e shpëtuar besimin nga imitimi duke fik-suar në zemër ndjenjën e mirësisë që u jep orientim ideve dhe sjelljeve, do-methënë gjendjen shpirtërore të shikimit të Zotit, shndërrimi i besimit në element sundues dhe të pandarë të personalitetit dhe jetesa në këtë rrugë.

Duke u shprehur si më poshtë, Ebul Husejn en-Nuri ka nënvizuar lidhjen e pashkëputur mes tasavvufit dhe moralit:

“Tasavvufi nuk është as formë, as dituri; ai është vetëm moral i bukur. Po të ishte formë, do të merrej me luftë e përpjekje, po të ishte dituri, do të merrej e fitohej me të mësuar. Prandaj, vetëm forma dhe dija nuk të çojnë dot në synim. Tasavvufi është veshja me moralin e Zotit!”

Edhe pse tasavvufi nuk është shqiptuar si fjalë në jetën shembullore të Profetit (s.a.s.), ekziston cilësisht dhe vërtetësisht në të. Me moral të bukur bëhet fjalë për moralin e lavdërueshëm të Profetit dhe pajisja me atë moral. Morali i tij është mbështetur dhe lartësuar nga Zoti ynë në Kur’an me këto fjalë:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“Pa dyshim, ti qëndron mbi një moral të lartë!” (el-Kalem, 4)

Edhe Hz. Aisheja (r.anha), kur e kanë pyetur për moralin e të Dërguarit të Allahut, ka thënë:

“Morali i tij ishte Kur’ani!” (Muslim, *Musafirin*, 139)

Po qe se robi vishet me moralin e Kur’anit dhe orientohet sipas konkluzioneve të Kur’anit, shndërrohet pothuaj në një Kur’an të gjallë. Këndimi i Kur’anit duke medituar mbi kuptimin e tij dhe jetesa në përputhje me konkluzionet e tij përbëjnë pikën kulmore të moralit të bukur.

Profeti Muhammed (s.a.s.) është ngarkuar me detyrën për t’i ndriçuar të gjitha kohët dhe hapësirat nga çasti kur u dërgua si profet, gjer në kiamet. Nisur nga kjo, të gjitha sjelljet e tij, gjer te hollësitë më të vogla e më intime, na janë përcjellë neve me një rrëfim të saktë dhe kjo përcjellje është bekuar me begatinë e vazhdueshmërisë në formë vargu të pandërprerë. Po të shqyrtohet jeta profetike, do të shihet që përkryerja njerëzore dhe kulmi i moralit të bukur është profeti Muhammed (s.a.s.). Ai e ka përkufizuar detyrën e tij me fjalët *“Unë jam dërguar jo për gjë tjetër, veçse për të plotësuar moralin e bukur”* (Imam Malik, *Muvatta*, Husnu’l-hulk, 8) dhe për të gjithë njerëzimin është bërë usve-i hasene, model i moralit të lartë!





Në Kur'an, morali muhammedian shprehet kështu:

“Me të vërtetë, te i Dërguari i Allahut ka një model të përsosur për ju, për besimtarët që shpresojnë të takohen me Allahun, të arrijnë ditën e ahiretit dhe që e përmendin Allahun shumë!” (el-Ahzab, 21)

Zoti ynë i Lartë do të bëjë që, si një dhuratë për ne, morali i bukur të vazhdojë pa ndërprerje gjer në kiamet duke filluar nga Profeti ynë (s.a.s.) nëpërmjet **verethetul enbija**,⁸ trashëgimtarëve profetikë.

Profeti ynë (s.a.s.) na porositi:

“Më i përsosuri ndër besimtarët për nga besimi është ai me moralin më të bukur!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 250) Duke u shprehur në këtë mënyrë, ai ka treguar se morali është fryt i besimit dhe shenjë e përsosmërisë. Miqtë e Allahut janë udhëzuesit shpirtërorë të veshur pikërisht me moralin muhammedian.

Ebu Muhammed Xheriri e ka nënvizuar këtë të vërtetë duke thënë:

“Tasavvufi është përvetësimi i moralit të bukur dhe largimi nga morali i keq!”

Stolisja e zemrës me moralin e bukur dhe ruajtja prej moralit të keq, sa ç'është e detyrueshme për shpëtimin dhe lumturinë e përjetshme, është po aq edhe një punë e mundimshme. Kështu, Ebu Hashim Sufi, nga mistikët e parë, ka thënë kështu:

“Gërryerja e një mendjemadhësie të ngulitur në zemër është më e vështirë nga gërryerja e malit me gjilpërë!”

Kurse Ebu Bekr el-Kettani thotë:

“Tasavvufi është moral. Ai që është epror ndaj teje në moral, është epror edhe në pastërtinë shpirtërore!”

Historia e njerëzimit është e mbushur plot me shfaqje të sjelljeve morale të një bukurie të pashoqe të profetëve. Një prej shembujve më të bukur të kësaj është, pa dyshim, Jusufi (a.s.), i cili, siç shprehet në ajetin kur'anor, u tha kështu të vëllezërve që i patën bërë padrejtësi të hapur:

“... Sot s'ka qortim për ju, Allahu ju faltë! Ai është më mëshiruesi i mëshiruesve!” (Jusuf, 92)

Duke u shprehur kështu, ai pati shfaqur një shembull të jashtëzakonshëm të faljes.

8 **Verethetul enbija**: trashëgimtarët e profetëve, dijetarët e vërtetë të cilët, përsa i përket diturisë, veprimit dhe moralit, janë bërë formalisht dhe në përmbajtje trashëgimtarë të profetëve, në radhë të parë, të profetit të kohës së fundit, Hz. Muhammedit (s.a.s.). Kështu, në një hadith profetik është thënë: *“Dijetarët e vërtetë janë trashëgimtarë të profetëve!”* (Ebu Davud, *Ilm*, 1)





Synimi i mistikut është ta bëjë zemrën, si Hz. Ibrahim (a.s.), të pastër nga kjo botë dhe të bindur ndaj urdhrave hyjnorë, si Hz. Ismaili (a.s.), të nënshtruar ndaj Zotit dhe të pajtuar me përcaktimin hyjnor, si Ejjubi (a.s.), të durueshme. Dëshpërimi i besimtarit duhet të jetë si dëshpërimi i Daudit (a.s.), kurse varfëria, si varfëria dhe ngopja e Hz. Isait (a.s.).

Mistiku është personi që përpiket të ketë një zemër të mbushur plot e përplot me dëshirën dhe harenë e Hz. Musait (a.s.) në çastet e përgjërimit dhe, më në fund, principlialitetin e Hz. Muhammedit (a.s.), domethënë, dashurinë dhe sinqeritetin e tij ndaj Zotit të vet.

Ebu Hafs el-Haddad ka thënë: "Tasavvufi është edukatë!" Me këtë thënie ai e ka përkufizuar tasavvufin si përmbledhjen më të përkryer të moralit të bukur.

Në lidhje me edukatën, poeti Mevlana Xhelaleddin Rumi ka thënë kështu:

"Zotëri! Dije se edukata është shpirti në trupin e njeriut. Edukata është drita e syve dhe e zemrës së ndjekësit të rrugës së Allahut. Po deshe t'ia shtypësh kokën shejtanit, hapi sytë e shih: ajo që e dëshpëron shejtanin, është edukata. Po të mos ketë edukatë te njeriu, ai s'është njeri me të vërtetë. Dallimi mes njeriut dhe kafshës është edukata!

Kurse kuptimi i disa vargjeve të tjera të tij është kështu:

"Mendja ime e pyeti zemrën time: "Ç'është besimi?" Dhe zemra, duke iu përkulur në vesh mendjes, i tha: "Besimi është edukatë!"

Një poet tjetër e ka poetizuar kështu edukatën:

Edukata, një kurorë nga dritë e Zotit na qenka;

Vëre atë kurorë e shpëto nga çdo bela!

Nisur nga kjo, dikur, nëpër teqe apo seli të mistikës varej ky shkrim paralajmërues: "أَدَبٌ يَا هُوَ" (Edukatë, o Ti!)⁹

2. Tasavvufi është pastrimi i vetes dhe purifikimi i zemrës

Si rrjedhojë e faktit që ka ardhur në këtë botë për provën e vetvetes si rob i Zotit, njeriu ndodhet i zënë gjer në kohën kur t'i vijë vdekja, nga një sëmundje që i thonë nefsi (vete, ego) dhe që përmban një mijë e një negativitete. Edhe sikur të ngjitet në shkallët më të larta të përsosmërisë shpirtërore, njeriu ndodhet çdo çast ballëpërballë me dredhitë, dyshimet dhe

⁹ Kjo shprehje kishte edhe vlerën e një paralajmërimi për ata që hynin në teqe apo seli, edhe vlerën e një lutjeje drejtuar Zotit, me kuptimin: "Na fal edukatë, o Zot!"





kurthet e përhershme të treshes botë materiale, nefis (vete, ego) dhe shejtan (djall). Fundja, edhe vlera e të qenit rob i Zotit fillon me eliminimin e këtyre rreziqeve, shmangien nga mashtrimet tërheqëse të kësaj bote të vdekshme, hyrjen në devocion dhe, si rezultat, me orientimin nga Zoti.

Prandaj, pastrimi i vetes dhe purifikimi i zemrës janë të detyrueshëm për t'i edukuar prirjet ndaj së keqes që ekzistojnë në krijimin e njeriut dhe për t'i bërë që të blerojnë farërat e devocionit. Prandaj çdo njeri është i ngarkuar me përgjegjësinë që, në raport me mundësitë dhe fuqitë e veta, ta njohë Zotin dhe, duke e kthyer këtë njohje në kulturë shpirtërore, ta lartësojë dhe madhërojë Zotin me punë të mira. Ja, kjo është shkurt pozita dhe detyra e robit ndaj Zotit. Ndërkaq, për ta arritur këtë cilësi të pozitës dhe detyrës së robit ndaj Zotit, njeriu është i kushtëzuar nga pastrimi i vetes dhe purifikimi i zemrës që do të thonë kapërcimi nga njeriu i pengesës nefis (vete, ego) për t'u mbushur me ndjenja të larta. Dhe vetëm në këtë mënyrë është e mundur arritja e pozitës "vasil-i ilallah"¹⁰ dhe, pastaj, nderimi me "likaullah"¹¹.

Sipas elementit thelbësor të saj, zemra (ndjenja) është, në këtë botë, **na-zargah-i ilahi**, seli e vështrimeve hyjnore. E thënë ndryshe, zemra meriton nderin të jetë post e shfaqjeve të vështrimeve hyjnore. Vetëm se, ashtu siç është e pamundur që në fronin e një mbreti të ulet dikush tjetër veç tij, ashtu dhe zemra, që të bëhet vetëm seli e vështrimeve hyjnore, duhet pastruar nga çdo gjë tjetër veç Zotit, nga mendimet egoiste, nga prirjet e shëmtuara dhe vanitetet. Në të kundërt, zemra mbyllet ndaj favoreve hyjnore. Por kjo nuk do të thotë që nuk duhet ushqyer afërsi dhe dashuri për tjetërkënd veç Zotit. Ç'është e vërteta, ata që e kanë pastruar veten, e kanë purifikuar zemrën dhe kanë arritur në kulmet e zemrës së paqëtuar, janë çliruar nga afërsia dhe dashuria për vanitetet ose, më saktë, për çdo njeri dhe për çdo gjë tjetër veç Zotit. Por njerëzit e tjerë nuk arrijnë dot ta fshijnë gradë-gradë plotësisht nga zemra afërsinë dhe dashurinë për pasurinë, fëmijët, etj. Në fakt, këto lloj afërsish dhe dashurish janë legjitime për sa kohë që nuk e kapërcejnë kufirin e caktuar.

Për ta konceptuar rëndësinë e purifikimit të zemrës mjafton të shihet pozita e zemrës në jetën materiale e moralo-shpirtërore. Profeti ynë (s.a.s.) e ka shprehur kështu rëndësinë jetësore të zemrës tek njeriu:

10 **Vasil-i ilallah:** takimi me Allahun në këtë botë me zemër (me ndjenja).

11 **Likaullah:** bashkimi me bukurinë e Allahut në jetën tjetër (ahiret).





“... Në trupin e njeriut është një copë mishi. Po të jetë mirë ajo, gjithë trupi është mirë; po të bëhet keq ajo, gjithë trupi bëhet keq. Kujdes! Ajo është zemra!”
(Buhari, Iman, 39)

Hz. Mevlana (k.s. – iu shenjtëroftë e fshehta!) thotë se përpjekja për ta mbushur thesin pa ia mbyllur vrimën në fund është një zell i kotë. Si kjo, është e qartë se edhe aktet dhe adhurimet e personit do të mund të bëhen pretekst lumturie për të vetëm po të kryhen me një zemër të purifikuar. Sepse aktet varen nga nijeti ose qëllimi i paracaktuar. Kurse nijeti është një nga aktet e zemrës. Prandaj, korrigjimi i nijetit dhe zbukurimi i tij me principialitet janë kusht.

Kjo cilësi arrihet vetëm si rezultat i edukimit ndjesor të kryer nga ana e kompetentëve. Momenti që synojnë miqtë e Zotit në edukimin e zemrës është arritja e vetëdijes së qenies vazhdimisht bashkë me Allahun, domethënë, arritja e asaj që quhet ihsan dhe, kështu, arritja e cilësisë së zemrës së gjallë. Për të arritur zemra këtë konsistencë, është e domosdoshme që të pastrohet nga vanitetet, domethënë, nga çdo gjë tjetër veç Allahut.

Zemra që arrin këtë konsistencë, arrin t’i shohë të vërtetat e imta e të thella. Me aq sa të shpëtojë nga trashësia dhe turbullia dhe të bëhet delikate dhe e shkëlqyer, zemra bëhet pasqyrë e emrave dhe fshehtësive hyjnore. Kështu, formohet dukuria e quajtur marifetullah, njohja intuitive e Zotit, njohja e Zotit me anë të zemrës. Kjo do të thotë shndërrim i dijes shpirtërore në kulturë shpirtërore (irfan).



Faktin që vetëm ata që do të dalin para Allahut me zemër të paqëtuar, domethënë të purifikuar, me një zemër të pastruar prej të gjitha sëmundjeve moralo-shpirtërore dhe të mbushur plot me dashurinë hyjnore, kanë për të shpëtuar, Allahu e bën të ditur kështu:

يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ

“Atë ditë nuk do të bëjnë dobi as malli, as fëmijët. Me përjashtim të atyre që vijnë me zemër të paqëtuar (kalb-i selim)!” (esh-Shuara, 88-89)

Nga ana tjetër, është përsëri Kur’ani që e ka bërë të ditur kështu se zemrat e papastruara dhe të mbetura larg përmendjes së Allahut, do të shkatërrohen:

“... Beto hem në nefsin dhe në Atë që e ka pajisur nefsin me aftësi dhe e ka frymëzuar për të mira e të këqija, se ai që e pastron veten nga





të këqijat, ka shpëtuar, kurse ai që e ka groposur në të këqija, ka pësuar dëm!” (esh-Shems, 7-10)

“... Sa keq për ata që u është ashpërsuar zemra e s’e përmendin dot Allahun! Ja, këta janë të humburit!” (ez-Zumer, 22)

Ja ç’thonë fjalët kuptimplote të Ebu Said el-Harrazit nën dritën e këtyre ajeteve:

“Njeriu i përsosur është ai që Allahu ia pastron zemrën e ia mbush me dritë!”

3. Tasavvufi është një luftë moralo-shpirtërore pa paqe

Ky përkufizim që i përket Xhunejd Bagdadit, shpreh faktin se tasavvufi është një luftë dhe përpjekje kundër nefsit (vetes, frymës, egos) që vazhdon gjatë gjithë jetës. Lufta kundër nefsit ka për qëllim t’i pengojë të gjitha dëshirat dhe kërkesat jolegjitime të tij.

Luftërat e armatosura bëhen në kohë dhe vende të caktuara dhe mbarojnë. Kurse lufta kundër nefsit duhet të vazhdojë pa ndërprerje gjithë jetën. Në Kur’an është urdhëruar:

“... Vazhdo ta adhurosh Zotin tënd gjersa të të vijë prova (vdekja)!” (el-Hixhr, 99)

Në ajetin si më poshtë, Zoti ka urdhëruar ndenjjen në vigjilencë të përhershme ndaj indiferentizmit që u hap portën dredhive dhe intrigave të nefsit dhe vazhdimit të adhurimit në këtë rrugë:

وَأذْكُرْ رَبَّكَ فِي نَفْسِكَ تَضَرُّعًا وَخِيفَةً وَدُونَ الْجَهْرِ
مِنَ الْقَوْلِ بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ وَلَا تَكُنْ مِنَ الْغَافِلِينَ

“Përmende Zotin tënd mëngjes e mbrëmje në vetvete, duke u lutur e duke u rrëqethur, me një zë jo të lartë! Dhe mos u bëj nga indiferentët!”

(el-Araf, 205)

Kur ushtria e muslimanëve e komanduar nga Profeti po kthehej nga fushata e Tebukut e mbiquajtur “Fushata e Vështirë”, një çast, Profeti u shpreh kështu:

“Tani po kthehem nga lufta e vogël për në luftën e madhe!”

Sahabet, shokët e tij, e pyetën të habitur Profetin: “A mund të ketë luftë më të madhe se kjo?”

Profeti u dha këtë përgjigje:





“Po! Tani po kthehem nga xihadi i vogël (lufta e vogël) për në xihadin më të madh (për në luftën më të madhe), për në luftën me vetveten!” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, II, 73)

Studiuesi bashkëkohor i ynë, R. Garodi, e vlerëson kështu rëndësinë e ekuilibrit mes xihadit të vogël dhe xihadit të madh në Islam:

Tasavvufi që është një formë edukimi shpirtëror krejtësisht islam, në të vërtetë, është lufta e brendshme kundër çdo dëshire që e largon njeriun nga qëllimi final i krijimit dhe që e bën të dënuarin e nefsit, vetvetes. Emërtimi i kësaj në terminologjinë islame është xihadi i madh. Kurse përpjekja kundër çdo pushteti, pasurie dhe njohurie të gabuar që e largojnë muslimanin nga rruga e Allahut duke e bërë për vete, me qëllim për ta siguruar bashkimin dhe unitetin e muslimanëve është emërtuar xihadi i vogël. Ekuilibri mes këtyre dy xihadeve e siguron lumturinë dhe shpëtimin e individit dhe shoqërisë.¹²

4. Tasavvufi është principialitet dhe sinqeritet

Tasavvufi është principialitet dhe sinqeritet ndaj Allahut. Kryerja e të gjitha punëve dhe adhurimeve vetëm për pëlqim të Allahut, në terminologjinë fetare emërtohet me fjalën “ihlas”. Pastrimi nga zemra i të gjitha qëllimeve dhe synimeve përveç pëlqimit të Zotit është një virtutet i madh i caktuar për muslimanin.

Përzjerja e një ortaku në aktet e urdhëruara për të fituar pëlqimin e Zotit është mungesë principialiteti ose dyfytërsi dhe atëherë ato akte s’lënë gjë tjetër në lartësinë hyjnore për autorin e tyre veç një lodhjeje të padobishme. Dhe kjo tregon se kushti më me rëndësi ndër kushtet bazë që i bëjnë aktet të pranueshme në lartësinë e Allahut, është principialiteti (ihlas).

Ihlas (principialiteti) është mbrojtja e zemrës nga çdo lloj interesi të kësaj bote me dëshirën për t’iu afruar Zotit.

Ihlas (principialiteti) i bën njerëzit, robtë e Zotit, të meritojnë pëlqimin hyjnor që është dobia dhe e mira më e madhe.

Dëshira e Allahut të Lartë për adhurimet dhe veprimet e robve të vet është kryerja e tyre vetëm në mënyrë të përshtatshme me pëlqimin e Tij. Në Kur’an urdhërohet:

“(O i Dërguar!) Pa dyshim, ta zbritëm Librin ty si të vërtetë. Atëherë, edhe ti adhuro (me principialitet dhe sinqeritet) duke ia kushtuar fenë vetëm Allahut!” (ez-Zumer, 2)





“Thua: “Unë jam urdhëruar ta adhuroj Allahun (me principialitet dhe sinqeritet) duke ia kushtuar fenë Atij!” (ez-Zumer, 11)

Iblisi (djalli) i përzënë nga prania hyjnore, siç thuhet në Kur’an, u shpreh kështu:

“... Zoti im, edhe unë do t’ua zbukuroj atyre mëkatet dhe do t’i nxjerr të gjithë nga rruga, me përjashtim të robve të sinqertë!” (el-Hixhr, 39-40)

Tasavvufi është t’ia kushtosh çdo gjë Allahut, të dish se dhuntitë dhe dinjiteti vijnë prej Tij dhe të shpëtosh nga egoizmi. Pavarësisht nga gjendja dhe pozita e lartë ku ndodhet, njeriu nuk duhet të fantazojë për vete se është diçka ose se ka ndonjë epërsi. Me të vërtetë, me rastin e fitores së Bedrit, Allahu i është drejtuar kështu Profetit (s.a.s.):

فَلَمْ تَقْتُلُوهُمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ قَتَلَهُمْ وَمَا رَمَيْتَ إِذْ رَمَيْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ رَمَىٰ

“... Nuk i vratë ju ata, por i vrau Allahu. Edhe kur qëlllove, nuk qëlllove ti, por Allahu!..” (el-Enfal, 17)¹³

Atëherë, njeriu duhet ta ndjejë gjithmonë dobësinë e vet, faktin se është rob i Zotit, dhe ta dijë se çdo mirësi, dhunti, fitore dhe sukses është një favor i ardhur nga Zoti. Në të kundërt, shpërblimi i veprimeve dhe adhurimeve pakësohet ose humbet plotësisht.



Ebu Hurejre (r.a.) njofton se Profeti (s.a.s.) ka thënë kështu për fundin e personave të cilët, duke e humbur principialitetin dhe sinqeritetin në adhurimet e tyre, nxjerrin në pah egoizmin dhe pasionet:

“Në ditën e kiametit, personi i parë që do të japë llogari, do të jetë dëshmori (shehidi, martiri). Ai sillet para Zotit. Dhe Zoti ia kujton dhuntitë që i ka dhënë. Edhe dëshmori i kujton dhe i pohon. Atëherë Zoti e pyet:

“Mirë, po ç’bëre si shpërblim për këto?”

“Luftova në rrugën tënde gjersa rashë dëshmor!” – I përgjigjet personi. Zoti i thotë:

“Po gënjen! Ti luftove që njerëzit të të përmendin për hero dhe ashtu ndodhi!”

¹³ Gjatë luftës së Bedrit, në një çast, Profeti mori një grusht dhé dhe e hodhi në drejtim të qafirëve. Me lejen e Allahut, dheu ua mbushi sytë qafirëve dhe i la të hutuar. Ajeti i mësipërm zbriti pas kësaj ngjarjeje.





Pastaj jepet urdhër dhe ai person hidhet me fytyrë në xhehennem. Pas tij sillet para Zotit një person që ka marrë dituri, që u ka dhënë mësim të tjerëve dhe ka kënduar Kur'an. Zoti ia kujton dhuntitë që ia ka dhënë, edhe personi kujtohet për to dhe i pohon. Zoti e pyet:

"Mirë, po ç'bëre si shpërblim për këto të mira?"

"Mësova dituri, i mësova edhe të tjerët dhe këndova Kur'an për pëlqimin tënd!" – I përgjigjet personi. Zoti i thotë:

"Po gënjen! Ti mësove dituri që të thonë për ty se sa i ditur je dhe këndove Kur'an që të thonë se sa bukur këndon. Dhe të gjitha këto u thanë!"

Edhe për të jepet urdhër dhe hidhet me fytyrë në xhehennem. Pastaj sillet një person të cilit Zoti i pati dhënë çdo mundësi materiale dhe pasuri. Zoti ia kujton dhuntitë, edhe personi i kujton dhe i pohon. Zoti e pyet:

"Mirë, po ç'bëre ti si shpërblim për këto të mira që t'u dhanë?"

"Nuk u kurseva të jap nga pasuria në të gjitha ato vende që ti i pëlqen dhe shpenzova vetëm për të fituar pëlqimin tënd!" – I përgjigjet personi. Zoti i thotë:

"Po gënjen! Ti i bëre të gjitha këto që të thonë se ç'njeri bujar je! Dhe kjo u tha!"

Edhe për të jepet urdhër dhe hidhet me fytyrë në xhehennem." (Muslim, Imare, 152)

Hz. Mevlana u bën zë kështu personave që bëjnë adhurime të mangëta nga principialiteti:

"O i paditur dhe indiferent! Eh, sikur ta ktheje me sinqeritet fytyrën nga Zoti kur bije në sexhde dhe ta dije denjësisht kuptimin e thënies "Zoti im i lartë është i pastër nga çdo lloj atributi mangësie", domethënë të bëje jo sexhde vetëm sa për formë, por sexhde zemre!"

Adhurimet pa principialitet dhe sinqeritet janë plot me ortakë të vdekshëm dhe papastërti moral-shpirtërore. Atëherë, sekret i purifikimit dhe lartësimit të adhurimeve qëndron te ihlasi (principialiteti dhe sinqeriteti). Adhurimi i bërë pa principialitet dhe sinqeritet nuk i siguron njeriut asnjë dobi. Jo vetëm kaq. Ata që e kryejnë namazin, urdhrin më të rëndësishëm të fesë pas besimit, pa respektuar kushtin e principialitetit dhe sinqeritetit, i nënshtrohen kërcënimit të tmerrshëm hyjnor:

"Sa keq për ata që falen por që nuk e marrin seriozisht namazin dhe veprojnë për dukje!.." (el-Maun, 4-6)

Khunejd Bagdadi (k.s.) thotë kështu:

"Ihlasi është kthjellimi i veprimtimit (adhurimit) nga turbullia moral-shpirtërore!"





Kurse një mik tjetër i Allahut thotë kështu:

“Pretendimi në principlialitet është një lloj mungese principlialiteti!” Sepse rreziku më i madh në principlialitet dhe devocion është kur personi e sheh veten posaçërisht principlial e të devotshëm.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“*Ji i sinqertë në fe sepse, po qe kështu, edhe pak adhurim të mjafton!*” (Hakim, Mustedrek, IV, 341)

“*Allahu i Lartë nuk sheh pamjen dhe pasurinë tuaj, por zemrat dhe veprimet tuaja (për sa i përket sinqeritetit dhe devocionit)!*” (Muslim, Birr, 34)

5. Tasavvufi është orientim

Në tasavvuf, shprehja e plotë e lidhjes fort pas Kur’anit dhe Sunnetit është orientimi (istikamet). Duke iu drejtuar Profetit dhe, në personin e tij, gjithë ummetit, Zoti urdhëron:

فَاسْتَقِيمْ كَمَا أُمِرْتَ وَمَنْ تَابَ مَعَكَ وَلَا تَطْغَوْا

“O i Dërguar! Bashkë me ata (besimtarët) që pendohen, që janë pranë teje, qëndroni të orientuar, siç je urdhëruar, dhe mos e teproni!..” (Hud, 112)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë kështu:

“*Mua më plakuri sureja Hud!*” (Tirmidhi, Tefsir-i Sure, 56/6)

Komunikimi hyjnor i mësipërm¹⁴ që është bërë shkak që Profeti (s.a.s.) të shprehet kështu, është kuptuar nga komentuesit në këtë mënyrë:

“O Profet! Duhet të sillesh e veprosh siç e kërkojnë morali dhe konkluzionet e Kur’anit dhe të bëhesh një model konkret orientimi me qëllim që të mos mbetet hapësirë për asnjë dyshim dhe lëkundje mbi ty! Ti mos shih se ç’flasin politeistët dhe hipokritët poshtë e lart; ata lëria Allahut! Qëndro i orientuar siç duhet qoftë në detyrat e tua të përgjithshme, qoftë në ato të veçanta, mos u shmang nga rruga e drejtë! Sado i rëndë të jetë zbatimi i urdhrit të zbuluar ty, mos u praps nga asnjë pengesë në kumtimin, zbatimin dhe ndjekjen e urdhrit! Zoti do të të ndihmojë!”¹⁵

Lidhur me këtë ajet, Abdullah bin Abbas ka thënë kështu:

“*Nuk ka në Kur’an ndonjë thënie më të ashpër për të Dërguarin e Allahut, se kjo!*” (Nevevi, Sherhu Sahih-i Muslim, II, 9)

Sado që këtu fjala i drejtohet Profetit dhe e plak atë, mundimi i tij nuk ka të bëjë vetëm me atë vetë, sepse Profeti pati merituar mbështetjen hyjno-

14 Shih Kurtubi, el-Xhami, IX, 107.

15 Shih Elmalılı M. Hamdi Yazır, Hak Dini Kur’an Dili, IV, 2829-2830.





re me cilësimin **“ti je në rrugë të drejtë”** (Jasin, 4). Ajo që e ka plakur atë ka qenë më tepër drojtja për besimtarët të cilëve u drejtohej ajo fjalë.



Pas dërgimit të Hz. Muhammedit (s.a.s.) si profet, asnjë rrugë tjetër veç rrugës së treguar prej tij nuk e çon njeriun te Allahu, sepse dashurinë dhe faljen, Allahu i Lartë i ka kushtëzuar me bindjen ndaj Profetit. Në Kur’an urdhërohet:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ
وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“O i Dërguar! Thuaj: **“Po qe se e doni Allahun, ndiqmëni mua që edhe Allahu t’ju dojë juve dhe t’jua falë mëkatet! Allahu është Gafur (Falës) dhe Rahim (Shpërblyes)!”** (Al-i Imran, 31)

“Thuaj: “Bindiuni Allahut, bindiuni edhe Profetit... Po qe se i bindeni atij, e gjeni rrugën e drejtë!” (en-Nur, 54)

Edhe Dhunnun Misri e mbështet këtë të vërtetë duke thënë:

“Personi i cili në aktet dhe veprimet e veta i përshtatet sunnetit të të dashurit të Allahut të Lartë, e provon dashurinë e vet për Zotin!”

Kurse Bajazit Bistami (k.s.) thotë:

“Po qe se shihni dikë që mundet të qëndrojë në ajër këmbëkryq, mos besoni se ajo që shihni është ndonjë shenjë shenjtërie pa parë që ai person i ruan kufijtë e urdhrave dhe ndalimeve hyjnore, është i lidhur pas Sunnetit dhe e respekton ligjshmërinë e Zotit!”

Në Kur’an, për ata që munden të ecin denjësisht në **“sirati mustakim”** që është rruga e njerëzve të orientuar, thuhet:

“Ata që u binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, janë bashkë me profetët, besnikët, dëshmorët dhe të mirët, të cilët janë të favorizuarit e Zotit. Ç’shokë të mirë që janë ata!” (en-Nisa, 69)

Siç shihet nga ky ajet, sirati mustakim (rruga e drejtë) është rruga e njerëzve të zgjedhur. Dhe baza e orientimit (rrugës së drejtë) janë besimi dhe devocioni që kanë për vend zemrën. Prandaj, orientimi është harmonia mes besimit dhe devocionit, nga njëra anë, me trupin, nga ana tjetër. Besimi në zemër, principialiteti dhe matura sigurojnë orientimin dhe i japin atij vazhdimësi. Profeti (s.a.s.) thotë:

“Po qe se gjuha nuk është e orientuar, po qe se zemra nuk është e orientuar, besimi nuk është i drejtë!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 198)





Dikujt që i ka kërkuar këshillë, Profeti i ka thënë kështu duke bërë edhe një përmbledhje të fesë:

“Thuaj “i besova Allahut” dhe pastaj vihu në rrugë të drejtë!” (Muslim, Iman, 62)



Nuk ka pozitë më të lartë se ruajtja e orientimit në çdo çështje dhe nuk ka urdhër më të vështirë për t’u vënë në vend se zbatimi i saj ashtu siç duhet, sepse orientimi është qëndrimi i vendosur në rrugën e Zotit duke e ruajtur maturinë në adhurim pa rënë në teprim ose nënvleftësim dhe zbatimi i urdhrit në mënyrën më të përsosur ashtu siç është dhënë dhe me aq sa ç’janë mundësitë. Ja, për këtë arsye, orientimi është aftësia parashikuese më e madhe!

Miqtë e Allahut e kanë bërë tipar qëndrimin dhe veprimin e orientuar. Ndërkaq, orientimi i vërtetë është ecja në rrugën e ndritshme të Profetit.

Sa bukur e ka shprehur poeti Mevlana Xhelaleddin Rumi këtë të vërtetë:

“Për sa kohë të jetë ky shpirt në trup, jam skllav i Kur’anit, jam dheu i rrugës së Hz. Muhammedit, pluhuri i këmbës së tij. Po që se dikush thur fjalë të tjera veç këtyre të mijave, jam ankues edhe kundër fjalëve të tij, edhe kundër atij vetë!”

“Dije se kush shkon në një sofër tjetër veç sofrës së Profetit (s.a.s.), shejtani ha gjellë në një enë bashkë me të, sepse atij që zgjedh një sofër tjetër veç asaj sofere të bekuar, ia shpojnë dhe shqyejnë grykën kockat!”

6. Tasavvufi është pëlqim (rizá) dhe nënshtirim (teslimijet)

Teslimijet do të thotë *nënshtirim, bindje, dorëzim dhe pranim pa kundërshtim*. Edhe fjala islam vjen nga e njëjta rrënjë. Tasavvufi shtreson ndër zemra ndjenjën e pëlqimit dhe nënshtirimit ndaj Zotit me qëllim që njeriu, robi i Zotit, të mund të jetojë sipas orientimit hyjnor dhe, në çdo frymëmarrje, të mund t’i afrohet më shumë Zotit të tij.

Veprimi i një mijë e një dhimbjeve, hidhërimeve dhe vuajtjeve që rrethojnë këtë botë të vdekshme si dhe dendësia e gënjimeve egoistike nisin të pakësohen dhe lehtësohen vetëm si rezultat i pëlqimit dhe nënshtirimit ndaj Zotit, me fjalë të tjera, me begatinë e pëlqimit dhe nënshtirimit, vuajtjet bëhen pothuaj të pandjeshme. Veset dhe sëmundjet, madje, duke u kuptuar si konsideratë e Zotit, kthehen në gëzim.

Shembulli më i bukur i këtij nënshtirimi është gatishmëria e profetit Ibrahim për ta bërë kurban të birin sipas urdhrit të Zotit dhe nënshtirimi i





të birit Ismail ndaj vendimit hyjnor duke e zgjatur me gëzim qafën për t'u bërë kurban! Kur'ani ia ka treguar nënshtrimin e këtyre dy profetëve si model tërë njerëzimit dhe për ta është shprehur kështu:

“Që të dy iu nënshtruan urdhrat të Allahut...” (es-Saffat, 103) Nënshtrimi i tyre ka merituar konsideratën hyjnore në formën e elementëve përbërës të një adhurimi më vete. Adhurimi i haxhit është një gjuhë që do t'i kumtojë ummetit nënshtrimin çdo çast gjer në kiamet.

I duhet nënshtruar Zotit në urdhrat dhe ndalimet, duhet treguar pëlqim me durim dhe dorëzim për vlerësimin hyjnor, për vështirësitë dhe provat. Sepse çelësi i përkryerjes është te përshtatja.

Shakik Belhi ka thënë: “Ai që e di shpërblimin e vështirësisë dhe shqetësimit, nuk dëshiron të shpëtojë prej tyre!” Miqtë e Allahut që e përvetësojnë këtë ide, i kanë parë me të njëjtin sy ankthin dhe gëzimin. Duke mos rënë në pozicione skajore që janë kurthe për nefsin (vetveten), si gëzimi i tepruar dhe dëshpërimi i tepruar, kanë ndjekur konsideratën e pëlqimit dhe dorëzimit.

Një aspekt tjetër i nënshtrimit është ashku (pasioni) dhe “dashuria hyjnore”, sepse ata që dashurojnë, duke pritur me kënaqësi çdo gjë të ardhur nga të dashurit, përpiqen ta shfaqin dhe provojnë sinqeritetin në dashurinë e tyre. Ka shumë mundësi që, duke u nisur nga ky mendim, Ebu Ali Ruzbari e ka përkufizuar tasavvufin duke u shprehur kështu:

“Tasavvufi është pritja e personit qoftë edhe të përzënë, në derën e të dashurit, i përgjunjur, me besnikëri dhe nënshtrim!”

Robi me zemrën të mbushur plot dashuri e pret dhe e pranon çdo gjë të ardhur nga Zoti i vet, me aq sa të ndjejë afërsi dhe dashuri për Të. Shfaqja e nënshtrimit dhe ashkut (dashurisë pasionante) të Ibrahimit (a.s.) për Allahun e pati kthyer brenda një çasti zjarrin në trëndafilishte. Pëlqimi dhe nënshtrimi i Jakubit (a.s.) përballë vendimit hyjnor i pati dhënë mundësi atij ta shtypte dhimbjen e mallit për të birin Jusuf duke thënë:

“Mua më përket të duroj!...” (Jusuf, 18)

Mistikët islamë e kanë bërë dorëzimin te Zoti dhe nënshtrimin ndaj Tij që është rruga e profetëve, gur prove të jetës së tyre. Sepse, siç thotë edhe Rabi'atul Adevijje (k.s.):

“Ai që do i bindet atij që do!”

Pra, dorëzimi dhe nënshtrimi janë çështje bindjeje me zemër mbështetur në dashuri.





Edhe sahabet, shokët e Profetit, u zhvilluan në raport me dashurinë, besnikërinë dhe bindjen që kishin ndaj Profetit (s.a.s.). Në sajë të nënshtrimit pa kushte me dashuri, u bënë yje model për të gjithë ummetin.



Duke u frymëzuar nga këto që u treguan këtu lidhur me përkufizimet e tasavvufit, mund të themi këto:

Tasavvufi është përpjekja për ta jetuar fenë në mënyrë cilësisht të përshatshme me thelbin e saj duke u pastruar nga papastërtitë materiale-shpirtërore dhe duke fituar moralin dhe cilësitë e bukura. Kështu, tasavvufi është arritja në një pjekuri ideore që të rrokë zhvillimet enigmatike dhe të fshehtat e larta në dukuritë materiale ose shpirtërore ku vetëm mendja është e pamjaftueshme për t'i zgjidhur. Është përpjekja për ta kapërcyer pengesën nefs që është pothuaj një litër lidhës këmbësh para tërheqjes së ndjerë nga zemra ndaj kënaqësive shpirtërore të përjetshme. Është shkencë e një sërë dijesh dhe situatash shpirtërore që siguron vëzhgimin me një mënyrë të kulturës shpirtërore nga shpirti duke i kapërcyer prirjet egoistike të trupit ku ndodhet i burgosur, të të vërtetave abstrakte në thelbin e dukurive, të faqeve plot mësimë dhe urtësi që shpalosen pas perdes në kufirin e njohjes.

Konkluzionin në çështjen e këtyre përkufizimeve të tasavvufit le t'ua lëmë vargjeve poetike të njohura të Sheh Ibrahim Efendiut:

Fillimit të tasavvufit, të bëhesh sufi i dorëzuar, i thonë;

Fundit, të bëhesh mbret në fronin e zemrës, i thonë!

Në tarikat, tasavvufi është shpëtim nga dobësitë njerëzore;

Në të vërtetë, të bëhesh mik në sarajin e fshehtë hyjnor, i thonë!

Tasavvufi është zhveshje nga kjo rrobë prej dheu dhe uji;

Tasavvuf, të bëhesh, si pastër, dritë e Zotit, i thonë!

Tasavvufi është ta ndezësh qiririn e zemrës me dritërat hyjnore;

Tasavvufit, të marrësh flakë me zjarrin e ashkut, i thonë!

Në tasavvuf thelbësore është ta mbyllësh librin e qenies;

Tasavvufit, të bëhesh njeri i shariatit, i besimit të vërtetë, i thonë!





Tasavvufi është të bëhesh njohësi i kulturuar i zakonit hyjnor;
Tasavvufit, të gjitha vuajtjeve t'u bëhesh shërim, i thonë!

Tasavvufi, ta hapësh sekretin e trupit me çelësat e emrave hyjnorë;
Tasavvufit, ta shkatërrosh me gjithësej këtë ndërtesë, i thonë!

Dije se tasavvufi është kthimi i fjalës së sufiut në jetesë;
Çdo fjalë që thotë të kthehet në eliksir, i thonë!

Tasavvufi është t'i dish dituritë mbi kuptimin dhe shpjegimin;
Tasavvufit, në shpirt të bëhesh një e fshehtë hyjnore, i thonë!

Tasavvufi është të jesh i dehur e i zgjuar në mahnitjen hyjnore;
Tasavvufit, t'i bëhesh admirues fshehtësisë së Zotit, i thonë!

Tasavvufi është të heqësh nga zemra çdo gjë tjetër veç Allahut;
Tasavvuf, zemra e besimtarit të bëhet seli e Zotit, i thonë!

Tasavvufi është në çdo frymë të arrish në lindje e në perëndim;
Tasavvuf, gjithë popullit t'i bëhesh kujdestar, i thonë!

Tasavvufi është ta shohësh Zotin në të gjitha grimcat e gjithësisë;
Tasavvuf, t'u bëhesh diell botërave, i thonë!

Tasavvufi është t'i kuptosh gjuhët, hallet e të gjithëve;
Tasavvufit, botës së mendjes t'i bëhesh Sulejman, i thonë!

Tasavvufi, ta tërheqësh duke hequr shpirt barrën e rëndë;
Tasavvufit, të meritosh ajetet e faljes, i thonë!

Tasavvufi është drejtimi i gjithësisë me Emrin e Madh;
Tasavvufit, të bëhesh Kur'an i gjallë, i thonë!

Tasavvufi është në çdo shikim t'i drejtohesh Zotit;
Tasavvufit, t'i bësh të lehta të gjitha vështirësitë, i thonë!





Tasavvufi është ta bësh gjoksin vend të dijes së Vërtetë;
Tasavvufit, sufiu të bëhet nga një pikë, një oqean, i thonë!

Tasavvufi është ta djegësh trupin me zjarrin e "la"-së;
Tasavvufit, të bëhesh njeri me dritën e "il'la"-së, i thonë!

Tasavvufi, t'i ftosh njerëzit me "Thuaj: "Allahu të mjafton!";
Tasavvufit, të dehesh me fjalën "Kthehu te Zoti yt", i thonë!

Tasavvufi është një mijë herë në ditë të vdesësh e të ringjallesh;
Tasavvufit, t'u japësh jetë gjithë trupave të botës, i thonë!

Tasavvufi është që njeriu ta shkrijë qenien në qenien e Zotit;
Tasavvufit, ta fshehësh veten në "dy harqe afër Zotit", i thonë!

Tasavvufi është t'ia japësh jetën të dashurit e të çlirohesh;
Tasavvufit, t'i bëhesh i dashur të dashurit, i thonë!

O Ibrahim, tasavvufi është t'i bëhesh skllav të Vërtetës;
Tasavvufit, të bëhesh provë në rrugën e Ahmedit, i thonë!





Tematika e tasavvufit është e gjerë dhe e thellë si det, sepse ai merret me çdo gjë që ka të bëjë me veten dhe shpirtin e njeriut.



C. TEMATIKA E TASAVVUFIT

Shpjegimet dhe përkufizimet e gjera që i bëhen tasavvufit, në një vështrim, burojnë nga gjerësia e tematikës së tij. Pra, tematika e tasavvufit është e gjerë dhe e thellë si një det. Sepse ai merret me çdo gjë që ka të bëjë me veten dhe shpirtin e njeriut. Tasavvuft merret me specifika të panumërta, si të gjitha largësitë e kapërcyera nga robi në udhëtimin moralo-shpirtëror, botët nëpër të cilat kalon, qeniet që mban lidhje, një mijë e një situata të jetuara dhe, më në fund, me gjetjen e Allahut që është Zoti i gjithësisë, me njohjen e tij me zemër dhe me kryerjen e detyrës së robit ndaj Tij.

Po qe se mund të ofrojmë katër-pesë pika nga deti i një tematike të tillë, mund të themi këto:

Tasavvufti, para së gjithash, bën për tematikë etapat dhe situatat dëshmuese të ecurisë së arritjes nga njeriu i papërpunuar te njeriu i përkryer në sajë të pastrimit të vetes dhe purifikimit të zemrës.

E shprehur ndryshe, tasavvufti bën fjalë për gjendjet e pastrimit të vetes dhe purifikimit të zemrës, për ndriçimin e botës së jashtme e të brendshme dhe për pastrimin e dukjes dhe përmbajtjes me qëllim për të fituar kënaqësinë e Zotit dhe për të arritur lumturinë e përjetshme. Tematika e tasavvufit është pajisja me moralin e lartë dhe njohja e të vërtetave shpirtërore. Është përjetimi i ndjenjës së mirësisë duke e shijuar në formën e një kënaqësie moralo-shpirtërore.

Në këtë kontekst, tematika kryesore e tasavvufit janë individualiteti i Allahut të Lartë që është Qenie e Domosdoshme, atributet e Tij si dhe parimet dhe metodat mbi konceptimin e urtësisë, enigmës dhe qëllimit hyjnor në modalitetet e shfaqjeve gjithëpërfshirëse të këtyre attributeve.





Në këtë kontekst, tasavvufi bën për tematikë gjendjet e larta të merituar kur ecet në përbashkësinë e mjeteve që i përkasin botës së brendshme, shpirtit, ndjenjave dhe ndërgjegjes, si zbulimi, frymëzimi, vëzhgimi shpirtëror, ekstaza dhe dashuria pasionante.

Më në fund, tasavvufi ka bërë për tematikë, me anë të vëzhgimit faktik të shfaqjes së emrave dhe attributeve të Allahut, njohjen intuitive të Zotit (marifetullah), kurse, me anë të njohjes së të vërtetave të njeriut, gjithësisë dhe Kur'anit, etapat në botën shpirtërore dhe përsosjen në përfundim të këtyre.





Qëllimi i tasavvufit është mundësia për ta shndërruar moralin e bukur, pra, meritat e larta, si mëshirën, dhembshurinë, bujarinë, faljen, falenderimin, në gjendje shijeje e kënaqësie te besimtari.



D. QELLIMI I TASAVVUFIT

Po të vështrohet përkufizimi dhe tematika e gjerë e tasavvufit, do të shihet se ai ka bërë për parim një qëllim shumë të rëndësishëm e të lartë për njeriun. Ky qëllim është “adhurimi i Allahut në mënyrën më të bukur e të begatë”, që qëndron si një diell në qiellin e të gjithë profetëve dhe të urtëve qysh nga profeti i parë. Me këtë aspekt, është qëllimi i qëllimeve. Me fjalë të tjera, për të fituar në kuptim të plotë pëlqimin e Zotit, është përfitimi nga morali i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij duke shpëtuar nga sëmundjet moralo-shpirtërore, është nënshtrimi i nefsit (frymës, egos) urdhrit të fesë, është shpëtimi i adhurimeve nga kryerja mekanike për t’u dhënë ndjenjën e mirësisë (**ihsan**), është orientimi i zemrës në drejtim të gjërave të larta moralo-shpirtërore për t’u bërë, si përfundim, i merituar i pëlqimit hyjnor me një zemër të paqëtuar.

Është një e vërtetë e ekspozuar për shumë herë me radhë nga historia, sipas së cilës njeriu, ndërsa është në lartësinë e **ahsen-i takvim-it**, domethënë, *qenies më të nderuar*, po të tjetërsohet për sa i përket qëllimit të krijimit e të largohet nga orientimi, mund të bëhet një qenie që të meritojë madje edhe cilësimin e *qenies më të ulët se kafshët*: بَلْ هُمْ أَضَلُّ I vetmi faktor që caktonte te njeriu vlerën dhe nderin, është *besimi (iman)*. Kurse pas besimit vjen *morali (ahlak)*.

Të urtët ose, sipas terminologjisë së tasavvufit, evlijanjtë, që janë ndër trashëgimtarët e Profetit (s.a.s.), dhe dituria shpirtërore e përfutur prej tyre nga ai burimi i begatë profetik, janë në pozitën e trashëgimtarit dhe përfaqësuesit të detyrës së të Dërguarit të Allahut.

Ata që ecin në rrugën e tasavvufit, në të gjitha gjendjet dhe veprimet e tyre karakterizohen nga një përpjekje lidhjeje e besnikërie të plotë ndaj





të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) i cili është qendra e vlerave të jashtme e të brendshme. Edhe miqtë e Zotit të orientuar në këtë rrugë, marrin përsipër një shërbim të kryer nga Profeti (s.a.s.) në këtë botë, duke marrë pjesë brenda konkluzionit:

“Dijetarët e vërtetë janë trashëgimtarë të profetëve!” (Ebu Davud, *Ilm*, 1)

Prandaj, pjekuria moralo-shpirtërore që është synimi i tasavvufit, mund të thuhet se, në një aspekt, është shfaqje e qëllimit që ka dashur të realizojë te njerëzit Profeti (s.a.s.). Siç dihet, ky qëllim është që, në truallin e besimit, t’i shpëtojë njerëzit nga veset egoistike e të këqija për t’i lartësuar në moralin e lavdërueshëm, domethënë në pjekurinë morale-shpirtërore dhe shprehitë e bukura.

Në një hadith të shenjtë, Zoti thotë kështu:

“Kjo është një fe për të cilën unë si personalitet, jam i kënaqur. Dhe çka i ka hije kësaj feje, është bujaria dhe morali i bukur. Për sa kohë që juve t’ju favorizohet dhuntia për t’u bërë ndjekës të kësaj feje, lartësojeni atë me këto dy virtyte!” (Hejthemi, Mexhmau’z-Zevaid, VIII, 20)

Nisur nga kjo, tasavvufi është mundësia për ta shndërruar moralin e bukur, pra, meritat e larta, si mëshirën, dhembshurinë, bujarinë, faljen, falenderimin, në gjendje shijeje e kënaqësie te besimtari.

Gjithashtu, qëllimi në tasavvuf është që, duke i zhvilluar më tej e duke i përsosur njerëzit me kapacitete, me aq sa e mundësojnë kapacitetet e tyre, të nxiten të kapërcejnë largësi në rrugën për t’u bërë njeri i përsosur, njeri bujar, njeri që e njeh mirë veten dhe Zotin e vet, që shijon gëzimin e afërsisë ndaj Zotit, që është mik i Zotit me qëndrueshmërinë ndaj armiqësive të nefsit (frymës, egos).

Në Kur’an thuhet:

إِنَّا عَرَضْنَا الْأَمَانَةَ عَلَى السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالْجِبَالِ فَأَبَيْنَ أَنْ يَحْمِلَهَا
وَأَشْفَقْنَ مِنْهَا وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ إِنَّهُ كَانَ ظَلُومًا جَهُولًا

“Ne ua propozuam amanetin qiejve, tokës e maleve dhe ata u drojtën ta merrnin përsipër këtë, u trembën (nga përgjegjësia). Atë e mori përsipër njeriu. Me të vërtetë, ai është shumë injorant dhe mizor!” (el-Ahzab, 72)

Siç thuhet në këtë ajet, njeriun që përpëlitet mes mëkatit, duke e shpëtuar nga cilësitë e ulta të injorantit dhe mizorit, ta ngresh në cilësinë e





njeriut të përsosur. E kundërta e mizorisë apo padrejtësisë (zulm) është drejtësia (adl). Me fjalë të tjera, që akti i robit të jetë i mirë (salih). Kurse e kundërta e injorancës (xhehl) është dituria (ilm). Për t'u bërë dijetar i vërtetë, duhet që ta zotërosh aq sa dijen e jashtme, formale, edhe dijen e brendshme, përmbajtësore.

Imam Gazaliu (r. alejh) ka thënë:

“Trashëgimtarë profetikë janë ata që zotërojnë dijen e jashtme e të brendshme!”

Shpëtimi i njeriut varet nga pastrimi i cilësive të këqija të nefsit, kështu, nga shndërrimi i akteve të tij në akte të mira (salih) dhe nga personalizimi i dijes, domethënë, nga kthimi i dijes së tij në kulturë shpirtërore (irfan). Ja, pra, tasavvufi ka për qëllim konceptimin dhe përjetimin e edukatës dhe cilësive që do të siguronin arritjen e kësaj.

Evljanjtë që e realizojnë këtë qëllim, domethënë të urtët që Zoti i bën miq të vet, janë njerëz përjashtimorë që e përjetojnë përsosmërinë në besim (iman) dhe devocion (takva). Zoti flet kështu për ta:

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ
وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ

“Ta dini se për miqtë e Zotit nuk ka frikë dhe ata nuk do të dëshpërohen. Ata kanë besuar dhe kanë arritur devocionin!” (Junus, 62-63)

Ndërsa besimi i shfaqur në zemër e shpëton robin nga të gjitha bestytinitë dhe e afron tek e Vërteta, edhe devocioni e pastron zemrën nga vanitetet. Tashmë zemra e një robi të këtillë fiton cilësinë e të qenit seli e vështrimit të Zotit, bëhet mjedisi i shfaqjes së urtësive dhe enigmave hyjnore.





Atë ditë nuk bëjnë dobi as pasuria,
as fëmija, me përjashtim të atyre
që vijnë te Allahu me zemër të pa-
stër... (esh-Shuara, 88-89)



E. NEVOJA PER TASAVVUF

Tasavvufi është jeta ndjesore dhe thelbi i fesë. Krejt si lëngu që e bën frutin të ngrënshëm e të shijshëm!

Siç dihet, njeriu ka dy anë: anën trupore dhe anën shpirtërore. Që të dyja këto anë kanë kërkesat e tyre të natyrshme të varura nga krijimi i tyre. Islami nuk i mohon këto kërkesa dhe prirje të bashkëlindura, por i pranon ato si realitete më vete. Ndërkaq, brenda kornizës së kritereve themelore që ka parashtruar, Islami përpiqet t'i zhvillojë prirjet e pranueshme, kurse prirjet e papranueshme përpiqet t'i mënjojë në minimum ose t'i vërë nën kontrollin e një qëllimi të pranueshëm.

Po qe se njeriu, duke ngritur për vete një botë në kornizën e nevojave dhe domosdoshmërive trupore, tenton t'i shtypë kërkesat shpirtërore për gjëra të larta e sublime, për të bëhet e pamundur që të arrijë qetësinë dhe kënaqësinë e duhur. Feja i ofron njeriut një program ekuilibri mes lëndës dhe kuptimit. Ndërsa nga njëra anë e orienton njeriun drejt klimës moralo-shpirtërore, nga ana tjetër nuk i kundërshton e nuk i hedh poshtë domosdoshmëritë e botës lëndore-materiale. Feja i shton prirjeve materiale të njeriut një kuptim abstrakt dhe një qëllim të lartë. Po qe se njeriu, duke mbetur vetëm në planin fizik-trupor, e vëzhgon çdo gjë me një vështrim materialist, atëherë, edhe ngjarjen më abstrakte, madje, e sheh në kallëpe konkrete dhe të pashpirt. Në të vërtetë, kjo është dhe njëra nga prirjet kryesore që shtrihen në themelin e kundërshtimeve të tasavvufit.

Në të vërtetë, njohja njerëzore është e prirur ndaj enigmave shpirtërore dhe të vërtetave abstrakte po aq sa edhe ndaj qenieve lëndore dhe kon-





krete. Prandaj, e gjithë puna mbërthehet në momentin e kënaqjes apo jo, veç strukturës lëndore-materiale të njeriut, edhe të shpirtit të tij. Bota përrëndimore e cila sot qëndron në kulm të mirëqenies materiale, zvarritet në ateizëm mes vorbullave shpirtërore dhe rrënimëve morale. Shumë ateistë ka, madje, edhe në Romë e cila është qendër e krishterizmit, sepse këta njerëz janë të privuar nga plotësimi i deficiteve shpirtërore të veta. Dhe në themelin e kësaj qëndron shpirtërore dhe lidhjes ndjesore me burimin hyjnor. Feja e shpërbërë me dorën e njeriut dhe e ritrajtësuar me ndërhyrjen e tij, për shkak se, për pasojë, e ka humbur kthjelltësinë, ka mbetur shumë larg nga përmbajtja shpirtërore e cila krijon kushte për qetësinë dhe prehjen ndjesore. Për këtë shkak, zemrat që s'e ndejnë dot emocionin e fesë, mbeben të përmalluara për qetësinë dhe prehjen ndjesore.

Njeriu i privuar nga ekstaza fetare, pra, nga emocionin shpirtëror, duke e parë ngjarjen shpirtërore më madhështore, madje, me syrin e një materialisti, përpriqet ta derdhë çështjen vetëm në planin formal, kështu, vë në shesh një mendësi fetare të thatë me brendësinë të boshatisur.

Tasavvufi e orienton njeriun për tek shpirti. Tasavvufi i hap shpirtit një rrugë ngopjeje e kënaqësie në përputhje me kapacitetin individual të personit. Me të vërtetë, po qe se fesë i hiqet aspekti moralo-shpirtëror që i jep ngopje e kënaqësi shpirtit të njeriut, feja zbret në nivelin e sistemeve njerëzore të ngritura thjesht mbi dobinë dhe përfitimin material. Në këto kushte, duke i dhënë jetës adhurimore vlerë vetëm në drejtimin formal dhe të interesave temporale (materiale e të përkohshme), njeriu privohet nga përfitimi ndjesor që është synimi dhe qëllimi i vërtetë i jetës adhurimore. Kështu, ky synim dhe qëllim i vërtetë eliminohet kur, për shembull, namazi shihet e bëhet për gjimnastikë, agjërimi, për dietë, zeqati, për ndihmë dhe asistencë sociale, etj., pra, kur adhurimet barten në planin e interesave, dobive e përfitimeve të dyta, jothelbësore. Ose mbetet vetëm në pjesën formale të kushteve të domosdoshme për kryerjen e adhurimeve. Dhe është e qartë se, meqë kjo do të krijojë një mendësi joislamike dhe larg thelbit të fesë, nuk do të mund t'u japë përgjigje nevojave të shpirtit të njeriut dhe nuk do ta kënaqë dot ndjenjën fetare që është e bashkëlindur. Rruga për t'u përfutuar detyrave fetare një thellësi ndjesore është edukimi mistik. Për të arritur thellësi cilësore në fe, njerëzit u janë drejtuar një sërë kërkimeve dhe, si përfundim, kanë arritur në edukimin mistik.





Po qe se qenieve u bëhet një radhitje nga më e thjeshta te më e përkryera, kulmin e kësaj radhitjeje e përbën njeriu. Ndërkaq, edhe kapacitetet dhe mundësitë e njeriut, të mbështetura në pasurinë e bashkëindur të tij, paraqesin shumë nivele të ndryshme, gjë që është e domosdoshme dhe e detyrueshme për sigurimin e harmonisë shoqërore në botë.

Si domosdoshmëri e qëllimit hyjnor, e dëshirës volitive hyjnore, Zoti i ka krijuar njerëzit me nivele të ndryshme si për sa u përket kapaciteteve të jashtme, ashtu dhe për sa u përket kapaciteteve të brendshme, moralo-shpirtërore. Ndërsa nuk kërkon prej njerëzve më shumë se ç'kanë mundësi, Zoti i ka bërë përgjegjës ata në raport të drejtë me kapacitetet dhe mundësitë që u ka dhënë.

Mëshira e pafundme e Allahut të Lartë, e cila është më e madhe se ndëshkimi i Tij, e përfshin tërë krijesën. Për këtë shkak, duke i vlerësuar dhe caktuar propozimet (mocionet) fetare që i takojnë me përgjegjësi tërë njerëzimit, Zoti ka marrë për bazë nivelin më të ulët, domethënë, i ka kufizuar ato në nivelin e njeriut më të dobët i cili i ka mundësitë për t'i plotësuar. Por meqë mbyllja e portës së zhvillimit moralo-shpirtëror për njerëzit me kapacitete, mundësi, fuqi dhe kërkesa të lindura për kryerjen e përgjegjësi me mëdha se ato që i përkasin shumicës, do të binte në kundërshtim me drejtësinë hyjnore, është e natyrshme dhe e domosdoshme që të ekzistojë një rrugë për këta njerëz që të plotësojnë nevojat e tyre shpirtërore. Pra, është fjala për mbajtjen hapur të një rruge për besimtarët që, përveç plotësimit të detyrave kanunore, janë të aftë për t'u lartësuar në botën shpirtërore, rrugë, e cila do t'u siguronte atyre të ecnin para me anë të adhurimit, devocionit dhe mirësisë. Siç dihet, kjo rrugë është **tasavvufi** ose mistika islame.

Ndërkaq, këto të vërteta janë nga mbështetjet racionale e fetare të nevojës për tasavvuf.



Që zemra të arrijë ngopjen dhe kënaqësinë, domethënë, qetësinë, prehjen dhe lumturinë, kjo varet nga niveli moralo-shpirtëror ku ka arritur. Dhe, për këtë, duhet që robi të kalojë nëpër një edukim moralo-shpirtëror.

Kështu, edhe profetët e dërguar si modele për njerëzimin janë kaluar nëpër një periudhë përgatitore para se të bëhen subjekte të komunikimit hyjnor. Hz. Muhammedi (s.a.s.) ende nuk ishte ngarkuar me detyrën e





profetësisë kur tërhiqej në itikaf¹⁶ në shpellën Hira. Para bisedës me Zotin, profeti Musa (a.s.) pati kaluar në malin Sina një lloj asketizmi prej dyzet ditësh. Para se të bëhej ministër në Egjipt, profeti Jusuf pati mbetur në qeli për dymbëdhjetë vjet me radhë.

Para se të ngjitej në Miraxh, i Dërguari i Allahut, profeti Muhammed (s.a.s.) meritoi të fshehtën e sures Inshirah. Iu hap gjoksi dhe iu la zemra. Gjoksi iu mbush me frymën shpirtërore të diturisë dhe urtësisë, sepse në Miraxh ai do të përballej me ngjarje të jashtëzakonshme e të çuditshme, do të vëzhgonte enigmën hyjnore të padukshme me anë të shikimit të kufizuar njerëzor dhe pamje të ndryshme të tejdukshme.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ishte njeriu me zemrën më të pastër ndër gjithë njerëzit që kishin kaluar e do të vinin. Këtë e pranonin edhe mohuesit. Pavarësisht nga kjo, meqë do t'i tregoheshin mbretërimi dhe enigma hyjnore e Zotit të gjithësisë, ai u kalua përsëri përmes një operacioni shpirtëror. Dhe ndodhi evenimenti i quajtur *shak-i sadr*, hapja e gjoksit¹⁷. Ky eveniment shpreh rëndësinë e jetës ndjesore. Edhe profetët të pajisur me atributin e pafajësisë (ismet), madje, megjithëse kanë qenë "të kulluar", janë kaluar nëpër purifikimin e zemrës për t'u pranuar në audiencën hyjnore.

Po qe se edhe profetët që janë robtë e zgjedhur të Allahut, kalohen nëpër purifikimin e zemrës, del në shesh se sa nevojtarë janë njerëzit e tjerë për pastrimin e zemrës! Me një zemër të dendur, të trashë e të patejdukshme nuk mund të rrokët ajo që është e hollë, e tejdukshme dhe delikate. Dikush që i janë zënë hundët, nuk mund t'i marrë erë trëndafilin apo karafilin! Nga dritarja me xhama të veshura me avull nuk mund të soditet qartë një panoramë!

Prandaj, që zemra të bëhet e aftë për t'i kapur dhe marrë të fshehtat dhe urtësitë hyjnore duke e thelluar më tej ndjeshmërinë ndjesore-shpirtërore, e ka të domosdoshme të pastrohet nga patejdukshmëritë dhe të bëhet e tejdukshme.

16 **Itikaf**: përgjithësisht, mbyllje diku për ta kaluar kohën me adhurim; posaçërisht, mbyllje në xhami gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit gjithashtu për adhurim.

17 **Shak-i sadr**: ky operacion i zbatuar mbi Profetin nga engjëjt dhe që quhet edhe "sherh-i sadr", korrigjimi i zemrës, është çarja dhe zgjerimi i gjoksit me anë të dritës dhe hipnozës hyjnore. Profeti e ka merituar këtë "korrigjim" dy herë, në vegjëli dhe para miraxhit. Kjo ndërhyrje është përmendur në Kur'an kështu: "A s'ta hapëm dhe zgjeruam gjoksin ty?" (el-Inshirah, 1)





Zoti ka urdhëruar:

“Atë ditë nuk do të bëjnë dobi as pasuria, as fëmija! Me përjashtim të vetëm atyre që vijnë te Allahu me një zemër të paqtë!..” (esh-Shuara, 88-89)

Dhe paqëtimi i zemrës mund të bëhet vetëm me anë të edukimit moralo-shpirtëror.

Në atë vend ku bashkohen deti me bregun, sheh plot gurë të lëmuar. Duke u rrahur nga dallgët për shekuj me radhë, atyre u janë rrafshuar thepat, majat, kanë marrë lustër e shkëlqim dhe janë forcuar si graniti.

Edhe margaritari në gjendje minerali duhet pastruar, duhet prerë, latuar e fërkuar që të marrë trajtë të bukur, lëmim e shkëlqim. Për të përfutur një gram flori, ndoshta duhen shoshitur një ton dhé. Pra, çdo qenie e gjallë apo jo e gjallë fiton vlerë pas një lloj përpunimi dhe edukimi të posaçëm.

Ja, pra, edhe zemra, për të arritur cilësinë “selim” (cilësinë e gjësë së paqëtur) që përmendet në Kur’an, ka nevojë për përpunim dhe edukim moralo-shpirtëror.

Para se të edukohet, zemra është si hekuri i ftohtë. Për të marrë formën dhe trajtën e dëshiruar, hekuri duhet të kalitet në zjarr e në kudhër. Krejt si kjo, as përkryerja e zemrës s’realizohet dot pa u kalitur. Kurse pas realizimit të përkryerjes ndjesore, bota e të vërtetave e cila nuk shihet dot me sytë e ballit, lëviz në gjendje shijesh e kënaqësish dhe ndjehet me zemër. Për këtë, duhet fuqizuar dhe aftësuar zemra.

Po qe se dikush tenton të bëjë një lëvizje për të cilën s’ka bërë asnjë lloj stërvitjeje, mund të thyejë edhe kockat, kurse sportisti i stërvitur për një kohë të gjatë për të, e bën pa asnjë lloj sforcimi. Stërvitja në fjalë është përqëndrimi i të gjitha forcave të trupit në atë lëvizje. Si kjo, edhe zemra duhet të forcohet duke u përqëndruar në dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij!

Zoti thotë kështu në Kur’an:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ
وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ

Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që u dridhen zemrat kur përmendet Allahu, që u shtohet besimi kur u këndohen ajetet e Allahut dhe që mbështeten dhe gjejnë siguri vetëm te Zoti i tyre!” (el-Enfal, 2)





Për të ardhur në këtë gjendje, zemrat duhet të pastrohen nga mëkatet dhe të maturohen nga ana ndjesore, sepse është e pamundur që një zemër e papërpunuar e mbushur plot lëndë të huaja, të lidhet denjësisht me Zotin.

Fëmija i shkollës fillore nuk mund të kuptojë gjë nga tekstet mësimore të një studenti të drejtësisë, sepse mendja e tij ende s'ka arritur konsistencën dhe pjekurinë përkatëse. Ajo ka nevojë edhe për shumë vite mësimore. Po kështu, edhe për zemrën ka arsimim dhe edukim të posaçëm për të. Është shumë e vështirë që zemra e papastruar, e mbushur plot lëndë të huaja që ia prishin transparencën, t'i rrokë imtësitë e rrugës së bashkimit me Allahun.

Meqë pranueshmëria e robit në lartësinë e Allahut varet më shumë nga zhvillimi ndjesor, është nevoja e një edukimi shpirtëror më vete me qëllim që zemra të arrijë përkryerjen e duhur. Dhe emri i këtij edukimi është *tasavvuf*.

Me të vërtetë, e gjithë puna përqëndrohet te zemra dhe, në adhurimet dhe sjelljet, Zoti i jep rëndësi më shumë cilësisë së zemrës.

Kështu, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) na ka porositur:

"Allahu nuk sheh trupin dhe pamjen tuaj, por vetëm zemrat tuaja!" (Muslim, Birr, 33)

Për shembull, po qe se në adhurimet dhe shërbimet për hir të Allahut hahet ushqim me synim për të fituar fuqi e qëndresë, edhe kjo ngrënie merr vlerë adhurimi. Personi që përpiqet të fitojë ushqimin e fëmijëve të vet me rrugë legjitime e të bekuara, fiton mirësi në çdo hap që hedh, sepse nijeti, qëllimi i tij që është akti i zemrës së tij, është i dobishëm.

Në Islam, mbulesa e femrës është kusht. Por femra duhet të fshihet jo vetëm në pamje, por edhe në shpirt. Po qe se femra e mbuluar nga jashtë, por në shpirt e zhveshur, pra, indiferente dhe e shkujdesur, u nënshtrohet trysnisë së kushteve ose nefsi, pra, vetvetja e saj, gjen rast, në atë çast mbulesa e jashtme merr fund, zhvlerësohet dhe bie poshtë. Veçanërisht, femra nën mbulesë nuk duhet ta humbë misionin e saj femëror, rregullimin e jetës shtëpijake e familjare dhe vazhdimin e brezit. Prandaj, në çdo specifikë, zemra, jeta ndjesore ka shumë rëndësi. Njeriu nuk mund të dalë jashtë kufijve të mbulesës të vëna nga Allahu, por mbulesa në vetvete nuk është gjithçka, është vetëm një pjesë e urdhrave hyjnore.

Për shembull, ndërtimi i një xhamie është mirësi e madhe, por po qe se personi që e ndërton krenohet dhe mbahet më të madh duke e nxjerrë





veten në pah, mirësia e tij zhvlerësohet, sepse Zoti e zhvlerëson dhe e poshtëron atë që thotë “unë”. Njeriu duhet të thotë: “Ky është favoriti yt, o Zot!” Një njeri të tillë Zoti e lartëson. Prandaj, është ndjeshmëria e zemrës që i bën të pranueshme e të pëlqyeshme sjelljet e njeriut!

Prandaj, në rrugën për ta kryer çdo sjellje me një ndjenjë adhurimi dhe çdo adhurim me pastërti zemre, kurrë nuk mund të mohohet rëndësia në jetën e njeriut e mistikës, e cila do të thotë edukim i zemrës. Me të vërtetë, adhurimet kanë dy aspekte që e plotësojnë njëri-tjetrin: forma dhe fryma e tyre. Zoti në Kur’an nuk tregon për kushtet dhe elementët përbërës të jashtëm të adhurimeve, por për kryerjen e tyre me cilësi shpirtërore dhe ndjeshmëri ndjesore. Kurse aspektin e jashtëm të adhurimeve mundet ta mësojmë nëpërmjet traditës profetike.



Aspektin formal të adhurimeve mund ta kryejë edhe një hipokrit, gjë që ka ndodhur dhe njohur konkretisht edhe në kohën e Profetit. Kreu i hipokritëve, Abdullah bin Ubej bin Selul shkonte në faltore dhe falej formalisht pas Profetit, pra, anën formale të adhurimeve mund ta plotësojë edhe një hipokrit. Dhe kjo tregon se adhurimet e kryera vetëm formalisht s’kanë asnjë vlerë para Allahut. Pranimi dhe miratimi i adhurimeve varet nga bashkëveprimi i formës me përmbajtjen shpirtërore.

Me të vërtetë, po të shqyrtohen në tërësi ajetet dhe hadithet lidhur me namazin, agjërimin, zeqatin dhe haxhin, nuk është e vështirë për ta parë këtë të vërtetë. Në lidhje me namazin, në një ajet thuhet kështu:

“... Pa dyshim, namazi largon nga paturpësia dhe të këqijat!..” (el-An-kebut, 45) Por po qe se dikush, megjithëse fal namaz, nuk largohet dot nga nga të këqijat, kjo do të thotë se namazi i tij nuk është falur me përsëritshmëri.

Për ata që falin namaz vetëm për formë pa përsëritshmërinë e zemrës, Zoti ka thënë:

“Sa keq për ata që falen, që i falin namazet me shkujdesje!” (el-Maun, 4-5)

Edhe në një ajet tjetër urdhërohet:

“Vetëm besimtarët që falen me përsëritshmëri me të vërtetë kanë shpëtuar!..” (el-Muminun, 1-2)

Siç e theksojnë edhe ajetet kur’anore, një prej cilësive të besimtarëve që arrijnë shpëtimin, është edhe falja e namazit me përsëritshmëri. Për ta kryer namazin në kuptim të plotë, duhen plotësuar të gjitha kushtet formale dhe përmbajtësore të tij. Dy vetë falin të njëjtin namaz në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin mjedis, por mes këtyre dy namazeve ka ndryshim sa largësia mes tokës dhe qiellit!





Duke u shprehur si në hadithin e mëposhtëm, Profeti (s.a.s.) ka theksuar cilësinë ndjesore që duhet respektuar në namaz:

“Dikush fal namaz, por vetëm gjysma e namazit, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e shtata, një e teta, një e nënta, madje vetëm një e dhjeta shkruhet për të!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 321)

Në Kur'an, duke përmendur cilësitë e besimtarëve, Zoti thotë:

“Dhe ata që e vazhdojnë namazin e tyre!” (el-Muminun, 9)

Duke nxjerrë në pah edhe kuptimin sinjifikativ të këtij ajeti, poeti Mevlana Xhelaeddin Rumi, e shpreh kështu atë:

“Ata që vazhdojnë ta përjetojnë gjendjen e namazit edhe pas namazit!”

Dhe thotë:

“Namazi i cili na e tregon neve rrugën e drejtë dhe që na shmang nga të këqijat, falet pesë herë në ditë. Kurse ashikët (të pasionuarit pas Zotit) ndodhen vazhdimisht në namaz. Sepse as ashku (pasioni) i zemrave të tyre, as dhe ajo ndjenjë e thellë afërsie hyjnore që ua përvëlon zemrat, nuk mund të qetësohen as me pesë kohë, as dhe me një mijë kohë namaz!”

Me të vërtetë, falja e një kohë namazi zgjat rreth 10-15 minuta. Por zemra duhet mbrojtur si në namaz edhe pas namazit. Sepse zemra e pambrojtur bie në indiferentizëm dhe, një kohë më pas, mundet të shkasë në mëkat, madje, na ruajttë Zoti, edhe në mohim! Prandaj personi duhet ta preokupojë zemrën me Zotin edhe pas namazit dhe të mos rrijë indiferent ndaj Tij.

Kurse indiferentët, jo më jashtë namazit, por janë të dënuar të mos munden ta mbledhin veten as në namaz, të mos munden të përulen me impresionim para pranisë hyjnore! Ja se si rrëfehët në lidhje me këtë situatë specifike:

Një dervish që përparonte në rrugën e përkryerjes shpirtërore, po falte namaz natën vonë në faltore. Ndërkaq filloi shiu dhe, në një çast, zemra e dervishit u kthye nga shtëpia. Atëherë, një zë i brendshëm ia tërhoqi vëmendjen kështu:

“O dervish! Me këtë namaz që po fal, nuk po bën asgjë për ne, sepse gjënë e bukur brenda teje (zemrën) e dërgove në shtëpi, kurse këtu le vetëm trupin!..”

Në një hadith profetik thuhet:

“Sa veta ka që falin namaz nate, pjesa e fitimit të të cilëve nga ai namaz është vetëm se mbeten pa gjumë!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 373)





Përfundimisht, ngado që të kthehemi, do të vijmë te çështja e nevojës së mbështetjes në maturimin e zemrës.

Edhe te adhurimi i agjërimit, gjendja nuk është e ndryshme nga namazi. Pra, edhe agjërimi duhet mbajtur duke respektuar edhe parimet formale, edhe parimet esenciale.

Agjërimi është një adhurim që fshin dhe i zhduk mëkatet. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Kush mban agjërimin e ramazanit duke besuar në vlerën dhe virtytet e tij dhe duke e pritur shpërblimin nga Allahu, i falen mëkatet e kaluara!” (Buhari, Savm, 6)

Qëllimi i agjërimit nuk është vuajtja prej urie. Zoti ka theksuar se qëllimi i agjërimit është devocioni:

“O ju që keni besuar! Siç u qe bërë agjërimi farz (detyrim) popujve para jush, është bërë farz edhe për ju që të bëheni të devotshëm!” (el-Bakara, 183)

Prandaj, agjërimi nuk është agjërim vetëm i stomakut, por bashkë me gjymtyrët dhe organet e tjera, edhe i zemrës. Duke e ndërë vlerën e të mirave të dhëna nga Allahu, zemra duhet ta zotërojë thellësinë e frymës moralo-shpirtërore të agjërimit.

Agjërimi është një edukim moralo-shpirtëror që zhvillon tek njeriu ndjenja të tilla si mëshira dhe dhembshuria. Po qe se tek njeriu që agjëron, nuk ekzaltohen këto ndjenja, do të thotë se agjërimi mbahet formalisht. Sidomos marrja me thashetheme dhe përfolje pas shpine gjatë agjërimit e asgjëson begatinë dhe mirësinë e tij.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka porositur:

“Sa vetë ka që mbajnë agjërim, nga i cili u mbetet vetëm uria dhe etja!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 373)

Edhe kjo tregon se edhe në agjërim ka nevojë për jetën ndjesore dhe shpirtërore.

Në Kur’an, duke përmendur cilësitë e besimtarëve, Zoti thotë:

“Në pasurinë e tyre kanë një të drejtë edhe ai që e tregon nevojëtari në e tij, edhe ai që e mban të fshehtë!” (edh-Dharijat, 19)

Po qe se një besimtar e ka të fuqishme strukturën shpirtërore, duke dhënë zeqat, sillet jo sikur po jep nga pasuria e tij, por sikur po i jep dikujt tjetër pjesën që i takon nga pasuria e tij, në mënyrë të natyrshme, me kënaqësi dhe, madje, duke e falenderuar atë që po e pranon zeqatin, duke fituar, kështu, vlerat e vërteta të zeqatit, sepse personi që merr, e ndihmon dhënësin për të çuar në vend një adhurim farz (të detyrueshëm), bëhet pretekst





për të që të ruhet nga aksidentet dhe fatkeqësitë, që të meritojë dhuntitë e jetës së pasme, ahiretit.

Në hadithin profetik thuhet:

“Pa dyshim, para se të kalojë në dorë të nevojtarit, sadakaja kalon në dorën e (fuqisë të) Allahut!” (Taberani, Muxhemu'1-Kebir, IX, 109)¹⁸

Për të merituar të fshehtën e këtij hadithi profetik, besimtari vepron me zgjuarsinë se, në të vërtetë, mallin që e ka dhënë si sadaka, e ka lënë në dorë të Zotit. Dhe kjo është një bazë e brendshme që siguron përkryerjen e adhurimit të zeqatit.

Natyrisht që edhe kjo delikatesë është e mundur me anë të pjekurisë ndjesore. Për më tepër, të mëdhenjtë tanë, kur kanë dhënë, e kanë zbukuruar dhuratën në formë pakete duke e bërë këtë punë me kujdes të posaçëm. Sepse dhurata në fillim arrin te Allahu, pastaj kalon te robi nevojtar. Këto janë shfaqje të hijshme të jetesës së Islamit me ndjeshmëri dhe delikatesë ndjesore.

Duke theksuar se **“... sadakatë i merr Allahu”** (et-Tevbe, 104), Zoti aludon mbi këtë edukatë dhe delikatesë që duhet treguar në dhurim.

Nga ana tjetër, dhënia në një mënyrë të mangët nga këto delikatesa ndjesore, duke e fyer nevojtarin, do të thotë eliminim me dorën e vet të shpërblimit të dhurimit të bërë. Islami e refuzon tipin e njeriut të ashpër, egoist dhe të trashë në sjellje. Muslimani është njeri i ndjeshëm, delikat dhe me sjellje të holla. Dhe të gjitha këto varen gjithmonë nga niveli ndjesor.

Këto delikatesa ndjesore të zemrës dalin më në pah në adhurimin e haxhit. Në dukje, haxhi është një adhurim ku peshon më rëndë aspekti trupor dhe fizik, si veshja e ihramit, tavafi, vakfeja në Arafat, therja e kurbanit, vajtja në Muzdelife. Kurse këto janë vetëm ana e jashtme e haxhit. Por po të vështrohet struktura moralo-shpirtërore e haxhit, do të vërehet kujtimi i kiametit dhe i ditës së ringjalljes, meditimi mbi llogarimarrjen hyjnore, llogaria e jetës së kaluar.

Në xhami, besimtarët falen sup më sup në të njëjtën radhë pa vënë re e pa marrë parasysh post e pozitë, pa bërë dallim të pasur e të varfër. Megjithëkëtë, duke parë veshjen dhe pamjen e jashtme të tyre, mund të kuptohet pak a shumë se ç'pozitë zënë në jetën shoqërore dhe ç'nivel mirëqenieje kanë. Por në haxh nuk është as kjo. Miliona njerëz të veshur në të bardha, pa asnjë shenjë dalluese, i kryejnë adhurimet pranë njëri-tjetrit.





Madje, gjatë kohës nën ihram janë ndaluar disa veprime krejt të zakonshme e legjitime, si këputja e barit, vrasja e kafshëve, gjuetia, tregimi i gjahut gjuetarit. Janë ndaluar bisedat e kota dhe preokupimet e panevojshme, kështu, është vënë si synim një nivel i lartë i ndjeshmërisë së zemrës.

Edhe adhurimi i kurbanit kërkon një akt në dukje formal dhe konkret. Por siç ndodh në adhurimet e tjera, ajo që e bën kurbanin të pranueshëm, është nijeti ose qëllimi që është akti i zemrës. Dekreti hyjnor mbi këtë çështje është shumë i qartë. Në Kur'an urdhërohet:

لَنْ يَنَالَ اللَّهَ لُحُومُهَا وَلَا دِمَاؤُهَا وَلَكِنْ يَنَالُهُ التَّقْوَىٰ مِنْكُمْ

“Te Allahu nuk shkojnë as mishrat, as gjakrat e tyre, por vetëm devocioni juaj!” (el-Haxh, 37)

Siç kuptohet edhe nga ajeti kur'anor, ata që therin kurban nga frika se mos turpërohen në mjedis po të mos therin, ose me mendime të ngjashme me këtë, e kanë të pamundur ta fitojnë pëlqimin e Zotit.

Fakti që kurbanin i djalit të Hz. Ademit, Kabilit, nuk u pranua, kurse kurbanin i dhuruar me sinqeritet nga djali tjetër, Habili, u pranua, është një dëshmi tjetër e kësaj të vërtete.

Kjo ngjarje tregohet kështu në Kur'an:

“Tregojua atyre si të vërtetë lajmin mbi dy djemtë e Ademit. Ata patën paraqitur nga një kurban dhe njërit i qe pranuar, kurse tjetrit nuk i qe pranuar. Vëllai që nuk i qe pranuar kurbanin i pati thënë vëllait: “Pa dyshim që kam për të të vrarë ty!” Kurse ai i qe përgjigjur: “Allahu pranon vetëm nga të devotshmit!” (el-Maide, 27)



Siç kuptohet nga këto të gjitha, vetëm me anë të purifikimit dhe maturimit të zemrës bëhet e mundur që adhurimet të fitojnë cilësinë për t'u bërë “makbul”, “të pranueshme” dhe aktet, cilësinë “salih”, “të mira”. Në këto kushte, del në shesh e vërteta se, para së gjithash, është e nevojshme të purifikohet zemra me anë të edukimit moralo-shpirtëror.

Ndërkaq, është e domosdoshme që kjo të kuptohet mirë. Sepse kurrë s'është e drejtë të braktisen aktet që janë duke u kryer, qofshin edhe me të meta, me drojë e pamundësisë për të kryer adhurim me përsheptshmëri dhe devocion dhe frikën nga rreziku i mungesës së sinqeritetit. Nuk duhen braktisur aktet që janë duke u kryer, por duhen bërë përpjekje për t'i





përkryer ato me sa të jetë e mundur me anë të ndjeshmërive ndjesore të tilla, si principialiteti dhe sinqeriteti, përshpirtshmëria dhe devotshmëria. Sepse rruga shpirtërore është e mbushur plot me vështirësi. Ajo e bën të domosdoshme luftën kundër prirjeve të nefsit (vetvetes, egos). Rezultati nuk arrihet menjëherë dhe aq thjesht. Përshpirtshmëria është një majë në ngjitjen moralo-shpirtërore dhe ngjitja në majë bëhet hap pas hapi. Në këtë rrugë, edhe vullneti njerëzor duhet përdorur, edhe bujaria dhe favori i Zotit duhen lutur.

Meqë cilësinë e akteve e cakton orientimi i zemrës, nevoja për tasavvufin i cili vë për synim t'i përftojë zemrës një orientim të përkryer, është në shesh dhe krejt e qartë. Nga ky aspekt, janë mjaft të kuptueshme rropatjet për kundërshtimin dhe hedhjen poshtë të tasavvufit të disa mjediseve të cilat dëshirojnë ta shohin fenë tonë të lartë si një tufë rregullash të thata dhe ta paraqesin të tillë.

Si në çdo fushë, gabime, të meta, shpërdorime mund të ndodhin edhe në shkencat fetare. Këto mund të apelojnë mjaft lehtë nga kompetentët. Por ta kundërshtosh dhe mohosh tasavvufin duke i treguar, me qëllim, këto gabime dhe shpërdorime, si të posaçme vetëm për shkencën e tasavvufit që është jeta ndjesore e fesë, kjo është vepër e një palogjikshmërie të tillë si dedikimi i dobësive dhe të metave njerëzore fesë dhe tasavvufit të vërtetë ose thelbit të tyre. Pra, kundërshtimi dhe hedhja poshtë e botëkuptimit mistik që zhvillohet sipas një orientimi të caktuar dhe në rrugë të drejtë vetëm sepse ekzistojnë njerëz që e shfrytëzojnë dhe e shpërdorojnë tasavvufin (mistikën) për dëshira të ulta, nuk mund të ketë asnjë lloj shpjegimi të logjikshëm. Kjo situatë i përngjet tentimit për ta kundërshtuar dhe hedhur poshtë tërësisht, bie fjala, shkencën e mjekësisë ngaqë ka njerëz që e përdorin atë për qëllime të mbrapshta.

Eshtë e pamundur ta kuptosh tasavvufin duke parë se si veprojnë një sërë njerëzish me qëllim të keq ose të padenjë, të cilët pandehin se e jetojnë atë. Sepse, meqë tasavvufi është një barrë që nuk mund ta ngrejë çdo kandar, po që se ndryshimi tejet i madh mes përmbajtjes praktike dhe të vërtetës së tasavvufit, ndryshim që shfaqet në sjelljet dhe veprimet e njerëzve jokompetentë, vështrohet me kritere maturie dhe logjike, mund të kuptohet madje edhe me një vështrim sipërfaqësor.

Eshtë e pamundur ta parashtrosh dhe ta shpjegosh tasavvufin me kritere mediokre. Sepse tasavvufi si një dukuri e horizontit ndjesor, ka për brumë afërsinë dhe dashurinë sublime. Sado që t'u shpjegohet njerëzve që





s'kanë pjesë nga afërsia dhe dashuria sublime, s'bën dobi. Kjo është po aq e padobishme sa dhe përpjekja për t'i folur për ngjyrat dikujt që ka lindur i verbër!

Sa më shumë që të largohet nga meditari mbi botën e tij të brendshme, njeriu në po atë masë është i dënues të bëhet automat dhe imitues. Njeriu i privuar nga begatia shpirtërore i cili nuk e njeh botën e tij të brendshme shpirtërore, prandaj dhe nuk kridhet dot në të si i fuqishëm, imiton të tjerët që ka përreth. Ai ia lë veten rrymës, prandaj dhe nuk përbën karakter dhe personalitet.

Meritimi i bashkimit hyjnor është i mundur duke e bërë zemrën të heqë dorë nga pasuria materiale, popullariteti, fama dhe drojat e jetës.



Në të vërtetë, tasavvufi është shkenca mbi njeriun. Njeriu që, duke u shmangur dhe çliruar nga bota, thellohet në shpirtin e vet, afrohet në portën e pallatit të urtësive dhe të të vërtetave. Ata që e kuptojnë Kur'anin dhe që e jetojnë atë si rrugën e besimit të vërtetë, janë mistikët e vërtetë. Mistiku është njeriu që e ndjen veten përgjegjës ndaj Allahut për mënyrën e jetesës fetare të shoqërisë mes të cilës ndodhet.

Hz. Nexhmeddin Kubra, nga miqtë e Zotit, merr pjesë bashkë me nxënësit e vet në varrimin e një personi të mirë. Kur po i këndohej telkini të vdekurit, N. Kubra buzëqesh. Nxënësit habiten nga buzëqeshja e mësuesit në këto kushte dhe e pyesin për kuptimin e këtij gjesti të tij. Ai s'dëshironte t'i sqaronte, por, pas këmbënguljeve të tyre, vendos t'u hapet dhe u thotë kështu:

“Zemra e personit që e bëri telkinin ishte indiferente dhe e vdekur, kurse e kufomës që kishte hyrë në varr, e gjallë. Më erdhi turp që dikush me zemër indiferente t'i sugjeronte dikujt me zemrën të gjallë!”

Ja, pra, edhe gjendja e atyre që ngrihen ta kundërshtojnë dhe mohojnë tasavvufin ose mistikën në emër të diturive dhe shkencës, është në një aspekt, diçka për t'u çuditur sa ç'është sugjerimi i të vdekurit për të gjallin. Sepse suksesi në shërbimet dhe zellin e mistikëve gjatë gjithë historisë për ta mbajtur gjallë jetën fetare, për t'ua përcjellë atë brezave pasues, për orientimin e popullit dhe për kumtimin e Islamit, është para syve.

Dijetari i shquar islam i shekullit të kaluar, Muhammed Hamidullah, thotë kështu:

“Mënyra se si jam rritur dhe përgatitur unë, është racionale. Kërkimet dhe studimet juridike m'i kanë hedhur poshtë të gjitha gjërat e pa-





përshtetura e të pavërtetuara në mënyrë bindëse. Pa dyshim, unë i kryej detyrat islame si namazi, agjërimi, etj., jo për shkaqe mistike, por juridike. Dhe them me vete:

“Allahu është Zoti im, është zotëria im. Ai më ka urdhëruar për t’i kryer këto. Pra, më duhet t’i kryej. Veç kësaj, të drejtat dhe detyrat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Allahu m’i ka urdhëruar këto me qëllim që të përfitoj prej tyre. Atëherë, unë e kam për detyrë ta falenderoj Atë!”

Qysh nga koha kur fillova të jetoj në shoqërinë perëndimore, në një mjedis të tillë si Parisi, nisa të shoh me habi se ajo që i shtyn të krishterët ta pranojnë Islamin, nuk janë pikëpamjet e dijetarëve të fikhut e të kelamit, por mistikë të tillë si Ibni Arabiu dhe Mevlanai. Mbi këtë çështje, edhe unë formova përvojën time personale. Kur më kërkohet shpjegimi i një çështjeje islame, përgjigjja ime e mbështetur në argumente racionale, domethënë, në arsyen, nuk e kënaqte personin që bënte pyetjen, kurse shpjegimi mistik nuk vononte të jepte fryt. Kështu, me kohë, unë e humba forcën ndikuese dhe tani besoj se të paktën në Europë dhe Afrikë, ajo që do t’i shërbejë Islamit nuk është as arsyeja, as shpata, por zemra, domethënë, tasavvufi!

Pas kësaj përvoje, fillova të studioj disa vepra të shkruara mbi tasavvufin. Kjo ma hapi syrin e zemrës. Dhe e kuptova se tasavvufi dhe rruga e mistikëve të mëdhenj islamë në kohën e Profetit që jo marrja me fjalë dhe as preokupimi me gjëra të pakuptim, por ecja në rrugën më të shkurtër që shkon nga njeriu te Zoti, kërkimi i rrugës së zhvillimit të personalitetit.

Njeriu kërkon shkaqet e detyrave që i ngarkohen. Shpjegimet materiale në fushën shpirtërore na largojnë ne nga synimi; vetëm shpjegimet moral-shpirtërore janë ato që e kënaqin njeriun!”¹⁹

Siç kuptohet edhe nga këto shprehje, tentimi për ta kundërshtuar dhe hedhur poshtë tasavvufin që është në akord të plotë me Kur’anin dhe sunetin, do të thotë ta gjuash me gurë pemën që jep fruta, gjë që ka një përgjegjësi dhe ndëshkim të rëndë.

Poeti Mevlana thotë:

“Po që se hunda nuk të nuhat dot, të paktën mos e fajëso trëndafilin!”

Një aspekt tjetër i rëndësisë së tasavvufit në ditët tona është metoda dhe stili i ndjekur prej tij për përmirësimin e njerëzve. Legjislacioni kanu-

19 M. Aziz Lahbabi, *İslam şahsiyetçiliği*, përkth. İ. Hakkı Akın, f. 114-115, shën. 8. İst. 1972. Ky shënim është teksti i letrës së datës 27 shtator 1967 të shkruar nga Muhammed Hamidullah për përkthyesin. (Cituar nga Mustafa Kara, *Metinlerle Günümüziün Tasavvuf Hareketleri*, f. 542-543)





nor ndjek qëllimin për t'i orientuar njerëzit me anë të shpërblimeve dhe ndëshkimeve edhe për këtë botë, edhe për jetën e pasme, ahiretin. Kurse tasavvufi përdor dashurinë, dhembshurinë dhe afërsinë. Në kohën tonë njerëzit, në përgjithësi, përjetojnë krizën moralo-shpirtërore të largimit nga feja dhe kryerjes së mëkateve të rënda. Ndërkaq, askush nuk mund ta mohojë se njerëzve në një krizë të tillë është më e lehtë t'u propozosh si rrugë shpëtimi ndjenjën e faljes, mirëkuptimin dhe dhembshurinë.





Tasavvuf do të thotë pajisje me dije dhe të vërteta formale për të arritur, në klimën e zemrës, në botët përtej tyre.



F. MARREDHENIET E TASAVVUFIT ME SHKENCAT DHE ARTET

Shkencat e tjera që dalin në shesh si përfundim i natyrshëm i ndjenjës së hetimit të të fshehtave, e cila përmbahet në krijimin e njeriut, e shprehur më thjesht, i kureshtjes për kërkim, njohje dhe studim, studiojnë rregullat dhe ligjet që u përkasin të vërtetave të fushave të tyre. Ndërkaq, gjatë këtij studimi, dashje pa dashje, ato arrijnë në shumë pika të përbashkëta me tasavvufin që e trajton fushën me të cilën merren ato, me një perspektivë më të përgjithshme dhe nga aspekti i urtësisë. Kjo cilësi që s'është e posaçme vetëm për shkencat fetare, përfshin edhe shkencat e natyrës që studiojnë veçoritë fizike të gjithësisë, edhe artet e bukura që janë produkt i krijimit të pastër dhe, në një pikë, edhe filozofinë. Prandaj, marrëdhënien e tasavvufit me shkencat e tjera mund ta analizojmë shkurt në pesë kategori.

1. TASAVVUFI DHE SHKENCAT E TJERA ISLAME

Qëllimi i fesë është t'ia bëjë të njohur njeriut Krijuesin e vet, t'ia bëjë të ditur detyrat dhe përgjegjësitë para Tij, t'i ngrejë marrëdhëniet njerëzore në drejtimin që kërkon dëshira (dëshira volitive) hyjnore, mbi drejtësinë, barazinë, paqen dhe qetësinë. Edhe synimi i tasavvufit ose mistikës islame është ta bëjë besimtarin të arrijë cilësinë ndjesore dhe konsistencën shpirtërore për të qenë në gjendje t'i realizojë të gjitha këto specifika; duke përbërë një bazë moralo-shpirtërore për legjislacionin formal fetar, të sigurojë plotësimin e akteve që janë domosdoshmëri e atij legjislacioni, në një mënyrë të përkryer duke respektuar këtë përmbajtje moralo-shpirtërore. Prandaj është e natyrshme që tasavvufi të paraqesë një specifike ndërthur-





jeje reciproke me shkencat e tjera islame. Për ta parë këtë të vërtetë në një mënyrë më të hapur, do të ishte e dobishme që t'i preknim shkurt marrëdhëniet mes këtyre shkencave.

a) Tasavvufi dhe Kelami

Si tematikë, shkenca e kelamit, para së gjithash, flet për individualitetin, atributet dhe njësinë e Allahut. Meqë ka lidhje me akaidin, pranohet si më i rëndësishmi i shkencave islame. Një ndër qëllimet e shkencës së kelamit është ta vërtetojë të drejtën dhe ta kundërshtojë dhe hedhë poshtë të shtrembrën. Për rrjedhojë, dhënia e përgjigjeve ndaj kritikave dhe kundërshtimeve të drejtuara ndaj Islamit dhe bindja e njerëzve se Islami është feja e vërtetë, është njëri prej qëllimeve të kelamit.

Kurse synimi i tasavvufit ose mistikës islame është njohja edhe me zemër e Allahut të karakterizuar nga atributet e përsosmërisë, të pastër nga atributet relative si dhe transcendental, pra, njohja *intuitive e Allahut*, e shprehur me terminologjinë e tasavvufit, *marifetullah*.

Shkenca e kelamit përqipet t'i zgjidhë vështirësitë që kanë lidhje me akaidin, me anë të mendjes (arsyes) duke marrë për bazë Librin dhe Sunnetin. Prandaj, sado t'u përngajnë filozofëve, dijetarët e kelamit, ngaqë nuk e trajtojnë mendjen (arsyen) të pavarur nga dogma (nass), e përdorin atë brenda kornizës së legjitimitetit. Ndërkaq, mendja (arsyeja), e cila përparon në botën e shkaqeve në linjën e njohjes që shkon nga vepra te autori, e vetme është e pamjaftueshme për ta çuar njeriun te e vërteta. Prandaj ndjehet nevojë në nivel të domosdoshëm edhe për ndijimet dhe pikëpamjet e zemrës ose afektive.

Ja, pra, tasavvufi ose mistika islame, në çështjet ku mendja (arsyeja) mbetet e pamjaftueshme, vazhdon e nënshtruar në rrugën e saj duke futur në veprim zemrën. Këto lloj çështjesh, tasavvufi i qartëson me shfaqjet e zemrës si frymëzimi dhe zbulimi, në përputhje me Kur'anin dhe Sunnetin. Në këtë mënyrë, individi çohet në një kënaqje dhe ngopje përfundimtare.

Nevoja për veprimtarinë e zemrës është një cilësi e pranuar edhe nga dijetarët e kelamit. Prandaj, ashtu siç e shprehëm edhe më lart, nuk është e drejtë që ndaj dijetarëve të kelamit të formohet një konsideratë si për filozofët, shumica e të cilëve e marrin mendjen (arsyen) për bazë. Në fakt, është një e vërtetë historike se mes tyre ka shumë vetë që i gjejnë të përshtatshme praktikisht ose teorikisht pikëpamjet mistike dhe i përdorin.





Nga ana tjetër, veprimtaria mendore e quajtur arsyetim dhe gjykim përdor mbresat e marra nga bota materiale dhe, në sajë të ngjashmërive ose kundërshtive, përpiqet të arrijë te e vërteta. Por është e pamundur të arrihet me anë të mendjes dhe arsytimit të e vërteta e qenieve metafizike që nuk zotërojnë mbresa të tilla. Është për këtë arsye që mendja mundet ta kënaqë në një farë mase prirjen e njeriut për të arritur te e vërteta. Për përkryerjen e kësaj kënaqjeje, përtej pikave ku arsyeja konsumohet, mund të arrihet me anë të frymëzimit dhe parandjenjës së zemrës e cila është qendër ndjeshmërie. Ja, pra, tasavvufi ose mistika islame i përfton njeriut mundësinë që, duke mos qëndruar në pikat ku mendja nuk shkon më tutje, të shkojë dhe të arrijë gjer përtej dhe këtë e siguron duke e sjellë zemrën në një truall të gatshëm për frymëzim në sajë të dhikrit. Është për këtë arsye që tasavvufi, duke e kompensuar pamjaftueshmërinë në përdorimin e mendjes dhe arsyes në të gjitha fushat që ka për objekt studimi shkencë e kelamit ose apologetika, duke filluar me individualitetin dhe atributet e Allahut, i jep kësaj veprimtarie shkencore pjekurinë që do ta kënaqte njeriun.



Të vërtetat që parashtron shkencë e kelamit për shumicën, tasavvufi ose mistika islame i sjell në nivelin që do ta kënaqte edhe atë më kapacitetin më të lartë, meqë kapaciteti i çdo individi është i ndryshëm. Duke e forcuar besimin e individit, tasavvufi i jep atij informacion faktik mbi çështjen e ekzistencës dhe njësisë së Allahut.

Këtë të vërtetë, Fahreddin Raziu i cili ka fituar popullaritet si një muftessir (komentues i Kur'anit, specialist i tefsirit, komentit të Kur'anit) kelamist, e shpreh kështu:

“Sado të pamjaftueshme të jenë metodat e kelamistëve për të arritur te e vërteta, janë një hap i parë tejet i rëndësishëm që duhet hedhur për të kaluar në tasavvuf. Grada e përsosmërisë arrihet me kalimin e njeriut nga shkencat kanonike (shariat) që mbështeten në formën e jashtme, te shkencat ezoterike që mbështeten në njohjen e të vërtetave të ngjarjeve!”²⁰

20 Muhammed Salih ez-Zerkan, *Fahruddin er-Razi ve Arauhu'l-Kelamijje ve'l- Felsefijje*, f. 76 (citim nga Muhammed Abid el-Xhabiri, *Arab-İslam Kültürü'nün Akıl Yapısı*, f. 626).





b) Tasavvufi dhe Tefsiri

Tefsiri është shkencë që ka për objekt nxjerrjen në dukje dhe shpjegimin e kuptimeve të gjera të Kur'anit të paraqitur njerëzimit si udhëzues i rrugës së drejtë. Me këtë aspekt, tefsiri kryen për tasavvufin që ka për synim t'ia pastrojë njeriut botën e brendshme për ta çuar atë në përsosmëri, punën e një barnatoreje që ofron ilaçet dhe recetat e duhura, sepse shkencë e tasavvufit, ndërsa i trajton temat që merr në dorë dhe përcakton metodat që janë të posaçme vetëm për të, e ka marrë dhe e merr për bazë Kur'anin si burim themelor.

Duke urdhëruar sjelljen me ndjenjë përgjegjësie ndaj Allahut në çdo fushë të jetës, kryerjen e adhurimeve me përshpirtshmëri, përmendjen e shpesh të Allahut dhe qëndrimin vazhdimisht nën kontrollin hyjnor, Kur'ani kërkon që robi të arrijë pëlqimin hyjnor. Të gjitha këto specifika janë tema të rëndësishme mbi të cilat mistikët kanë qëndruar me ndjeshmëri.

Kompetentët dhe njerëzit e tasavvufit që e kanë bërë qëllim themelor bashkimin me zemër me Allahun, e kanë parë Kur'anin si rrugën e vetme që do t'i çojë tek Ai dhe e kanë bërë Kur'anin bosht të jetës së tyre. Ajetet e Kur'anit mbi të cilat është urdhëruar të meditohej thellë, i kanë shndërruar në virde të mëngjeseve të hershme të tyre. Për të mund të rrokin kuptimet e holla të tij, kanë besuar në domosdoshmërinë e purifikimit të zemrave të tyre!

Meqë morali i të Dërguarit të Allahut përbëhet prej vetë Kur'anit ose është vetë Kur'ani, njerëzit e Allahut të cilët kanë vënë si synim të përsosjen moralisht, kanë shfaqur zellin që të gjitha veprimet dhe sjelljet t'i rregullojnë sipas përmbajtjes së fjalës hyjnore, janë përpjekur dhe kanë luftuar për t'u bërë Kur'an i gjallë!



Si rrjedhojë e faktit që burimi kryesor i begatisë ideore dhe i frymëzimit të njerëzve dhe kompetentëve të tasavvufit ose misticizmit islam është Kur'ani, mistikët islamë i kanë bërë shërbime të mëdha edhe shkencës së tefsirit ose komentit të Kur'anit. Duke nxjerrë në shesh edhe kuptimet sinjifikative të ajeteve, kanë ndihmuar për pasurimin e kësaj shkencë. Mund të thuhet se me këtë këndvështrim, personalitetet e mëdhenj të tasavvufit, në tefsirin e Kur'anit, duke u kredhur në detin e gjerë të fjalëve të tij, kanë treguar zell për të përfutur shumë e shumë urtësi dhe janë përqëndruar mbi rëndësinë e kësaj. Në këtë mes, nuk është e drejtë që përmbajtja e fjalës





hyjnore të mbyllet në ngushticën e fjalës njerëzore. Ndërkaq, as nuk duhet pandehur se kjo veprimtari është pa sistem e pa rregull. Duke dhënë kuptimin sinjifikativ, janë respektuar këto tri specifika:

1) Kuptimi sinjifikativ të mos përbëjë kontradiktë me kuptimin e jash-tëm formal.

2) Kuptimi i dhënë të ndodhet në përmbajtjen e Librit dhe Sunnetit.

3) Fjalët dhe konteksti të jenë në përshtatje me kuptimin sinjifikativ.

Si modele të veprave të tefsirit të Kur'anit me mënyrën sinjifikative, mund të tregohen tefsiret *Hakaiku't-Tefsir* i Ebu Abdurrahman Sulemit, *Le-taifu'l-Isharat* i Kushejrit dhe *Ruhu'l-Bejan* i Ismail Hakiut. Krahas këtyre, edhe veprat e mistikëve si Mevlana dhe Ibni Arabi janë pasuruar me tefsiret (komentet) sinjifikative të shumë ajeteve kur'anore.

Është një e vërtetë se nga ç'aspekt që t'i jepet kuptim Kur'anit që është shfaqje e atributit Fjalë të Zotit, është e pamundur që të gjitha kuptimet e shprehura prej tij të përcillen në fjalën njerëzore. Sa ç'është e pamundur të rroket ashtu siç duhet individualiteti dhe atributet e Allahut të Lartë, është po aq e pamundur të rroket Kur'ani në të gjithë përbërjen dhe natyrën e tij. Ato çka kuptojmë nga Kur'ani janë vetëm sa një pikë ujë nga deti. Sa bukur e shpreh ky ajet këtë të vërtetë:

“Po qe se të gjithë drurët mbi tokë do të bëheshin kalem dhe të gjithë detrat, bojë, fjalët e Allahut s'do të mbaroheshin së shkruari. Nuk ka dyshim se Allahu është fitimtar absolut dhe i urtë!” (Llukman, 27)

Në këtë ajet, në një kuptim, Zoti e nxjerr përmbajtjen e fjalëve të veta mbi përmbajtjen e fjalëve njerëzore dhe duke e shprehur pafundshmërinë e tyre, dëshiron që njerëzit të përfitojnë sa më shumë e sa më thellë prej tyre. Këtë specifikë të Kur'anit, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh me këto fjalë:

“... kuptimet e pazbuluara të Kur'anit që dalin në shesh çdo çast, nuk kanë të sosur!” (Tirmidhi, *Fedailu'l-Kur'an*, 14)

Në lidhje me këtë, poeti Mevlana thotë kështu:

“Ana e jashtme e Kur'anit mund të shkruhet me një shishe bojë, kurse për shprehjen e të gjitha të fshehtave që përmban ai, edhe sikur të gjithë detrat të bëheshin bojë dhe të gjithë drurët të bëheshin kalem, nuk do të mjaftonte!”

Shprehjet në ajetet dhe hadithet e përmendur më sipër tregojnë se Kur'ani është një përmbledhje poetike e plotë e të gjitha të vërtetave në gjithësi dhe se të gjitha të vërtetat ndodhen tek ai në gjendje embrionale,





sepse po qe se ekzistenca në Kur'an e këtyre lloj njohurish dhe të vërtetash do të ishte e hapur, do të duhej që Kur'ani të kishte një vëllim të pafund. Prandaj, në Kur'an, disa të vërteta ndodhen hapur, kurse shumica në formë argumentesh. Gjetja dhe parashtrimi i këtyre lloj të vërtetave enigmatike është e mundur vetëm me anë të një mendjeje të shëndoshë kapacitive dhe me anë të syrit të zemrës.

Prandaj, në veprat e metodës së tefsirit, duke u përmendur dituritë që duhet të zotërojnë mufessirët, specialistët e tefsirit, komentit të Kur'anit, bëhet fjalë edhe për diturinë e quajtur "vehbi ilm" që Allahu i Lartë ua dhuron robve të Tij të zgjedhur. Kjo dije mund të fitohet vetëm me anë të devocionit ndaj Allahut të Lartë, me anë të thjeshtësisë ndaj krijesave, me anë të asketizmit kundër kësaj bote dhe me anë të një lufte të pamëshirshme kundër nefsit, egos. Për këtë të vërtetë aludon porosia profetike: *"Atyre që veprojnë me ato që dinë, Allahu ua mëson edhe ato që nuk dinë!"* (Ebu Nuajm, Hilje, X, 15)

Kjo do të thotë se për sa kohë që sëmundje të tilla të zemrës si mendjemadhësia, smira, dashuria për këtë botë, etj., që bëhen pengesë për t'i kuptuar ajetet e Allahut, nuk kurohen me anë të edukimit dhe purifikimit mistik, përfitimi nga fshehtësitë e Kur'anit është i pamundur. Këtë e shpreh hapur ajeti kur'anor:

"Ata që mbahen më të madh në këtë botë, i pengoj t'i kuptojnë si duhet ajetet e mia!" (el-Araf, 146)

Pra, po nuk u shënuar përparim në botën ndjesore me anë të edukimit dhe purifikimit moralo-shpirtëror, përfitimi nga fshehtësitë e Kur'anit, gjithësisë dhe njeriut është i pamundur.

c) Tasavvufi dhe Hadithi-Sijeri

Hadithi është shkencë që merret me shqyrtimin e specifikave që kanë të bëjnë me fjalët, aktet, miratimet, si dhe me natyrën e krijimit ose moralin e bukur të Profetit (s.a.s.).

Si për shkencat e tjera islame, edhe për tasavvufin ose mistikën islame, hadithi ka qenë dhe është burimi i dytë i referimit pas Kur'anit. Nuk është aspak e vështirë për ta kuptuar rolin e madh që kanë marrë përsipër hadithet, të cilat zotërojnë një pasuri që do ta vinte në shesh me të gjitha aspektet materiale-shpirtërore jetën e Profetit, për formësimin dhe zhvillimin e tasavvufit. Në çështjet që i interesojnë nga afër tasavvufit, fjalët dhe sjelljet e Profetit lidhur me jetën shpirtërore i kanë afruar tasavvufin dhe shkencën e hadithit me njëri-tjetrin duke i sjellë në një të tërë të pandarë.





Ashtu siç u tha edhe në marrëdhënien e tasavvufit me shkencën e tefsirit, mistikët që e kanë bërë qëllim themelor final afrimin dhe bashkimin me Allahun, meqë e kanë ditur shumë mirë se dashuria dhe afërsia ndaj Allahut realizohen duke shkuar në gjurmët e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), ndjekjen e tij në çdo çështje e kanë bërë shenjë dhe tregues të vetes së tyre dhe në këtë pikë kanë përfituar me kënaqësi e ngopje nga thesari i pasur i Sunnetit. Dhe ecja në gjurmët e Profetit është e mundur vetëm duke e dashur atë dhe duke e njohur si më të çmuar se çdo gjë tjetër.

Qoftë në adhurim dhe marrëdhëniet civile, qoftë në çështjet moralotike, pa asnjë dyshim, personaliteti shembullor përsa i përket thellësisë së ndjenjave, delikatesës dhe elegancës së sjelljeve, është i Dërguari i Allahut (s.a.s.), Profeti ynë. Veprat e hadithit dhe sijerit janë plot me shembuj të panumërt që e mbështesin këtë.

Gjërat që na janë përcjellë neve në mënyrë të pandërprerë nga Profeti, nuk janë vetëm fjalët e tij të bekuara. Në të njëjtën mënyrë, edhe të gjitha sjelljet e tij gjer në hollësi, janë përcjellë nga ana e sahabeve dhe, kështu, kanë arritur gjer tek ne.

Si rrjedhojë, bukuritë në jetën e virtytshme të mistikëve, duke qenë reflektime të figurës moralo-shpirtërore të Profetit, përbëjnë një element plotësues të teksteve të shkruara të hadithit. Qëndrimet dhe sjelljet e mistikëve përbëjnë kritikën praktike të haditheve. E shprehur ndryshe, duke i kaluar hadithet nga teoria në praktikë, janë ato që u kanë dhënë vazhdimësi atyre në kohë dhe hapësirë.

Veprat e titulluara “Kitabu’z-Zuhd”, të shkruara si nga specialistët e hadithit, si nga mistikët para se tasavvufi të dilte në shesh si një shkencë, kanë bërë punën e një ure midis shkencës së hadithit dhe tasavvufit.

Nga ana tjetër, me anë të shpjegimit të haditheve duke u dhënë kuptime sinjifikative, mistikët e kanë pasuruar shkencën e hadithit. Madje, disa sufite kanë pranuar se hadithe mund të merren edhe nga bota shpirtërore e Profetit me rrugën e zbulimit, megjithëse kjo nuk është pranuar nga specialistët e hadithit.

Në histori ekzistojnë mistikë të mëdhenj si Hakim, Tirmidhi dhe Kela-bazi, të cilët, megjithëse janë bërë të famshëm si sufi, kanë dhënë vepra mbi hadithin. Po kështu, ka pasur vazhdimisht shkencëtarë të hadithit të cilët, megjithëse janë bërë të famshëm si specialistë të hadithit, krahas kriterëve të shkencës së hadithit, kanë pranuar edhe metodat e sufive (mistikëve).





Për shembull, imam Buhari (rahmetullahi alejh) që pranohet si autoriteti më i madh në shkencën e hadithit, vepra e të cilit në fushën e hadithit është burimi më me konsideratë pas Kur'anit, për çdo hadith që ka përcjellë, para se ta shënojë në veprën e vet, ka falur dy reqate namaz istihareje dhe vetëm pas namazit, pasi është bindur edhe me zemër për autencitetin e hadithit përkatës, e ka futur në veprën e vet.²¹ Gjithashtu, rrëfëhet se specialisti i madh i hadithit, Ahmed b. Hanbel, ka marrë tre hadithe prej Profetit në ëndërr.²²

d) Tasavvufi dhe Fikhu

Kuptimi leksikor i fjalës *fikh* është *dije, njohje, kuptim, rrokje e hollësive*. Në kohët e para të Islamit, çdo gjë që duhej mësuar dhe ditur në të gjitha specifikat fetare e temporale, mësohej nën emërtimin *fikh*, kurse kompetentët e kësaj fushe dijeje quheshin *fakihë*, domethënë, dijetarë. Në këtë kuptim, fjala fakih emërtonte personin kompetent të ekzistencës dhe dukurive, personin që ishte i aftë për të diferencuar specifikat pro (në dobi) dhe kundër (në dëm) të njeriut në çështjet fetare-besimore. Kështu, imami i madh Ebu Hanife e përkufizon fikhun kështu:

“Fikhu është njohja nga personi e gjërave pro dhe kundër tij nga pikëpamja fetare.”

“Njohja drejt e Zotit” si faktori me ndikim në shkallë të parë mbi lumturinë dhe fatkeqësinë e njeriut, përbënte pjesën më me rëndësi të kësaj shkence. Është për këtë arsye që teksti i parashtruar nga Imam Adhami Ebu Hanife mbi çështjet besimore, i shënuar me shkrim nga nxënësit e tij dhe i përcjellë gjer në ditët e sotme, është mbiquajtur Fikhu'l-Ekber, dija më e lartë. Ndërsa puna qëndronte kështu në fillim, më vonë, me zgjerimin e veprimtarisë shkencore mbi këtë specifikë, fakihët, duke i lënë konkluzionet besimore (itikadî) dhe moralo-etike (ahlakî) jashtë fikhut, e kufizuan dhe e specializuan atë vetëm për konkluzionet praktike dhe juridike. Edhe sot, kjo kuptohet me fikhun.

Edhe tasavvufi ose mistika islame është njohja nga njeriu edhe në formë edhe në përmbajtje e gjërave pro dhe kundër tij dhe mbajtja e qëndrimit të duhur. Fikhu bën të ditur kushtet formale të vlefshmërisë të çështjeve besimore-praktike, si abdesti, pastrimi, namazi dhe agjërimi. Kurse tasavvufi,

21 shih. Ibni Haxher, *Hedju's-Sari Mukaddimetu Fethi'l-Bari*, f. 489; Ibni Haxher, *Taghliku'l-Talik*, V, 421.

22 shih. Mexhmuu'l-Hadith, fletët 110a-112b.





duke e pastruar zemën, e përgatit njeriun me anë të ndjenjave afektive dhe intuitive. Kjo do të thotë përgatitje e truallit më të përshtatshëm për përkryerjen e atyre adhurimeve. Nisur nga kjo, tasavvufi është mbiquajtur “fikhu i brendshëm” ose “fikhu i ndërgjegjes” me kuptimin “baza dhe thelbi shpirtëror i shkencës së fikhut”.



Pa asnjë dyshim, qëllimi final i shkencës së fikhut është të sigurojë që akti (adhurimor) të kryhet në mënyrë të përsosur, domethënë, në mënyrën më të pranueshme në lartësinë e Allahut. Ndërkaq, meqë një përkryerje dhe përsosje e tillë mund të realizohet vetëm me anë të pjekurisë shpirtërore të siguruar nga mendimet mistike, e bën të domosdoshme që këto dy shkencë të konsiderohen pothuaj plotësuese të njëra-tjetrës.

Ndërsa fakihët i kanë shqyrtuar adhurimet, si namazin, agjërimin dhe haxhin, si dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore ose civile, si kurora martesore, shkursorëzimi, tregtia dhe ndëshkimi ekuivalent (kisas), kanë konkluduar mbi to dhe i kanë kompiluar, mistikët i kanë dhënë rëndësi kryerjes së tyre së bashku me institucione moralo-shpirtërore, si asketizmi (zuhd), devocioni (takva) dhe principialiteti e sinqeriteti (ihlas).

Natyrisht, kjo s’do të thotë se mistikët nuk i kanë dhënë rëndësi fikhut ose nuk janë marrë sa duhet me shkencën e fikhut. Përkundrazi, shumë mistikë, si Gazaliu, Ibni Arabiu, Mevlana Xhelaledin Rumi, imam Rabbaniu dhe Halid Bagdadi janë dijetarë dhe fakihë të mëdhenj, kompetentë edhe në shkencat formale.

Disa persona që nuk i kanë kuptuar dot si duhet as përmbajtjen e tërësisë konkluzionale formale të fesë islame, as dhe të vërtetat mistike, kanë dalë me pretendimin se ekziston një mospërputhje midis fikhut dhe dispozicionit mistik dhe, prej kësaj, është shkaktuar kohë më kohë një kundërvënie e pavend. Ndërkaq, në fakt, nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë mosmarrëveshje mes mistikëve kompetentë dhe fakihëve të vërtetë. Kundërvënia dhe polemika është midis injorantëve që e pandehin veten si dijetarë, dhe sufitëve të trashë që e pandehin veten për kompetentë.





Me do t'u tregojmë njerëzve provat tona në horizonte dhe në botën e tyre të brendshme në mënyrë që të kuptohet qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A s'mjafton që Zoti yt është dëshmitar për gjithçka? (el-Fussilet, 53)



2. TASAVVUFI DHE SHKENCAT E NATYRES

Edhe nëse shkencat e natyrës, domethënë shkencat që vërtetohen me anë të vëzhgimeve dhe provave laboratorike, duken, në shikim të parë, se nuk kanë të bëjnë me tasavvufin, e vërteta nuk është aspak kështu.

Rruga e çdo veprimtarie diturore-shkencore që vrapon drejt një qëllimi final që ka për objekt kuptimet, urtësitë dhe cilësitë ekzistencialiste të qenieve dhe dukurive, arrin, më në fund, në një pikë metafizike. Kjo është vetë pika ku takohen shkencat e natyrës me tasavvufin. Sepse tasavvufi analizon, përcakton dhe kompilon përgjithësisht të fshehtat dhe kuptimet, domethënë, dimensionet metafizike të të gjitha qenieve në gjithësi. Tasavvufi e bart njeriun për tek një dije më e drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe në një nivel që do t'ia plotësonte prirjen për hetim, mbi Allahun dhe vanitetet, pra, e bart për tek klima e të vërtetës.

Fusha e interesimit të shkencave të natyrës është bota materiale. Të vërtetat që gjejnë shkencat e natyrës të qeniet, janë veçori të vendosura tek to me anë të caktimit hyjnor. Sipas kësaj, çdo zbulim mbi botën materiale shfaqet si një provë dhe argument i fuqisë dhe madhështisë së Krijuesit. Duke u nisur nga kjo, mund të thuhet se shkencat e natyrës, në një kuptim, ndihmojnë në arritjen të mrekullitë e artit hyjnor.

Nga ana tjetër, Islami, edhe materien, madje, e trajton bashkë me dimensionet e saj metafizike; sot edhe shkencat moderne të natyrës i janë afruar këtij lloj shpjegimi. Sepse çdo zbulim në botën materiale ua hap por-





tën të panjohurave të reja duke e tërhequr meditacionin njerëzor drejt një largësie të pafundme. Dhe, në fund të kësaj veprimtarie të zhvilluar me mbresat e botës materiale, ndodh ballafaqimi me disa dukuri metafizike.

Zbulimet e reja mbi genet e njeriut ka vënë në shesh të vërtetën se çdo njeri ka shifrën e vet të posaçme për personalitetin e vet të papërsëritshëm. Ky dhe zbulime të tjera të ngjashme janë shembuj të shkëlqyer në kohën tonë të artit hyjnor që i shtang mendjet. Ndërkaq, në fakt, muslimanët e njohin prej kohësh këtë dobësi të njeriut para mrekullive të artit hyjnor. Madje për muslimanët nuk është e panjohur se këto zbulime shkencore, afër kiametit, do të afrohen gjer në nivelin e mrekullive.



Ngaqë tasavvufi e shqyrton gjithësinë me qëllim për t'ia njohur të fshehtat, është e detyrueshme të pranohet se shkencat e natyrës të cilat, në finalen e të vërtetave fizike, vijnë ballë për ballë me specifika metafizike, janë të lidhura, në një farë mënyre, me tasavvufin.

Në fakt, Kur'ani tërheq shumë herë vëmendjen mbi të fshehtat dhe urtësitë në gjithësi. Në një ajet thuhet:

سُنُرِيهِمْ آيَاتِنَا فِي الْآفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ
أَنَّهُ الْحَقُّ أَوْلَمْ يُكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ

“Ne do t’u tregojmë njerëzve provat tona në horizonte dhe në botën e tyre të brendshme në mënyrë që të kuptohet qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A s’mjafton që Zoti yt është dëshmitar për gjithçka?” (el-Fussilet, 53)

Me fjalën “horizonte”, në ajet shënohet bota e jashtme që e rrethon njeriun, kurse me shprehjen “bota e tyre e brendshme”, bëhet fjalë për urtësitë, shembujt domethënës dhe të fshehtat në strukturën biologjike dhe shpirtërore të njeriut.

Për t’ua çelur sytë njerëzve, robve të tij, duke ua fshirë indiferentizmin, Zoti urdhëron kështu në Kur’an:

“O i Dërguar, ata që të kundërshtojnë ty) a nuk shëtiten fare mbi tokë? Sepse po të shëtisnin, gjithsesi do të kishin zemra që do t’u mendonin dhe veshë që do t’u dëgjonin. Por e vërteta është se nuk janë sytë që nuk shohin, por zemrat në gjokse!” (el-Haxh, 22)





“Ne nuk i krijuam qiejt dhe tokën dhe çka midis tyre vetëm për lojë e dëfrim. Ato i krijuam vetëm për një shkak të vërtetë. Por shumica e tyre nuk dinë!” (ed-Duhan, 38-39)

Në një ajet tjetër, Zoti e bën të ditur kështu se, si qeniet e tjera, edhe njerëzit i ka krijuar me një synim të caktuar:

أَفَحَسِبْتُمْ أَنَّمَا خَلَقْنَاكُمْ عَبَثًا وَأَنَّكُمْ إِلَيْنَا لَا تُرْجَعُونَ

“A mos pandehët se ju krijuam juve pa ndonjë kuptim dhe se nuk do t’ju kthejmë prapë tek Ne?” (el-Muminun, 115)

Nga mikrobota në makrobotë, në çdo molekulë janë të pranishme shfaqjet e mrekullueshme të artit hyjnor. Tasavvufi është një pikëpamje që siguron konceptimin tërësor dhe në një cilësi të përgjithshme të këtyre të vërtetave me qendër njeriun, si dhe një disiplinë praktike dhe teorike që, për sendërtimin e kësaj pikëpamjeje, e matoron njeriun me anë të stërvitjeve shpirtërore, si përmendja e Allahut (dhikrullah) dhe përkorësia.

Në ajetet e Kur’anit janë të pranishme deklarata që tërheqin vëmendjen mbi urtësitë e botës fizike dhe që, për t’i theksuar dhe përforcuar, i parashtrajnë këto urtësi me formën e pyetjeve. Megjithëse ka të bëjë me fushën e veprimtarisë së shkencave të natyrës, kjo cilësi parashtrimi nuk është e kufizuar vetëm me përkatësinë ndaj veçorive fizike të materies. Prandaj, për konceptimin e urtësisë, është nevoja e një fuqie tjetër veç kompetencës dhe mundësive të këtyre shkencave. Dhe kjo e bën të detyrueshme zhvillimin e aftësisë së posaçme të afeksionit me anë të stërvitjeve shpirtërore. Ja, pra, tasavvufi është një horizont i zgjedhur dhe përjashtimor që ia dhuron njeriut këtë mundësi dhe kompetencë.

Ashtu si Kur’ani dhe njeriu, edhe gjithësia është formuar me anë të sintezave të emrave hyjnorë. Në një vështrim, të gjitha shkencat e natyrës janë të ngarkuara me përgjegjësinë për të kërkuar urtësitë e zakonit hyjnor (adetullah) që është shfaqje e këtyre sintezave në gjithësi. Ndërkaq, në zbatimin e kësaj përgjegjësie, shkencat e natyrës janë të dënuara me një dobësi absolute. Vetëm se janë ata që, duke përparuar shpirtërisht, mund të zotërojnë një lloj receptorësh afektivë që në konceptimin e të fshehtave dhe të vërtetave, mund të arrijnë largësi më të mëdha se ato të arritura nga shkencat e natyrës. Ja, që nga këto pika, shkencat e natyrës me tasavvufin shkrihen dhe identifikohen





Tasavvufi është ai që e ka formuar, e ka zhvilluar dhe e ka pjekur letërsinë turke. (Nihad Sami Banarllë)



3. TASAVVUFI DHE LETERSIA

Tasavvufi që ka për fushë origjinale aktiviteti botën e zemrës, i ka reflektuar ndjenjat moralo-shpirtërore dhe internale, idetë dhe emocionet, brenda një stili dhe etike të caktuar, në vargje e strofa, pra, në fjalë.

Në historinë tonë të letërsisë, vlerat fetare-mistike janë reflektuar në mënyrë intensive në prodhimet letrare të thjeshta, të rrjedhshme, disa herë, lirike e, disa herë, didaktike, që e kanë treguar veten nën emërtimin “letërsi e teqes”. Llojet letrare si panegjirikët me temë tevhidin, besimin monoteist islam në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë, si dhe dashurinë dhe mallin e djegur për Profetin, kanë kryer një detyrë tejet të dobishme në mbështetjen dhe forcimin e botës moralo-shpirtërore të popullit, në qetësimin e zemrave të mjera e të lodhura, në largimin e tyre nga mëkati, kundërshtimi dhe indiferentizmi, në sendërtimin e afërsisë, dashurisë, vëllazërisë, paqes e qetësisë mes shoqërisë.

Poezitë e Junus Emresë të cilat kanë shtatë shekuj që jetojnë, nga pushtimet mongole, gjer në ditët e sotme, janë bërë njëri prej burimeve orientuese dhe ngushëlluese të popullit. Pra, mistikët, të cilët kanë dhënë vepra letrare të këtij lloji, kanë kryer shërbime të mëdha për bartjen e emocionit fetar në shtresat e gjera të popullit, në mbajtjen gjallë të vlerave moralo-shpirtërore. Ahmed Jesevi, Haxhi Bajram Veli, Eshrefogllu Rumi dhe Aziz Mahmud Hydaji janë më të shquarit prej këtyre.

Kurse letërsia e Divanit është formuar nga veprat e poetëve që kanë shkruar më shumë me metrikën prozodike dhe kanë tërhequr vëmendjen me stilin artistik. Edhe në këtë periudhë të letërsisë e cila njihet me emërtimin “letërsi e poezisë së Divanit” për shkak të mbisundimit të veprave poetike, megjithëse qe përdorur edhe proza, është dukur ndikimi i madh i





meditimit dhe thellësisë mistike. Me anë të shumë simboleve të ndodhura në thesarin e fjalëve, delikatesat mistike janë shprehur me një formë shprehëse të një kënaqësie të lartë dhe me një trajtë mjeshtërore.

Veçanërisht, në secilin prej llojeve letrare sundon shfaqja e një emociioni shpirtëror të veçantë, në lirikën fetare didaktike me temë tevhidin, monoteizmin islam, ndihen rrahjet e flatrave të një gjendjeje shpirtërore të hareshme drejt horizonteve hyjnore të pafundme. Posaçërisht lirikat didaktike fetare të shkruara nga poetët mistikë e bëjnë zemrën udhëtare të një qielli besimi krejt të veçantë.

Panegjirikët janë këngë të djegura të afërsisë dhe dashurisë pasionante të ndërë për profetin Muhammed (s.a.s.), të derdhura në vargje, janë tabllo intimiteti të pikturuara në zemrat. Ja se si shprehet malli dhe dëshira e gjerë e ndërë për Profetin në panegjirikon e Fuzuliu:

*Ta arrijë dheun ku i shkeli këmba, thotë një jetë pandërprerë,
Tek vrapon duke e përplasur kokën gur më gur uji i mjerë...*

Mevlana Xhelaledin Rumi, Fuzuli, Naili, Nabi, Nahifi, Shejh Galib e sa e sa poetë të tjerë u kanë dhënë blerim veprave të tyre në klimën e ndjenjave të ushqyer nga hareja mistike!



Të gjitha këto tregojnë se është një e vërtetë që thellësia ideo-emocionale dhe përmbajtja mistike i kanë përftuar letërsisë një pasuri dhe pjekuri të veçantë. Në arritjen të shtresat e gjera të popullit e poezisë dhe kënaqësisë letrare ka një ndikim të madh edhe fakti që janë ushqyer me një përmbajtje të tillë. Kështu, historiani i letërsisë Nihad Sami Banarllë e ka shprehur këtë të vërtetë me këto fjalë:

“Është tasavvufi që e ka formuar, zhvilluar dhe pjekur letërsinë turke!”

Gjithashtu, fakti që në periudhat kur kjo e vërtetë ndodhej në kulmet e saj, ka shkruar panegjirikë edhe Nedimi i njohur si poet i botës materiale, madje që një poet i tillë si Tevfik Fikret është bërë i njohur me lirika fetare didaktike, është reflektim kuptimplotë i kësaj të vërtete!





Nga ana tjetër, fakti që përdorimi i letërsisë, posaçërisht i poezisë për t'i bërë njerëzit të prirën ndaj një bote ideore dhe ndjesore të caktuar, është diçka për t'u vlerësuar, evidentohet edhe me hadithe profetike.

Hz. Aisheja (r. anha) e shpreh kështu rëndësinë që i ka dhënë Profeti (s.a.s.) kësaj fushe:

“Profeti porositi të ndërtohej në faltore një minber i veçantë për poetin Hasan bin Thabit. Poeti ngjitej në minber, në këtë katedër poetike, dhe u jepte përgjigje me poezi atyre që e satirizonin Profetin. Dhe Profeti thoshte kështu për të:

“Allahu i Lartë e mbështet Hasanin me anë të Shpirtit të Shenjtë kur ai e mbron të Dërguarin e Allahut!” (Tirmidhi, *Edeb*, 70; Ebu Davud, *Edeb*, 87)

Këtu, qenia e Xhebrailit bashkë me Hasanin që recitonte poezi, do të thotë që poetit në rrugën e të vërtetës t'i vijë frymëzim nga Allahu dhe që poeti të meritojë mbështetjen hyjnore!





Të brumosura me tasavvufin, domethënë, të ekzekutuara në klimën e ndjeshmërisë dhe thellësisë së zemrës, artet, siç është parë edhe në historinë tonë, janë bërë faktorë të sendërtimit të qytetërimeve!



4. TASAVVUFI DHE ARTET E BUKURA

Arti është reflektimi i thellësive dhe ndijimeve të zemrës në materie dhe konkretizimi i tyre në të. Të çfarëdo fushe që të jenë, të gjitha artet janë, në themel, një lloj shfaqjeje të meditimit dhe ndjeshmërisë në shpirtin e njeriut. Delikatesa dhe eleganca në art ndjek një ecuri paralele me thellësinë shpirtërore.

Të brumosura me mistikën, domethënë, të ekzekutuara në klimën e ndjeshmërisë dhe thellësisë së zemrës, artet, siç është parë edhe në historinë tonë, janë bërë faktorë të sendërtimit të qytetërimeve. Me të vërtetë, kombet e lartësuar në qytetërim kanë arritur një pozitë të zgjedhur jo vetëm në fusha të tilla, si politika, ekonomia dhe ushtria, por edhe në shkencë dhe art. Historia jonë është e mbushur plot me pasuri të këtij zhvillimi dhe përparimi. Meqë s'kemi as fuqi e as mundësi për t'i pohuar të gjitha motivet mistike të shfaqura në shumë fusha të arteve të bukura, këtu do të mjaftohemi vetëm duke i prekur shkurt zhvillimet e arritura nën ndikimin e mistikës në disa fusha.

a) Muzika

Islami është një fe e lartë që jo vetëm nuk i kundërshton dhe hedh poshtë veçoritë e pranishme në natyrën e njeriut, por i vë në rregull ato në trajtën më të përsosur. Si shumë arte të bukura, edhe muzika është njëra nga format e shfaqjeve të veçorive natyrore të njeriut. Është e natyrshme që ashtu si veçoritë e tjera, edhe kjo as nuk mund të hidhet poshtë tërësisht, as dhe nuk mund të pranohet tërësisht siç është.





Mistikët e kanë përdorur efektin e pamohueshëm të muzikës mbi njeriun brenda etikës dhe pjekurisë islame në shërbim të së mirës. Duke i caktuar muzikës një synim sublim, ata i kanë përfutur asaj përmbajtje dhe cilësi për ta bërë ushqim jo për frymën, por për shpirtin. Dhe, pastaj, muzikën në përshtatje me këtë përmbajtje dhe cilësi e kanë miratuar dhe nxitur, tjetrën, e kanë kundërshtuar dhe hedhur poshtë.

Ashtu siç ka nga ata që dalin krejtësisht kundër përdorimit të muzikës si një mjet edukimi moralo-shpirtëror, ka edhe nga ata që mbrojnë mendimin se mund të përdoret në mënyrë të kufizuar. Këta të dytët, ndërsa dalin kundër instrumentave me tela, e quajnë të lejueshme përdorimin e instrumentave që nxjerrin tinguj harmonikë me anë të goditjes. Këtë lejueshmëri ata e mbështesin në faktin se Profeti ka përdorur gjatë fushatave ushtarake instrumenta të tillë për të nxitur entuziazmin dhe ndjenjat luftarake e heroike të luftëtarëve muslimanë.

Ndërkaq, le të mjaftohemi duke thënë se është lejuar, brenda kriterëve ligjore-fetare, edhe zëri i bukur dhe harmonik, madje, kjo është parë si gjë e bukur dhe e mirë. Për këtë mjaftojnë të kujtojmë se është i njohur për të gjithë ndikimi tërheqës i zërit të bukur të muezinëve ose imamëve në adhurim. Gjithashtu, le të kujtojmë se në kohën e Profetit, kur diskutoheshin format dhe mënyrat që duheshin përdorur për t'i thirrur besimtarët në falje, Profeti miratoi propozimin e Abdullah bin Zejdit dhe Hz. Omerit (r.a.) të cilëve, në mënyrë të njëkohshme, u ishte frymëzuar në ëndërr ezani. Por, ndërsa i miratonte ata të dy, Profeti e ngarkonte me thirrjen e ezanit zezakun etiopian Bilal që kishte zë të bukur. Dhe nuk bëjmë gabim po të themi se fakti që Bilali e kreu këtë detyrë gjatë gjithë jetës, e kishte burimin të zëri i kulluar, i bukur dhe kumbues i Bilalit.

Natyrisht, ashtu siç është e pamundur të thuhet se, si mjetet e tjera, edhe muzika është e përshtatshme vetëm për të mirë, është një e vërtetë se edhe mohimi i plotë i muzikës duke u nisur nga fakti që veçanërisht në ditët tona po përdoret më shumë për nxitjen e ndjenjave sensuale e egoistike, nuk është i drejtë.

Njëri prej muridëve, nxënësve të Bahaeddin Nakshibendit, thotë kështu:

“Isha në shërbim të mësuesit Bahaeddin Nakshibendi dhe isha edhe një i pasionuar pas muzikës. Një ditë, bashkë me nxënës të tjerë të tij, vendosëm të gjejmë disa vegla muzikore dhe të ekzekutojmë pjesë muzikore në





një nga kuvendet e tij dhe të shohim se si do ta presë ai këtë e të mësojmë mendimet e tij mbi këtë. Dhe ashtu bëme. Mësuesi nuk na pengoi, ne u ramë veglave dhe pastaj mësuesi na tha:

“Ne nuk e bëjmë këtë, por as e mohojmë!”

Kjo thënie e Shah Nakshibendit (k.s.), aludon për domosdoshmërinë e sjelljes së kujdesshme në këtë fushë të përshtatshme e të mundshme për t’u shndërruar në sensualizëm. Me të vërtetë, sot vëzhgohet se disa mjedise, duke mos e ruajtur dot këtë ekuilibër, largohen nga thelbi i tasavvufit ose mistikës, për ç’shkak kuptohet më mirë se sa me rëndësi është ndjeshmëria në këtë çështje.

b) Arkitektura

Mes arteve të bukura, fusha që shquhet më shumë, është, pa dyshim, arkitektura e ndërtimit. Arkitektura është përgatitja e matematikës dhe gjeometrisë për një kënaqësi të lartë të sendërtuar me anë të ndjenjave të zemrës. E shprehur ndryshe, arkitektura është materializimi dhe personifikimi i kapaciteteve mendore dhe shpirtërore me anë të materialeve të përbashkëta si guri dhe druri!

Dihet se tasavvufi i ka përfutur arkitekturës shumë vlera. Për shembull, po të shqyrtohet xhamia Sulejmanie dhe kompleksi i saj me anë të thellësisë së tasavvufit, do të shihet tejet qartë se aty është reflektuar shpirti islam, se është shprehur figurativisht bota shpirtërore me një shkëlqim syverbues dhe se disa motive mistike janë simbolizuar me një stil mjeshtëror. Për shembull, kubesë qendrore dhe mjedisit përreth saj i është dhënë një formë e tillë që ndërtesa lartësohet gradualisht nga baza e sipër duke përfunduar madhërisht te “Njëshi”. Ndërkaq, harmonia e kubesë qendrore me gjysmëkubetë dhe të tjerat është shprehje madhështore dhe e shkëlqyer e enigmës mistike:

“Shumëllojshmëri dhe hollësi në unitet, unitet në shumëllojshmëri dhe hollësi!”

Me të vërtetë, Sulejmania është një varg idesh dhe delikatesash me bukuri përjashtimore që simbolizojnë arritjen nga shumë hollësi, tek një “njësh unik”, domethënë, te Allahu, pastaj, kthimin nga “Njëshi” te hollësitë!

Veçanërisht kubeja e madhe simbolizon Profetin (s.a.s.). Me detyrën e saj për ta kthyer prapë te besimtarët jehonën e këndimit të Kur’anit dhe lutjeve, kubeja e madhe përfaqëson kumtimin nga Profeti për tek besimtarët të urdhrave të marra nga Zoti i Lartë.





Në këtë monument të pashoq ku janë bashkuar zelli, përpjekja dhe konsekuenca mbinjerëzore me gjenialitetin, qetësia dhe fisnikëria janë shprehur me një figuracion të përsosur dhe ka dalë në shesh një siluetë tejet harmonike. Me minaretë që lartësohen drejt qiellit, xhamia Sulejmanie qëndron me duart të ngritura lart duke iu lutur Zotit!

Nga ana tjetër, edhe veprat e tjera arkitektonike si teqet, tyrbet, komplekset arsimore e të shërbimeve njerëzore të tjera kanë krijuar fytyrën tipike të vendbanimeve islame. Shumë vepra të tilla të mëdha e të vogla janë ndërtuar me një arkitekturë ku reflektohen thjeshtësia, modestia, përkohshmëria e kësaj jete, të ekzekutuar me një trajtë në përshtatje me etikën dhe specialitetin mistik. Edhe këto vepra janë plot me shfaqje ideore e shpirtërore të mishëruara në materiale inerte.

c) Bukurshkrimi i Kur'anit

Husni hat ose bukurshkrimi i Kur'anit është shkrimi i shkronjave të tekstit të Kur'anit në formë të bukur dhe me art duke u mbetur besnik përmasave estetike të tyre. Pra, bukurshkrimi i Kur'anit është një art krejt i veçantë dhe i zgjedhur, i lindur nga zelli dhe përpjekjet për ta shkruar atë me një bukuri të denjë për të.

Gjatë gjithë historisë, teqet dhe selitë mistike kanë luajtur një rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin e artit të bukurshkrimit të Kur'anit. Arti i bukurshkrimit të Kur'anit ka gjetur vazhdimisht mbrojtje dhe nxitje nga mjediset mistike që janë bërë çerdhe arsimit dhe edukimi ku janë përgatitur shumë mjeshtër të këtij arti dhe ku mjeshtër, pastaj, kanë përgatitur nxënësit e tyre. Arti i bukurshkrimit kërkon, veç mjeshtërisë, edhe një zemër të pastër. Për të arritur përsosmërinë në këtë art, kërkohet durim dhe nënshtrim i madh, kërkohet edhe një mjeshtër udhëheqës i përkryer. Nisur nga të gjitha këto veçanti, arti i bukurshkrimit të Kur'anit paraqet përbashkësi me tasavvufin ose mistikën.

Për shembull, po qe se një person me sjellje të trasha dhe nevrastenik, bën një vijë, ajo vijë të kujton dhëmbët e sharrës, sepse shpirti i tij është i vuajtur. Qëllimi i tasavvufit është t'i paqëtojë egot dhe, duke e shpëtuar shpirtin nga mundimi që i shkakton egoja, t'i përftojë atij delikatesë, ndjeshmëri dhe qetësi. Sepse bukurshkrimi i Kur'anit nuk është vetëm arti i shkrimit; në të njëjtën kohë, është një disiplinë që u përfiton delikatesë shpirttrave dhe i ushqen zemrat me ndjenja të larta.





Me të vërtetë, mbështetja shpirtërore gjithmonë ka përgatitur truall për përgatitjen e gjenive në art. Mjeshtrat me emër në artin e bukurshkrimit të Kur'anit, Shejh Hamdullah, Karahisariu, Jesarizade, Mustafa Rakim e shumë të tjerë janë personalitete të përgatitur duke u maturuar me edukatën shpirtërore të mjedisëve mistike.

Sa domethënës është ky shembull që tregon thellësinë shpirtërore dhe vetëmohimin e artistëve të brumosur me harenë mistike:

Detyra e shkrimit të kubesë së xhamisë Sulejmanie i qe dhënë kaligrafit Karahisari. Karahisari iu vu punës me një zell të jashtëzakonshëm për ta plotësuar shkrimin në atë mënyrë siç i kishte hije madhështisë dhe shkëlqimit të xhamisë. Ai punoi dhe u lodh aq shumë, sa, në çastin kur bëri vijën e fundit, iu shua edhe drita e syve, kështu, për të u mbyll dritarja nga e cila shihte botën.

Kur përfundoi ndërtimi i plotë i xhamisë dhe do të hapej për falje, sultan Sulejmani, i mbiquajturi Kanuniu, Ligjvënësi, tha kështu:

“Nderi për hapjen e kësaj xhamie të nderuar i takon atij që e ka ngritur në mënyrë kaq madhështore e të shkëlqyer, kryearkitektit tonë, Sinan!”

Arkitekti Sinan i cili e pati filluar mësimin e këtij arti me mësimin e sjelljes së thjeshtë, duke treguar se ishte i pashoq sa në art, aq edhe në shpirt, mendoi në atë çast sakrificën e kaligrafit Karahisari dhe iu përgjigj me edukatë të thellë fjalëve të sulltanit kështu:

“Sundimtari im! Duke e zbukuruar dhe stolisur këtë xhami të nderuar me shkrimin e tij, kaligrafi Karahisari sakrifikoi dritën e syve. Faljani atij këtë nder!”

Atëherë, mes lotëve të syve të të pranishmëve, Ligjvënësi dekretoi që xhamia Sulejmanie të hapej për falje nga mjeshtri Karahisari!

Ky art i begatshëm në shërbimin e tij si rrjedhojë e një mendësie plot principialitet dhe sinqeritet, gjatë gjithë shekujve u është mësuar nxënësve pa pagesë. Në mes nuk qe futur interesi material dhe çdo artist kaligraf e pati konsideruar shërbimin për t’ua mësuar të tjerëve këtë art pa pagesë, si zeqat të artit të vet!



Si përfundim, nuk mund të mendohet që besimtari i cili e kupton thellë porosinë profetike që thotë se “... Allahu është i bukur dhe e pëlqen të bukurën...” (Muslim, *Iman*, 147) dhe arrin të përfitojë prej saj, të mos ndjejë interes për të bukurën.





Në kuadrin e kësaj ideje, është krejt e natyrshme që njeriu të kërkojë t'i shprehë bukuritë e tij të brendshme në nivelin e vlerave estetike, me kusht që të mos bjerë në krenari dhe mendjemadhësi dhe që t'i mbetet besnik thelbit të fesë. Nisur nga kjo, të gjitha artet e bukura të çdo fushe, në përshtatje me etikën islame, vazhdimisht janë mbrojtur dhe nxitur nga mjediset mistike. Edhe shumë arte të bukura të takuara me mistikën në thellësitë e botës ndjesore të brendshme, në sajë të disa vlerave mistike të bartura në motivet e veta, ka arritur në një kënaqësi estetike dhe pasuri përmbajtjeje më të lartë.





Pa jetën ndjesore dhe ndijimet e saj moralo-shpirtërore, nuk mund të kalohet në botën e të vërtetave të pafundme vetëm me anë të arsyes!



5. TASAVVUFI DHE FILOZOFIA

Duke i shqyrtuar një nga një qeniet dhe dukuritë, shkencat e natyrës përpiqen që veçantitë e tyre t'i shprehin në formën e rregullave të përgjithshme që dihet se quhen "ligjet e natyrës". Kurse shkenca e meditimit njerëzor e cila përpiket të bëjë përgjithësimin ideor dhe metodologjik të ligjeve të natyrës dhe shoqërisë, quhet filozofi. Prandaj, filozofia quhet edhe *shkenca e shkencave*.

Mjeti i vetëm që përdor filozofia me qëllim për të arritur tek e vërteta, është mendja (arsyeja). Në çdo shkollë filozofike, arsyeja, edhe pse nuk ngrihet pothuajse në pozitën e një zoti, siç ndodh në racionalizëm që është, në fund të fundit, një degë e filozofisë, prapëseprapë pranohet si mjeti i vetëm ku mbështeten filozofët në kërkimet e tyre mbi të vërtetën.

Islami e konsideron arsyen si njërin prej kushteve minimale të përgjegjesisë. Ndërkaq, meqë Islami e pranon pamjaftueshmërinë e arsyes në arritjen e të vërtetave, në krahasim me filozofinë e cila konsiderohet racionale, pra, e mbështetur vetëm në arsyen, merr për bazë, në të njëjtën kohë, edhe *përcjelljen* (nakl). Edhe tasavvufi ose mistika islame që është, në Islam, një kërkim botëkuptimi dhe përkryerjeje, megjithëse vrapon pas një sërë të vërtetash metafizike, e realizon veprimtarinë e vet ideore që mbështetet gjer në kufirin e *zbulimit* (keshf), në vartësi të *dogmës* (nass), pra, të teksteve të shenjta me burim hyjnor ose (dhe) profetik, që përbëjnë atë që quhet, si më sipër, *përcjellje* (nakl), e cila ka karakter aprioristik. Kështu, fakti që idetë dhe mendimet mistike themelore u rrinë besnikë bazave të caktuara kanonike (juridiko-fetare), kërkon pranimin e faktit se veprimtaria ideore





mistike është edhe aprioristike. Megjithëse arsyeja përdoret për kompetencën mbi urtësinë e dogmës, veprimtaria e saj e pavarur nuk shihet e lejueshme (xhaiz) në përcaktimin e konkluzioneve islamike. Është për këtë arsye që në Islam, arsyeja duhet të edukohet me anë të vahjit ose zbulesës hyjnore dhe, kështu, të kufizohet në kompetencë, në mënyrë që të sigurojë një dobi të përkryer. Kështu, rruga ku ecet, vështrimi si të lejueshme (xhaiz) ose pranimi i të vërtetave të konsumuara në kufirin e zbulimit dhe të arritura në vartësi të veprimtarive ndjesore, nuk e bëjnë të detyrueshme pranimin (miratimin) e përgjithshëm. Për ta shprehur këtë të vërtetë, është thënë:

“Zbulimi mistik është argument vetëm për kompetentin e zbulimit mistik, jo dhe për të tjerët!”

Megjithëkëtë, në pikën ku fuqia dhe kompetenca e arsyes konsumohet krejtësisht, meqë nuk mund të pretendohet që e vërteta të arrijë në fundin e saj, prirja për të arritur tek të vërtetat që, duke nisur nga kjo pikë, zgjaten varg drejt pafundësisë, nuk mund të eliminohet. Sepse kjo prirje është e natyrshme, është pjesë e krijimit ose e bashkëlindur. Është si rrjedhojë e kësaj që, si në fe, ashtu dhe në meditimet jashtëfetare, nuk është mbajtur qëndrim indiferent ndaj kësaj pjese të të vërtetave. Dihet nga të gjithë se mendimet filozofike mbi çështjet metafizike përbën një kompleks tej të madh. Mirëpo, meqë filozofët kanë përdorur vetëm arsyen, nuk kanë shpëtuar dot prej kontradiktave dhe çdo filozof i dalë në shesh e ka filluar punën me kritikën, kundërshtimin dhe hedhjen poshtë të paraardhësve. Edhe nëse në këtë fenomen ekziston roli i mbajtjes në plan të parë të ndjenjës së egoizmit dhe pretendimeve egoistike, shkaku i vërtetë dhe esencial është veçoria e arsyes si e paçliruar dot prej kontradiktave.



Me të vërtetë, arsyeja është si një thikë me dy presa. E shtyn njeriun edhe në terror, edhe në punë të mira. Pa ndihmën e arsyes nuk mund të arrihet te “krijesa e përkryer” (ahseni takvim), por është gjithashtu arsyeja ajo që shpesh e rrëzon njeriun në një nivel më poshtë se kafshët për sa i përket njohjes. Prandaj duhet që arsyeja të mbahet nën disiplinë. Dhe kjo disiplinë është edukimi që bën vahji ose zbulesa hyjnore. Po që se arsyeja ndodhet nën kontrollin e zbulesës hyjnore, e çon njeriun në paqe dhe shpëtim. Përkundrazi, po që se nxirret jashtë zbulesës hyjnore, e çon njeriun në fatkeqësi dhe shkatërrim. Prandaj duhet që arsyeja të orientohet kah pëlqimi hyjnor.





Gjatë gjithë historisë, shumë mizorë që kanë pasë arritur kulme në arsye, nuk kanë ndërë as dhe vrasjen më të vogël të ndërgjegjes për bëmat e veta. Sepse dhuna dhe mizoritë që kanë kryer, kanë qenë, sipas arsyes së tyre, veprimet më të arsyeshme. Hulagu që pati hyrë në Bagdad dhe pati mbytur në ujrat e Tigris 400 mijë të pafajshëm, nuk pati ndërë asnjë vrasje ndërgjegjeje. Ose në periudhën e Mekës paraislamike, zotëria mund ta vriste skllavin pa ndërë kurrë mundim ndërgjegjeje, pa ndërë as pendimin më të vogël. Për arsyen e tyre, prerja e një druri me prerjen e kokës së një skllavi ishin e njëjta gjë. Për më tepër, vrasjen e skllavit, zotërinjtë ose, me një fjalë tjetër, skllavopronarët, e shihnin si të drejtën e tyre të natyrshme dhe legjitime. Ja, pra, edhe tek ata njerëz kishte arsye, por, meqë ishte jashtë edukimit dhe kontrollit të vahjit ose zbulesës hyjnore, arsyeja e tyre e bënte njeriun pervers, e shtynte në krime të panumërta dhe këtë e tregonte si diçka krejt normale. Një arsye si kjo i kishte verbuar ndërgjegjet, ishte bërë perde penguese para ndjenjave të mëshirës, keqardhjes dhe dhembshurisë!

Meqë filozofët kanë tentuar ta shpjegojnë çdo gjë me anë të arsyes, as veten nuk e kanë vënë dot në rrugë të drejtë, as dhe popujt. Fundja, po qe se arsyeja do të ishte në gjendje t'i zgjidhte të gjitha, nuk do të kishte nevojë për profetët, udhërrëfyesit, treguesit e udhës së drejtë. Prandaj arsyeja ka nevojë për udhëheqjen e vahjit ose zbulesës hyjnore.

Disa filozofë që e kanë dalluar këtë të vërtetë, bashkë me pohimin e dobësisë së arsyes, janë vënë të kërkojnë mjete të tjera për gjetjen e të vërtetës. Një ndër këta, filozofi francez Henri Bergson (1859-1941), e ka pranuar intuitën si një mjet për të arritur te e vërteta. Pavarësisht se edhe intuita nuk është e tillë siç e ka vlerësuar ai apo ndonjë tjetër, shumica dërrmuese e filozofëve nuk pranojnë mjet tjetër veç arsyes për të arritur te e vërteta dhe e kalojnë kohën duke e hedhur poshtë njëri-tjetrin. Në ndryshim krejt të kundërt me ta, profetët dhe ndjekësit e tyre, me anë të njohjes së të vërtetës me rrugën e zbulesës dhe frymëzimit, kanë ardhur duke e mbështetur njëri-tjetrin!

Mendimtari i madh islam, imam Gazaliu (r. alejh), thotë kështu:

“Pasi i dhashë fund punës intensive mbi këtë çështje pas fazave të analizës, kritikës dhe njohjes filozofike, duke u nisur nga synimi im, e kuptova se edhe kjo shkencë është e pamjaftueshme, se arsyeja është e papërshtatshme për ta rrokur dhe kuptuar çdo gjë e vetme, se ajo s’ka për ta ngritur dot perden e fshehtësisë së lëshuar para çdo gjëje!”





Situatën e Gazaliut mes fushave të arsyes dhe intuitës shpirtërore, Nexhip Fazëll Kësakyrek e tregon kështu në një vepër të vetën:

“Ky burrë i madh i mendimit që përmendet si “dokument i Islamit”, kur i la mënjatë tërë punët e mendjes dhe arsyes dhe u drejtua kah intuita e vërtetë shpirtërore, tha kështu: “... dhe pashë se e vërteta është mbështetje në begatinë shpirtërore të Profetit të Profetëve, kurse çdo gjë tjetër është vetëm gënjeshtër, fantazi dhe iluzion. Kurse arsyeja, vetëm kufi!..”

Dhe kjo kokë e madhe dhe e pashoqe, duke i shuar të gjitha pyetjet, u mbështet dhe u strehua në begatinë shpirtërore të Profetit të Profetëve dhe e gjeti të pakufishmen!” (nga *Veliler Ordusu*, f. 213)

Me të vërtetë, me një arsye në vetvete të kufizuar mund të shkohet gjer në një pikë. Mirë, po mos vallë e gjithë e vërteta është identiteti i përmbajtjes brenda këtyre kufijve? A nuk ka më të vërtetë përtej kufijve të arsyes? Ja, pra, përgjigjja ngopëse për pyetje si kjo mund të gjendet në botën ndjesore të tasavvufit ose mistikës, e cila është, posi filozofia, një meditim përtej lëndës dhe materies, por që ndahet nga filozofia sepse ushqehet nga burimi i vahjit ose zbulesës hyjnore.

Është Allahu i Lartë që e ka krijuar njeriun dhe që i njuh më mirë veçoritë e njeriut. Prandaj, në rrugën për tek e vërteta, arsyeja ka nevojë absolute për të ecur nën dritën e kumtimit hyjnor. Kurse hyrja në veprim e rrugës së zemrës dhe zbulimit mistik në pikën gjer ku mund të arrijë arsyeja, për të shkuar më tutje, është e domosdoshme dhe e pashmangshme. Nuk mund të kalohet në botën e të vërtetave të amshuara vetëm me anë të arsyes, pa jetën e zemrës, pa ndijimet dhe ndjenjat e saj!





Të dish dhe të njohësh s'do të thotë të vëzhgosh, por të zgjidhësh kuptimin, urtësinë dhe të fshehtën!



G. DIJA E DOBISHME (Ilmi nafî)

Konkretizimi dhe personifikimi i dijes për të hedhur rrënjë në thellësi të një njohjeje të pastër e të shëndoshë, quhet **irfan** (kulturë). Kurse **arif**-i është personi që zotëron të fshehtat, urtësitë dhe shfaqjet hyjnore në esencën e dijeve që zotëron, pra, personi që zotëron irfan.²³ Për personat që nuk e kanë arritur këtë pjekuri, thuhet: “*Eshtë alim* (dijetar), por jo *arif* (i kulturuar)!” Dijet e njerëzve të tillë janë të fiksuara e të mbyllura si dijet e librave. Kjo gjendje i ngjason krejt farës në hambar. Ajo farë mbin dhe zhvillohet vetëm nëse hidhet në tokë dhe gjen aty lagështirë dhe dritë. Në të kundërt, dije të tilla si fara e mbyllur në hambar nuk mund të arrijnë suksesin për të prodhuar ide dhe, duke zbritur nga mendja në zemër, për t’i thelluar ndjenjat. Prandaj këtyre dijeve u thuhet **dije librore**.

Eshtë jashtë çdo dyshimi se, kur çdo dije ose dituri përdoret me vend dhe drejt, mund të sigurojë dobi. Vetëm se marrja e diturive vetëm formalisht është e pamjaftueshme për shpëtimin dhe lumturinë e njeriut në të

23 Edhe në konceptualitetin tonë sekularist ekziston një cilësim dhe dallim i tillë. Për njeriun që di, por që dituria nuk është bërë natyrë e tij, themi pak a shumë kështu: “Eshtë dijetar, por jo i kulturuar!” Kurse për njeriun tek i cili dijet, dituria janë bërë natyrë e dytë e tij ose ia kanë ndryshuar natyrën, themi se “është i kulturuar” duke dashur të nxjerrim në pah për të pikërisht këtë veçori dhe cilësi. Përgjithësisht, kur për dikë themi se “është i kulturuar”, nënkuptojmë edhe se “është i ditur”, kurse kur për dikë themi se “është i ditur”, nuk nënkuptojmë edhe se “është i kulturuar”. Ndërkaq, në konceptualitetin e tasavvufit ose mistikës islame, dija dhe kultura janë shumë më të gjera se në konceptualitetin sekularist ose materialist-pozitiv. Kështu, siç kuptohet qoftë edhe nga shpjegimi i shkurtër si më sipër, koncepti irfan shpreh, krahas kulturës së përgjithshme materiale, edhe (ose kryesisht) kulturën shpirtërore, prandaj arifi është dijetari i kulturuar, i pajisur edhe me kulturë shpirtërore. Si konkluzion, dija ose dituria e dobishme që është tema e kësaj pjese, është dija ose dituria e kthyer në kulturë, posaçërisht në kulturë shpirtërore. (Shënim i përkthyesit)





dy botët. Pikërisht për kompensimin e kësaj të mete, Islami e ka stolisur jetën ndjesore me **dijen e dobishme** (ilmi nafi) me synimin për t'i përdorur dijet, dituritë dhe shkencat drejt dhe në vende të dobishme, si dhe për të penguar që ato të bëhen mjet i së keqes.



Me të vërtetë, pjekuria ndjesore e arritur në përfundim të edukimit moralo-shpirtëror, e bart njohjen njerëzore në një horizont mbi dijen formale dhe kësaj dukurie i thuhet **marifet**, që mund të përftohet vetëm në sajë të disa ushtrimeve dhe praktikave mistike.²⁴ Kur njeriu arrin këtë horizont pikëpamjeje, sado dijetar i madh që të jetë, e kupton dobësinë e vet dhe shpëton nga sëmundja e krenarisë për diturinë e vet.

Sa bukur e tregon Mevlana Xhelaleddin Rumi rendësinë e përfutimit të dijes së quajtur marifetullah, të nevojshme për lumturinë e përjetshme të njeriut, si dhe fundin e hidhur të atyre që mbeten indiferentë ndaj kësaj.

Një gjuhëtar kishte hipur në një gjemi. Gjatë udhëtimit, u vu të bisedojë me gjemixhiun duke u mbajtur më të madh dhe krenar për diturinë e tij. Herë pas here i bëri pyetje gjemixhiut dhe, pasi mori përgjigjen “nuk e di” prej tij, e ironizoi duke i thënë me krenari për veten:

“Sa keq! Për shkak të injorancës, e paske çuar kot gjysmën e jetës!”

Edhe pse gjemixhiut iu thye zemra e pastër nga kjo sjellje zemërthyesë e gjuhëtarit, u tregua i matur dhe nuk iu përgjigj, vetëm heshti. Ndërkaq, doli një furtunë e fortë që e zvarriti gjeminë mes një vorbulle të tmerrshme. Në ato çaste kur secili mendonte si të shpëtonte, gjemixhiu iu kthye gjuhëtarit:

“O mjeshtër, a di të notosh?”

I zverdhur, i mbledhur shuk dhe me një zë të dridhur nga frika e vdekjes, gjuhëtarit iu përgjigj:

“Jo, nuk di!”

Me një shikim të dëshpëruar, gjemixhiu iu drejtua, tashmë, me këto fjalë qortuese gjuhëtarit:

“Mua më kishte shkuar kot gjysma e jetës ngaqë s’kam ditur gjë nga gramatika, kurse tani jeta jote do të shkojë e gjitha kot ngaqë s’di të notosh! O mjeshtër i gjuhës! A nuk e ke ditur se në këtë det, shkenca e notit është më e dobishme e më e domosdoshme se shkenca e gjuhësisë?”

²⁴ Koncepti marifet është njohja intuitive e Zotit, për të cilën, siç do të haset më poshtë, në mistikën islame përdoret fjala marifetullah. Ndërkaq, duhet sqaruar se këtu kemi të bëjmë jo me intuitën e psikologjisë materialiste, por me intuitën mistike e metafizike. (Shënim i Përkthyesit)





Në këtë tregim, shkencë e gjuhësisë përfaqëson dijet materiale dhe formale, kurse njohja e notit, dijen që i përgjigjet nevojës. Nevoja më e madhe e njeriut është sigurimi i lumturisë së përjetshme jo vetëm për trupin, por edhe për shpirtin. Dhe kjo varet nga fitimi i pëlqimit të Allahut. Pëlqimi i Allahut arrihet, bashkë me besimin e përkryer, edhe me punë të mira.

Duke u kthyer te simbolika e tregimit, duhet thënë se, para se të vijë mbytja, duhet mësuar noti, domethënë, para se të vijë vdekja, të gjitha dijet dhe njohuritë duhen shndërruar në një cilësi të tillë që të ndihmojnë për të merituar pëlqimin e Allahut. Prandaj është dhënë porosia:

مُوتُوا قَبْلَ أَنْ تَمُوتُوا

“Vdisni para se të vdisni!” Kjo do të thotë se duhet të bëjmë përpjekje për t’i rrëzuar në nivelin më të ulët prirjet sensuale dhe egoistike të botës sonë të brendshme. Prandaj nuk duhet ta harrojmë edhe paralajmërimin:

حَاسِبُوا قَبْلَ أَنْ تُحَاسَبُوا

“Para se të merreni në llogari në gjykatën hyjnore, kërkojini llogari vetes!”



Siç rrëfëhet, një dijetar tregon kështu:

“E pashë imam Gazaliun mes një kuvendi në fytyrat e pjesëmarrësve të të cilit shquheshin qartë bukuria dhe mirësia. Gazaliu kishte mbi trup një rrobë të arrnuar dhe në dorë, një ibrik. I thashë:

“O imam! A mos ishte detyra e kryemuderrisit në medresenë Nizamije të Bagdatit më e mirë se kjo?”

Më pa thellë e thellë e më tha:

“Bëra kështu ngaqë me të lindur hëna e plotë në qiellin e vullnetit, dielli i mendjes më tregoi rrugën e bashkimit (me Zotin)!” (Muhammed b. Abdullah el-Hani, *Adab*, f. 9)

Është për këtë arsye që dija më me efekt që i jep mundësi njeriut të arrijë shpëtimin dhe lumturinë në këtë botë dhe në jetën e pasme (ahiret), është njohja me zemër e Allahut në mënyrën më të bukur dhe, me anë të përgjegjësisë së arsyes, ndërgjegjes dhe zemrës të lindur nga kjo dije, kryerja e punëve të mira në nivelin më të përsosur.





Sa bukur që thotë poeti Junus Emre:
*Qëllimi për të mësuar dituri
Është që njeriu ta njohë të Vërtetën;
Sepse kur s'e di pse di,
Do të thotë ta çosh kot jetën!*

Prandaj, çdo njeri, ndërsa preokupohet me dituri dhe shkenca të ndryshme për të arritur sukses në punët e kësaj bote e të tjetrës, për rrjedhojë, për të bërë përparim materialo-shpirtëror, para së gjithash ka nevojë për ndriçimin e dijeve të dobishme dhe thellësinë e zemrës.

Me të vërtetë, dija që e shtyn njeriun në krenari dhe mendjemadhësi dhe, më në fund, e mbyt në vorbullën e shkatërrimit, edhe sikur të përbëhet formalisht prej gjërash të bukura e të dobishme, ç'mund të jetë në të vërtetë gjë tjetër veç mundimit? Është për këtë arsye që i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i është drejtuar Zotit vazhdimisht me lutje në këtë drejtim, duke u shprehur:

"O Zot! Kërkoj nga Ti dije të dobishme dhe mbështetem tek Ti nga dija e padobishme!" (Muslim, Dhikr, 73)

Në kornizën e këtij kuptimi, dija e dobishme që mund të quhet esencë e shkencës së tasavvufit, është përpjekja për ta pajisur dhe stolisur njeriun me adhurim, devocion dhe mirësi. Dija ose dituria e atyre që janë bërë të tillë, do të thotë se, tashmë, është bërë marifet.

Zoti ka urdhëruar kështu në Kur'an:

"(O i Dërguar!) Thuaj: Zoti im, ma shto diturinë!.." (Taha, 114)

Ky shtim është që ndjenjat e devocionit dhe frikës të njeriut, robit të Zotit, të fitojnë nivel. Sepse, siç urdhërohet po në Kur'an,

إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ

"... Nga robtë, vetëm të diturit frikësohen nga Allahu (ashtu siç duhet)..." (Fatir, 28)

Edhe Profeti (s.a.s.) ka thënë:

"Mes jush, unë jam ai që ruhet më shumë nga Allahu dhe që e njeh më mirë Atë!" (Buhari, Iman, 13; Edeb, 72)

Çdo grimcë në gjithësi dhe çdo çast na jep neve një lajm të freskët dhe një përhëndetje nga hareja hyjnore. A nuk është çdo gjë, nga buzëqeshja e fëmijës në djep tek rrahja e krahëve të një fluturë, nga kënga e bilbilit te





vallja e ngjyrave të pranverës, shfaqje mijrallojëshe të haresë hyjnore? Ja, pra, dukja më e shkëlqyer e dijes së dobishme është ta lexosh librin e gjithësisë me syrin e zemrës. Është të arrish ta kuptosh se gjithësia përbëhet prej urtësive, shembujve domethënës dhe shfaqjeve hyjnore. Zoti thotë kështu në Kur'an:

“Ne nuk i krijuam qiejt, tokën dhe gjithçka ndodhet mes tyre për lojë dhe dëfrim!” (ed-Duhan, 38)

“A mos pandehët ju se ju krijuam kot dhe se me të vërtetë nuk do t’ju kthejmë tek Ne?” (el-Mu’minun, 115)

Një thesar tjetër të fshehtash ku ekspozohet arti hyjnor, është trupi i njeriut. Mjeku që e zbulon këtë thesar dhe e kthen dijen e vet në të dobishme, me admirimin e thellë që ka për të ndjerë përballë fuqisë hyjnore, do të arrijë virtytin për ta parë dhe trajtuar të sëmurin e vet me modesti, dhembshuri dhe respekt për hir të Krijuesit.

Nga ana tjetër, njeriu që nuk e arrin dot këtë horizont, edhe sikur të ndodhet në kulm të pozitave diturore dhe materiale, përsëri është i paplotësuar, sepse vlera e një diturie matet me pjekurinë e ndjenjave dhe përsosmërinë morale që do të ishin të dobishme në këtë botë dhe në jetën e pasme, ahiret!

Siç kuptohet nga këto të gjitha, rruga e dijes së dobishme kalon nga shtresimi në zemër i disa cilësive moralo-shpirtërore. Pra, është e domosdoshme që nefs (vetvetja, egoja) të pastrohet nga të gjitha cilësitë e këqija, si dyfytirësia, mendjemadhësia, pangopësia, vetëkënaqësia, etj., dhe, në përfundim të kësaj, zemra të pajiset me moralin muhammedan, cilësitë e të cilit janë devocioni, përsheptshmëria, mëshira, durimi, falenderimi, thjeshtësia, kënaqja me atë që ke, dorëzimi dhe nënshtrimi te Zoti.



Klimën dhe kornizën ku bleron dija e dobishme, imam Rabbaniu e përshkruan kështu:

“O vëllai im i fesë! Gjëja që na duhet të gjithëve para së gjithash, është ta rregullojmë besimin dhe bindjen sipas Librit dhe Sunnetit. Ata që sajojnë gjëra sipas mendjes së vet dhe ata që janë shmangur nga rruga e drejtë, pandehin se mendimet dhe bindjet e tyre janë në përshtatje me Librin dhe Sunnetin. Por bindjet e tyre janë larg e më larg prej të drejtës dhe të vërtetës!”

Edhe pas kësaj duhet t’i njohim mirë konkluzionet dhe urdhrat e fesë, hallallin dhe haramin, farzet, vaxhibet dhe sunnetet dhe t’i zbatojmë ato





në formën e punëve të mira. Vetëm se për realizimin e të gjitha këtyre në kuptim të plotë, është e domosdoshme pastrimi i vetes dhe purifikimi i zemrës. Sepse po qe se bindja s'është e drejtë, njohja e konkluzioneve dhe urdhrave fetare s'ka asnjë dobi; po qe se konkluzionet dhe urdhrat fetare s'njihen, kryerja e adhurimeve dhe e punëve të mira s'ka asnjë dobi; po qe se nuk kryhen adhurimet dhe punët e mira, pastrimi i vetes dhe purifikimi i zemrës s'kanë asnjë dobi dhe, më në fund, po qe se nuk kryhen pastrimi i vetes dhe purifikimi i zemrës, besimi, bindja, adhurimi, puna e mirë dhe dituria s'kanë asnjë dobi...

Ja, pra, dija dhe sjelljet që do të blerojnë në truallin e formuar prej këtyre parimeve themelore, duke hyrë në kornizën e dijës së dobishme, do të fitojnë natyrën dhe cilësinë e marifetit, njohjes intuitive të Zotit.

Zoti ynë! Të lutemi të na ushqesh gjithmonë me dije të dobishme dhe mbështetemi tek Ti nga çdo lloj dijeje që s'ka dobi! Bëna ne nga ata që veprojnë me dije! Dhe na bëj nga ata fatmirë që, duke e kthyer dijen e tyre në kulturë, ngjiten në qiejt e njohjes intuitive të Zotit dhe, kështu, bëhen konfidentë të miraxhit Tënd!

Amin, ashtu qoftë!





PJESA E DYTE

EDUKIMI MISTIK (Udha dhe udhëtimi mistik)

A. NEFSI DHE PASTRIMI I TIJ

1. Natyra e nefsit
2. Pastrimi i nefsit (tezkije)
3. Gradët e nefsit
 - a) *Nefsu'l-Emmare (nefsi urdhërues, imponues)*
 - b) *Nefsu'l-levvame (nefsi pendestar)*
 - c) *Nefsu'l-mulheme (nefsi i frymëzuar)*
 - d) *Nefsu'l-mutmainne (nefsi i ngopur e i kënaqur)*
 - e) *Nefsur-radije (nefsi në pajtim me Zotin)*
 - f) *Nefsu'l-merdiije (Zoti në pajtim me nefsën)*
 - g) *Nefsu'l-kamile (nefsi i përsosur)*

B. ZEMRA DHE KULLIMI I SAJ


1. Natyra e zemrës
2. Llojet e zemrës
3. Purifikimi i zemrës (tasfije)
 - a) *Ushqimi hallall*
 - b) *Pendimi dhe lutja*
 - c) *Këndimi i Kur'anit dhe ndjekja e konkluzioneve të tij*
 - d) *Kryerja e adhurimeve me përshpirtshmëri*
 - e) *Gdhirja e netëve*
 - f) *Dhikrullah dhe murakabe*
 - g) *Ndjenja e afërsisë ndaj Resulullahut dhe salavati sherife*
 - h) *Meditimi mbi vdekjen*
 - j) *Qëndrimi me njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq)*
 - k) *Pajisja me një moral të bukur*
4. Vështrim mbi gjithësinë me një zemër të qashtë

C. PARIMET THEMELORE NE EDUKIMIN MISTIK

D. PRIJESI I PERSOSUR DHE METODAT E ORIENTIMIT

1. Prijësi i përsosur
2. Metodatat e orientimit
 - a) *Ndjenja e afërsisë (muhabbet) dhe lidhja shpirtërore (rabita)*
 - b) *Biseda (sohbet)*
 - c) *Shërbimi (hizmet)*
 - d) *Prirja (tevexhxhuh)*
 - e) *Lutja (dua)*

E. STILI MISTIK

1. Stili i orientimit dhe mëshirës
 2. Stili i butësisë dhe dhembshurisë
- 



“Kush është pastruar, pa dyshim, ka shpëtuar!” (el-A'la, 14)



EDUKIMI MISTIK

(Udha dhe udhëtimi mistik)

Në dorën e edukatorëve të vërtetë, trashëgimtarë të Profetit, tasavvufi ose mistika islame është shkolla ku edukohet nefsi dhe purifikohet zemra!



Njerëzit janë krijuar në nivele të ndryshme të kapaciteteve dhe mundësive. Edukimi në tasavvuf ose edukimi mistik bëhet sipas kapacitetit dhe mundësisë afektive të nxënësit ose udhëtarit të udhës mistike si dhe karakterit dhe temperamentit të tij. Meqenëse karakteri dhe temperamentit nuk mund të ndryshohen krejtësisht, pjekuria e dëshiruar arrihet në atë masë që të mundet të edukohet me anë të urdhrave hyjnorë dhe të orientohet. Ndryshe nga sheriatit që vë rregulla të posaçme për të përgjithshmen dhe të njëjta për secilin, në tasavvuf, për nxënësin ose udhëtarin e udhës mistike (salik) është përdorur rruga e metodave edukative që ndryshojnë nga individi në individ krejt siç ndryshojnë syzet optike me numra. Ndërkaq, pandehma se mes sheriatit dhe tasavvufit ka ndonjë mospërputhje ose kontradiktë, është e gabuar. Marrëdhënia sheriat-tasavvuf është përngjasuar qysh në krye të herës me një kompas. Këmbe e fiksuar e kompasit është sheriatit, kurse këmba e lëvizshme, tasavvufi. Hapësira mes dy këmbëve hapet ose mbyllet sipas kapacitetit, karakterit dhe temperamentit të bashkëbiseduesit.

Nga ana tjetër, këto kritere të ndjeshme të tasavvufit diskutohen për njerëz që e kanë plotësuar respektimin e urdhrave dhe ndalimeve të Allahut. Prandaj, mistikët e vërtetë janë njerëz që e kanë rregulluar botën e tyre të jashtme dhe e kanë orientuar për edukim botën e brendshme. Ata bëjnë përpjekje të vazhdueshme që përkryerjen e jashtme ta kurorëzojnë edhe me zhvillimin e brendshëm. Sepse, edhe nëse përmirësimi dhe plotësimi i dukjes është me rëndësi, esenciale është bota e brendshme, domethënë,





zemra. Sepse, edhe pse është vullneti që u jep sendërtim akteve, nuk duhet mbajtur larg nga kujtesa se janë të gjitha ndjenjat që e orientojnë dhe drejtojnë vullnetin. Kurse mjedisi i ndjenjave është zemra¹.

Njëra nga parimet delikate të ndjekura nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.) në edukimin moralo-shpirtëror është që folësi të mos e prekë dhe të mos e fyejë bashkëbiseduesin, përkundrazi, ta bëjë qortimin duke e marrë mbi vete të metën. Shprehjet e tij të formës “ç’po ndodh me mua që po ju shoh kë-shtu”,² me pretekste të ndryshme, janë shembulli më tipik i kësaj shfaqjeje. Edhe njerëzit e zemrës të cilët i ndjekin këto kritere delikatesash ndjesore, e kanë bërë shenjë dalluese të vetën qortimin për veten (për nefsin e vet) dhe mirëkuptimin për të tjerët. Meqë ata janë të preokupuar më shumë jo me dukjen, por me pastrimin e zemrës, për rrjedhojë, me edukimin e zemrës, edhe mëkatarin e trajtojnë me mëshirë dhe mirëkuptim. Sepse ata nuk e kanë hallin të eliminimi të mëkatarit por të eliminimi të mëkatit. Prandaj, para se të rregullojnë gjendjet negative të njeriut, e përmirësojnë atë duke ia zbutur zemrën me anë të begatisë së bisedës.

Fakti që Jusufi (a.s.), pasi u bë ministër i Egjiptit, nuk i hodhi poshtë kërkesat për ndihmë të të vëllezërve që dikur e kishin hedhur në pus për ta vararë, dhe, duke e fshehur se kush ishte, i ndihmoi ata e i përcolli me dhurata, është, në edukimin ndjesor, një delikatesë e papërshekrueshme. Kurse me fuqinë që kishte atë çast në dorë, ai fare mirë mund të merrte shpëtim nga ta. Mirëpo ai ishte një prijës i rrugës së drejtë që kishte arritur virtytin për t’i harruar, për hir të Zotit, të këqijat që i kishin bërë të tjerët. Ajeti kur’anor e shpreh kështu këtë trajtim të mirë të Jusufit (a.s.) ndaj të vëllezërve:

“(Jusufi) U tha:

“Sot nuk ka qortim për ju! Allahu ju faltë! Ai është më mëshiruesi i mëshiruesve!” (Jusuf, 92)

Përballë këtij qëndrimi fisnik, të vëllezërit shfaqën pendim dhe bënë pendesë. Ata e pranuan epërsinë e Jusufit (a.s.) dhe e miratuan pjekurinë e tij. Si rrjedhojë e kësaj, u arrit edhe rezultati i kërkuar.

Shembulli i mëposhtëm i përket një shfaqjeje tjetër të kësaj metode edukimi.

1 Këtu duhet mbajtur parasysh që, si dhe në shqip, zemra përfaqëson, figurativisht, ndjenjat, kështu që, në këtë rast, kur themi zemër, s’e kemi aspak fjalën për organin anatomik zemër.

2 Shih. Muslim, Salat, 119; Ebu Davud, Hatem, 4; Edeb, 14.





Disa djem të rinj të paditur e indiferentë po pinin verë e po argëtohehin në breg të lumit Tigër. Ndërkaq, aty pari kaloi Maruf Kerhi (k.s.), një nga miqtë e njohur të Zotit. Djemve të cilët menduan se i urti Kerhi do t'i mallkonte për shkak të mëkatit që po bënin, u iku qejfi. Me këtë zemërim, njëri nga të rinjtë u ngrit në këmbë dhe i foli të urtit me një ton të ashpër e provokues:

“O i urtë! Eja, tani, e fillo të lutesh që të na rrëmbejnë ujrat e tërbuara të Tigrin!”

Pa treguar asnjë shenjë zemërimi, i urti Maruf Kerhi ngriti duart lart me mëshirë për lutje dhe tha me zë të lartë:

“O Zot! Siç u ke dhënë këtyre trimave gjallëri djaloshare në këtë botë, jepu edhe në botën tjetër!”

Përballë këtij qëndrimi të pashpresuar, djemtë i thanë me habi:

“Ç’po thua, o i urtë! Nuk e morëm vesh kuptimin e këtyre fjalëve!”

Me forcën ndikuese të fjalëve të veta të dhënë nga Zoti, i urti u tha kë-shtu djemve:

“Bijtë e mi! Po deshi Zoti t’ju japë gjallëri në jetën tjetër, jua bën të mundur të pendoheni!”

Në fillim të rinjtë ranë në mendime, pastaj ata e ndjenë se duhej të bënin vetëllogari e të pendoheshin. Ata i derdhën kupat e verës, i thyen veglat muzikore dhe u penduan. Ata kërkuan shpëtimin dhe lumturinë e të dy botëve!

Siç e përmendëm edhe më lart, një specifikë tjetër e edukimit të zemrës në mistikë është përdorimi i një metode përmirësimi dhe orientimi sipas karakterit dhe temperamentit të çdo individi. Shumëllojshmëria e tarikateve ka lindur nga domosdoshmëria e metodës së edukimit dhe sugjerimit sipas dallimeve në karaktere dhe temperamente.

Asgjësimi i karakterit dhe temperamentit është i pamundur. Edhe pri-jësit e përkryer kanë vetëm për detyrë që, si pengesë për rrjedhjen e aftë-sive në karakteret dhe temperamentet e nxënësve drejt një fokusi subjektiv dhe egoistik, t’i drejtojnë ata drejt qëllimeve të larta. Ata ofrojnë receta mjekuese të posaçme që do të ishin shërim për sëmundjet personale të botës moralo-shpirtërore të çdo nxënësi.

Arabët e periudhës pagane paraislamike të quajtur “xhahilije”, të cilët i groposnin të gjalla vajzat e tyre të vogla, ishin njerëz zemërgurë. Ata ishin njerëzit e një shoqërie të privuar nga mëshira, ku e drejta i përkiste vetëm





të fortit, ku i dobëti s'kishte asnjë lloj mbështetjeje dhe strehimi. Kjo shoqëri e gjeti rrugën e drejtë dhe, me anë të edukimit moralo-shpirtëror të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), pjesëtarët e saj u bënë njerëzit më të zgjedhur të botës. Në sajë të vitalitetit që fituan duke mbajtur gjallë çdo çast në zemër dashurinë që ndjenin për të Dërguarin e Allahut, adhurimet e tyre u mbushën me përshpirtshmëri. Ata u bënë modele të moralit të lavdëruar dhe u quajtën “as’habi kiram”, “sahabet (shokët) bujarë”!

Me edukimin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), sahabet bujarë arritën një nivel të tillë moralo-shpirtëror që Abdullah bin Mes’udi (r.a.) e ka përshkruar me këto fjalë:

“Ne arritëm në atë gjendje sa të dëgjonim tesbihet e kafshatave që na kalonin nëpër grykë!” (Buhari, *Menakib*, 25)

Ja, pra, tasavvufi ose mistika islame është një rrugë sublime e përfitimit nga këto nivele moralo-shpirtërore ku patën arritur sahabet bujarë, shokët e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) në sajë të edukimit të tij! Pra, është një shkollë shpirtërore ku bëhet edukimi i nefsit dhe purifikimi i zemrës në dorën e edukatorëve të vërtetë që janë bërë trashëgimtarë të Tij! Hyrja në këtë shkollë të edukimit moralo-shpirtëror për të kapërcyer etapa në rrugën për t’u bërë njeri i përkryer, emërtohet edukim mistik (sejr-u suluk ose udha dhe udhëtimi mistik).





*K*ush e njuh veten, njuh Zotin e vet...



A. NEFSI DHE PASTRIMI I TIJ

1. Natyra e nefsit

Zoti e ka krijuar në xhennet Ademin (a.s.), atin e brezit njerëzor, duke e bërë më të përsosurin e krijesave. Por Zoti, si domosdoshmëri e nderit dhe dinjitetit që i favorizoi Ademit dhe brezit të tij, ka dëshiruar në mënyrë volitive që qëndrimi i tij në xhennet të realizohet jo thjesht me favor, por si shpërblim, prandaj, sipas dëshirës volitive hyjnore, Ademi (a.s.) iu nënshtrua atij gabimit të njohur dhe, për këtë shkak në dukje, u nxuar nga xhenneti, vatani i tij i origjinës dhe u suall në këtë botë prove.

Për rikthimin e Hz. Ademit dhe brezit të tij në xhennet në formën e një shpërblimi, është bërë e domosdoshme që njeriu të kapërcejë një sërë vështirësish.

Është për këtë arsye që Zoti e ka pajisur Ademin dhe brezin e tij, ndryshe nga qeniet e tjera, me shfaqje antagoniste. Si rrjedhojë, është dashur që njerëzit të ndodhen në një pozitë, sipas meritës, mes nivelit më të ulët të quajtur **esfeli safilin** dhe nivelit më të lartë të quajtur **alai il'ijjin**. Pra, njeriu, i cili është qenie e nderuar, edhe me kapitalin e krijimit të vet, edhe me vullnetin e vet të pjesshëm, të aftë e të prirur për ta përdorur kapitalin e krijimit edhe për të mirë, edhe për të keq, zë vendin e vet në një pikë mes pozitës më të ulët të quajtur **më poshtë se kafshët** (*bel hum edal*) dhe pozitës më të lartë të quajtur **më lart se engjëjt**. Kjo realizohet sipas zellit të njeriut dhe rezultatit që do të marrë ai nga lufta mes prirjeve pozitive dhe negative të pranishme në natyrën e krijimit të tij. Ja, pra, mbi këtë urtësi ngrihet fakti që ndërsa është pajisur me një sërë prirjesh pozitive, njeriu është çenuar me disa prirje negative.

Sipas botëkuptimit mistik, prirjet pozitive dhe negative që ndodhen së bashku tek njeriu, dalin në pah nga qendrat e ashtuquajtura *ruhi hajvani* - fryma shtazore dhe ruhi sulltani - fryma mbretërore.





Ruh-i hajvaní ose **fryma shtazore** është një forcë e padukshme që i siguron njeriut vazhdimësinë e gjallesës dhe jetës, së cilës i thuhet edhe *xhan*, *shpirt* ose *nefs* (frymë, subjekt). Te njeriu që është në gjumë sundon dhe vepron fryma shtazore, prandaj shumica e veprimtarive biologjike gjatë kësaj kohe zhvillohen në mënyrë të pavullnetshme. Kurse fryma mbretërore e braktis njeriun në gjumë për t'u rikthyer në çastin kur ai zgjohet. Fryma shtazore është ajo që e bën trupin të lëvizë, që e bën njeriun të flasë dhe, që, shkurtimisht, përbën shkak për ekzekutimin dhe kryerjen e çdo lloj akti dhe veprimtarie, por që del dhe largohet nga trupi së bashku me vdekjen. Fryma shtazore që e ka qendrën në tru ose në zemër, është e përhapur në të gjitha organet dhe gjymtyrët e trupit dhe sundimin e vërtetë e ka ngritur mbi gjakun. Kjo frymë që është nga **bota e krijimit**³ dhe që përbën pikën fillestare të sjelljeve, po të mos edukohet, mundet të ushtrojë dhe ushtron mbi njeriun efekte negative.

Kurse **fryma mbretërore** është fryma apo shpirti (ruh) që Zoti ia ka fryrë njeriut nga fryma (shpirti) e vet dhe është pikërisht kjo veçanti që e dallon njeriun nga gjallesat e tjera. Bashkekzistenca e kësaj fryme që është nga **bota e urdhrit**⁴, ka për qëllim që kjo frymë të ushtrojë mbi njeriun efekte pozitive. Me anë të kësaj fryme të *veshur* trupit të njeriut, njeriu kryen adhurime dhe priret nga aktet e mira. Kjo frymë nuk preket nga vdekja dhe, pastaj, kalbja e trupit. Ndërkaq, ndikimi dhe efekti i saj mbi trupin merr fund vetëm me vdekjen.

Njeriu i jep orientim gjendjes dhe ecurisë së jetës së vet me anë të përplasjeve mes këtyre dy poleve të kundërta brenda vetes së vet. Kur del fituese fryma mbretërore, njeriu orientohet drejt akteve të mira dhe moralit të bukur; në të kundërt, kur del fituese fryma shtazore, njeriu bie në mëkate dhe imoralitete të ndryshme.

Meqë njeriu është bërë zotërues në një masë të caktuar i aftësisë dhe mundësisë për t'i dhënë formë nefsit (vetvetes, subjektit të vet) me vullnetin e vet, është një qenie që mund të bëhet edhe objekt shpërblimi, edhe objekt ndëshkimi.

- 3 Në original: halk alemi; bota e krijimit është bota e përbërë prej qenieve të krijuara si të kushtëzuara nga koha dhe hapësira. Kjo quhet edhe bota e pronës dhe e dëshmisë. Të kësaj bote janë gjërat që i perceptojmë me anë të pesë shqisave të jashtme.
- 4 Në original: emir alemi; është bota që ekziston sipas urdhrit "kun" (bëhu!) të Zotit jashtë kohës dhe materies. Kjo quhet edhe bota engjellore ose e fshehtë (e padukshme). Gjërat e padukshme, si mendja, arsyeja, shpirti, ndjenja, e fshehta, etj. i përkasin kësaj bote.





Nefsi, i cili është një nga pengesat më të mëdha që duhen kapërcyer në provën e kësaj bote, përgjithësisht të sjell ndërmend prirjet negative që i janë imponuar njeriut. Ndërkaq, në esencën e njeriut ekziston, si një margaritar, edhe një natyrë pozitive. Detyra e njeriut është që, duke e pastruar nefsin nga negativitetet, që janë si pluhura e dhera, me anë të edukimit moralo-shpirtëror, ta nxjerrë në shesh margaritarin në esencën e tij.

Ashtu siç përpiqet njeriu i dalë në kurbet për të mos u kthyer duarbosh në vatan, ashtu duhet të tregojë zell e përpjekje në këtë botë që është vend i madh kurbeti, për të fituar lumturinë e jetës tjetër, ahiretit. Sepse çdo njeri e përgatit në këtë botë lumturinë ose disfatën e përjetshme dhe e merr, pastaj, me vete për atje, pra, me fjalë të tjera, fatin e së ardhmes e përcakton në jetën e kësaj bote.

Njëri ndër kushtet më themelore të paqes dhe lumturisë së amshuar është që nefsit t'i jepet një konsistencë e tillë që të aftësohet për punë të mira. Nefsi i privuar nga një synim i tillë është si një kalë i pazbutur. Kali i pazbutur, në vend që ta çojë të zotin atje ku ai kërkon të shkojë, e hedh poshtë në greminë duke e shkaktuar vdekjen. Kurse kali i zbutur e i urtë e çon shëndoshë e mirë të zotin duke e kaluar shëndoshë e mirë edhe nëpër shtigjet më të rrezikshme. Ashtu siç është e pamundur të arrihet në synim me një kalë të pazbutur, ashtu është e pamundur të realizohet qëllimi i lartë i jetës me një nefsi të pazbutur, të papërmirësuar e të pavënë nën kontroll.

Me të vërtetë, nefsi është një mjet i dyanshëm i cili edhe mundet ta lartësojë njeriun në një pozitë të nderuar mes krijesave, edhe mundet ta rrëzojë në të kundërtën e kësaj pozite, që është esfeli safilin. Nefsi është si një thikë me dy presa e cila ka aftësi për t'u bërë pretekst për të mirë nëse përmirësohet, kurse për të keqe nëse nuk edukohet.

Çdo nefsi i privuar nga orientimi dhe kontrolli moralo-shpirtëror, është shkak i një privimi të hidhur që i mbulon të vërtetat me indiferentizëm. Ndërkaq, siç e thamë edhe më sipër, po qe se njeriu, pavarësisht nga pengesa nefsi, shpëton nga morali i ulët dhe pastrohet, mund t'i kalojë edhe engjëjt. Sepse nderi i çdo përfundimi është në raport të drejtë me vështirësitë e kapërcyera për ta arritur atë nder.

Janë përsëri atributet e ulta të nefsit ato që hyjnë si perde indiferentizmi mes Allahut dhe njeriut, robtë të tij, e largojnë njeriun nga orientimi i vërtetë dhe që i shtyjnë zemrat të preokupohen me të tjera gjëra veç Allahut. Dëshirave dhe pasioneve të ulta të nefsit, që s'dinë të mbarohen, mund t'u kundërvihet vetëm me anë të metodave edukuese që të zbatoheshin





me një vendosmëri serioze, gjë që do të thotë një luftë të pamëshirshme që kërkon zgjuarsi dhe vendosmëri të vazhdueshme. Është për këtë arsye që, në një hadith profetik, Zotëria i Botëve ka thënë:

المُجَاهِدُ مَنْ جَاهَدَ نَفْسَهُ

“(Në të vërtetë) Muxhahid (luftëtar) është personi që bën xhihad (luftë) kundër nefsit të vet!” (Tirmidhi, *Fedailu'l-Xhihad*, 2; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, VI, 20)

Me luftën e bërë kundër tij, nefsi nuk vdes, por vetëm mund të merret nën kontroll. Fundja, ajo që kërkohet, nuk është asgjësimi i nefsit, por, duke e ruajtur atë nga teprimet, kufizimi dhe edukimi i prirjeve të tij me anë të parimeve në përputhje me pëlqimin hyjnor. Në lidhje me këtë specifikë, duke e përngjasuar njeriun me një kalorës, imam Gazaliu thotë kështu:

“Nefsi është kali i shalës i shpirtit. Po qe se njeriu i lëshon frerët e nefsit dhe e lë të lirë të shkojë në ç’drejtim që të dojë, shkatërrimi i tij është i paracaktuar, i pashmangshëm. Nga ana tjetër, po qe se përpiket ta vrasë atë - siç ndodh në disa fe indiane dhe filozofi mistike - mbetet pa mjet udhëtimit në rrugën drejt së vërtetës. Atëherë, mbaji fort në duar frerët e nefsit dhe përfito nga kali yt i shalës!

Respektimi i kësaj mase në edukimin e nefsit është, në të njëjtën kohë, domosdoshmëri e metodës profetike. Profeti ynë u qe bërë pengesë atyre që deshnin ta mbyllnin veten në adhurim pa u ushqyer dhe pa bërë jetë familjare. Duke ua mësuar njerëzve se në Islam nuk ka një vetizolim (asketizëm) dhe murgëri të tillë, ka treguar rrugën e zhvillimit dhe përparimit shpirtëror të mundshëm brenda jetës dhe së bashku me shoqërinë.

Nga ana tjetër, gjatë këtij procesi edukimi që është një luftë shumë e vështirë, në gjendjet dhe shkallët e nefsit haset në një sërë etapash. Ndërkaq, njëra nga fatkeqësitë e nefsit është që, gjatë këtij procesi ndryshimi dhe përparimi, të kapet pas iluzionit se është diçka dhe të bjerë në vetëpëlqim. Kjo është një mendjemadhësi dhe prepotencë e fshehtë. Po qe se në luftën e filluar kundër nefsit shfaqet qoftë edhe nënvleftësimi dhe mefshtësia më e vogël, ai kthehet menjëherë në gjendjen e vjetër. Meqë nefsi është gjithmonë në pusí, kurrë nuk mund të kihet siguri nga e keqja e tij.

Për këtë shkak, çdo besimtar duhet ta quajë domosdoshmëri syçelësi-në e vazhdueshme ndaj rreziqeve vrasëse të këtij faktori të tmerrshëm për jetën e tij. Ai duhet ta mbajë nën bindje nefsin duke i trajtuar prapësitë e tij me gjykim të shëndoshë dhe me një vullnet të edukuar me anë të vahjit, revelacionit hyjnor.





Si duhet të jetë pastrimi i nefsit, i cili është si një kalë shale për njeriun, por që në natyrën e vet ka prirjen për t'u harbuar? Veç kësaj, nëpër ç'etapa mund të arrihet në edukimin dhe pastrimin e nefsit? Ja, këtu do të qëndrojmë mbi këto dy çështje të rëndësishme.





E rëndësishme është të mund të bëhesh me natyrë trëndafilore. Pra, jo duke parë në bahçen e kësaj bote gjambat, të mbushesh me gjemba edhe ti, por, edhe nëse në mes futen mundime e vuajtje si dimri, t'i rrethosh ato me klimë pranvere dhe të bëhesh një trëndafil për të gjithë botën!



2. PASTRIMI I NEFSIT (TEZKIJE)

Fjala tezkije, krahas kuptimit leksikor *pastrim*, përmban edhe kuptime të tjera leksikore, si *shtim*, *zhvillim*, *begatim*. Brenda kësaj kornize kuptimesh, fjala tezkije shpreh, në fakt, të gjithë ecurinë e edukimit moralo-shpirtëror.

Pastrimi i nefsit është, para së gjithash, pastrim nga mohimi (kufri), injoranca, ndjenjat e këqija, bindjet e gabuara, morali i keq, pra, pastrim nga të gjitha llojet e gabimeve besimore (itikadí), moralo-etike (ahlakí) dhe praktike-adhurimore (amelí) që bien në kundërshtim me legjislacionin kanonik. Dhe, pas pastrimit dhe mbrojtjes nga të këqijat, mbushje e tij me frymë shpirtërore duke e edukuar dhe stolisur me tipare devocioni, si besimi, dituria, urtësia, ndjenjat e mira dhe shprehitë e bukura.

Në tasavvuf, tezkije ose pastrimi i nefsit është thyerja e pushtetit të tij mbi trupin duke ia pakësuar kërkesat dhe, në këtë mënyrë, sigurimi i pushtetit të shpirtit, gjë që mund të arrihet me rrugën e përkorisë e cila e forcon vullnetin kundër nefsit. Prandaj, në tasavvuf, metodë e frenimit të nefsit është quajtur qysh në krye të herës ngrënia e pakët, fjetja e pakët dhe folja e pakët. Por, si në çdo gjë tjetër, edhe në praktikimin e kësaj metode nuk duhet lënë mënjanë matura, sepse trupi është amanet i Allahut për njerëzit.

Pra, duke e pastruar nefsin, personi duhet të ruhet nga qëndrimet e skajshme në lëshime dhe teprime, sepse feja këshillon dhe urdhëron ma-





turinë në të gjitha sjelljet dhe qëndrimet. Para së gjithash, jo vetëm s'është e mundur të asgjësohet nefsi, domethënë subjekti i njeriut, por as që kërkohet një gjë e tillë! Pastrimi i nefsit, i botës subjektive, egoistike e ndjesore të njeriut është edukimi dhe mbajtja e nefsit, pra, e botës subjektive, brenda kornizës së urdhrave hyjnorë.

Edukimi dhe pastrimi i nefsit është faktori më përcaktues në realizimin e përfundimit njerëzor si fatkeqësi ose lumturi. Esenciale është që Zoti të konceptohet me të gjithë madhësinë, fuqinë dhe përsosmërinë e Tij dhe me këtë konceptim duhen orientuar aktet. Po të bëhet kjo, nefsi i cili, sipas shprehjes së Kur'anit, **“e urdhëron me forcë të keqen”**,⁵ pastrohet nga atributet e këqija dhe bëhet i butë e i pranueshëm.

Përpjekja për pastrimin e nefsit dhe, në këtë synim, hyrja në rrugën e edukimit mistik me një zell serioz është pranuar si **“xihadi i madh”** (xihad-i ekber) duke u mbështetur në rëndësinë dhe vështirësinë e tij.

Këtë cilësim e pati përdorur vetë profeti Muhammed (s.a.s.) gjatë kthimit nga **fushata e Tebukut** kur u pati thënë sahabeve, shokëve të tij:

“Tani po kthehemi nga xihadi i vogël për në xihadin e madh!”

Mirëpo fushata nga e cila po ktheheshin kishte qenë një fushatë e madhe nga të gjitha drejtimet: intrigat e hipokritëve, e nxehta dhe thatësira e madhe e atij viti, rruga prej më shumë se një mijë kilometrash e gjatë e kaluar në këmbë, periudha e të korrave që kish hyrë e kish kaluar, etj. Duke iu afruar Medines, pothuaj kishin ndërruar trajtë. Lëkura u ish ngjitur pas eshtrave, mjekra dhe flokët u ishin ngatërruar me njëra-tjetrën. Disa shokë kureshtarë për kuptimin e kësaj fjale të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! A mund të ketë luftë më të madhe se kjo?”

Dhe Profeti u dha këtë përgjigje:

“Po! Tani po kthehemi nga lufta e vogël në luftën e madhe, në luftën me vetveten!”⁶

Nga ana tjetër, është e njohur çështja e tre sahabeve që patën marrë pjesë në të gjitha fushatat e tjera, por që munguan pa justifikim në fushatën e Tebukut, për çka u dënuan me lënie në vetmi (sahabet dhe Profeti nuk i

⁵ Shih. Jusuf, 53.

⁶ Shih. Sujuti, Xhamiu's-Sagir, II, 73





shihnin në fytyrë, nuk u flisnin dhe nuk ua kthenin përshëndetjen). Pendi-mi dhe dërrmimi i tyre shpirtëror ishin të papërshtueshëm.⁷

Tani le të mendojmë me maturi se në ç'pozitë do ta vinte nesër para pranisë hyjnore njeriun nënvleftësimi i pastrimit të nefsit (vetvetes) dhe i purifikimit të zemrës, të cilat emërtohen xihadi ose lufta e madhe!

Prandaj këto dy vërejtje të Zotit të madh janë mjaft të ashpra:

“A mos pandehët se ju kemi krijuar pa qëllim dhe se nuk do t’ju kthejmë prapë tek Ne?” (el-Mu’minun, 115)

Si dhe:

“A mos pandeh njeriu se do të lihet të bredhë pa qëllim?” (el-Kijame, 36)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka porositur:

“I mençur është ai që e sundon nefsën dhe, duke i kërkuar llogari atij, punon për jetën pas vdekjes, kurse kokëtrashë është ai që, megjithëse shkon pas pasioneve të nefsit, shpreson (të mirë) nga Allahu!” (Tirmidhi, Kijamet, 25; Ibni Maxhe, Zuhd, 31)

Prandaj, çdo besimtar duhet të veprojë me vetëdijen e një përgjegjësie serioze me të cilën është ngarkuar për pastrimin e nefsit të vet.

Zoti ynë na paralajmëron kështu ne, robtë e Tij përballë rreziqeve të nefsit:

أَرَأَيْتَ مَنْ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوَاهُ أَفَأَنْتَ تَكُونُ عَلَيْهِ وَكَيْلًا

“(O i Dërguar!) A e ke parë atë që i ka bërë dëshirat e nefsit zot të vetes? A mos do të bëhesh tani dorëzanës për të?” (el-Furkan, 43)

⁷ Këta tre sahabe janë: Murare bin Rabii'l-Amri, Hilal bin Ummejeti'l-Vakifi dhe poeti Ka'b bin Malik. Këta kishin marrë pjesë në të gjitha fushatat dhe luftërat. Dy të tjerët veç Ka'bit kishin marrë pjesë edhe në Bedër. Por ç'e do se përballë qëndrimit të zbatuar ndaj tyre për shkak të gabimit të mosmarrjes pjesë në fushatën e Tebukut, bota u bë e ngushtë për zemrat e tyre. I Dërguari i Allahut dhe shokët i prenë të gjitha lidhjet me ta. Ata u izoluan edhe nga gratë e veta gjer në ardhjen e një komunikimi hyjnor për çështjen e tyre. Prandaj derdhën lot pendese ditë e natë dhe u bënë si qirinj të tretur. Bënë gabim, por nuk e lanë sinqeritetin, drejtësinë, ndershmërinë dhe pendimin. Kështu kaluan plot pesëdhjetë ditë. Më në fund, si shpërblim për pohimin e të vërtetës siç ishte dhe për pendesën e sinqertë, u erdhi falja me këtë ajet kur'anor:

“Allahu e pranoi edhe pendesën e tre vetëve që kishin mbetur pas. Me gjithë gjersësinë e saj, toka u erdhi e ngushtë dhe i vrau ndërjegjja. Më në fund e kuptuan se nuk kishin shpresë tjetër veç mbështetjes te Allahu (nga ndëshkimi i Tij). Pastaj Allahu ua pranoi pendesën që të ktheheshin në gjendjen e mëparshme. Allahu e pranon shumë pendimin dhe është falës i madh! O besimtarë! Kini frikë Allahun dhe bashkohuni me besnikët!” (Tevbe, 118-119) (Për njohuri më të hollësishtme, shih O.N.Topbash, *Vargu i Profetëve*, botimi shqip).





Në një hadith profetik, Profeti (s.a.s.) thotë:

“Gjëja nga e cila frikësohem më shumë për ummetin tim, është se mos bëjnë sipas dëshirave të nefsit!” (Sujuti, Xhami'u's-Sagir, I, 12)

Është për këtë arsye që pastrimi i nefsit ka një rëndësi tejet jetësore për çdo besimtar dhe bart një përgjegjësi të madhe. Këtë përgjegjësi, Zoti e ka shprehur në këtë formë në Kur'an:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا

“Pa dyshim, kush e pastron nefsin (nga të këqijat), ka shpëtuar, kurse kush e zhyt atë në të këqija, ka humbur!” (esh-Shems, 9-10)

Siç shihet, kur nefsi ndiqet pa masë, bëhet shkak për një fatkeqësi të përjetshme, kurse kur edukohet dhe nënshtrohet, bëhet një pretekst përfitimi që e lartëson njeriun në një pozitë mbi engjëjt!

Nga ana tjetër, edhe nëse punët e mira, si dhurimi, sadakaja dhe shërbimi, mund të duken si të dobishme për të tjerët, në të vërtetë janë sugjerime të së drejtës, së bukurës dhe së mirës për nefsin, sepse në këtë mënyrë zënë vend mirësitë në vetveten e njeriut dhe vetvetja e njeriut ambientohet me to. Krahas të gjitha punëve të tjera të mira, këndimi i Kur'anit i cili është më e drejta dhe më e bukura e fjalëve, dëgjimi me veshin e zemrës i këshillave dhe porosive të tij dhe zbatimi i urdhrave të tij, janë preteksti më i madh për përmirësimin e nefsit. Njeriu i cili e rregullon jetën nën orientimin e Kur'anit, shpëton nga e keqja e nefsit dhe trazimet e djallit dhe jeton duke kërkuar vetëm pëlqimin e Zotit dhe, atëherë, zemra i bëhet e merituar e shfaqjeve hyjnore. Për njeriun që arrin në këtë gjendje, hapet një dritare shpirtërore për të parë përtej kushteve të kësaj bote dhe gjithësia shndërrohet në një libër madhështor.

Atëherë, asnjë besimtar nuk duhet të rrijë indiferent ndaj urdhrave dhe ndalimeve hyjnore që përmbahen në Kur'an, nuk duhet ta hedhë në rrezik lumturinë dhe shpëtimin e tij të përjetshëm!



Në librin tonë të lartë, Kur'an, ka shumë ajete mbi pastrimin e nefsit. Në këto ajete, pastrimi (tezkije) është trajtuar si:

- pastrim nga Allahu i Lartë;
- pastrim nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.);





- pastrim i nefsit të vet nga vetë personi.

1. Pastrimi (tezkije) nga ana e Allahut

Allahu urdhëron kështu në Kur'an:

فَلَا تَزُكُّوا أَنْفُسَكُمْ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنِ اتَّقَى

“... Mos t’ju pëlqejë vetja e ta nxirrni të pastër (të pafajshme). Ai (Allahu) e di shumë mirë se kush ruhet nga e keqja!” (en-Nexhm, 32)

Elmallëllë Hamdi e komenton kështu këtë ajet:

“Mos e lavdëroni veten duke e quajtur pa mëkat, pa të meta dhe krejt të pastër, se te vetja juaj mund të gjenden shumë të meta që nuk i dini!”

Në lidhje me këtë çështje, mufessiri, komentuesi i Kur’anit, Alusi, thotë kështu:

“Rrëfëhet se ky ajet është zbritur për një grup njerëzish që thoshin: “Ne kemi namaz, agjërime dhe haxh!” Eshtë më e pranueshme që njeriu t’i mbajë fshehtë adhurimet dhe mirësitë që bën, sepse në to mund të përzihen mendjemadhësia dhe dyfytirësia. Por po të mos ketë një qëllim të tillë negativ, nuk ka ndonjë të keqe që t’i tregojë.”

Në një ajet tjetër, Allahu thotë kështu:

“A nuk i pe ata që e nxjerrin veten të pastër? Përkundrazi, Allahu e nxjerr të pastër atë që do!” (en-Nisa, 49)

Pastrimi (tezkije) për të cilin bëhet fjalë në këtë ajet, është përpjekja e personit për ta nxjerrë veten të pastër duke e lavdëruar. Mirëpo tezkija (pastrimi) është e lidhur me takvanë (devocionin), ndërkaq që takvaja është një atribut i brendshëm, të vërtetën e të cilit e di vetëm Allahu. Prandaj, e vlefshme është të na nxjerrë Allahu të pastër, jo ta nxjerrim ne veten tonë!

Kështu, Profeti (s.a.s.) lutej:

“Allahu im! Jepi nefsit tim devocion (takva) dhe nxirre të pastër! Ti je më i dobishmi i atyre që e pastrojnë atë! Ti je kujdestari dhe i Adhuruari i tij!” (Muslim, Dhikr, 73)

Në ajetin kur’anor urdhërohet:

“... Po të mos ishte mëshira e Allahut mbi ju, askush prej jush kurrë nuk do të dilte i pastër. Por Allahu e nxjerr të pastër atë që do! Allahu dëgjon me të vërtetë dhe e di çdo gjë me përsosmëri!” (en-Nur, 21)

Siç shihet, në ajet pohohet se pastrimi (tezkije) i përket Allahut. Sado që pastrimi i atribuohet njeriut vetë për sa i përket vendosmërisë dhe zellit,





si dhe profetëve dhe prijësve të udhës së drejtë si trashëgimtarë të detyrës së tyre profetike përsa i përket mësimin dhe orientimit, duhet t'i atribuohet Allahut përsa i përket suksesit që u jep në këtë punë njerëzve, robve të vet, me mëshirën e vet, dhe aktin krijues të Tij në këtë drejtim.

2. Pastrimi (tezkije) nga ana e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.)

Në Kur'an, në lidhje me detyrat e Profetit (s.a.s.), thuhet kështu:

كَمَا أَرْسَلْنَا فِيكُمْ رَسُولًا مِّنكُمْ يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ
وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُعَلِّمُكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ

“(O njerëz!) Me të vërtetë, dërguam një të ngarkuar me detyrë nga mesi juaj. Ai jua këndon ajetet tona, ju pastron nga të këqijat dhe jua mëson ato që s’i dini duke ua praktikuar Librin dhe urtësinë!” (el-Bakara, 151)

“Me të vërtetë, duke u dërguar nga mesi i tyre një të ngarkuar me detyrë i cili ua këndon ajetet e Allahut, i pastron (nga të këqijat dhe mohimi), ua mëson Librin dhe urtësinë, Allahu u ka bërë një favor të madh besimtarëve. Kurse gjer atëherë ata ishin në rrugë të shtrembër!” (Al-i Imran, 164)

Siç kuptohet qartë edhe nga këto ajete, Profeti ynë (s.a.s.) ka tri detyra bazë:

a) *T’ua këndojë njerëzve ajetet e Allahut:*

Ftesa e bashkësive të tyre për në udhën e drejtë nga profetët ka filluar me këndimin e fjalës hyjnore që u ka ardhur. Ndërkaq, kjo detyrë është etapa e parë për t’i çuar njerëzit në synimin e kërkuar dhe përbën një bazë.

b) *T’i pastrojë nefset:*

Ftesa për tevhid (për besimin në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë) mund t’ia arrijë qëllimit vetëm duke i bërë nefset, vetet njerëzore, të arrijnë përsipirtshmërinë dhe prehjen duke i pastruar nga fëlliqësitë moral-shpirtërore, si mohimi (kufr), politeizmi (shirk) dhe mëkati. Kështu, sahabet me të kaluarën pagane, në sajë të bisedave të begata dhe edukimit moral-shpirtëror të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), pastruan zemrat, gjetën udhën e drejtë dhe u bënë njerëzit më të zgjedhur të botës.

c) *T’ua mësojë njerëzve Librin dhe urtësinë:*

Në këtë etapë vjen mësimi i Librit, domethënë, i Kur’anit, i cili shpreh ligjet dhe urdhrat që duhen zbatuar. Thellimi në frymën e Kur’anit varet





nga niveli i zemrës. Kur'ani këndohet dhe kuptohet vërtet me anë të zemrës. Kurse sytë janë, për zemrën, vetëm një ndërmjetës i thjeshtë.

Kur'ani është një thesar të fshehtash të pafundme ngaqë gjithësia dhe njeriu dalin në shesh me anë të shfaqjeve të emrave hyjnorë. Dhe këto të fshehta dhe urtësi shfaqen në procesin e njohjes në vartësi të pastrimit dhe maturimit ndjesor.

Kurse praktikimi i urtësisë vjen më pas, sepse Allahu i Lartë i bën të njohur vetëm njerëzit me zemër të pastruar me urtësitë dhe të fshehtat e Kur'anit i cili është shfaqja në formë fjale e emrave hyjnorë në njohjen njerëzore.

Fakti që në ajete, pastrimi me mësimin e Librit dhe urtësive përmenden së bashku, shpreh se njerëzit me nefs të papastruar nuk do të mund të fitojnë dituri, se, edhe sikur të fitojnë, nuk do të mund të sigurojnë ndonjë dobi prej saj. Sepse dituria dhe urtësia janë një dritë dhe stoli e tillë që, për t'i shtënë në dorë ato, në radhë të parë duhet që zemra ku do të vendosen ato, të zbrazet dhe çlirohet nga gjërat e panevojshme e të dëmshme. Prandaj, profetët, në fillim u kanë kënduar njerëzve ajetet, pastaj, duke ua pastruar nga teprimet dhe shëmtitë nefs të njerëzve që u kanë besuar dhe ua kanë dhënë zemrën ajeteve, ua kanë purifikuar zemrat nga fëlliqësitë moral-shpirtërore. Pastaj, njerëzve të pastruar dhe purifikuar, ua kanë mësuar dhe praktikuar Librin dhe urtësitë. Vetëm ata që kanë një zemër të tillë mund të njihen edhe me rrymat e fshehtësive dhe forcave në gjithësi dhe mund të bëhen burim urtësie.

Detyra e Profetit (s.a.s.) për t'ua lexuar njerëzve ajetet dhe për t'ua mësuar haramin dhe hallallin, do të vazhdohet gjer në kiamet nga dijetarët, kurse pastrimi i nefseve dhe purifikimi i zemrave, nga prijësit e përsosur.

3. Pastrimi i vetvetes (nefsit) nga vetë njeriu

Në lidhje me këtë specifike, në ajetin kur'anor thuhet kështu:

“Betohem në nefsin dhe në Atë që e shtron nefsin, pastaj, në Atë që ia frymëzon nefsit edhe të keqen, edhe ruajtjen prej së keqes, se kush e pastron nefsin arrin shpëtimin, kurse kush e zhyt atë (me anë të injorancës dhe mëkateve) në kotësi, del i humbur!” (esh-Shems, 7-10)

Sipas këtij ajeti, vetëm personat që i ka pastruar Allahu, domethënë, personat që janë pastruar nga mëkatet dhe janë edukuar me anë të frymëzimit hyjnor dhe devocionit (takva), kanë arritur shpëtimin e vërtetë. Për këta njerëz fatlumë është sihariqi hyjnor:

“... hyr mes robve të mi të mirë (salih) dhe hyr në xhennetin tim!”

(el-Fexhr, 29-30)





Në një ajet tjetër, Allahu urdhëron:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّىٰ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّىٰ

“Personi që pastrohet me të vërtetë dhe që e adhuron Zotin e vet duke e përmendur Atë, pa dyshim ka arritur shpëtimin!” (el-A'1a, 14-15)

Veç kësaj, të tërheq vëmendjen radhitja e gjërave sipas rëndësisë në ajet:

- në fillim, pastrimi nga negativitetet ndjesore, fizike e materiale;
- për rrjedhojë, heqja dhe hedhja tutje e perdeve (pengesave) mes Zotit dhe robtit;
- pastaj, duke hyrë në një klimë të plotë adhurimi në përsheptshmëri me anë të një trupi të ushqyer me ushqime hallall dhe me nefsi të pastër, stolisja e zemrës me shije shpirtërore.

Sipas shprehjes së mufessirit Ismail Haki:

“Në këtë ajet aludohet për pastrimin e nefsit nga punët në kundërshtim me sheriatin, për purifikimin e zemrës nga dashuria për këtë botë dhe për kthimin drejt Allahut me të gjitha mundësitë, madje, për t’u ruajtur nga sjellja ndërmend e tjetërkujt veç Allahut!”

Kështu, kur e pyetën Ebu Bekr Kettaniun (k.s.), një nga miqtë e Allahut, i cili ndodhej i shtrirë në shtratin e vdekjes, se ç’punë të shquara kishte bërë, u përgjigj me këto fjalë shembullore:

“Po të mos e kisha vdeken pranë, nuk do t’ju kisha folur për punët e mia duke dyshuar se mos kjo merrej për hipokrizi. Plot dyzet vjet bëra rojë në portën e zemrës sime. U përpoqa të mos ia hapja atë askujt tjetër veç Allahut të Lartë. Dhe zemra më erdhi në një gjendje të tillë që u bëra të mos njoh tjetër veç Allahut!”

Fjalën **“tezekka”** që përdoret në ajetin më sipër, Ibni Abbasi (r.anh) e komenton si “thënie nga personi të shprehjes **“la ilahe il’lallah”** (nuk ka zot tjetër veç Allahut)”. (Kurtubi, **el-Xhami**, XX, 22) Sepse hapi i parë në tezkije është pastrimi i zemrës nga mohimi (kufr) dhe politeizmi (shirk).

Me të vërtetë, Fjala e Njësisë (Tevhid) fillon me **mohim** (nefi), pra, duke thënë **“la ilahe”** (nuk ka zot tjetër), nxirren nga zemra dëshirat subjektive dhe emotive, morali i keq dhe veset e shëmtuara, pastaj kalohet në **pohim** (ithbat); pra, duke thënë **“il’lallah”** (veç Allahut), zemra e cila është në pozitën e një vendvështrimi hyjnor, mbushet me dritën e tevhidit, besimit në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë.





Duke shprehur rëndësinë e pastrimit, Ibrahim Desuki (k.s.) thotë kështu:

“O bir! Kurrë të mos pretendosh për egoizëm edhe sikur t’i kalosh ditët me agjërim dhe netët me namaz, edhe sikur të kesh një botë të brendshme të pastër dhe të veprosh me drejtësi! Kurrë të mos mundesh prej krenarisë dhe të mashtrohesh prej nefsit!..”

Edhe Hatem Essam (k.s.) thotë kështu:

“Mos u gënje nga konaqet e shkëlqyera dhe nga kopshtet e vreshtat prodhimtare, vend më të bukur se xhenneti s’ka! Por ato që i ranë mbi krye Hz. Ademit, i ranë kur ndodhej mes bukurive të xhennetit! Nefsi i desh të mbetej aty përjetësisht. Ai u afrua te fruti i ndaluar dhe, sipas vullnetit hyjnor, u ndëshkua me zbritjen në tokë!

Mos u mashtro nga adhurimet që bën dhe nga të fshehtat që të tregohen! Sa domethënës është fundi i hidhur i Belam bin Bauras⁸ megjithëse njihje shumë të fshehta dhe Allahu (xh.xh.) ia kishte mësuar emrin e madh!

Tregohu ai që je dhe mos u mashtro se di shumë e bën shumë adhurime! A nuk e di ç’i ndodhi Iblisit megjithëse kishte dituri të madhe dhe bente shumë adhurime? Mos u mashtro nga dredhitë e nefsit dhe shejtanit!

Zoti ynë i lartë që ka mëshirë të pafund për robtë e vet, urdhëron kështu në Kur’an si paralajmërim për ne ndaj dredhive dhe kurtheve të shejtanit (djallit):

“Iblisi tha: “(Zoti im!) Të betohem se do t’u ulem njerëzve mu në mes të udhës për t’i nxjerrë ata nga udha e drejtë!” (el-A’raf, 16)

Si dhe:

“(Iblisi) Tha: “Zoti im! Unë do t’ua stolis mëkatet atyre dhe do t’i nxjerr nga udha e drejtë!” (el-Hixhr, 39)

Mos ki siguri në vetvete sepse ndodhesh pranë njerëzve të mëdhenj të adhurimit (abid) dhe përkushtimit (zahid). Thalebe⁹ pati një fund tragjik ngaqë merrte pjesë pa ndjenja në kuvendin e Profetit (s.a.s.)!

Megjithëse ishte bir profeti, djali i Hz. Nuhut pati fatkeqësinë për ta parë veten jo nevojtar për ftesën e të atit. Pastaj, as lidhja e gjakut s’i bëri dobi! Si përfundim, u bë ndër të shkatërruarit!

8 Shih Kur’ani, A’raf: 175-176.

9 Ndërsa në fillim Thalebe nuk ndahej nga faltarja dhe bisedat e Profetit (s.a.s.), kur u bë pronar pronash e pasurish dhe dashuria për këtë botë i zuri vend në zemër, u largua nga xhemaati (bashkësia), pastaj ngurroi edhe të jepte zeqatin dhe, si rezultat, pati një fund të hidhur. (Taberi, Tefsir, XIV, 370-372; Ibni Kethir, Tefsir, II, 388)





Për shkak të afërisë me mëkatarët dhe mohuesit dhe të dashurisë ndaj tyre, gruaja e profetit Lut mbeti pa pjesë nga drita që kishte pranë dhe u kredh në errësirat e mohimit në padituri dhe indiferentizëm të plotë.

Shkurt, mos ki shumë siguri në mbështetje të tilla, si dituria, adhurimi, pasuria, fëmijët dhe miqtë për shpëtimin tënd në ahiret dhe kurrë mos nxirr pjesë për nefsin tënd prej tyre!”

Në ajetin kur’anor pohohet se **“do të shpëtojnë ata që do të pastrohen nga negativitetet duke e kapërcyer pengesën nefsi”**. Nga ky ajet, në të njëjtën kohë, del kuptimi se ata që nuk do të jenë pastruar, domethënë, nuk do ta kenë pastruar veten nga negativitetet, nuk do të shpëtojnë.

Allahu urdhëron kështu në Kur’an:

إِنَّمَا تُنذِرُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُم بِالْغَيْبِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ
وَمَنْ تَزَكَّى فَإِنَّمَا يَتَزَكَّى لِنَفْسِهِ وَإِلَى اللَّهِ الْمَصِيرُ

“... Ti mund t’i paralajmërosh vetëm ata që frikësohen nga Zoti edhe pse nuk e shohin, dhe ata që falin namaz. Kush pastrohet, pastrohet vetëm për dobi të vet. Më në fund, arritja është te Allahu!” (Fatir, 18)

Në ajet deklarohet se frikësimi i bashkësive të profetëve me pasoja përfundimtare të rënda do t’u bëjë dobi vetëm njerëzve që i kanë të mbushura zemrat me impresionimin nga Allahu edhe pse nuk e shohin Atë, që falin namaz dhe që e zbukurojnë pamjen me adhurim.

Personi mëkatar do ta heqë vetë pasojën e mëkatit të vet dhe askush nuk do t’i bëhet ortak. Edhe mirësitë e kryera do t’i sjellin dobi vetëm personit që i ka kryer. Edhe personi i pastruar do të pastrohet në favor të vet.

Fjala “tezekka” e ajetit përfshin edhe impresionimin dhe frikën nga Allahu dhe faljen e namazit me përsëritshmëri.

Ajeti **“Allahun e kanë frikë me kuptimin e vërtetë të fjalës, vetëm dijedarët!”** (Fatir, 28) pohon se personi ndjen frikë nga Allahu në atë masë që ka njohuri. Zemrat e personave që nuk dinë gjë për Zotin dhe që nuk ndjejnë frikë prej Tij, janë të vdekura. Paralajmërimi dhe këshilla nuk ndikojnë mbi ta. Këtë e tregon edhe pohimi në ajetin e shtatëdhjetë të sures Jasin, **“(Profeti) t’i paralajmërojë të gjallët (në zemër me anë të Kur’anit)...”**. Pra, brenda duhet të ketë frikë, kurse jashtë një namaz i rregullt.

Shpërblimi (kundërvlera) i pastrimit nga mëkatet është xhenneti dhe gradët e tij të larta. Në Kur’an urdhërohet:





“Dhe gradët e larta janë pikërisht për atë që arrin te Ai si një besimtar që ka bërë punë të mira, janë xhennetet e Adnit ku rrjedhin lumenj dhe ku ata do të mbeten përgjithmonë! Ja, ky është shpërblimi për ata që pastrohen!” (Taha, 75-76)

Shpërblimi i çlirimit nga lidhja e zemrës pas tjetërkujt veç Allahut është dhuntia *Xhemalullah* (Bukuria e Allahut), një meritë përtej meritës së xhennetit ku do të soditen shfaqjet e e papërshkrueshme të bukurisë së Allahut të Lartë. Për atë që kthehet denjësisht nga Allahu me pëlqimin dhe vullnetin e vet, nuk mbetet ndonjë mendim tjetër veç Tij. Edhe njohja e Allahut, e emërtuar marifetullah, fillon me mësimin e të vërtetës së nefsit pas pastrimit të tij. Këtë kuptim ka e vërteta “kush njeh vetveten, njeh Zotin e vet”!

Çdo besimtar, duke hyrë shpesh në “larje hesapesh” me nefsin ose vetveten, duhet ta korrigojë seriozisht gjendjen e vet moralo-shpirtërore dhe ta vërë atë nën kontroll. Në shkencën shpirtërore, kjo emërtohet “vetë-llogari”. Të paktën një herë në njëzet e katër orë, kur të mbështesë kokën në jastëk, njeriu duhet ta marrë veten në pyetje dhe të bëjë llogarinë e asaj dite. Për ata që e kthejnë këtë në shprehi, lehtësohet shpëtimi nga këmbëngulja në gabim.

Në lidhje me këtë specifikë, le të dëgjojmë këto këshilla dhe porosi të Hz. Imam Gazaliut:

“Besimtari, pasi ta falë namazin e mëngjesit dhe para se ta fillojë ditën e re, duhet të ulet për të biseduar kokë më kokë me nefsin, vetveten, dhe të merret vesh me të. Kështu bën edhe tregtari me ortakun e vet të cilit ia dorëzon në mëngjes mallin. Ai jo vetëm ia dorëzon mallin, por edhe ia tërheq vëmendjen për disa gjëra. Edhe njeriu duhet t’ia tërheqë vëmendjen nefsit dhe t’i sugjerojë këto gjëra:

“Kapitali im është jetëgjatësia ime. Po të më marrë fund jeta, më merr fund edhe kapitali bazë, edhe fitimi. Por ja ku filloi një ditë e re. Allahu më fali edhe një ditë jetë! Po të më kishte bërë të vdes, sigurisht do të kërkoja të kthehesha qoftë edhe një ditë të vetme për të bërë punë të mira. Tani, o nefsi, pranoje se vdiqe, por t’u dha mundësia të kthehesh prapë. Prandaj, sot kurrsesi mos iu afro mëkatit dhe gjërave të kota dhe kurrsesi mos e shpenzo kot edhe një çast të vetëm, sepse çdo frymëmarrje është një dhunti e paçmueshme!

Dhe dije se një ditë përbëhet prej njëzet e katër orësh ku futet edhe nata. Ditën e kiametit, para njeriut sillen për çdo ditë njëzet e katër kuti të





mbyllura. Kur njeriu e hap kutinë e parë dhe sheh se ajo është e mbushur plot dritë si shpërblim për aktet e bëra prej tij në atë orë, gëzohet aq sa, po ta ndante atë gëzim me njerëzit e xhehennemit, ata nuk do ta ndjenin dhimbjen e xhehennemit. Kur e hap kutinë e dytë dhe prej saj dalin errësirë dhe kundërmime të ndyra të cilat janë produkte të orës së kaluar me mëkat, personi dëshpërohet aq shumë sa, po t'u shpërndahej ky dëshpërim njerëzve të xhennetit, ata do ta humbnin kënaqësinë e xhennetit. Pastaj hapet kutia e tretë që del krejt e zbrazët. Ajo është ora e kaluar me gjumë ose punë të kota. Dhe njeriu përpëlitet në dhimbjet e kalimit të kotë të asaj ore.

Atëherë, o nefsi im, sa e ke në dorë, mbushe kutinë, mos e lër bosh, mos bjer në përtaci se, pastaj, bie nga gradët e larta!"

Edhe gjymtyrët e trupit janë ndihmës të nefsit. Njeriu duhet t'i këshillojë dhe porosisë gjymtyrët posaçërisht, sipas detyrave që kanë dhe duhet t'ia sugjerojë nefsit që të mos i ngatërrojë gjymtyrët, të cilët janë amanete, me punë të këqija.

Ai duhet ta pengojë **syrim** nga shikimi i gjërave të ndaluara (haram) dhe gjërave të kota e të padobishme.

Ai duhet ta pengojë **gjuhën** nga thashethemet, shpifjet, gënjeshtat, bartja e fjalëve, vetëlavdërimet, poshtërimi i të tjerëve dhe ta preokupojë vazhdimisht me dhikr dhe fjalë të mira.

Ai duhet ta pengojë **stomakun** nga ushqimet e ndaluara (haram) dhe të dyshimta dhe ta mësojë që edhe ushqimet e lejuara e të bekuara (hallall), t'i konsumojë në nivel të ulët të mjaftueshëm.

Në çdo lëvizje që bën, njeriu përballet me shumë gjëra të zakonshme, prandaj, sukcesi më i madh është shmangia nga preokupacionet e kota. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

"Braktisja e gjërave të panevojshme është, për njeriun, rrjedhojë e qenies musliman!" (Tirmidhi, Zuhd, 11; Ibni Maxhe, Fitn, 12)

Pra, të folurit e një muslimani të vërtetë duhet të jetë dhikri, vështrimi, mësimnxjerrës, dhe heshtja, meditimi!

Ja, pra, nefsi duhet mbajtur vazhdimisht zgjuar nga indiferentizmi me të tilla sugjerime.

Një nga specifikat që nuk duhen nënvleftësuar duke i kërkuar llogari nefsit, është që njeriu duhet ta hetojë vetveten nëse akti që ka bërë është për hir të Allahut apo për nefsin e vet, sepse, kohë më kohë, njeriu, ndërsa





pandeh se ka kryer punë të mira për hir të Allahut, mund të ketë vepruar për të kënaqur ndjenjat subjektive.



Në përfundim të pastrimit të nefsit, zemra kthehet në gjendje të paqëtuar (selim). Në etapën e zemrës së paqëtuar vëzhgohen këto tri gjendje:

1) Personi nuk ngacmon askënd. Kjo është gjendja e njerëzve që ruhen. Zemra ruhet nga e keqja e nefsit. Formësohet morali i bukur.

2) Personi nuk ngacmohet nga askush. Kjo është gjendja e njerëzve që ndjejnë afërsi (muhabbet) ndaj Zotit (që ndjehen konfidentë të Zotit). Për ta nuk kanë asnjë rëndësi lavdërimet apo sharjet e njerëzve të vdekshëm, prandaj dhe nuk ndjejnë ngacmim nga askush edhe sikur të ngacmohen. Siç nuk do të kishte asnjë lloj vlere ndezja apo shuarja e një drite në prani të diellit.

3) Kur i vihen ballëpërballë interesi material i kësaj bote me jetën e pasme (ahiret), personi, duke zgjedhur ahiretin, synon pëlqimin hyjnor.

Përmbledhja e të gjitha këtyre që thamë, është kështu:

Në këtë botë për të cilën deshi të ishte një botë prove, Allahu ka vënë para çdo njeriu pengesën nefs dhe i ka vënë për detyrë njeriut që, pasi t'i kapërcejë të gjitha vështirësitë që do t'i shkaktojë nefs, të kthehet fitimtar te Ai. Nefsi është një mjet i aftë për t'u bërë pretext edhe për të mirë, edhe për të keq. Për rrjedhojë, nefs është edhe një portë fitimi, edhe një gropë humbjeje nëse shkohet pas tij. Kurse begatia dhe përfitimi i pastrimit të nefsit është aq i madh sa të mos mund të krahasohet me asgjë në botë.

Zoti na bëftë të gjithëve nga ata që dalin fitues mbi nefs!

Amin, ashtu qoftë!





Njeriu i pastruar nga nefsi është një mrekulli arti e artistit absolut, Zotit të vet, sepse është pasqyrë e të gjitha shfaqjeve të bukurisë hyjnore.



3. GRADET E NEFSIT

Gjendjet dhe gradët e nefsit që vëzhgohen gjatë edukimit dhe zhvillimit moralo-shpirtëror, sipas klasifikimit të njohur, trajtohen në shtatë lloje:

a) Nefsu'l-Emmare (nefsi urdhërues, imponues)

Është nefsi kryengritës më i keq i cili, duke e larguar robin nga Zoti i vet, e provokon dhe e nxit për të bërë të këqija. “Emmare” do të thotë “shumë urdhërues” (imponues, nxitës, provokues). Synimi i vetëm i nefsit me këtë cilësi është t’i kënaqë pa masë dëshirat dhe pasionet e veta. Është nefsi i shtënë pas qejfit dhe kënaqësive, i cili është bërë rob i epshit dhe ndihmës i shejtanit.

Edhe pasiviteti ndaj epsheve që janë pasionet dhe kërkesat e skajshme të nefsit, si dhe hyrja në rrugën e shejtanit në përshtatje me dëshirat e tij, janë pjesë e gjendjes së personave që ndodhen në nivelin e nefsit urdhërues, imponues.

Në të vërtetë, nefsi emmare është për njeriun më i rrezikshëm se shejtani. Këtë specifikë, Ibni Ataullah el-Iskenderi e shpjegon kështu:

“... Ti ki frikë me të vërtetë nga nefsi yt i cili punon kundër teje. Për më tepër, ai s’ndahet nga njeriu gjer në vdekje. Kurse shejtani të paktën në ramazan largohet prej njeriut, sepse në ramazan, shejtanëve u vihen pranga. Ndërkaq, rastet e krimeve, vjedhjeve dhe imoraliteteve që ndodhin edhe gjatë muajit të ramazanit, nuk janë pasojë e mashtrimit të shejtanit, por e tërbimit të nefsit.

Pohimi si më poshtë i Zotit është për nefsin e kësaj grade:

إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ

“Pa dyshim, nefsi e urdhëron (imponon) me forcë të keqen!” (Jusuf, 53)





Përsa i përket pozitës që ka në botën moralo-shpirtërore të njeriut, nefsi emmare është përngjasuar qysh në krye të herës me një gjarpër. Poeti Nevizade Atai e shpreh këtë poetikisht kështu:

*Morali i ulët në gjarpër u kthye;
Mbreti i gjarpërit, nefsi emmare!*

Prandaj, çdo besimtar me mendje të shëndoshë është vazhdimisht në gjendje lufte me nefsin urdhërues. Në këtë luftë nuk mund të mendohet një dëm më i madh se futja e shpatës së mendjes dhe vullnetit në millin e indiferentizmit. Sepse nefsi, duke përfituar nga një çast indiferentizmi të sa e sa njerëzve me merita të larta shpirtërore, është bërë faktor për disfatën dhe fatkeqësinë e tyre të përjetshme. Nga kjo kanë bërë dhe bëjnë përjashtim vetëm robtë principialë e të sinqertë që i ndihmon dhe mbron Allahu.

Me të vërtetë, ngjarja e zhvilluar mes zonjës së ministrit egjiptian, Zylejha, dhe Hz. Jusufit (a.s.), është shumë mësimdhënëse.

Siç tregohet në Kur'an, Jusufi (a.s.) ishte rritur e bërë një djalosh i bukur e i pashëm. Kjo e shtyu Zylejhanë, të zonjën e shtëpisë ku banonte ai, në mendime të tjera.

Zoti e tregon kështu këtë ngjarje:

"... Gruaja deshi të përfitonte nga nefsi i tij. I mbylli mirë dyert dhe i tha: "Ty po të them! Kthehu prapë!" Kurse ai i tha: "(Hasha, më ruajttë Zotit!) Mbështetem te Allahu! Burri yt është mirëbërësi im, ai u soll mirë me mua! E vërteta është se mizorët kurrë nuk gjejnë shpëtim!"

"Me të vërtetë, gruaja kishte vënë si qëllim ta fuste në dorë atë. Po qe se ai nuk do ta kishte parë shenjën dhe paralajmërimin e Zotit tënd, do t'i jepej asaj. Ja, kështu ia treguam Ne provat tona për ta larguar të keqen prej tij. Pa dyshim, ai ishte ndër robtë tanë të sinqertë!" (Jusuf, 22-24)

Me favorin dhe bujarinë e Allahut të Lartë, Jusufi mori ndihmë moralo-shpirtërore dhe shpëtoi nga prirja ndaj Zylejhasë që përfaqësonte nefsin emmare. Edhe ne, robtë e dobët të Zotit, duke iu drejtuar Zotit me devocion, jemi të detyruar ta mbajmë veten larg të keqes së nefsit tonë dhe situatave të rrezikshme të krijuara prej tij.

Mbi këtë urtësi mbështetet fakti që Zoti ynë i lartë na ka urdhëruar ta mbrojmë veten edhe nga fillimet. Madje, të disa akteve dhe veprimeve me fund tragjik. Për shembull, meqë shikimi me epsh nga një mashkull i një femre të huaj i hap portën adulterit, është ndaluar. E njëjta gjë vlen edhe për të gjitha aktet dhe veprimet e papëlqyeshme.

Me të vërtetë, kjo ngjarje është e mbushur me mësim të mëdha, sepse





shumë elementë që i bëjnë të vështira dhe të rënda provat e kësaj bote të cilat kanë vlerën e një kundërshpërblimi për shpëtimin e përjetshëm, zhvillohen këtu një pas një.

Jusufi (a.s.) ishte një i ri si engjëll dhe me një bukuri tërheqëse legjendare. Të mahnitura para bukurisë së tij, gratë i prenë gishtat pa e ndjerë aspak dhimbjen. Po që se Jusufi (a.s.) do të ishte një plak me ndjenja epshore e të këqija të shuara, as kjo provë nuk do të ishte kaq e vështirë për të, as dhe kjo ngjarje do të ishte kaq mësimdhënëse dhe orientuese.

Në kundërshtim me këtë, Zylejhaja zotëronte tri gjëra ndaj të cilave nefsi, egoja e njeriut, është e shtënë më shumë: pasurinë, famën dhe epshin. Po që se Zylejhaja do të ishte një grua plakë dhe e shëmtuar, edhe Hz. Jusufi (a.s.) i ri nuk do ta kishte të vështirë kalimin e kësaj prove dhe kjo ngjarje nuk do të përbente një shembull kaq me efekt. Mirëpo edhe ajo ishte e re dhe e bukur, edhe ai ishte i ri dhe i bukur, i tillë që mund të bënte për vete shumë vetë. Mbi gjithçka, ajo e kishte mbyllur fort derën e dhomës.

Duke e ftuar Hz. Jusufin me fjalët provokuese e nxitëse, **“hejte lek!”**, **“eja, pra, tek unë!”**, Zylejhaja mori një iniciativë të shëmtuar. Faktin që para kësaj situatë nuk do të mund të qëndronin shumë e shumë vullnete, edhe Jusufi (a.s.), madje mbeti shumë ngushtë, Zoti ynë i lartë na e shpreh me këto fjalë:

“Po që se nuk do t’i arrinin në ndihmë provat tona, edhe ai do të jepej!”

Ja, pra, për të mos iu nënshtuar mashtrimeve të shumë tërheqjeve të tmerrshme të shpalosura para tij, Jusufi (a.s.), duke thënë **“meadhallah”**, **“mos e thënë Zoti”**, tregoi se zgjidhja e vetme është **“mbështetja te Allahu”** me një devocion (takva) të lartë. Dhe kjo tregon se takvaja është domosdoshmëri që ndihma hyjnore të hyjë në etapën e veprimit. Pra, rezistenca ndaj dëshirave të forta të nefsit imponues është e mundur vetëm në sajë të fuqizimit të ndjenjave të devocionit.

Me të vërtetë, një nga provat më të rënda me të cilat mund të përballet një mashkull gjatë jetës, është t’i thotë **“jo”** konsideratës dhe ftesës, veçanërisht në kushte të qeta, të një femre që zotëron të gjitha llojet e elementëve tërheqës, si rinia, bukuria dhe pasuria.

Në një hadith profetik, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), pasi bën të ditur se në ditën e vështirë të kiametit kur nuk do të ketë asnjë hije, shtatë lloj njerëzish do të strehohen nën hijen e arshit, thotë se njëri nga këta **“do të jetë i riu i cili, duke shprehur frikën nga Allahu, e ka hedhur poshtë ftesën për marrëdhënie të një gruaje të bukur e të pushtetshme!”** (Buhari, Ezan, 36)





Njëra nga dobësitë më të mëdha të njeriut është humbja e forcës së vetëmbrojtjes duke rënë i mundur ndaj komplimentit. Por kjo nuk ndodhi tek Jusufi, sepse mbrojtja e Allahut e ruajti për shkak të devocionit dhe për shkak se nefsi i tij i edukuar ndodhej në pozitën e përkryerjes. Mbrojtja hyjnore e bëri të fortë atë përballë dredhive të nefsit imponues.

Një specifikë tjetër nga e cila e vlen të merret mësim, është kjo:

Meqë Jusufi nuk iu përgjigj dëshirës së saj, Zylejhaja e kërcënoi me burg. Por meqë nefsi i pastruar i Jusufit (a.s.) i frymëzonte atij devocionin (takvanë), ai tha:

“Zoti im! Qelia është më e pëlqyer për mua se ato gjëra që m’u propozuan!”

Veç kësaj, fakti që në përgjërimit të tij ndaj Zotit, Jusufi, duke i thënë Atij se **“po të mos e kishte penguar dredhinë e tyre, do të bëhej nga injorantët që u jepeshin atyre”**, parapëlqeu burgun si zgjidhja e vetme e shpëtimtimit nga gjendja ku pati rënë, ishte një shenjë e madhe devocioni për të.

Dhe kjo tregon se e vetmja forcë që mund t’u qëndrojë ftesës **“hejte lek”**, **“eja tek unë”** të të gjitha tërheqjeve të kësaj bote të cilat e zvarrisin njeriun në mëkate, është që në atë çast zemra, duke thënë **“meadhallah”** (mos e thëntë Allahu!), **të strehohet te Allahu!**



Në Kur’an bëhet e ditur se arma më e fuqishme për t’u mbrojtur nga fatkeqësitë e nefsit emmare është takvaja, devocioni. Gjithashtu, një ngjarje e Kur’anit që tregon të vërtetën e nefsit, është kështu:

Në malin Sina, Musait (a.s.) iu komunikua profetësia dhe menjëherë pas kësaj, u urdhërua:

“Hidhe shkopin!” Kur Musai pa shkopin të përdridhej si një gjar-për, iku pa kthyer kokën për të parë pas. Atëherë dëgjoji një zë që i thirri: “O Musa! Kthehu pas, mos u frikëso! Sepse ti je nga ata që ndodhen në siguri!” (el-Kasas, 31)

Allahu i Lartë ia pati treguar fuqinë Musait (a.s.) të shkopi. Edhe Musai, me anë të shkopit, u mësua me fuqinë e Allahut. Pasi Allahu e caktoi profet, i dha konfidencë duke biseduar me të dhe pasi e ngarkoi me disa përgjegjësi, i tha kështu:

“Ç’është ajo që ke në dorë të djathtë, o Musa?” (Taha, 17)

Musai (a.s.) iu përgjigj:

“Është shkopi im. Mbështetem në të dhe u shkund gjethe bagëtime. Kam edhe nevoja të tjera për të.” (Taha, 18)

Pastaj Allahu (xhel’le xhelaluhu) e urdhëroi:

“Hidhe përtokë atë, o Musa!” (Taha, 19)

H.z. Musai e çoi menjëherë urdhrin në vend.





“Dhe e hodhi menjëherë përdhe! Po ç’të shihete? Një gjarpër që zvarritej me nxitim!” (Taha, 20)

Kur e pa këtë, Musai (a.s.) menjëherë filloi të ikte. Por:

“Allahu e urdhëroi: “Merre atë! Mos ki frikë! Tani Ne do ta kthejmë atë në gjendjen e parë!” (Taha, 21)

Në shpjegimin sinjifikativ të ajetit lidhur me hedhjen e shkopit përtokë nga Musai (a.s.), disa komentues janë shprehur se ky akt ka vlerën e një orientimi në botën e brendshme të Hz. Musait.

Pasi Musai (a.s.) përmendi interesat dhe mbështetjet relative të kësaj bote, Allahu (xhel’le xhelaluhu) e urdhëroi t’i hidhte përtokë ato.

Nefsi dhe gjërat e lidhura me nefsin morën trajtën e një gjarpëri. Musait iu tregua e vërteta e nefsit. U frikësua, u drodh dhe iku prej tyre. Atij iu tha në mënyrë sinjifikative:

“O Musa, ky gjarpër është vetë cilësia e lidhjes pas gjërave të tjera veç Allahut. Kur kjo cilësi subjektive i tregohet të zotit në mënyrë të trajtësuar, ai frikësohet prej saj dhe ikën! Ti tashmë je pajisur me atributin e tevhidit. Sa është e drejtë dhe me vend që të mbështetesh në një shkop i cili do të duhej të ishte për ty mbështetje, gjë nga e cila do të kërkoje ndihmë dhe do të përfitoje? Si ndodh që ti thua se bën diçka me atë shkop, se përfiton prej tij dhe se te ai ka dobi të tjera për ty? Hapi i parë në rrugën e tevhidit (besimit islam në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë) është braktisja e shkaqeve, domethënë nënshtrimi dhe dorëzimi absolut. Prandaj, hiq dorë prej çdo lloji kërkesë dhe dëshire!”

Është thënë se:

“Personi që dëgjon thirrjen e të Vërtetës (Zotit) dhe sheh nurin, bukurinë e Tij, braktis çdo gjë tjetër ku mbështetet, veç Zotit. Ai nuk mbështetet më në asgjë tjetër veçse në bujarinë e Tij. Në këtë mënyrë, ai çlirohet nga dëshirat dhe prapësitë e nefsit.”



Është gjithashtu nefsi emmare që e bën njeriun ta braktisë lumturinë e vërtetë dhe mbretërimin e botës së përjetshme për hir të kënaqësive kallpe pesëminutëshe të kësaj bote ëndrre, që e rrëzon njeriun nga kulmi në nivelin më të ulët.

Njeriu i sëmurë nga nefsi emmare (urdhërues, imponues), edhe përballë të vërtetave që do t’i vlenin për shpëtimin e tij, madje, pothuaj ndjen kënaqësi nga kundërshtimi me kryeneçësi dhe mendjemadhësi, nga vështrimi me çudi i personave që ka përreth, nga marrja me thashetheme dhe përfolja pas shpine. Ai nuk mundet të shpëtojë nga shëmtitë e ndaluara fetarisht. Njerëz të tillë janë njerëz që e kanë humbur mendjen, arsytimin dhe kuptimin aq sa t’i braktisin xhennetin, Bukurinë Hyjnore, lumturinë dhe paqen e përjetshme për hir të kënaqësive egoistike dhe të përkohshme





të jetës së shkurtër të kësaj bote, janë njerëz që u janë veshur sytë e zemrës, injorantë dhe indiferentë.

Te nefsi emmare, fryma mbretërore është kthyer plotësisht në rob të frymës shtazore, atributi njerëzor ka humbur, atributi kafshëror është bërë sundues!

Për njerëz të tillë, Allahu urdhëron kështu në Kur'an:

“Me të vërtetë, shumë prej xhindve dhe njerëzve Ne i kemi krijuar për në xhennem. Ata kanë zemra, por me to nuk ndejnë, ata kanë sy, por me to nuk shohin, ata kanë veshë, por me to nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, madje më poshtë se kafshët! Ja, ata janë indiferentët!” (el-A'raf, 179)

Njerëz të tillë, mes euforisë së tmerrshme të indiferentizmit, duke i besuar ende më shumë sesa duhet mëshirës së Allahut, e ngushëllojnë vetveten dhe vazhdojnë të bëjnë mëkate. Të sigurtë se nuk do t'i godasë ndëshkimi i Zotit, thonë:

“Fundja, mëkatimi duke e pranuar se po mëkaton, nuk të çon në mohim! Sidoqë të jetë, një ditë bëj pendesë!”

Mirëpo paralajmërimi i Zotit është shumë i madh:

“O njerëz! Ruhuni nga kundërshtimi i Allahut! Ruhuni nga ajo ditë kur as i ati për të birin nuk do të paguajë gjë, as i biri për të atin! Dijeni se fjala e dhënë nga Allahu është e vërtetë! Kujdes, të mos ju gënjejë jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrijë shejtani duke ju bërë të keni siguri në faljen e Allahut!” (Llukman, 33)

Ja, pra, këto mendime e të ngjashme janë, në të vërtetë, përshpëritje tinzare të nefsit dhe shejtanit, të cilët kërkojnë të sigurojnë kryerjen me lehtësi të mëkateve dhe tregimin e kësaj si normale.

Nga ana tjetër, personat e kredhur në indiferentizmin e nefsit imponues tregohen dembelë për të vrapuar nëpër punë të mira e të dobishme që do t'ua shpëtonin jetën tjetër, kurse të painteresuar për t'u larguar nga të këqijat. Po qe se, për fat, bëjnë një punë të mirë të vogël, e bëjnë të madhe në sytë e vet dhe lavdërohen vazhdimisht me të. Edhe sikur kohë më kohë të ndejnë pak pendesë për të këqijat e shkaktuara prej tyre, kjo pendesë është e mangët nga fuqia që do të bëhej pretekst për një ndryshim të mbarë në qëndrimin dhe sjelljet e tyre.

Besimtari i këtij niveli është si një i sëmurë që ka nevojë për mjekim. Ndërkaq, mënyra më e mirë që duhet ndjekur në mjekimin moralo-shpirtëror që ai të shpëtojë nga nefsi emmare për të kaluar te nefsi levvame, është vetëllogaria serioze. Robi duhet të mendojë se Zoti i tij i lartë e di çdo gjë, duhet të mendojë pyetjet në varr, llogaridhënien pas ringjalljes, ndëshkimin e rëndë në xhennem dhe ta dëshirojë pendesën. Por, gjatë pendesës, robi duhet ta bëjë përgjërimin ndaj Zotit jo vetëm me fjalë, por,





duke u penduar edhe me zemër, me një sinqeritet të madh. Po qe se, duke u penduar me gojë, në zemër sundon dëshira për ta bërë përsëri atë mëkat kur të bjerë rasti, pendesa bëhet e papranueshme. Përkundrazi, kjo është pendesë hipokriti, madje, është pendesë nevojtare për pendesë. Ndërsa në një rënë anë bëhet pendesë, në anën tjetër vazhdohet me mëkate, kjo do të thotë të nënvleftësohet pozita ndaj të cilës bëhet pendesë dhe nga e cila kërkohet falje, do të thotë të tallesh me të. Pendesë do të thotë të pendohesh me të vërtetë dhe, duke hequr dorë nga të këqijat për të mos u kthyer më tek to, të kërkosh falje nga Zoti.

Nga ana tjetër, për të shpëtuar nga nefsi emmare, njeriu, duke respektuar të paktën konkluzionet dhe urdhrat legjislativë fetare të domosdoshme, të përpiqet për t'u thelluar në frymën dhe të vërtetën e Fjalës së Njësisë (Tevhid). Të gjitha dëshirat dhe pasionet që janë shndërruar në zemër pothuaj në idhuj dhe që e shmangin robin nga Zoti, duhen mohuar qysh me të thënë **"la ilahe"** dhe të gjitha synimet përveç Allahut duhen fshirë nga zemra. Pastaj, duke e fiksuar të vërtetën **"il'allah"** në truallin e pastruar të zemrës, duhet përpjekur për t'ia përkushtuar zemrën vetëm Allahut. Në këtë mënyrë, robi, duke e kuptuar se është i dobët dhe se s'është asgjë, duhet të përpiqet që në besim të përparojë nga imitimi në arsyetim dhe vërtetim. Nëse besimi gjen vend në zemër në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe fiton fuqi, e shtyn robin për në punë të mira dhe, si rezultat, e ngre në pozita të larta!

b) Nefsu'l-levvame (nefsi pendestar)

Ata që duke u penduar dhe duke i kërkuar llogari nefsit emmare, bëjnë përpjekje për të shpëtuar nga gjendja dhe veprimet e shëmtuara të tij, ngjiten drejt nefsit levvame.

Njerëz të tillë, meqë janë pastruar relativisht nga indiferentizmi i vetë-ngushëllimit me anë të mendimit "sidoqë të jetë, Allahu më fal" tek nefsi emmare, nuk e qetësojnë dot veten. Për këtë shkak, e dënojnë nefsin e vet, pendohen e bëjnë pendesë. Në këtë klasë futen ata që ndjejnë pendesë sepse nuk janë bindur, dhe ata që, pasi kanë derdhur lot e janë penduar në kuvendet e dijes dhe kulturës, pastaj kthehen tek të njëjtat të këqija.

Levm do të thotë qortim dhe dënim. Levvame quhet nefsi që ndjen pendesë për të këqijat që ka bërë, për nënvleftësimin dhe të metat e treguara ndaj urdhrave dhe ndalimeve të Allahut, që ndjen vrasje ndërgjegjeje dhe, që, për këtë shkak, e dënon me forcë veten. Personi që ndodhet në këtë pozitë, ka bërë pendesë për disa akte që përfshihen në nefsin emmare, dhe ka shpëtuar. Me fjalë të tjera, është shmangur pak nga indiferentizmi dhe dëshira për të mëkatuar i është pakësuar. Ndërkaq, meqë këto ndjenja nuk janë pjekur mirë, vjen një çast që të mos durojë dot dhe të bjerë sërish në mëkate.





Meqë fryma mbretërore shpëton nga robëria e frymës shtazore dhe ndahet prej saj, menjëherë pas mëkateve shfaqet pendimi. Robi e dënon nefsën dhe bën pendesë. Vetëm se, meqë nefsi nuk është mundur, personi nuk bëhet dot plotësisht i vendosur në pendesë. Njerëz të tillë, edhe sikur të ndjehen të shqetësuar nga mëkatet, nuk shpëtojnë dot prej tyre sepse tek ata ende nuk është zhvilluar vendosmëria e duhur për të kundërshtuar dhe hedhur poshtë ndikimet negative të ardhura nga jashtë. Për shembull, si dikush që futet në mëkate me justifikimin e brendshëm për të mos ua prishur shokëve!

Njerëz të tillë, përgjithësisht janë të gëzuar për të mirat që kanë kryer dhe të dëshpëruar për të këqijat. Ata përpiqen ta mbrojnë veten nga teprimet e dëshirave epshore dhe t'i kundërshtojnë ato. Prirjet për pendesë u janë fuqizuar. Janë ndriçuar pak me dritën e zemrës dhe në po atë masë janë zgjuar nga indiferentizmi.

Tek këta njerëz vihet re shtim në besnikërinë ndaj urdhrave të Allahut të Lartë dhe në aktet dhe punët e mira. Aktet e tyre janë, në përgjithësi, për Allahun. Vetëm se, ngaqë nuk e kanë arritur dot ende me tërë kuptimin e fjalës prehjen dhe qetësinë e dhuruar nga frymëzimet hyjnore, kërkojnë me gjithë zemër që punët e mira që kanë bërë ose bëjnë, të njihen edhe nga njerëzit. Pra, disa vese të këqija të nefsit emmare vazhdojnë të veprojnë, megjithëse robi e dënon veten për këtë gjendje të tij.

Emri i kësaj etape cilësore të arritur nga nefsi përmendet në Kur'an:

وَلَا أُقْسِمُ بِالنَّفْسِ اللَّوَّامَةِ

“**Betohem në nefsin levvame** (pendestar) ...” (el-Kijame, 2)

Po qe se dënimi nga njeriu me forcë i nefsit të vet bëhet vetëm me fjalë të thata, është e qartë se nuk do të mund të merret përfundimi i shpresuar. Sepse mes gradëve *emmare* dhe *levvame* ka një kufi mjaft të hollë e delikat. Po qe se për shkak se njeriu e dënon pak veten, brenda tij shfaqet një gjendje mendjemadhësie, do të thotë se atje, qoftë edhe fshehtas, ende vazhdon sundimi i nefsit emmare.

Zoti urdhëron në Kur'an

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ وَنَعَلْمَا تَوْسُوْسَ بِهِ نَفْسُهُ
وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ





“Me të vërtetë, Ne e krijuam njeriun dhe e dimë se ç’i pëshpërit nefsi atij, sepse Ne jemi më pranë tij se damari i qafës që i rreh!” (Kaf, 16)

Nisur nga kjo, edhe duke e dënuar nefsin, madje, njeriu duhet të ruhet nga mashtrimet e fshehta të nefsit emmare dhe ndjenja e vetësigurisë.

Disa njerëz marrin një qëndrim modest dhe e dënojnë nefsin jo si domosdoshmëri të natyrës së tyre krijuese, por me qëllim për t’i bërë të tjerët t’i quajnë modestë. Kjo gjendje e pasinqertë dhe hipokrite është, në të vërtetë, e ashtuquajtura “krenari modestie” .

Për të qenë i vendosur në pendesë dhe për t’u pastruar prej akteve të këqija, është e mundur vetëm me anë të edukimit moralo-shpirtëror. Po qe se nefsi i gradës levvame ndodhet nën edukimin moralo-shpirtëror dhe bashkë me njerëzit e mirë, shpëton nga aktet dhe veprimet e këqija dhe nuk rikthehet tek to me të gjetur rast. Megjithëkëtë, në zemër i mbeten disa vese të këqija, si urrejtja, zilia dhe mendjemadhësia.¹⁰

Shpëtimi nga niveli levvame për të kaluar në nivelin mulheme bëhet përsëri me anë të lidhjes shpirtërore (rabita) që është një mënyrë me rëndësi e edukimit moralo-shpirtëror. Pra, për t’u ruajtur nga haramet në çdo qëndrim e sjellje dhe për t’i respektuar urdhrat hyjnorë, personi duhet të veprojë duke e ndjerë pranë shpirtërisht prijësin e përkryer të cilit i ka dhënë fjalë dhe e ka bërë udhërrëfyes në edukimin moralo-shpirtëror.

I duhet kërkuar vazhdimisht llogari nefsit, duhet treguar vendosmëri për t’i braktisur gradualisht të gjitha cilësitë e moralit të keq të pranishme në të dhe duhet bërë pendesë. Pastaj duhen bërë përpjekje për t’u pajisur me cilësitë morale të bukura, të kundërta me to. Për shembull, po qe se personi është mendjemadh, duhet të vishet me thjeshtësi dhe modesti. Po qe se është i sëmure nga smira, duhet t’i shohë vëllezërit besimtarë mbi veten dhe, para se të merret me të metat e tyre, të merret me të metat e veta. Duhet të mendojë se besimtari është pasqyrë për besimtarin, se, po e pa me sy të keq, do të shohë tek ai gjëra të këqija dhe e anasjellta, dhe duhet ta preokupojë nefsin me anët e mira të besimtarëve.

Edhe në këtë gradë duhet vazhduar me përmendjen e Allahut, duhet qëndruar larg gjërave të kota dhe duhet përpjekur për ta ndriçuar botën e ndjenjave me dritën e dashurisë dhe afërsisë ndaj Allahut.

c) Nefsu’l-mulheme (nefsi i frymëzuar)

Besimtari i lartësuar në levvame duke ndjerë pendesë, me anë të pendimit dhe pendesës së mëtejshme, me anë të ruajtjes nga mëkatet, me anë

10 Në origjinal: tevazu-u fahr, vetëlavdërim me anë të modestisë. Për shembull, dikush, duke dashur ta tregojë veten, përdor shprehje të tilla, si: “Unë i varfëri e i dobëti, vetëm në tri ditë mund të bëj një hatme!”





të përkushtimit me zemër ndaj orientimit moralo-shpirtëror, arrin në gradën mulheme.

Në këtë gradë, robi, me favorin e Allahut, arrin zgjuarsinë për të diferencuar në mënyrë të ndjeshme të mirën nga e keqja dhe qëndresën ndaj teprimeve të ndjenjave epshore. Ai largohet nga çdo gjë që e bën zemrën indiferente ndaj Allahut. Tashmë ai mbushet me dyshimin mbi pozitën ku ndodhet jo më shumë para njerëzve sesa para Zotit. Të vërtetat e besimit në zemrën e tij janë në gjendje zhvillimi të vazhdueshëm.

Emërtimi “mulheme” i nefsit të kësaj grade vjen nga ajeti kur’anor:

“Betohem në nefsin dhe në Atë që, duke e formësuar nefsin në përputhje me qëllimin e krijimit të tij, i frymëzon atij mëkatin dhe devocionin!” (esh-Shems, 7-8)

Nefsi mulheme është nefsi i merituar për frymëzimin hyjnor. Ata që e përjetojnë këtë etapë të nefsit, me anë të begatisë së respektimit të konsiderueshëm të urdhrave dhe ndalimeve hyjnore, nisin të marrin pjesë nga të vërtetat hyjnore, nga afërsia hyjnore dhe zbulimi mistik. Njeriu arrin pjekurinë shpirtërore për të merituar frymëzimet hyjnore. Ndërkaq, për të kuptuar nëse këto frymëzime janë hyjnore, absolutisht është nevoja e kontrollit të një prijësi shpirtëror.

Sepse edhe nëse si rezultat i përpjekjeve, nefsi është në gjendje të mundur, prapë nuk rri kot, por vazhdon ta preokupojë zemrën me dredhi dhe dyshime të fshehta për ta rrëzuar frymën mbretërore nga pozita e fitimtarit. Për këtë shkak, dorëzimi (tevekkul) dhe nënshtrimi (teslimijet) i personave të gradës mulheme ndaj Zotit nuk është i përkryer. Pra, përkryerja formale dhe praktike ende nuk është realizuar në botën e brendshme.

Edhe nëse veset e këqija shpesh nuk kalojnë në zbatim, vazhdojnë të jenë të pranishme; ende nuk është kaluar dot nga bota e shkaqeve formale në klimën e të vërtetës, prandaj nuk janë hedhur dot ende plotësisht lëkundjet, iluzionet, fantazitë, pasionet dhe ngushtimet e zemrës, nuk është arritur ende dot qetësia dhe lumturia e dorëzimit të Zotit. Zemrat vuajnë nga shqetësimet për kërkesat e jetesës së përditshme dhe për të ardhmen. Ndërsa u është dhënë rizku (racioni jetësor) i sotëm, ndjejnë shqetësim për rizkun e të nesërme. Edhe nëse e pranojnë formalisht atributin “Rezzak” (furnizues, dhënës i rizkut, ushqyes) të Allahut, mund të mbeten, ndoshta pa e kuptuar as vetë, në nivelin e mosbindjes për këtë atribut hyjnor. Edhe në situatat e tjera të ngjashme me këtë, pëlqimi ndaj paracaktimit hyjnor (takdir), nënshtrimi dhe dorëzimi ndaj Zotit kryhen në mënyrë të sipërfaqshme dhe imituese ngaqë nuk janë realizuar ende me zemër dhe në mënyrë vërtetuese.

Edhe në këtë etapë, duke braktisur gjërat që dëshiron nefsi dhe duke i bërë ato që nuk i dëshiron, është bërë një farë përparimi në edukimin e nefsit. Por, edhe nëse fryma shtazore është mundur, shprehitë e pastra dhe





morali i bukur që e kanë burimin nga fryma mbretërore, nuk janë shtresuar plotësisht.

Shtresimi i tyre nuk mund të bëhet vetëm duke braktisur gjërat që i pëlqejnë nefsit për të bërë ato që s'i pëlqejnë, pra, vetëm me praktikë dhe luftë (rijazet dhe muxhahede). Krahas kësaj ka nevojë edhe për përmendjen e Allahut (dhikrullah). Por nëse zemra ndodhet e preokupuar me shqetësime dhe pasione materiale të kësaj bote, nuk mundet të kalojë në etapën "dhikrullah" dhe, si rezultat, në kënaqësi dhe ngopje (itminan). Ndërkaq, për kryerjen e përmendjes së Allahut (dhikrullah) duke respektuar etikën e saj, ka nevojë për orientimin dhe udhërrëfimin shpirtëror të prijësve shpirtërorë.

Atëherë kur robi, jo me synim mjekimi dhe kompensimi, por në një gjendje shijeje e kënaqësie të thellë, mes pasionit dhe ekstazës, fillon ta përmendë Zotin, atë çast arrin formën e vërtetë të zikrit (dhikrit). Atë kohë, me anë të frymëzimeve hyjnore, njihet me të fshehtat e gjithësisë, mbetet i mahnitur nga rrjedhat e fuqisë hyjnore të ekspozuara aty dhe zemra i ngopet. Pastaj fillon të përfitojë nga urdhri hyjnor si në ajetin në vijim dhe fjalët i bëhen të bukura e të urta, sepse tashmë ai është bërë një rob i merituar për frymëzimin hyjnor:

ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ

"(O i Dërguar!) Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë!" (en-Nahl, 125)

Në këtë nivel, sa më shumë që të përparohet, aq më shumë fryma shtazore, domethënë, nefsi, fillon t'i nënshtrohet urdhrin mbretëror, për rrjedhje, të shpëtojë nga ndikimi prapësues i prirejeve të ulta. Shtohet forca e durimit dhe lejueshmërisë, fitohet një nivel i lartë në thjeshtësi, në përkori dhe bujari.

Ndërkaq, nuk duhet kapur nga pandehma sipas së cilës njeriu "është bërë diçka". Nga ana tjetër, duke arritur në horizontin e pikëpamjes që do ta mendonte jetën e kësaj bote pa harruar jetën e pasme, ahiretin, duhet arritur pjekuria e meditimit mbi vdekjen.

Kështu, Profeti (s.a.s.) ka porositur:

"Kujtojeni shpesh vdekjen, sepse sjellja ndërmend e vdekjes e pastron njeriun nga mëkatet, e bën njeriun të distancohet nga kjo botë. Po qe se jeni i pasur dhe e kujtoni vdekjen, ju shpëton nga fatkeqësitë e pasurisë. Po qe se jeni i varfër, ju bën të kënaqur nga jeta!" (Sujuti, *Xhamiu's-Sagir*, I, 47)

Udhëtari i udhës së edukimit mistik, nefsi i të cilit ka arritur këtë gradë, duhet të ketë vendosmërinë për të përjetuar domosdoshmërinë e kësaj porosie të Hz. Umerit (r.anh):





“Para se të merreni në llogari, kërkojini llogari vetvetes. Peshojini një herë punët tuaja para se të peshohen në peshoren hyjnore. Para se të dilni në audiencën e Zotit për të cilin nuk mbetet e fshehtë asnjë punë e juaja, përgatituni për atë gjyq të madh!” (Ibni Kethir, Tefsir, I, 27)

d) Nefsu'l-mutmainne (nefsi i ngopur e i kënaqur)

Është nefsi i cili, duke i respektuar denjësisht urdhrat e Zotit dhe duke u ruajtur me rreptësi nga ndalimet e tij, ka shpëtuar nga sëmundjet moral-shpirtërore dhe, me anë të një besimi të vërtetë e të fuqishëm, ka arritur qetësinë, prehjen dhe kënaqësinë e plotë. E fshirë nga dyshimet dhe lëkundjet me begatinë e përmendjes së Allahut, zemra është çdo çast në gjendje falenderimi dhe lavdërimi ndaj Zotit.

Në këtë gradë, vetitë e këqija e të shëmtuara ia kanë lënë vendin moralit të bukur. Morali i lartë i Profetit (s.a.s.) i cili, për sa i përket pjekurisë së sjelljeve, përbën kulmin dhe është model për tërë njerëzimin, përjetohet bukur me një kënaqësi të papërshkruar. Zemra e robit është kurorëzuar me durim, dorëzim, nënshtrim dhe pëlqim. Mutmainne është nefsi i atyre, zemra e të cilëve është e zënë vazhdimisht me përmendjen e Zotit. Ata e njohin edhe anën e brendshme të konkluzioneve legislative fetare.

Imam Rabbani ka thënë:

“Adhurimet e bëra gjer në gradën e nefsit mutmainne kanë karakter imitues. Kurse në gradën e nefsit mutmainne këto kthehen nga imitimi në arsyetim dhe vërtetim!”

Lartësimi në vërtetim në detyrën e robit ndaj Zotit do të thotë arritje e pozitës “hakikat” (e vërteta) të radhitjes hierarkike shariat-tarikat-hakikat-marifat. Kjo përkryerje e arritur sjell me vete edhe një ndjeshmëri të lartë në mendësinë e përgjegjësisë, ashtu që ata që s’kanë pjekuri mendore sipas kritereve të legjislacionit fetar, nuk konsiderohen përgjegjës për zbatimin e konkluzioneve dhe urdhrave fetare. Përgjegjësia fetare u përket vetëm personave me zhvillim mendor normal.

Si kjo, edhe nxënësi që i ka hyrë njërës prej rrugëve mistike, gjer kur ta plotësojë udhëtimin mistik, duke u pranuar si një fëmijë i pafajshëm, shihet me mirëkuptim për të metat në etikën e tarikatit. Në tarikat, nxënësi konsiderohet se e ka arritur pjekurinë (ruzhd) vetëm pasi ta ketë plotësuar udhëtimin mistik. Vetëm atëherë bëhet përgjegjës për gabimet e kryera ndaj etikës së tarikatit, siç është sheriati. Ndërkaq, ende nuk quhet përgjegjës për të metat dhe gabimet që kanë të bëjnë me aspektin “hakikat”. Kjo gjendje papërgjegjësie kthehet në përgjegjësi sapo personi të hedhë hapin në shkallën mutmainne, sepse në mutmainne arrihet pjekuria me aspektin “hakikat”.

Është për këtë arsye që disa gjëra që në shariat janë normale (mubah), në tarikat konsiderohen si mëkate të vogla. Kurse gjërat që janë mëkate të





vogla në tarikat, në hakikat dhe marifet quhen serioze e të rëndësishme si mëkatet e mëdha.

Për shembull, në shariat, ngrënia pas ngopjes është shpenzim i tepërt, shpërdorim. Kurse në tarikat, shpërdorim është ngrënia gjer në ngopje. Në hakikat, ngrënia e sasisë së mjaftueshme duke qenë indiferent për praninë e Allahut (duke e harruar praninë e Allahut) është shpërdorim. Në marifet, përveç të gjitha këtyre, ngrënia pa parë te të mirat shfaqet hyjnore është shpërdorim, sepse Zoti parashtron në çdo gjë një shenjë të ekzistencës së vet. Kjo vlen edhe për të gjitha specifikat e tjera.

Ja, pra, duke arritur të vërtetën, qetësinë dhe njohjen evidente¹¹ me anë të bujarisë dhe suksesit të dhënë nga Zoti, nefsi mutmainne ka shpëtuar nga dëshpërimi dhe dyshimet dhe ka merituar disa frymëzime dhe zbulime.

Në këtë gradë, perdet e indiferentizmit mbi zemër janë ngritur. Zemrat janë kah i vëzhgojnë botët përtej dhe të vërtetat në nivelin e sigurisë kategorike (ajneljakin). Domethënë se zemra është pastruar nga lëkundjet dhe dyshimet dhe, me një nënshtrim të plotë, ka arritur kënaqësinë dhe qetësinë e plotë. Robi i cili ka arritur këtë gjendje, i pranon dhe i kryen bukur përgjegjësitë fetare pa lëkundje formale e përmbajtësore. Mbi të gjitha, ky pranim dhe kjo bindje janë aq të shëndosha sa, sikur e gjithë bota të ngrihen bashkë e të pretendojnë të kundërtën, tek ai nuk shfaqet as lëkundja më e vogël. Sepse tashmë ai është kah e sodit botën materiale e shpirtërore nga dritarja e hakikatit, të vërtetës absolute e përfundimtare.

Kur magjistarët e faraonit e panë me sytë e tyre dhe e përjetuan mrekullinë e treguar nga profeti Musa si dhe dështimin e magjisë së tyre, pohuan besimin duke e dhënë jetën me dëshirë për të. Ata e kundërshtuan pa frikë faraonin:

“... Fundja, ne kemi për t’u kthyer te Zoti ynë! Ti merr shpagim prej nesh vetëm pse u besuam argumenteve të Zotit tonë kur na erdhën neve. Zoti ynë! Jepna shumë durim dhe na e merr jetën si muslimanë!” (el-A’raf, 125-126)

11 Në original: yakin (jakin), evidencë, evident. Është një fjalë arabishte që emërton informacionin (dijen) kategorik dhe krejt të qartë. Në jakin nuk ka dyshim. Zemra është plotësisht e kënaqur me të vërtetën e një gjëje. Gjithashtu, jakin, duke kaluar përtej argumenteve, shpreh shikimin krejt të hapur me anë të fuqisë së besimit. Kushhejriu thotë se jakini është tre llojesh: **ilmel yakin** (evidencë informative ose evident me burim informativ): dije mbi një gjë e mbështetur në informacion. **aynel yakin** (evidencë me të parë ose evident me të parë): dije mbi një gjë e mbështetur në të parë. **hakkal yakin** (evidencë me të jetuar ose evident me të jetuar): dije mbi një gjë e mbështetur në përvojën jetësore mbi të. (Shënim i origjinalit)





Meqë në gradën mutmainne, vendin e dendësisë dhe padukshmërisë njerëzore e cila, pas njohjes së të vërtetës evidente jo vetëm me sy, por edhe duke e përjetuar, zhduket për t'ia lënë vendin shfaqjes së tejdukshmërisë së të vërtetës esenciale, nefsi mutmainne bëhet i merituari i konsideratës hyjnore:

يَا أَيَّتُهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ

“O ti nefsi i kënaqur plotësisht!” (el-Fexhr, 27)

Siç shihet, nefset e gradëve poshtë gradës mutmainne nuk janë bërë të denjë për konsideratën hyjnore. Vetëm nefsi mutmainne që ka arritur ngopjen dhe kënaqjen (itminan) si dhe nefset e gradëve më të larta se kjo, janë të denjë për këtë konsideratë. Ndërkaq, për t'u bërë i denjë për konsideratën hyjnore, duhet bërë përpjekje e madhe dhe duhet treguar zell i madh për ta vënë nefsin nën bindje.

Robtë fatmirë që kanë merituar gradën mutmainne, drejtohen drejt tre gradëve të tjera më të larta që quhen radije, merdije dhe kamile, përmes të cilave, në raport me suksesin, arrijnë kulmin e afërsisë dhe konfidencës hyjnore.

e) Nefsur-radije (nefsi në pajtim me Zotin)

Është nefsi i cili, duke iu drejtuar vazhdimisht Zotit, ka arritur vetëdijen e qenies së bashku me Allahun, i cili, i nënshtruar urtësisë dhe vendimit të Allahut, është bërë plotësisht i kënaqur dhe ka rënë plotësisht në pajtim me Të. Robi i ngjitur në këtë gradë, duke hequr dorë nga vullneti i vet, është shkrirë në vullnetin e Zotit.

Ajeti i mëposhtëm i Kur'anit është pjesërisht shprehje e kësaj grade, së cilës i takon vetëm pjesa e parë, **“i pajtuar ti me Të”**:

ارْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَةً

“Kthehu te Zoti yt i pajtuar ti me Të dhe Ai me ty!” (el-Fexhr, 28)

Kjo gjendje pajtimi është tregim durimi ndaj të gjitha provave të mundimshme të ardhura nga Zoti dhe pranim, në këtë drejtim, me gjithë zemër i vullnetit të Tij. Në ajetin kur'anor urdhërohet:

“Me të vërtetë, do t'ju provojmë ju me pak frikë, me pak uri dhe duke ua pakësuar mallrat, jetët dhe prodhimet tuaja! Dhe përgëzoi durimtarët!” (el-Bekare, 155)

Qenia nga grupi i **“durimtarëve”** për të cilët flitet në këtë ajet është e mundur vetëm me anë të pëlqimit, pa rënë kurrë në kundërshtim, ndaj





paracaktimit (takdir) të Allahut edhe nëse ai paracaktim nuk shfaqet ashtu siç shpresohet dhe pritet. Ja, pra, nefsi radije është pozita e atyre që u nënshtrohen pa lëkundje, me pëlqim dhe pa u ankuar kurrë të gjitha vendimeve aksidentale (kaza) të vullnetit hyjnor, të cilat shfaqen si e mirë ose e keqe.

Provat e këtij posti janë më të rënda se të të tjerave. Sepse sa më shumë që të lartësohet njeriu, aq më shumë i shtohen mundimet. Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

“Nga njerëzit, profetët janë ata që kanë pësuar mundimet më të rënda. Pastaj vijnë njerëzit me gradën më të afërt ndaj tyre. Njeriu u nënshtrohet mundimeve në raport të drejtë me thellësinë e besimit!” (Tirmidhi, Zuhd, 57)

Vetëm pas kapërcimit të pengesës nefsi njeriu mund të arrijë kapacitetin për të treguar denjësisht durim ndaj vështirësive dhe mundimeve dhe për të qenë plotësisht në pajtim me atë që ia jep ato. Këto janë kthesat e rrugës së lartësimit shpirtëror. Prandaj ndodh që sukseset e mëdha vijnë gjithmonë pas qëndresës, durimit, vendosmërisë dhe tolerancës së lartë.

Në vështrimin e besimtarëve të kësaj grade, hidhërimi dhe gëzimi i jetës janë një, sepse, meqë s’janë të lidhur pas botës me zemër, hidhërimet dhe gëzimet e jetës për ta kanë marrë vlerë të barabartë. E mirë apo e keqe, çfarëdo që të jetë përcaktuar për ta, i njohin si të ardhura nga Zoti dhe i pranojnë me pëlqim.

Ja si e shprehin vargjet e mëposhtme këtë gjë:

*E këndshme është për mua çdo gjë që më vjen Teje,
Dhe në qoftë gonxhe trëndafili, dhe në qoftë gjemb,
Dhe në qoftë pelerinë, dhe në qoftë qefin,
I këndshëm në qoftë favor, dhe në qoftë ndëshkim!*

Ndërkaq, vështirësia e përballimit në jetë të këtyre të vërtetave të shprehura me kaq lehtësi në këtë strofë duhet konceptuar dhe vlerësuar mirë. Këto fjalë apo shprehje të realizuara në gradën radije mund të jenë të parakohshme dhe pretencioze, gjë nga e cila duhet ruajtur me kujdes, sepse, po të ndodhë kështu dhe po qe se Zoti e vë në provë sinqeritetin e robit në këto fjalë, ekziston frika se mos shumë njerëz do të mbeteshin këmbësorë në këtë rrugë!

Robi në pozitën radije fillon të bëhet i informuar për të fshehtën hyjnore. Duke e rrokur në kuptim të plotë unitetin hyjnor, ai meriton të vëzhgojë përsosmërinë në botën e kuptimit. Ai nderohet me meritimin e shfaqjeve të posaçme të emrave dhe attributeve hyjnore. Personaliteti i tij shndërrohet





në një burim të begatshëm të së mirës, së bukurës dhe së drejtës. Njeriu i ndjek me kënaqësi urdhrat dhe ndalimet hyjnore. Adhurimet nuk i shkaktojnë aspak lodhje meqë i kryen me pastërti dhe për hir të Allahut. Sepse në fytyrën e brendshme të adhurimeve që japin lodhje ekzistojnë ose qëllimi për të kapërcyer gradë, ose qëllimi për të merituar aftësi të jashtëzakonshme parashikimi dhe zbulimi shpirtëror (keramet dhe keshf), ose qëllime të ndryshme si këto. Po qe se njeriu ndjek qëllime të tilla, ia mbyll rrugën vetes me to dhe i çon dëm të gjitha përpjekjet që ka bërë e bën. Atëherë, shfaqet një lodhje që të bën ta harrosh dhikrin dhe mendimin. Prandaj, udhëtari i rrugës mistike, nga kreu në fund, s'duhet të ndjekë asnjë qëllim tjetër përveç pëlqimit të Allahut!

Zoti i Lartë është, për ne, robtë e Tij, më afër se damari i qafës që na rreh. E rëndësishme është që edhe ne, duke e kuptuar këtë afërsi, të mund të bëhemi të denjë për afërsinë e Zotit tonë. Zoti bëhet i kënaqur me robtë mjafton që robtë të bëjnë përpjekje në rrugën e Tij, të tregojnë pëlqim dhe pajtim me vendimin dhe aktin e Tij ekzekutues, t' i presin me pjekuri shfaqjet hyjnore që u drejtohen dhe të bien në pajtim me Të!

f) Nefsu'l-merdijje (Zoti në pajtim me nefsin)

Për ata që ndodhen në gradën radije, që të mund të përfitojnë prej të gjitha begative të kësaj grade, duhet që edhe Zoti të jetë i kënaqur prej tyre, të jetë në pajtim me ta. Pra, nuk mjafton që robi të jetë i kënaqur dhe në pajtim me Zotin; për një përparim të përsosur, duhet që edhe Zoti të jetë i kënaqur dhe në pajtim me robin. E shprehur ndryshe, pajtimi ynë me Zotin duhet të jetë i një konsistence dhe bukurie të tillë që nefsi të mund të bëhet i merituar i pëlqimit dhe pajtimit të Zotit. Kështu, radije është grada e atyre që janë të kënaqur dhe në pajtim me Zotin, kurse merdijje, grada e atyre me të cilët Zoti është i kënaqur dhe në pajtim të plotë.

Te nefsi merdijje nga i cili Zoti është personalisht i kënaqur dhe me të cilin është në pajtim të plotë, veset e këqija janë asgjësuar, shprehitë e bukura dhe vetitë morale janë zhvilluar, ashtu që tek ky nefsi, dhembshuria për krijesat për hir të Krijuesit, mëshira, dashuria, bujaria, ndjenja e faljes dhe ndjeshmëria janë në gjendje kënaqësie. Besimtari i kësaj grade e kontrollon dhe e merr në llogari nefsin e vet në mënyrën më të mirë. Duke vëzhguar në çdo frymëmarrje shfaqjet e pretendimit të qenies dhe egoizmit, bën kujdes që të mos ndodhet i papërgatitur ndaj dredhive djallëzore.

Gjithashtu, në këtë gradë, robi i është nënshtruar Zotit në të gjitha kushtet dhe me të gjithë qenien e vet. Duke emigruar në botën e përjetësisë me begatinë e pranimit edhe të shfaqjeve të ndëshkimit, edhe shfaqjeve të





favorizimit të ardhura nga Zoti, është përgëzuar me pëlqimin hyjnor dhe i është veshur rroba e xhennetit.

Këtë situatë e shpreh konkluzioni “... i pajtuar dhe ai me ty” te ajeti “**Kthehu te Zoti yt i pajtuar ti me Të dhe Ai me ty!**” (el-Fexhr, 28) i cituar më sipër.

Veç kësaj, pohimi si më poshtë në ajetin 8 të sures Bejjine është një shprehje tjetër e kësaj të vërtete:

رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ

“... Allahu është bërë i kënaqur me ta, edhe ata janë bërë të kënaqur me Allahun...”

Robi që ka merituar të arrijë në këtë gjendje e të njohë këto të vërteta, tashmë i sodit ngjarjet nga niveli “hakkal jakin” (e vërtetë evidente e jetuar). Me lejen e Allahut, ai mund të njohë disa të panjohura të fshehta. Si rrjedhojë e pajtimit, dorëzimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit, Zoti bëhet pothuaj syri i tyre që u sheh, veshi që u dëgjon, gjuha që u flet, dora që u kap... Ai u dhuron forcë ndikuese gjendjes dhe moralit të tyre.

E thënë ndryshe, shfaqjet e përsosmërisë që i vëzhgoi në pozitën e nefsit radije, tani i shijon vetë në nefsin, veten e vet, dhe i përjeton qenësisht ato situata. Cilësi të larta si durimi, dorëzimi, nënshtrimi dhe pëlqimi janë, tashmë, cilësi sunduese të sjelljeve të tij.

Ja disa shembuj nga morali i lartë i profetëve në lidhje me këto situata të bukura:

Pas prapësive dhe fatkeqësive që i kishin ardhur njëra pas tjetrës, Hz. Jakubi (a.s.) thotë kështu: **“Mua më takon vetëm të duroj në mënyrën më të mirë!”**

Ejubit (a.s.) të sëmure dhe të vuajtur rëndë, e shoqja i thotë “që t’i lutet Zotit që të marrin fund këto vuajtje për të”, kurse ai i përgjigjet:

“Zoti i Lartë më dha tetëdhjetë vjet jetë plot shëndet. Kur nuk kam kaluar edhe po aq vjet me sëmundje, më vjen turp të kërkoj shëndet!”

Edhe Ibrahim (a.s.) u pati thënë kështu engjëjve që i patën shkuar në ndihmë ndërsa po e hidhnin në zjarr:

“Kush e bën zjarrin të ndizet? Ai e di hallin tim! Unë s’kërkoj gjë prej jush!”

Megjithëse etapat që kalohen në rrugën e pastrimit të nefsit përbëhen, në të vërtetë, prej etapave të trajtuara gjer këtu, është edhe një etapë tjetër për sa u përket shërbimeve të dhëna sërës së njerëzve të përkryer, etapa e nefsit kamile ose safije.





Nefsi kamile (i përkryer e i kulluar) është nefsi i kulluar, i kthjellët, i lartë e i pjekur, i pastruar në përfundim të procesit të pastrimit të quajtur tezkije. Është pozita ku njihen të gjitha të fshehtat e njohjes intuitive të Zotit dhe e favorizuar prej Tij vetëm si e dhënë prej Tij! Kjo pozitë është e dhënë e Zotit, nuk arrihet me punë dhe përpjekje. Është një mirësi hyjnore e mbështetur mbi të fshehtë të kaderit.

Meqë atyre që e arrijnë këtë pozitë, u jepet detyra e shërbimit të prijësisë në rrugën e drejtë, kjo pozitë, në të njëjtën kohë, quhet edhe “pozita e orientimit (irshad)” Me anë të përkryerjes dhe përsosmërisë së gjendjes, qëndrimit dhe sjelljes së atyre që ndodhen në këtë pozitë, Zoti krijon një ndikim paralajmërues dhe zgjues të njerëzve nga indiferentizmi. Kur persona të tillë takohen me një mëkatar, ia kuptojnë gjendjen dhe ia tregojnë ilačin e sëmundjeve të zemrës me anë të gjuhës së gjendjes, qëndrimit dhe sjelljes së vet. Duke e kuptuar se kë duhet të marrë shembull dhe se rruga e kujt është e drejtë, mëkatarin të cilit mund t’i jetë vulosur zemra, gjykon dhe, me pendim, zgjohet nga indiferentizmi.





Zemra është fusha ku luftojnë e mira me të keqen, devocioni me mëkatin, pra, forcat engjëjllore me forcat djallëzore. Gjatë një jete të tërë, zemrat trazohen paprerë me këto shfaqje dhe prirje engjëjllore dhe djallëzore.



B. ZEMRA DHE KULLIMI I SAJ

1. Natyra e zemrës

Qëllimi themelor i fesë është të përgatisë njerëz delikatë e të thellë që të jenë të vetëdijshëm për pozitën e tyre si rob të Zotit. Realizimi i këtij qëllimi varet vetëm e vetëm nga njohja dhe kryerja e adhurimit ndaj Zotit. Maturimi i njeriut dhe arritja në një nivel të lartë moral-shpirtëror realizohet në raport të drejtë me emocionin e lartë, drithërimet hyjnore dhe përpjekjet e shenjta në botën e zemrës.

Zemra është qendër e botës sonë trupore e shpirtërore. Ajo ka një rol qëndror në vazhdueshmërinë e jetës trupore. Zemra e cila është kaq e rëndësishme për jetën trupore, është, në të njëjtën kohë, një element shpirtëror që përbën qendrën e fuqisë dhe kapacitetit specifik tek njeriu. Sipas kësaj, me aspektet e saj edhe organik, edhe moral-shpirtëror, zemra është në pozitën e sovranit të qenies njerëzore. Dhe kjo shkon gjer atje sa edhe truri që është qendër meditimi, madje, prodhon ide nën ndikimin e afekcionit të buruar prej saj. Kjo do të thotë se me kapacitetin e saj afektiv që zotëron, zemra luan një rol bazë i cili është sundues mbi të gjitha organet përfshi trurin. Dikujt i cili është i emocionuar, i dridhen duart, i shtohen rrahjet e zemrës. Është një e vërtetë e cila mund të vërehet në të gjitha sjelljet njerëzore se ndjenja të tilla si mëshira, zemërimi, dashuria, etj., të nxitura nga një ndikim i jashtëm, u japin kahje meditimit, vullnetit dhe, si përfundim, lëvizjes.

Ndërkaq, me aspektin e saj moral-shpirtëror, zemra është edhe një busull për gjetjen e të drejtës dhe të të vërtetës. Këtë detyrë ia ka ngarkuar asaj Zoti.

Zoti na e tërheq vëmendjen kështu në Kur'an me qëllim që zemra të mos gënjejë nga kënaqësitë materiale të kësaj bote, për pasojë, personi të mos mbetet i izoluar në botën e përjetshme:





“O njerëz! Sigurisht, premtimi i Allahut është i drejtë. Kujdes, të mos ju gënjejë jeta e kësaj bote dhe djalli hileqar të mos ju mashtrojë ndaj Allahut!” (Fatir, 5)

Poeti i shquar Xhelaledin Rumi-Mevalana (kuddise sirruh), e shpreh kështu domosdoshmërinë e frenimit të dëshirave subjektive në mënyrë që njeriu të mos shmanget nga qëllimi bazë i tij:

“Mos shih ta zhvillosh trupin duke e ushqyer tepër. Sepse ai është një kurban që, më në fund, do t’i jepet tokës. Ti shih ta ushqesh zemrën! Ajo është që do të shkojë lart e do të nderohet!

Jepi pak gjëra të yndyrta e të ëmbla trupit, sepse ai që e ushqen atë më shumë se ç’duhet, bie në dëshira subjektive dhe, më në fund, poshtërohet e mbaron!

Shpirtit jepi ushqime morale e shpirtërore. Të jenë mendimi pjekur, kuptimi i hollë dhe ushqimet shpirtërore në mënyrë që, atje ku do të shkojë, të shkojë i fortë, i fuqishëm!”

Edhe Llukman Hekimi e ka këshilluar kështu të birin si paralajmërim për moskokëçarjen dhe indiferentizmin:

“O bir, kjo botë është një det pa fund. Dijetarët pa kulturë shpirtërore dhe shumë njerëz janë mbytur dhe shkatërruar në të. Anija jote në këtë det le të jetë besimi te Allahu me një zemër të ngopur. Kurse pajisja e anijes le të të jenë devocioni (takva) dhe adhurimi (ibadet). Dhe vela e kësaj anijeje që e bën atë të vozisë në detra, le të të jetë dorëzimi (tevekkul). Vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtosh!” (Bejhaki, *Kitabu’z-Zuhd*, 73)

Zemra si qendër, me një aspekt, e trupit dhe, me një aspekt tjetër e shpirtit, aq sa ç’është e nevojshme dhe e rëndësishme për trupin, në atë masë bart një rëndësi të madhe edhe për jetën shpirtërore. Ngaqë ajo çka e bën njeriun njeri është, më tepër se pamja, struktura shpirtërore, roli shpirtëror i zemrës është, në çdo aspekt, më i madh se roli i saj organik. Është për këtë cilësi shpirtërore dhe në sajë të shumë enigmave dhe urtësive të saj, që zemra është i vetmi faktor i cili i siguron njeriut të arrijë kuptimin dhe vlerën e “njeriut”. Mbi këtë urtësi mbështetet fakti që, para se të realizohet me anë të “pohimit me gojë”, besimi realizohet me anë të “pohimit me zemër”. Të tërheq vëmendjen fakti që këtu, më tepër se pranimi mendor ose ideor, është parë i mjaftueshëm pranimi me zemër.

Ashtu siç ndodh që tek njeriu i cili pranohet si esenca e gjithësisë, e mira dhe e keqja, kapacitetet dhe prirjet e larta e të ulta ekzistojnë së bashku në mënyrë të bashkëlindur, ashtu dhe te zemra, si esenca e njeriut, këto kapacitete dhe prirje antagoniste ndodhen së bashku. Me të vërtetë, zemra është e hapur sa për administrimet engjëjlore të saj, aq dhe për ndërhyrjet djallëzore në të. Mund të thuhet se zemra është fushë lufte mes të mirës dhe të keqes, mes devocionit dhe mëkatit, pra, mes forcave engjëjlore dhe





djallëzore. Zemra kalon një jetë të tërë të trazuar me këto shfaqje dhe prirje engjëlllore dhe djallëzore.

Sa për formën e veprimit të engjëllit dhe djallit në zemër, cilësia engjëlllore vepron mbi të me anë të situatave shpirtërore, si besimi, shprehitë e bukura, punët e mira, dhembshuria për krijesat dhe kryerjen e adhurimeve me përsheptshmëri, kurse cilësia djallëzore i ngjit zemrës situatat e këqija, si mohimi, dyshimi, morali i keq, epshi, pasioni dhe fantazia.

Largimi i djallit nga zemra është i mundur vetëm në sajë të adhurimit dhe përmendjes së Allahut (dhikrullah).

Zemra e cila është fusha e luftës mes cilësive engjëlllore dhe djallëzore, zotëron një strukturë të lëvizshme e të ndryshueshme që futet në radhët e anës fituese dhe që vishet me cilësinë e saj. Zemra është e ndryshme nga organet e tjera përsa i përket çështjes së bindjes dhe nënshtrimit ndaj vullnetit njerëzor. Kapaciteti i bashkëlindur i zemrës për prirjen edhe kah e mira, edhe kah e keqja, vihet në veprim më shumë se me ndikimet e brendshme, me ato të jashtme. Pra, ndjenjat sendërtohen më shumë se me anë të mendimeve të lindura vetvetishëm në zemër, me anë të shkaqeve të jashtme. Me këtë veçori, zemra pothuajse i ngjan ujit që merr formën dhe ngjyrën e enës ku ndodhet. Ndërkaq, njerëzit e zemrës e arrijnë klimën e paqes (selamet-paqëtimit) duke e përdorur mundësinë e zgjedhjes në favor të prirjeve pozitive të zemrës.

Në Kur'an urdhërohet:

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe bashkohuni me besnikët!” (et-Tevbe, 119)

“(O i Dërguar!) Kur t’i shohësh ata që flasin lart e poshtë mbi ajetet tona, qëndro larg tyre gjersa të kalojnë në një fjalë tjetër. Po qe se shejtani të bën të harrosh, kur të kujtohesh, mos rri më me atë grup njerëzish mizorë!” (el-En’am, 68)

“... Kur të dëgjoni që ajetet e Allahut janë mohuar ose janë vënë në tallje, mos rri me qafirët gjersa të futen në një bisedë tjetër (gjersa ta ndërrojnë temën e bisedës), ndryshe, edhe ju bëheni si ata!” (en-Nisa, 140)

Në fillim, vullneti përdoret për caktimin, fiksimin dhe parapëlqimin e faktorëve pozitivë apo negativë që do të veprojnë mbi të. Në këtë gjendje, zemra, duke marrë drejtimin që ia imponojnë ndikimet e jashtme, i përngjet flugerit i cili kthehet nga të fryjë era. Fundja, po të vërehet kuptimi që i japin fjalorët fjalës “zemër”, do të shihet ky përkufizim: “kthim i diçkaje në të kundërtën e vet, ndërrim forme dhe ngjyre”.

Në hadithin profetik thuhet:

“Zemra i përngjet një pende zogu në një tokë boshe, që era e hedh sa andej-këtej!” (Ibni Maxhe, *Mukaddime*, 10; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, IV, 408)





Kjo ngjarje e ndodhur në kohën e Profetit e shpreh mjaft hapur çështjen specifike të “shndërrimit të zemrës”.

Një ditë, Hz. Ebu Bekri (r.anh) takoi Handhalën (r.anh) dhe e pyeti se si i kishte hallet. Tejet i prekur dhe i lëkundur, Handhala iu përgjigj:

“Handhala u bë munafik (hipokrit), o Besnik!”

Hz. Ebu Bekri i tha:

“Subhanallah, Allahu qoftë i madhëruar! Ç’janë këto fjalë?”

Handhala iu përgjigj:

“Sa ndodhemi në kuvendin e të Dërguarit të Allahut, ai na kujton xhennetin dhe xhehennemin dhe ne na duket sikur po i shohim me sy! Por sapo të dalim e të fillojmë të merremi me familjen, me ushqimin dhe me punët e kësaj bote, shumicën e atyre që kemi dëgjuar, i harrojmë (e humbim frymëzimin dhe gjendjen shpirtërore që fitojmë në kuvendet e Tij)!”

Hz. Ebu Bekri (r.anh) i tha:

“Vallahi, gjëra të ngjashme ndodhin edhe me ne!”

Pas kësaj, të dy së bashku shkuan te i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe ia parashtruan çështjen. I Dërguari i Allahut u tha kështu:

“Beto hem në Allahun që ka jetën time në dorë, se, po qe se do ta ruanit gjendjen që keni pranë meje dhe do të bënit vazhdimisht zikr, edhe kur të ndodheshit shtrirë në shtrat, edhe kur të ishit në rrugë duke ecur, engjëjt do të ndodheshin krahpërkrah me ju!”

Pastaj, shtoi duke e përsëritur tri herë:

“O Handhala! Disa herë kështu e, disa herë ashtu!” (Muslim, Tevbe, 12)

Pra, duhet të shkojnë së bashku edhe adhurimi i mbushur me të vërtetat dhe të fshehtat e jetës tjetër, ahiretit, edhe preokupacionet e kësaj bote për vazhdimin e jetës.

Në këtë mënyrë e ka shpjeguar i Dërguari i Allahut (s.a.s.) specifikën e “**telvinit**” të zemrës, domethënë, të kalimit të saj nga një gjendje në tjetrën. Kurse njëri nga synimet kryesore të tasavvufit është që “telvinin” ta kthejë, me të gjitha mundësitë që sigurojnë kuvendet dhe zikri, në “temkin”, domethënë në stabilitet, në orientim.

Kështu, pas ngjarjes së miraxhit, mushrikët ose politeistët mekas nisën një fushatë të gjerë përgënjeshtuese. Qëllimi i tyre ishte që, duke mbjellur në zemrat e besimtarëve farat e dyshimit dhe lëkundjes, t’i kthenin nga feja. Prandaj, siç shkuan te shumë sahabe, shkuan edhe te Hz. Ebu Bekri (r.anh) dhe i thanë:

“A dëgjove? Njeriu yt thoka se qenka ngjitur në qiej! Po kësaj, ç’i thua?”





Mes një ekstaze të thellë besimi, Hz. Ebu Bekri nguliti në veshët e tyre këto fjali vendosmërie e besnikërie të cilat mushrikët kurrë nuk i kishin dëgjuar gjer atëherë:

“Ç’të thotë ai, është e drejtë! Sepse ai kurrë nuk gënjen! Unë i besoj pa kushte çdo gjëje të sjellë prej tij!” (Ibni Hisham, *es-Siret*, II, 31)

Pasi tentativat e përfaqësuesve të politeizmit për t’i lëkundur njerëzit dështuan edhe një herë tjetër, ata u tërhoqën pas duarbosh dhe të mjeruar!



Engjëjt janë krijuar me aftësinë vetëm për të bërë mirë. Shejtanët, djajtë, janë krijesa që përpiqen vetëm për të keqe e çorientim. Kurse njerëzit janë vendosur në një pozitë mes këtyre të dyve. Prandaj, njeriu, duke e ruajtur zemrën nga teprimet në të djathtë e në të majtë, duhet as të mos bjerë në gjendjen e një djalli, as të mos e shtrëngojë veten aq sa të mos e përballojë dot fuqia njerëzore për t’u ngjitur në nivel engjëllor. Njeriu duhet të ruajë masën dhe ekuilibrin, gjë që është domosdoshmëri e natyrës së krijimit të tij.

Detyra më me rëndësi dhe preokupacioni më serioz i njeriut në këtë botë duhet të jetë përgatitja për “botën pas vdekjes” e cila është një perspektivë absolute dhe e përjetshme. Dhe kjo është e mundur vetëm duke e njohur të vërtetën e zemrës, duke e mbrojtur atë nga të këqijat dhe duke e vënë nën ndikimet shpirtërore, sepse ekuilibri dhe paqja në këtë botë dhe kënaqësia dhe lumturia në botën tjetër varen nga zotërimi i një zemre të paqëtuar (selim). Zemër e paqëtuar (selim) do të thotë zemër e ardhur e pastër që nga krijimi, e cila nuk i ka humbur cilësitë e krijimit dhe mbështetet mbi paqen dhe shpëtimin besimor.

Profeti (s.a.s.) ka thënë:

“Çdo fëmijë që lind, lind me natyrë islame. Më pas, e ëma dhe i ati e bëjnë atë (sipas besimeve të veta) ose krishter, ose hebre, ose adhurues të zjarrit (zoroastrian)!” (Muslim, *Kader*, 22)

Kjo do të thotë se struktura e natyrshme dhe e paqtë (selim) e zemrës është islame. Por kur zemra i nënshtrohet ndikimeve negative, i prishet struktura e paqtë dhe lind mundësia për ta humbur orientimin.

Kurse në zemrat e mbushura me shfaqje shpirtërore duke thithur vazhdimisht ajrin e begatë të klimave shpirtërore, sendërtohen morali i bukur, punët e mira dhe gjendjet moral-shpirtërore. Vetëm në këtë mënyrë shfaqet tek njeriu e fshehta e “krijesës më të bukur”¹² në natyrën krijimore të tij, njeriu fiton thellësi dhe cilësi shikimi ndaj ngjarjeve dhe qenieve, gjë

12 Në original: ahseni takvim, njeriu i krijuar në formën dhe konsistencën më të bukur.





që do të thotë ngritje e perdeve nga “sytë e zemrës”, siç aludohet edhe në ajetet kur’anore,¹³ dhe aftësimi për ta parë të përtejmen. Pa asnjë dyshim, ky shikim ka të bëjë me të vërtetat përtej fushës së shikimit të syve të ballit.

Në këtë botë prove ku propozohen urdhrat dhe ndalimet hyjnore, njeriu është pajisur me vullnet dhe me mundësinë e zgjedhjes në atë mënyrë që të ketë mundësi të priret edhe pozitivisht, edhe negativisht.

Personat me aftësinë që t’u hapen sytë e zemrës, duke dëshiruar me gjithë zemër të edukohen dhe orientohen, bëjnë përpjekje serioze për të përparuar në udhën e së Vërtetës. Kurse zemrat nën sundimin e nefsit janë plot mohim, politeizëm, imoralitet, pasione epshore dhe shprehi lëkundjeje. Këto zemra, në kundërshtim me qëllimin e krijimit, janë të verbra ndaj sublimes, kurse të etura ndaj groteskes. Duke rënë, sipas shprehjes së Kur’anit në nivelin “bel hum edal”¹⁴, më poshtë se kafshët, e shkatërrojnë jetën e kësaj bote mes iluzioneve të indiferentizmit që u ngjajnë iluzioneve optike në shkretëtirë¹⁵. Këto zemra janë të sëmura dhe kanë nevojë për mjekim.



13 Shih Kur’ani, Haxh: 46.

14 Shih. Furkan, 44.

15 Në original: serap.





Sjelljet tona përbëjnë grafinë e zemrës sonë. Ne shpalosim sjellje sipas baticave dhe zbaticave të zemrës sonë!



2. LLOJET E ZEMRES

Sipas klasifikimit të përgjithshëm, zemrat mund t'i vlerësojmë në tre lloje sipas gjendjes së tyre moralo-shpirtërore:

- a) Zemrat që e ruajnë qëllimin dhe ndjeshmërinë e krijimit.
- b) Zemrat e vulosura e të vdekura.
- c) Zemrat e sëmura dhe indiferente.

a) Zemrat që e ruajnë qëllimin dhe ndjeshmërinë e krijimit

Këto janë zemrat e zgjuara nga indiferentizmi në sajë të zikrit. Në rastin e këtyre, ana shpirtërore ka fituar epërsi mbi nefsin, zemra është mbushur me dritën e besimit. Këta janë persona që kanë arritur të bëhen të suksesshëm për ta plotësuar domosdoshmërinë e ajeteve të mëposhtme:

“O ju që keni besuar, përmendeni shumë Allahun!..” (el-Ahzab, 41)

“Përmende emrin e Zotit tënd dhe kthehu nga Ai me të gjithë qenien tënde!” (el-Muzemmil, 8)

“Ka njerëz aq të mirë (salih), të cilët nuk i pengon as tregtia dhe as ndonjë punë tjetër për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin siç duhet dhe për ta dhënë zeqatin! Ata kanë frikë nga ajo ditë kur zemrat dhe sytë do ta humbin toruan nga tmërri!” (en-Nur, 37)

Zemrat e çliuara nga prirjet subjektive me anë të begatisë së dashurisë, ekstazës dhe afërsisë së ndjerë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe tek të cilat, vanitetet e kanë humbur vlerën, janë përmendur në Kur'an me emërtimet zemra “selim” (e paqëtuar), zemra “munib” (e kthyer) dhe zemra “mutmain” (e ngopur). Këto zemra të pëlqyera e të pranuar në lartësinë e Allahut mund të parashtrohen shkurt kështu:

Zemra e paqëtuar (selim) është zemra e mbrojtur apo e pastruar nga prirjet subjektive dhe presioni i tyre. Është zemra që Allahu i Lartë ia fal robit së bashku me natyrën e pastër dhe që kërkon prej tij ta ruajë atë. Ndërkaq, kjo gjendje e kulluar e zemrës arrihet vetëm me anë të metodave mis-





tike të quajtura pastrimi i nefsit dhe purifikimi i zemrës, në përfundim të të cilave arrihet gjendja e quajtur zemra e paqëtuar (kalbi selim), e cila është zemra që do të mirëpranohet në audiencën hyjnore.

Në Kur'an thuhet:

“Atë ditë nuk bëjnë dobi as malli, as fëmijët, me përjashtim të atyre që vijnë te Allahu me zemër të paqëtuar (selim)!” (esh-Shuara, 88-89)

Poeti bagdadas, Ruhi, e shpreh kështu këtë ide:

*Mos pandeh, o tregtar, se prej teje
Kanë për të kërkuar
Në Ditën e Llogarisë ar e argjend;
Jo, vetëm një zemër të paqëtuar!*

Zemra e kthyer (munib) është zemra e kthyer vazhdimisht nga Zoti. E shpëtuar nga robëria e interesave të përkohshme, është në gjendjen e një shijimi të vazhdueshëm të kënaqësive të botës hyjnore me anë të dashurisë pasionante dhe haresë. Zemra dridhet me emocionet sublime të rrjedhave të fuqisë hyjnore. Në Kur'an thuhet:

“Ja xhenneti i premtuar për ju! Është xhenneti i posaçëm për personat që i janë drejtuar Allahut, që i respektojnë urdhrat e Tij, që frikësohen prej Mëshiruesit edhe pse s’e shohin dhe që vijnë tek Ai me zemrën të kthyer nga Ai!” (Kaf, 32-33)

Zemra e ngopur (mutmainne) është zemra e cila, me anë të kënaqësisë së besimit, ka përparuar drejt përsosjes së moralit të bukur. Tek kjo zemër, duke shpëtuar nga imitimi, adhurimet kanë marrë karakter analitik. Zemra është zbukuruar me zikër, te nefsi ka fituar epërsi fryma shpirtërore, elementi besim ka gjetur mjedis në mënyrë të patronditshme në zemrën e cila është qendër ndjeshmërie. Me gjendjet e besimit analitik dhe pëlqimit e pajtimit, zemra ka arritur qetësinë, kënaqësinë dhe ngopjen (itminan).

أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

“Zemrat arrijnë ngopjen vetëm me përmendjen (zikrin) e Allahut!”

(er-Rad, 28)

Nga konceptimi i kundërt i këtij ajeti kuptohet se zemrat e mbetura larg përmendjes (dhikrit) të Allahut, kurrë s’kanë për t’u çliruar nga ankthet e moskënaqësisë dhe nuk kanë për të arritur qetësinë e vërtetë.

Treguesi i zemrës që ka fituar cilësitë e paqëtueshmërisë (selim), kthimit të vazhdueshëm nga Zoti (munib) dhe ngopjes (mutmain), janë de-





likatesa (rikkat), mëshirë për krijesat, lotim, pajtim me gjendjen, shërbim për të vërtetën dhe të mirën, shmangie nga e keqja, këshillë, vrapim për në rrugën e drejtë dhe mbushje me kënaqësinë e dashurisë hyjnore.

Kapitali i këtij niveli të zemrës i kushton vëmendje, bashkë me “lutjen dhe pendesën e kulluar”, edhe “kafshatës hallall”. Ndërkaq, ruajtja dhe mbrojtja e këtij kapitali janë të mundura vetëm me anë të punëve të mira (ameli salih). Meqë, si rrjedhojë e të qenit njeri, shmangia absolute nga mëkatet nuk është e mundur dhe, meqë, për pasojë, mëkatet, duke e pakësuar ndjeshmërinë e zemrës, e bëjnë atë të verbër dhe të shurdhër shpirtërisht ndaj së vërtetës, është kusht i domosdoshëm që zemra të kapet pas lutjes dhe pendesës së kulluar me qëllim që të bëhet e aftë për të kapur shfaqjet pozitive. Mbi këtë urtësi mbështetet fakti që mësimet mistike fillojnë me pendim dhe pendesë. Sepse, siç shprehet edhe në rregulloren e njohur të Mexhel'les:

“Prapësimi i të këqijave është veprim më i mirë (më me rëndësi dhe më me vlerë) se tërheqja e të mirave!”

Sa për të ashtuqajturën “kafshatë hallall”, mistikët janë shprehur kështu:

“Allahu e ndriçon zemrën e atij që ha hallall dhe e bën që burimet e urtësive t’i rrjedhin nga zemra në gjuhë!”

Kurse puna e mirë (ameli salih) garanton ruajtjen dhe mbajtjen e nivelit të fituar nga zemra. Konsideratat e larta specifike të ardhura nga Zoti i Lartë u përkasin vetëm personave me zemër të tillë.

Ndërkaq, mbi këto qëndrojnë zemrat “e gjalla” të pajisura me nurin (dritën, bukurinë) e Allahut, zemrat e profetëve dhe miqve të mëdhenj të Allahut. Si rrjedhojë e faktit që zemrat e tyre i mban të gjalla afërsia dhe dashuria hyjnore, ata nuk ua hedhin sytë me vështrime që mund të quhen konsideratë, as kësaj bote, as botës tjetër, madje nuk i shohin as me bisht të syrit. Profetët si dhe dijetarët dhe të urtët si trashëgimtarë të profetëve, Allahu i ka bërë ftues së “portës së paqes”¹⁶, të cilët ua hapin sytë njerëzve duke ua hequr nga sytë perdet e indiferentizmit, duke i nxitur për moral të bukur dhe adhurime të pastra e të sinqerta dhe, duke ua zgjuar zemrat, i shtyjnë drejt njohjes intuitive (marifetullah) të Zotit për të arritur takimin me Të (vasilillah).

Niveli i kërkuar për t’u arritur nga udhëtarët e udhës mistike në përfundim të edukimit të zemrës, është arritja nga zemra e gjendjes së qenies

16 Në original: darusselam, xhenneti, parajsa.





vazhdimisht së bashku me Allahun, gjendje, e cila është pikërisht ajo që emërtohet “ihsan” dhe, në këtë mënyrë, fitimi i cilësisë së “zembrës së gjallë”!

b) Zemrat e vulosura e të vdekura

Zemrat e këtij lloji janë zemrat e vdekura, antagonistet e zemrave të gjalla, përmendëse të Zotit, të cilave u janë mbyllur portat e mundësisë për të marrë pjesë nga besimi. Zemra të tilla nuk kanë ndryshim nga disa varre të cilat janë gropa nga gropat e xhehennemit. Qëllimet që kanë në jetë nuk janë më të larta se të kafshëve. Zoti urdhëron kështu në Kur’an:

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë punë të mira, Allahu i vë në xhennete nën të cilat rrjedhin lumenj, kurse mohuesit përfitojnë dhe hanë si kafshët. Vendi ku do të arrijnë ata, është zjarri!” (Muhammed, 12)

Kurse në një ajet tjetër thuhet kështu:

“(O i Dërguar!) A mos po pandeh se shumica e tyre e kërkojnë apo e kuptojnë të drejtën? Ata janë vetëm si kafshët. Ç’është e vërteta, janë më poshtë se kafshët!” (el-Furkan)

Jeta e njerëzve të tillë, tërë veprimtaritë jetësore të të cilëve u kushtohen dëshirave dhe qëllimeve vetiake frymore e subjektive (nefsani), kalon nëpër një disfatë të përjetshme. Kurse gjendja e tyre në jetën e pasme (ahiret) vazhdon gjer në pafundësi me një tmerr të papërshkrueshëm tragjedi.

Këta lloj njerëzish nuk dinë gjë për njeriun dhe të fshehtat e jetës, për qëndrimet mesimdhënëse në gjithësi. Jo vetëm vetë janë në rrugë të shtrembër, por bëhen shkak për perversitetin edhe të personave që kanë nën ndikim.

Megjithëse jetojnë në këtë botë mes pronës dhe të mirave të Allahut, ata tregohen tejet mosmirënjohës duke e mohuar pronarin e këtyre të mirave dhe duke u shkelur urdhrat dhe ndalimet e tij. Për këtë tip njerëzish, Zoti i Lartë urdhëron kështu:

“A nuk e sheh njeriu se e krijuam atë prej një embrioni? Kurse ja tek e sheh që është bërë armik i hapur i Zotit të vet!” (Jasin, 77)

“Ata janë shurdhër, të pagojë dhe të verbër. Prandaj ata nuk kthehen nga rruga së cilës i kanë hyrë!” (el-Bekare, 18)

“Sigurisht, ti nuk mund t’ua bësh të ditur të vdekurve atë ftesë! Ti nuk mund t’i bësh të të dëgjojnë shurdhët që kanë vënë kokën para e shkojnë! Ti nuk mundesh as t’i nxjerrësh qorrat nga gropa ku kanë rënë për t’i vënë në rrugë të drejtë! Ti mund t’u flasësh vetëm atyre që u besojnë ajeteve tona dhe nënshtrohen!” (en-Neml, 80-81)

Në ajete është e fiksuar se këta njerëz i kanë zemrat të kyçura e të vulosura. Në Kur’an kjo e vërtetë është deklaruar me këtë ajet:





حَتَمَ اللَّهُ عَلَى قُلُوبِهِمْ وَعَلَى سَمْعِهِمْ وَعَلَى أَبْصَارِهِمْ غِشَاوَةً
وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ

“Allahu i ka vulosur zemrat dhe veshët e tyre. Dhe para syve të tyre ka varur një perde. Dhe për ata ka një dënim të madh!” (el-Bekare, 7)

Kjo situatë është një e fshehtë dhe urtësi hyjnore që e bën tërë njerëzimin të rrëqethet me frikë dhe impresionim. Ndërkaq, meqë tek çdo njeri ka pjesë edhe nga atributi “orientues” (hádí), edhe nga atributi “çorientues” (mudill), nuk mund të mendohet që, qysh në këtë botë, zemra të vuloset dhe asaj t’i mbyllen dyert e orientimit në mënyrë absolute dhe me vullnet hyjnor. Kështu ka ndodhur që të mos u mbyllet dera e orientimit Hz. Umerit i cili kishte dalë në rrugë me qëllimin e mbrapshtë për ta vrarë Profetin (s.a.s.), Vahshiut që vrau Hz. Hamzanë, madje, Hindit, gruas së Ebu Sufjanit, e cila e keqtrajtoi kufomën e Hz. Hamzait.

Megjithëse në Kur’an bëhet fjalë për persona që u është vulosur zemra, është e pamundur që këta të caktohen një për një. Sepse fundi është i fshehtë. Momenti ku duhet përqëndruar këtu, është fakti që, ata që përmenden në Kur’an si persona të cilëve u është vulosur zemra, janë disa nga ata të cilët kanë kryer faje të tilla si *padrejtësia dhe dhuna* (dhulm), *mohim blasfemik* (kufr) dhe *mëkat* (fisk). Për njerëz të karakterizuar kështu, në njëzet e shtatë vende të Kur’anit është thënë se **“Allahu nuk i orienton ata”**. Dymbëdhjetë ajete janë për të padrejtët dhe dhunuesit, tetë ajete janë për mohuesit dhe gjashtë ajete janë për mëkatarët. Ndërkaq, për njerëzit që, duke hequr dorë nga këto mëkate, kthehen kah Allahu me zemër të sinqertë, dera e orientimit (hidajet) është e hapur.

Ata që u është vulosur zemra qysh në këtë botë, janë njerëz fatzinj të ndëshkuar me dënimin më të rëndë. Ndërkaq, edhe nëse përmendja e privimit nga orientimi pas këtyre tre fajeve, përbën një fill që të çon në njohjen e shkakut të këtij privimi, nuk ka zgjidhje tjetër veç lënies së të vërtetës në dorë të Allahut, pra, përveç pranimit se vetëm Allahu e di si është e vërteta. Duke u nisur nga kjo, ne duhet të nxjerrim përfundimin se duhet treguar një ndjeshmëri më e madhe për t’u ruajtur nga këto tre mëkate.

Nga ana tjetër, për shkak se, mbështetur në shumë urtësi, kaderi mbetet i fshehtë dhe për shkak se preokupimi i gjerë me këtë çështje s’është fort i miratueshëm, s’e shohim me vend të thellohemi më tej në të.

Pavarësisht nga urtësia që fshihet pas saj, është një e vërtetë e pamohueshme se ata që i kanë zemrat kështu të kyçura e të vulosura, janë persona që u janë mbyllur dyert për te Zoti dhe e mira, që u janë prerë lidhjet me njerëzoren dhe jetën shpirtërore. Zotëruesi i fuqisë së vetme që mund





t'ua heqë drynat dhe vulat e zemrave, është Zoti i Lartë. Në formën e paralajmërimit për ne, robtë e Tij, që të mos biem në një gjendje të tillë, Zoti ka urdhëruar në Kur'an:

“Mos u bëni si ata që e kanë harruar Allahun dhe që, prandaj, edhe Allahu ka bërë që ata ta harrojnë nefsin e vet! Ata janë njerëz të dalë nga udha!” (el-Hashr, 19)

Në këtë ajet theksohet se personat që e harrojnë Allahun, mbeten të privuar nga vetëdija dhe zgjuarsia për ta kujtuar edhe veten, madje.

Këto zemra të verbra ndaj së vërtetës i kundërshtojnë dhe i hedhin poshtë recetat e shpëtimit dhe pishtarët e orientimit sepse u bien në kundërshtim me dëshirat frymore e subjektive, ose mbeten indiferentë ndaj tyre. Duke ndërtuar, nën sugjerimet mashtruese të nefsit (frymës dhe egos) së vet, një botë iluzive pa vdekje dhe ringjallje, përpiqen ta ngushëllojnë veten në të.

Ashtu si lakuriqët e natës, si domosdoshmëri e krijimit të tyre, kënaqen nga errësira, edhe këta jetojnë në fatkeqësinë e pandehmës së mjerimit të vet si lumturi.

Poeti Mehmet Akif thotë:

*Besimi është ai margaritar që, sa i madh është, o Zot!
Zemra e ndryshkur pa besim është vetëm barrë në gjoks!*

Ata që janë zhytur në batakun e dëshirave dhe të mosbesimit, edhe sikur të ngjallen në botën e të vërtetës me tronditjet e frikshme të çastit të vdekjes dhe goditjet prej zjarri të engjëllit të vdekjes, nuk do të kenë asnjë dobi, sepse përgjegjësia e njeriut merr fund me shfaqjen e engjëllit të vdekjes.

c) Zemrat e sëmura dhe indiferente

Këto ndodhen në një pozitë të ndërmjetme mes zemrave të shëndosha dhe zemrave të vdekura. Gjendja e këtyre u përngjan jetës plot vuajtje të njerëzve me trupin të sëmurë. As në jetën materiale nuk kanë kënaqësi, as në botën e brendshme. Paqartësia e botës së brendshme ua ndikon botën e jashtme, parregullsia në botën e jashtme ua mban nën ndikim negativ botën e brendshme. Konfuzioni në mendje u përhapet në të gjitha gjendjet, lëvizjet dhe veprimet. Këto lloj zemrash të sëmura dhe indiferente që përpëliten në vorbullat e dyshimit, pavendosmërisë dhe paqëndrueshmërisë, janë të prirura për t'u kapur nga sëmundje shpirtërore si përballimi çdo çast me mundësinë për të rënë në të gjitha imoralitetet për shkak të injorancës, epsheve dhe pasioneve të tyre!

Mbi këtë grup njerëzish, Zoti ka urdhëruar kështu në Kur'an:





“Në zemrat e tyre ka sëmundje, edhe Allahu ua ka shtuar sëmundjet. Për shkak të gënjeshtreve që thonë, për ta ka një ndëshkim të dhimbshëm!” (el-Bekare, 10)

Sëmundjet e këtyre zemrave janë:

Dyshimi. Është sëmundja e privimit nga jeta shpirtërore e begatë që u sjell shpirttrave dhimbjet e vdekjes. Privimi nga qëndrueshmëria e besimit e cila e kënaq zemrën, i bën ata të sëmurë të pashërueshëm të mungesës së qetësisë dhe prehjes.

Padija dhe injoranca. Është një rrugë e verbër plot mjerim, dhimbje dhe errësi. Kjo gjendje që i pushton njerëzit, i çon ata në dështim absolut dhe fatkeqësi.

Epsheet dhe pasionet. Është sëmundja e nënshtrimit të zemrës që e ka humbur delikatesën dhe ndjeshmërinë, ndaj dëshirave që s’dinë të ngopur. Është një lloj çmendurie dëshirash e cila gjen prehje vetëm në dheun e zi të varreve nën hijet e dendura të selvive.

Imoraliteti. Është kanceri moralo-shpirtëror i zemrës. Po të mjekohet me kohë, me lejen e Allahut, mund të gjendet shërim.

Një sëmundje e frikshme e zemrës është edhe ngurtësia. Zemra të tilla nuk njohin ç’është bindja, nuk e dëgjojnë zërin e orientimit, nuk preken nga rënkimi dhe britma, nuk e njohin mëshirën dhe dhembshurinë. Edhe gurët mbeten më të butë se këto!

Këtë të vërtetë, Zoti e ka shprehur kështu në Kur’an:

“... (Ç’e do se) pas këtyre, zemrat ju ngurtësuan përsëri. Tashmë zemrat ju janë si gur ose më të ngurtë. Sepse ka gurë të tillë, nën të cilët fluskojnë lumenj. Ose ka të tillë që çahen dhe prej tyre shpërthen ujë. Kurse një pjesë gurësh, nga frika e Allahut, rrokullisen nga lart-poshtë. Allahu nuk është i panjohur për ato që bëni!” (el-Bekare, 74)

Siç kuptohet nga ajeti, ngurtësia e zemrës është përfundim i natyrshëm i mospërmendjes së Allahut dhe i privimit për një kohë të gjatë nga afrimi me të vërtetat hyjnore. Në një ajet tjetër, Zoti ynë urdhëron kështu:

“Turp për ata që u janë ngurtësuar zemrat në përmendjen e Allahut! Ja, pra, ata janë në një perversitet të hapur!” (ez-Zumer, 22)

Aktet dhe adhurimet e bëra me zemër të sëmurë dhe indiferente e humbin vlerën në lartësinë e Zotit. Duke mos u ndriçuar me dritën e Zotit, zemrat e humbin ndjeshmërinë dhe verbohen. Në Kur’an, Zoti thotë:

“(O i Dërguar!) A nuk shëtiten mbi tokë (ata që të kundërvihen ty)? Ndryshe, do të kishin zemra për të ndjerë dhe veshë për të dëgjuar. E vërteta është se nuk janë sytë që verbohen, por zemrat në gjokse!” (el-Haxh, 46)





Edhe sëmundjet e vogla të zemrës që nënvleftësohen, mund të shkaktojnë humbje të mëdha të pazëvendësueshme, madje në vdekjen moralo-shpirtërore të saj. Prandaj, është e domosdoshme që, duke e mbrojtur zemrën brenda një korrektese të lartë besimi, të bëhet nënshtrimi ndaj vullnetit të Allahut. Njeriun e nënshtruar ndaj Zotit me kuptimin e plotë të kësaj fjale, nuk ka forcë tjetër veç Zotit që ta zotërojë dhe shtyjë në një drejtim të caktuar.

Sa bukur e shpreh ky hadith profetik domosdoshmërinë e mbrojtjes së zemrës:

أَلَا وَإِنَّ فِي الْجَسَدِ مُضْغَةً إِذَا صَلَحَتْ صَلَحَ الْجَسَدُ كُلُّهُ
وَإِذَا فَسَدَتْ فَسَدَ الْجَسَدُ كُلُّهُ أَلَا وَهِيَ الْقَلْبُ

“Ta dini se te njeriu është një copë mishi, që, po të jetë mirë ajo, i gjithë trupi bëhet mirë; po të bëhet keq ajo, i gjithë trupi sëmurët. Ajo është zemra!” (Buhari, Iman, 39)

Kjo botë është fusha e propozimit dhe provës së Zotit. Mbi të fryjnë lloj-lloj erërash prove të cilat, duke e mbajtur zemrën nën ndikimin e tyre, e zvarrisin sa në këtë anë, sa në anën tjetër! Nisur nga kjo, zemra u duhet dorëzuar flladeve të ëmbla që fryjnë nga ana e ndihmës së Zotit. Dhe kjo është e mundur vetëm duke iu lutur Allahut me përgjërime, duke iu bindur urdhrave dhe ndalimeve të Tij dhe duke u treguar i nënshtruar!





Zemra është si një ujë i kthjellët. Por kur turbullohet me punë të këqija dhe mëkate, bëhet që të mos duket asgjë! Në këtë gjendje, për t'i parë margaritarët e frymës shpirtërore dhe dritërat e të vërtetës, ky ujë duhet kulluar!



3. PURIFIKIMI I ZEMRES (tasfije-purifikim)

Kushtet kryesore që duhen respektuar për t'i mbrojtur vetitë e larta të zemrave të paqëta (selim), të kthyer nga Zoti (munib) dhe të ngopura me besim (mutmain), për t'i mjekuar zemrat e sëmura dhe për të mos rënë në gjendjen e zemrave të vulosura me privimin dhe izolimin e përrjetshëm, janë këto:

- a) Ushqimi hallall.
- b) Pendimi dhe lutja.
- c) Këndimi i Kur'anit dhe ndjekja e konkluzioneve të tij.
- d) Kryerja e adhurimeve me përshpirtshmëri.
- e) Gdhirja e netëve.
- f) Dhikrullah dhe murakabe.
- g) Ndjenja e afërsisë ndaj Resulullahut (s.a.s.) dhe salavati sherife.
- h) Meditimi mbi vdekjen.
- j) Qëndrimi me njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq).
- k) Pajisja me një moral të bukur.

Këto kushte mbi të cilat duhet qëndruar me seriozitet dhe që duhen zbatuar me zell, para së gjithash duhet të kuptohen drejt dhe të njihet rëndësia e tyre.





a) Ushqimi hallall

“ O vëllezërit e mi! Për sa kohë që të hani haram, mos pandehni se do të arrini gjë në urtësi dhe marifet!”

Ibrahim Desuki (k.s.)

Adhurimet kryhen, krahas ushqimeve shpirtërore që e ushqejnë shpirtin, edhe me fuqinë dhe forcën që merr trupi nga lëndët ushqimore. Ndërsa nga ushqimet hallall (të lejuara, të bekuara) reflektohet në trup frymë dhe frymëzim shpirtëror, nga ushqimet haram (të palejuara, të pabekuara) që janë e kundërta e të parave, shfaqet shqetësim, ankth dhe indiferentizëm.

Mes ushqimit hallall dhe akteve të mira ka një lidhje të ngushtë. Rëndësia e ushqimit hallall është e madhe edhe në pranimin e lutjes. Këtë çështje, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh kështu:

“O njerëz! Pa dyshim, Allahu është i pastër dhe i kulluar nga çdo gjë, prandaj nuk pranon tjetër veç gjërave të pastra dhe hallall. Gjërat që ua ka urdhëruar profetëve, Allahu i Lartë ua ka urdhëruar edhe besimtarëve:

“O të dërguar! Hani nga gjërat hallall dhe bëni punë të mira, sepse unë e di shumë mirë se ç’bëni!” (el-Mu’minun, 51)

“O ju që keni besuar! Hani nga furnizimet hallall që ju kemi dhënë!” (el-Bakara, 172)

Pasi leximit të këtyre ajeteve, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) bëri fjalë për një burrë të kthyer nga fushata e gjatë me flokë dhe mjekër të trazuar, i cili ngriti duart për lutje dhe u lut kështu: “O Zot! O Zot!” Pastaj vazhdoi:

Si mund t’i pranohet lutja këtij njeriu që ha haram, pi haram dhe vishet me haram?” (Muslim, Zekat, 65)

Miqtë e Zotit që janë njerëz të zemrës, tregohen të rreptë në këto dy specifika për zhvillimin e botës ndjesore dhe thonë:

“Duke ngrënë, bëni kujdes se ç’ju hyn në gojë, duke folur, bëni kujdes se ç’ju del prej goje!..”

Edhe hadithi profetik në vijim na e shpreh neve mjaft bukur dhe në mënyrë lakonike se është tejet e domosdoshme të tregohemi të kujdesshëm në çështjen e dallimit dhe vlerësimit të hallalleve (gjërave legjitime, të lejuara e të bekuara) dhe haramëve (gjërave jolegjitime, të palejuara e të pabekuara).

Profeti ynë (s.a.s.) porositi:

“Pa dyshim, hallalli është i qartë. Edhe harami është i qartë. Por mes këtyre ka një sërë gjërash të dyshimta, të cilat shumica nuk mund t’i dijë. Personi që





shmanget nga gjërat e dyshimta, e mbron fenë dhe dinjitetin e vet. Kurse personi që nuk shmanget nga gjërat e dyshimta, me kohë bie në haram. Krejt si puna e çobanit që e kullot tufën përreth një are të huaj kur ka rrezik që dhentë t'i hyjnë në arën e huaj. Kini kujdes! Çdo padishah ka një arë ku hyrja është e ndaluar. Dhe mos harroni se ara me hyrje të ndaluar e Allahut janë gjërat që Ai i ka bërë haram!”
(Buhari, *Iman*, 39)

Zemrat në gjendje bindjeje, nënshtrimi dhe paqëtimi me urdhrin e Allahut, bëhen qendra urtësie, dobie dhe frymëzimi. E kundërta e këtyre, zemrat dhe trupat që nuk ruhen prej gjërave haram dhe të dyshimta, kthehen kryekëput në strehim të keqeje dhe në çerdhe imoraliteti.

Shembujt e mëposhtëm janë tejet mësimdhënës përsa i përket rëndësisë së kësaj korrekte dhe ndjeshmërie.

Ebu Bekr Besniku (r.a.) kishte një skllav. Skllavi punonte, fitonte dhe, një pjesë të fitimeve i sillte në shtëpi. Dhe Ebu Bekri hante prej gjërave që i sillte skllavi. Një ditë prej ditësh, skllavi i solli përsëri Hz. Ebu Bekrit gjëra për të ngrënë dhe ai filloi të hante. Skllavi e pyeti:

“A e di se ç’po ha?”

Hz. Ebu Bekri (r.a.) iu kthye:

“Jo! Pa na e thuaj ti!”

Skllavi e sqaroi kështu:

“Në kohën e injorancës (paganizmit), megjithëse s’dija fall, i pata he dhur fall një burri duke e mashtruar. Sot u takuam me të. Si shpërblim, ai më dha këtë ushqim nga i cili po ha ti tani!”

Hz. Ebu Bekri futi gishtat në fyt dhe, pavarësisht nga mundimet, i nxori jashtë gjithçka kishte ngrënë! (Buhari, *Menakibu'l-Ensar*, 26)

Sipas një varianti tjetër të këtij rrëfimi, skllavi i tha pastaj:

“Pse gjithë ky mundim për një kafshatë?”

Dhe Hz. Ebu Bekri iu përgjigj:

“Do ta nxirrja këtë kafshatë edhe sikur ta dija se kishte për të më dalë shpirti bashkë me të!” (Ahmed b. Abdullah et-Taberi, *er-Rijadu'n-Nadra*, II, 140-141)

Edhe kjo bisedë e zhvilluar gjatë vizitës që i pati bërë **Hizri** (a.s.) mikut të Zotit, **Abdulhalik Guxhdevani** (k.s.) është mjaft mësimdhënëse.

Hizri (a.s.) nuk i preku gjellët që ia vuri para Guxhdevani dhe u tërhoq pas nga sofrë. I çuditur, Guxhdevani e pyeti:

“Këto janë kafshata hallall, pse nuk ha?”

Hizri (a.s.) i dha këtë përgjigje:

“Po, janë llokma hallall, mirëpo ai që i ka gatuar, i ka gatuar me zemërim dhe moskokëçarje!”

Siç shihet, përtej cilësisë në vetvete të ushqimeve si hallall ose haram, mbi personin që i ha ndikojnë edhe gjendja dhe cilësitë shpirtërore të per-





sonit që i gatuan. Kjo situatë nxjerr në pah rëndësinë dhe delikatesën e qëndrimit që duhet mbajtur para ushqimeve.

Ndjeshmëria e posaçme e njerëzve të mirë në lidhje me gjërat ushqimore, i ka shtyrë ata t'i çojnë në shtëpi të mbyllura ushqimet e blera në pazar, sepse mbi to nuk duhet të mbeten mbresat e "syve të ngulur mbi to", efektet negative të shikimeve të nevojtarëve.

Krahas shmangies dhe ruajtjes me rreptësi nga gjërat haram dhe të dyshimta, edhe gjatë përdorimit të të mirave hallall, besimtari duhet ta ruajë mirë ekuilibrin e kursimit dhe të shmanget nga shpërdorimi. Në Kur'an urdhërohet:

"Jepua hakun edhe farefisit, të varfërit dhe udhëtarit! Dhe mos shpenzo pa vend! Sepse ata që shpenzojnë kështu, janë shokë të shejtanit, kurse shejtani është shumë mosmirënjohës ndaj Zotit të vet!" (Isra, 26-27)

Në Methnevinë e tij, poeti Mevlana Xhelaledin Rumi e shpreh figurativisht kështu efektin e kafshatës hallall mbi trupin dhe shpirtin:

"Mbrëmë frymëzimi na u shfaq ndryshe, sepse disa kafshata të dyshimta që na ranë në stomak, na e zunë rrugën e frymëzimit!"

Ushqimet e dyshimta që t'i dëshiron nefsi janë si gjemba që të janë ngulur në këmbë, që ta zënë rrugën për tek Zoti. Prandaj, ata që nuk i kanë kushtuar vëmendje kafshatës, janë bërë mëkatarë!

O trup! Brenda teje është një trëndafil i tillë që, po ta ruash atë, nga aromat e këndshme që përhapen përreth, formohen trëndafilishte irfani (kulture fetare) dhe marifeti (afërsie hyjnore)!"

Abdulkadir Gejlani (k.s.) tërheq kështu vëmendjen mbi rëndësinë e kafshatës në purifikimin e zemrës:

"Shih, o bir! Ushqimi haram e vdes zemrën. Ka kafshata që e ndriçojnë zemrën, ka kafshata që e mbysin në errësi atë. Ka kafshata që të preokupojnë me këtë botë, ka edhe kafshata që të preokupojnë me botën tjetër. Ka kafshata që të bëjnë të përkushtuarin e të dy botëve, ka edhe kafshata që të kthejnë kah Krijuesi edhe i kësaj bote, edhe i botës tjetër. Ngrënia haram të preokupon me këtë botë dhe t'i tregon të dashura vanitetet. Ngrënia muhah (e zakonshme, normale dhe e rregullt) të preokupon me ahiretin dhe t'i bën të dashura adhurimet. Kurse ngrënia hallall ta afron zemrën te Zoti. Cilësia dhe efekti i të ngrënave mund të kuptohet vetëm me anë të ndjerjes (marifetullah) së Allahut. Dhe ndjerja e Allahut bëhet në zemër, jo në letër dhe libër. Aftësia për ta njohur dhe ndjerë praninë e Allahut (marifetullah) i dhurohet si mirësi (ihsan) zemrës nga vetë Zoti, jo nga krijesat e Tij, gjë që vërtetohet pas veprimit me anë të vërtetimit të unitetit hyjnor (tevhid-i ilahi) dhe konkluzioneve dhe urdhrave hyjnorë!"

Ibrahim Desuki (k.s.) thotë:





“Vëllezërit e mi! Për sa kohë që të hani haram, mos pandehni se do të arrini diçka në lidhje me urtësinë (hikmet) dhe intuitën (marifet)!”

Gjithashtu në lidhje me ngrënien hallall, të tërheq vëmendjen biseda e zhvilluar mes Ubejdullah Ahrar-it (k.s.) dhe Sejjid Kasëm Tebrizi-ut.

Ubejdullah Ahrar tregon:

“Një ditë, Hz. Sejjid Kasëm më tha:

“Baba, a e di pse urtësia dhe e vërteta shfaqet rrallë në kohën tonë? Sepse në kohën që po jetojmë, pastrimi nga bestytnitë dhe paragjykimet ka mbetur në shumë pak njerëz. Përkryerja është tek pastrimi nga bestytnitë dhe paragjykimet, gjë që është e mundur me anë të ngrënies së kafshatës hallall. Kurse në këtë kohë, kafshatat hallall janë shumë të pakta dhe njerëzit e pastruar nga bestytnitë dhe paragjykimet pothuajse s’ekzistojnë. E si kërkon, atëherë, t’u shfaqet enigma hyjnore të tillëve?”

b) Pendimi dhe lutja

“(O i Dërguar!) Thuaju: **“Po qe se nuk luteni, pse Zoti t’ju japë vlerë?..”** (el-Furkan, 77)

Profetët dhe të gjithë të urtët i janë lutur dhe përgjëruar Zotit gjithmonë, në ngushticë dhe bollëk, në hidhërim dhe gëzim. Meqë edhe tek profetët kanë ndodhur gabime¹⁷, nuk mund të mendohet ndonjë njeri që të përjashtohet nga lutja dhe pendesa. Dhe ngaqë lutja dhe pendesa, me natyrën e tyre të vërtetë, përmbajnë kuptimin e një pendimi dhe përgjërimit të brendshëm, janë mjetet më me efekt të afërsisë ndaj Allahut. Edhe një ndër urtësitë e faktit që namazi në arabishte quhet “salat”, “lutje”, është se namazi është shprehja më e gjerë dhe përfshirëse e lutjes dhe përgjërimit.

Nga ana tjetër, fillimi i lutjes është pendesa, është të kërkosh falje nga Allahu. Hadithi i mëposhtëm i Profetit (s.a.s.), me të cilin ai kërkon të pohojë se zemrat e nxira si rezultat i mëkateve të kryera ndriçohen me anë të pendesave, është tejet orientues e paralajmërues për sa i përket purifikimit të zemrës:

“Kur robi bën një gabim, në zemrën e tij formohet një pikë e zezë. Po qe se heq dorë nga ai mëkat, pendohet dhe bën pendesë, zemra i pastrohet dhe i shkëlqen. Por po të mos veprojë kështu, por ta përsërisë mëkatin, pikat e zeza shtohen dhe, më në fund, e përfshijnë krejt zemrën.

Ja, kjo është gjendja për të cilën bën fjalë Zoti i Lartë:

¹⁷ Në origjinal: dhel’le, gabim pa dashje, i pavullnetshëm, rrëshqitje e pavullnetshme (lat. lapsus).





كَلَّا بَلْ رَانَ عَلَى قُلُوبِهِمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ

“Jo, e vërteta është se zemra e tyre ka zënë ndryshk për shkak të gjërave (të këqija) që kanë punuar dhe fituar!” (el-Mutaffifin, 14) (Tirmidhi, Tefsir, 83)

Po ta shohim botën me syrin e zemrës, vërejmë se të gjitha krijesat, para se të falenderojnë për dhuntitë hyjnore, ndodhen në pozitën e pohimit të dobësisë së tyre. Për njeriun i cili ka vullnet dhe është absolutisht e pamundur që të mos bjerë në gabim gjatë përdorimit të vullnetit të vet, pendesa është hapi i parë që duhet hedhur në rrugën e afrimit (takarrub) tek Allahu.

Me cilësinë e saj si ftesë për mëshirën hyjnore, lutja zotëron një forcë të madhe ndikuese siç është sigurimi i mundësisë për të shpëtuar nga vuajtjet e paracaktuara. Është për këtë arsye që, ashtu siç e kemi përsëritur edhe më parë me pretekste të ndryshme, në të gjitha tarikatet, mësimi fillon me pendesën.

Lidhur me rëndësinë e lutjes, në Kur'an thuhet kështu:

قُلْ مَا يَعْزُبُ عَنْكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

“O i Dërguar! Thua ju: **“Po qe se nuk luteni, pse Zoti t’ju japë vlerë?..”** (el-Furkan, 77)

“O i Dërguar! Kur të të pyesin robtë për mua, thua ju se me të vërtetë unë jam shumë pranë tyre. Kur më luten, u përgjigjem lutjeve të tyre. Prandaj, edhe ata të m’i përgjigjen ftesës dhe të më besojnë, se, në këtë mënyrë, futen në rrugë të drejtë!” (el-Bekare, 186)

“Lutiuni Zotit tuaj fshehtas me maturi dhe përgjërimit se Ai s’i do ata që e kalojnë masën!” (el-A’raf, 55)

Në hadithet e tij, Profeti (s.a.s.) ka porositur kështu:

“Nuk mund të ketë gjë më me vlerë se lutja ndaj Zotit! Lutja është thelbi i adhurimit!” (Tirmidhi, Deavat, 1)

“Personi që dëshiron t’i pranohet lutja në kohë ngushtice dhe shqetësimi, të lutet shumë edhe në kohë bollëku dhe mirëqenieje!” (Tirmidhi, Deavat, 9)

“Kujt t’i jenë hapur portat e lutjes, do të thotë se i janë hapur portat e mëshirës!” (Tirmidhi, Deavat, 101)

“Lutiuni Zotit të Madh duke besuar se do t’ju pranohet lutja! Djeni se Zoti nuk e pranon lutjen e bërë me zemër indiferente!” (Tirmidhi, Deavat, 65)

Siç del nga ky hadith profetik, të pandehësh se lutjet e bëra me zemër indiferente dhe me një mënyrë të trashë, do të pranohen te Allahu, s’është gjë tjetër veçse të gënjejesh nga djalli.





Imam Rabbani (k.s.) thotë:

“Lufta fitohet duke marrë pjesë në të me dy ushtri: njëra, ushtria e ushtarëve, ndërsa tjetra, ushtria e lutjeve!”

Edhe sahabet, shokët e Profetit, kur niseshin për në luftë, veç lutjeve që bënin vetë, i porosisnin shokët e sufës të luteshin për ta në mungesë.

Profeti (s.a.s.) ka porositur:

“Nuk ka lutje të pranuar më shpejt se lutja e një besimtari për një besimtar tjetër në mungesë!” (Tirmidhi, *Birr*, 50)

Njerëzit u luten personave nga të cilët shpresojnë se do t’ua plotësojnë lutjen. Mirëpo motivi bazë që siguron pranimin e lutjes drejtuar Zotit, më tepër se pranueshmëria e lutësit në lartësinë hyjnore, është principlialiteti dhe sinqeriteti i kërkesës. Kjo do të thotë se lutja nga zemra që do të bënte me principlialitet dhe sinqeritet një mëkatar për vëllain besimtar do të ishte më e dobishme se lutja pa zemër e dikujt tjetër i cili, përta i përket pozitës tek Allahu ndodhet ku e ku më lart se mëkatar! Të jesh mëkatar nuk do të thotë se të ka braktisur Zoti. Po të ishte kështu, përmendja e gabimeve, të metave dhe mëkateve të mëkatarit nuk do të konsiderohej për folje, gjë që është një nga mëkatet e mëdha. Ja, pra, kushdoqoftë, duhet ta kuptojë dhe njohë vlerën e fitimit të zemrës së një robi të Allahut dhe të marrjes së lutjeve të sinqerta të tij!

Sahabet e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut (s.a.s.):

“Cila është lutja më e pranuar?”

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) u është përgjigjur:

“Lutja e bërë në pjesën e fundit të natës dhe pas çdo namazi farz!” (Tirmidhi, *Deavat*, 78)

Për pranimin e lutjes, vetëm shprehja verbale e kërkesës është e pamjaftueshme. Zemra duhet të dridhet me dëshirat mbi kuptimin e ngarkuar në fjalët dhe nëse lutja është për faljen e një mëkati, duhet bërë me një vendosmëri përfundimtare për të mos e përsëritur më.

Nga ana tjetër, për sa i përket sigurimit të ngjitjes së lutjeve në lartësinë e Allahut, rëndësia e orientimit dhe punës së mirë është shumë e madh. Në Kur’an thuhet:

“Te Ai ngjiten fjalët e pastra (lutjet dhe përgjërimet e sinqerta) dhe këtë ngjitje e lartëson puna e mirë!” (Fatir, 10)

Duhet bërë përpjekje që lutjet të bëhen mes frikës dhe shpresës. Lutja dhe pendesa i çojnë individët dhe popujt në paqe e shpëtim dhe i eliminojnë fatkeqësitë.

Në lidhje me shpëtimin nga sëmundjet e zemrës dhe pranimin e lutjes, Hz. Mevlana (k.s.) shprehet kështu:





“Pendohu dhe lutu me një zemër plot zjarr pendimi, sepse lulet çelin në vende me diell e lagështi!”

Pendesa e parë ka filluar me profetin e parë, Ademin (a.s.). Në pendesën e tij ai është përgjyruar kështu:

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا
لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

“Zoti ynë! Ne i bëmë padrejtësi vetes! Po qe se nuk të vjen keq për ne e nuk na fal, do të bëhemi nga të humburit!” (el-A’raf, 23)

Kjo lutje është bërë model pendese për të gjithë bijtë e tij gjer në kiamet!

Duke i ftuar robtë e Tij për pendesë me qëllim që zemrat t’u zgjohen nga indiferentizmi dhe t’u shërohen nga sëmundjet moralo-shpirtërore, Zoti urdhëron:

“O ju që keni besuar! Kthehuni te Zoti juaj me një pendesë të sinqertë se Zoti mund t’ju mbulojë të këqijat!” (et-Tahrim, 8)

Në kthimin nga Allahu dhe në fitimin e një niveli më të lartë nga zemra, lutja dhe pendesa janë shumë të rëndësishme. Në lidhje me këtë, Zoti ynë i lartë i mëson robtë e vet të luten kështu:

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِن لَّدُنكَ رَحْمَةً
إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ

“Zoti ynë! Pasi të na kesh futur në rrugë të drejtë, mos na i rrëshqit zemrat në të shtrembër dhe falna mëshirë nga lartësia jote! Pa dyshim, Ti je favorizuesi më i madh!” (Al-i Imran, 8)

Profeti ynë, Krenaria e Gjithësisë (s.a.s.), i cili e pati kthyer këtë lutje në refren të jetës, lutej shpesh e shpesh:

يَا مُقَلَّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ

“Allahu im që i kthen zemrat nga të duash! Bëma të palëvizshme zemrën në besim!” (Tirmidhi, Kader, 7)

Lutja është një nga mjetet më të rëndësishme për pastrimin e zemrës. Ajeti i mëposhtëm e thekson bukur rëndësinë e lutjes në pastrimin e zemrës nga fëlliqësitë moralo-shpirtërore:



“Pasardhësit (e muhaxhirëve dhe ensarëve) (i) luten dhe përgjërohen (Zotit) kështu:

“Zoti ynë! Falna ne dhe vëllezërit tanë që kanë besuar para nesh! Dhe mos lër asnjë urrejtje në zemrat tona për besimtarët! Zoti ynë, Ti ke dhembshuri dhe mëshirë të pasosur!” (el-Hashr, 15)

Në fillim duhet eliminuar negativiteti që i bëhet pengesë arritjes në synim dhe, në këtë mënyrë, trualli i zemrës duhet sjellë në gjendje të përshtatshme për synimin bazë. Profeti (s.a.s.) e konkretizon kështu në personin e vet domosdoshmërinë e lutjes dhe përgjërimit të vazhdueshëm ndaj Zotit me qëllim për t’u pastruar nga pandjeshmëria e zemrës dhe mendimeve e ndjenjave negative që ndodhen tek ajo:

“Allahu im! Mbështetem tek ti nga dituria që s’jep dobi, nga zemra që s’rreqethet, nga nefsi që s’ngopet dhe nga lutja që s’do të pranohet!” (Muslim, Dhikr, 73)

“Allahu im! Pastroma zemrën nga mëkatet dhe bëma të kthjellët si uji i kulluar siç pastrohet e zbardhet këmisha nga këllira!” (Buhari, Deavat, 39)

Hz. Ibrahim (a.s.) që pati arritur t’i drejtohet Zotit me një zemër të paqme, i lutej kështu Zotit për të mos u turpëruar në ditën e ringjalljes kur do të ekspozohen fshehtësitë:

“(Zoti im!) Mos më turpëro në atë ditën e ringjalljes kur malli dhe fëmijët nuk do të bëjnë dobi, kur do të bëjnë dobi vetëm ata që do t’i shkojnë Allahut me zemër të pastër!” (esh-Shuara, 87-89)

Në këtë mënyrë i lutej Zotit edhe Profeti ynë (s.a.s.):

“Allahu im! Kërkoj prej Teje një gjuhë që thotë të vërtetën dhe një zemër të pastër!” (Tirmidhi, Deavat, 23)

Nga ana tjetër, përsëritja dhe vendosmëria në lutje kanë shumë rëndësi. Përsëritja tri herë e lutjes është mënyrë profetike. Lutja e sinqertë kurrë nuk hidhet poshtë. Mirëpo disa kërkesa, megjithëse janë të sinqerta, disa herë nuk përputhen me “kaderin absolut”. Prandaj lutësi nuk duhet të shfaqë lodhje dhe bezdisje, por të vazhdojë të lutet, sepse lutjet e paplotësuara në këtë botë do të plotësohen në botën e pasme (ahiret).

c) Këndimi i Kur’anit dhe ndjekja e konkluzioneve të tij

Mbushja e zemrës sonë me urtësira dhe të fshehta duke marrë begati nga fryma shpirtërore e Kur’anit, varet vetëm nga niveli i zemrës që kemi kur e këndojmë atë!

Njëra prej dhuratave më të mëdha që ka favorizuar Zoti, është se e ka bërë njeriun bashkëbisedues të Kur’anit.





Kriteret e përsosura mbi qetësinë dhe prehjen e vërtetë të shpirtit dhe trupit ndodhen në përmbajtjen e begatë të Kur'anit. Lumturia dhe shpëtimi i njeriut janë të mundura në raport me sa përfiton njeriu nga këto kritere ideale. Personi që e humb ekuilibrin duke mos u strehuar dot në frymën shpirtërore të Kur'anit dhe duke i kthyer shpinën atij, do të thotë se e ka poshtëruar dinjitetin njerëzor, përballë meritimit të kësaj dhuntie është zvarritur në një mosmirënjohje të tmerrshme dhe e ka shkatërruar veten në vorbullat e dëshirave dhe pasioneve.

Kur'ani është shërim për shpirtat që vlojnë, për zemrat e lodhura, si dhe burim urtësisht hyjnore që dhurojnë ngushëllim. Kur'ani është një favor hyjnor që ofron kriteret e mundësisë së përballimit të së vërtetës tmerruese e të pashmangshme të vdekjes duke e konceptuar atë si "natë dasme", si ndërmjetësuese bashkimi të robit me Zotin e vet!

Zoti ynë i Lartë ia paraqet fjalën hyjnore tërë njerëzimit, në këtë mënyrë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ مَوْعِظَةٌ مِنْ رَبِّكُمْ
وَشِفَاءٌ لِمَا فِي الصُّدُورِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ

"O njerëz, juve ju ka ardhur nga Zoti një këshillë, shërim për zemrat, orientim dhe mëshirë për besimtarët!" (Junus, 57)

Në hadithet e tij, Profeti (s.a.s.) ka porositur:

"Kushdo që shtron gosti, dëshiron që njerëzit t'i shkojnë në gosti dhe kënaqet nga kjo. Kur'ani është gostia e Allahut! Mos rrini larg tij!" (Darimi, Fedailu'l-Kur'an, 1)

"Këndoni Kur'an, ... sepse Allahu nuk i shkakton mundime një zemre brenda së cilës ka Kur'an!" (Darimi, Fedailu'l-Kur'an, 1)

Zemrat e privuara nga përmendja e Allahut dhe këndimi i Kur'anit bien në kasavet. Kështu, Ebu Musa el-Esh'ariu nga sahabet i këshillonte në këtë mënyrë ata që i shkonin për vizitë:

"Vazhdoni të këndonit Kur'an! Mos rrini pa kënduar Kur'an për një kohë të gjatë, përndryshe, siç u ka ndodhur paraardhësve tuaj, edhe zemrat tuaja gurtësohen!" (Muslim, Zekat, 119)

Ngjarja e mëposhtme e cila tregon se Kur'ani ushtron ndikim të fuqishëm edhe mbi kafshët dhe engjëjt, është shumë mësimdhënëse.

Usejd bin Hudajr (r.a.) tregon:

"Një natë po këndoja suren Bekare. Kali më ndodhej pranë i lidhur. Një çast dhe kali nisi të ngrihej kas. E preva këndimin dhe kali u qetësua.





Kur fillova prapë të këndo, edhe kali filloi të ngrihej kas dhe aq u tremba, sa e mora pranë djalin nga frika se mos ma shkelte.

Në atë mes, kur hodha sytë nga qielli, pashë sipër meje ca gjëra që u përngjisinin kandilëve që pastaj u ngjitën lart e më lart gjersa më humbën nga sytë.

Në mëngjes, kur ia tregova të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), më tha:

"Këndo, o Usejd, këndo!"

Pastaj më pyeti:

"O Usejd, A e di se ç'janë gjërat që ke parë?"

"Jo!" - I thashë.

Dhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) më tha kështu:

"Ata kanë qenë engjëj që kanë ardhur për të dëgjuar këndimin tënd. Po të kish vazhduar të këndoje, kishin për të të dëgjuar gjer në mëngjes. Atëherë, engjëjt s'do të kishin mbetur të fshehtë dhe njerëzit do t'i shihnin!" (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 15)

Kur'ani u ka zbritur njerëzve. Për njeriun e zemrës, Kur'ani është një thesar meditimi. Rezultati i mbetjes larg frymës shpirtërore të Kur'anit, është një disfatë absolute dhe e përjetshme. Për ata që mbeten të panjohur për detin e urtësisë, përvojës dhe të fshehtave të Kur'anit, Zoti thotë kështu:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا

"A nuk mendojnë hollësisht ata për Kur'anin? Apo mos mbi zemrat e tyre ka dryna?" (Muhammed, 24)

Kur'ani është një shfaqje e emrave të Allahut e reflektuar në trajtë fjalësh në botën tonë të njohjes.

Zoti e shpreh kështu në Kur'an madhësitinë e kuptimit të pafund të Kur'anit:

"Po qe se të gjithë drurët mbi tokë do të bëheshin kalem dhe të gjithë detrat, bojë, fjalët e Allahut s'do të mbaroheshin së shkruari. Nuk ka dyshim se Allahu është fitimtar absolut dhe i urtë!" (Llukman, 27)

Mbushja e zemrës sonë me urtësi dhe të fshehta duke marrë begati nga fryma shpirtërore e Kur'anit, varet vetëm nga niveli ynë ndjesor (afektiv) që kemi kur e këndojmë atë. Për këtë shkak, për t'u bërë konfidentë të së vërtetës së Kur'anit, është e domosdoshme t'i përftojme lartësi sublime zemrës, sepse Kur'ani i cili është një udhëzues orientimi në rrugën e drejtë, është i tillë që personin që e merr në dorë për ta kënduar, të mund ta çojë edhe në orientim, edhe në çorientim, sipas qëllimit dhe gjendjes ndjesore (afektive) të personit.





Zoti ynë i Lartë e shpreh kështu efektin dhe entuziazmin moralo-shpirtëror të ajeteve të kënduara të Kur'anit mbi botën e zemrës së besimtarëve:

“... Atyre që e kanë frikë Zotin, u rrëqethen qimet nga efekti i këtij libri, ndërkaq që edhe trupat, edhe zemrat u ngrohen dhe u zbuten me përmendjen e Tij!” (ez-Zumer, 23)

“... Kur ajetet e Allahut u këndohen besimtarëve, ua shtojnë dhe ua forcojnë besimin!” (el-Enfal, 2)

Kushti i parë i përfitimit denjësisht nga Kur'ani është trajtimi i tij me respekt dhe politesë, sepse respekti dhe politesa që duhen treguar ndaj tij janë shfaqje e rëndësisë që i dedikohet Kur'anit.

Me të vërtetë, me përmbajtjen tek ai të përsosmërisë, të vërtetës dhe të fshehtës që mundet t'i plotësojnë nevojat e njeriut gjer në kiamet, Kur'ani ka cilësinë e një udhëzuesi të shkëlqyer. Këtë veçanti, Kur'ani e shpreh kështu:

“Pa dyshim, ky Kur'an të shtyn në rrugë të drejtë; ai u jep besimtarëve që bëjnë punë të mira, sihariqin se për ta ka një shpërblim të madh!” (el-Isra, 9)

Ngaqë Kur'ani është një libër hyjnor, udhëzueshmëria e të cilit do të veprojë gjer në kiamet, çdo besimtar që ndodhet nën hijen e tij është i detyruar t'u mbetet besnik konkluzioneve, urdhrave dhe jetës kur'anore gjersa t'i hapet porta e përjetshmërisë së vdekjes. Vetëm në këtë mënyrë është e mundur arritja e lumturisë së zemrës dhe shpëtimit në këtë botë dhe e dhuntive hyjnore si meritim i pëlqimit hyjnor në jetën e pasme (ahiret).

Përfitimi denjësisht nga Kur'ani realizohet në raport të drejtë me aq sa mund të lexohet me zemër, pra, në mënyrë ndjesore (afektive). Këtë situatë ndjesore, porosia profetike e shpreh si në vijim.

Të Dërguarin e Allahut e pyetën se cili zë dhe cila mënyrë këndimi janë më të bukur për këndimin e Kur'anit, dhe ai u përgjigj:

“Eshtë këndimi i personit i cili, kur e dëgjon duke kënduar Kur'an, zgjon tek ti ndjenjën e frikës ndaj Allahut!” (Darimi, Fedailu'l-Kur'an, 34)

Ishte këndimi me përshpirtshmëri i Kur'anit në shtëpinë e së motrës Fatime që e tronditi thellë Hz. Umerin (r.a.) dhe u bë pretekst për orientimin e tij!

Ajetet e mëposhtme na bëjnë dritë për faktin se si duhet kënduar Kur'ani:

“O i Dërguar! Ky Kur'an është një libër i bekuar burim begatish që ta zbritëm ty me qëllim që njerëzit që kanë mend të mendojnë hollë mbi ajetet e tij dhe të marrin mësim!” (Sad, 29)

“O i Dërguar! Këndoje Kur'anin fjalë për fjalë!” (el-Muzemmil, 4)





Nga ana tjetër, rrëfëhet se Hz. Omeri (r.a.) e plotësoi suren Bakara në dymbëdhjetë vjet dhe, kur e mbaroi, theri një deve si kurban falenderimi. (Kurtubi, *el-Xhami*, I, 40)

Të gjitha këto janë për t'u mbajtur parasysht sepse tregojnë se, duke e kënduar Kur'anin, nuk duhet mjaftuar vetëm me përmbajtjen shqiptimore të tij, por të përfitohet nga kuptimi i brendshëm, të respektohen konkluzionet dhe urdhrat e tij dhe të përvetësohet morali i tij.

Dihet rëndësia e etikës islame të mosmbajtjes së Kur'anit në një nivel më të ulët se në mes e poshtë. Gjithashtu, jo vetëm këndimi i Kur'anit, por edhe vështrimi i shkrimeve të tij është konsideruar mjet e afërsisë ndaj tij, madje, mirësi (thevab).

Kështu, duhen bërë përpjekje për të mos e lënë mangët respektin ndaj Kur'anit dhe, me sa të jenë mundësitë, këndimi i tij i shpreshtë të kthehet në zakon. Për më tepër, nuk duhet larguar nga mendja urtësia e faktit që urdhri i parë i zbritur i Kur'anit është "ikrá" (إِكْرًا), "lexo!". Rëndësia e leximit në fjalë është e fiksuar me faktin që nuk mund të ketë namaz pa këndim Kur'ani (kiraat), e thënë ndryshe, namazi pa kiraat është i pavlefshëm.

Biseda e parë e kalifit omejad Sulejman bin Abdulmelik ka qenë kështu:

"O robtë e Allahut! Librin e Allahut bëjeni udhërrëfyes! Pranojeni urdhrin e dhënë prej tij dhe veproni sipas tij, sepse ky Kur'an, ashtu siç e fshin drita e mëngjesit errësirën e natës, i shkatërron kurthet dhe dredhitë e ngritura nga djalli!" (Bejhaki, *Kitabu'z-Zuhd*, 61)

Kur merren parasysht të gjitha këto, kuptohet lehtë se ç'vend të rëndësishëm duhet të zërë në jetën tonë afërsia me Kur'anin. Ne duhet t'i lutemi Zotit që zemrat të na mbushen e derdhen me gëzimin dhe harenë hyjnore të Fjalës Hyjnore. E tillë është edhe lutja e Profetit (s.a.s.):

"... Zoti im! Për hir të çdo emri tënd të bukur që ia mësove ndonjërit prej robve të tu, që e zbritë në librin tënd ose që e fshehe tek ti, lutja ime është që të ma bësh Kur'anin pranverën e zemrës, bukurinë e gjoksit, shërimin e hidhërimit dhe dëshpërimit tim!" (Ahmed b. Hanbel, *Musned*, I, 391)

d) Kryerja e adhurimeve me përshpirtshmëri

**"Adhuroje Allahun sikur ta shihje Atë!
Sado që ti s'e sheh Atë, Ai të sheh ty!"**

(Buhari, *Iman*, 37)

Adhurimet janë një vërtetim besnikërie që tregojnë se robi i qëndron besnik marrëveshjes së bërë me Zotin e vet në pafillimshmëri (eternitet). Çastet e adhurimit janë, brenda kushteve të marrëdhënieve Zot-rob dhe të pozitës së robit ndaj Zotit, koncentrimet të afrimit më të madh me Zotin.





Adhurimet janë një botë krejt private ku njeriu, duke i shtyrë jashtë zemrës të gjitha hallet që kanë të bëjnë me preokupacionet e kësaj bote, e qetëson dhe e forcon shpirtin me kënaqësinë se po bën diçka vetëm për pëlqim të Zotit të vet. Tekbiri i bërë në fillim të namazit duke i vënë duart te veshët është shprehje e hedhjes pas të çdo gjëje për t'iu drejtuar Allahut drejtpërsëdrejti.

Adhurimet janë burimi më me efekt i shërimit dhe qetësimi që mundet ta çlirojë njeriun nga dyshimet dhe shqetësimet e përtej vdekjes, janë një klimë shpirti nëpër të cilën kalon rruga e vetme e "investimeve" që bëhen për botën e përjetshme. Me këto cilësi, adhurimet janë një burim begatie që kurrsesi s'duhet nënvleftësuar në rrugën e sigurimit të ekuilibrit dhe paqëtimit të zemrës.

Për të vjelur rezultatin e dëshiruar nga adhurimet, është kusht që ato të kryhen me përsëritshmëri dhe përsëritshmëria është qëndrimi para audiencës hyjnore në bashkëveprimin e qetësisë dhe kënaqësisë së zemrës me ndjenjat e dashurisë dhe frikës, është shkëputja e të gjitha lidhjeve të jashtme për të qenë bashkë me Zotin dhe arritja e vetëdijes së krijimit vetëm për ta adhuruar Atë!

Ndër adhurimet, **namazi** është adhurimi me përmbajtje më të gjerë dhe më impresionues. Namazi është dhurata më e madhe e Allahut për robtë e vet. Në hadithin profetik thuhet:

"Po qe se një besimtar në fillim merr abdest mirë e bukur dhe pastaj ngrihet e fal dy reqate namaz i përqëndruar me të gjithë qenien e vet, me kënaqësi e përsëritshmëri, xhenneti i takon në mënyrë të domosdoshme!" (Muslim, *Taharet*, 17)

Përsa u përket vetive të larta që i përfton njeriut, nuk ka ndonjë adhurim që ta zërë vendin e namazit të vërtetë. Për një namaz të tillë duhet që në sytë dhe zemrën e njeriut ta humbë vlerën çdo gjë përveç Zotit, madje edhe vetvetja e tij.

Sulejman Darani (k.s.) ka thënë:

"Po të lihesha i lirë të zgjidhja mes faljes së dy reqateve namaz apo hyrjes në xhennetin e Firdeusit, do të zgjidhja dy reqatet namaz, sepse hyrja në xhennet është diçka që i pëlqen nefsit, kurse po të fal dy reqate namaz, do të jem bashkë me Zotin tim!"

Personi që qëndron në namaz nuk mund të preokupohet me asgjë tjetër. Namazi e pengon atë nga çdo lloj mendimi vanitetesh. Në një namaz të vërtetë, perdet e zemrës ngrihen dhe shfaqen dritërat e të vërtetës, përjetohet një bashkim i papërsishkrueshëm me Zotin.

Namazi i falur drejt e saktë është një adhurim me vlerë i cili, me begatinë dhe frymën e tij, e shpëton besimtarin nga rënia në vorbullën e prirjeve





subjektive dhe e bart në vetëdijen e ndodhjes së vazhdueshme në praninë hyjnore dhe nën vetëkontroll.

Në një hadith të tijn, Profeti (s.a.s.) thotë:

"Adhuroje Allahun sikur ta shihje Atë! Sado që ti s'e sheh Atë, Ai të sheh ty!"

(Buhari, *Iman*, 37)

Si dhe:

"Në namaz kujtoje vdekjen, sepse, po qe se dikush fal namaz duke e kujtuar vdekjen, ai namaz bëhet i plotë dhe i bukur. Fale namazin si personi që e fal duke menduar se e ka namazin e fundit. Më në fund, shmangu nga çdo gjë për të cilën do të duhej të kërkohet falje!" (Dejlemi, *Musned*, I, 431)

Në Kur'an, për namazin e kryer siç duhet, thuhet:

"... Dhe fale namazin drejt e saktë! Pa dyshim, namazi i falur në kuptimin e vërtetë të tij, pengon nga ndyrësitë dhe shëmtitë!" (el-Ankebut, 45)

Mbrojtja që bën namazi nga të këqijat varet nga vazhdimi i gjendjes së kënaqësisë dhe përsipirtshmërisë së namazit edhe pas tij. Po qe se një mbrojtje e tillë nuk duket te personi që fal namaz, do të thotë se ai nuk e kryen namazin rregullisht siç duhet.

Mbrojtja që realizon namazi nga të këqijat varet nga vazhdimi edhe pas namazit i gjendjes së përsipirtshmërisë dhe kënaqësisë. Po qe se te personi që falet nuk shihet një mbrojtje e tillë, do të thotë se ai nuk është një falës (adhurues) i vërtetë.

Në Kur'an ka një kërcënim të rëndë për ata që e falin namazin në këtë mënyrë:

"Sa keq për ata që falin namaz por që s'e marrin me seriozitet namazin! Ata janë persona që bëjnë hipokrizi në të gjitha punët dhe bëhen pengesë edhe për ndihmën më të vogël!" (el-Maun, 4-7)

Atëherë, kush fal namaz pa respektuar rregullat, pa qenë i vetëdijshëm se ndodhet në praninë hyjnore dhe me mendjen të ngulur në punët e përditshme, namazi i falur prej tij nuk e jep begatinë që pritret prej namazit. Namaze të tillë, të llojit të detyrueshëm, sigurojnë vetëm plotësimin e detyrimit fetar përkatës.

Zoti shprehet kështu në Kur'an për namazin në kuptim të vërtetë dhe ideal:

"Me të vërtetë, besimtarët kanë arritur shpëtimin; ata që në namaz janë në përsipirtshmëri të plotë!..." (el-Mu'minin, 1-2)

Nga sahabet, Abdullah bin Shihhir (r.anh) e përshekruan kështu gjendjen e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) në namaz:

"E pashë të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) duke falur namaz. Ngaqë qante, nga gjoksi i dilte një zhurmë si e tenxheres kur zjen!..." (Ebu Davud, *Salat*, 156-157; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, IV, 25)





Kur Hz. Aliu qëndronte në namaz, fytyra i zverdhej dhe ai zhvishej prej çdo gjëje përfshi edhe trupin e vet.

Ndërkaq, ata që nuk e falin namazin me këtë cilësi dhe përkryerje, nuk duhet të kapen pas pesimizmit dhe të tentojnë për ta braktisur atë. Sepse çdo falës që vazhdon të kryejë ato namaze që vlejnë të paktën për pagimin e borxhit farz, një ditë do të arrijnë patjetër një përkryerje në këtë drejtim.

Pesë kohët namaz që falen çdo ditë në kohë të caktuara të ditës, duke e programuar kohën e njeriut, i përfton atij një disiplinë jetese dhe ia forcon ndjenjën e përgjegjësisë.

Një adhurim tjetër i domosdoshëm në luftën për jetën, i cili e përsos moralin me anë të mbështetjes së gjendjeve të tilla, si durimi, vullneti dhe rezistenca ndaj dëshirave subjektive e egoistike.

Sipas qëllimit bazë të tij, **agjërimi** është lufta kundër pengesës nefs brenda vetëdijes së adhurimit të vazhdueshëm dhe, duke e mbajtur atë nën kontroll, zbritja e ndikimit të tij në minimum.

Gjithashtu, agjërimi u kujton njerëzve vlerën e dhuntive dhe të mirave. Duke i bërë të gjithë, me të pasur e me të varfër, ta shijojnë urinë, i vë të gjithë në kushte barazie. Me këtë pretekst, duke ua kujtuar njerëzve të pasur gjendjen e njerëzve të varfër e të mjerë, zhvillon tek ata ndjenjat e ndihmës dhe mëshirës.

Duke u dhënë gjallëri ndjenjave të devocionit tek njeriu, agjërimi e shton qashtërsinë e zemrës. Në Kur'an urdhërohet:

“O ju që keni besuar! Ashtu siç u qe bërë agjërimi detyrim atyre para jush, ju është bërë edhe juve në mënyrë që të ruheni!” (el-Bekare, 183)

Nuk ka ndonjë mënyrë më efikase se agjërimi për edukimin e vullnetit. Kurse vullneti është njëri prej mjeteve themelore të kundërvënies ndaj ekseseve të prirjeve natyrore e subjektive të njeriut.

Poeti Mevlana (k.s.) shprehet kështu mbi çështjen e ngrënies së pakët në këtë botë për meritimin e dhuntive të botës së përjetshme:

“Ushqimi bazë i njeriut është dashuria hyjnore dhe urtësia. Për këtë shkak, nuk është me vend që atij t’i jepet ushqim trupi më shumë se ç’duhet!”

Gjithashtu:

“Allahu ka thënë për dëshmorët: “Ata ushqehen pranë Allahut!”¹⁸ Për atë lloj ushqimi nuk ka as gojë, as trup!”

Për ta arritur të vërtetën e agjërimin dhe për të përfutur nga fryma shpirtërore e tij, duhet ruajtur dhe shmangur me forcë nga nënvleftësimet që e dëmtojnë atë. Në hadithin profetik thuhet:

“Agjërimi nuk është vetëm ndërprerje e ushqimit dhe e gjërave të tjera. Agjërimi i përkryer dhe i dobishëm është vetëm agjërimi kur lihen fjalët dhe punët e





padobishme dhe nga fjalët e këqija dhe përgojimet. Po qe se dikush të fyen ose bën ndonjë veprim injorant ndaj teje, thuaji: "Me të vërtetë, unë jam i agjëruar!" (Hakim, *Mustedrek*, I, 595)

Për ta mbrojtur jetën shoqërore dhe për t'i lidhur individët me dashuri me njëri-tjetrin, është bërë detyrim **zeqati**. Në regjimin shoqëror islam, adhurimi i **zeqatit dhe dhurimit (infak)** ka rëndësi shumë të madhe për sigurimin e dashurisë mes të varfërve e të pasurve dhe për ta eliminuar zilinë dhe armiqësinë mes tyre.

Fakti që në Kur'an, adhurimi i zeqatit i cili përmendet në disa vende të tij, përmendet edhe në 27 vende së bashku me namazin, shtyllën themelore të fesë, tregon për rëndësinë që i kushtohet zeqatit.

Zeqati është borxhi, në masë të urdhëruar nga Allahu, i atij që ka mundësi për nevojtarin. Në Kur'an urdhërohet:

"Në pasurinë e tyre kanë një të drejtë të caktuar i varfëri që e tregon varfërinë dhe nevojtarin që s'e shfaq dot (për shkak të dinjitetit) nevojtarinë e vet!" (edh-Dharijat, 19)

Me anë të zeqatit pastrohet kapitali i të pasurit dhe në shoqëri krijohen ekuilibri, drejtësia dhe harmonia shoqërore. Për ta kuptuar këtë, mjafton të shihet ajeti kur'anor:

"... edhe dhënësit e zeqatit u pastruan e gjetën shpëtim!" (el-A'la, 14)

Zeqati është një borxh minimal i ngarkuar të pasurit nga Allahu. Kurse nuk është vënë ndonjë raport në sadakatë jashtë zeqatit dhe ashtu si në zeqat, për t'i nxitur njerëzit, shpërblimi në formë mirësie (thevabi) është mbajtur i fshehtë. Në ndryshim nga ummetet, bashkësitë e kaluara, ummetit të Muhammedit Zoti i jep mëkateve ndëshkim një për një, kurse të mirave, shpërblim dhjetë për një.

Ndërkaq, masa e mirësisë (thevab) si shpërblim për dhurimin (infak) të dhënë bashkë me zeqatin, është mbajtur e fshehtë me qëllim nxitjeje dhe inkurajimi. Zoti urdhëron kështu në Kur'an:

"(O i Dërguar!) Merr sadaka prej tyre që, me këtë, t'i pastrosh ata (nga mëkatet) dhe t'i lartësosh. Dhe lutu për ta se lutja jote është qetësim për ta!" (et-Tevbe, 103)

Sipas ajetit, zeqati dhe dhurimi (infak) kanë dy aspekte: aspektin pastrues të mallit dhe aspektin pastrues të zemrës.

Duke bërë një kërcënim hyjnor, Allahu i Lartë urdhëron kështu në Kur'an:

"... Ata që e hanë arin e argjendin dhe nuk japin në rrugën e Allahut, paralajmëroji me një ndëshkim të dhimbshëm!" (et-Tevbe, 34)

"Atë ditë, ato (ari dhe argjendi) skuqen në zjarrin e xhehennemit dhe me to u damkosen ballët, ijet dhe shpinat dhe u thuhet: "Ja, ky është kapitali që grumbulluat për nefsën tuaj dhe tani shijojini gjërat që i grumbulluat!" (et-Tevbe, 35)





Sipas kësaj, me shtresimin në zemër të dashurisë së ndjerë për mallin dhe pasurinë, në përfundim të humbjes së aftësisë së atij malli për tu dhuruar, e drejta e nevojtarit bëhet e grabitur.

Nga ana tjetër, vetëm për dy dhunti është përdorur cilësimi “intrigë” (fitne): fëmijët dhe pasuria. Rreziku i shtresimit dhe zotërimit në zemër të dashurisë për fëmijët dhe pasurinë është shprehur ng Zoti kështu në Kur’an:

“Me të vërtetë, bijtë dhe pasuria janë për ju një intrigë (pretekst prove) ...” (et-Tegabun, 15)

Cilësia që do t’i mbrojë këto nga shndërrimi në intrigë, është frenimi i dashurisë së skajshme dhe mosfutja e tyre në zemër.

Përballë paralajmërimeve hyjnore që i përmendëm pjesërisht më lart, duhet menduar mirë dhe duhen bërë përpjekje për ta kaluar masën e detyrueshme të zeqatit prej një të dyzetën me anë të sadakave dhe dhurimeve (infak) të tjera.

Në Kur’an, Zoti urdhëron:

وَيَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنْفِقُونَ قُلِ الْعَفْوَ

“... Të pyesin ty se ç’duhet të shpenzojnë në rrugën e të mirës. Thua-ju: “Tepricën pas plotësimit të nevojave...” (el-Bakara, 219)

Të pasurit falenderues dhe bujarë janë së bashku në nderin njerëzor me të varfërit e durueshëm e me dinjitet. Në Islam, të pasurit mendjemëdhenj dhe koprracë si dhe, e kundërta e këtyre, të varfërit e paduruar që, si rezultat, nuk shpëtojnë dot nga kundërshtimi dhe revolta, janë parë me sy të keq.

Zeqati është një formë konkrete e shprehjes së falenderimit nga ana e zotëruesve të pasurisë dhe kapitalit, ndërkaq që, sipas premtimit hyjnor, falenderimi e shton dhuntinë. Allahu i Lartë urdhëron:

لَئِن شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ

“... Me të vërtetë, po të falenderoni, jua shtoj dhuntitë...” (Ibrahim, 7)

Me të vërtetë, Profeti (s.a.s.) e pëlqente shumë të jepte dhe e nxiste këtë. Në një hadith profetik, ai thotë:

“O njeri! Jep, që edhe ty të të jepet!..” (Buhari, *Nefekat*, 1)

Profeti (s.a.s.) e donte shumë që bujaria të bëhej natyrë bazë e një muslimani dhe thoshte:

“Vetëm dy veta kihen zili. Njëri, personi që Allahu i jep mall dhe e bën të aftë e të suksesshëm për ta shpenzuar në rrugën e Zotit. I dyti, njeriu të cilit Allahu i jep dituri dhe ai vepron me këtë dituri dhe ua mëson edhe të tjerëve, domethënë, e fal diturinë.” (Buhari, *Ilm*, 15)





Shkurt, njeriu, për nga krijimi, është i prirur ndaj botës. Kurse malli e pasuria e kësaj bote i vjen tërheqëse nefsit. Ata që gënjejnë me të nuk dinë të ngopen. Me grumbullimin e mallit, njeriut i shtohet ambicja dhe ai bëhet ambicioz. Te njeriu që ia kanë zënë sytë materiali dhe ambicja për pasuri, ndjenja e mëshirës dhe dhembshurisë pakësohet, atij i vjen e vështirë të japë. Dhe nefsi i thotë atij duke e sugjeruar në mënyrë të gabuar:

“Bëhu më i pasur; më tej do të bësh më shumë dobi dhe dhurime! Një njeri i tillë, edhe nëse e arrin rehatinë e trupit, në shpirt është i sëmurë.

Kështu, për ata që thonë “nesër e bëjmë”, është thënë:

“Ata që thonë nesër e bëjmë, u shkatërruan!”

Ja, pra, zeqati është shërimi i sëmundjeve të zemrës si pangopësia ndaj mallit të kësaj bote.

Zoti na njofton në Kur’an se personi i cili në çastin e vdekjes vjen në vete sikur të zgjohej nga një ëndërr, thotë kështu me një pendim të përfundimtar:

رَبِّ لَوْلَا أَخَّرْتَنِي إِلَىٰ أَجَلٍ قَرِيبٍ فَأَصَّدَّقَ وَأَكُن مِّنَ الصَّالِحِينَ

“... Zoti im, sikur të ma shtyje (vdekjen) gjer në një afat të afërt që të jepja sadaka e të bëhesha nga të mirët!..” (el-Munafikun, 10)

Në zeqat dhe sadaka ka shumë rëndësi respektimi i etikës. Veçanërisht ai që jep duhet të ndjejë falenderim për atë që merr, sepse marrësi i zeqatit dhe sadakasë e shpëton dhënësin nga një borxh i detyrueshëm duke e bërë, njëkohësisht, të merituar të shpërblimit hyjnor. Sadakatë e dhëna janë, njëkohësisht, mburoja për dhënësin ndaj sëmundjeve dhe fatkeqësive. Me qëllim për ta bërë të qartë rëndësinë e dhënies së sadakasë të varfërit me një zemër të ndjeshme, në Kur’an thuhet:

“... Sadakatë i merr Allahu!” (et-Tevbe, 104)

Si dhe:

“O besimtarë! Mos i zhvlerësoni të mirat që bëni duke u mbajtur më të madh e duke e prekur tjetrin ashtu siç bën ai që, megjithëse nuk e beson Allahut dhe ditës së ringjalljes, shpenzon për t’u dukur!” (el-Bekare, 264)

Të gjitha gjallesat jetojnë dhe ushqehen në pronën e Allahut. Njerëzit si qenia e vetme ndër të gjitha qeniet e pajisur me mendje dhe arsye, a s’e shohin këtë të vërtetë dhe, përballë faktit që Zoti i ushqen të gjitha qeniet si besimtarë e mosbesimtarë, të dobët e të fuqishëm, a nuk mendojnë se mallin e kujt e kursejnë dhe prej kujt e kursejnë?

Zoti e ka krijuar gjithësinë me motivin e dashurisë dhe, për respekt të kësaj dashurie, ka bërë shumë dhurime, mirësi dhe favore. Sepse përfundi-





mi i natyrshëm i dashurisë është sakrifica. Dashuruesi e kupton si detyrë dhe kënaqësi të bëjë sakrificë për të dashurin me aq sa ta ketë dashurinë për të. Kjo shkon gjer atje sa dashuruesi të japë jetën për të dashuruarin. Dhurimi i bërë për krijesat e Allahut në emër të Tij, është shfaqja më e bukur e dashurisë e dashuruesit për të dashuruarin.

Krahas këtyre adhurimeve materiale (pasurore), edhe **haxhi** si adhurim edhe material (pasuror), edhe fizik (trupor), është një adhurim i lartë i cili, me anë të kujtimeve prekëse mbi vargun e profetëve nga i pari, Ademi (a.s.) e gjer te i fundit, Hz. Muhammedi (s.a.s.), e përkryen margaritarin e besimit ndër zemra dhe, duke e bërë personin ta përjetojë në këtë botë përngjasimin e grumbullimit të njerëzve në sheshin e llogaridhënies pas ringjalljes, bëhet pretekst për njohjen e të fshehtës së thënies (مُوتُوا قَبْلَ أَنْ تَمُوتُوا) *“vdisni para se të keni vdekur”*.

Adhurimi i haxhit përmban shumë urtësi materiale e shpirtërore. Një haxh i vërtetë është një adhurim madhështor dhe i bekuar gjatë të cilit, muslimanët që meritojnë falje me shfaqjen e mëshirës së pasosur të Allahut, bashkohen e shkrihen me njëri-tjetrin brenda një emocionit besimi të thellë, dashurie dhe ekstaze.

Haxhi është përpjekje për të shpëtuar nga stuhitë subjektive duke u zhveshur nga rroba e nefsit (frymës shtazore) dhe e ekzistencës për t’u përqëndruar në thellësitë shpirtërore.

Haxhi është një adhurim plot shfaqje shpirtërore ku shpirti njerëzor gjen harmoninë, klimën dhe ngjyrën e vet, fiton natyrën e vet bazë dhe pastrohet e zbardhet me shirat e begatisë moralo-shpirtërore të zemrës.

Qabeja e madhëruar, pika e orientimit të muslimanëve, është pika ku orientohet namazi, kryerjen e të cilit Zoti e ka urdhëruar në Kur’an me ajetin **“Bjer në sexhde dhe afrohu!”** (el-Alak, 19) Në të njëjtën kohë, është vendi ku rreh pulsi i gjithë botës islame. Vendshfaqja e vështrimeve hyjnore te njeriu është zemra, kurse te gjithësia është Qabeja. Pra, në një kuptim, brenda gjithësisë, Qabeja është si zemra brenda njeriut. Për këtë arsye, haxhi është një adhurim që kërkon kujdes të posaçëm dhe i cili, duke e kuptuar madhështinë e Qabes, duhet kryer me një zemër të ndjeshme.

Brenda ihrameve borë të bardha, haxhi është përpjekje për të marrë pjesë prej brishtësisë dhe tejdukshmërisë së engjëjve. Nën ihram nuk duhet bërë gjah, nuk duhet shkullur as një fije bari dhe as edhe një qime me qëllim! **Atje nuk ka marrëdhënie seksuale, nuk ka mëkat, nuk ka polemikë...**¹⁹ Vetëm dhembshuri, mëshirë dhe delikatesë për krijesat për hir të Krijuesit!





Ata që i kanë mundësitë për të shkuar në haxh, duhet të ruhen fort prej indiferentizmit dhe mefshtësisë. Në të kundërt, përballen me këtë paralajmërim të tmerrshëm të Profetit (s.a.s.):

“Po qe se dikush i ka mundësitë për të bërë shpenzimet e ushqimit dhe transportit për të shkuar në Shtëpinë e Allahut dhe nuk shkon të bëjë haxh, nuk ka asnjë pengesë që ai të vdesë si çifut apo krishter!” (Tirmidhi, Haxh, 3)

Ç’indiferetizëm dhe ç’humbje e madhe është për muslimanët të mbeben të painteresuar për adhurimin e haxhit ku kanë mundësi ta purifikojnë zemrën duke u pastruar nga mëkatet!

Profeti (s.a.s.) porositi:

“Kush vjen në Qaben e madhëruar me qëllim haxhi dhe e kryen haxhin pa bërë mëkate dhe veprime të ndaluara, kthehet në shtëpinë e vet krejt i pastër pa mëkate siç ka lindur nga e ëma!” (Muslim, Haxh, 438)

e) Gdhirja e netëve

Mbushe nga ajo verë, mbushe prapë e na sill! Të ndalet nata! Ndale natën në vend, o mik! Lidhma gjumin me zinxhirë, çastet të mos kalojnë! S’e kuptojnë sekretin e natës, o mik, ata që flenë!

Njeriu mund t’i hedhë nga vetja shqetësimet materialo-shpirtërore të ditës duke u kthyer në botën e vet të brendshme dhe duke u strehuar nën qetësinë e natës. Ditët nuk mundën ta japin prehjen shpirtërore dhe shëndetësore të natës. Dhe ata që nuk e njohin dhuntinë e natës, e kanë të pamundur ta mendojnë të mirën e ditës!

Për të hyrë në peizazhet hyjnore dhe shpirtërore të natës, është e domosdoshme që nata të përdoret me qëllim të caktuar.

Për njerëzit e zemrës nuk ka kohë më të begatë se qetësia e natës. Duhet që, duke e kaluar natën pjesërisht zgjuar, të përfitohet prej begatisë së saj. Në lidhje me këtë specifike, në Kur’an urdhërohet:

تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا
وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ

“... Ata ngrihen nga shtretërit dhe luten duke u frikësuar prej Zotit të tyre e duke shpresuar mëshirën e Tij. Dhe japin në rrugë të dobishme nga ajo me të cilën i kemi furnizuar!” (es-Sexhde, 16)





Si dhe:

“Dhe bëji sexhde Atij në një pjesë të natës dhe madhëroje Atë në një pjesë të gjatë të natës!” (el-Insan, 25-26)

Vlerat që i ka dhënë Zoti natës dhe të fshehtat e vendosura brenda saj janë të panumërta. Sekretet e mënyrës së shprehjes së ajeteve në vijim është një dritare hyjnore e hapur për ne për të na dhënë mundësi të sodisim shumë e shumë të vërteta!

“Beto hem në natën dhe në errësirën e saj që mbështjell çdo gjë, se...” (el-Inshikak, 17) **Beto hem në natën kur bie qetësia, se...”** (ed-Duha, 2) **Beto hem në natën kur fillon të bjerë errësira, dhe në mëngjesin kur fillon të zbardhë!”** (et-Tekvir, 17-18)

Për besimtarët që kanë arritur pjekurinë, netët janë një pasuri e veçantë si rrjedhojë e qetësisë dhe begatisë së thellësisë së tyre. Ata që e njohin siç duhet vlerën e kësaj pasurie, veçanërisht pas mesit të natës, atëherë kur e gjithë qenia tërhiqet në pushim dhe tërë bota përfshihet nga qetësia, me lutje, adhurime dhe përgjërime të djegura, gjejnë truallin më të begatë të kthimit kah Zoti.

Poeti dhe mistiku i madh Mevlana - Xhelaleddin Rumi i shpreh këstu në vargje në veprën e tij poetike Divani Kebir pasionin dhe ekstazën e jetuar gjatë netëve:

*Saki, mbushe kupën me dashuri hyjnore plot!
Lëre të dehurin, për bukë ç'i flet kot!
Shërbeje eliksirin të ngopen zemrat e etura!
Gjallesa që noton në det, veç ujit tjetër ç'do?
Mbushe nga ajo verë, mbushe prapë e na sill!
Të ndalet nata! Ndale natën në vend, o mik!
Lidhma gjumin me zinxhirë, çastet të mos kalojnë!
S'e kuptojnë sekretin e natës, o mik, ata që flenë!*

Në lidhje me kalimin zgjuar të netëve dhe agimeve, Zoti shprehet këstu për robtë e Tij fatlumë të cilët i lavdëron duke thënë se do të meritojnë dhunti hyjnore meqë janë ruajtur prej Tij:

كَانُوا قَلِيلًا مِنَ اللَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ وَبِالْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

“Ata të bindurit flenë pak netëve dhe, në kohën e agimit, vazhdojnë me pendesë!” (edh-Dharijat, 17-18)

Si dhe:

“(Robtë e Mëshiruesit që) E gdhijnë natën duke qëndruar në këmbë dhe duke rënë në sexhde para Zotit të tyre!” (el-Furkan, 64)





Në një ajet tjetër, Zoti urdhëron kështu:

“(O i Dërguar!) Allahu sheh se ti, kur ngrihesh natën (për namaz), përsillesh mes atyre që bëjnë sexhde...” (esh-Shuara, 218-219)

Në lidhje me këtë ajet, Kadi Bejdaviu thotë kështu:

“Kur pesë kohë namaz u bënë farz për ummetin, kurse namazi i natës u kthye në sunnet, Profeti (s.a.s.) ka dalë natën nga shtëpia për të parë se ç’bëjnë sahabet, është përsjellur mes shtëpive të tyre dhe ka vënë re se ato zjenin si koshere bletësh me zërat e këndimit të Kur’anit, zikrit dhe tespihve.”

Allahu i jep më shumë vlerë zikrit (dhikrit) të bërë në kohën e zbardhjes në mbarim të natës, në krahasim me dhikrin e bërë në kohë të tjera, sepse marrja me zikër dhe adhurim në kohën e zbardhjes është më e vesh-tirë se në kohët e tjera. Është për këtë shkak që kalimi zgjuar në kohën e zbardhjes është shprehje e dashurisë së pastër dhe e madhërimit që ndjen robi për Zotin e vet.

Po qe se besimtari mundet ta përdorë natën në mënyrë të qëllimshme dhe përfiton shpirtërisht nga dhikri në kohën e zbardhjes, nata i bëhet më e ndriçuar dhe më e dobishme se dita. Kurse nata e kaluar pa qëllim dhe e dënuar me gjumë, është si shiu që bie mbi gur, det dhe shkretëtirë dhe një humbje e pazëvendësueshme. Edhe dita e një nate të tillë është shpirtërisht e errët.

Po qe se fryma shpirtërore e tevhidit që fillon në zbardhje na i përfshin ditët dhe zemrat, edhe fryma jonë e fundit, domethënë vdekja që është lamtumira e madhe ndaj çdo gjëje në këtë botë, në dashtë Zoti, me frymën shpirtërore të Fjalës së Tevhidit, kthehet në “natë dasme”²⁰ !

Abdullah bin Amr bin As (r.anhuma) ka bërë të ditur se Profeti (s.a.s.) ia ka tërhequr vëmendjen në këtë mënyrë:

“O Abdullah, mos u bëj si filani që, ndërsa vazhdonte të bënte adhurim natën, tani nuk ngrihet më!” (Buhari, Tehexhahud, 19; Muslim, Sijam, 185)

Duke iu drejtuar sahabeve, shokëve të tij, Profeti u ka thënë kështu:

“Kini kujdes për adhurimin e natës, sepse është zakoni i njerëzve të mirë para jush! Pa dyshim, ngritja për adhurim natën është pretekst për t’iu afruar Zotit, pengon nga mëkatet, bëhet kundërshtpërblim për gabimet dhe i lehtëson dhimbjet e trupit!” (Tirmidhi, *Deavat*, 101)

Nga ana mjekësore është saktësuar se zgjimi natën është me rëndësi edhe për shëndetin e trupit të njeriut. Me të vërtetë, ata që ngrihen nga një gjumë i gjatë, kanë dhimbje koke. Kjo dukuri është rezultat i ngadalësimit të frymëmarrjes dhe mosushqimit të zemrës me sasi të mjaftueshme oksi-

20 Në origjinal: sheb-i arus, nata e bashkimit me Zotin.





gjeni. Ata që e ndërpresin gjumin, meqë e normalizojnë frymëmarrjen me anë të lëvizjeve, megjithëse flenë pak, ngrihen nga shtrati më të gjallë.

Ndërkaq, edhe nëse urdhrat e fesë që nuk janë për dobi të tilla materiale të kësaj bote, janë vënë me qëllim për të realizuar adhurimin ndaj Allahut, në secilin prej tyre janë të pranishme edhe dobi të tilla materiale. Edhe në namaz, agjërime dhe në adhurime të tjera ka urtësi dhe përfitime materiale të tilla. Por, natyrisht, këto nuk janë shkak i ekzistencës së atyre adhurimeve, por ndikime të anshme të dobishme.

f) Dhikrullah dhe murakabe

“Zemrat ngopen vetëm me përmendjen e Allahut!” (er-Rad, 28)

Sipas burimit, fjala *insan* (njeri), sipas një pikëpamjeje, vjen nga fjala *nisjan* (harresë). *Nisjan* është e kundërta e *dhikrit* (përmendjes, kujtesës) dhe shpreh *harresën* që është njëra nga dobësitë më të mëdha të njeriut. Kjo e vërtetë është shprehur nga populli me proverbën “kujtesa e njeriut vuan nga harresa”. Rruga më e saktë e zbritjes së harresës në minimum është *dhikri*²¹.

Për të jetuar në përshtatje me qëllimin e krijimit të vet, njeriu kurrë nuk duhet ta nxjerrë nga kujtesa dhe zemra Krijuesin duke i mbetur besnik aktit të lidhur në Bezmi Elest mes Zotit dhe shpirttrave²². Prandaj, për kompensimin e dëmeve që lindin nga prania e natyrshme e harresës te njeriu, ka nevojë, para së gjithash, për ta mbajtur gjallë vazhdimisht vetëdijen e adhurimit ndaj Allahut, sepse gjëja që përsëritet vazhdimisht e fuqizon vendin e vet në njohje dhe arsye.

Zoti nuk e sheh robin në strukturën e jashtme (në pamje), por në zemër. Prandaj, çdo besimtar, duke e mbrojtur nga indiferentizimi zemrën ku shfaqen vështrimet hyjnore, duhet ta dijë për detyrë ta preokupojë atë me zikër.

Për shkak të kësaj rëndësi që ka zikri (dhikri) mes detyrave të adhurimit, përmendet në më shumë se dyqind vende të Kur’anit. Adhurimi i Allahut në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale dhe, në këtë mënyrë, afrimi të Allahu, realizohen në përpjestim të drejtë me pozitën dhe thellësinë e zik-

21 Gjer këtu kemi përdorur më shumë trajtën zikr meqë kjo është bërë traditë tek ne, por në këtë pjesë do të përdorim trajtën dhikr-dhikrullah për saktësi.

22 **Bezmi Elest** (Mbledhja e shpirttrave në paraekzistencë-eternitet); në botën e shpirttrave, Allahu i Lartë i pyeti shpirttrat: “A s’jam unë Zoti juaj?” dhe shpirttrat iu përgjigjën: “Po, ti je Zoti ynë!” duke pohuar hyjnitetin e Allahut, Zotit të gjithësisë. Shih. Kur’ani, A’raf, 172.





rit në zemër. Është për këtë arsye që dhikrullah, domethënë meritimi me zemër i të vërtetës së Zotit, është konsideruar dituria më e çmuar. Sepse kjo është dija esenciale që i duhet njeriut.

Në një pjesë të ajeteve mbi çështjen e dhikrit, me qëllim që njerëzit të mos mbeten të privuar nga fryma shpirtërore e dhikrit, Zoti ka urdhëruar:

أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ آمَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ

“A nuk erdhi ende koha që besimtarëve t’u dridhet zemra me përschpirtshmëri nga përmendja e Allahut dhe Kur’anit të zbritur nga Ai?”

(el-Hadid, 16)

Dhe:

“Përmendja e Allahut është, sigurisht, adhurimi më i madh!” (el-Ankebut, 45)

Dhe:

“Përmendmëni ju mua, që edhe unë t’ju përmend ju! Falenderomëni mua, mos u tregoni mosmirënjohës!” (el-Bekare, 152)

Edhe duke i dërguar Musain dhe Harunin te Faraoni për ftesë, Zoti i ka urdhëruar të mos e harrojnë dhikrin:

“Ti dhe vëllai yt çojani së bashku ajetet e mia. Dhe që të dy mos u tregoni të mefshtë për të më kujtuar dhe përmendur mua!” (Taha, 42)

Ta përmendësh Allahun, pa dyshim që nuk do të thotë vetëm ta përsërisësh fjalën “Allah”, por që kjo fjalë të zërë vend në zemër që është qendra e ndjenjave.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Ai që e përmend Allahun, me atë që s’e përmend, janë si i gjalli me të vdekurin!” (Buhari, *Deavat*, 66)

Dhe:

“Shenja e dashurisë ndaj Allahut është dëshira për ta përmendur Allahun!” (Sujuti, *Xhamiu’s-Sagir*, II, 52)

Me të vërtetë, personat që shmangen nga dhikri, janë nën kërcënimin hyjnor sepse ndodhen larg dashurisë së Allahut. Në Kur’an thuhet:

“Sa keq për ata që u janë ngurtësuar zemrat për ta përmendur Allahun!..” (ez-Zumer, 22)

Për të qenë të qetë nga ky kërcënim, duhet ndodhur vazhdimisht në gjendje dhikri:

“Përmende natë e ditë Zotin tënd me zë të ulët duke iu përgjëruar e duke u dridhur dhe mos u bëj nga indiferentët!” (el-A’raf, 205)

Në ajete është shprehur kështu në lidhje me rrezikun e shmangies dhe largimit nga dhikri:





“Atë që shmanget nga përmendja e Rahmanit, e shqetësojmë me anë të një shejtani që nuk ndahet prej tij!

Pa dyshim, këta shejtanë i shmangin njerëzit nga rruga e drejtë, ndërsa ata pandehin se ndodhen në rrugë të drejtë!

Personi që është shok me shejtanin, kur, më në fund, të vijë tek Ne (për të dhënë llogari), do t’i thotë shokut: “Eh, sikur të kishim qenë nga njëri-tjetri aq larg sa lindja me perëndimin! Sa shok i keq paske qenë ti!” (ez-Zuhruf, 36-38)

Dhe:

“Atë që shmanget për të më përmendur Mua, pa dyshim, e vëmë në vështirësi jetese dhe në ditën e kiametit, e ringjallim të verbër. (Atëherë) Ai thotë:

“Zoti im, pse më ringjalle mua të verbër? Unë më parë kam qenë një njeri që shihja!”

Allahu i Lartë i thotë:

“Po, ashtu ke qenë, por i pate harruar ajetet tona që patën ardhur në botë. Ja, kështu harrohesh edhe ti sot!” (Taha, 124-126)

Morali dhe vetitë e bukura janë të posaçme vetëm për atë që frikësohet nga Zoti, që e do shumë Atë dhe që e përmend shumë Atë! Allahu i Lartë urdhëron:

“Shtatë qiejt e toka dhe çdo gjë që ndodhet në to e madhërojnë Atë. Nuk ka asgjë që të mos e madhërojë Atë me lavdërim e falenderim. Ç’e do se ju nuk e kuptoni dot gjuhën e madhërimit të tyre. Ai është i Butë dhe Falës!” (el-Isra, 44)

*

Në një hadith të shenjtë, në lidhje me dhikrin dhe vlerat e kuvendeve të dhikrit, Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë kështu:

“Allahu i Lartë urdhëron:

Unë e trajtoj robin tim sipas pandehmës së tij për mua. Kur ai më përmend mua, unë jam bashkë me të. Po qe se ai më përmend brenda vetes, edhe unë e përmend. Po qe se ai më përmend mua brenda një grupi njerëzish, unë e përmend brenda një grupi më të dobishëm se ai!” (Buhari, Tevhid, 15)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i pyeti kështu sahabet, shokët e tij:

“A t’ju tregoj se cili është veprimi juaj më i pastër para Allahut, se cila është grada juaj më e lartë, se cila është, për ju, më e dobishme se dhënia e arit dhe argjendit, se cila është më e dobishme se ta vrisni ju armikun kur të përballeni me të ose t’ju vrasë ai?”

Ata iu përgjigjën:

“Na e trego, o i Dërguari i Allahut!”





"Eshtë ta përmendni Allahun!" - Tha i Dërguari i Allahut. (Tirmidhi, *De-awat*,6)

Përmendja (dhikri-zikri) e Allahut mund të bëhet edhe individualisht, edhe në grup. Kështu, Muavije (r.a.) u afrua pranë një grupi njerëzish të mbledhur në formë rrethi në një skaj të xhamisë dhe i pyeti:

"Pse jeni mbledhur këtu?"

"U mblodhëm për ta përmendur Allahun!"

Ai i pyeti përsëri:

"Thomëni, për dashuri të Allahut, a jeni ulur këtu vetëm për ta përmendur Allahun?"

"Po, jemi ulur vetëm me këtë qëllim!" - I thanë.

Atëherë, Muavije (r.a.) u tha kështu:

"Unë nuk u betova sepse nuk i besova fjalës suaj. Nuk ka më të afërt se unë ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe që të ketë rrëfyer hadithe më shumë se unë. Një ditë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) pati shkuar pranë një grupi sahabesh të ulur në formë rrethi dhe i pati pyetur:

"Pse po rrini këtu?"

Ata i qenë përgjigjur:

"Po rrimë për ta përmendur dhe lavdëruar Allahun që na ka favorizuar me Islamin!"

Atëherë i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u pati thënë:

"Më thoni, në emër të Allahut, me të vërtetë jeni ulur këtu vetëm për ta përmendur Allahun?"

"Po, - i qenë përgjigjur sahabet, - vallahi, për këtë qëllim jemi ulur!"

Dhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u pati thënë:

"Unë nuk u betova sepse nuk ju besova, por thashë kështu sepse më erdhi Xhebraili e më tha se Allahu i Lartë krenohet me ju para engjëjve!" (Muslim, *Dhikr*, 40)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i mësonte dhe praktikonte sahabet, shokët e vet, në edukimin shpirtëror sipas mundësive të secilit. Biseda mes tij dhe Ummu Hani është nga shembujt e bukur të kësaj.

Vajza e Ebu Talibit, Ummu Hani (r.anha) iu drejtua të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe e pyeti:

"O i Dërguari i Allahut! Unë u plaka dhe u dobësova. A mund të më këshillosh një adhurim që të mund ta bëj ku të jem ulur?"

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e këshilloi:

"Thuaj njëqind herë "subhanallah", njëqind herë "elhamdulillah" dhe njëqind herë "la ilahe il'lallah"!" (Ibni Maxhe, *Edeb*, 56; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, VI, 344)

Ndër dhikret, vend të veçantë ka thënia kolektive e Fjalës së Njësisë. Për këtë tërhiqet vëmendja veçanërisht në hadithin e rrëfyer nga Sheddad bin Evs (r.a.):





Një radhë, kur ndodheshim pranë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), na pyeti:

“A keni të huaj mes jush?”

Me “të huaj” e kishte fjalën për ndjekësit e Librit, hebrenjtë dhe krishterët.

“Jo, s’kemi, o i Dërguari i Allahut!” - I thamë.

Atëherë, i Dërguari i Allahut urdhëroi të mbylleshin dyert dhe na tha:

*“Ngrini duart dhe thoni **“La ilahe il’lallah!”**”*

Sheddad bin Evsi e tregon kështu vazhdimin e këtij kuvendi:

I ngritëm duart dhe thamë **“La ilahe il’lallah”**. Pas kësaj, i Dërguari i Allahut i uli duart dhe u lut kështu:

“Lavdi Ty, Allahu im! Zoti im, me këtë fjalë më dërgove mua, më urdhërove ta them (dhe të veproj sipas saj) dhe, për këtë, më premtove xhennetin. Ti kurrë nuk e kthen fjalën!”

Pastaj, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u tha kështu shokëve:

“Qofshi të përgëzuar! Allahu i Lartë ju ka falur!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 124)

Në një hadith tjetër thuhet kështu:

“La ilahe il’lallah është një fjalë me vend dhe vlerë shumë të lartë pranë Allahut. Atë që e thotë këtë fjalë me sinqeritet dhe besnikëri të plotë, Allahu e vë në xhennet. Kurse atij që nuk e beson por e thotë vetëm me gojë, i ruhet pasuria, por nesër, kur të takohet me Allahun, Allahu do t’i kërkojë llogari!” (Hejthemi, Mexh-mau’z-Zevaid, I, 26)

Të tërheq vëmendjen edhe ky hadith profetik që shpreh domosdoshmërinë e ndodhjes çdo çast në vetëdijen dhikrullah dhe murakabe:

“Mos u zhytni në biseda të panevojshme duke e harruar Allahun, sepse bisedat e shumta të bëra duke e harruar Allahun, e ngurtësojnë zemrën. Kurse personi që është më larg Allahut, është ai që i është ngurtësuar zemra!” (Tirmidhi, Zuhd, 62)

Siç shihet, dhikrullah është mësuar, sugjeruar dhe nxitur shumë herë nga i Dërguari i Allahut personalisht.

Sa më shumë që ta ndjejmë dhe ta kuptojmë Zotin tonë me thellësi në jetën e kësaj bote, në atë masë do të bëhemi të merituar të bashkimit hyjnor në jetën tjetër, ahiret.

Dashuruesit ndjejnë nevojë për t’i përmendur të dashuruarit në raport të drejtë me forcën e dashurisë që ndjejnë për ta. Nga ana tjetër, edhe përmendja vetë e shton dashurinë e ndjerë ndaj të dashuruarit. Ata që përfitojnë nga kënaqësia e besimit, sa më tepër të përparojnë në këtë drejtim, aq më shumë u shtohen edhe dëshirat, edhe përmendjet.





Ata që në çdo rast e në çdo situatë ndodhen vazhdimisht në gjendje dhikri, zhyten në urtësitë e krijimit të qiejve e të tokës, meditojnë dhe luten:

“... Zoti ynë, Ti nuk i krijove kot këto! Ne të madhërojmë Ty! Mbro-na nga vuajtja e xhehennemit!” (Al-i Imran, 191)

Jetesa me besim dhe bashkimi me Zotin me një besim të plotë kalojnë përmes dhikrit. Sepse njeriu vdes siç ka jetuar dhe ringjallet siç ka vdekur. Në hadithin profetik thuhet:

“Në ditën e kiametit, njerëzit do të ringjallen në atë gjendje siç kanë vdekur!” (Muslim, *Xhennet*, 83)

Asnjë gjë nuk mund të arrijë ta kënaqë dëshirën afektive dhe të mediti-mit të njeriut në nivelin e njohjes së ekzistencës së Qenies së Domosdoshme i cili është Sunduesi dhe Rregulluesi i gjithësisë. Sepse, siç thuhet në ajetin kur’anor:

أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

“Zemrat arrijnë ngopjen dhe kënaqësinë vetëm me përmendjen e Allahut!” (er-Rad, 28)

g) Ndjenja e afërsisë ndaj Resulullahut (s.a.s.) dhe salavati sherife

“Pa dyshim, Allahu dhe engjëjt i bëjnë shumë salat Profetit. O besimtarë, edhe ju bëjini salat Atij dhe jepini selam me një nënshtrim të plotë!” (el-Ahzab, 56)²³

Ne e kemi të pamundur ta njohim plotësisht brenda kapacitetit dhe mundësisë njerëzore Profetin tonë (s.a.s.), i cili është një mrekulli krijimi. Mbresat e marra nga kjo botë mbeten të pamjaftueshme për ta shpjeguar dhe njohur atë. Ashtu siç është e pamundur të futet oqeani në një gotë me ujë, nuk është e mundur as të njihet Drita Muhammediane ashtu siç duhet.

Si shprehje e kësaj të vërtete, në Kur’an urdhërohet:

23 Origjinali i ajetit është kështu: Innallahe ve melaiketehu jusal'lune ale'n-nebiji; ja ejjuhel'ledhine amenu sal'lu alejhi ve sel'limu teslima. Me të vërtetë, Allahu dhe engjëjt luten për Profetin; o ju që keni besuar, lutuni për të dhe përshëndeteni atë me bindje të plotë! Fjala *salat* (shumës: *salavat*) do të thotë *lutje*, kurse fjala *selam* do të thotë *urim për paqe dhe shëndet, përshëndetje*. “Allahumme sal'li ala Muhammedin” (Allahu ynë, fale Muhammedin) - është *salat*; “Esselamu alejke ejjuhe'n-nebijju” (Paqe ty, o Profet) - është *selam*. Përthyesi.





إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ
يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

“Pa dyshim, Allahu dhe engjëjt i bëjnë shumë salat Profetit. O besimtarë, edhe ju bëjini salavat Atij dhe jepini selam me një nënshtrim të plotë!” (el-Ahzab, 56)

Si domosdoshmëri e dekretimit hyjnor në këtë ajet, salati dhe selami për Profetin janë të detyrueshëm.

Lutja dhe përshëndetja për Profetin për të cilin luten dhe të cilin e përshëndesin Allahu bashkë me engjëjt, është një domosdoshmëri besimi. Zoti ynë thotë kështu në Kur’an:

“(O i Dërguar!) Thuaju: “Po qe se pretendoni se e doni Allahun, ndiqmëni mua që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë mëkatet!” (Al-i Imran, 31)

Është e padiskutueshme se kur besimtari, përballë dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i zbraz rrëqethjet hyjnore nga të gjitha linjat dhe pamjet frymore, subjektive e egoistike, do të thotë se ka hyrë në rrugën e marrjes pjesë nga dashuria dhe personaliteti shembullor i tij.

Burrat e zemrës së ummetit të cilët, duke marrë pjesë nga personaliteti i bekuar i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), janë shkrirë dhe humbur në personalitetin e tij, kanë shpalosur shembuj të bukur të dashurisë për të Dërguarin e Allahut (s.a.s.).

Ata që e arrijnë burimin e dashurisë të Dërguarit të Allahut, jetojnë gjer në kiamet si miq të ummetit, bashkësisë së Muhammedit dhe, pas jetës së tyre të vdekshme kujtohen vazhdimisht me mëshirë dhe lutje. Ja dy nga të pasionuarit e panumërt ndaj të Dërguarit të Allahut.

Profeti dërgoi mësues në fiset përreth për ta përhapur fenë e së drejtës dhe për t’ua mësuar atë njerëzve. Por disa prej këtyre mësuesve qenë tradhtuar dhe vranë. Njëra nga këto ngjarje pati ndodhur në ngjarjen Rexhi.

Fiset Adal dhe Kare kërkuan nga i Dërguari i Allahut mësues që t’ua mësonin Islamin. Ai dërgoi një ekip prej dhjetë vetësh. Kur ekipi në formë karvani arriti në zonën Rexhi, ra në pritë. Tetë prej tyre u vranë, kurse dy u zunë robër dhe iu dërguan politeistëve mekas.

Robërit ishin sahabet Zejd dhe Hubejd (r. anhumas). Të dy u vranë nga politeistët mizorë. Para se ta vrisnin Zejdin, e pyetën:

“A nuk do të deshe që, në shkëmbim të jetës, të shihje në vendin tënd pejgamberin tënd?”

Zejd (r.a.) e pa me keqardhje Ebu Sufjanin që ia bëri këtë pyetje dhe iu përgjigj:

“Jo vetëm që s’dua të ndodhet këtu pejgamberi im që e dua si fëmijët e mi, por as dhe t’i ngulet një gjemb në këmbë!”





Ebu Sufjani ngriu para kësaj shfaqjeje dashurie.

“Çudi, me të vërtetë!” - Tha ai. “Unë s’kam parë gjer më sot në jetën time dikë që ta duan sa ç’e duan Muhammedin shokët e vet!”

Pastaj shkuan te Hubejbi (r.a.). Atij i thanë se do të shpëtonte po të hiqte dorë nga feja.

Hudejb (r.a.) u tha:

“Edhe sikur të ma falni botën, nuk heq dorë nga feja!”

Pastaj ia bënë edhe pyetjen që i bënë Zejdit dhe morën të njëjtën përgjigje.

Ndërkaq, Hubejbi pati një dëshirë të fundit para vdekjes:

“T’i dërgonte përshëndetje me dashuri të Dërguarit të Allahut!”

Mirëpo, me kë do t’ia dërgonte? Pranë s’kishte asnjë musliman! I ngriti sytë me dëshpërim drejt qiellit dhe, me përgjërim, tha:

“Allahu im! Këtu s’ka asnjë njeri që t’ia çojë përshëndetjen të dërguarit Tënd! Dërgoja Ti përshëndetjen time!”

Në këtë çast, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) po rrinte në Medine së bashku me shokët, të cilët e dëgjuan atë të thoshte pa iu drejtuar kujt: “*Ve alejhis-selam!*”

Shokët e pyetën me habi:

“O i Dërguari i Allahut, përshëndetjes (selamit) të kujt iu përgjigje?”

“*Selamit të vëllait tuaj, Hubejb!*” - U tha ai.

Më në fund, qafirët i vranë të dy sahabet duke i vënë nën tortura të rënda. Njëra nga fjalët e thëna nga Hubejbi ndërsa po vdiste është shumë e kuptimshme:

“Nëse vdes si musliman, ç’rëndësi ka nëse vdes kështu apo ashtu?²⁴

Ja, pra, ashku dhe guximi i sahabeve, shokëve të Profetit. Ndërsa një tablo e tillë torturash na rrëzon ne në tmerr, ata që e donin të Dërguarin e Allahut me pasion, kurrë nuk dridheshin para një pamjeje të tillë. I gjithë halli i tyre ishte të meritonin vëmendjen e të Dërguarit të Allahut!

Edhe shembulli në vijim ku shpaloset malli dhe dashuria për të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), sa mësimdhënës është për ne!

Abdullah bin Zejd el-Ensari (r.a.) shkoi te i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe i tha duke qarë:

“O i Dërguari i Allahut! Ti je më i dashur për mua se vetja ime, malli dhe pasuria ime, se fëmijët dhe familja ime! Po të mos ishte e mira për të ardhur këtu e për të parë ty, do të dëshiroja të vdisja!”

Profeti (s.a.s.) e pyeti:

“*Pse qan?*”

Ensariu iu përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut! Qaj sepse mendoj që do të vijë një ditë që edhe ti do të vdesësh, edhe ne do të vdesim dhe, ndërsa ti do të jesh në pozita të

24 Shih. Buhari, *Megazi*, 10; Vakidi, *Megazi*, f. 280-281.





larta bashkë me profetët e tjerë, ne, edhe sikur të hyjmë në xhennet, do të mbetemi në pozita të ulta!”

Oqeani i mëshirës, Profeti ynë (s.a.s.), nuk i dha përgjigje, por ndenji ashtu, i heshtur. Në këtë mes, zbriti ajeti që thoshte:

“Kush u bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ja, ata do të jenë së bashku me profetët, besnikët, dëshmorët dhe të mirët, të cilëve Allahu u ka dhënë dhunti. Ç’miq të mirë që janë ata!” (en-Nisa, 69)

Abdullah bin Zejd el-Ensariu (r.a.) ishte duke punuar në bahçe kur i biri erdhi me një frymë dhe me dëshpërim dhe e lajmëroi se i Dërguari i Allahut kishte vdekur. I tronditur rëndë nga ky lajm, Ensariu u lut kështu:

“Allahu im! Merrmi sytë që këtej e tutje të mos shoh më njeri tjetër veç Muhammedit i cili ka qenë njeriu i vetëm që kam dashur!”

Lutja e Abdullah bin Zejd el-Ensariut u pranua dhe sytë iu verbuan aty për aty!²⁵

Dashuria dhe afërsia janë një linjë rryme mes dy zemrave. Ata që duan, kurrë nuk i heqin goje dhe zemre të dashurit e tyre. Ata jetojnë dhe vdesin mes kënaqësisë së sakrificës së jetës dhe pasurisë së vet për të dashurit.

Në Kur’an urdhërohet:

“Falni namaz, jepni zeqat dhe bindiuni Profetit që të fitoni mëshirën hyjnore!” (en-Nur, 56)

Sipas parimit “ai që dashuron, do çdo gjë të atij që dashuron dhe jepet krejtësisht pas tij”, ndjekja në çdo gjë e Profetit, të Dashurit të madh, i cili është model, është kusht, ashtu që dashuria dhe pasioni për të si dhe ndjekja e tij përbëjnë shtyllën kurrizore të dashurisë për Zotin.

Në Fjalën e Njësisë (Tevhid), pas “la ilahe illallah” (nuk ka zot tjetër veç Allahut) vjen “Muhammedun resulullah” (Muhammedi është i dërguari i Allahut). Çdo fjalë e njësisë dhe çdo lutje e përhëndetje për Profetin përbëjnë kapitalin e afërsisë dhe dashurisë për të Vërtetën (Zotin). Lumturia e jetës së kësaj bote e të jetës së pasme, ahiretit, si dhe të gjitha ngadhënjimet arrihen me dashurinë për Të. Bota është shfaqje e dashurisë hyjnore. Elementin thelbësor të kësaj dashurie e përbën Drita Muhammediane dhe rruga e vetme e arritjes të Individualiteti Hyjnor është dashuria për Të!

Fryma shpirtërore në adhurime, delikatesa në sjellje, etika në moral, tejdukshmëria në zemër, bukuria në fytyra, elokuenca në shprehje, brishtësia në ndjenja, thellësia në shikime, shkurtimisht, të gjitha bukuritë janë veçullime të reflektuara në zemra nga dashuria për Atë dritën e ekzistencës!

Poeti dhe mistiku i madh Mevlana shprehet kështu:

“Eja, o zemër! Festa e vërtetë është bashkimi me Muhammedin, sepse drita e botës është prej bukurisë së asaj qenieje të bekuar!”





Lutja dhe përshëndetja për Profetin që në gjuhën fetare quhen *salavati sherife*, kanë rëndësi shumë të madhe për të ngulitur në zemra frymëzimin dhe begatinë hyjnore, për të fuqizuar lidhjen me Profetin veçanërisht në kohën e zbardhjes së dritës dhe për të marrë pjesë nga fryma shpirtërore e tij.

Miqtë e të Vërtetës që kanë gjetur jetë në të vërtetën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i kanë radhitur kështu vlerat e salavatit dhe afrimit ndaj Profetit:

1) Me bindjen ndaj urdhrat hyjnor, fitohet salavati i Allahut dhe engjëjve. Në Kur'an thuhet:

“Me të vërtetë, Allahu dhe engjëjt luten për Profetin; o ju që keni besuar, lutuni për të dhe përshëndeteni atë me bindje të plotë!” (el-Ahzab, 56)

Nuk ka dyshim se mes salateve dhe selameve të Allahut, engjëjve dhe ummetit ka ndryshime kuptimore. Salati i Allahut është mëshirë dhe lartësim për profetin e Tij. Salati i engjëjve është pendesë dhe lutje për Profetin. Kurse salati i besimtarëve është lutje e tyre për Profetin.

2) Salavati sherife është pretekst për faljen e mëkateve. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Atij që më bën mua salat një herë, Allahu i bën salat dhjetë herë, i fshihen dhjetë mëkate dhe lartësohet dhjetë gradë!” (Nesai, *Sehv*, 55)

3) Në kiamet, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ndodhet pranë tij. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Njerëzit më të afërt me mua në ditën e kiametit do të jenë ata që kanë bërë më shumë për mua salat dhe selam!” (Tirmidhi, *Vitr*, 21)

4) I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i përgjigjet atij që këndon salat. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Për t’iu përgjigjur selamit të atij që më dërgon mua selam, Allahu ma kthen shpirtin!” (Ebu Davud, *Menasik*, 96)

5) Profetit i paraqitet emri i secilit që bën salat. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Mbi tokë ka engjëj shëtitës të Allahut. Ata ma sjellin në çast selamin e ummetit tim!” (Nesai, *Sehv*, 46)

6) Personi që këndon salat dhe selam, meqë dashurinë për të Dërguarin e Allahut e ka parapëlqyer ndaj dashurive të tjera, fiton nivel në pajisjen me moralin e tij, shpëton nga morali i keq dhe bëhet i virtytshëm.

7) Dashuria e personit për Profetin dhe e Profetit për personin vijnë duke u shtuar e shumëfishuar.

8) Ndërsa favoret që na ka dhuruar Allahu i Lartë me anë të Profetit janë aq shumë sa të mos numërohen dot, me salat dhe selam ne përpiqemi ta paguajmë sado pak detyrimin që kemi për Profetin.





9) Salavati sherife është pretekst që mbi ne të zbresë mëshira e Allahut të Lartë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Atë që më dërgon mua një herë salat dhe selam, Allahu e mëshiron atë dhjetëfish!” (Muslim, *Salat*, 70)

10) Salati sherife bëhet pretekst për të kujtuar fjalën e harruar.

11) Bëhet pretekst për pranimin e lutjeve.

Pas namazit, Profeti (s.a.s.) pa një burrë që bëri lutje pa e falenderuar Allahun dhe pa i dërguar salat dhe selam Profetit. Ai tha: “Ky burrë u nxitua!” Pastaj e thirri pranë burrin dhe i tha kështu:

“Kur të bëni lutje, në fillim ta lavdëroni dhe falenderoni Allahun e Lartë, pastaj të më dërgoni mua salat dhe selam!” (Tirmidhi, *Deavat*, 64)

Në një hadith profetik thuhet:

“Për sa kohë që të mos i këndojë salavat Profetit, lutja e personit mbetet e izoluar (nuk e arrin dot synimin)!” (Mundhiri, *et-Tergib ve't-Terhib*, III, 165)

12) Personi që i dërgon Profetit salat dhe selam, mbrohet nga qortimi hyjnor. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Atij që, kur pranë tij përmendet emri im, nuk më dërgon salavat mua, theftë hundën!” (Tirmidhi, *Deavat*, 100)

13) Allahu e ndihmon personin që i bën salat Profetit të vet dhe ia heq të gjitha dëshpërimet e kësaj bote e të jetës tjetër!

Me të vërtetë, Ubej b. Ka'b (r.a.) thotë:

“E pyeta Hz. Pejgamberin:

“O i Dërguari i Allahut! Unë të dërgoj ty shumë salavati sherife. Në ç'masë duhet ta bëj këtë, vallë?”

“Bëj sa të duash!” - M'u përgjigj.

“A është e përshtatshme sikur një të katërtën e lutjeve t'i ndaj për salavati sherife?”

“Ndaj sa të duash, por po bëre më shumë, është më mirë për ty!” - Më tha.

“Atëherë, gjysmën e lutjeve t'i lë për salavati sherife!” - I thashë.

“Lër sa të duash, por po le më shumë, është më mirë për ty!” - Më tha.

Unë prapë:

“Atëherë, a mjafton dy të tretat?” - I thashë.

“Sa të duash, por po e shtove, është më mirë për ty!” - Më tha.

“Atëherë, si bëhet po ta ndaj gjithë kohën e lutjeve për të të sjellë ty salavati sherife?” - I thashë.

“Atëherë, Allahu t'i heq të gjitha shqetësimet dhe t'i fal të gjitha mëkatet!” (Tirmidhi, *Kijamet*, 23)

Lutja dhe përsëritja për Profetin bën të mundur ngritjen e lidhjes me botën shpirtërore të tij dhe përfitimin prej dritës së tij. Kurse përfitimi





nga lutja dhe përshëndetja janë në raport të drejtë me dashurisë dhe sinqeritetit të personit ndaj Profetit.

**O Profet, të pafund qofshin lutjet dhe përshëndetjet për ty!
Të lutem, o i Dërguari i Allahut!** ²⁶

h) Meditimi mbi vdekjen

As në botë nuk ka kohë dhe vend për t'i ikur vdekjes, as në varr nuk ka mundësi për t'u kthyer prapë, as në kiamet nuk ka ndonjë strehim për t'u fshehur nga forca dhe tmerri i tij!..

Në rrjedhën e jetës, njeriu lëkundet mes dy të kundërtave të tmerrshme, si gëzimi i jetës dhe frika e vdekjes. Pa u rrokur kuptimet e vërteta të jetës dhe vdekjes që ndodhen në një rrjedhë të pandërprerë, nuk mund të konceptohen dot as enigma dhe urtësia e krijimit bashkë me natyrën e vërtetë të njeriut.

Vdekja e cila do t'i bjerë në kokë pa përjashtim çdo udhëtari të jetës, është një e panjohur që të gjitha qeniet me vetëdije janë të detyruara ta zgjidhin!

Në ajetin 2 të sures Mulk të Kur'anit thuhet:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيُنَبِّئَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا

"Ai që ka krijuar vdekjen dhe jetën për të provuar se cili nga ju do të bëjë punë më të mira!"

Dhe në ajetin 35 të sures Enbija thuhet:

"Çdo i gjallë do ta shijojë vdekjen. Ne ju provojmë ju edhe me të mirën, edhe me të keqen. Dhe pastaj do të ktheheni vetëm tek Ne!.."

Bota është një shkollë besimi hyjnore, kurse vdekja, një ligj kalimi i pashmangshëm. Hz. Mevlana thotë:

"Vaisni që të ringjallen!"

Ringjallja e zemrës është e mundur vetëm me heqjen dorë prej subjektivitetit. Profeti (s.a.s.) porositi:

²⁶ Në origjinal është kështu: "Dahilek, ja Resulallah!" e shpjeguar në formën "O i Dërguari i Allahut, jam nevojtar për shefaatin dhe mëshirën tënde!"





“Kujtojeni shpesh vdekjen e cila i asgjëson me rrënjë të gjitha dëfrimet e kënaqësitë!” (Tirmidhi, *Kijamet*, 26)

Të meditosh mbi vdekjen do të thotë ta kujtosh vdekjen pa të ardhur ende vdekja, kështu, duke u larguar nga subjektiviteti, të përgatitesh në mënyrë të vullnetshme për daljen para Allahut. Është një meditim dhe vetëdije e mbështetur mbi besimin.

Dëshirat dhe qëllimet materiale të njeriut të cilat s’dinë të sosur, shpresat dhe ngushëllimet e përkohshme e të vdekshme janë si një rënie gjethesh e tmerrshme mbi dheun e varrit!

Varrezat janë të mbushura plot me adresat e nënave dhe baballarëve, grave e fëmijëve, të dashurve dhe farefisit, miqve e shokëve që e patën konsumuar një ditë jetën e tyre të përkohshme. Kudo që të bëhet jeta e kësaj bote, në pallat apo në mashnën e kashtës, pikëdalja e detyruar e të gjitha rrugëve dhe kthesave është varri. Nuk ekziston as ndonjë kohë dhe as ndonjë vend nga mund të iket prej saj për të shpëtuar!

Në Kur’an thuhet:

“Thuaju: “Ç’është e vërteta, vdekja nga e cila ikni, patjetër ka për t’ju zënë. Pastaj do të ktheheni te Allahu që e njuh të fshehtën dhe të hapurën. Dhe Ai do t’ju thotë një e nga një se ç’keni bërë!” (el-Xhuma, 8)

Çdo gur varri i mbuluar nën heshtjen e vdekjes është një këshillues i zjarrtë që flet me gjuhën e gjendjes së vet. Fakti që varrezat janë formuar brenda qyteteve, përreth rrugëve dhe në avllitë e xhamive, është një lloj meditimi mbi vdekjen, domethënë, mendim i vdekjes dhe rregullim i botës sipas saj. Peshën rrëqethëse të vdekjes nuk mundën ta mbajnë supet e dobëta të fjalëve. Përballë vdekjes marrin fund dhe shkrihen të gjitha pushtetet!

Bota është një iluzion optik në shkretëtirë, kurse jeta e pasme, ahireti, një jetë e pavdekshme. Në përgjithësi, mes një mijë e një lojrave dhe shfaqjeve të jetës, njeriu është robi i gënjeshtreve në pasqyrë. Kjo botë e cila e vë në veprim çdo çast pabesinë e saj me anë të këtyre gënjeshtreve, në s’është një vend mashtrimi, ç’është?

A nuk merr mësim njeriu që freskia dhe gjallëria e çdo qenieje të vdekshme dërrmohet e bluhet papushim mes gurëve të mullirit të kohës? Zhytja me anë të një jete të jetuar pa ditur gjë mbi të vërtetën e ahiretit, në konsiderata temporale dhe lojra të përkohshme të cilat nxisin dëshirat sensuale është një vetëmashtrim i frikshëm përballë perspektivës së madhe e të pafundme! Jeta në padije, indiferentizëm dhe moskokëçarje përbëhet prej lojrave në fëmijëri, epshit në rini, indiferentizmit në pjekuri dhe mallit për gjërat e dalura dore, një mijë e një përpëlitjeve dhe pendimeve në pleqëri!





Vdekja është kiameti²⁷ specifik i personit. Prandaj, le të zgjohemi para kiametit që të mos bëhemi ndër ata që pendohen. Sepse është jashtë çdo diskutimi se çdo i vdekshëm do të takohet patjetër me Engjëllin e Vdekjes²⁸ në një çast dhe vend të caktuar. Prandaj, pa humbur kohë, duke përfutuar nga thirrja “...vraponi te Allahu...” (edh-Dharijat, 50), ta pranojmë mëshirën hyjnore si strehimin dhe banesën e vetme!

Meditimi më i qartë mbi vdekjen është i fshehur në enigmën e heshtjes së pazgjidhshme të lidhur nyje në buzët e mavijosura të të vdekurve!

Përgjigjet që vijnë nga bota përballë oratorisë këshilluese të vdekjes, janë vetëm lot dhe ngashërime të kota!

Por sa e çuditshme është që njeriu e gënjen veten në këtë botë ku ndodhet si vizitor për pak ditë. Megjithëse çdo ditë vëzhgon skena funebre, vdekjen e shih si diçka që s’ka të bëjë me atë vetë. Mirëpo, në çastin kur njeriu, pasi i vishet shpirtit të tij një trup, futet në këtë botë, bëhet, njëkohësisht, një udhëtar drejt vdekjes. Pastaj, në varrin i cili është porta e jetës së pasme, ahiretit, përcillet për një tjetër udhëtim të madh!

Çdo çast që bie nga shiriti i kohës, na afron në mëngjesin e të vërtetës. Kur’ani na e pohon kështu këtë:

“Kujt t’i japim jetë të gjatë, ia kthejmë së prapi krijimin. A nuk e mendojnë këtë?” (Jasin, 68)

Në ajetin kur’anor, njeriu këshillohet në mënyrën më të mirë. Cilësia dalluese e kësaj bote është pabesia. Ajo ta merr shpejt prapë atë që të ka dhënë. Një ditë të lartëson, të nesërmen të zbret në fund të pusit. Kjo botë është si hija. Po deshe ta zësh, të ikën. Por edhe sikur të duash t’i ikësh, të ndjek pas pa të lënë. Ajo i flizon shpejt ata që lidhen pas saj.

Duhet menduar se as ka në botë ndonjë vend dhe kohë për të ikur nga vdekja, as ka në varr ndonjë mundësi për t’u kthyer pas, as dhe ka ndonjë strehim për t’u fshehur nga forca e kiametit.

Një sahabi, shok i Profetit (s.a.s.), e pyeti atë:

“O i Dërguari i Allahut, cili besimtar është më i mençur?”

Profeti iu përgjigj kështu:

“Ai që e kujton shpesh vdekjen dhe bën përgatitjen më të mirë për pas vdekjes! Ja, këta janë njerëzit e mençur!..” (Ibni Maxhe, *Zuhd*, 31)

Gjithashtu, Profeti (s.a.s.) ka thënë:

“Kujtoni vdekjen dhe kalbjen e kufomës dhe eshtrave pas vdekjes! Ai që e kërkon jetën e ahiretit, e braktisin stolinë e jetës së kësaj bote!” (Tirmidhi, *Kijamet*, 24)

Fudal bin Ijad thotë:

“Vdekja është e mjaftueshme si këshillë për njerëzit!”

27 Këtu, fjala kiamet është përdorur me kuptimin përmbysje, apokalips. Përkthyesi.

28 Në origjinal: Azrail. Përkthyesi.





Dikush nga sahabet kishte vdekur. Shokët folën me lavdërim për të dhe thanë se kishte bërë adhurime shumë.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i dëgjonte në heshtje. Kur mbaruan së foluri ata, e mori fjalën ai dhe i pyeti shokët:

"Personi për të cilin flisni, a e kujtonte shpesh vdekjen?"

"Jo!" - I thanë ata.

"Mirë, po a hiqte dorë shpesh nga nga dëshirat e panevojshme dhe të tepruara të nefsit?" - I pyeti Profeti.

"Jo, o i Dërguari i Allahut!" - Iu përgjigjën sahabet.

Atëherë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) tha:

"Shoku juaj s'paska qenë aq sa thatë ju!" (Hejthemi, Mexhmau'z-Zevaid, X, 308-9)

Abdullah bin Omer (r.a.) tregon:

"Hz. Pejgamberi më kapi dhe më tha:

"Sillu në këtë botë si një i vetmuar, madje si një udhëtar! Dhe quaje veten një nga të vdekurit, një nga banorët e varrezës!"

Njëri nga të mëdhenjtë e tabiinëve, Muxhahid bin Xhebr (rahmetullahi alejh) thotë:

"Pasi e tregoi këtë hadith, Abdullah bin Omeri (r.a.) më dha këtë këshillë:

"O Muxhahid! Kur të gdhihesh në mëngjes, mos i fol nefsit për mbrëmjen dhe kur të bëhet mbrëmje, mos i fol për mëngjesin! Përfito nga shëndeti para se të sëmuresh dhe përfito nga jeta para se të vdesësh! Sepse, o rob i Allahut, nuk e di se në ç'gjendje do të jesh nesër (i gjallë apo i vdekur)!" (Tirmidhi, Zuhd, 25)

Enes b. Malik thotë:

"Çdo ditë, toka i flet njeriut me këto dhjetë këshilla:

O njeri!

E para, ti tani shëtit mbi mua, por tek unë ke për t'u kthyer!

E dyta, ti bën çdo lloj mëkati mbi mua, por brenda meje do të ndëshkohesh!

E treta, ti qesh e dëfrehesh mbi mua, por brenda meje ke për të qarë!

E katërta, ti gëzohesh mbi mua, por brenda meje do të dëshpërohesh!

E pesta, ti mbledh mall e pasuri mbi mua, për brenda meje do të pendohesh!

E gjashta, ti ha haram mbi mua, por brenda meje kanë për të të ngrënë krimbat!

E shtata, ti mbahesh më të madh mbi mua, por brenda meje ke për t'u poshtëruar!

E teta, ti ecën me hare mbi mua, por brenda meje do të mbetesh në hidhërim!

E nënta, ti shëtit në dritë mbi mua, por brenda meje do të mbetesh në errësirë!





E dhjeta, ti ndodhesh mes njerëzve mbi mua, por brenda meje do të hysh i vetëm! (Ibni Haxher el-Askalani, *Munnebihat*, 37)

Duke u folur shokëve mbi mjeshtrin e urtësisë dhe oratorisë, Kuss bin Saide, Profeti (s.a.s.) ka thënë kështu:

“E pata parë Kuss bin Saiden në panairin e Ukadhit mbi deve tek po u fliste njerëzve kështu:

“O njerëz! Ejani, dëgjoni, mbajeni mend mirë dhe merrni shembull! Kush jeton, vdes; kush vdes, merr fund; ç’ka për t’u bërë, bëhet! Shiu reshon, barërat mbijnë, fëmijët lindin dhe zënë vendin e prindërve. Dhe, pastaj, të gjithë shkatërrohen dhe mbarojnë. Ngjarjet nuk ndërpriten, ato ndjekin njëra-tjetrën. Në qiell ka njoftime, në tokë ka gjëra mësimdhënëse. Faqja e tokës është një shtrat i shtrirë, faqja e qiellit është një tavan i lartë. Yjet ecin, detrat rrinë në vend. Kush vjen, s’mbetet këtu; kush ikën, s’kthehet prapë. A mos vallë mbeten atje se janë të kënaqur me vendin ku kanë shkuar, apo janë shtrënguar të qëndrojnë aty dhe kanë rënë në gjumë?...”

O fisi Ijad! Ku i keni baballarët dhe gjyshërit? Ku janë fiset Ad dhe Themud që patën bërë pallate të stolisura dhe banesa prej guri? Ku janë Faraoni dhe Nemrudi që krenoheshin me pasuritë e kësaj bote dhe i thoshin popullit se ishin zot?

Kjo tokë i thërrmoi ata në gurin e mullirit, i bëri pluhur. Edhe kockat, bile, iu kalbën dhe iu shpërndanë. Kurse shtëpitë u shembën dhe mbetën pa njeri. Vendet e tyre tashmë i gjallërojnë qentë. Kujdes, mos u tregoni moskokëçarës si ta. Çdo gjë është e përkohshme, vetëm Zoti është i përhershëm!

Lumi i vdekjes ka shumë vende për të hyrë në të, por vend për të dalë s’ka!...”²⁹

Vdekja e cila është akti i fundit i skenarit të jetës, është si një pasqyrë që lajmëron secilin për fundin e vet. Po qe se një njeri rron nën pushtetin e nefsit të vet dhe duke pasur si synim këtë botë, varri i duket atij si një vrimë e errët. Edhe sjellja ndërmend e vdekjes, madje, e bën atë të vuajtur në shkallë të pakrahasueshme me asgjë tjetër.

Po qe se njeriu e kapërcen pengesën nefs dhe, si përfundim i meditimt mbi vdekjen, përparon në drejtim të cilësive engjëjlore të fshehura në shpirtin e tij, vdekja i duket paimagjinueshmërisht madhështore dhe si kusht i domosdoshëm i bashkimit me Zotin e vet transcendental. Kështu, vdekja e cila në përgjithësi bëhet shkak te njerëzit për ethe të ftohta, te ai kthehet në emocion të bashkimit me të dashurin. Vdekje të tilla, sipas shprehjes së mjeshtrit të madh të rrugës mistike, Mevlana Xhelaleddin Rumi, është “sheb-i arus”, “nata e parë e martesës”. Kjo është një rrugë e tillë që e bën vdekjen, ngjarjen më të tmerrshme për njeriun, të bukur. Ndër-

²⁹ Shih Bejhaki, *Kitabu’z-Zuhd*, II, 264; Ibni Kethir, *el-Bidaje*, II, 234-241; Hejthemi, *Mexhmau’z-Zevaid*, IX, 418.





kaq, “zbukurimi i vdekjes” mund të realizohet vetëm me anë të përsosjes përmes kapërcimit të nefsit dhe përjetimit të situatave afektive, si pendesa (tevbe), përkushtimi në adhurim (zuhd), dorëzimi (tevekkul), përkorësia (kanaat), përmendja e Allahut (dhikr), vështrimi kah Allahu (tevexhxhuh), durimi (sabr), vetëkontrolli i brendshëm (murakabe) dhe pëlqimi (riza).

Meditimi mbi vdekjen ushtron një ndikim të rëndësishëm, të pakrahasueshëm me asgjë tjetër për arritjen e zemrës në këtë nivel purifikimi. Në lidhje me këtë specifikë, Rebi bin Husejin thotë kështu:

“Po qe se zemra më largohet nga sjellja ndërmend e vdekjes, frikësohem se mos më priset. Sa për mua, do të dëshiroja të qëndroja në varreza gjersa të vdisja, në qoftë se me këtë veprim nuk do t’u bëja opozitë paraardhësve!” (Bejhaki, Kitabu’z-Zuhd, f. 212)

Vdekja është një fillim i detyrueshëm i udhëtimit të ahiretit. Para se të dilet për në këtë udhëtim, përgatitja e zemrës për vdekjen me anë të njohjes nga afër të Zotit, sigurimi i shëndetit dhe paqes së zemrës duke shpëtuar nga dyshimet dhe shqetësimet e vdekjes janë gjëra që kurrsesi s’duhen nënvleftësuar. Kështu vërtetohet e fshehta *“vdisni para se të keni vdekur”* dhe njeriu, në vend të sundimit të nefsit pothuaj të asgjësuar, realizon në kuptim të plotë afërsinë dhe bindjen ndaj Allahut!

j) Qëndrimi me njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq)

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe bashkohuni me besnikët!” (et-Tevbe, 119)

Për ta ruajtur zemrën nga vanitetet dhe për ta bërë objekt dhe bashkëbisedues të vazhdueshëm të sugjerimeve për të mirën, afërsia, konfidenca dhe intimiteti me njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq), nga bota shpirtërore e të cilëve mund të merret frymëzim, është e detyrueshme.

Zemra vishet me ngjyrën, formën dhe harmoninë e mjedisit ku ndodhet, vetëm se kjo gjendje është faza fillestare e hedhjes rrënjë dhe vendosjes së ndikimeve të caktuara në zemër. Ndikimet pozitive ose negative të mëpasme, për shkak të ngjashmërisë ose kundërshtisë me të mëparshmet, mund të jenë edhe pozitive, edhe negative. Por, në qoftë se në fillim zemra nuk vihet nën ndikime të mira për t’u sjellë në një konsistencë të caktuar, ndodhet nën një rrezik të madh. Sepse zemra e bërë objekt i ndikimeve të jashtme, ose mbetet nën ndikimin e tyre në raport të drejtë me afërsinë që tregon ndaj tyre, ose luan një rol kundërshtues ndaj tyre gjithashtu në raport të drejtë me neverinë që ndjen ndaj tyre. Është për këtë arsye që





përdorimi me vend i ndjenjave të afërsisë dhe neverisë në lartësimin ose rënieën poshtë shpirtërisht të njeriut është një institucion me mjaft rëndësi.

Po të mbahet parasysh kjo e vërtetë, dalin në shesh në mënyrë të qartë nevoja dhe rëndësia e ndenjes bashkë dhe jetesës me robtë e mirë (salih) të Allahut me qëllim përparimin shpirtëror. Ndërkaq, përfitimi realizohet në raport të drejtë me afërsinë dhe dashurinë e ndjerë ndaj bashkëbiseduesit, ndryshe, edhe nëse një shoqërim i thatë indiferent ndaj thellësisë shpirtërore mund të sigurojë pak a shumë dobi, nuk e siguron dot rezultatin e kërkuar. Në lidhje me këtë specifikë, është shumë domethënëse rrëfimi i përcjellë nga Bejazit Bistamiu (k.s.).

Njëri nga myridët e vet i thotë kështu Bejazit Bistamiut:

“Imzot, sikur të më jepnit një copë nga qyrku juaj dhe ta mbaja me vete për ogur!..”

Dhe Bistamiu i jep këtë përgjigje:

“O bir, nëse ti s’je vetë i orientuar në rrugë të drejtë, jo të hysh në qyrkun e Bajazitit, por t’ia rrjepësh lëkurën e të hysh në të, s’të bën dobi!”

Në tërë gjithësinë ekziston dhe vepron një prirje identifikimi, gjë që buron nga identiteti i origjinës së ekzistencës. Për më tepër, kjo prirje e përgjithshme identifikimi vlen edhe për cilësitë fizike, edhe për gjendjet shpirtërore.³⁰ Për shembull, në qoftë se në skaj të një dhome derdhet një shishe me një lëng aromatik të mprehtë, aroma do të vazhdojë të përhapet nëpër të gjitha skajet gjerë të vijë në të njëjtin nivel në të gjitha molekulat e ajrit. Kjo cilësi që vlen për të gjitha shfaqjet antagonistë si të nxehtit dhe të ftohtit, është një ligj fizik. Ndërkaq, për të vepruar ky ligj edhe në jetën njerëzore, është nevoja e një ndërmjetësi që do ta siguronte identifikimin

30 Ky konkluzion i autorit ose paralelizmi që ngre më poshtë autori midis dukurive fizike e shpirtërore përkatëse, duhet marrë në kuptimin figurativ. Si në shembullin e përhapjes së aromës, ashtu dhe të nxehtësisë, kemi të bëjmë me ligjin fizik të ekuilibrit i cili nuk është një dukuri identifikimi. Kurse prirja e natyrshme e njerëzve, posaçërisht e fëmijëve, adoleshentëve dhe e të rinjve që ende nuk e kanë formuar personalitetin e vet, për t’i ngjarë dikujt tjetër, është cilësi vetëm e qenieve njerëzore të ndërgjegjshme e të vetëdijshe, gjë që shfrytëzohet si nga pedagogjia e përgjithshme dhe institucionet që merren me manipulimin psikik-shpirtëror, ashtu edhe nga mistika për qëllimet e saj edukative-manipuluese. Ndërkaq, duhet mbajtur parasysh se, në bazë të ligjeve të krijimit të njeriut sipas Kur’anit, njeriu është një identitet original dhe i papërsëritshëm ku mbështetet personaliteti i tij. Prandaj dhe prirja e tij për t’u ngjarë të tjerëve si dhe shfrytëzimi i kësaj prirjeje nga një cilido institucion duhet të ketë një kufi. Në qoftë se përpjekjet e një njeriu për t’i ngjarë dikujt ose përpjekjet e të tjerëve për ta bërë një njeri t’i ngjajë dikujt, çojnë në humbjen e identitetit dhe personalitetit të tij, ai njeri s’është më njeri dhe s’vlen më për kurrë. Shembulli i mësipërm i myridit (nxënësit) të Bistamiut është pikërisht ky moment pervers i asgjësimit të identitetit individual dhe personalitetit, kundër të cilit ngrihet edhe Bistamiu i cili i jep nxënësit këshillën e duhur. (Përkthyesi)





dhe ky ndërmjetës, në gjuhën e mistikës quhet **muhabbet** (afërsi ndjesore, afeksion, dashuri).

Në përgjithësi, personalitetet e fuqishëm dhe energjikë janë bërë gjithmonë burim frymëzimi për të dobëtit. Në fakt, njëri prej prirjeve të pranishme në natyrën e njeriut është ndjenja e imitimit. Me këtë ndjenjë i rrugëllon në fillim fëmija të gjitha lëvizjet dhe veprimet e veta. Por kjo prirje vazhdon të mbetet e pranishme pak a shumë gjatë gjithë jetës. Prandaj, përshtetshmëria në adhurim e njerëzve të mirë e besnikë, niveli i lartë i moralit, dhembshuria, mëshira dhe thellësia shpirtërore e tyre u zgjon njerëzve përreth tyre ndjenjën e ndjekjes dhe imitimit. Kështu, edhe sahabet me të kaluar njerëzore pagane e krejt të pazhvilluar arritën kulme në zhvillimin personal pikërisht në sajë të kësaj ndjenje ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) i cili ishte një personalitet shembullor i pashoq!

Nga vëzhgimet tona në botën e jashtme, ne e dimë se, po qe se mësuesi i bën nxënësit ta duan (të ndjejnë afërsi dhe afeksion ndaj tij), ata e mësojnë me lehtësi mësimin e tij, sepse afërsia (muhabbet) luan një rol të magjishëm që i shndërron mundimet në mëshirë. Një vështirësi e dëshiruar (e këndshme) pranohet sado e vështirë që të jetë, kurse mundimi i një pune krejt të lehtë por të padëshiruar vjen shumëfish në krahasim me ç'është. Ndërsa kur në shpirt shfaqet dashuria, namazi njëzet reqatesh i teravive vjen i lehtë, namazi prej katër reqatesh i agimit i falur pa dashuri vjen i rëndë. Si kjo, edhe rëndesa dhe dembelizmi në sjelljet e tjera janë rezultat i mungesës së dëshirës dhe dashurisë. Ja, kur analizohen këta shembuj, shihet se qëndrimi bashkë me njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq) mbushur me ndjenjat e dëshirës dhe dashurisë përmban një ndikueshmëri shpirtërore, madje magjike, e cila i eliminon gjithatë të përpjeta vështirësi në rrugët e lartësimit moralo-shpirtëror.

Nga ana tjetër, për ta mbrojtur qetësinë e zemrës, duhet shmangur me forcë nga afërsia me indiferentët dhe mëkatarët.

Sheh Ubejdullah Ahrar e porositi kështu njeriun e vet të dashur në këtë drejtim:

“Ndenjja bashkë me të huajt dhe indiferentët i jep zemrës mërzitje, shpirtit çorientim dhe ndjenjave rrënim!”

Një ditë, Bejazid Bestamiu ndjeu një shqetësim dhe keqësim të tillë dhe në asnjë mënyrë nuk mundi ta shpëtojë veten nga ajo gjendje. Pastaj i pyeti ata që kishte në kuvend:

“Pa shihni, a mos kemi ndonjë të huaj mes tonë?”

Panë, por nuk gjetën asnjë të huaj. Por Bejazid Bistamiu nguli këmbë:

“Pa kërkoni mirë! Kërkoni në vendin ku ndodhen shkopinjtë!”

Prapë kërkuan dhe gjetën shkopin e dikujt që ishte indiferent. Bejazid Bistamiut iu kthye qetësia.





Prapë një ditë, Haxhe Ubejdullah Ahrar i tha kështu një të afërmi që i kishte ardhur:

“Prej teje vjen kundërmim të huaji!”

Dhe shtoi:

“Mbase ke veshur rrobat e një të huaji!”

Tejet i çuditur, i afërmi i tha:

“Po, ashtu është!”

Pastaj shkoi, i ndërroi rrobat dhe u kthye prapë.

Kjo veçori komunikimi në situatat negative është po kaq e vlefshme edhe në situatat pozitive. Shembulli më i bukur i kësaj është ajo që ka ndodhur mes profetit Jusuf (a.s.) dhe të atit, profetit Jakub (a.s.), i cili në fillim e ndjeu se ishte pikërisht Jusufi nga fëmijët ai që i përngjiste më shumë, prandaj dhe u dha më shumë pas tij, si dhe filloi ta ndjente kundërmimin e këmishës së të birit që po ia sillnin që prej shumë larg, në një kohë kur i vëllai Jehuda që po e sillte, nuk e ndjente. Pastaj, siç dihet, kur Jakubit ia fërkuan fytyrën dhe sytë me këmishën e të birit, iu kthye shikimi dhe nisi të shohë. Kjo situatë është shfaqje e lidhjes shpirtërore që i komunikohet edhe materies!

Dhe, në këtë rast, është sheshit se sa me pedantizëm duhet mbrojtur zemra e njeriut e cila, pa dyshim, është shumë më e ndjeshme se sendet!

Gjatë kthimit nga fushata tejet e mundimshme e Tebukut, sahabet u futën për pushim, për të gjetur hije dhe ujë, në rrënojat e pallateve me gurë të gdhendur të fisit të Themudit. Prandaj, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ua tërhoqi vëmendjen kështu:

“Në këtë vend, Zoti e shkatërroi fisin Themud. Për të mos ju ardhur pjesë nga ai shkatërrim, mos merrni ujë prej këtu!”

Sahabet i thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Ne i mbushëm enët me ujë dhe gatuum brumë!”

I Dërguari i Allahut i urdhëroi:

“Zbrazini ujërat dhe brumin jepuani deveve ta hanë!” (Buhari, *Enbija*, 17)

Këto dhe ngjarje të tjera të ngjashme janë shembuj të gjallë që tregojnë përcjelljen dhe reflektimin e situatës shpirtërore edhe në qeniet pa jetë!



Duhen bërë përpjekje për të marrë begati (energji moralo-shpirtërore) nga situatat shpirtërore të bukura të njerëzve të mirë (salih) dhe besnikë (sadiq) me qëllim për t'i zhvilluar vetitë e larta të zemrës dhe për t'u lartësuar shpirtërisht, gjë që realizohet më mirë nëpërmjet bisedave moralo-shpirtërore. Të tërheqin vëmendjen këshillat e Lukmanit (a.s.) për të birin në këtë drejtim:





“Biri im! Rri bashkë me dijetarët dhe përpiqu të mos largohesh nga kuvendet e tyre. Sepse, Allahu, ashtu siç e gjallëron tokën me anë të ujit, i gjallëron edhe zemrat me anë të dritës së urtësive!” (Ahmed b. Hanbel, *Kitabu’z-Zuhd*, hadithi nr. 551)

Në një hadith profetik thuhet:

“Në njërën nga shtëpitë e Allahut, mbi xhemaatin e mbledhur për ta kënduar librin e Allahut dhe për ta diskutuar mes tyre, zbret qetësia, ata i mbulon mëshira dhe i rrethojnë engjëjt. Allahu i përmend ata mes atyre që ka pranë!” (Ebu Davud, *Vitr*, 14; Ibni Maxhe, *Mukaddime*, 17)

Ebu Idris el-Havlani tregon:

Në Damask, u futa në xhaminë Umejje. Aty pashë një të ri me dhëmbë të ndritshëm dhe fytyrë të qeshur që po rrinte. Përreth i ishin mbledhur njerëz që po bisedonin ca gjëra. Kur binin në kundërshtim, i kërkonin mendim atij. Nga të pranishmit mësova se djaloshi ishte Muadh bin Xhebel (r.a.).

Të nesërmen herët shkova në xhami. Ai kishte ardhur më herët se unë dhe po falte namaz. E prita që të mbaronte, pastaj i shkova pranë, i dhashë selam dhe i thashë:

“Vallahi, unë të dua për hir të Allahut!”

Muadhi më pyeti tri herë:

“A me të vërtetë për hir të Allahut?”

Edhe unë, që të tri herët i dhashë të njëjtën përgjigje:

“Po, për hir të Allahut!”

Atëherë, më kapi për rrobe dhe, duke më tërhequr pranë, më tha:

“Qofsh i lumtur! Unë kam dëgjuar se i Dërguari i Allahut ka thënë duke përcjellë fjalët e Zotit:

“Dashuria ime u jepet domosdoshmërisht atyre që e duan njëri-tjetrin për hirin tim, rrinë bashkë për hirin tim, e vizitojnë njëri-tjetrin për hirin tim dhe ia kushtojnë veten pëlqimit tim!” (Imam Malik, *Muvatta*, *Shaar*, 5)

Zoti urdhëron kështu në Kur’an:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَكُونُوا مَعَ الصَّادِقِينَ

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe bashkohuni me besnikët!” (et-Tevbe, 119)

Përcjellja dhe komunikimi mes situatave, siç u prek edhe më lart, realizohet në raport të drejtë me afërsinë dhe dashurinë mes subjekteve përkatëse. Për t’u bërë një besimtar i përkryer është kusht afërsia me njerëzit e mirë dhe besnikë.

Edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s) e shpreh kështu rëndësinë e qëndrimit me të mirët dhe besnikët:





“Shoku i mirë me shokun e keq u ngjasin përkatësisht shitësit të parfumeve dhe fryrësit të calikut te kovaçi. Ose shitësi i parfumeve të jep aromë parfumi ty, ose ti blen parfum prej tij!

Sa për fryrësin e calikut, ose ta djeg rrobën, ose ta ngjit erën e keqe!” (Buhari, *Buju*, 38)

Sa ç’ka rëndësi ndenja bashkë me të mirët dhe besnikët në të gjallë, aq e rëndësishme është edhe varrosja pranë tyre pas vdekjes. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka porositur kështu:

“Varrosini të vdekurit pranë njerëzve të mirë!” (Dejlemi, *Musned*, I, 102)

Hadithi në vijim e parashtron bukur rëndësinë edhe të sigurimit të nevojave, madje, nëpërmjet njerëzve të mirë e besnikë.

Siç tregon Ibnul Firasi, i ati e ka pyetur kështu Profetin:

“O i Dërguari i Allahut! A t’u kërkoj të tjerëve (po të kem nevojë)?”

Dhe Profeti (s.a.s.) i është përgjigjur:

“Jo, mos u kërko! Por, po mbete ngushtë, të paktën kërkoju njerëzve të mirë!”

(Ebu Davud, *Zekat*, 28; Nesai, *Zekat*, 84)



Një dervish i ka thënë Bejazit Bistamiut:

“Më këshillo një veprim që të më afrojë tek Allahu!”

Dhe Bejazit Bestamiu e ka këshilluar kështu:

“Duaji robtë e urtë të Allahut! Duaji që edhe ata të të duan ty! Dhe përpiqu t’u hysh në zemër, sepse Allahu i Lartë sheh çdo ditë 360 herë në zemrat e tyre dhe, kur të shohë, të të gjejë edhe ty aty!”

Ja, për këtë shkak, në edukimin mistik, me qëllim që nxënësi i rrugës mistike ta mbajë të gjallë e të freskët dashurinë për vendin ku është anëtar dhe për njerëzit besnikë, **rabita** (lidhja shpirtërore) është bërë rregull në formën e një praktike të përhershme.³¹

Duhet menduar se një njeri që ndodhet në rrugën e mëkatit dhe të këqijave, nën ndikimin e bukur të kësaj lidhjeje zemrash, ndoshta mund të shpëtojë prej shumë humbjeve moralo-shpirtërore të pazëvendësueshme, gjithashtu, me begatinë e lidhjes ndjesore mund të bëhet i merituar i shumë fitimeve moralo-shpirtërore në rrugën e mirësive dhe dobive.

Me forcën e ndjenjës së afërsisë dhe dashurisë (muhabbet), lidhja shpirtërore (rabita) sendërton një linjë shpirtërore të lartë të ndjeshmërisë së zemrës. Në personalitetet në dy skajet e kësaj linje fillon një marrëdhënie shpirtërore me drejtim **identifikimin**. Ndërsa besimtarët në pozitën e marrësit (receptorit) në këtë marrëdhënie, përparojnë, të mirët (salih) dhe besnikët (sadiq) në pozitën e dhënësit (emetuesit), mund të pësojnë dëm në

31 Për rabita, shih më hollësisht tek kapitulli “Metodat e orientimit”.





masë të caktuar. Kjo situatë është pasojë e faktit që njerëzve të mirë e besnikë u duhet t'i pastrojnë nga ndyrësitë personat që u vijnë. Prandaj, në jetën e tyre ka gjithmonë një periudhë të shkurtër tërheqjeje në vetmi jo vetëm nga dëshira për afrimin ndaj Zotit, por, në të njëjtën kohë, nga nevoja për t'u çliruar për një farë kohe nga ndyrësitë dhe shëmtitë e jetës.

Dashuria (muhabbet) e përforcuar me anë të afërsisë ndjesore, më në fund arrin në atë gjendje, sa dashuruesi pothuaj të asgjësohet në qenien e të dashuruarit. Poeti Mevlana Xhelaleddin Rumi (k.s.) e shpreh me këto fjalë këtë situatë që realizohet si rezultat i dashurisë:

"Atje ku bashkohet me detin, lumi merr fund së qeni lumë. Ai bëhet pjesë e detit ku hyn. Buka që hamë shkrihet në trup dhe bëhet pjesë e tij. Edhe qenia e dikujt që dashuron, humbet në qenien e atij që dashuron në atë masë sa e dashuron!"

Duke vazhduar më tej, poeti Mevlana e shpreh kështu gjendjen shpirtërore në procesin e identifikimit:

"Erdhi ashku dhe m'i mbushi damarët si gjaku. Më mori mua prej meje dhe ma mbushi qenien me dashuri. Të gjitha pjesët e trupit m'i zuri miku. Tek unë nga unë mbeti vetëm një emër, kurse përtej emrit, vetëm Ai..."

Ja, kjo është situata cilësore e quajtur në tasavvufin ose mistikën islame **fenafil'lah** dhe **bekabil'lah**.³² Ndërkaq, për të përparuar në këtë gradë në drejtimin e quajtur "muhabetullah" (dashuria për Allahun), duhet që zemra të fitojë një dinjitet dhe lejueshmëri të përballeshme për të, gjë që mund të arrihet me anë të stërvitjeve në afërsinë dhe dashurinë njerëzore.

Në kulmet e dashurisë njerëzore, dashuruesi arrin një identifikim me njeriun që dashuron në raport të drejtë me forcën e afërsisë ndjesore. Në tasavvufin ose mistikën islame, grada në të cilën myridi (nxënësi i rrugës mistike) arrin këtë moment afërsie dhe dashurie me shejhun (prijësin e rrugës mistike), momentin ku nxënësi pothuaj asgjësohet në qenien e shejhut (prijësit), quhet fena **fi'sh-shejh**.

Hz. Ebu Bekri (r.a.), në çdo takim të ri me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) dhe në çdo bisedë të re me të, përjetonte një gjendje të veçantë ekstaze dhe kënaqësie shpirtërore. Edhe kur ndodhej pranë tij, madje, dashuria dhe malli për të, në vend që t'i qetësoheshin, i shtoheshin edhe më shumë.

Një ditë, Profeti (s.a.s.) tha:

"Aq sa ç'kam përfituar nga pasuria e Ebu Bekrit, nuk kam përfituar nga pasuria e askujt!"

32 Në burimet bibliografike të tasavvufit janë bërë përkufizime të ndryshme të këtyre termave. Njëri prej tyre është kështu:

Fenafil'lah: humbje në Allahun; duke u çliruar me zemër nga të gjitha lidhjet e kësaj bote, pastrim nga cilësitë egoistike.

Bekabil'lah: përjetësim në Allahun; pajisja me moralin e Allahut, gjë që realizohet duke u veshur me moralin dhe frymën shpirtërore të Profetit (s.a.s.) dhe Kur'anit.





Ndërkaq, Hz. Ebu Bekri u kap nga ndjenja e "tjetrit" dhe, i shqetësuar për këtë, e pyeti Profetin:

"O i Dërguari i Allahut, a nuk të përkasim unë dhe pasuria ime ty dhe vetëm ty?" (Ibni Maxhe, *Mukaddime*, 11)

Prapë një ditë, Profeti (s.a.s.) qe shprehur kështu për Ebu Bekrin:

"Ebu Bekri është prej meje dhe unë jam prej tij! Ebu Bekri është vëllai im në këtë botë dhe në ahiret!" (Dejlemi, *Musned*, I, 437)

Duke u shprehur kështu, Profeti ka pohuar shoqërimin e tyre në botën e kuptimit si dhe rrjedhën e ndjenjave nga zemra në zemër.

Dhe, kur Profeti pati rënë në shtratin e vdekjes, pati thënë kështu:

"Të gjitha dyert të mbyllën, të mbetet hapur vetëm e Ebu Bekrit!" (Buhari, *As'habu'n-Nebi*, 3)

Sheh Saadi Shirazi u shpreh kështu specifikën e përçimit mes gjendjeve shpirtërore:

"Qeni i Shokëve të Shpellës (As'habi Kehf) fitoi një nder të madh sepse u ndodh bashkë me besnikët. Emri i tij kaloi në Kur'an dhe në histori. Kurse gruaja e profetit Lut ra në mohim sepse u ndodh bashkë me mëkatarët!"

Dëmin e afërsisë me mëkatarët, Profeti (s.a.s.) e shpreh kështu:

"(Në kohën e fundit), disa njerëz nga ummeti im do të pretendojnë se janë dijetarë në fe, do të këndojnë Kur'an dhe do të thonë kështu: "Ne shkojmë te pushetaret, përfitojmë nga pasuria e tyre, por nuk i përzejmë në fe!" Mirëpo nuk do të ndodhë kështu. Ashtu siç nga gëmusha me gjemba mund të mblidhen vetëm gjemba, edhe ata që tregohen të afërt me ta, do të përfitojnë prej tyre vetëm nga gjërat e këqija të tyre!" (Ibni Maxhe, *Mukaddime*, 23)

Përcjelljen e vetive shpirtërore të krijuar nga afërsia me njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq) si dhe identifikimin si rezultat i saj, poeti Saadi e tregon kështu metaforikisht në veprën e tij "Gjylistani":

"Një person shkon në hamam. Atje, njëri nga miqtë i jep një copë argjilë aromatike për t'u pastruar. Nga copa e argjilës përhapet një aromë parfumore. Njeriu e pyet argjilën:

"Moj e bekuar! U deha me aromën tënde të mirë! Pa më thuaj, ç'je ti, myshk apo amber?"

Argjila iu përgjigj kështu:

"Unë s'jam as myshk e as amber! Siç e di dhe ti, jam vetëm një copë dhé! Vetëm se ndodhem nën një fidan trëndafilave dhe lagem përditë nga vesa që pikon nga gonxhet e trëndafilave. Ja, kjo aromë që u jep prehje zemrave dhe që e ndjeve edhe ti, atyre trëndafilave u përket!"

Ata që i shpalosin zemrat para miqve të Zotit me sinqeritet, nënshtrim dhe thjeshtësi, kthehen në pasqyra që reflektojnë bukuritë pas të cilave shkojnë. Ashtu si hëna e cila ndërse s'ka dritë të vet, reflekton dritën e marrë nga dielli, edhe këta njerëz ndriçojnë si kandilë në netët e errta të njerëzimit!





k) Pajisja me një moral të bukur

Në ditën e kiametit, në peshoren e besimtarit nuk do të ketë gjë që të rëndojë më shumë në dobi të tij se morali i bukur. Allahu i Lartë ndjen neveri nga njeriu që bën veprime të shëmtuara dhe që thotë fjalë të shëmtuara!"

(Tirmidhi, *Birr*, 62)

Zoti e ka pajisur njeriun me kapacitete të tilla, si brishtësia, delikatessa dhe thellësia e ndjenjave. Edhe vlera esenciale e njeriut është në raport të drejtë me sa i zhvillon ai këto veti të larta në botën e ndjenjave. Për t'u bërë njeriu njeri jo vetëm në pamje, por edhe në veti, është e mundur vetëm duke u pajisur me shprehi të bukura dhe duke i bërë të paefektshme shprehitë (veset) e këqija.

Zemrat e mbushura plot frymë shpirtërore, bëhen faktorë të moralit të bukur, akteve të mira dhe shfaqjeve të gjendjeve moralo-shpirtërore. Në këtë mënyrë, robi realizon domosdoshmërinë e qenies së krijuar në trajtën më të bukur.

Po qe se, në vend që të mbushet me frymë shpirtërore, në zemër del fituese fryma subjektive e nefsit, krijohet mundësia për shfaqjet e këqija në të, si kufri (mohimi), politeizmi (shirk), veset, epshi dhe lëkundjet. Si rezultat, duke e harruar Zotin dhe duke u drejtuar në një drejtim të kundërt me qëllimin e krijimit, zemra verbohet. Për më tepër, disa herë bie në një gradë më poshtë se qeniet e tjera.

Krijuesi i gjithësisë, duke e bërë njeriun bashkëbisedues, ia tërheq vëmendjen që të mos bjerë poshtë nivelit të krijesave të tjera dhe që të kthehet në vetvete në qoftë se bie:

يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ مَا غَرَّكَ بِرَبِّكَ الْكَرِيمِ الَّذِي خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ
فَعَدَّلَكَ فِي أَيِّ صُورَةٍ مَا شَاءَ رَكَّبَكَ

"O njeri! Ç'gjë të mashtron përkundër Zotit tënd tejet bujar që të ka krijuar, që të ka dhënë këto gjymtyrë harmonike dhe që të ka falur këtë rregull dhe masë?" (el-Infitar, 6-8)

Në Kur'an, Zoti ynë na urdhëron:

وَاللَّهُ يَدْعُو إِلَى دَارِ السَّلَامِ

"Allahu i fton robtë e Tij në Portën e Lumturisë!" (Junus, 25)





Ndërkaq, është një kusht për t'i dhënë përgjigje pozitive edhe ftesës së qenieve të vdekshme, siç janë njerëzit. Nuk mund të ftohet gjithkush në çdo vend. Për ftesën kërkohet kushti i denjësisë. Ftesës së Zotit për në Portën e Lumturisë mund t'i përgjigjet vetëm me "zemër të paqëtuar" (kalbi selim).

Kushti i vetëm për të jetuar me cilësinë si njeri në kuptimin e vërtetë të fjalës, është arritja e fesë dhe moralit në synimet e tyre të larta. Kurse modeli në kulmin e përkryerjes dhe moralit të bukur të njerëzimit është Profeti Muhammed (s.a.s.). Për ta mbështetur këtë veti të tij, Zoti thotë:

"Pa dyshim, ti qëndron mbi një moral të lartë!" (el-Kalem, 4)

Në hadithet e tij profetike, Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë:

"Mua më edukoi Zoti im dhe sa të bukur ma bëri edukatën!" (Sujuti, *Xhamiu's-Sagir*, I, 12)

"Në ditën e kiametit, në peshoren e besimtarit nuk do të ketë gjë që të rëndojë më shumë në dobi të tij se morali i bukur. Allahu i Lartë ndjen neveri nga njeriu që bën veprime të shëmtuara dhe që thotë fjalë të shëmtuara!" (Tirmidhi, *Birr*, 62)

"Unë u dërgova për ta plotësuar moralin e bukur!" (Imam Malik, *Muvatta, Husnu'l-hulk*, 8)

H.z. Muhammed Mustafa (s.a.s.) është, në histori, i vetmi profet dhe i vetmi njeri, jeta e të cilit njihet plotësisht gjer në hollësitë më të imta. Duke u shënuar të gjitha fjalët, veprimet dhe sjelljet e tij çast pas çasti, janë sjellë në formën e një table nderi. Personaliteti shembullor i profeti Muhammed (s.a.s.) përbën një kulm për të gjithë njerëzimin. Zoti e ka bërë të ditur këtë kështu në Kur'an:

"Pa dyshim, te i Dërguari i Allahut ka një model të bukur për ju, për ata që shpeshojnë të arrijnë ditën e ahiretit e të takohen me Allahun dhe për ata që e përmendin shumë Allahun!" (el-Ahzab, 21)

Përfitimi nga jeta ndjesore dhe morali i lartë i Krenarisë së Gjithësisë (s.a.s.) është i detyrueshëm, gjë që realizohet vetëm në raport të drejtë me afërsinë dhe dashurinë e ndjerë për të dhe me veshjen me moralin e tij. Si rezultat i këtij reflektimi dhe i kësaj "ngjyrosjeje", tek besimtari, vetitë e larta, si mëshira, dhembshuria, dhurimi, falja, ndarja e mundësive të veta me vëllain besimtar, shndërrohen në gëzim dhe kënaqësi. Shokët e Profetit (sahabet), të urtët (evlijauallah), njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq) janë modelet më të bukur të kësaj gjendjeje.

Besimtarët me shpirt të ndjeshëm, për t'iu afruar të vërtetës së të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), si fluturat rreth dritës, rreth frymës shpirtërore të tij, shkrihen në personalitetin e tij e kanë konsideruar si dhuntinë më të madhe të kësaj bote dhe, në këtë mënyrë, janë mbushur me favore hyjnore. Duke i përkryer haretë hyjnore në krijimin e tyre, janë bërë pishtarë të shenjtë për njerëzimin. Shpëtimi më i sigurt i zemrave të sëmura e indiferente është afërsia dhe dashuria për të!





Ja disa nga shembujt tipikë të krijimit të lartë, moralit dhe sjelljeve të tij.

Fytyra e bekuar e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) ishte më e pastra dha më e bukura e fytrave. Dijetari çifut Abdullah ibni Selam pati pyetur në hixhret me kureshtje për të Dërguarin e Allahut dhe, kur ia kishte parë fytyrën e bekuar, pati thënë:

“Ai që ka një fytyrë të tillë, nuk mund të jetë gënjeshtar!”

Dhe qe bërë musliman. (Ahmet b. Hanbel, *Musned*, V, 451)

Bukuria, madhështia, ndriçimi shpirtëror dhe delikatesa ishin tek ai në atë gradë, sa s’kishte nevojë për ndonjë mrekuili të veçantë, për ndonjë argument ose provë për të vërtetuar profetësinë e tij.

Kur Profetit nuk i pëlqente ndonjë gjë, menjëherë kuptohej nga fytyra, kurse kur i pëlqente, kënaqësia i lexohej në tërë qenien.

Drita e parë e krijuar është drita e tij. Ai ishte më i turpshëm se një vajzë e virgjër e fshehur nën mbulesën e saj.

Thellësia e ndjeshmërisë së zemrës së tij ishte e pamundur për t’u shpjeguar.

Ai nuk fliste kot, çdo fjalë e tij ishte urtësi dhe këshillë. Në fjalorin e tij s’njiheshin përfolja dhe thashethemet. Ai shoshte fjalë sipas mendjes dhe aftësisë kuptuese të secilit.

Profeti ishte i butë dhe i thjeshtë. Ishte i buzëqeshur por kurrë s’e tepronte në qeshje.

Personi që e shihte papritmas, impresionohej. Personi që afrohej e bisedonte me të, bëhej mik me zemër ndaj tij.

Profeti i respektonte njerëzit e çmuar sipas gradëve të tyre. Farefisit u bënte dhurata me tepriçë. Ashtu siç i trajtonte mirë njerëzit e shtëpisë dhe shokët, edhe ndaj njerëzve të tjerë sillej me butësi dhe favor dhe thoshte:

“Secili nga ju, gjersa atë që doni për vete, të mos e doni edhe për vëllain besimtar, nuk mund të bëheni besimtarë të përkryer” (Buhari, *Iman*, 7; Muslim, *Iman*, 71-72)

Profeti i mbante shërbyesit mirë. I ushqente dhe i vishte e i mbathte po me ato që hante, vishte e mbathej vetë. Kur duhej, ishte bujar, gostitës, i dhimbshëm dhe i mëshirshëm, kur duhej, ishte i guximshëm dhe, kur duhej, ishte i butë.

Profeti ishte njeri i fjalës. Ai ishte i denjë për lavdërim edhe për bukurinë e mendjes, mençurisë dhe moralit.

I Dërguari i Allahut ishte në përgjithësi, i vrenjtur e i menduar. Ai nuk fliste pa nevojë. Gjendja e heshtjes i zgjaste gjatë. Po ta fillonte një fjalë, nuk e ndërpriste por e çonte gjer në fund. Me pak fjalë, shprehte shumë kuptime. Fjalët i dilyn kokërr-kokërr. As më tepër se sa duhej, as më mangët. Megjithëse ishte i butë si natyrë, ishte edhe mjaft i rëndë dhe impresionues.





Kur Profeti zemërohej, nuk ngrihej nga vendi. Ndërkaq, nuk zemërohej për gjë tjetër veçse për kundërshtimin e të drejtës dhe të vërtetës, për marrjen nëpër këmbë të së drejtës. Pastaj, kur e çonte të drejtën në vend, qetësohej. Kurrë nuk zemërohej për vete. Gjithashtu, s'e mbronte vetveten dhe me asnjëri s'hynte në polemikë për veten.

Ai nuk hynte në shtëpinë e askujt pa marrë leje. Kur hynte në shtëpinë e vet, kohën që do të qëndronte aty e ndante në tri pjesë: njëren për adhurim ndaj Allahut, tjetrën për familjen, kurse pjesën e tretë, për vete. Kohën që e ndante për vete, ua kushtonte të gjithë njerëzve, të popullit dhe fisnikëve, nuk linte njeri pa e takuar dhe pa ia fituar zemrën!

Çdo gjendje dhe veprim i Profetit (s.a.s.) shoqërohej me dhikrullah.

Për të parandaluar zakonin për të ndenjtur gjithmonë në të njëjtin vend, Profeti ulej në vende të ndryshme të faltores. Nuk donte që vendeve dhe posteve t'u dedikohej shenjtëri dhe nuk donte që në faltore të mbante një qëndrim që të bëhej shkak për t'u mbajtur më të madh. Kur hynte nëpër kuvende, ulej atje ku gjente vend bosh, edhe të tjerët i porosiste të vepronin ashtu.

Kur dikush i kërkonte diçka për të plotësuar ndonjë nevojë, Profeti nuk gjente qetësi gjersa t'ia plotësonte, qoftë edhe duke ia fituar zemrën me një fjalë të mirë kur s'kishte asnjë mundësi tjetër për të bërë.

Ai nuk e dënonte askënd për të metat dhe mangësitë dhe, kur krijohej nevoja për të dhënë këshillë, këtë e bënte me një shenjë të hollë që të mos e prekte para të tjerëve.

"Mos e prit me gëzim fatkeqësinë që i ka rënë vëllait musliman, sepse mund të ndodhë që Allahu me mëshirën e tij mund ta shpëtojë atë nga ajo fatkeqësi, kurse ty të të provojë me një fatkeqësi." (Tirmidhi, Kiamet, 54)

Profeti jo vetëm s'u muar kurrë me të metat dhe mangësitë e padala në shesh të të tjerëve, por e ndaloi me forcë hetimin e gjërave të tilla, sepse pandehma dhe hetimi ndaj të tjerëve janë ndaluar me urdhra hyjnorë.

Profeti nuk bisedonte për çështje të tjera veç atyre nga të cilat priste mirësi (thevab). Kurse shokët e dëgjonin me aq vëmendje, sa, edhe sikur ndonjë zog t'u qëndronte mbi krye, të mos trembej e të ikte. Ata e konsideronin guxim edhe t'i bënin ndonjë pyetje atij dhe prisnin se mos vinte ndonjë beduin nga shkretëtira, bënte pyetje dhe, me atë rast, edhe ata mësonin ndonjë gjë.

Ebu Hurejre (r.a.) e shpreh kështu gjerësinë e mëshirës dhe dhembshurisë së tij:

"Gjatë një lufte, i kërkua të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) t'i mallkonte qafirët që të zhdukeshin, kurse ai na tha:

"Unë nuk jam dërguar për mallkim, por për mëshirë (për botët)!" (Muslim, Birr, 87)





Allahu i Lartë ka thënë kështu në Kur'an për Profetin (s.a.s.):

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“Ne të dërguam ty vetëm si mëshirë për botët!” (el-Enbija, 107)

Miku i Allahut, Ahmed er-Rifai, i këshillonte kështu nxënësit e vet:

“O kërkues të kulturës shpirtërore (irfan)! Tërë ç’ke shpenzoje në rru-gën e Zotit! Ndiqe sunnetin e nderuar të të Dërguarit të Allahut! Ditën dhe natën kaloji në klimën e adhurimit të mbushur plot përshepshtëri dhe me sjellje të mira. Vetëm në këtë mënyrë bëhesh i denjë për afërsinë e Zotit. Në të kundërt, nuk mund të marrësh pjesë nga kjo dhe mbetesh një rob i metë!”

Cilësitë morale në krijimin e lartë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) të cilat u përpoqëm t’i përmbledhnim këtu me mundësitë e kufizuara të fjalëve, janë si pika vese që pikojnë nga ai mbi njohjen tonë. E fshehta e mundësisë për t’u bërë konfident i Zotit është te qëndrimi ndaj Librit të Allahut dhe sunnetit të nderuar të Profetit me një zemër të purifikuar e të paqëtuar. Dhe motivi themelor i përfitimit nga bota ndjesore e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) është dashuria ndaj tij dhe urrejtja ndaj armiqve të tij!





Për ata që kanë arsye, kjo gjithësi është spektakël estetik (soditje kuptimplotë e shfaqjeve, rregullsisë dhe artit hyjnor), kurse për ata që s'kuptojnë, s'është gjë tjetër veçse ngrënie dhe epsh!



4. VESHTRIM MBI GJITHESINE ME NJE ZEMER TE KULLUAR

Duke u fshirë e duke u fshirë, edhe me bujarinë dhe favorin e Zotit si shtesa, këto, të stërvitjeve njerëzore dhe mistike, në fund të rrugës zemra vjen në një gjendje të tillë që, ndërsa e lë të zotin në pamje njeri, në përmbajtje e lartëson pothuaj në gradë engjëllore. Disa prej atyre që ndodhen në këtë gjendje, si njëri cilido prej engjëjve të pafund në kozmos, jetojnë në botën e tyre (vetiake) dhe përballë botës së jashtme, mes një fshehtësie plotësisht të panjohur. Ata nuk njihen.

Kurse disa të tjerë prej tyre, si pasojë e detyrave shoqërore që u janë dhënë përpjekjeve të tyre, njihen, në një farë mase, pjesërisht, dhe, si pishtarë orientimi nga koha e vet drejt së ardhmes, marrin pjesë nga e fshehta e përjetshmërisë për ta vazhduar detyrën e ngarkuar në jetën njerëzore. Ata e rrokin shkakun final³³ në zinxhirin e shkaqeve i cili ndodhet në shpinë të ngjarjeve, domethënë, dëshirën volitive hyjnore³⁴. Prandaj jetojnë në qetësinë dhe kënaqësinë e njohjes kompetente të urtësisë. Ata janë të çliruar (të pafajshëm³⁵, të mbrojtur) nga shumë dobësi njerëzore si dyshimi dhe shqetësimi.

Për ata nuk ka më "gjë të kotë"³⁶. Në konsideratën shpirtërore të filluar me kriterin "shihe me sy të mirë krijesën për hir të Krijuesit", me konsideratën për urtësinë, fillojnë ta sodisin kafazin e gjithësisë të mbushur plot me ndjenjat e dashurisë dhe mahnitjes!

Si shfaqje të fuqisë hyjnore, diellin që lind, tabllotë ngjyra-ngjyra që vizatojnë rrezet e diellit në perëndim, i vështrojnë me habi e admirim. Meqë

33 Në origjinal: nihaí sebep, shkak final.

34 Në origjinal: murad-i ilahí, dëshira volitive hyjnore.

35 Në origjinal: masum, inocentë.

36 Në origjinal: abes.





këta e shohin me këtë sy edhe gjarpërin, në vend që të rrëqethen si të tjerët, pasionohen pas variacioneve dekorative të lëkurës së këtyre kafshëve, pas shpejtësisë dhe zhdërvjelltësisë në lëvizje megjithëse nuk kanë këmbë!

Meqë këta miq të Zotit i shohin krijesat me vështrim dashurie dhe urtësie, tregohen të qetë edhe ndaj sulmit të kafshëve të egra madje. Sepse, përta i përket zbutjes dhe nënshtrimit të partnerit ose kundërshtarit, dashuria ushtron një ndikim si të radiacionit të zbuluar në kohën tonë.

Tek ta nuk ndodh ajo që ndodh tek njerëzit e tjerë që i shohin mrekullitë e gjithësisë si gjëra të thjeshta e pa vlerë. Me të vërtetë, një njeri i zakonshëm, duke soditur me miratim tabllotë e krijuara nga një piktor duke imituar natyrën, nuk mund të ndjejë të njëjtin miratim përballë gjithësisë dhe Krijuesit të saj. Të gjitha mrekullitë i konsideron si gjëra të zakonshme. Kurse miqtë e Allahut që kanë zemër të kulluar, jetojnë me një zemër që, në vend të këtyre tabllave të krijuara nga piktori vetëm për t'i dhënë vazhdimësi emrit të vet, ndjejnë mahnitje dhe emocion përballë artistit të vërtetë dhe veprave të tij! Ata ndjejnë kënaqësinë e artit hyjnor në mrekullitë e pafundme të krijuara në natyrë nga fuqia hyjnore. Këta vështrojnë gjethet dhe lulet ngjyra-ngjyra të bimëve të mbira e të rritura nga i njëjti dhë, variacioneve të ngjyrave tek to, frutave me lloj-lloj ngjyrash, aromash e shijesh, dekoracioneve të mrekullueshme të krahëve të fluturave megjithëse ato kanë vetëm një javë jetë, mrekullisë në krijimin e njeriut dhe hapin veshët e ndjekin me vëmendje mrekullitë hyjnore të pafundme si shikimi i syrit dhe mendimi i trurit, si dhe deklaratave enigmatike të quajtura “gjuha e pamjes, qëndrimit dhe lëvizjeve”!³⁷

Për të tillët, gjithësia e tërë është, tashmë, si një libër i gatshëm për t'u lexuar. Këta i kanë kapërcyer dituritë në rreshta dhe kanë arritur te dituritë në gjokse. Krejt si Mevlana Xhelaleddin Rumi i cili, dikur, ndërsa ishte një myderris që shihte punën e vet i kredhur në librat e veta në Medresenë Selçuke, mori shkëndija nga mendimet orientuese të një dervishi të pasionuar, të quajtur Shems, me zemrën të mbushur plot me ashkun hyjnor, dhe filloi të digjej edhe vetë me zjarrin e atij ashku. Ai Mevlana i cili, pasi, në këtë mënyrë, lindi në klimën e pasionit hyjnor, i la mënjanë librat që i kushtoheshin diturisë formale dhe filloi të lexonte enigmat dhe qëndisjet e gjithësisë. Vetëm pas kësaj ka mundur të formësohet vepra e quajtur *Methnevi*, një lirikë ankese e vaji, kjo, e cila zbulon sheshit enigmat dhe urtësitë që përmbahen te njeriu, gjithësia dhe Kur'ani.

Ja, pra, mundësia e besimtarit për t'i përjetuar këto gjendje, varet vetëm nga sa mundet t'i zbulojë ai pasionin, kapacitetin dhe potencën në zemrën e vet!





Zemra të tilla tashmë pothuaj kanë arritur kulmin në drejtimin për t'u bërë vendvështrimi hyjnor. Duke e ngritur lart vlerën e një zemre të kulluar në këtë gradë – gjithsesi ngaqë në shfaqjen e tij kishte vullnet njerëzor – Hz. Mevlana ka thënë:

*Kâbe bünyâd-ı Halil-i Azer'est,
Dil, nazargâh-ı Celil-i Ekber'est.*³⁸

*Qabeja, ndërtesë e Halil Azerit është,
Zemra, vendvështrim i të Madhit është!*

Në librat me rrëfime legjendare të sufive haset shpesh paralelizmi figurativ mes Qabes dhe zemrës. Ky paralelizëm mbështetet në paralelizmin mes zemrës si thelbi i njeriut dhe Qabes si thelbi i gjithësisë. Që të dyja janë në pozicion qëndror për sa i përket faktit që janë vendvështrim hyjnor. Që të dyja janë pikëpërqëndrime të shfaqjeve hyjnore. Fakti që në këto rrëfime legjendare, disa herë, zemra paraqitet me një stil shprehës që e parapëlqen atë ndaj Qabes, bëhet pjesërisht për një entuziazëm pasionant, pjesërisht me qëllim për ta treguar rëndësinë e sjelljes së zemrës në këtë gjendje dhe për t'i bërë interesante përpjekjet në këtë drejtim.

Janë shumë interesante fjalët e thëna duke iu drejtuar Qabes nga Ibni Omer (r.anh.) për ata të cilëve zemra u shndërrohet në vendvështrim hyjnor:

"Sa e madhe je ti (Qabe)! Sa e lartë është fama jote! Por nderimi i një besimtari të vërtetë në lartësinë e Allahut është më i madh se i yti!" (Tirmidhi, *Birr*, 85)

Zemra është mjedisi i besimit. Fakti që zemra e një besimtari të përkryer është më e çmuar se Qabja, kuptohet edhe nga kjo shprehje e Ibni Omerit (r.anh.).

Sikur të donte ta përforconte këtë të vërtetë, Hz. Mevlana ka thënë kështu:

"Nëse tek ti ka tejpmësi, bëje tavaf Qaben e zemrës! Kuptimi i vërtetë i Qabes që ti pandeh se është bërë prej dheu, është zemër!"

"Zoti ta ka bërë detyrë ta bësh tavaf Qaben në atë formë që e shohim dhe e dimë, me qëllim që të arrish të kesh Qaben e një zemre të fshirë e të pastruar prej vaniteteve³⁹!"

"Ta dish mirë se, po që se ngacmon, prek dhe thyen një zemër e cila është vendvështrimi i Allahut, edhe sikur të shkosh në këmbë në Qabe, mirësia që do të fitosh nuk e mbulon mëkatën e thyerjes së një zemre!"

38 Persisht në origjinal.

39 Në origjinal: masijet, çdo gjë tjetër veç Allahut.





Kurse Hz. Abdylkadir Gejlani, *kuddise sirruh*, e shpreh kështu kushtin e kësaj lartësie sublime:

“Zemra u bëhet Qabe vetëm atyre që e kërkojnë njohjen e Allahut, të pastruar nga vanitetet!”

Në lidhje me këtë specifikë, Ismail Haki Burseviu thotë kështu:

“Personi që hyn në zemër është më i lartë se personi që hyn në Qabe. Është për këtë arsye që robve të mirë (salih) dhe miqve të Allahut u thonë: “As ne mos na nxirrni nga zemra!” Dhe, kështu, kërkojnë frymëzim dhe interesim!”⁴⁰

Hz. Imam Rabbani, *kuddise sirruh*, e shpreh kështu faktin që njeriu është një “botë e vogël”:

“Njeriu është një përmbledhje e zvogëluar e gjithësisë. Prandaj, një model i çdo gjëje që ekziston në gjithësi, ekziston edhe tek njeriu!”

Kjo është aluzion për të vërtetën dypolëshe të njeriut, të përbërë nga “e mira” dhe “e keqja”, siç e kemi shprehur disa herë edhe më lart. Synimi i urdhrave fetare dhe, si shtesë, i stërvitjeve mistike, është që, duke i bërë me sa ka mundësi të paefektshme prijet e së keqes, të sigurohet fitorja e së mirës në veten e njeriut. Për këtë, duhet që të gjitha gjymtyrët të përdoren në kornizën e bindjes ndaj urdhrave hyjnorë. Por aktet dhe stërvitjet në këtë çështje lidhur me zemrën, janë më të rëndësishme se çdo gjë tjetër. Sepse zemra e cila është qendër ndjenjash, i jep drejtim meditimit dhe meditimi, vullnetit. Kjo do të thotë se motivi shtytës themelor i të gjitha akteve të vullnetshme është zemra. Ato që vendosen aty e lëshojnë rrënjë, janë ndjenjat. Kurse zemra është organi më i pavarur përballë vullnetit. Vendosja e saj në kornizën e urdhrave hyjnorë është më me rëndësi dhe më e vështirë se për organet e tjera. Vështirësitë e rrugëve të mjekimit të zemrave të sëmura për të cilat folëm më sipër, janë të mjaftueshme për vërtetimin e kësaj. Vetëm se, meqë vlera e çdo rezultati të arritur është në përpjesëtim të drejtë me vështirësitë e përballuara për arritjen e tij, edhe futja e zemrës nën kontroll dhe disiplinë ka vlerë të madhe në lartësinë hyjnore. Mbi këtë urtësi mbështetet fakti që Zoti u fal atyre që bëhen të suksesshëm në këtë drejtim, cilësi engjëlllore dhe, ndonjëherë më të larta.

Është për shkak të rëndësisë kaq të madhe që kanë zemra dhe ndjenja, e cila është emërtimi i ekzistencës jomateriale të saj, në sigurimin e lumturisë dhe shpëtimit të njeriut, që lëndimi i zemrës nga tjetërkushi është konsideruar një mëkat shumë i rëndë nga të gjithë kompetentët e tasavvufit. Hz. Mevlana ua tërheq vëmendjen kështu atyre që i ngacmojnë, i prekin dhe i lëndojnë zemrat:

40 Në origjinal: *istimdâd-1 feyz*, kërkesë për frymëzim; *taleb-i himmet*, kërkesë e interesimit të myrshidit.





“Zemra (ndjenja) e shembur që ti s’i jep vlerë as sa një fijeje kashte, është më e lartë edhe se Arshi, edhe se Kursia, edhe se Levhi, edhe se Kalemi!...⁴¹ Edhe në qoftë e ulët zemra, ti mos e poshtëro! Prapëseprapë, ajo është e lartë e më përtej! Zemra e shembur është qenia që e vështron dhe për të cilën përkujdeset Zoti! Sa e bekuar është jeta që e bën atë! Meremetimi i zemrës së thyer, së bërë copë-copë, është, në lartësinë e Allahut, më e mirë se shumë mirësi e dobi!... Hesht! Edhe sikur të kesh dyqind gjuhë në çdo fije floku e të shprehesh me to, prapë zemra është e pa-shprehshme!”

Për shkak të pozitës së saj mbretërore në trupin e njeriut, zemra është parapëlqyer si bashkëbiseduesi i shfaqjeve hyjnore dhe mjedisi i tyre. Me të vërtetë, siç e kemi prekur më lart me pretekste të tjetra, për realizimin e besimit (iman) kërkohet plotësimi i kushtit “pohim me zemër”. Në ajetin kur’anor, si vend reflektimi i revelacionit hyjnor (vahj) dhe bashkëbisedues i tij është përmendur jo truri i cili është qendër meditimi, por zemra e cila është qendër ndjenje (afeksioni). Atje thuhet:

نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ
بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ

“(O i Dërguar!) Shpirti i Besueshëm⁴² ta zbriti atë (Kur’anin) në “zemrën” tënde me një arabishte të qartë që të jesh nga paralajmëruesit!” (esh-Shuara, 193-195)

Përparimi në edukimin e zemrës, ashtu si edhe në të gjitha veprimtaritë e tjera, bëhet duke u shtuar përpjekjeve njerëzore ndihmën, favorin dhe bujarinë e Allahut. Sepse përpjekjet dhe punët e mira njerëzore krahas që përbëjnë një truall moralo-shpirtëror, janë pretekste për favoret dhe ndihmën hyjnore. Prandaj, po qe se robi futet në këtë rrugë, duhet ta lidhë shpresën te favori dhe bujaria e Allahut. Sipas asaj që favoret hyjnore do ta çojnë robin pak a shumë, por pa diskutim, në një arritje, në të gjitha rastet përfitimi është i padiskutueshëm. Mjafton që zelli dhe përpjekjet që pret Zoti për ta favorizuar dhe ndihmuar robin, me sa të ketë mundësi robi, të vihen në shesh.

Të vjetërit thoshin: *“مَا لَا يُدْرِكُ كُفَّهُ لَا يَبْرُكُ كُفَّهُ”*, domethënë, “Nëse s’arrihet dot e tëra e një gjëje, s’duhet hequr dorë nga pjesa e arritur!” Kështu duhet menduar edhe në edukimin e zemrës dhe jo të tregohet nënvleftësim për realizimin e të mundshmes, e asaj që njeriu ka në dorë!

41 Kështu në origjinal. Arshi: qielli i shtatë, rezidenca hyjnore; Kursia: katedra hyjnore; Levhi: Levhi Mahfudh, tabela e kujtesës; Kalemi: shkrimi.

42 Në origjinal: Ruhul Emin (Xhebraili).





Në tasavvufin, mistikën islame, ka një thënie proverbiale të tillë: *“Babai ndihmon, i biri përpiqet!”* Pra, dikushi që pret ndihmë nga mjeshtri, duhet të bëjë edhe vetë përpjekje! Edhe ajo çka pret Zoti pafundësisht favorizues e bujar nga robi në çështjen e edukimit të zemrës, është që robi, siç e kërkon e vërteta *“kush njeh vetveten, njeh Zotin e vet”*, duke e njohur dobësinë dhe **“asgjësinë”** e vet përballë madhësisë hyjnore, të bëjë përpjekje të sinqer-ta e të vërteta, sepse, në luftën me vetveten, robi përpiqet, kurse suksesin e jep Allahu! Pa diskutim, edhe llogaria që do të kërkojë Zoti nga robi, do të jetë në përpjesëtim me favoret hyjnore të realizuar prej Tij për robin. E rëndësishme është që robi të drejtohet kah e mira dhe dobia në përpjesëtim me mirësitë që i jepen!

Zoti ynë! Duke na dhënë mundësi të sodisim në pasqyrën tonë të zemrës përshndritjet e të vërtetës, të fshehtat dhe urtësitë e të dy botëve, na i ndriço sytë dhe zemrat në atë mënyrë që në botën tjetër të nderohemi me soditjen e bukurisë tënde!

Amin, ashtu qoftë!





Arritja e përkryerjes tek njeriu është, si rezultat i respektimit të kritereve dhe veçorive ndjesore, i mundur me përfitim të një cilësie përkryerjeje duke u çliruar nga vetitë e ulta.



C. PARIMET THEMELORE NE EDUKIMIN MISTIK

Janë disa parime të përcaktuara nga Hz. Abdulhalik Guxhdevani (k.s.), një nga autoritetet e tasavvufit, mistikës islame. Posaçërisht në metodën e udhëtimit mistik (sejru suluk) të ndjekur nga rruga Nakshí, domethënë nga rruga e edukimit moralo-shpirtëror që ka për synim arritjen në nivelin cilësor të njeriut të përkryer (kamil) duke u çliruar nga vetitë e ulta, respektimi i këtyre parimeve përmban një rëndësi përjashtimore. Këto parime mund t'i radhisim kështu:

1) **Hush der dem**⁴³ (vetëdije në çdo çast): Të jesh i zgjuar mendërisht dhe shpirtërisht në çdo frymëmarrje.

2) **Nazar ber kadem** (vështrim mbi hap): Ta mbash syrin te maja e këmbës.

3) **Sefer der vatan** (udhëtim për në vatan): Në çdo hap të udhëtosh drejt Zotit.

4) **Halvet der enxhumen** (veçim nga turma): Të ndodhesh së bashku me Zotin edhe mes turmës.

5) **Jad-kerd** (përgatitje e zemrës; zemër përkujtuese): Zemra të bëhet përkujtuese.

6) **Baz-gesht** (kthim pas, prapsje): Kërkesa dhe synimi të jenë vetëm pëlqimi i Allahut.

7) **Nigah-dasht** (vështrim i ngulur): Të mbrohesh nga vështrimet djallëzore dhe epshore.

8) **Jad-dasht** (përkujtim i ngulur): Ta dish veten vazhdimisht para Zotit.

43 Këto parime që janë paraqitur në origjinal në këtë formë, persisht ose osmanisht, po i paraqesim duke ua ruajtur origjinalin por me transliterim. Kuptimet në kllapa janë të përkthyesit, kurse shpjegimet e shkurtra, të tekstit origjinal.





9) **Vukuf-i zamani** (zotërim kohor): Ta zotërosh veten në çdo çast dhe ta shfrytëzosh mirë kohën.

10) **Vukuf-i adedí** (zotërim sasior): Të kesh kujdes dhe të respektosh numrin e dhikreve.

11) **Vukuf-i kalbí** (zotërim ndjesor): Zemra të preokupohej vazhdimisht me përmendjen hyjnore dhe në dhikr të priresh nga zemra.

Mendojmë se është e dobishme të qëndrojmë shkurt mbi këto parime të çmuara.

1) Hush der dem (vetëdije në çdo çast): Të jesh i zgjuar mendërisht dhe shpirtërisht në çdo frymëmarrje.

Mevlana Sadeddin Kashgari e përkufizon kështu këtë kriter:

“Të mos biesh në indiferentizëm (harresë, shkujdesje) as duke kaluar nga një frymëmarrje në tjetrën, madje, dhe të ndodhesh vazhdimisht në prani të Allahut.”

Të jesh i zgjuar në çdo frymëmarrje do të thotë që *dhakiri*, ai që bën dhikr, përmendësi i Allahut, të mos e heqë mendjen nga Allahu as gjatë dhikrit, as dhe gjatë kohëve të tjera. Shpëtimi i frymëmarrjeve nga indiferentizmi (harresa, shkujdesja) i fal zemrës prehje. Ndodhja e zemrës në prani të Allahut në çdo frymëmarrje varet nga rigjallërimi i frymëmarrjeve me begatinë e bindjes ndaj Allahut. Kur zemra e një njeriu arrin vetëdijen dhe prehjen e ndodhjes së bashku me Allahun, në vartësi të kësaj vërehet përmirësim edhe në qëndrimet dhe sjelljet e tjera.

2) Nazar ber kadem (vështrim mbi hap): Ta mbash syrin te maja e këmbës. Kjo do të thotë të ecësh duke e mbajtur vështrimin te maja e këmbës. Me qëllim që syri dhe, lidhur me të, zemra e udhëtarit ose nxënësit të udhës mistike të mos kapen tepër pas gjërave përreth, ai duhet të ecë duke parë në majë të këmbëve, sepse interesimet për vanitetet që e kalojnë masën e nevojshme, e shpërndajnë dhe e çrregullojnë qetësinë dhe prehjen e zemrës, për pasojë, mes tij dhe Zotit formohet pengesë.

Në vetvete, kjo mënyrë veprimi është zbatim i mënyrës së ecjes së Profetit (s.a.s.). Kur ishte duke ecur, Profeti nuk shihte përreth pa nevojë; përgjithësisht, ecte pa ndalesa dhe serioz duke parë në majë të këmbëve sikur të ishte duke zbritur një tatëpjetë. Pra, ky parim është marrë nga morali shembullor i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Me të vërtetë, ku të shohë syri, aty sheh edhe zemra. Filmat e xhiruar nga syri si të ishte kamerë, në shumicën e kohës e preokupojnë zemrën pa nevojë. Këto shikime zënë vend të panevojshëm në arkivin e zemrës. Prandaj, që zemra të mund të mbetet e paqhtë nga çorientimi dhe çrregullimi, varet, nga një aspekt, nga cilësia e pamjeve të reflektuara te ajo.





Sepse kur zemra e udhëtarit ose nxënësit të udhës mistike kapet pas vaniteteve, fillojnë dyshimet dhe lëkundjet. Po qe se përzihet mes indiferehtëve, në zemër i reflektohen shqetësimi i zemrave të tyre të ngurta, veset e tyre të këqija, mendimet e tyre të prishura. Dhe kjo është tejet e rrezikshme.

Prandaj, udhëtari ose nxënësi i udhës mistike, jo vetëm duhet të ecë duke vështruar majat e këmbëve me një mënyrë dhe edukatë që u ka hije njerëzve të thjeshtë e kokukur, por duhet t'u kushtojë kujdes vështrimeve të veta edhe në kohë të tjera. Në ecjen duke parë në majat e këmbëve ka thjeshtësi, edukatë, kufizim, ruajtje e syrit nga harami dhe lidhje pas sunetit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

3) Sefer der vatan (udhëtim për në vatan): Në çdo hap të udhëtosh drejt Zotit. Ky parim shpreh faktin që, krahas udhëtimit të nisur për të arritur te një myrshid (prijës shpirtëror) i përkryer, udhëtari ose nxënësi i udhës mistike, duke u çliruar nga morali i keq dhe dendësia (intransparenca) e mëkateve, të priret kah morali i bukur dhe ndjenjat e holla, domethënë, kah cilësia e tij origjinale. Duke mos e parë në asnjë kohë të mjaftueshme gjendjen ku ndodhet, udhëtari ose nxënësi i udhës mistike duhet të përpiqet për të arritur në një gjendje më të mirë ose duhet për të kaluar nga një pozitë shpirtërore në një pozitë tjetër shpirtërore më të lartë.

Hz. Ebu Osman el-Magribi ka thënë:

“Udhëtari duhet t'i braktisë dëshirat dhe imagjinatat e të kthehet në adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut. Me shprehjen “sefer der vatan” është fjala jo për udhëtimin nga një vend në një vend tjetër, por për arritjen e njeriut në botën e tij të brendshme te Allahu (xh.xh.). Kur udhëtari ose nxënësi i udhës mistike gjen një prijës të përkryer, e lë udhëtimin formal dhe fillon udhëtimin përmajtësor, në botën e vet shpirtërore.”

Me këtë parim të udhëtimit mistik, si profeti Ibrahim (a.s.) që thoshte “Unë po shkoj te Zoti im” (es-Saffat, 99), arrin vetëdijen e vajtjes hap pas hapi te Zoti.

4) Halvet der enxhumen (veçim nga turma): Të ndodhesh së bashku me Zotin edhe mes turmës. E thënë ndryshe, të ruash vetëdijen e qenies së bashku me Zotin edhe kur të jesh mes popullit. Pra, ndërsa ndodhet në dukje mes njerëzish dhe në marrëdhënie reciproke me ta e duke u preokupuar me punët e përditshme, udhëtari ose nxënësi i udhës mistike duhet të bëhet i ndërgjegjshëm se në botën e vet shpirtërore ndodhet bashkë me Zotin e Lartë. Për rrjedhojë, e vazhdon qenien bashkë me Zotin pa i dhënë të kuptojë gjë mjedisit përreth dhe, në të njëjtën kohë, nuk i lë mangët as detyrimet e jetës njerëzore. Me të vërtetë, fjala e urtë “dora në dëborë, zem-





ra te ai (ajo) që do” (dora e ftohtë, zemra e ngrohtë) e shpreh këtë gjendje në mënyrë shumë koncize.

Në Kur’an, Zoti i karakterizon kështu robtë me këtë ndërgjegje zemre:

رِجَالٌ لَا تُلْهِيهِمْ تِجَارَةٌ وَلَا بَيْعٌ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَإِقَامِ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءِ
الزَّكَاةِ يَخَافُونَ يَوْمًا تَتَقَلَّبُ فِيهِ الْقُلُوبُ وَالْأَبْصَارُ

“Ata janë njerëz që as tregtia, as shitblerja nuk mund t’i pengojnë për ta kujtuar Allahun, për të falur namaz dhe për të dhënë zeqat. Ata kanë frikë nga ajo ditë kur zemrat dhe sytë do të çapëlohen!” (en-Nur, 37)

Në nakshizëm, kuvendi dhe shoqërizimi janë bazë. Prandaj, jo veçimi në një vend të qetë dhe mbyllja në vetvete, por vazhdimi i gjendjes së veçimit me zemër së bashku me Zotin edhe kur personi ndodhet në dukje mes turmave, është parë më i konsiderueshëm.

5) Jad-kerd (përgatitje e zemrës; zemër përkujtuese): Zemra të bëhet përkujtuese, të kthehet në dhakir (dhikërbërës). Pasi të nxirren nga zemra me anë të rrugës së mohimit dhe pohimit (rrugës së dhikrit la ilahe il’allah) të gjitha ndotjet e vaniteteve të kthyer në zemër në një lloj idhulli, në zemër fiksohet mendimi se Allahu është synimi i vetëm.

Në përfundim të shpërndarjes nga zemra në të gjithë trupin të nxehtësisë së këndshme të dhikrit, ndjenjat e larta që ndodhen të mbyllura në nënvetëdijen e njeriut marrin gjallëri, shndërrohen në vetëdije dhe arrijnë konsistencën për t’u reflektuar në sjelljet. Sepse nuk mund të mendohet që njeriu që e ka mendjen dhe dhikrin një me Allahun, të mbetet pa pjesë nga vetitë e moralit hyjnor, si mëshira, durimi, bujaria dhe falja. Kurse të gjitha këto janë nga kushtet e domosdoshme të mundësisë për t’u bërë njeri i përkryer (kamil). Prandaj, sjellja e zemrës në gjendje të zgjuar me anë të dhikrit është një nga parimet më të rëndësishme të tasavvufit ose mistikës islame.

6) Baz-gesht (kthim pas, prapsje): Kërkesa dhe synimi të jenë vetëm pëlqimi i Allahut.

Është thellimi në meditimin e dhikrit të bërë në fund të dhikrit mohim-pohim (la ilahe il’allah), duke thënë: “إِلَهِي أَنْتَ مَفْصُودِي وَرِضَاكَ مَطْلُوبِي”, “Allahu im, synimi im je vetëm Ti dhe ajo çka pres prej Teje është vetëm pëlqimi Yt!” Kjo, me qëllim që, duke e dendësuar kuptimin e mohim-pohimit, e fshehta e tevhidit të shtresohet në zemër me kuptimin e saj të vërtetë.





Kështu, duke u mohuar dhe hedhur poshtë të gjitha qëllimet dhe dëshirat të cilat janë perde (pengesë) mes robit dhe Allahut, formohet ngopja dhe kënaqja ndjesore (e zemrës). Nga ana tjetër, duke i kundërshtuar dhe hedhur poshtë edhe shqetësimet e mundshme që mund të lindin në zemër si, p.sh., për të kapërcyer etapa me anë të stërvitjeve shpirtërore si dhikri apo për të merituar aftësi parashikuese (keramet), mendimi se qëllimi i vërtetë është fitimi i pëlqimit të Allahut qëndiset edhe një herë tjetër në zemër!

Pasi kuptimi i dhikrit të bërë në këtë formë, zë vend mirë në vetëdije dhe reflektohet në jetë, fiksimit e përkohshme dhe relative e humbin rëndësinë dhe në çdo gjë nisin të vëzhgohen shfaqjet hyjnore!

7) Nigah-dasht (vështrim i ngulur): Të mbrohesh nga vështrimet djallëzore dhe epshore. Është mbrojtja e syrit që të mos shohë gjëra të papërshtatshme dhe e mendjes nga kredhja në mendime të këqija dhe, duke e mbajtur vazhdimisht nën kontroll zemrën e cila është vendvështrimi i Zotit, të pengohet pushtimi i saj nga vanitetet.

Një synim tjetër i tasavvufit është mbrojtja e zemrës nga kujtimet negative dhe mendimeve mëkatore, ndërkaq që kjo është një punë shumë e vështirë. Personi që bëhet i suksesshëm këtu, do të thotë se e merr frytin e vërtetë të tasavvufit!

8) Jad-dasht (përkujtim i ngulur): Ta dish veten vazhdimisht para Zotit. Është parimi sipas të cilit robi duhet ta mbajë vazhdimisht në mendje se ndodhet në praninë shpirtërore të Zotit dhe me këtë vetëdije, t'u kush-tojë kujdes veprimeve të veta. Kësaj i thuhet edhe "murakabe", kontroll i brendshëm ose vetëkontroll.

Në Kur'an, Zoti urdhëron:

"Pa dyshim, Ne e krijuam njeriun dhe e dimë se ç'i pëshpërit atij nefsi (vetvetja). Ne jemi më afër tij se damari i qafës që i rreh!" (el-Kaf, 16)

Prandaj duhet që kurrë të mos humbet ndjenja e mirësisë (ihsan), domethënë vetëdija se Zoti e sheh robin për çdo çast dhe ia di çdo gjendje. Me të vërtetë, kjo ndjenjë është si një blind i qëndrueshëm përballë mëkateve, sepse si mund të kryejë mëkate njeriu duke e ditur veten në praninë hyjnore dhe zemrën, bashkë me Allahun?

9) Vukuf-i zamaní (zotërim kohor): Ta zotërosh veten në çdo çast dhe ta shfrytëzosh mirë kohën. Është llogaritja nga pikëpamja e "efektivitetit" ose "indiferentizmit" të çdo ore të kaluar dhe shfrytëzimi i mirë i kohës. Udhëtari ose nxënësi i udhës mistike duhet ta dijë mirë vlerën e kohës ku ndodhet dhe, duke i braktisur gjërat e panevojshme, duhet ta veçojë kohën





për gjënë më të çmuar. Edhe në çështjen se në ç' nivel e vlerësoi kohën, duhet ta marrë shpesh veten në llogari.

Në një kuptim tjetër, ky parim është që udhëtari ose nxënësi i udhës mistike duhet të ketë dijëni çdo çast për gjendjen e vet dhe duke e ditur se gjendja e vet e bën të domosdoshëm falenderimin apo kërkesën për falje, duhet të veprojë sipas kësaj domosdoshmërie. Me të vërtetë, udhëtari duhet të bëjë llogarinë një për një të punëve që ka kryer ditën dhe natën, ta falenderojë Allahun që ia mundësoi të kryejë punë të mira (salih), të përpiqet për të shkuar më tej dhe duhet t'i drejtohet Allahut i penduar duke bërë pendesë për gabimet. Ai duhet t'i njohë si një rast të favorshëm dhe pasuri çdo çast tejet të çmuar të jetëgjatësisë së vet, si dhe kohët e veçanta kur Zoti i jep begati të posaçme dhe të bëjë përpjekje me të gjitha mundësitë që, mes zgjuarsisë shpirtërore, t'i njohë e t'i rivlerësojë ato!

Shkurt, duke bërë llogarinë e çdo çasti e të çdo gjendjeje, duke falenderuar për çastin dhe gjendjen e kaluar në qetësi, kënaqësi e prehje, të bëjë pendesë për kohët e konsumuara në indiferentizëm. E shprehur ndryshe, udhëtari ose nxënësi i udhës mistike duhet ta vazhdojë pendesën në gjendje ngushtice dhe falenderimin në gjendje çlirimi. Personi që ruhet nga indiferentizmi në këtë mënyrë, duke u çliruar nga dyshimi për të kaluarën dhe shqetësimi për të ardhmen, preokupohet me gjallërimin e gjendjes që është duke e jetuar, gjë që e shpreh edhe parimi mistik, sipas të cilit "sufiu duhet të jetë i biri i kohës"!

10) Vukuf-i adedî (zotërim sasior): Të kesh kujdes dhe të respektosh numrin e dhikreve.

Prijësit e përkryer i japin udhëtarit ose nxënësit të udhës mistike dhikre në një sasi të caktuar sipas gjendjes moralo-shpirtërore të tij.⁴⁴ Sepse që dhikri të japë rezultatin e shpresuar, duhet të plotësojë një numër përsëritjesh të caktuar ose, në mund të thuhet kështu, të plotësojë një dozazh të caktuar. Prandaj që nxënësit të mos i shpërndahet vëmendja dhe zemra të mos i bjerë në dyshime e lëkundje, ai duhet t'i respektojë kriteret dhe numrin e dhënë nga myrshidi. Sepse, sado që në dhikër janë të rëndësishëm përparësia dhe cilësia, kur dhikri nuk ka vlerë sasiore, domethënë një kufi dhe masë të caktuar, disa herë mund të duken shqetësime mendore dhe ndjesore. Si në çdo gjë tjetër, edhe në dhikër, kjo gjendje është rezultat i gabimeve që ka mundësi të lindin nga teprimi dhe mungesa e masës. Prandaj, duhen bërë përpjekje për ta kryer dhikrin në formën më të bukur edhe si cilësi, edhe si sasi. Sepse respektimi i numrit në dhikër nuk është

44 Për faktin që Profeti bënte ushtrime dhikri me persona të ndryshëm duke marrë parasysh gjendjen e tyre, shih çështjen "Dhikrullah dhe murakabe" të kësaj pjese.





numrimi për numrim, por, në kornizën e numrit, thellimi i “dhikrit të zemrës” (dhikrit të ndjerë). Ndërkaq, kjo jo vetëm s’është pengesë për cilësinë e dhikrit, por, në të vërtetë, kuptohet se është një kusht që e përforcon atë.

Me të vërtetë, në dhikrin e bërë ndërsa mendja është e mbushur plot mendime të ndryshme, kurse zemra, e paqetë për shkak të dyshimeve të llojlojshme, edhe respektimi i numrit shpesh është i pamundur. Prandaj, krahas mbrojtjes së mendjes nga shpërndarja dhe përqëndrimit të vëmendjes mbi kuptimin e dhikrit, respektimi edhe i numrit të dhikrit është, në të njëjtën kohë, shprehje e seriozitetit të treguar për këtë punë!

11) Vukuf-i kalbî (zotërim ndjesor): Zemra të preokupohet vazhdimisht me përmendjen hyjnore dhe në dhikr të priresh nga zemra.

Kjo do të thotë që ndjenja e mirësisë (ihsan) të kthehet në vetëdije të vazhdueshme. Udhëtari ose nxënësi duhet ta kontrollojë zemrën në çdo rast që i mundësohet, duhet të shohë se në ç’gjendje ndodhet ajo. Sepse arritja e vërtetë në dhikër është që zemra të dijë se ç’po bëhet dhikër. Dhikri nuk është përsëritje fjalësh të thata që s’zbresin nga goja në zemër! Prandaj, gjatë dhikrit udhëtari apo nxënësi duhet të jetë në gjendje vetëkontrolli, duhet të bëjë përpjekje që ta përqëndrojë tërë vëmendjen mbi atë që po bëhet dhikër. Zotërinjtë e lartë thonë se zotërimi ndjesor, domethënë përqëndrimi i vëmendjes mbi zemër është kusht në dhikër. Për të mund ta shijuar përmbajtjen e vërtetë të dhikrit, duhet që t’i drejtohesh Allahut me të gjithë qenien, veçanërisht me zemrën!

Në Kur’an, Allahu i Lartë urdhëron:

وَأذْكُرِ اسْمَ رَبِّكَ وَتَبْتَئِلْ إِلَيْهِ تَتَّبِعًا

“Përmende emrin e Zotit tënd dhe kthehu nga Ai me të gjithë qenien tënde!” (el-Muzzemmil, 8)





Ata që u bëjnë shpirttrave vaksinë rregullsisë dhe jete, janë njerëz të mirë (salih) që e kanë pastruar nefsin.



D. PRIJESI I PERSOSUR DHE METODAT E ORIENTIMIT

1) PRIJESI I PERKRYER (MURSHID-I KAMIL)

Besimtari që përparon në rrugën shpirtërore, përballet me shfaqje shumë të ndryshme. Sepse zemra e njeriut është si oqean. Ujrat e këtij oqeani janë disa herë shumë të qeta, kurse disa herë në gjendje furtune me dallgë të tmerrshme. Prandaj, për ta kaluar oqeanin dhe për të arritur në bregun e shpëtimit, sa ç'ka nevojë që anija të jetë e fortë dhe e qëndrueshme, ka nevojë edhe që kapiteni të jetë i aftë. Po qe se kapiteni nuk e komandon dot anijen gjatë furtunave, ajo groposet në thellësitë e oqeanit. Shfaqje të tilla pothuaj s'duken te ata që ndodhen ende në krye të rrugës. Por sa më tepër që të dalin në det të hapur, fillojnë ta tregojnë veten një sërë shfaqjesh që s'dihet nëse janë hyjnore apo djallëzore, disa variacione shpirtërore që ndryshojnë nga individ në individ, dhe një sërë gjendjesh të emërtuara inkibad dhe inbisat⁴⁵. Ja, për përcaktimin dhe parandalimin e këtyre gjendjeve është nevoja e udhëzimit të një prijësi të mençur e të përkryer⁴⁶.

Për të arritur në këtë orientim, çdo besimtar duhet ta vërë veten nën një disiplinë. Gjithashtu, duhet të përpiqet për ta zbatuar me korrektesë dhe me sa ka mundësi, jetën ndjesore të Profetit (s.a.s.), i cili është personaliteti model më i madh për ummetin, bashkësinë. Besimtari duhet të bëjë përpjekje për t'i vënë me sa ka mundësi në jetë nënshtrimin e Profetit (s.a.s.) ndaj Zotit, gjendjen e tij të durimit dhe falenderimit përballë ngatërresave

45 **Inkibad** (kabd) dhe **inbisat** (bast) janë dy gjendje antagoniste të udhëtarit apo nxënësit të udhës mistike. Inkibad është gjendja e ngushtimit shpirtëror me ndjenja frike e të ngjashme, kurse inbisat është gjendja e çlirimit dhe prehjes shpirtërore me anë të shpresës.

46 Në origjinal: *murshid-i kamil*, prijësi i përkryer ose i formuar. Në vende të tjera të këtij teksti është sqaruar se prijësi ose mësuesi i udhës mistike quhet *myrshid*, kurse udhëtarit ose nxënësi i udhës mistike, *myrid*. Këto terma janë të njohura në traditën mistike të Ballkanit.





dhe shqetësimeve, ndjenjën e ngopjes, të thjeshtësisë dhe përlulësisë ndër-
sa para i rridhnin të mirat si lumë! Prandaj, për t'i kapërcyer pengesat në
rrugën e zhvillimit ndjesor (afektiv), duhet t'u drejtohet me thjeshtësi dhe
edukatë udhëzimit të dijetarëve, të urtëve dhe prijësve të përkryer të cilët
janë trashëgimtarë profetikë, dhe të bëjë përpjekje për t'i zbatuar me gjithë
zemër këshillat dhe porositë e tyre. Ai duhet ta dijë si dhunti që ndodhet
pranë miqve të Zotit dhe nën edukimin e tyre, sepse siç është hëna që e
merr dritën nga dielli, provë e ekzistencës së diellit, edhe njerëzit e shquar
e të urtë të ndriçuar me dritën muhammediane, janë dëshmitarë dhe tra-
shëgimtarë të Profetit Muhammed (s.a.s.)!

Tasavvufi ose mistika islame zhvillon mundësinë shpirtërore të ulët
apo të lartë që ekziston në mënyrë të bashkëlindur te personi. Çdo zemër,
në mund të shprehemi kështu, është si një truall nën të cilin gjendet mu-
ndësi naftë e cila kurrë nuk do të mund të dalë në sipërfaqe në qoftë se
trualli nuk sondohet. Ja, pra, ajo nafta nën tokë është mundësia shpirtërore
që Zoti ia ka dhënë njeriut. Edhe kjo mundësi, njëlloj si mendja (arsyeja), te
çdo njeri ndodhet në një nivel të caktuar ose, e thënë ndryshe, te njerëz të
ndryshëm ndodhet në nivele të ndryshme.

Ndërkaq, është prijësi i përkryer i cili, për ta zhvilluar këtë mundësi,
do të kryejë sondazhin moralo-shpirtëror për ta nxjerrë jashtë, për ta zbu-
luar mineralin e çmuar. Për këtë, sonda duhet të arrijë gjer te minerali dhe
duhet të jetë aq e fortë sa të mos thyhet kur të takojë në ndonjë shkëmb. Kjo
do të thotë se është tejet e rëndësishme që myrshidi, prijësi i përkryer, prej
të cilit do të kërkohet udhëzimi moralo-shpirtëror, të jetë i aftë dhe inteli-
gjent, gjë që ka disa kritere. Me që i erdhi vendi, dëshirojmë ta prekim pak
këtë çështje të rëndësishme.

Prijësin e përkryer mund ta njohim me këto tri cilësi:

Cilësia e parë:

Është një ndjekës i vërtetë i Librit dhe Sunnetit. Jeta dhe aktet e prijësit të
përkryer përbëhen nga përjetimi i moralit të Kur'anit dhe traditës profeti-
ke. Besnikëria e prijësve të përkryer ndaj Kur'anit është e një grade tejet të
lartë. Këtë mund ta krahasojmë me ecjen e personit që ndjek udhërrëfyesin
në një terren me dëborë duke shkelur pa u shmangur aspak në gjurmët e
tij. Prandaj prijësit e përkryer quhen "*verethetul enbija*", "trashëgimtarë pro-
fetikë". Natyrisht, në përmbajtjen e një besnikërie të tillë nuk mund të ketë
përjetime egoistike e sentimentale.

Cilësia e dytë:

Me fjalët dhe sjelljet të kujton Allahun. Meqë robtë e zgjedhur të Allahut
janë përsosmërisht të merituar të shfaqjeve të emrave hyjnorë dhe i shndë-
rrojnë atributet e bukurisë në moral, i bëjnë vazhdimisht njerëzit që kanë





përreth ta kujtojnë Allahun. Me të vërtetë, kur sahabet e patën pyetur të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) se cilët ishin robtë e zgjedhur (veli) të Allahut, ai u qe përgjigjur:

الَّذِينَ إِذَا رُؤُوا ذُكِرَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ

“Po t’i shohësh në fytyrë, të kujtojnë Allahun!” (Hejthemî, *Mexhmau’z-Zevaid*, X, 78; Ibni Maxhe, *Zuhd*, 4)

Ja, pra, edhe fytyra e prijësit të përkryer, mik i Allahut, duhet t’i japë zemrës së tjetrit prehje e qetësi, duhet ta bartë atë në një botë shpirtërore, duhet ta bëjë që t’i kujtojë Allahun dhe jetën e pasme, ahiretin. Sepse prijësi i përkryer është i pajisur me moralin e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij!

Dy nga emrat më të njohur të Zotit janë *Rahman* (mëshirues) dhe *Rahim* (mirëbërës, shpërblyes). Edhe robtë e zgjedhur të Allahut janë shumë të mëshirshëm. Zoti është “settarul ujub”, “mbulues i të metave”. Edhe veliu, robi i zgjedhur i Zotit, nuk merret me hetimin e të metave të të tjerëve, përkundrazi, ua mbulon të metat. Zoti është *Kerim* (bujar). Edhe robtë e zgjedhur të Zotit janë bujarë dhe ndjejnë kënaqësi nga dhënia dhe bujaria. Zoti është *Gafur* (falës). Edhe robtë e zgjedhur të Zotit i falin të metat dhe gabimet. Zoti është *Halim* (i butë). Edhe robtë e zgjedhur të Zotit janë të butë në sjellje.

Prijësit e përkryer janë miq të Zotit, prandaj, në shumë anë, ndryshojnë nga njerëzit e tjerë. Zemrat e tyre janë pranë Zotit. Në adhurimet e tyre ka seriozitet dhe përsëritshmëri. Ata u kushtojnë shumë vëmendje e kujdes sjelljeve të veta. Meqë ecin në gjurmët e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), lutjet e tyre janë më të pranueshme se lutjet e njerëzve të tjerë. Meqë trupi u shndërrohet në gjendje dhikri dhe gjokset u kthjellohen, u japin prehje mjediseve ku hyjnë.

Besimtari i sinqertë preket dhe shqetësohet nga ankthi moralo-shpirtëror i kontaktit me një mëkatar. Kurse kontakti, afërsia dhe ndenja bashkë me një besimtar të mirë (salih) i fal zemrës së tij prehje e qetësi. Kurse afërsia me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) është, për besimtarin, një bukuri përtej përfytyrimit. Është e pamundur të përshkruhet kënaqësia shpirtërore e besimtarit nga nderi i qenies bashkëbisedues i madhështisë moralo-shpirtërore impresionuese të mbretit të profetëve! Ja, pra, edhe prijësit e përkryer bartin një forcë impresionuese dhe begatie moralo-shpirtërore me burim të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) sepse ecin në gjurmët e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i përshtaten përsosmërisht traditës profetike dhe janë ata që mundën t’i afrohen më shumë moralit profetik. Në ngjashmëri me efektin pozitiv jetëdhënës të goditjes elektrike mbi trupin e njeriut, prijësi





i vërtetë në fillim duhet ta trondisë pak shpirtin e njeriut, pastaj ta ringjallë dhe ta çojë drejt horizontesh të larta moralo-shpirtërore!

Cilësia e tretë:

Caktimi moralo-shpirtëror. Mbledhja e një grupi njerëzish për ta caktuar një person si myrshid, prijës shpirtëror, është e pamjaftueshme. Këtë detyrë, domethënë caktimin dhe antarësimin ose, shkurt, certifikimin e një personi si prijës shpirtëror, mund ta bëjë një prijës i përkryer i certifikuar⁴⁷ nga vargu autentik i prijësve të përkryer që zgjatet gjer te i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Në atë çast kur mungon ky caktim dhe antarësim, vargu ndërpritet. Për këtë shkak, disa prijës të përkryer, kur nuk gjejnë dot një person kompetent, nuk lënë pasardhës që të vazhdojë rrugën e tyre. Kurse disa herë lënë vetëm një myrshid si pasardhës ose, siç ka ndodhur me Hz. Halid Bagdadin, lënë shumë myrshidë. Kuptimi dhe urtësia e kësaj dukurie është një eveniment cilësor që i përket Zotit!

Shkurt, maturimi i zemrës dhe sjellja e saj në gjendjen e receptorit të vërtetave shpirtërore është i mundur me anë të disa praktikave dhe stërvitjeve. Për këtë, duhen njohur dhe zbatuar rrugët e përkryerjes moralo-shpirtërore. Dhe, për t'i kapërcyer me sukses pengesat në këto rrugë, ekziston nevoja e prijësisë së miqve të Zotit. Çdo udhëtar ose nxënës i udhës mistike duhet të kërkojë një myrshid, prijës, i cili do t'i bëhej udhërrëfyes për zhvillimin moralo-shpirtëror, ndërkaq që duhet të shohë me kujdes nëse ekzistojnë apo jo te prijësi, nën edukimin e të cilit ka për të hyrë, cilësitë përkatëse!



Disa vërejtje me rëndësi:

Meqë prijësit e përkryer me veçoritë e tyre që i përshkruam gjer këtu, dallohen si miq të veçantë të Zotit dhe rob të zgjedhur të Tij, gjithsesi duhen respektuar dhe prej tyre duhet përfituar. Ndërkaq, edukata, respekti dhe përfitimi prej tyre nuk duhet ta kalojnë masën, sepse edhe të gjithë

47 Në original: *ixhazetli* (turq.). Në traditën islame të arsimit privat qoftë shkencor, qoftë mistik, mësuesi (dijetari ose prijësi mistik) i njohur si i tillë nga opinioni i gjerë nëpërmjet veprave, rretheve të nxënësve dhe veprimtarisë tjetër, pra, në kuptim të përgjithshëm, i certifikuar (me dokument ose jo), u ka dhënë nxënësve certifikata (*ixhazete*). Certifikata të quajtura *ixhazet* kanë dhënë edhe medresetë. Tradita e *ixhazetit* në Islam është e njohur. Ndërkaq, më sipër, fjala *ixhazet* përdoret më shumë me funksionin konceptual të saj, *certifikim*. Kështu, kur masa e dijetarëve u është referuar pikëpamjeve, veprave dhe veprimtarisë së një personi, kjo, njëkohësisht, ka përbërë për atë person certifikimin e tij nga opinioni shkencor dhe mistik, njohjen e tij si shkencëtar apo prijës shpirtëror.





profetët, edhe personat e karakterizuar në gjuhën e mistikës si *salih*, janë, para së gjithash, rob të Zotit. Ata kanë marrë dhe marrin atë që u cakton Zoti nga deti i diturisë, urtësisë dhe njohjes shpirtërore (marifet). Vjen një kohë që syve dhe zemrës së tyre u hapen të fshehtat e të dy botëve dhe vjen një kohë që të mos mund të shohin një hap më tej. Siç rrëfen sheh Saadiu në veprën e tij “Gylistan”, dikush e ka pyetur profetin Jakub:

“O profet i mençur me zemër të ndritur! Si ndodhi që e ndjeve erën e këmishës së Jusufit që nga Egjipti, dhe nuk e ndjeve se po e hidhnin në pusin që e kishe mu mbi krye?”

Dhe Jakubi (a.s.) i përgjigjet kështu:

“Pjesa e të mirave hyjnore që marrim ne është si rrufetë. Prandaj të vërtetat disa herë na bëhen të qarta, disa herë na fshihen!”

Edhe Profeti (s.a.s.), një ditë, meqë nuk i dinte në atë çast përgjigjet e pyetjeve që po ia bënte dikush, duke u mbështetur në sigurinë e plotë mbi ardhjen e zbulesës (vahj), i tha atij kështu:

“Eja nesër të të jap përgjigje!”

Por të nesërmen zbulesa nuk i erdhi dhe kjo ndërprerje vazhdoi pesëmbëdhjetë ditë. Kështu, edhe Drita e Qenies për hir të të cilit ishin krijuar botërat, mbeti i paaftë. Më në fund, zbulesa hyjnore filloi t’i vinte vetëm bashkë me vërejtjen:

“(O i Dërguar!) Pa dëshiruar Allahu (pa thënë inshaallah), për asnjë gjë mos thuaj “këtë gjë do ta bëj nesër patjetër!” (el-Kehf, 23-24)

Pasi ky kriter iu caktua edhe Profetit (s.a.s.), madje, duhet menduar mirë se në ç’masë i përfshin edhe të gjithë njerëzit. Prandaj nuk mund të thuhet se, po qe se një rob i dashur i Allahut bën një lutje, ajo do t’i pranohet patjetër ose, i këndon një të sëmuri, ai do të shërohet patjetër! Sepse në këto raste, krahas sinqeritetit të të dy palëve, duhet të plotësohet edhe kushti i dëshirës së Zotit. Veç kësaj, nuk duhet harruar se pranimi i lutjeve mund të shfaqet jo në këtë botë, por në jetën e pasme dhe se këto janë gjëra që varen nga dëshira volitive e Zotit.

Një specifikë tjetër me rëndësi është se edhe profetët, edhe njerëzit e zgjedhur të Zotit (evlijauallah) zotërojnë karaktere dhe mundësira të ndryshme, kështu që, një cilësi e lartë që shquhet te dikush, mund të mos shquhet te dikush tjetër. Prandaj nuk është e drejtë që nga të gjithë të priten të njëjta aftësi dhe rezultate. Siç bëhet e ditur edhe në Kur’an, Hz. Musait (a.s.) i qe dhënë një dije që s’ndodhej te Hz. Hizri dhe Hz. Hizrit (a.s.) i qe dhënë një dije që s’ndodhej te Hz. Musai. Po kështu, siç nuk mund të ndodhë që Hz. Gejlani të jetë Hz. Mevlana, nuk mund të ndodhë as që Hz. Mevlana të jetë Hz. Gejlani. Sepse ato që u janë dhënë dy anëve si dhe shërbimet e kërkuara prej tyre janë të ndryshme. Por sigurisht që qëllimi final





tek të gjithë është adhurimi dhe njohja shpirtërore, sepse udhët që shkojnë tek Zoti janë të shumta sa numri i frymëve të krijesave!

Një specifikë tjetër me rëndësi është e vërteta se asnjë njeri tjetër veç profetëve nuk është ndodhur e nuk ndodhet nën garancinë hyjnore. Pra, edhe sikur një njeri, një rob i Zotit, ngjitet në kulmin e kulmeve, ndodhet në çdo çast përballë rrezikut që t'i shkasë këmba. Me të vërtetë, personi i quajtur Bel'am Baura i cili dikur ishte njeri i mirë (salih), më pas, duke bërë sipas egos së vet, pësoi disfatën e përjetshme. Kjo ngjarje përshkruhet kështu në Kur'an:

“Tregoju atyre ngjarjen e personit që iu vu pas djalli dhe ai, duke u larguar nga ajetet që ia dhamë, u bë nga të tërbuarit. Po të deshim, e bënim atë të lartë me ajetet tona, por ai u prir nga kjo botë dhe shkoi pas dëshirave. Gjendja e tij është si e qenit, që edhe sikur ta ndjekësh, edhe sikur ta lësh në hall të vet, merr frymë me gjuhën e varur jashtë!” (el-A'raf, 175-176)

I tillë është edhe shembulli i Karunit për të cilin flitet në suren Kasas. Edhe ai, ndërsa ishte një rob i mirë e i zgjedhur, e shkatërroi lumturinë e tij të përjetshme si një indiferent i ulët dhe si një kundërshtues i turpshëm. Zoti e fundosi atë nën tokë së bashku me pasurinë ku mbështetej dhe me të cilën lavdërohej. Prandaj, pavarësisht nga pozita, grada dhe epërsia shpirtërore e personit, nefsi (egoja) brenda njeriut pret vazhdimisht në pusi dhe, sapo t'ia gjejë rastin, e rrëzon atë në disfatë. Nisur nga kjo, Profeti (s.a.s.) i lutej Zotit:

“Allahu im! Shpresoj në mëshirën tënde! Gjersa të mbyll sytë mos më lër vetëm për vetëm me veten time! Dhe përmirësoma gjendjen! Pa dyshim, zot tjetër veç teje s'ka!” (Ebu Davud, Edeb, 100-101)

Edhe miqtë e Zotit jetojnë vazhdimisht brenda përmbajtjes së këtij hadithi profetik pa rënë në iluzionin se “puna e tyre është përplotësuar”! Ata që kapen pas këtij iluzioni, edhe sikur ta kenë mbaruar formalisht udhëtimin mistik, në fakt gjithmonë kanë mbetur në mes të udhës! Vetëm ata që i kanë parë mangësitë e veta duke thënë “kam edhe më për të bërë”, kanë vazhduar të përparojnë pa pushim kokulur dhe duke u lutur. Edhe kryeprofeti, Hz. Muhammed Mustafa (s.a.s.) madje, pavarësisht nga ato shfaqje të jashtëzakonshme adhurimi, kurrë nuk e pati braktisur namazin e natës gjer në enjtjen e këmbëve dhe i qe përgjigjur kështu Hz. Aishesë që e pati pyetur për shkakun e kësaj sjelljeje:

“O Aishe, a të mos bëhem një rob që falenderon?” (Muslim, Munafikun, 79)

Gjithashtu, sipas rrëfimeve të bashkëshorteve të tij të nderuara, pas ajetit si më poshtë, Profeti është preokupuar çdo çast e më shumë me madhërimin dhe falenderimin e Allahut:

“Dhe madhëroje Zotin tënd duke e falenderuar dhe kërko prej Tij falje sepse Ai i pranon pendimet dhe është falës i madh!” (en-Nasr, 3)





Kështu, pra, kushdo që përparon në rrugën e të Vërtetës, pavarësisht nga grada ku mund të ngjitet, kurrë nuk mund të shpëtojë nga përgjegjësia dhe në aktet e tij në asnjë formë nuk mund të bëjë shkurtime ose përjash-time. Domethënë, farzet, vaxhibet, sunnetet, haramet, hallallet, mubahet, mustehabet dhe të gjitha parimet dhe përgjegjësitë e tjera hyjnore janë ngarkuar në supet e secilit në rrugën e adhurimit dhe nuk do t'i hiqen gjer në vdekje. Prandaj, prijësit e përkryer të vërtetë gjatë gjithë jetës bëjnë përpjekje për të jetuar në përputhje me urdhrin hyjnor:

“Dhe përmende Zotin tënd me falenderim, ji nga ata që bëjnë sexhde dhe adhuroje Zotin tënd gjer në vdekje!” (el-Hixhr, 98-99)

Prijësit shpirtërorë të tillë nuk paraqesin asnjë kërkesë për shërbimin që kryejnë ndaj popullit, madje nuk presin shpërblim as për detyrën e robit që kryejnë ndaj Zotit të tyre. Sepse e dinë se ata që bëjnë punë të mira (salih amel) duke pritur shpërblim, e rrëzojnë vlerën dhe gradën e punëve që bëjnë. Prandaj ka ndodhur që Hz. Aliu me Hz. Fatimenë, megjithëse kanë genë vetë të agjëruar, një mbrëmje ia kanë dhënë ushqimin e iftarit një të varfëri që u ka trokitur në derë, mbrëmjen tjetër një jetimi dhe mbrëmjen e tretë, një robi, duke e prishur vetë agjërimin me ujë për tri ditë me radhë dhe, për më tepër, duke iu përgjigjur kështu falenderimeve të tyre:

“Ne nuk u suallëm kështu duke pritur falenderime nga ju. Synimi dhe qëllimi ynë i vetëm është pëlqimi i Zotit tonë!..”

Shkurt, prijësit e përkryer të vërtetë, duke shpalosur një personalitet model, janë kulme të botës shpirtërore që vazhdojnë detyrën edukative të profetëve. Në të njëjtën kohë, këta miq të së Vërtetës janë persona që kanë arritur gradën e quajtur *ihsan* në besim si *arifë*, domethënë, si njohës shpirtërorë të Allahut dhe attributeve të Tij të larta. Kështu, atyre u janë dhuruar nga lartësia hyjnore dhunti të tilla, si dituria hyjnore (ilmi ledun), urtësia (hikmet), aftësia e njohjes intuitive shpirtërore të Zotit (marifet), etj. Por asnjëri nuk është në nivelin e sahabeve. Gjithsesi, edhe sahabet nuk janë në nivelin e profetëve, edhe profetët nuk janë në pozitën e profetit Muhammed (s.a.s.). Sa për profetin Muhammed (s.a.s.), ai është vetëm robi dhe i dërguari i Allahut të Lartë!

Duke u mbështetur në këtë të vërtetë, duhet ruajtur nga vlerësimi i tepruar i njerëzve dhe çdo njeri duhet trajtuar vetëm sipas gjendjes ose pozitës ku ndodhet. Pra, edhe Vejsel Karaniu, edhe Imam Adhami që ka sistematizuar të drejtën juridike islame, kurrë nuk mund të jenë në gradën e sahabeve. Kurse nderimi, respekti dhe, gjoja, besnikëria që shprehin herë-herë disa të paditur e të pakujdesshëm ndaj personave që i mbajnë për mësues sikur t'i konsideronin këta mbi sahabet, madje mbi Profetin (s.a.s.), është jo gabim, por devijim dhe korruptim shpirtëror. Ky devijim dhe korruptim është një ekstremizëm i çuditshëm i cili, përmes një tepr-





mi në kahje të kundërt me ndarjen e bërë nga Zoti, largon nga e vërteta. Eshtë për këtë arsye që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), me frikën nga rënia në gjendje të tilla, i ka ndaluar lavdërimet e pakuptimta dhe nëse lavdërimet kanë qenë të tilla që të shkaktojnë egoizëm, ka thënë kështu për personin lavdërues:

“Hidhini dhé fytyrës së tij!” (Ahmed b. Hanbel, *Musned*, VI, 5)

Sepse komplimentet që provokojnë egon, janë nënshkrime të hedhura për fatkeqësinë e zemrës!





Bota e qenieve qëndron në këmbë me anë të dashurisë dhe lidhjeve shpirtërore. Sepse lidhja shpirtërore është shfaqje e dashurisë e cila përbën thelbin e ekzistencës, është vazhdim i freskisë dhe gjallërisë së dashurisë!



2. METODAT E ORIENTIMIT

a) Ndjenja e dashurisë (muhabbet) dhe lidhja shpirtërore (rabita)

Po ta vërejmë thelbin dhe qëllimin e tasavvufit (mistikës islame), shohim se motivi themelor i tij në udhëtimin mistik është “dashuria” (muhabbet) dhe qëllimi final, “edukata” (adab). Nga këto, dashuria është mjeti, kurse edukata, rezultati. Çfarëdo që të thuhet mbi rëndësinë e këtyre dy koncepteve, është pak.

Me forcimin e dashurisë së ndjerë për një qenie, pjesë të kësaj dashurie reflektohen tek çdo gjë që ka lidhje me atë qenie, si afërsi, ngjashmëri ose interesim, me një intensitet në raport të drejtë me lidhjen përkatëse.

Për shembull, myridi (nxënësi i udhës mistike) që e do jashtëzakonisht myrshidin (mësuesin dhe prijësin e udhës mistike) e vet, ndjen dashuri edhe ndaj atyre që kanë sjellje të ngjashme me të tijat sepse ato sjellje ia kujtojnë myrshidin. Po të takohet me një të afërmin e myrshidit, e mbyllet në komplimente atë sikur të ishte takuar me një haxhi të porsakthyer nga Qabja. Përvetësimi i ndonjë plaçke të përdorur nga myrshidi, shkakton një gëzim të pafund në shpirtin e tij. Ky i ngjan gëzimit të Vejsel Karaniut para hirkës që i kishte dërguar Profeti (s.a.s.).

Paralel me shtimin e dashurisë, “raporti” ndaj qenies së dashur, për të cilin sapo u bë fjalë, me kohë fiton një gjerësi që fillon nga vlera më e fuqishme drejt vlerës më të dobët. Këtu, le të themi edhe këtë që, emërtimi në tasavvuf i zgjerimit gjer në pafundësi në formë rrathësh koncentrikë i tërësisë së dashurisë e cila ka në qendër qenien e dashur, në atë mënyrë që të përmbledhë të gjitha raportet ndaj qenies së dashur në qendër, nga raporti më i afërt, në më të largët, është “dashuri absolute”. Kjo cilësi, siç shprehet edhe në vargjet e mëposhtme të poetit Junus Emre, është situata





cilësore e përfshirjes me dashuri dhe mëshirë, për hir të Krijuesit, e të gjithë krijesave pavarësisht nga natyra dhe aktet e tyre:

*Shihe me sy të mirë krijesën
Për hir të Krijuesit!*

Kjo është etapa e fundit ku mund të arrijë ashiku, dashnori. Ndërkaq, emërtimi i situatës së çdo pike që ndodhet gjatë të gjithë rrathëve koncentri- kë gjer në etapën e fundit ose rrethin e fundit, është “dashuri relative”⁴⁸.

Në çastin kur nxënësi ose udhëtari i udhës mistike lidhet me dashu- ri dhe pasion pas myrshidit, mësuesit ose prijësit të udhës mistike, nis të zhvillohet edhe ashku ose pasioni i tij ndaj mësuesit. Ky është ashk ose pasion relativ, sepse, meqë zemra i përket posaçërisht Allahut, nuk mund të ketë “të dashuruar të vërtetë”⁴⁹ tjetër veç Allahut! Të dashuruarit e tjerë dhe situatat e përjetuara me ta (me to) kanë vlerën e shkallareve të shkallë- ve që ngjiten në pallat, vlerën e praktikimit të zemrës për dashurinë ndaj Allahut⁵⁰. Nëse mund të thuhet kështu, janë përgatitje për të arritur nga “Lejlaja”, te “Zoti”⁵¹. Etapa më e begatshme në këto përpjekje është kur nxënësi bëhet konfident⁵² i mësuesit dhe përjeton emocionin shpirtëror të afërsisë dhe dashurisë. Ndërkaq, shfaqja më produktive e kësaj është lidhja shpirtërore (rabita). Arritja e dashurisë (muhabbet) në një gradë intensiteti të pakrahueshëm me lidhje të zakonshme e të rastit, është vetë lidhja shpirtërore (rabita).

48 Për emërtimet “dashuri absolute”, “dashuri relative”. Në origjinal, përkatësisht, “aşk-ı mutlak”, “aşk- ı mecâzî”: “ashk absolut, i vërtetë”, “aşk formal, relativ”. Për ashkun absolut, në origjinal është ky shënim: Me ajetin “وَالَّذِينَ آمَنُوا أَتَدْعُونَ لِيهِ”, “**Te besimtarët, dashuria për Allahun është më e fuqishme se çdo dashuri**” (el-Bakara, 165), Kur’ani deklaroi se dashuria e besimtarëve për Allahun duhet të jetë tejet e zhvilluar dhe dashuria e kësaj grade quhet ndryshe, “aşk-ı ilahî”, “ashk hyjnor”, “ashku për Hyun”.

Përgjithësisht, në trajtimin e kësaj çështjeje, siç do të shihet në vijim, në vepër përdoren dy koncepte: *muhabbet*, që do të thotë afërsi, konfidencë, intimitet, dashuri, dhe *ashk*, që do të thotë dashuri pasionante ose, thjesht, pasion.

49 Në origjinal dhe në terminologjinë përkatëse: mashuk.

50 Në origjinal: muhabetullah.

51 Këtu aludohet për aventurën dashurore të Mexhnunit i cili, gjatë kërkimeve të tij të gjata për Lejlanë, arriti të kuptojë se ekzistonte një dashuri tjetër, e vërtetë, dashu- ria për Zotin. Ai nuk e gjeti dot Lejlanë, por gjeti Zotin! Fundja, dashuria tokësore për Lejlanë ishte pashmangshmërisht e përkohshme dhe e vdekshme siç ishte edhe vetë Lejlaja, kurse dashuria për Zotin eternal është jotokësore, prandaj e pavdek- shme dhe sublime! Kjo është edhe ideja qendrore e veprës së Fuzuliu “Lejlaja dhe Mexhnuni”. Nga kjo ide ka lindur ideja mistike “nga Lejlaja te Zoti”, që në origjinal ka poeticitet sepse për Zotin përdoret fjala “Mevla” që rimon me fjalën “Lejla”: “Lejla’dan Mevla’ya”, “nga Lejlaja te Mevlaja”.

52 Në origjinal: mülâkî (arab. – osm.)





Kuptimi leksikor i fjalës “rabita” është “lidhje dhe interesim”. Me këtë aspekt, në fakt, në gjithësi nuk ka asnjë gjallesë pa lidhje dhe interesim. Çdo gjë është e lidhur me marrëdhënie të ndërsjelltja me të tjerat.

E shprehur ndryshe, rabita, lidhja dhe interesimi, janë shfaqje e dashurisë (muhabbet) e cila përbën thelbin e ekzistencës, janë dhënia vazhdimësi freskisë dhe gjallërisë së dashurisë.

Janë tri lloje lidhjesh (rabita):⁵³

1) *Lidhja e natyrshme (tabii):*

Është afërsia dhe dashuria që ndjen individit ndaj individëve të tjerë të afërm. Kjo është produkt i motiveve shtytëse të bashkëlindura, si dashuria e nënës për fëmijën.

2) *Lidhja e ulët (thufli):*

Është lidhja ndaj prirjeve djallëzore të ndaluara, si preokupimi i vazhdueshëm i zemrës së një kumarxhiu me kumarin aq sa kumarxhiu të harrojë familjen!

3) *Lidhja e lartë ose sublime (ulvi):*

Është lidhja ose interesimi për pretekstet të cilat, me anë të koncepteve të shenjta dhe ndenjave të larta e sublime, e çojnë njeriun te Allahu. Është konfidenca e vazhdueshme (e pandërprerë) faktike ose ideore me persona që kanë arritur pozitën e shkëlqimit të zemrës (shkëlqimit afektiv) dhe vëzhgimit hyjnor, me qëllim për të përfituar nga bota dhe vlerat shpirtërore të tyre.

Ne këtu do të shpjegojmë llojin e tretë të lidhjeve, pra, se ç’është lidhja e lartë. Kjo është një shprehje⁵⁴ që formon nxënësi duke e mbajtur të freskët në zemër në mënyrë të pandërprerë dashurinë për mësuesin me qëllim për të përfituar siç duhet prej tij.

Si njëra nga metodat e edukimit mistik, rabita, krahas faktit që në çdo tarikat ka emërtime dhe forma zbatimi të ndryshme, në përgjithësi do të thotë që myridi ta mbajë gjallë para syve myrshidin dhe, duke kujtuar qëndrimet dhe sjelljet e tij, të përjetojë vazhdimisht ndjenja të larta. Mbajtja freskët vazhdimisht në këtë mënyrë e nderimit, respektit dhe dashurisë për myrshidin përfton tek myridi gjallëri (vitalitet) shpirtërore.

Njeriu është një genie e hapur ndaj ndikimit. Siç ndodh në disa sëmundje, te njeriu ndodh edhe “ngjitja”⁵⁵ e qëndrimeve dhe sjelljeve nga të

53 Meqë koncepti *rabita* është, nga pikëpamja psikologjike, *afektivitet* dhe mund të shprehet shkurt me këtë fjalë ose term, tri llojet e lidhjeve që përshkruhen aty e poshtë, mund t’i emërtojmë, përkatësisht, edhe kështu: *afektivitet cilësisht i natyrshëm, afektivitet cilësisht i ulët, afektivitet cilësisht i lartë*.

54 Në origjinal: *mumarese* (arab.), shkathtësi, shprehje. Siç dihet, shkathtësitë dhe shprehitë, si dhe formimi dhe edukimi i tyre, janë çështje të psikologjisë dhe pedagogjisë.

55 Në origjinal: *sirajet* (arab.).





tjerët. Marrëdhënia sublime mes shpirtave është një nga të vërtetat e pamohueshme të jetës. Posaçërisht prirjet shpirtërore të fuqishme të personalitetit aktivë dhe ndikues tejkohen tek të pranishmit në masë të madhe ose të vogël në raport me kapacitetet psikiko-shpirtërore të tyre. Ky tejçim nuk ka të bëjë me karakterin pozitiv apo negativ të situatës (qëndrimit ose sjelljes) që “ngjitet”. Tejçimi ndodh në të gjitha situatat dhe kushtet, mjafton që në mes të ketë lidhje afërsie dhe dashurie, e thënë ndryshe, të ketë afektivitet.

Për shembull, qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve tejet të mëshirshëm, vetëmohues dhe sakrifikues ndikojnë mbi grupin mes të cilit ndodhen. Lidhja ose afektiviteti si shfaqje e afërsisë dhe dashurisë, shërben për shumimin dhe shpejtimin e marrëdhënies shpirtërore mbi veti të tilla morale dhe, më shumë, për t’i shndërruar këto në moral. Prandaj, çdo besimtar me gjykim të shëndoshë, duke ndjerë dashuri ndaj personave të mirë e të devotshëm dhe duke krijuar afërsi me ta, duhet të përpiqet ta ngrejë këtë reflektim qëndrimesh dhe sjelljesh në gradë maksimale.

Por sa e çuditshme është që mendja e cila dëshpërohet nga spërkatja me baltë e rrobës së pastër e të bukur, në shumicën e rasteve nuk ndjen as dhe shqetësimin më të vogël nga evadimi shpirtëror i veseve të shëmtuara të zemrave të nxira me mëkate në qoftë se nuk është ndriçuar me dritën e zbulesës hyjnore. Ai nuk e ndjen këtë shqetësim shpirtëror sepse, në mungesë të këtij ndriçimi, mbetet i nënshtruar ndaj një lloji efekti narkotik shpirtëror i sugjerimeve egoistike, sensuale e djallëzore. Prandaj duhen hapur sytë e zemrës dhe duhen llogaritur mirë fitimi dhe humbja e përjetshme! Sepse njeriu është lënë i lirë të zgjedhë përballë këtyre “ngjitjeve” që realizohen, krahas formës së ndikimeve pozitive, edhe me formën e ndikimeve negative dhe që janë një lloj “transferim personaliteti”. Ndërkaq, zgjedhjen e drejtë Allahu e ka treguar kështu në Kur’an:

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe rrini me besnikët!”

(et-Tevbe, 119)

Po të shihet me vëmendje, në këtë ajet, Zoti nuk u ka thënë robve të Tij **“bëhuni besnikë”**, por, për ta mbrojtur takvanë (devocionin), u ka thënë **“rrini me besnikët”**. Sepse hapi i parë që do të hidhet në rrugën për t’u bërë besnik, është bashkimi, shoqërimi dhe ndenja me besnikët, domethënë, krijimi dhe përjetimi i një afërsie konfidenciale me ta. Arritja e cilësisë **“besnik”**⁵⁶ është rezultat i natyrshëm i kësaj. Siç thotë edhe fjala e urtë, **“shih rrushi rrushin e piqu!”**⁵⁷

56 Në origjinal: sadik.

57 Kjo duhet marrë pak me rezervë sepse, megjithëqë si formë, kjo fjalë e urtë është identike në të dyja gjuhët, në shqipe përdoret edhe me kuptim negativ.





Në edukimin e nefsit (egos), bashkimi dhe qëndrimi bashkë me njerëzit e mirë (salih) dhe besnikë (sadiq), ashtu si radiacioni, është një agjent i padukshëm, por me rezultat absolut. E tillë është ndodhja në mjedisin e njerëzve të mirë, vëzhgimi i qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre, madje shikimi në fytyrat e tyre të ndritshme. Është si rrjedhojë e kësaj që qëndrimi në praninë e njerëzve të mëdhenj shpirtërorë është një dhunti e madhe. Sepse gjendjet (qëndrimet dhe sjelljet) “ngjiten”. Ashtu siç ndodh që njeriu i cili po argëtohet në një lulishte plot trëndafila, rrethohet nga aroma e tyre e këndshme, edhe kuvendi i njerëzve të mirë është si tregu i shitblerjeve sublime të shpirtrave.

Haxhe Ubejdullah Ahrar ka thënë kështu:

“Urdhri **“rrini me besnikët”** te ajeti **“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe rrini me besnikët!”** shpreh bashkimin e përhershëm. Pra, meqë ndenjja bashkë shprehet, këtu, në formë absolute, ka dy aspekte: edhe faktik, edhe konvencional. Ndërsa bashkësia faktike është ndodhja në fakt me kënaqësinë e zemrës në kuvendin e besnikëve, bashkësia konvencionale është përfytyrimi në mungesë i qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre.”

Nisur nga kjo, ashtu siç është e domosdoshme që prania në bashkimin e jashtëm me miqtë e Zotit, të bëhet përherë mbi ndjenjat e larta, është e domosdoshme edhe që ky bashkim të vazhdohet në mungesë të tyre me anë të bashkimit me zemër ose afektiv. Sepse qëndrimi faktik bashkë me miqtë e Allahut mund të mos jetë gjithmonë i mundshëm. Në këto kushte, për ta vazhduar bashkimin me zemër ose afektiv, është nevoja e lidhjes shpirtërore **rabita**.

Por siç e kemi shprehur edhe më parë, në edukimin mistik, edhe bashkimi faktik sa për formë nuk është i pëlqyeshëm e i pranueshëm. Sepse disa ndodhen gju më gju me një prijës të përkryer por, për shkak të indiferentizmit të vet, nuk përfitojnë asgjë! Nga ana tjetër, shumë myridë në vende të largëta, si pretekst i nderimit dhe respektit të thellë, mallit, dashurisë dhe besnikërisë që ndjejnë për myrshidin e tyre, mund të arrijnë përfitime të veçanta, frymëzime dhe ndijime shpirtërore. E rëndësishme është që kudo që të ndodhesh, të mos e humbësh ndjenjën e bashkimit afektiv.

Veçanërisht, sado i lartë të jetë kapaciteti ndikues i njerëzve me intelekt shpirtëror mbi njerëzit përreth, vetëm për vetë nuk është i mjaftueshëm. Sepse tejçimi situacional në mistikë është një rrymë shpirtërore e tillë që, për t’u prodhuar përfitimi maksimal prej shpejtësisë dhe efektit të saj, krahas inteligjencës së prijësit të përkryer, duhet edhe niveli i lartë i kapacitetit dhe afërsisë të myridit. Prandaj ndodh që çdo myrid nuk arrin në të njëjtën gradë vetëm pse është myrid. Ndryshimi lind nga kapaciteti dhe niveli i afërsisë afektive që ndryshojnë nga njëri myrid tek tjetri. Po u





desh të thuhej me një shembull, nuk ka ndryshim nëse personi që kërkon të mbushë ujë me një enë, e zhyt atë në një liqen të vogël apo në një oqean pa anë e pa fund. Në të dyja rastet, ai do të nxjerrë ujë sa ç'nxë ena. Prandaj duhet që edhe vetë myridi të jetë me kapacitet, edhe të bëjë përpjekje për ta përdorur kapacitetin e vet.

Në lidhje me përpjekjen, poeti Junus Emre thotë kështu:

*Nëse e lë bardakun
Në çezmë pa e mbushur,
Një mijë vjet në ndernjtë,
Vetë s'ka për t'u mbushur!*



*Një metodë tjetër e përdorur në lidhjet shpirtërore dhe vetëllogaritë është edhe këndimi i Vargut të Nderuar*⁵⁸. Kjo bëhet për të marrë pjesë nga mëshira që shpresohet të zbritet në zemra me përmendjen e njerëzve të mirë (salih) dhe nga reflektimi i situatave të mira të atij personaliteti që përmendet. Dijetari i madh Sufjan bin Ujejne ka thënë:

“Në kuvendet ku përmenden njerëzit e mirë (salih), zbret mëshirë!”

(Axhluni, *Keshfu'l-Hafa*, II, 70)

Në fakt, edhe shkrimi i librave të ndryshme që përmbajnë jetën legjendare të miqve të Allahut, bëhet gjithë për të realizuar këtë frymëzim te personat që i trajtojnë ata me dashuri.

Ja, pra, edhe qëllimi i lidhjes shpirtërore (rabita) është begatimi i zemrave me anë të vargut të miqve të Allahut që zgjatet gjer te Profeti (s.a.s.).

Ngjitja në nivel e lidhjes shpirtërore (rabita) aq sa të bëhet pretekst për pajisjen e myridit me moralin e myrshidit duke e treguar edukatën dhe dashurinë e shfaqur ndaj tij në praninë e tij, edhe në mungesë të tij, është emërtuar **fena fi'sh-shejh**⁵⁹.

Përtej pozitës *fena fi'sh-shejh* është pozita **fena fi'r-rasul**⁶⁰. Kështu, disa nga sahabet, yjet e qiellit islam, para se të nderoheshin me Islamin, bënë një jetë të kundërnatyrshme. Por pasi u orientuan dhe e gjetën rrugën e drejtë dhe pasi tek ta u reflektuan ndjenjat e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), u bënë njerëzit më të virtytshëm të botës. Edhe begatia e derdhur në

58 Në origjinal: **silsile-i sherife** (turq.); kështu quhet zinxhiri i myrshidëve që zgjatet gjer te Profeti (s.a.s.).

59 Shkriroje, humbje në personalitetin e shehut (myridit, prijësit shpirtëror). Kjo lloj shkriroje dhe humbje e përdorur edhe në raport me Profetin dhe Zotin, si koncept, në mistikë vihet në paralelizëm figurativ me humbjen e lumit në det.

60 Shkriroje, humbje në Profetin.





zembrën e prijësve të përkryer të lidhur si varg pas të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), u përçohet udhëtarëve ose nxënësve të udhës mistike me anë të lidhjes shpirtërore (rabita) dhe bisedës (sohbet). Për rrjedhojë, personaliteti shembullor i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) i reflektohet myridit me aq sa ta ketë kapacitetin.

Në këtë shkallë, duke vepruar në çdo çast të jetës si të ndodhej në praninë e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), bëhet njësimi me moralin e tij. Dhe, për ta fuqizuar lidhjen (afeksionin), domethënë, besnikërinë ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), duhet formuar në zemër një linjë e shëndoshë dashurie dhe bashkimi me anë të lutjeve për paqe e mëshirë⁶¹ për Profetin (s.a.s.) dhe të ndjekjes besnike të traditës profetike.

Siç dihet, situacioni fena fi'r-rasul është realizuar në mënyrën më të bukur te Ebu Bekr Besniku (r.anh). Para këtij situacioni (qëndrimit dhe sjelljeve) të tij, Profeti (s.a.s.) ka thënë:

"Ebu Bekri është imi dhe unë jam i Ebu Bekrit. Ebu Bekri është vëllai im në dynja dhe në ahiret!" (Dejlemi, *Musned*, I, 437).

Sa bukur e shpreh ky hadith profetik afërsinë reciproke të zemrave! Etapa më lart se ky bashkim afektiv është pozita **fena fi'l-lah**⁶².

Njohja denjësisht e të fshehtave të ajeteve në vijim është e mundur me anë të meritimit të pozitës *fena fi'l-lah*:

وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ

"Kudo që të ndodheni, Ai është bashkë me ju..." (el-Hadid, 4)

"Ne jemi më pranë njeriut se damari i tij i qafës që i rreh!" (Kaf, 16)

Zemra e një prijësi të përkryer të shkrirë tek Zoti është begatar me meritimin e shfaqjeve të emrave hyjnorë. Nisur nga kjo, zemra e myrshidit (prijësit) është pothuaj si thjerza që e mbledh tufën e rrezeve të dritës në një pikë. Me begatinë e këtyre shfaqjeve, i djeg e i bën hi të gjitha negativitetet. Me lidhjen e tij, myridi përpiqet të përfitojë nga kjo begati. Ndjenjat egoistike ikin nga zemra dhe në vendin e tyre përçohen situatat e personalitetit model. Duke e hedhur jashtë çdo gjë materiale të kësaj bote që ia ka pushuar zembrën, mbahet në nivelin ku është bërë i denjë.

Ky kalim situacional mes myrshidit dhe myridit do të thotë për myridin meritim i një zhvillimi në drejtim identifikimi.

Në hadithin profetik thuhet:

"Personi rri me atë që do..." (Buhari, *Edeb*, 96)

61 Salat dhe selam.

62 Shkrirje, humbje në Allahun.





Kështu, në lidhje me këtë specifikë, është shumë interesant rrëfimi mbi Shokët e Shpellës⁶³ në Kur'an. Kitmirit, qenit të shokëve të shpellës, i është zbritur cilësia e besnikërisë⁶⁴ ngaqë u shërbeu si roje besnike njerëzve të mirë (salih) e besnikë (sadiq). Edhe ai do të hyjë në xhennet si besnik⁶⁵. Ja, pra, në qoftë se Kitmiri ngjitet në këtë gradë pse u shërbeu besnikërisht njerëzve besnikë, është e qartë se në ç'masë të lartë do të gradohet besimtari i vërtetë duke u lidhur me dashuri pas miqve të Allahut dhe njerëzve të mirë (salih)!



Këtu dëshirojmë të prekim edhe një temë mbi lidhjen shpirtërore (ra-bitë) që ka rëndësi në mistikë.

*Lidhja me vdekjen ose meditimi mbi vdekjen:*⁶⁶

Në tasavvufin ose mistikën islame, formimit të lidhjes (shpirtërore, afektive) me vdekjen i thuhet "meditim mbi vdekjen" (tefekkur-i mevt). Meditimi mbi vdekjen ushtron ndikim të madh mbi qëndrimin dhe sjelljet e njeriut. Profeti (s.a.s.) thotë:

أَكْثَرُوا ذِكْرَ هَاذِمِ اللَّذَاتِ يَعْني الْمَوْتِ

"Kujtojeni shpesh vdekjen e cila i asgjëson nga rrënjët të gjitha kënaqësitë!"
(Tirmidhi, Zuhd, 4)

Me të vërtetë, meditimi mbi vdekjen e pakëson dashurinë egoistike dhe sensuale për botën, e cila e bën njeriun të shqetësuar e të pakënaqur. Dashuria e tepruar dhe lidhja e zemrës pas pasurisë, postit, pozitës dhe bukurive sensuale të përkohshme e kalimtare të kësaj bote është kreu i sëmundjeve moralo-shpirtërore, si, p.sh., indiferentizmi (mosdija dhe shkujdesja). Mendimi mbi varrin dhe meditimi i situatës së varrit që na pret përpara, me qëllim për ta mbrojtur zemrën nga këto lloj prirjesh dhe lidhjesh, duke na shtyrë në përshpirtshmëri me anë të një pendimi dhe adhurimi të sinqertë, na mbrojnë nga pasionet materiale e sensuale, nga dëshirat dhe iluzionet e kota. Ndërkaq, dhikri dhe lidhjet shpirtërore që i vazhdojmë, na bëhen pretext për shpëtimin dhe lumturinë e ahiretit, jetës së pasme.

Burrat e mëdhenj të Islamit, me qëllim për t'i zgjuar zemrat indiferente dhe për t'i ringjallur ndjenjat e vdekura, kanë bërë shumë këshilla dhe porosi në këtë drejtim dhe e kanë paralajmëruar popullin.

63 As'habu Kehf, sureja Kehf, 9-26.

64 Në origjinal: sadakat.

65 Për njohuri, shih İ. Hakkı Bursevî, *Rûhu'l-Beyân*, V, 226.

66 Në origjinal: râbita-i mevt ose tefekkur-i mevt.





H.z. Aliu (r.anh) i ka lënë këtë porosi të birit Hasan (r.anh):

“O bir, kujtoje seriozisht vdekjen dhe edukoje zemrën me anë të kujtimit të vdekjes! Mos harro se, në fund të fundit, çdo gjë do të asgjësohet dhe herë pas here kujtoja zemrës rreziqet e mundshme të kësaj bote!”

Me të vërtetë, meqë dihet se koha s’ka për të rrjedhur sipas një vije të drejtë, s’duhet harruar dhe s’duhet ndenjtur indiferent ndaj faktit se edhe ditët e shqetësuar e të hidhura, edhe ditët e qeta e të gëzuara janë të mundura, të paracaktuara e të pashmangshme!

Imam Gazaliu (r.alejh) porositi kështu:

“O bir, jeto sa të duash, se, sidoqë të bëhet, një ditë ke për të vdekur! Duaje kë të duash, se, sidoqë të bëhet, një ditë ke për t’u ndarë prej tij! Bëj ç’të duash, se, sidoqë të bëhet, një ditë ke për të dhënë llogari!”

O bir, synimi yt duhet të jetë ta maturosh shpirtin, ta sundosh vetveten dhe ta përgatisësh për vdekjen trupin, sepse vendqëndrimi i fundit do të të jetë varri! Ata që janë në varre, të presin duke të pyetur: “Kur do të vish?” Kurrresi mos mendo të shkosh atje pa ushqim me vete!”

Një pjesë e këshillave dhe porosive të hutbes së fundit të Omer bin Abdulazizit është kështu:

“O njerëz!

Ahireti që përhap tmerr, është i jashtëzakonshëm. Edhe profetët dhe engjëjt e afërm që kanë merituar të njohin të fshehtë të forcës hyjnore, dridhen nga tmerrri i asaj dite të llogarisë. Te kush mund të mbetet durim dhe përballim para forcës hyjnore?

Megjithëkëtë, është mëshira e gjerë dhe e pakufishme e Allahut, prandaj mos e humbni shpresën!

Gjithashtu, ta dini mirë se shpëtimi nesër në ditën e ringjalljes është për njerëzit që sot kanë frikë nga Allahu, që ruhen nga mohimi dhe kundërshtimi, që e parapëlqejnë të përherëshmen ndaj të përkohshmes. Ata që veprojnë ndryshe, gënjejnë, e shpenzojnë kapitalin e jetës në punë të padenja dhe pastaj mbeten duarbosh!

Sot jeni ju që keni ardhur në vend të atyre që kanë shkuar. Dhe në vend tuaj do të vijnë të tjerë!

E shihni se kush vjen, shkon dhe ata që shkojnë, nuk kthehen. Kjo ikje pa alternativë, kjo rrjedhë në ekzistencë është në dorë të Allahut!

Pothuaj çdo ditë përcillni ata që ndahen prej jush dhe shkojnë në ahiret, i çoni në vendpushimin e përjetshëm dhe s’merrni mësim? I lini ata nën tokë pa shtrat, pa jastëk, në vetmi dhe largoheni. Sa e dhimbshme dhe sa mësimdhënëse është gjendja e atyre që e shijojnë vdekjen! Kanë shkuar në një botë të panjohur, janë ndarë nga të dashurit, janë zgjuar nga gjumi i indiferentizmit të kësaj jete të përkohshme. E kanë parë të vërtetën, por





shumë me vonesë, kur mundësitë e rikthimit, zëvendësimit dhe rregullimit nuk ekzistojnë më. Në duar s'u ka mbetur gjë tjetër veç punëve të mira që mund të kenë bërë. Në atë ditë ndëshkimi e presin fundin e tyre me mëkatet që u rriten ndër sy, krejt të dëshpëruar! Dhe dridhen nga tmerrri i llogarisë tmerrësisht i pashmangshëm!"

Vdekja është pretekst për t'u zgjuar në një botë tjetër dhe për ta njohur të vërtetën. Por, meqë zgjimi në atë botë nuk do të sjellë ndonjë dobi, duhet që para se të vijë vdekja, të grisen perdet e indiferentizmit për t'u zgjuar!

Meditimi mbi vdekjen është një mjet që e ruan myridin nga pasionet dhe shtënia pas botës, nga konsiderata ndaj të gjitha llojeve të prirjeve egoistike e sensuale. Meqë në tasavvuf, qëllimi themelor është fitorja mbi nefsin (vetveten), meditimi mbi vdekjen është pothuaj në çdo tarikat një metodë e përdorur për këtë qëllim.



b) Biseda (sohbet)

Kuvendet e bisedave dhe dhikrit janë kop-shte xhenneti në tokë, mbi të cilat reshon me bollëk mëshira dhe prehja hyjnore!

Një prej mjeteve që përdorin prijësit e përkryer me qëllim për të ndikuar mbi shpirtin dhe zemrën e udhëtarit apo nxënësit të udhës mistike, është "fjala", pra, biseda. Në fjalët e dikujt që e ka pastruar nefsin dhe purifikuar zemrën, janë të ngarkuara ndjenjat e situatës që përjeton. Fjalët e thëna me këto ndjenja dhe me sinqeritet, duke gjetur rrugë nga veshi i bashkëbiseduesit në zemrën e tij, prodhon efekte të dobishme,

Ndërkaq, faktori më themelor që e bën të efektshme bisedën, është "ihlasi"⁶⁷. Kjo veprimtari e prijësit të përkryer i cili, si një njeri plotësisht principial dhe i sinqertë, përpiket të përcjellë te bashkëbiseduesi një sërë kuptimesh dhe ndjenjash të ngarkuara fjalëve, përbëhet prej ndjekjes besnike të sunnetit, traditës së Profetit (s.a.s.). Evenimenti cilësor "ihlas" që e prodhon këtë ndikueshmëri dhe efektshmëri, përbëhet prej veprimit sipas

67 Fjala *ihlas* e cila në Kur'an, në suren me të njëjtin emër, përdoret për të cilësuar tevhidin, besimin Islam në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë, përbëhet prej dy nocionesh që e plotësojnë njëri-tjetrin: *principialitet* dhe *sinqeritet*. Edhe nëse në përdorime të tjera kjo fjalë përdoret kryesisht me kuptimin sinqeritet, ky sinqeritet ngrihet mbi bazën e principialitetit, pra nuk mund të mendohet i zhveshur prej tij.





asaj që di dhe dëshirimit me të vërtetë dhe me gjithë zemër të asaj që i sugjerohet bashkëbiseduesit⁶⁸.

Një shkak tjetër i ndikueshmërisë së fjalës është “lakonizmi” i saj. Ndërkaq, për ta shprehur fjalën në mënyrë lakonike është e mundur me zotërimin e plotë të gjuhës dhe aftësisë për t’i zgjedhur fjalët. Kulmi i kësaj është Kur’ani.

Kur Profeti (s.a.s.) jetonte periudhën e Mekës, vajza e poetit të famshëm arab, Imrul Kajs, ishte gjallë. Asaj ia kënduan suren Zilzal. Ajo femër që e dinte se ç’ishin elokuenca, oratoria dhe figuracioni, ngriu nga habia dhe tha kështu:

“Një fjalë e tillë s’mund të jetë fjalë njeriu. Asnjë njeri nuk është i aftë për të folur në këtë nivel. Dhe në qoftë se mbi tokë ka një fjalë të tillë, nuk është me vend që poezia e tim eti të vazhdojë të qëndrojë e varur në Qabe. Shkoni, zbriteni dhe, në vend të saj, vareni këtë!”

Është për këtë arsye që në hadithin profetik thuhet:

إِنَّ مِنَ الْبَيَانِ سِحْرًا

“Pa dyshim, një sërë fjalësh janë si magji (kanë fuqi magjike)!” (Buhari, *Nikah*, 47)

Pra, fjala shkakton në zemër një ndikim magjepsës!

Nga ky aspekt, rëndësia e orientimit me anë të fjalës ka rëndësi shumë të madhe. Veçanërisht për ta kuptuar ashtu siç duhet se ç’ka qenë begatia e bisedave të Profetit (s.a.s.), mjafton të mendohen shkaqet dhe urtësitë e emërtimit “epoka e lumtur” në historinë e njerëzimit të asaj kohe kur janë bërë ato biseda. Bisedat e të Dërguarit të Allahut, të cilat janë sunnet muekkes, zënë, pothuaj në të gjitha tarikatet, veçanërisht në nakshizëm, një vend të posaçëm për tejçimin e frymëzimit dhe begatisë shpirtërore nga zemra në zemër.

Ja se sa në mënyrë lakonike shprehet poeti Junus Emre mbi forcën e madhe ndikuese pozitive apo negative të fjalës:

*Ka fjalë që pret luftë,
Ka fjalë që pret kokë,
Ka fjalë që gjellën e helmuar
E bën mjaltë e gjalpë!*

68 Kuptimi i kësaj fjalie me karakter përgjithësues është ky: ai që e zhvillon bisedën (prijësi apo mësuesi), për të arritur tek bashkëbiseduesi ndikimin apo efektin e dëshiruar, duhet të jetë principlial dhe i sinqertë, domethënë duhet t’i sugjerojë bashkëbiseduesit njohuri për të cilat ai ka kompetencë dhe bindje të plotë si dhe të cilat i dëshiron edhe për vete me të vërtetë dhe me gjithë zemër. Vetëm në këto kushte ai do të bëhet i besueshëm dhe fjala e tij do të zërë vend.





Bota ndjesore e sahabeve e cila e kishte të kaluarën si një tokë e thatë dhe shterpë, u gatua me reshjet e mëshirës dhe begatisë së klimës moraloshpirtërore të kuvendeve me bisedat e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Për rrjedhojë, farërat e pashoqe të ideve dhe virtyteve që dikur ndodheshin të mbuluara sipër me dhé, gjetën lagështirë, ajër dhe dritë dhe u zhvilluan. Me anë të shkëmbimit të ndjenjave të afërsisë, dashurisë dhe përshepshtimisë të reflektuara nga gjoksi në gjoks, u zhvilluan personalitete-ye. Njeriu i periudhës pagane paraislamike, i pamëshirshëm, i pandërgjegjshëm, zemërgur sa të groposë përsëgjalli vajzën e vet të vogël, i tillë që të mos njohë as të drejtë e as drejtësi, u shkri e u zhduk. Ai u ritrajtësua brenda së njëjtës siluete me cilësitë e një njeriu tejet të ndjeshëm, sypërlotur, vetëmohues!

Në këtë mes, të tërheq vëmendjen fakti që fjalët “sahabi” dhe “sohbet” kanë rrjedhur nga e njëjta rrënjë. Mes dashurisë, nderimit dhe ndjenjës së respektit ndaj të Dërguarit të Allahut, sahabet u bënë modeli më konkret dhe më i përsosur i përfitimit të synuar nga biseda dhe edukimi moraloshpirtëror. Ndërkaq, si të deshin ta pohonin kushtin e këtij përfitimi që u ishte mundësuar, e shprehnin kështu pozitën e tyre etike të qetësisë dhe kënaqësisë në kuvendin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

“Rrinim sikur të na kish qëndruar mbi krye një zog dhe druheshim se, po të lëviznim, do të fluturonte dhe ikte!”⁶⁹

Ata njerëz e bartën kudo që shkuan personalitetin dhe moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ata shpalosën modele të pashoqe virtyti dhe vlerash, rrëfimet legjendare mbi të cilat do të vazhdojnë gjer në kiamet. Zoti ynë i Lartë thotë kështu për ta në Kur’an:

“Allahu është i kënaqur me muhaxhirët e parë dhe ensarët që qenë të parët (që hynë në Islam) bashkë me ata që i ndoqën në cilësitë e mira, edhe ata janë të kënaqur me Allahun. Allahu ka përgatitur për ta xhenete nën të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të rrinë përgjithmonë. Ja, ky është shpëtimi i madh!” (et-Tevbe, 100)

Të gjitha bisedat të cilat kalojnë mes një ekstaze adhurimi, janë refleksione nga bisedat e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Sepse Ai është epiqendra e përfitimit moraloshpirtëror. Edhe bisedat plot emocione shpirtërore janë shkëlqime të tejçuara në mënyrë të vargëzuar gjithë nga ajo qendër. Për rrjedhojë, nëse dikush merr pjesë nga drita shpirtërore e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) nëpërmjet një miku të Zotit, meqë kjo dritë vjen nga e njëjta qendër, është si të jetë marrë nga vetë Profeti (s.a.s.). Krejt si ndezja me një qiri e të gjithë qirinjve ose kandilëve të tjerë. Flaka që marrin dhe me të ci-

69 Shih. Ebu Davud, *Sunnet*, 23-24.





lën digjen qirinjtë apo kandilët dhe me të cilën ndriçojnë mjedisin përreth, është e njëjta flakë. Edhe sikur njeriu të ndriçohet me të fundit prej qirinjve ose kandilëve, ky qiri apo kandil i fundit që bën dritë (flakë) me dritën (flakën) e parë, reflekton vazhdimisht burimin e parë të dritës (flakës).

Kuvendet e bisedës dhe dhikrit ku reshon mëshira dhe prehja hyjnore, janë kopshte xhenneti në tokë. Në hadithin profetik thuhet:

“Kur një grup njerëzish mbledhen për ta përmendur Allahun, rrethohen nga engjëjt, i mbulon mëshira e Allahut, mbi ta zbret qetësia dhe prehja dhe Allahu i përmend ata mes atyre që ka pranë!” (Muslim, Dhikr, 39)

Kuvendet e tilla të njerëzve besnikë dhe të mirë duhet të njihen si pasuri, sepse janë parajsë kuptimi të tilla ku fshihen sy dhe zemra që përhndrisin me pasionin hyjnor!

Edhe njerëzit e zemrës e bartin dashurinë, pasionin dhe ekstatën e vet në bisedat e tyre. Nuri, domethënë, drita dhe bukuria shpirtërore e të fshehtës së zemrave të tyre u reflektohet pjesëmarrësve. Si rezultat i reflektimit dhe ngjyrosjes moralo-shpirtërore, në vartësi të kapacitetit dhe mundësive të veta, zemrat mbushen me nurin e frymëzimit, begatisë dhe të së vërtetës. Krejt si frymërat e këndshme që shpërndan ku shkon fladi i mëngjesit pasi ka kaluar nëpër lulishten me trëndafila, karafila dhe lule të tjera të zgjedhura.

Zoti thotë në Kur’an:

وَذَكِّرْ فَإِنَّ الذِّكْرَى تَنْفَعُ الْمُؤْمِنِينَ

“Ti këshilloji ata sepse këshilla u jep dobi besimtarëve!” (edh-Dharijat, 55)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i cili e ka përjetuar këtë ajet të lartë në kuptimin më të përkryer të saj, ka thënë:

“Feja është këshillë!” (Buhari, Iman, 42)

Këshilla ka dy kuptime: njëri, sinqeritet dhe tjetri, ftesë për të mirë.

Abdullah bin Revaha (r.anh), kur takohej me dikë nga sahabet, i thoshte:

“Eja, o vëlla, për hir të Zotit, të ulemi pak e ta freskojmë besimin në Zotin tonë!”⁷⁰

Një sahabi që nuk e kishte kuptuar se ç’do të thoshte kjo, shkoi dhe ia paraqiti çështjen Profetit (s.a.s.) Dhe Profeti (s.a.s.) iu përgjigj kështu:

“Allahu e mëshiroftë Abdullah bin Revahanë! Ai i ka qejf shumë kuvendet e dhikrit që lavdërohen prej engjëjve!”⁷¹

⁷⁰ Ta përmendim Zotin tonë.

⁷¹ Shih. Ahmed b. Hanbel, *Musned*, III, 265.





Edhe ky hadith ka shumë rëndësi për sa i përket rëndësisë së bisedës:

Një grua shkoi te Profeti (s.a.s.) dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Nga fjalët e tua përfitojnë vetëm burrat. Sikur të ndaje një ditë edhe për ne që të mblidheshim e të na tregojë nga ato që të mëson Allahu!”

Profeti (s.a.s.) i tha:

“Mirë, mblidhuni këtë ditë në këtë vend!”

Gratë u mblodhën dhe Profeti (s.a.s.) u mësoi atyre nga gjërat që ia kishte mësuar Allahu. (Buhari, *Ilm*, 36)

Gratë sahabe të shndërruara në nëna model për të gjithë ummetin me anë të këtyre bisedave të begata, i qortonin të bijtë që rrinin gjatë pa e parë dhe takuar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Kështu, e ëma e pati qortuar Hudhejfen (r.anh.) që s’e pati parë disa ditë Profetin (s.a.s.). Ai e tregon kështu këtë rast:

Nëna më pyeti:

“Kur je takuar më së fundi me të Dërguarin e Allahut?”

“U bënë disa ditë që nuk jam takuar!”

Ajo u zemërua dhe më qortoi ashpër. Kurse unë i thashë:

“Prit, mos u nxeh! Po shkoj menjëherë pranë të Dërguarit të Allahut, po fal namazin e akshamit bashkë me të dhe, pastaj, t’i them të bëjë pendesë edhe për mua, edhe për ty!” (Tirmidhi, *Menakib*, 30; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, V, 391-2)

Nga burrat e mëdhenj, Muhammed Zijauddin (k.s.) herë pas here i mblidhte fëmijët e vegjël dhe bisedonte me ta. Pas një bisede të tillë, e shoqja e pyeti:

“Ata janë ende të vegjël, ku marrin vesh nga biseda?”

Ai i dha këtë përgjigje:

“Edhe ata përfitojnë pak a shumë. Por qëllimi i vërtetë nuk është që ata të kuptojnë diçka. Kuvendet e bisedave tërheqin mëshirën e Allahut. Ja, atë mëshirë kërkoj unë! Këta fëmijë janë një pretekst...”

Prijësi i madh, Shah Nakshibendi (k.s.) thotë:

“Rruga jonë e edukimit është ngritur mbi bisedën. Punët e mira bëhen së bashku me njerëzit e mirë për hir të Allahut. Duke biseduar e duke biseduar me ta, na jepet mundësia të arrijmë besimin e vërtetë!”

Edhe dijetari Xhafer bin Sulejman (r.anh.) e tregonte kështu se ç’kishte fituar nga ndenjja dhe shoqërimi me njerëzit e mirë:

“Kur ndjeja një ngurosjë në zemër, ngrihesha dhe shkoja menjëherë te Muhammed bin Vasi, futesha në kuvendin e tij dhe e shihja në fytyrë. Kështu. Ngurosjë e zemrës më kalonte, brenda vetes më vinte gëzimi i adhurimit, përtesa më largohej dhe me atë gëzim bëja një javë adhurim!”

Edhe Omer bin Abdulaziz (r.anh.) thoshte:





“S’ka gjë më të gëzuar e më të bekuar në botë për mua se sa të ndodhem në një kuvend me Ubejdullah bin Abdullahun nga juristët e Medines. Nga qëndrimi dhe shoqërimi me njerëz si ai, mendja ndriçohet, zemra kënaqet, njeriu edukohet!”

Njëri nga nxënësit e prijësit të madh Ebul Hasan Shadhili (k.s.) i kishte braktisur bisedat. Një ditë, prijësi u takua me nxënësin dhe i tha:

“Pse u ndave prej nesh, pse i le bisedat tona?”

Nxënësi iu përgjigj:

“Më mjaftojnë ato që mësova dhe mora prej jush gjer më sot, tani s’kam më nevojë për ju!”

I dëshpëruar për këtë gjendje, ia hoqi vërejtjen kështu nxënësit:

“Shih, o bir! Po që se do të ishte e drejtë që dikush të mjaftohej me begatinë shpirtërore të marrë nga dikush, Hz. Ebu Bekri (r.anh) duhej të mjaftohej me begatinë e marrë nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.), kurse ai nuk u ndaj nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.) gjersa vdiq!”

Sigurisht, jo vetëm Ebu Bekri (r.anh), por të gjithë sahabet vazhdonin me një dëshirë të veçantë të bisedat e Profetit (s.a.s.) dhe merrnin begati shpirtërore, gjë që edhe Profeti vetë e nxiste të sahabet me çdo rast. Sepse njëra prej metodave më të rëndësishme të tij të edukimit ishte biseda.

Sa ç’është e rëndësishme të kesh dëshirë për të përfutur bukuritë e arritshme me anë të bisedës, është e rëndësishme edhe t’i kushtohet kujdes kohës dhe vendit të bisedës. Në lidhje me këtë, Abdullah ibni Mes’ud (r.anh) ka thënë kështu:

“Për të mos na e bërë të mërzitshme neve, i Dërguari i Allahut priste kohën më të përshtatshme për të na dhënë këshilla neve!” (Buhari, Ilm, 11)

Ebu Vakid el-Lejsi nga sahabet tregon:

Një ditë, së bashku me një grup njerëzish, ndodheshim pranë Profetit (s.a.s.). Në atë mes, në derë u panë tre burra. Njëri iku pa hyrë brenda. Kurse dy të tjerët hyjnë brenda dhe shkuan gjer pranë Profetit. Njëri u ul në vendin bosh që gjeti në rrethin e formuar nga njerëzit që rrinin ulur. Kurse tjetri, meqë s’gjeti vend dhe për të mos i shqetësuar të tjerët, u ul pas rrethit.

Pas një farë kohe, në një vend të bisedës, Profeti (s.a.s.) tha kështu:

“A t’ju tregoj se ç’ndodhi me tre vetë? Njëri që u ul në rreth, u mbështet te Allahu i Lartë. Edhe Allahu e mori nën mbrojtje.

Tjetri pati turp nga Allahu dhe u druajt. Edhe Allahu e mbrojti atë nga ndëshkimi.

I treti që nuk hyri brenda, i ktheu shpinën kuvendit. Edhe Allahu ia ktheu shpinën atij!” (Buhari, Ilm, 8)

Të gjithë burrat e mëdhenj të Islamit të cilët e kanë kuptuar urtësinë e këtij hadithi, edhe nëse kanë qenë në kulmin e diturisë, vazhdimisht e





kanë gatuar zemrën në kuvendet e bisedave të miqve të Allahut dhe kurrë nuk e kanë parë të tepërt të ndodhen në kuvende të tilla. Kështu, Ahmed b. Hanbel (r.alejh), njëri ndër imamët e mëdhenj të shkollave juridike-fetare, shkonte shpesh te prijësi i madh Bishri Hafi (k.s.) dhe bisedonte me të. Ishte lidhur me të në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Një radhë, nxënësit i thanë:

“O imam, ti je një dijetar muxhtehid (ideator) në dituritë e Kur’anit dhe Sunnetit. A të ka hije ty të shkosh e të vish te një njeri i tillë i zakonshëm?”

Imami i madh u dha një përgjigje të tillë:

“Po, në ato drejtime që thatë, unë di më mirë se ai, por ai e di dhe e njeh Zotin më mirë se unë!”

c) Shërbimi (hizmet)

Shërbimi i pranueshëm është kërkimi i pëlqimit të Allahut duke iu drejtuar krijesave me një zemër plot sinqeritet, mëshirë dhe vetëmohim.

Njerëzit e shërbimit, me një ndjeshmëri si të ecnin mbi truall të minuar, duhet t’i kushtojnë kujdes delikatesës në trajtimin e njerëzve, sepse bashkëbisedues të tyre janë zemrat, vendvështrimi hyjnor!

Në edukimin mistik, rëndësia e shërbimit është shumë e madhe. Rruga më efektive e shtresimit të ndjenjës së thjeshtësisë, përlësisë dhe dhembshurisë për krijesat kalon përmes shërbimit. Prandaj, të gjithë prijësit e përkryer e kanë konsideruar shërbimin si një mjet me rëndësi në edukimin e nxënësve apo udhëtarëve të udhës mistike.

Po ta kërkojmë bazën e moralit islam, do ta gjejmë në kthimin kah Zoti me dashuri, principlialitet dhe sinqeritet, kurse shenjën e vetme të këtij kthimi, pa dyshim, te **“shërbimi”!** Sepse, shërbimi në kuadrin e parimit “kush shërben, meriton shërbim” është një shkallare e lartë dhe e veçantë që i ngjit zemrat në lartësitë hyjnore!

Kjo është një shkallare e tillë ku janë ngjitur profetët dhe të urtët, të gjithë ata që kanë merituar takimin hyjnor dhe shpërblimin e pasosur, ata që janë bërë modele konkrete të hadithit profetik:

“Zotëri i një fisi është ai që u shërben atyre!..” (Dejlemi, Musned, II, 324)

Sipas kësaj, për njerëzit, robtë e Zotit, rruga e kulmeve dhe e fitimit të përjetësisë kalon përmes shërbimeve të kryera me një zemër të sinqertë,





ashtu që, sipas vendit, një shërbim i vogël që ka merituar pëlqimin hyjnor, qëndron më lart se shumë adhurimeve nafile (suplementare).

Gjatë një fushate kur të nxehtit ishte rënduar shumë, Profeti (s.a.s.) vendosi të qëndronin e të pushonin në një vend të përshtatshëm. Një pjesë e sahabeve ishin të agjëruar, një pjesë, jo. Nga lodhja, të agjëruarit ranë në gjumë. Kurse ata që s'agjëronin, bartën ujë për abdest dhe ngritën çadra për të agjëruarit. Por kur erdhi koha e iftarit, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) tha:

"Sot, ata që s'agjëronin morën shpërblim më të madh!" (Muslim, Sijam, 100-101)

Profeti (s.a.s.) i cili i zgjaste ummetit, bashkësisë së tij, shumë e shumë kandilë të tillë shërbimi, gjatë ndërtimit të faltores së Kubas dhe Faltores Profetike pati bartur gurë në supet e bekuara pavarësisht nga këmbënguljet e vazhdueshme të sahabeve për t'a ndaluar. Kjo thjeshtësi e lartë dhe kjo frymë shërbimi e Krenarisë së Qenies është një shembull i pashoq për të gjithë ummetin. Në fakt, jeta e tij ka kaluar gjer në fund me shërbim ndaj Zotit, njerëzimit dhe tërë krijesave!

Për rrjedhojë, edhe në jetën e njerëzve fatmirë që e kanë marrë dhe e marrin shembull për vete atë qenie të bekuar, shërbimi është vetia më e shquar. E thënë ndryshe, çdo njeri që e do Zotin dhe zemra e pasionuar pas Profetit, është nga të shërbimit. Njerëzit e shërbimit janë si hëna dhe dielli në qiell që, sa më shumë ta ndriçojnë mjedisin përreth, aq më shumë u shtohet shkëlqimi i vet. Ata s'i pengon dot vranësia as e vjeshtës, as e dimrit. E shprehur ndryshe, ata janë si një lumë që rrjedh për vite të tëra duke u dhënë jetë gjallesave: kafshëve, drurëve e bimëve, trëndafilave, zymbylave e bilbilave, ndërkaq që vendi ku do të arrijnë të gjithë, është vetëm deti i pafundësisë dhe takimit me të Dashurin!

Ata që e njohin nga afër këtë të vërtetë, edhe nëse kanë qenë mbretër, e kanë quajtur veten vazhdimisht shërbëtorë të popullit. Kur qytetet e bekuara të Mekës dhe Medinës iu lanë në amanet shtetit osman dhe, me atë rast, imami e cilësoi sulltan Selimin e Rreptë "Sundues të dy qyteteve të shenjtë", ai sulltan i madh e kundërshtoi me sy të përbotur imamin duke iu korrigjuar shprehjen: "Përkundrazi, "Shërbëtor i dy qyteteve të shenjtë"! Dhe ky gjest ishte shprehje e kuptimit të lartë mbi shërbimin dhe e njohjes së qëllimit të vërtetë të detyrës së robit ndaj Allahut!

Kështu, Ubejdullah Ahrar (k.s.), duke ia atribuar gradën që kishte arritur begatisë së shërbimit, thotë kështu:

"Ne i kapërcyem largësitë në këtë rrugë jo vetëm duke i lexuar librat e tasavvufit, por duke i zbatuar ato që lexonim dhe duke i shërbyer popullit. Çdo njeri e dërgojnë nëpër një rrugë, ne na dërgojnë nëpër rrugën e shërbimit!"





Dhe kjo shpreh faktin se vetëm dija nuk është e mjaftueshme se ajo që dihet duhet bartur patjetër në shërbim!

Ndërkaq, që shërbimi i kryer të jetë i pranueshëm në lartësinë e Allahut, duhet që kryerja të përmbajë disa veti dhe cilësi. Sipas kësaj, shërbimi i pranueshëm është kërkimi i pëlqimit të Allahut duke iu drejtuar krijesave me një zemër të mbushur plot me principialitet, sinqeritet, mëshirë dhe vetëmohim. E thënë ndryshe, shërbimi duhet bërë sinqerisht pa ndjekur ndonjë interes vetiak apo material dhe me të duhet të synohet fitimi i përjetësisë. Po të bëhet kështu, për shpëtimin e përjetshëm bëhet pretekst edhe një "gjysmë hurme" siç thuhet në hadithin profetik!

Ubejdullah Ahrar Hazretleri tregon:

Një ditë kisha shkuar në pazar. Një person i uritur m'u afrua dhe më tha:

"Jam i pangrënë! Për hir të Allahut, a më jepni për të ngrënë?"

Atë çast s'kisha asnjë mundësi. Kisha vetëm një çallmë të vjetër. Hyra në një gjellëtoze dhe i thashë gjellëtarit:

"Merre këtë çallmë! Është e vjetër, por e pastër! E përdor për të tharë enët. Në shkëmbim të kësaj, a po i jep të hajë këtij njeriu të uritur?"

Gjellëtari i dha të varfërit për të ngrënë, kurse mua deshi të ma kthente çallmën. Megjithëse nguli këmbë shumë, nuk e pranova. Megjithëse edhe vetë isha i pangrënë, prita gjersa i varfëri u ngop.

Hz. Ubejdullah Ahrar, më vonë, me favorin e Zotit, u bë pronar i një pasurie të madhe. Në çifligjet e tij punonin me mijra punëtorë. Por prapë, ai njeri i bekuar nuk e la shërbimin. Gjendjen e vet të kohës kur qe i pasur e tregon vetë kështu:

"Kisha marrë përsipër shërbimin për katër të sëmurë të Medresesë Mevlana Kutbuddin të Samarkandit. Nga rëndimi i sëmundjes, e fëlliqnin shtratin. Unë i laja me duart e mia dhe ua ndërroja ndërresat. Nga shërbimi i vazhdueshëm pranë tyre, sëmundja m'u ngjit edhe mua dhe rashë në shtrat. Por edhe në atë gjendje, madje, vazhdova të sjell ujë me shtamba, t'i pastroj ata vetë dhe rrobat e tyre!"



Sjelljet ideale në jetën e njerëzve të mëdhenj mbi vlerën dhe virtytin e dhënies dhe shërbimit në rrugën e Zotit, janë shembuj të bukur për ne. Sado i pasur të jetë një musliman, hakun dhe kundërshtëpërblimin e mundësive materiale mund ta japë vetëm me aq sa ta shtojë inteligjencën shpirtërore dhe ta ngrejë nivelin e jetës ndjesore. Duke përparuar në vlerat shpirtërore, respektimi i kritereve të adhurimit dhe devocionit dhe ruajtja e një thjeshtësie të plotë pavarësisht nga qenia i pasur, e çojnë atë në një pikë ideale si ajo e përshkruar në rrëfimin e Hz. Ubejdullah Ahrarit.





Njëra prej shkallëve të vështira për t'u ngjitur në shërbim, vërehet edhe në këtë rrëfim të Hz. Maruf Kerhiut.

Një i sëmurë i moshuar i vuajtur shkon në shtëpinë e Maruf Kerhiut. Njeriu i shkretë ishte i pashpresë: flokët i kishin rënë, ngjyra e fytyrës i kishte ikur, shpirti ia copëtonte trupin si me çengel. Maruf Kerhi shtroi një shtrat dhe i krijoi mundësi të sëmurit të pushonte.

Nën dhimbjet e rënda, i sëmuri rënkonte dhe ankohej me zë të lartë. Me rënkimet dhe ankesat me zë të lartë jo vetëm që s'fjeti vetë gjer në mëngjes, por s'la as njerëzit e shtëpisë të flinin. Veç kësaj, u prapësua dhe filloi t'i qortonte dhe shqetësonte njerëzit e shtëpisë. Më në fund, duke mos e duruar dot, ata u larguan një nga një nga shtëpia. Në shtëpi mbeten vetëm i sëmuri dhe Maruf Kerhi.

Maruf Kerhi s'flinte as natën, por përpiquej t'ia plotësonte nevojat këtij të sëmuri të prapë, për t'i shërbyer atij. Por një ditë, kur pagjumësia i arriti kulmin, e zuri gjumi pa dashje. Dhe i sëmuri i pamarrëvesh që e pa se po flinte, në vend që ta falenderonte atë person të mirë që ia kishte hapur prehrin me mëshirë dhe dhimbshuri, e qortonte dhe vetë me vete thoshte:

“Ç'dervish është ky kështu? Fundja njerëz si ky kanë emër e famë në dukje, por në të vërtetë janë dyfytyrësh. Çdo punë e kanë të kotë. Nga jashtë janë të pastër, por nga brenda, të fëlliqur. Të tjerët i këshillojnë për devocion, por vetë s'bëjnë. Prandaj ky njeri fle pa e menduar hallin tim. Njeriu që e ka mbushur barkun dhe është kredhur në gjumë, ç'merr vesh për hallin e të sëmurit të pashpresë që s'mbyll sytë gjer në mëngjes?”

Maruf Kerhi u tregua i durueshëm dhe zemërgjerë edhe ndaj këtyre fjalëve të hidhura që i dëgjoji. Bëri sikur s'kishte dëgjuar gjë. Mirëpo e shoqja që i kishte humbur durimi, s'duroi dot më dhe i tha kështu me zë të ulët Maruf Kerhit:

“I dëgjove se ç'tha ky njeri i prapë. Atë s'mund ta mbajmë më këtu. Nuk duhet ta lejojmë më që të na rëndojë më shumë dhe ty të të mendojë. Thuaji të largohet që këtu dhe t'i gjejë çare vetes diku tjetër. Mirësi i bëhet atij që ia di vlerën. Është keq t'u bësh të mirë mosmirënjohësve. Atëherë ata tërbohen më shumë. Njeriut të poshtër nuk i vihet jastëk nën kokë. Koka e njerëzve të tillë duhet të mbështetet mbi shkëmb!”

Maruf Kerhi i cili i dëgjoji me qetësi këto fjalë të gruas, iu kthye asaj me buzëqeshje:

“O grua! Pse të prekin ty fjalët e tij? Po të ketë bërtitur, më ka bërtitur mua, po të ketë bërë paturpësi, ka bërë ndaj meje. Fjalët e tij që duken të pakëndshme, mua më vijnë të këndshme! E sheh se ai vuan vazhdimisht. Pa shih: nuk fle dot asnjë frymë! Dhe ta dish se aftësia e vërtetë, dhembshuria dhe mëshira e vërtetë janë durimi i të keqes së njerëzve të tillë...”

Sheh Saadiu që na e përcjell këtë rrëfenjë, na këshillon:





“Virtyti në shërbim është që, kur ta shohësh veten të shëndoshë, të aftë e të fuqishëm, ta përballosh barrën e njerëzve të dobët për të marrë falenderimet e tyre!”

Zemra e mbushur me dashuri, bëhet falëse. Po të jesh thjesht një trup, kur të vdesësh, do të vdesësh bashkë me emrin. Po të jesh bujar dhe njeri i shërbimit, edhe pasi të vdesësh, do të vazhdosh të jetosh me aq sa ç’ke sakrifikuar dhe sa ke hyrë ndër zemra. A nuk sheh se në Kerh ka shumë tyrbe? Por nuk ka tyrbe më të shquar dhe me më shumë vizitorë se tyrbeja e Maruf Kerhit!”

Sa bukur kanë thënë njerëzit e Allahut:

“Tasavvufi është t’u bëhesh të tjerëve jar⁷², jo barrë!”

Pra, të mbash barrën e çdokujt, por të mos i bëhesh barrë askujt!

Ummetit i hapen dyert e mëshirës veçanërisht me anë të shërbimeve mëshiruese dhe sakrifikuese. Vlera e një shërbimi varet nga madhësia e sakrificës së përballuar për kryerjen e tij dhe nga kryerja e tij me ekstazë adhurimi. Gjithashtu, një shërbim i pranuar duhet kryer vetëm me qëllim pëlqimin e Allahut dhe me një mënyrë që të mos e prekë dhe ulë personin të cilit i jepet ai shërbim. Abdullah bin Munazil (k.s.) është shprehur kështu:

“Edukata në shërbim është më e çmuar se vetë shërbimi!”

Mbështetur në këtë të vërtetë, Hz. Mevlana thotë:

“Puno për dashuri të Allahut, shërbe për dashuri të Allahut! Ç’punë ke ti me pranimin ose kundërshtimin e njerëzve? A nuk është i mjaftueshëm Allahu si një myshteri me leverdi të mëdha në pazarin e kësaj bote të përkohshme? Ku mund të krahasohen ato që kanë për të të dhënë njerëzit me ato që ka për të të dhënë Allahu? Prandaj mos i kthe sytë dhe zemrën nga falenderimet që do të të vijin prej njerëzve, por nga meritimi që do të të vijë prej Allahut!”

Ja, kjo është bukuria dhe lartësia ku rruga e tasavvufit kërkon t’i bëjë zemrat të arrijnë! Në këtë kontekst, Hz. Emir Kulal e ka këshilluar kështu nxënësin e vet, Bahaeddin Nakshibend (k.s.), për t’i shkatërruar prirjet egoistike e sensuale në veten e tij:

“Shih të fitosh një zemër, shërbeju të pafuqishmëve! Mbroji të dobëtit, zemërthyerit. Ata janë njerëz të tillë që nuk kanë asnjë të ardhur nga njerëzit. Megjithatë, shumë prej tyre ikin me zemër plotësisht të qetë, të thjeshtë dhe të shtypur! Kërkoji dhe gjeji njerëz të tillë dhe shërbeju!”

Me të vërtetë, në vitet e para të udhëtimit mistik⁷³, Shah Nakshibendi (k.s.), për të arritur në gjendjen e “asgjësisë” që është e kundërta e krenarisë dhe mendjemadhësisë, u ka shërbyer njerëzve të sëmurë e të vuajtur, kafshëve të plagosura dhe, madje, duke pastruar rrugët nga kalonin njerëzit, ka kaluar plot shtatë vjet një jetë të pashembullt shërbimi.

72 Jar, jaran, i dashur, mik.

73 Në origjinal: *intisab* (arab.) antarësim, hyrje në tarikat dhe fillim i edukimit mistik.





Ai vetë e tregon kështu:

“Punova për një kohë të gjatë në rrugën që më caktoi mësuesi im. I krevia të gjitha shërbimet. Vetëdija m’u bë e tillë që, kur kaloja në rrugë, po qe se më dilte para ndonjë krijesë çfarëdo e Allahut, ndaloja dhe prisja të kalonte. Kjo gjendje më vazhdoi shtatë vjet. Në shpërblim të këtij shërbimi, arrita të dëgjoj se si qeniet nxirrnin zëra ankues dhe përgjërimesh drejtuar Zotit!”

Ky shembull si më sipër është shfaqje konkrete e shërbimit flijues duke e parë krijesën me dashurinë e Zotit dhe për hir të Tij.

Për robtë e mirë (salih), Zoti thotë kështu në Kur’an:

“... ata bëjnë garë me njëri-tjetrin në të mirë.” (Al-i Imran, 114)

Dhe produktet më të zgjedhura në këtë garë të njerëzve të mirë për të bërë mirë, janë institucionet e vakfit. Njerëzit e vakfit janë profetët dhe të urtët të cilët ndodhen në kulm të njerëzimit, si dhe besimtarët që kanë arritur përkryerjen nën edukimin e tyre. Ata e kanë bartur emocionin e besimit të zemrave në katër anët e botës dhe po ata i kanë mbushur faqet e arta e më të zgjedhura të historisë.

Gjithsesi, shërbimet janë të ndryshme. Të tëra përpjekjet e bëra për pëlqim të Allahut hyjnë në kuadër të shërbimit. E rëndësishme është që zemrat të realizojnë një shërbim qoftë material, qoftë moralo-shpirtëror sipas dinjitetit, mundësive dhe aftësive të veta. Sepse Allahu i Lartë i ka caktuar secilit një shërbim, e ka bërë secilin të denjë për një punë sipas natyrës krijimore të tij dhe për këtë, i ka dhuruar mundësitë e duhura materiale-shpirtërore.

Është shumë domethënëse që në Haxhin e Lamtumirës ishin të pranishëm afro njëqind e njëzet mijë vetë. Mbi njëqind mijë prej tyre, duke u shpërndarë në zona të ndryshme të botës, ia kushtuan veten shërbimit për pëlqim të Zotit dhe vdiqën në ato vise. Kështu, tyrbet e fëmijëve të Hz. Osmanit dhe Abbasit (r.anhuma) ndodhen në Samarkand, kurse varret e shumë sahabeve, në Stamboll. Ndërkaq, një pjesë e madhe e atyre që mbejnë në Mekë dhe Medinë, mbrojtën qendrën dhe morën përsipër shërbimet e atyshme.

Fakti që Halid bin Zejd Ebu Ejjub el-Ensariu pati ardhur në moshën tetëdhjetë e sa vjeçare dhe, me gjithë pleqërinë e shtyrë, dy herë gjer në muret e Stambollit dhe e dorëzoi shpirtin aty, është njëra nga përpjekjet mbarëbotërore për t’i ftuar njerëzit në rrugën e drejtë dhe për t’ua mundësuar atyre lumturinë e kësaj bote dhe të përjetësisë. Pasioni për shërbim dhe lufta për shpëtimin e jetës tjetër nga pikëpamja personale i ka shtyrë ata të shkojnë në katër anët e botës!





Njëri prej shembujve madhështorë të frymës së shërbimit është edhe Vehb bin Keshhe (r.anh.). Tyrbeja e këtij sahabinu të bekuar është në Kinë⁷⁴. Profeti (s.a.s.) e pati ngarkuar me detyrë atë për të kryer shërbimin e kumtimit të fesë në Kinë. Mirëpo me kushtet e asaj kohe, Kina ndodhej në një largësi prej një viti rrugë. Megjithëkëtë, pasi pati shkuar gjer në Kinë dhe pati shërbyer për një kohë të gjatë, qe nisur për në Medinë për të shuar mallin për Profetin. Por, kur pati arritur në Medinë, nuk e pati gjetur dot Profetin i cili ndërkohë kishte vdekur, prandaj, i vetëdijshëm për detyrën që ia kishte ngarkuar i Dërguari i Allahut (s.a.s.), qe kthyer përsëri në Kinë dhe atje e pati dorëzuar shpirtin ndërsa ndodhej në detyrë!

Këto janë tabllo shërbimi të shkëlqyera dhe të sakrificës të mundura për t'u kryer vetëm me anë të ekstatës së besimit. Pasioni dhe fryma e tyre e shërbimit janë për ne si yje të ndritshëm që ndriçojnë rrugët e shpëtimit të përjetshëm.

Pa asnjë dyshim që sahabet kanë arritur në këtë shkallë të shërbimit nën dritën e edukimit të veçantë të Profetit (s.a.s.), veçanërisht duke respektuar me rreptësi këto nëntë specifika:

- 1) Shërbim ndaj Allahut, zbatimi i urdhrave dhe ndalimeve të Tij me dëshirë.
- 2) Shërbim ndaj Profetit (s.a.s.); duke ndjerë dashuri për të nga zemra, jetesë sipas traditës së tij profetike.
- 3) Shërbim ndaj burrave të mëdhenj të Islamit, tregimi i dashurisë, besës dhe besnikërisë ndaj tyre.
- 4) Shërbim ndaj prindërve, fitimi i pëlqimit të tyre pa bërë as "of" ndaj tyre.
- 5) Shërbim ndaj fëmijëve dhe sigurimi i rritjes së tyre si besimtarë të mirë (salih).
- 6) Shërbim ndaj farefisit, vizitë te të afërmit dhe kryerja e mirësive ndaj tyre.
- 7) Shërbim ndaj besimtarëve, ndarja me ta e hidhërimeve dhe gëzimeve të tyre.
- 8) Shërbim ndaj të gjithë njerëzve, përpjekje me gojë dhe dorë për t'u bërë i dobishëm për ta.
- 9) Shërbim ndaj krijesave, shprehja e dhembshurisë ndaj të gjitha qenieve.

⁷⁴ Edhe në qytetin Guangzhou të Kinës ndodhet një seli që i kushtohet Sa'd bin Ebi Vakkas (r.anh.). Është një e vërtetë historike e njohur se varret e sahabeve dhe njerëzve të shquar në shumicën e herës kanë ndikuar për mbajtjen gjallë dhe mbrojtjen e ndjenjave fetare të popullsisë së zonës përkatëse. Me të vërtetë, shembuj të kësaj ka në zona të Azisë Qëndrore, si Samarkandi, Buharaja, Turkistani dhe Tashkenti.





Janë mjaft domethënëse thëniet e Ali Ramitenit në lidhje me kryerjen e këtyre shërbimeve:

“Janë shumë ata që bëjnë shërbime duke u mburrur, por janë shumë të pakët ata që e konsiderojnë shërbimin mirësi dhe dhunti ndaj vetes së tyre. Po që se ju e njihni për favor (mirësi dhe dhunti) që iu është dhënë mundësia të shërbeni dhe u jeni mirënjohës atyre që u shërbeni, çdo njeri mbetet i kënaqur prej jush dhe ankuesit pakësohen...”

Edhe sikur ta kuptojmë, edhe sikur të mos e kuptojmë, ajo çka kërkojmë të gjithë në të vërtetë, është paqja e shpirtit, domethënë, arritja e prehjes dhe kënaqësisë shpirtërore. Dhe kjo është një thesar i brendshëm që mund të arrihet me anë të shërbimeve që kryhen me ekstazën e adhurimit ndaj Zotit. Prandaj, besimtari me shpirt dhe vetëdije shërbimi di të gjejë në të gjitha kushtet mjetet dhe rastet për të shërbyer. Në sakrificat që bën për pëlqim të Allahut, tregon zell më të madh se zelli dhe ambicjet që tregojnë ata që vrapojnë pas interesave materiale dhe, përgjithësisht, të kësaj bote!

Kur dëshira për shërbim që ushqehet nga klima e pasionit hyjnor, gjen vend në zemër, e bën njeriun udhëtar të përjetësisë. Zemra del nga ngurtësia e Haxhxahxit Mizor⁷⁵ dhe mbulohet me lëkurën e butë të dhembshurisë së Junusit. Dituria, arti dhe morali të zotëruar me këtë frymë, arrijnë një pavdekësi dehëse. Nisur nga kjo, shërbimet e singerta e të vërteta janë kryevepra të maturisë së zemrës. Zemra të tilla janë “vendvështrim hyjnor”.

Ndërsa puna qëndron kështu, ç’disfatë e madhe është ta kalosh jetën larg cilësive ndjesore (afektive) të zemrës! Ç’lumturi për ata që e mbushin zemrën me të vërtetë me pasionin për shërbim!

d) Prirja (tevehxhuh)

Në gjuhën e tasavvufit, mistikës islame, tevehxhuh është përqëndrimi i tërë fuqisë moralo-shpirtërore të myrshidit mbi zemrën e myridit dhe, në këtë mënyrë, tejçimi te ai i situacioneve. E shprehur ndryshe, është përçimi te myridi i situatave psikologjike-shpirtërore të bukura të prijësit të përkryer dhe, si rezultat, ushtrimi i ndikimit mbi shpirtin dhe zemrën e myridit. Kjo ka shumë mjete parësore e dytësore.

Nga këto mjete, ne do të bëjmë fjalë për “syrin” dhe “thelbin”.

Syri (mësyshi):

Syri është mjet shikimi. Ndërkaq, meqë me anë të shikimit shkaktohet një efekt i caktuar, edhe ky efekt emërtohet sy (syri). Për shembull, thuhet

⁷⁵ Jusuf bin Sakafi, guvernator i Irakut, që njihet për dhunën e egër që pati ushtruar ndaj pasardhësve të profetit Muhammed dhe përkrahësve të tyre.





“e zuri syri”. Por për efektin përdoren më shumë dhe në mënyrë specifike, fjalët mësysh, mësyshje, përsysh, përsyshje. Për shembull, thuhet: “mori mësysh”, “u përsysh”, etj.⁷⁶

Për efektin e shikimit ose, më saktë, për mësyshjen (përsyshjen), në hadithet profetike thuhet:

“Mësyshja është e vërtetë!” (Buhari, Tib, 36)

“Mësyshja e çon njeriun në varr, kurse devenë, në tenxhere!” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagîr, II, 60)

Këto që u thanë gjer këtu, dihen nga të gjithë. Ndërkaq, efekti që krijohet me anë të syrit nuk është vetëm i dëmshëm ashtu siç pandeh populli i thjeshtë, por mund të jetë edhe i dobishëm. Nga syri i shikuesit drejtohet për tek objekti një tufë drite me natyrë ende të panjohur dhe efekti i dëmshëm apo i dobishëm krijohet nga natyra e dëmshme apo e dobishme e kësaj tufe.

Në kohën tonë, njohuritë fizike mbi rrezet dhe tufën e dritës kanë përparuar aq shumë sa të na detyrojnë ta pranojmë efektin e saj si një të vërtetë shkencore.

Edhe lazeri i zbuluar në shekullin e kaluar është një tufë drite. Sot gjithkush e di se me lazer pritet hekuri i trashë, bëhen operacione mjekësore, etj. Nga ana tjetër, dihet që prej shumë kohësh dukuria e thithjes ose reflektimit të dritës nga objekte të ndryshëm në vartësi edhe të ngjyrës së tyre.⁷⁷

Efekti i krijuar në qeniet lëndore përballë tufës së dritës të dalë nga syri, nuk është gjithmonë i të njëjtës gradë. Ashtu siç rrezet e dala nga sytë janë – negativisht ose pozitivisht – edhe të fuqishme, edhe të dobëta, ashtu dhe efektet e krijuara prej tyre, në vartësi edhe të objektit lëndor, janë edhe të fuqishme, edhe të dobëta. Për personat që kanë aftësi të shkaktojnë efekte tek qeniet lëndore, pra, që konsiderohen të rrezikshëm, populli përdor shprehjet “ka sy të fortë” “të ha me sy”, “sykeq”, etj., dhe ruhet prej tyre.

76 Përshtatja e këtij paragrafi sipas konceptualitetit dhe traditës zakonore shqiptare është e përkthyesit.

77 Në disa biblioteka shtrojnë mbulesa jeshile mbi tryezat e leximit. Kjo bëhet për të parandaluar lodhjen e syve. Për këtë, le të kujtojmë se sytë e njeriut çlodhen kur vështrojnë hapësira të gjelbëruara ose ujore. Njerëzit veshin rroba të bardha verës për t’u ruajtur nga nxehtësia sepse ngjyra e bardhë e reflekton dritën. Kurse ngjyra e zezë e thith krejtësisht dritën, prandaj rrobat e zeza mbajnë ngrohtë. Në spitale, ndërsa përgjithësisht përdoren përparëset e bardha sepse ngjyra e bardhë simbolizon pastërtinë dhe higjienën, kirurgët veshin përparëse në ngjyrë të blertë qelqore e cila i çlodh sytë. Gjithashtu, dihet se e verdha e thellë dhe bluja e thithin dritën. Prandaj, siç duket, në disa popuj, si p.sh., turqit, u varin fëmijëve në trup ose në ballë flori.





Syri i fortë ekziston edhe tek disa kafshë. Për shembull, shikimi i ne-përkës është aq me efekt, saqë shkakton dështimin e gruas me barrë ose vdekjen e disa kafshëve.⁷⁸

Efekti i syrit që populli e pranon edhe pse joshkencërisht, ka një rol të madh në tasavvufin ose mistikën islame, për rrjedhojë në edukimin e nxënësit ose udhëtarit të udhës mistike. Prijësit e përkryer janë persona tek të cilët, si rezultat i përkorjes dhe pastrimit ndjesor, fuqia ndikuese e vështrimit arrin në kufij maksimalë. Kjo kompetencë dhe fuqi e tyre është përfitim nga Profeti (s.a.s.), trashëgimtarë të të cilit janë.

Menjëherë pas vargut të profetëve të cilët zënë radhën e parë në shka-llëzimin moralo-shpirtëror të njerëzimit, vijnë sahabet, shokët e Profetit (s.a.s.). Fjala “sahabe” e formuar nga e njëjta rrënjë me fjalën “sohbet” (bi-sedë), emërton personat që kanë pasur nderin të marrin pjesë në bisedat e Profetit (s.a.s.) si njerëz që i kanë besuar atij. Ndërkaq, megjithëse shkakut i nderit, konsideratës dhe famës që gëzojnë sahabet është “begatia e nderimit me bisedën profetike”, faktori esencial është fakti që ata kanë qenë objekt i shikimeve të Profetit, atij njeriu të bekuar. Edhe pse për cilësimin e dikujt si “sahabe” diskutohen shumë kritere, kriteri më i pranueshëm ose përgjithësisht i pranueshëm është prania e personit si besimtar pranë Profetit, domethënë, personi është ndodhur përballë Profetit si bashkëbisedues i tij, e ka parë vetë atë dhe ka qenë objekt i vështrimit të tij.

As i urti (evlija) në gradën më të lartë të të urtëve (evlijave), madje, nuk mund të krahasohet me sahaben e gradës më të ulët, sepse mes tyre ekziston një dallim i madh i lindur nga partneriteti ndaj vështrimit profetik dhe krejt i pamundur të fitohet me ndonjë motiv tjetër. Muslimanët e ardhur pas Profetit (s.a.s.) nuk arritën dot në pozitën e sahabes ngaqë nuk qenë partnerë ose objekte të shikimit ose vështrimit profetik. Ndërkaq, muslimanët që patën nderin të takoheshin dhe shiheshin me sahabet, u quajtën “tabiinë”, kurse muslimanët që patën nderin të takoheshin dhe shiheshin me tabiinët, u quajtën “tebei tabiinë”.

Megjithëkëtë, meqë të urtët (evlija) janë trashëgimtarë të veprimtarisë moralo-shpirtërore të Profetit (s.a.s.), zotërojnë një kompetencë dhe fuqi me të cilën të tjerët nuk mund të krahasohen. Është për këtë arsye që, për të përfituar siç duhet nga një prijës i përkryer, nuk mjafton të jesh nga njerëzit që e duan atë, por është kusht që të fitosh nderin dhe begatinë e partneritetit ndaj vështrimeve të tij të ndritshme.

Profeti (s.a.s.) ka thënë:





“Ruhuni nga urtësia⁷⁹ e besimtarit sepse ai sheh me dritën e Allahut!”
(Tirmidhi, *Tefsir*, 15)

Duke u shprehur kështu, Profeti ka treguar se urtësia e çdo besimtari është në raport të drejtë me besimin e tij. Nisur nga kjo, urtësia e të urtëve të cilësuar evlija që janë besimtarë të përkryer, është shumë më i fuqishëm se i të tjerëve.

Paralajmërimi i formës “ruhuni” në hadithin e mësipërm, do të thotë: “Mos hyni tek besimtarët e përkryer me hesape të fshehta dhe zemër të turbullt (të papastër), sepse ata, me intuitën e veçantë që kanë, ata i shohin ato që ju përpiqeni t’i fshihni.” Sepse ata që arrijnë këtë fuqi shikimi (vështrimi), i shohin të vërtetat qartë pasi për ta janë ngritur perdet materiale mes përmbajtjes dhe formës. Prandaj, mbrojtja e gjuhës përballë dijetarit dhe e zemrës përballë arifit (dijetarit të kulturës shpirtërore) është një domosdoshmëri fetare.

Duke u nisur nga fakti që syri (shikimi) është një nga mjetet më me rëndësi që përdor myrshidi si metodë edukimi, arrija e shikimit (vështrimit) të myrshidit është konsideruar për myridët një fatmirësi e madhe.

Një kujtim

Ishin vitet kur mësoja në liceun fetar⁸⁰. Njoha një njeri të mirë zemre të quajtur Ahmed Khan. Ishte pakistanez. Ishte i shtënë pas Sami Efendiut. Edhe tim atë të ndjerë, Musa Efendi (k.s.), e donte shumë dhe s’pranonte të ndahej prej tij. Kështu, kur vinte shpesh në Turqi për t’i bërë vizitë Sami Efendiut, banonte në shtëpinë e miqve që kishim në oborr.

E kishte zemrën të mbushur aq shumë me dashuri, sa edhe në ditët kur s’kishte bisedë, digjej nga dëshira për ta parë Sami Efendiun dhe përsillej rreth shtëpisë së tij. Një mbrëmje na tregoi se si kishte lindur kjo dashuri tek ai.

“Ishte koha e haxhit. Në varrezën profetike, po rrija në vendin e quajtur As’habi Suffe. Në atë mes, para meje kaluan një person i nderuar mjaft elegant, me fytyrë të pastër dhe që të kujtonte Allahun kur ta shihje në fytyrë, së bashku me një grup të hijshëm që e shoqëronte. Dhe, kur ndodhej mu në drejtimin tim, më fali mua të varfërit një **shikim!**

Ja, pra, me vështrimin e atyre syve engjëllorë, brenda një çasti hyra në klimë tjetër, në një botë tjetër. Çdo gjë ndryshoi. Nga kënaqësia shpirtërore që mora, m’u duk sikur e humba veten. Për një çast qesh dhënë pas atij nje-

79 Në original: firaset, forcë shpirtërore, intuitë shpirtërore, urtësi (shenjtëri) moralo-shpirtërore.

80 Në original: imam-hatip.





riu të pashembullt, kisha rënë në një gjendje gjysmë të asfiksuar. Dhe kur pak më pas erdha në vete, u përpoqa ta gjeja atë njeri, por s'qe e mundur mes atij kallaballëku të Varrezës Profetike!

Dhe u vura të pres me mendimin se ka për t'u kthyer prapë aty. Shyqyr që shpresa s'më shkoi kot. E ndoqa me gëzim. Siç duket duke më pandehur për lypsar, shumë vetë m'u afruan për të më dhënë sadaka. Por unë nuk i pranova. Në të vërtetë, nuk isha ndonjë i pasur, por me begatinë e vështrimeve të atij personi të mirë (salih), çdo gjë që kishte të bënte me këtë botë, e kishte humbur vlerën para syve të mi dhe unë isha kredhur, tashmë, në detin e një ngopjeje krejt tjetër. Më në fund, ata arritën në një shtëpi dhe hynë brenda. Kur edhe unë desha të hyj pas tyre, natyrisht që më penguan sepse nuk më njihnin, por ai njeri i madh, Hz. Samiu, u kthye pas dhe më mori brenda. Atë ditë, në atë shtëpi, meritova sa e sa shfaqje të atij njeriu të madh, sa e sa **shikime** dhe **prirje** të tij ndaj meje!

Lavdi Zotit, me ato shikime dhe prirje, e gjithë jeta më ndryshoi, m'u zbukurua dhe, më në fund, u bëra njeriu i një bote krejt tjetër, mjaft të këndshme e të pafundme. Dhe tani mbledh para dhe çdo vit vij këtu për të përfituar nga shikimet dhe prirjet e tij, gjë që është, për mua, fitorja më e madhe shpirtërore dhe gëzimi i vetëm i zemrës!

Thelbi:

Mjeti më i efektshëm e më i shpejtë që përdor myrshidi për të vepruar mbi shpirtin dhe zemrën e myridit, është "thelbi", "e fshehta". Kjo zbatohet duke përdorur të fshehtën e prijësit të cilën e përmendim kur themi "kuddise sirruh", "iu shenjtëroftë e fshehta". Natyrën dhe përbërjen e këtij mjeti e di vetëm ai që e përdor. Kjo futet në pjesën e përmbajtjes (hâl) të tasavvufit, jo në pjesën e fjalës (kâl), prandaj dhe nuk ndodhet në libra.

e) Lutja (duá)

Një mjet tjetër që përdor prijësi i përkryer për ta drejtuar nxënësin ose udhëtarin e udhës mistike, është lutja (duá). Dhe kjo është një gjë cilësore e lindur nga ndjekja e sunnetit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Siç dihet, para se të bëhej musliman, Hz. Omeri (r.anh.) pati vendosur të kryente mëkatën më të rëndë që mund të përfytyrohej, të vriste Profetin. Por me pretekstin e një lutjeje të Profetit të bërë më parë për të, ai hoqi dorë nga ky mendim dhe gjeti rrugën e drejtë. Në jetën e Profetit (s.a.s.) ka shumë ngjarje të tilla.

Gjithashtu, siç dihet, kur në rrethimin e Taifit, Profetit iu kërkua ta mallkonte fisin Thakif që u kishte shkaktuar shumë humbje muslimanëve, Profeti (s.a.s.) u lut për të mirën e tyre që të hynin në rrugën e drejtë dhe





me begatinë e asaj lutjeje, pas një kohe të shkurtër, ai fis shkoi te Profeti si musliman!⁸¹

Një sahabe me emrin Shejbe tregon këtë ngjarje:

“Në ditën e Hunejnit, mora pjesë në luftë së bashku me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Nuk luftoja se isha musliman dhe se e kisha pranuar Profetin, por sepse nuk e duroja dot që fisi Hevazin mblidhte ushtarë për kurejshët dhe kishte hapur luftë. Gjatë betejës, kur ndodhesha pranë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i thashë:

“Unë po shoh kuaj të larmë!”

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) më tha:

“*Shejbe! Këta kuaj që kanë ardhur në ndihmë të muslimanëve vetëm qafirët mund t’i shohin!*” Pastaj duke më rënë kurrizit, u lut:

“O Zot! Drejtoje Shejben!”

Këtë gjë e përsëriti tri herë. Radhën e tretë, kur e hoqi dorën, mbi tokë s’kishte për mua njeri më të dashur se ai!” (Ibni Kethir, *el-Bidaje*, IV, 333)

Edhe nëna e raviut⁸² të njohur Ebu Hurejre, megjithëse i kishte hedhur poshtë propozimet e njëpasnjëshme të të birit për të besuar, më në fund, me begatinë e lutjes së Profetit, pati besuar.⁸³

Kjo efektshmëri e lutjes është në gradë të lartë edhe te trashëgimtarët e Profetit (s.a.s.). Dhe kjo është një mjet veprimi, domethënë, përmirësimi të begatshëm.

Në të gjitha kushtet, lutja krijon një përfundim. Po qe se kërkesa e lutjes është në kundërshtim me kaderin (paracaktimin) absolut prandaj mbetet pa rezultat, dhurata hyjnore si shpërblim shfaqet në ahiret. Edhe kjo specifike është e fiksuar në hadithet profetike.⁸⁴

Nga ana tjetër, që një lutje të krijojë një rezultat, nuk është kusht të dalë nga një personalitet i lartë e i mirë. Mjafton që lutja të bëhet me thjeshtësi dhe me dëshirë serioze. Në këto kushte, edhe lutja e një besimtari mëkatar, madje, ka një vlerë të madhe për vëllain besimtar. Sepse Zoti nuk heq dorë nga robi sado mëkatar të jetë ai! Po të ishte ndryshe, përfolja pas shpine kundër një mëkatarin nuk do të konsiderohej mëkat i madh!

Është për këtë shkak fakti që personat që kanë mëkate njerëzore, tërhiqen nga bërja e lutjeve për ummetin e Muhammedit dhe të afërmit e vet me mendimin se ç’mund të dalë nga lutja e tyre, nuk është një qëndrim i drejtë. Edhe lutja e njeriut më mëkatar për dikë tjetër, në qoftë se bëhet me

81 shih. Ibni Hisham, *es-Sire*, IV, 103.

82 Ravi: rrëfyes hadithi.

83 shih. Muslim, *Fedailu’s-sahabe*, 158.

84 shih. Ahmed b. Hanbel, *Musned*, III, 18.





thjeshtësi dhe si për vete, ka jashtëzakonisht mundësi të pranohet. Zoti e pranon lutjen e kujt të dojë!

Me këtë rast, do të ishte me dobi të flisnim pak edhe për specifikat e tjera të lutjes.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e ka këshilluar për çdo rast që besimtarët të lutën për njëri-tjetrin si në prani, ashtu dhe në mungesë të njëri-tjetrit. Ai i pati thënë kështu Hz. Omerit (r.anh.) që i pati kërkuar leje për umre:

“As ne mos na harro në lutjen tënde, o vëlla!” (Tirmidhi, *Deavat*, 109; Ebu Davud, *Vitr*, 23)

Përballë kësaj kërkesë komplimentuese, Hz. Omeri (r.anh.) e pati shprehur kështu gjendjen e vet emocionale:

“Aq u gëzova, sa m’u duk sikur të gjitha botët m’u bënë të miat!”

Pa dyshim, Profeti (s.a.s.) është, te Allahu, më i nderuari i krijesave! Megjithëkëtë, ai ka kërkuar nga sahabet, shokët e vet, të lutën për të! Kjo është aluzion për faktin që edhe personat me gradë të lartë shpirtërore mund të përfitojnë nga lutjet e personave që ndodhen më poshtë tyre në këtë pikëpamje.

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i ka thënë Hz. Omerit (r.anh.) kështu:

“Më i dobishmi i tabiinëve është dikush me emrin Uvejs. Po të betohet ai në Allahun, Allahu e nxjerr patjetër me të drejtë në atë betim. Kush prej jush të takohet me të, ai le të kërkojë falje për ju!”⁸⁵

Më pas, Hz. Omeri (r.anh.) qe takuar me Vejsel Karaniun dhe i pati kërkuar lutje.

Siç u pa, kërkimi i lutjes për largimin e ngatërresave dhe shqetësimeve dhe tërheqjen e mirësive nga personat e virtutshëm e të devotshëm, është porosi personalisht e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) për ummetin, bashkësinë e tij.





T i zër (gjithmonë) rrugën e faljes, urdhëro për të mirë... (el-A'raf, 199)



E. STILI MISTIK

1. Stili i orientimit dhe mëshirës

Prijësit e përkryer që e njohin shumë mirë rëndësinë e stilit mistik po aq sa edhe përmbajtjen e orientimit mistik, duke ndjekur edhe në këtë çështje një rrugë profetike, janë bërë pretekst për shumë orientime dhe gjetje të rrugës së drejtë. Ata e kanë bërë parim të vetin në edukimin mistik trajtimin me mëshirë dhe dhembshuri të nxënësve përse i përket përparimit të tyre, për rrjedhojë, kanë arritur rezultate të frytshme. Jeta e miqve të Allahut është e mbushur me shembuj të panumërt lidhur me këtë specifikë. Ky rrëfim për mistikun e madh Ibrahim Haki Erzurumin është shumë domethënëse.

Për të shkuar në një fshat të Erzurumit për predikime dhe këshilla gjatë muajit të ramazanit, Ibrahim Hakiut i ishin dhënë një kalë dhe një shoqërues jomusliman që i bënte këto punë kundrejt pagesës. Ata dolën në udhë. Por meqë kishin një kalë, Ibrahim Hakiu zbatoi moralin e lartë të Hz. Omerit (r.anh), kalifit, i cili, duke shkuar për në Jeruzalem, e kishte përdorur devenë me radhë me skllavin që e shoqëronte.

Shoqëruesi jomusliman e kundërshtoi Ibrahim Hakiun:

“Po ta marrin vesh fshatarët, më shajnë dhe s’më paguajnë!”

Por, me gjithë këmbënguljen e shoqëruesit, Ibrahim Hakiu qëndroi në të vetën dhe i tha kështu shoqëruesit:

“O bir, s’dihet se si do ta kemi hallin në frymën e fundit! Ti druhash nga sharjet e fshatarëve, kurse unë frikësohem nga llogaria e madhe që kemi për të dhënë para Allahut!”

Dhe vuri radhë për t’i hipur kalit.

E deshi urtësia hyjnore që, mu kur do të futeshin në fshat, ashtu siç pati ndodhur me Hz. Omerin, radha për të hipur në kalë i erdhi shoqëruesit. Duke pasur frikë nga fshatarët, ai iu lut Ibrahim Hakiut të vazhdonte të qëndronte mbi kalë, por ai s’pranoi duke i thënë se radha ishte e tija, e detyroi t’i hipte kalit ndërsa vetë u vu të printe dhe ashtu u futën në fshat.





Kur e panë fshatarët këtë pamje, e rrethuan shoqëruesin dhe filluan ta gortonin dhe shanin. Ata pushuan vetëm pasi Ibrahim Hakiu ua shpjegoi se si qëndronte puna. Atëherë njëri nga fshatarët e ftoi shoqëruesin të bëhej musliman:

“O njeri! Pe dhe jetove një virtyt kaq të lartë! Bëhu musliman!”

Pasi heshti pak, shoqëruesi u tha të pranishmëve këto fjalë me kuptim të madh:

“Po të më ftoni në fenë tuaj, kurrë! Por po të më ftoni në fenë e këtij njeriu të bekuar, në atë fe kam hyrë qysh gjatë rrugës!”

Ky shembull i shpalosur nga një mik zemre i Allahut, vë në shesh një stil ose mënyrë sjelljeje mëshire dhe orientimi. Të sillesh ndaj njeriut duke parë më shumë te thelbi i tij, do të thotë, në një kuptim, të mund ta shohësh krijesën me syrin e Krijuesit. Prandaj, zemrat e paqta (salih) janë të vetëdijshëm se njeriut i është dhuruar nderi për të qenë zëvendësi i Zotit mbi tokë dhe se, siç thotë ajeti kur’anor për njeriun, **“Zoti i ka fryrë nga shpirti i vet** (nga fuqia e vet një të fshehtë)”⁸⁶. Pavarësisht se me sa mëkate mund të jetë fëlliqur robi, ata, duke parë nga përsosmëria e thelbit të tij, nuk ia kthejnë shpinën. Ata nuk e presin lehtë shpresën nga njeriu, veç kësaj, e bëjnë edhe atë që të mos e presë shpresën. Ky me të vërtetë është një shkak i pamohueshëm racional dhe ndjesor. Me të vërtetë, Zoti, në Kur’an na ka sugjeruar neve më shumë emrat **Rahman** dhe **Rahim**, madje, duke zbritur një sure që bart emrin e nderuar “Rahman” që do të thotë mëshirë që përfshin të gjitha krijesat, e ka filluar ajetin e parë të saj me fjalën “er-Rahman”, “Mëshiruesi i Përgjithshëm”.

Nga ky këndvështrim, ta shohësh njeriun nga kjo dritare zemre, domethënë, ta trajtosh nga pikëvështrimi i stilit të orientimit dhe mëshirës, është më në përshtatje me pëlqimin hyjnor, jashtëzakonisht frytdhënës nga rezultati dhe blerues i bukurive të larta të fshehura te njeriu. Sepse ky stil ka për veti të jetë përftues edhe për atë që e përdor, edhe për objektin ndaj të cilin përdoret, pra, për të dy anët, i një delikatese, pjekurie dhe dashurie të veçantë, dhe i cilësive të interesimit për Zotin. Ky stil është një eliksir që i ka bërë Junusët Junusë dhe Mevlanatë Mevlana, si dhe një ujë jetëdhënës për shumë shpirtra të sëmurë të vdekur kuptimisht.

Prandaj, përdorimi i stilit mistik si në përmbajtjen e tij, ashtu dhe në kumtimin e Islamit, gjithmonë ka paraqitur një rëndësi të madhe. Është një e vërtetë historike që mistikët e mëdhenj si Mevlana dhe Junus Emre të përgatitur në periudhën kur rregulli shoqëror i Anadollit ishte tronditur nga pushtimet mongole, u bënë pothuaj burime paqeje, qetësie dhe prehjeje dhe u ofruan shërim dhe ngushëllim masave popullore në krizë, plagëve





që rridhnin gjak dhe zemrave të lodhura. Ata i kanë konsideruar shumë e shumë indiferentë e të shkujdesur si të sëmurë që presin shpëtim dhe në trajtimin që u kanë bërë të tjerëve, kanë qenë vazhdimisht larg urrejtjes dhe armiqësisë. Sa bukur thotë Junus Emre:

*Unë s'erdha për dava,
Puna ime është të dua;
Shtëpia e mikut janë zemrat,
Të fitoj zemra erdha!*

Ngaqë këto personalitete të mëdhenj erdhën për të bërë dhe fituar zemra, i panë njerëzit gjithmonë nga dritarja e zemrës dhe, duke përhapur gjithmonë përreth dashuri dhe dhembshuri, u bënë pretekst për orientimin dhe hyrjen në rrugë të drejtë të sa e sa njerëzve! Po që se ata do të vepronin në të kundërt të këtyre sjelljeve të bukura dhe të zgjuara, si përfundim, lidhja me njerëzit mes të cilët kishin në mes gremina, do të këputej plotësisht dhe, më në fund, mundësia për t'ua kumtuar të Vërtetën njerëzve të tillë, do të humbiste. Dhe kjo do të binte në kundërshtim me qëllimin dhe synimin hyjnor, sepse Zoti kërkon shpëtimin e robve të vet nga baltovina ku kanë rënë. Prandaj ka dërguar mijra profetë gjatë gjithë historisë njerëzore duke i urdhëruar ata për t'i pastruar zemrat me mënyrën më të mirë të sjelljes dhe trajtimit. Edhe të urtët (ehlullah) si favore për njerëzit për të njëjtin qëllim, këtë stil profetik kanë vazhduar të përdorin në edukimin e tyre moralo-shpirtëror.

Zoti ynë i Lartë që është burimi i vetëm i dhembshurisë dhe mëshirës, e shpreh kështu stilin e efektshëm që duhet ndjekur për ftesën në fenë e vërtetë:

“(O i Dërguar!) Ftoji njerëzit në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe (kur të jetë e nevojshme) polemizo me ta me një mënyrë të bukur!..” (en-Nahl, 125)

“Kush mund të jetë më fjalëbukur se ai që, duke bërë punë të mira dhe duke thënë se është nga ata që i janë dorëzuar Allahut, i fton njerëzit të Allahut? E mira dhe e keqja nuk mund të jenë njëlloj! Ti përpiqu ta parandalosh të keqen në mënyrën më të mirë dhe atëherë do të shohësh se personi që ka armiqësi ndaj teje, sikur të është bërë aty për aty një mik për zemër!” (el-Fussilet, 33-34)

Si rezultat i praktikimit të këtij stili hyjnor që këshillohet, gjatë historisë, sa e sa shpirta të veshur me gjemba janë kthyer në trëndafilat dhe gjokse si burgje janë mbushur me dritë!

Duke u nisur nga kjo e vërtetë, Hz. Mevlana (k.s.) e sugjeron kështu rëndësinë e orientimit në rrugë të drejtë si të njerëzve pa besim, si të njerëzve mëkatarë dhe stilin e duhur për këtë:





“Megjithëse hekuri është i zi dhe pa bukuri, kur të fshihet dhe shkëlqehet, pastrohet nga ndryshku. Edhe sikur pasqyra të jetë prej hekuri, po të shkëlqehet, i ndriçon fytyra dhe zbukurohet dhe në të duken format dhe trajtat!”

Mos e turbullo ujin e qytetit të zemrës që të shohësh në të se si shëtisin hëna dhe yjet! Sepse njerëzit i ngjajnë ujit të lumit: po të turbullohet, në të nuk mund të shohësh asgjë!”



Siç thotë Hz. Mevlana, shpirti i njeriut është si një ujë i kthjellët. Por kur turbullohet me punë të këqija dhe mëkate, në të nuk mund të shihet asgjë. Në këto kushte, ky ujë duhet pastruar dhe kthjelluar në mënyrë që të mund të shihen margaritarët moralo-shpirtërore dhe dritërat e të vërtetës. Prandaj, qëllimi final i tasavvufit është t'i edukojë ndjenjat egoistike dhe sensuale dhe, si përfundim, t'i bëjë individët, për rrjedhojë, shoqëritë, të arrijnë paqen, qetësinë dhe kënaqësinë. Sepse Zoti e ka stolitur njeriun me delikatesë, hijeshi dhe cilësi të tjera të larta. Edhe vlera e vërtetë e njeriut është në raport të drejtë me sa i shtreson në zemër dhe pastaj i zhvillon njeriu këto vlera. Zemrat plot vlera moralo-shpirtërore janë të afta për të kryer punë të mira dhe për të ndërjerë shfaqjet e situatave moralo-shpirtërore. Kështu, robi realizon domosdoshmërinë e krijimit të tij në trajtën më të bukur, domethënë, si “ahseni takvim” (krijesë e bukur).

Prandaj, sado larg të ketë shkuar robi në mohim, herezi dhe mëkat, asnjë njeri nuk mund të privohet nga e drejta për të qenë bashkëbisedues i ftesës së rrugës së drejtë. Njëri prej shembujve të panumërt të kësaj në shekullin e lumtur është ky:

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) dërgoi njërin prej sahabeve për ta ftuar në Islam Vahshiu, atë që ia kishte vararë të unguin Hamza duke i shkaktuar një dëshpërim të thellë. Vahshiu i çoi fjalë:

“O Muhammed! Kur ti ke deklaruar urdhrin e Allahut që thotë se **“Kush bën vrasje ose i bën shok Allahut ose bën zina, në ditën e kiametit do të ndëshkohet dy herë dhe do të mbetet përjetësisht në xhehennem i përbuzur e i poshtëruar!”** (el-Furkan, 68-69), si mund të më ftosh mua në Islam? Unë i kam kryer të gjitha këto punë të shëmtuara! Si mund të ketë rrugë shpëtimi për mua?

Mbi këtë ngjarje, Allahu zbriti ajetin:

قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ اللَّهِ
إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ





“Thuaju: “O robtë e mi që e keni tepruar në padrejtësinë kundër vetes suaj! Mos e prisni shpresën nga mëshira e Allahut, sepse Allahu i fal të gjitha mëkatet! Pa dyshim, ai është Gafur dhe Rahim!”⁸⁷ (ez-Zumer, 53)

Më në fund, me lajmin e mirë të ajetit, Vahshiu u lehtësua dhe, duke bërë pendesë të thellë e duke u shprehur si më poshtë, u bë musliman bashkë me shokët:

“Sa të madhe e ke mëshirën, Zoti im!”

Vahshiu që e kishte vrarë Hz. Hamzain në Uhud, tashmë ishte Hz. Vahshi (r.anh)! Dhe, mes kënaqësisë së thellë të këtij orientimi dhe ndjese, me shpresën për t’i siguruar vetes faljen dhe si dëmshpërblim për Hamzain, e vrau mëtuesin për profet, Musejlemetu’l-Kedhdhab duke marrë parasysh të gjitha rreziqet dhe, kështu, i dha fund një intrige.

Sahabet që ndodheshin pranë Profetit (s.a.s.), e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Kjo mëshirë dhe falje a është e veçantë për Vahshiun, apo i përfshin të gjithë muslimanët?”

Dhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u tha:

“I përfshin të gjithë muslimanët!”⁸⁸

Zemrat e drejtuara te pendesa e thellë, ashtu siç u pa edhe në këtë hadith profetik, tingujt më prekës të mëshirës dhe dashurisë në kuptimin e vërtetë të fjalës nga Profeti (s.a.s.) i kanë dëgjuar. Shkurt, e gjithë bota njerëzore, nga buzët e tij të bekuara i ka dëgjuar meloditë që japin ngushëllim, shërim dhe lehtësim. Detin e paanë e të pafund të faljes dhe bujarisë dhe bregun e tij të shpresës gjithashtu me bujarinë e “Dritës së Ekzistencës” i ka parë. Pavarësisht nga të gjitha mëkatet, ka merituar thirrjen hyjnore të dhembshur **“O robtë e mi!”** gjithashtu për respekt të dritës së syve të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.)!

Prandaj, sugjerimi me një stil shpresëdhënës duke e nxjerrë në plan të parë mëshirën dhe dhembshurinë e Allahut, ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe edhe për shoqërinë tonë të përfshirë nga një turbullirë moralo-shpirtërore të ngjashme me atë të perëndimit nën ndikimet negative materialiste. Jo t’i zvarrësish njerëzit në grindjet ideore, por t’i fitosh në ndjenja, është një rrugë më realiste. Shumë njerëz mund të kenë fiksime ose kufizime të gabuara ideore, prandaj, bindja dhe fitimi i tyre me anë të polemikës dialektike përgjithësisht janë të pamundura, sepse fiksime dhe kufizime negative i bëhen pengesë pranimit të argumenteve racionale. Që zemrat të afrohen dhe pajtohen me të vërtetën, para së gjithash duhet bërë një trajtim me mirëkuptim, pastaj përpjekje për ringjalljen e prirejeve të larta të brend-

87 Gafur: falës, dhënës i amnistisë. Rahim: mëshirues, shpërblyes.

88 shih. Hejthemi, *Mexhmau’z-Zevaid*, X, 214-215.





shme, gjë që do të ishte një metodë me shumë efekt.



Para se të kritikohet njeriu i zhytur në gabime, kundërshtime ndaj Zotit dhe mëkate, para se të bëhet me turp dhe para se t'i kërkohet që t'i zbatojë urdhrat fetare, duhet t'i fitohet zemra dhe kësaj i duhet dhënë përparësi. Prandaj duhen bërë përpjekje për ngritjen e një lidhjeje të afërt që do të formonte bazën ndikuese të afërsisë dhe sugjerimit personal. Pasi zemra e bashkëbiseduesit të përgatitet në këtë mënyrë, gabimet mund të rregullohen dalngadalë. Veç kësaj, duhet mbajtur parasysh fryti i begatë i lidhjes shpirtërore që do të zgjonin te bashkëbiseduesi dhurimet dhe konsideratat materiale e moralo-shpirtërore. Në këtë specifikë duhet rrokur kuptimi i hollë i shprehjes së hadithit në vijim, ku Profeti (s.a.s.), sikur t'u hapte një dritare qiellore zemrave të mbytura me tymërat e mëkatit, thotë në formën e një dhurate që ofron frymëmarrje të freskëta:

"Shefaati im është posaçërisht për ata nga ummeti im, të cilët kanë kryer mëkate të mëdha!" (Ebu Davud, *Sunnet*, 20)

Sa bukur e shpreh poeti Mevlana këtë qëndrim dhe shprehje të të Dërguarit të Allahut kundrejt mëkatarëve:

"Ilaçi kërkon njerëz të sëmurë e të plagosur që t'i shërojnë. Ku të ketë një vuajtje, atje shkon shpëtimi. Uji rrjedh për në vendet e ulëta dhe gropa."

"Po t'u desh ty uji i mëshirës dhe dhembshurisë, edhe ti kështu bëj!"

Por që ilaçi dhe melhemi të veprojnë, më parë duhet pastruar plaga prej mikrobeve. Kjo do të thotë që zemrat e sëmura të pastrohen nga mikrobi i mëkatit, domethënë, të lahen me ujin e pendesës. Pas kësaj vepron ilaçi, domethënë, shefaati.

Me të vërtetë, deklarata si më poshtë e një hadithi tjetër profetik është një shfaqje mëshire me cilësinë që shpreh, nga njëra anë, lajm të mirë dhe, nga tjetra anë, kushtin e këtij lajmi të mirë:

"Kush bën pendesë për mëkatet e veta, bëhet sikur të mos kishte kryer fare mëkate!" (Ibni Maxhe, *Zuhd*, 30)

Ashtu siç e kanë respektuar të gjithë profetët kuptimin e hollë e të lartë të stilit të orientimit dhe mëshirës në kuadrin e këtij kriteri, ashtu e kanë respektuar me ndjeshmëri edhe evlijatë (të urtët, prijësit shpirtërorë) që ecin në gjurmët e tyre. Duke u mbështetur mbi këtë, mëshira është konsideruar fryti i parë i besimit dhe detyra e robit si dhe adhurimi ndaj Zotit janë përkufizuar shkurt në kuadrin e këtyre dy kriterëve:

"Ta'dhim li emrillah" – pranim me madhërim i urdhrave të Allahut, zbatim i tyre me respekt.

"Shefkat li halkillah" – dhembshuri dhe mëshirë për krijesat e





Allahut.

Gjendja e Fudajl bin Ijadhrit, një ndër miqtë e Allahut, është shembull i bukur për zemrën e besimtarit që jeton me këto kritere:

E panë Fudajl bin Ijadhin duke qarë. Dhe e pyetën:

“Pse po qan?”

Ai u përgjigj:

“Qaj se më erdhi keq për një musliman të shkretë që më bëri padrejtësi! Gjithë hallin e kam se mos turpërohet në kiamet!”

Sikur të donte të shpjegonte specifikën që i shtyn këta njerëz të përkryer të shfaqin një mëshirë dhe dhembshuri të tillë, poeti Mevlana shprehet kështu:

“Kur marrin vrull detet e mëshirës, edhe gurët pijnë ujë jetësor dhe ngjallen, i vdekuri njëqindvjeçar ngrihet nga varri, kurse fytyrat shpirtzeza bëhen engjëj të bukur që t’i kenë zili edhe hyritë!”

Siç rrëfëhet, Ibrahim bin Et’hemi ia ka larë gojën erëndyrë një të dehuri dhe, prandaj, e kanë pyetur se pse e ka bërë atë gjë, kurse ai u është përgjigjur:

“Po qe se gojën dhe gjuhën të krijuara për ta përmendur emrin e Allahut të lartë, i lë të mbeten të ndyra si enët e palara, kjo do të ishte mungesë respekti...”

Kur i dehuri u përmend dhe i thanë se Ibrahim bin Et’hemi, adhuruesi i madh prej Horasani, ia kishte larë gojën, të dehurit u zgjua edhe zemra dhe tha:

“Në qoftë kështu, edhe unë po bëj pendesë!”

Atëherë, Ibrahim bin Et’hemit, i cili u bë pretekst për një ndryshim të tillë, iu njoftua kështu nga lartësia hyjnore:

“Ti ia lave gojën atij për Ne! Edhe Ne, për ty, ia lamë zemrën atij!”



Në Kur’an, Zoti i drejtohet kështu Profetit (s.a.s.) dhe, në personin e tij, tërë ummetit, bashkësisë së muslimanëve:

Ti zër (gjithmonë) rrugën e faljes, urdhëro për të mirë...” (el-A’raf, 199)

Pa dyshim, në çështjen e zbatimit të këtij urdhri, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) është shembulli më i bukur e më i përkryer për ne. Shfaqjet e moralit të bukur, mëshirës dhe faljes të shpalosura prej tij janë të një lartësie të parritshme që do t’i bënte ziliqarë edhe engjëjt. Ja njëri prej tyre:

Ditën e triumfit të Mekës, i Dërguari i Allahut shpalli një falje dhe garanci të përgjithshme. Meka e cila prej vitesh nuk po bëhej dëshmitare e asgjëje tjetër veç padrejtësisë, dhunës dhe armiqësisë, atë ditë, me festën e faljes së përgjithshme përjetonte shfaqjet e një mëshire dhe dashurie të papërshekruar. Ndërkaq një person nga mekasit, i quajtur Fudale, si të de-





shte të lëshonte hije mbi këtë bukuri, iu afruar Profetit (s.a.s.) me qëllim për ta vrarë. Por Profeti (s.a.s.) i cili e kishte kuptuar qëllimin e tij, i foli Fudales me mëshirë dhe dhembshuri pa shfaqur asnjë lloj shqetësimi apo nervozizmi:

“A ti je Fudale?”

“Po, - i tha ai, - unë jam Fudale!”

Atëherë, Profeti i dërguar si mëshirë për të gjithë botët, mbështeti duart e bekuara në gjoksin e Fudales dhe i tha:

“O Fudale! Pendohu për mendimin e sajuar në mendje dhe bëj pendesë!”

Kështu, zemra e Fudales i cili pak më parë bluante në mendje si ta vriste të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), u mbush me dritën e besimit dhe brenda një çasti, i Dërguari i Allahut u bë njeriu më i dashur për të!⁸⁹

Pa asnjë dyshim, kjo situatë është një pjekuri dhe formë sjelljeje shumë e lartë e shprehur në formën **“kush vjen për të të vrarë ty, të ringjallet tek ti”**, me shembujt e së cilës historia islame është e mbushur plot. Me të vërtetë, në radhë të parë Hz. Omeri dhe, pastaj, shumë e shumë të tjerë janë bërë fryte të çmuar të këtij stili të bukur. Hz. Mevlana thotë:

“Si rezultat i përsosmërisë së mëshirës së Allahut dhe i dallgëzimit të detit të bujarisë, në cdo vend të thatë reshon shi, çdo vend i paujë bëhet me ujë!”

“O ti që fton për në rrugën e drejtë! Ta dish se ilaçi i syrit të keq është syri i mirë. Syri i mirë dhe shikimi i bukur e vë nën këmbë syrin e keq. Syri i mirë dhe vështrimi i pastër janë si pasojë e epërsisë së mëshirës së Allahut ndaj persekutimit të Tij, janë si pasojë e mëshirës së tij. Kurse syri i keq ojen nga persekutimi i Tij, domethënë, nga mallkimi. Prandaj, meqë vështrimi i bukur është prej mëshirës së Zotit, del fituese mbi syrin e keq. Kjo gjendje është shfaqje e deklaratës së hadithit profetik ku thuhet: “Mëshira ime e tejkalon ndëshkimin tim!” (Buhari, Tevhid, 55) Dhe ta dish se mëshira e Allahut është gjithmonë mbi persekutimin e tij. Prandaj, çdo profet ka dalë fitues dhe epror ndaj armiqve që e kanë sulmuar!”

“Atëherë, zgjidhja e belasë nuk është qortimi, padrejtësia, por falja, bujaria dhe zemërmadhësia! Le të të zgjojë ty vërejtja profetike⁹⁰ se “sadaqatë e largojnë belanë”! Tashmë kuptoje mirë metodën e mjekimit të sëmundjeve dhe belave!”

“Por mos e harro edhe këtë se falja e të padrejtëve dhe mizorëve është padrejtësi dhe mizori ndaj të dëmtuarve dhe viktimave. Dhembshuria ndaj vjedhësve dhe njerëzve të këqinj të të çdo lloji është rrahje ndaj njerëzve të dobët, mungesë mëshire ndaj tyre!”

Ky ekuilibër duhet rregulluar mirë. Sepse Allahu është jo vetëm Gafur (falës) dhe Rahim (bamirës), por edhe Azizun Dhuntikam (hakmarrës i shenjtë).

Prandaj, në një hadith, Profeti (s.a.s.) ka thënë:

89 Ibn Hisham, *es-Sire*, IV, 46; Ibn Kethir, *es-Sire*, III, 583.

90 Shih. Tirmidhi, *Zekat*, 28; Suyuti, *Xhamiu's-Sagir*, I, 108.





"Kur të shihni se po grinden dy vëllezërit tuaj, ndihmojini edhe dhunuesit, edhe viktimës!"

Sahabet e kanë pyetur:

"O i Dërguari i Allahut! Për viktimën e kuptuam. Po dhunuesit, si do t'i ndihmojmë?"

Profeti u është përgjigjur:

"Duke e penguar dhunën e tij!" (Buhari, *Ikrah*, 7; Muslim, *Birr*, 62)

Shkurt, ajo që deshëm të themi, është se sot, bashkë me të gjithë botën, edhe njerëzit e vendit tonë janë si zogj të plagosur për sa i përket besimit dhe Islamit. Është e domosdoshme që atyre t'u lidhen plagët me kujdes dhe vëmendje, për këtë, ata duhen trajtuar me mëshirë dhe dashuri. Dhe kjo, është diçka që do të realizohet nëpërmjet përmbajtjes dhe stilit që u përpoqëm t'i shpjegojmë qysh në krye.





Mirëkuptimi ndaj mëkatarit nuk duhet bartur te mëkati dhe armiqësia ndaj mëkatit nuk duhet hedhur edhe te mëkatarin. Besimtari me një vetëdije të tillë, në kumtim dhe orientim duhet të përdorë stilin “qortimin ndaj vetes, mirëkuptimin ndaj tjetrit!”



2. STILI I BUTESISE DHE DHEMBSHURISE

Vështrimi i njeriut me sy mistik kërkon, më shumë se sa vlerësimin e gjendjes së tij të fëlliqur me mëkate, konsideratën dhe nderimin për thelbin e tij. Ja, ky është kuptimi i thellë i stilit mistik, mirëkuptim jo ndaj mëkatit, por ndaj mëkatarit duke e rrethuar atë me mëshirë. Mistiku i vërtetë e konsideron njeriun mëkatar si një zog krahëthyer, si një qenie nevojtare për interesim dhe dhembshuri. Ai e ndjen me gjithë zemër se sa e domosdoshme është të qetësohet shpirti i trazuar i mëkatarit, të arrijë përsëri shëndetin dhe prehjen e duhur. Sepse dhembshuria dhe mirëkuptimi që do të tregohen ndaj krijesës për hir të Krijuesit, janë faktori më i efektshëm që i bën besimtarët të përkryer e të virtytshëm.

Siç rrëfëhet, Ebu Derda nga sahabet shërbente si kadi në Damask. Një ditë dëgjoi se njerëzit e kishin sharë një mëkatar dhe i pyeti:

“Po të shihni se një njeri ka rënë në një pus, çfarë bëni?”

“I hedhim një litar dhe përpiqemi ta nxjerrim jashtë!” – I thanë.

Atëherë, Ebu Derdaja i pyeti:

“Nëse është kështu, pse nuk mendoni t’i hidhni një litar njeriut që ka rënë në pusin e mëkateve për ta shpëtuar prej atje?”

Njerëzit e pyetën të habitur Ebu Derdanë:

“A s’ndjen armiqësi ti ndaj këtij mëkatarin?”

Ebu Derda u dha këtë përgjigje të urtë:

“Unë jam armik jo i tij dhe i personit të tij, por i mëkatit të tij!”

Në këtë shembull ka shumë kuptime të thella dhe urtësi që Ebu Derda ka dashur të shtresojë në zemrat e besimtarëve. Këto urtësi janë shkëndija të larta nga morali i lartë i Profetit (s.a.s.) të reflektuara me urdhrin dhe





pëlqimin e Zotit te ummeti, bashkësia e tij, të cilat gjatë historisë islame janë konsideruar gjithmonë pretekste për gëzimin dhe dritën e orientimit si parime pjekurie dhe, duke hedhur rrënjë në dheun e aktit të mirë (ameli salih), janë shndërruar në stil.

Ky stil është përpjekja që, duke mos e lënë mëkatarin të mbytet në mëkatin e tij, të pastrohet ai në detin e pendesës në klimën e mirëkuptimit, faljes, mëshirës dhe dashurisë. Profeti (s.a.s.) e ka trajtuar me një delikatesë të tillë edhe më azganin e politeistëve, si Ebu Xhehli, madje; ai nuk është marrë me mëkatet dhe ndyrësitë e bashkëbiseduesit, por vetëm e ka ftuar atë për t'u pastruar krejtësisht në detin e shpëtimit dhe lumturisë së besimit. Me të vërtetë, fakti që Zoti ia fshin mëkatet e kaluara personit që kapet pas pendesës dhe besimit, që e trajton atë sikur të mos kishte bërë fare mëkat, për më tepër, që ia kalon të gjitha mëkatet në librin e sevapeve (mirësive) në raport me sinqeritetin e tij, është për ne një pishtar i madh urtësie që na tregon neve rrugë në këtë drejtim. Në ajetin kur'anor thuhet:

"... përveç atyre që heqin dorë (nga të këqijat), besojnë dhe bëjnë punë të mira. Allahu ua kthen atyre të këqijat në të mira (mëkatet në sevape). Allahu është falës dhe mëshirues i madh!" (el-Furkan, 70)

Ata që nuk munden të marrin pjesë nga kjo mëshirë e lartë, janë armiq edhe të vetes, edhe të njerëzimit. Njerëz të tillë indiferentë e që s'marrin vesh, të cilët s'e dinë ç'është mëshira e dhembshuria, janë mjeranë që ia zënë vetes rrugët e përfitimeve të përjetshme. Kurse miqtë e Zotit, si Mevlanatë dhe Junusët të cilët kanë mundur të arrijnë në burimin e mëshirës, si miq edhe të njerëzve, janë trëndafila parajse, fytyrëqeshur tërë dritë, duhen nga tërë gjithësia, nga ujku e nga zogu! Ata i shpërndajnë botës bukurin edhe nga gjembat dhe i mjekojnë zemrat e plagosura. Ja, kjo është e rëndësishme: të mund të bëhesh me natyrë trëndafilore, domethënë, jo t'i shohësh gjembat në kopshtin e kësaj bote, të shpohësh nga ta e të bëhesh gjemb, por, sikur në mes të futen edhe vështirësi si dimri, t'i rrethosh gjembat me klimë pranvere e të bëhesh një trëndafil për tërë botën! Sa bukur e thotë Mevlanai:

"Pse nuk pati frikë nga nata, pse nuk iku nga errësitat, Hëna u mbush me dritë e nisi të lëshojë dritë. Edhe trëndafili e fitoi atë aromë të këndshme sepse kaloi mirë me gjembin!"

"Dëgjoje këtë të vërtetë edhe nga trëndafili. Shih ç'thotë ai: "Pse të mërzitem e pse ta lëshoj veten në dëshpërim që ndodhem bashkë me gjembin unë që fitova aftësinë për të qeshur pse pranova të rri bashkë me atë gjembin e mbrapshtë, unë që, në sajë të tij, fitova mundësinë për t'i shpërndarë gjithësisë bukurin dhe aromën të këndshme?"





Hz. Eshrefogllu Rumi e përkufizon kështu në mënyrë lakonike në një dyvargshin e vet stilin e domosdoshëm për të arritur në këtë gjendje:

*Për atë mik, helmet
Duhet qëlltitur si sheqer!..*



Njëri nga sahabet, pasi ishte mërzhitur së ndëshkuari pa sukses një pijanec, e kishte mallkuar atë. I Dërguari i Allahut që e kishte dëgjuar këtë, kishte thënë:

“Mos e mallkoni atë! Betohe në Allahun se, nëse di një gjë për atë njeri, kjo është se ai i do Allahun dhe të dërguarin e Tij!” (Buhari, *Hudud*, 5)

Një nxënës i të ndjerit Ramazanogllu Mahmud Sami (k.s.), pasi kalon një krizë shpirtërore, troket i dehur në portë të mësuesit. Personi që hap portën, pasi e sheh nxënësin në atë gjendje, e pret keq duke i thënë ashpër:

“Ç’është kjo? A e ke të qartë se në ç’portë ke ardhur?”

I rrënuar shpirtërisht e i pashpresë, nxënësi i përgjigjet:

“A mos kam ndonjë portë tjetër që të më pranojë me mëshirë?”

Duke e dëgjuar nga brenda se ç’po ndodh, Sami Efendiu del menjëherë te porta dhe e merr brenda atë njeri zemërthyer dhe ia ringjall me mëshirë, dhembshuri dhe dashuri zemrën e kthyer në gërmadhë. Edhe personi i cili e gjen rrugën e drejtë me anë të këtij stili delikat, shpëton nga të gjitha gjendjet e këqija dhe, me kohë, futet në grupin e njerëzve të mirë!

Morali i lartë i “vështrimit me dhembshuri të krijesave me shikimin e Krijuesit” që vëzhgohet te miqtë e Zotit, shprehet bukur në këtë hadith me karakter universal të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

“Betohe në Allahun që ka në dorë frymën time, se, gjersa të mos kini mëshirë për njëri-tjetrin, nuk mund të hyni në xhennet!”

Sahabet i thanë:

“O i Dërguari i Allahut, ne të gjithë jemi të mëshirshëm!”

Atëherë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u tha kështu:

“Mëshira (për të cilën e pata fjalën unë), nuk është, siç e kuptoni ju, vetëm mëshira për njëri-tjetrin, përkundrazi, është mëshira që i përfshin të gjitha krijesat, po, mëshira për të gjitha krijesat!” (Hakim, *Mustedrek*, IV, 185)

Sado që të mbetet larg nga qëllimi bazë i tij, njeriu me dinjitetin si “njeri” është përsëri zotëruesi i një nderi të lartë. Rënia e tij në baltovinën e mëkatit duke mos ditur gjë për vlerat sublime të margaritarit në thelbin e vet, i ngjan rënies së Gurit të Zi nga muri i Qabes përtokë, pluhurosjes dhe fëlliqjes së tij. Ndërkaq, nuk mund të përfytyrohet asnjë ndërgjegje besimtare që të mbetet indiferent ndaj kësaj gjendjeje e të mos shpërthejë! Edhe





ashtu, i rrëzuar përtokë e i pluhurosur, Guri i Zi vazhdon të respektohet nga njerëzit. Ata e rrëmbejnë atë siç është, me gjithë pluhurat, e pastrojnë me lotët e syve dhe bëjnë garë me njëri-tjetrin për ta ngjitur në vendin e mëparshëm të nderuar. Ata mendojnë se ai ka dalë nga xhenneti dhe se në thelbin e tij ka vlera të larta. Mirëpo edhe njeriu, ashtu si Guri i Zi, ka dalë nga xhenneti. Sado të rrëzohet për shkak të mëkateve që ka kryer, vlera në thelbin e tij vazhdon të ekzistojë!

Nga ana tjetër, asnjë mjek i vërtetë s'nxehet me të sëmurin duke i thënë "pse u sëmurë"! Edhe sikur sëmundja të jetë shfaqur për shkak të vetë personit, ai e interpreton këtë si përfundim të lindur nga dobësia e buruar prej akteve ose mendimeve të tij. Kështu, në vend që të nxehet me të sëmurin për shkak të specifikave që kanë shkaktuar sëmurjen e tij, duke mbajtur parasysh dhimbjet dhe vuajtjet e të sëmurit, mjeku fillon menjëherë, pa humbur kohë, mjekimin e tij me një mëshirë dhe dhembshuri të madhe! Ai e ndjen veten përgjegjës për këtë mjekim. Ja, pra, edhe mistiku jeton me botën ndjesore të mjekut i cili shëtit dhomat e spitalit brenda shoqërisë. Dhe kjo botë ndjesore e bërë sunduese në sjellje është pothuaj si tapë shpëtimi për ata që janë shmangur nga udha!

T'i zgjasësh tjetrit një tapë shpëtimi si kjo dhe ta shpëtosh njeriun fetarisht mëkatar nga baltovina e mëkatit ku ka rënë, është një pretekst lumturie shumë të lartë. Të tërheq vëmendjen kjo vërejtje që ia pati bërë Profeti (s.a.s.) Hz. Aliut gjatë fushatës së Hajberit në fushën e luftës:

"O Ali! Orientimi i një njeriu nëpërmjet teje është më e dobishme për ty se zotërimi i deveve të kuqe që janë dhuntia më e çmuar e kësaj bote!" (Buhari, *Xhihad*, 143)

Kjo e vërtetë shprehet kështu në Kur'an:

وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ

"Kush e përmirëson atë (njeriun), është sikur t'i ketë përmirësuar të gjithë njerëzit..." (el-Maide, 32)

Kjo është çështje besimi (iman). Pa dyshim, mohimi (kufr) është gabimi më i rëndë në ndjenjat dhe mendimet njerëzore. Meqë mundësia e shpëtimit edhe prej kësaj është më e madhe me anë të një stili të butë, kur Zoti e dërgoi Hz. Musain (a.s.) te Faraoni për t'ia sugjeruar besimin, e urdhëroi t'i fliste me "kavl-i lejjin", me fjalë të butë. Sepse sukcesi në këtë rast i ftuesit, siç është shprehur edhe më lart, është një akt i mirë (ameli salih) që shërben si urë për tek fitimi më i madh. Allahu i Lartë jo se s'kishte dijëni mbi këmbënguljen e fuqishme të Faraonit në mohim! Prandaj, edhe sikur bashkëbiseduesi të jetë po aq i rëndë dhe këmbëngulës sa Faraoni në mohim (kufr), stili ynë i sugjerimit nuk duhet të jetë në trajtën e acarimit të





ndjenjave, si fyerja dhe kërcënimi, por në kuadrin e porosisë hyjnore që e orienton fjalën kah serioziteti. Sa bukur shprehet poeti Mevlana:

“Kuptoje mirë fjalën e Allahut: “O Musa! Thuaj fjalë të buta para Faraonit, trego butësi ndaj tij!”

“Sepse po i hodhe ujë vajit që zjen, edhe oxhakun e shkatërron, edhe tenxherenë!..”

Këtë të vërtetë e shpreh edhe ky ajet të cilin Zoti ia drejton gjithë ummetit në personin e Profetit (s.a.s.):

وَلَيْنَ مَتَّمُ أَوْ قُتِلْتُمْ لِإِلَى اللَّهِ تُحْشَرُونَ فِيمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لَئِن تَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ
فَطَّاءٌ غَلِيظَ الْقَلْبِ لَأَنْفَضُوهُم مِّنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ

“(O i Dërguar!) Atëherë, si mëshirë prej Allahut, u solle mirë me ta! Po të tregoheshe zemërgur e i ashpër, pa dyshim që do të largoheshin prej teje e do të zhperndareshin! Prandaj fali ata dhe lutu për falje për ta!..” (Al-i Imran, 159)

Ky stil nuk është i nevojshëm vetëm për mëkatarët dhe mohuesit (qafirët); ndoshta është i nevojshëm edhe ndaj disa dobësive dhe të metave që mund të duken si domosdoshmëri njerëzore edhe te njerëzit që e jetojnë Islamin në pikat më të larta! Stili i ashpër e i rëndë që do ta fyente dhe nëpërkëmbte bashkëbiseduesin ndërsa bëhen përpjekje për t’ia rregulluar të metat, mund të bëhet shkak për opozicion ndaj synimit dhe ndoshta për përfundime në drejtim krejt të kundërt. Sepse në vërejtjet dhe paralajmërimet e bëra me një stil të tillë, disa herë njerëzit tregohen jotolerues edhe ndaj prindërve, jo më ndaj të tjerëve! Edhe të vërtetat e thëna në kushte të tilla bëjnë në zemra efektin e një thike të dhëmbëzuar duke e humbur dobinë dhe tërheqjen. Poeti Mevlana thotë:

“Edhe yt atë, kur të qorton rëndë për ndonjë gabimin tënd, duket në sytë e tu agresiv dhe kafshues si lugat...”

“Kjo gjendje është efekti i një vuajtjeje të buruar prej sjelljes së ashpër të tij. Domethënë, qortimi i tyt eti, megjithëse është për të mirën tënde, për shkak të poshtërimit që të bën, ta tregon mëshirën dhe keqardhjen në zemrën e tyt eti si lugat...”

Ja, pra, kjo psikologji e njeriut nuk duhet të harrohet dhe sado që të jetë zhytur ai në mëkat, duhet vepruar me dijen se ai është një genie e çmuar. Është për këtë arsye që në porosinë e tij, Profeti (s.a.s.) thotë:

“Njeriut i mjafton si mëkat që ta nënvleftësojë vëllanë e vet musliman!” (Muslim, Birr, 32)

Fakti që Bezmialem Valide Sulltan, e cila e kishte rrokur urtësinë e këtij hadithi profetik, që të mos shtypet personaliteti i shërbëtorëve, ndërtoi





në Damask një vakëf si dëmshtëpërblim për orenditë e thyera e të dëmtuara prej tyre, na tregon neve një horizont të gjerë zemre!

Besimtari me këtë vetëdije duhet të përdorë si stil në kumtim dhe orientim “qortimin ndaj vetes, mirëkuptimin ndaj tjetrit”. Sepse Allahu i Lartë urdhëron:

“... Mos i hetoni të metat e njëri-tjetrit, askush të mos e përgojë tjetrin, sepse kujt i pëlqen të hajë mishin e vëllait të vdekur? Kjo ju shkakton neveri (apo jo)...?” (el-Huxhurat, 12)

Njerëzit idealë që munden të jetojnë në drejtim të këtyre porosive hyjnore, janë bërë heronj të mëdhenj morali dhe virtyti të cilët kurrë nuk e kanë menduar këtë botë të ndarë nga fronti i botës tjetër. Sa të thella e plot kuptim janë këto këshilla e porosi të bëra nga Sheh Edebali, kujdestari shpirtëror i Osman Gaziut, njërit prej sulltanëve që i ka dhënë drejtim historisë duke ecur në gjurmët e sulltanëve të mendimit, të bëra, pra, për të dhe, në personin e tij, të gjithë burrave të shtetit që do të vijnë, madje, duke filluar nga familja, për çdo administrator dhe qeveritar nga posti më i ulët gjer te posti më i lartë:

“O bir! Tashmë je bej! Pas kësaj, zemërimi na takon neve, kurse butësia, ty..., prekja na takon neve, kurse marrja me të mirë, ty..., fajësimi na takon neve, kurse pranimi, ty..., dobësia, gabimi na takojnë neve, kurse mirëkuptimi, ty..., mosmarrëveshjet, grindjet, mospajtimet na takojnë neve, kurse drejtësia, ty..., syri i keq, goja e hapur, vlerësimi i padrejtë na takojnë neve, kurse falja, ty...”

“O bir, pas sodi, ne do të përçahemi, kurse ti do të na bashkoh, ne do të përtojme, kurse ti do të na heqësh vërejtjen, do të na japësh zemër, do të na japësh formë...”

Këto porosi të pashoqe, edhe sikur të të prekin në ndonjë të metë personale, janë shfaqje të pashembullta të pasurisë ndjesore dhe virtytit të lartë në formën e faljes së njerëzve për hir të Allahut, e vështrimit të robve të Allahut me dhembshuri, mëshirë dhe dashuri.

Kështu, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), edhe sikur ta dinte se kush ishte fajtori mes një grupi njerëzish, për të mos e prekur atë, fliste në mënyrë të përgjithshme ose e hidhte qortimin mbi të gjithë grupin. Kurse disa herë, për ta bërë të kuptohet se nuk mundej ta pranonte se dikush ta kishte bërë një gabim të tillë, e fajësonte veten për paaftësi kuptimi të gjendjes:

“Ç’po më ndodh mua që po ju shoh juve kështu!” (Buhari, Menakib, 25; Muslim, Salat, 119)

Ja, ky është stili për të mos e turpëruar ose për të mos e ulur fajtorin, që është cilësi e përbashkët e atyre që e kuptojnë dhe e jetojnë drejt tasavvufin. Sepse rruga e Allahut kalon jo nga shembja e zemrave, por nga ndërtimi i zemrave. Sa bukur e ka thënë poeti Junus Emre:





*Zemra, froni i Zotit;
Zoti pa nga froni.
Fatkeqi i dy botëve
Ai që zemra shemb!*

Me të vërtetë, shumë vetë të qortuar rëndë dhe të poshtëruar për shkak të të metave të tyre, është mundur të rikthehen në klimën e mëshirës vetëm me begatinë e këtij stili dhe botëkuptimi.



Siç rrëfëhet, Xhunejd Bagdadi kishte një nxënës. Një ditë, e kishte zënë atë në flagrancë. I turpëruar shumë, nxënësi u largua dhe s'u kthye më në seli. Pasi kaloi një kohë, ky nxënës me zemrën të rrënuar ra në sy të Xhunejd Bagdatit që ishte duke kaluar nëpër treg së bashku me shokët e bisedës. Nxënësi e dalloi mësuesin dhe, nga turpi, u largua me vrap. Xhunejd Bagdadi (k.s.) që e pa se iku, u kthye nga shokët e u tha:

"Ju shkoni se mua më ka ikur një zog nga foleja!"

Dhe u nis pas nxënësit. Ndërkaq, kur nxënësi e ktheu kokën dhe e pa mësuesin që po e ndiqte, e shpejtoi më shumë ikjen e emocionuar dhe kjo ndjekje nëpër sokakë mori fund pasi nxënësi e përplasi pa dashje kokën në një mur. Pastaj, kur e pa mësuesin para vetes, i iku fytyra dhe e uli kokën. Xhunejd Bagdadi (k.s.) i tha:

"O bir, ku po shkon, nga kush po ikën? Ndihma e mësuesit për nxënësin në këto ditë të vështira duhet!"

Dhe e mori me vete me dhembshuri dhe e çoi në seli. Atje, nxënësi i ra ndër këmbë mësuesit dhe bëri pendesë.

Ja, kjo situatë është njëra prej rezultateve të begatshme të orientimit moralo-shpirtëror të pjekurisë për të mos e prapësuar njeriun pavarësisht nga gabimet, përkundrazi, për ta trajtuar me dhembshurinë e prindit.

Nga ana tjetër, përtej faljes së të metave dhe gabimeve, aftësia për ta kthyer të keqen me të mirë, madje për t'u lutur për përmirësim dhe orientim për dikë që të ka bërë keq, duhet të jenë veti dalluese të muslimanit. Si shembull për këto veti mjafton rasti i Qëndrimit të Profetit (s.a.s.) në Taif ku ai, në vend që t'i mallkonte ata që e goditën me gurë, u lut për orientimin e tyre në rrugë të drejtë. Gjithashtu, stili i tij që përdori për ruajtjen e dinjitetit të Mekës jo duke u lutur për shkatërrimin e njerëzve por për hyrjen e secilit prej tyre në rrugën e drejtë, u bë pretekst për shpëtimin e sa e sa mohuesve dhe kundërshtarëve të tërbuar!

Në hadithin profetik këshillohet kështu:

"Nuk është ndonjë gjë me vlerë për ju t'u bëni mirë atyre që ju bëjnë mirë dhe t'u bëni keq atyre që ju bëjnë keq. Fisnikëri është jo t'u përgjigjeni me të njëjtën të keqe atyre që ju bëjnë një të keqe, por me të mirë!" (Tirmidhi, Birr, 63)





Sepse, po qe se njeriu që i bën mirë, është armik, të bëhet mik; po qe se është në mes, të afrohet; po qe se të është afër, dashuria për ty i shtohet. Ky është kuptimi i faktit që sot, në botë, njerëzit e vënë nën sundimin e pamëshirshëm të materializmit dhe të zvarritur në krizë shpirtërore, për t'u lehtësuar shpirtërisht, tregojnë interes më shumë për konsideratat mistike. Edhe përdorimi i stilit mistik në paraqitjen dhe sugjerimin e Islamit në këtë drejtim është më i suksesshëm. Sot në Perëndim, shumica e shtresave të zgjedhura që kanë përqafuar Islamin, për ta kënaqur boshllëkun shpirtëror, u drejtohen veprave të mistikëve të mëdhenj si Hz. Mevlana dhe Ibni Arabi. Gjithashtu, në krye të veprave të kërkuara sot në botën perëndimore, janë veprat e tasavvufit, mistikës islame. Prandaj, ka nevojë jashtëzakonisht të madhe për gjerësinë shpirtërore që përfshin gjithë botën e Mevlanait, i cili thotë:

*Eja! Eja! Kushdo që të jesh, prapë eja!
Mohues, zjarradhurues ose idhujtar po të jesh, eja!
Selia jonë (e Islamit) nuk është seli e pesimizmit!
Njëqind herë në e ke prishur pendimin, prapë eja!*

Synimi final i i kësaj ftese tolerante të shumë të shquarit Mevlana është që, duke ia bërë njeriut të njohur margaritarin e thelbit të tij, ta shpëtosh nga gabimet me anë të bazës së begatë të dhembshurisë dhe mirëkuptimit dhe ta nderosh me Islamin, nuk është ta pranosh pa ndonjë qëllim gjithkënd pavarësisht nëse vazhdon të mbetet në gjendjen e tij të vjetër. Synimi është rregullimi i botës së brendshme të atij njeriu. Te riparuesi dërgohet vegla e prishur. Edhe selitë e njerëzve të tillë të mëdhenj janë si ofiçina riparimi, prandaj edhe është mjaft e natyrshme që thirrja t'u bëhet më shumë njerëzve që kanë nevojë të ndreqen!



Veçanërisht në kohët kur jeta fetare dobësohet tejet dhe kur njerëzit janë mjaft me të meta për sa u përket kritereve fetare, bashkëbiseduesi duhet trajtuar me një vetëmohim mistik, me mëshirë dhe mirëkuptim, sepse kjo lloj sjelljeje është qëndrimi më rezultativ që do ta rriste mundësinë e rregullimit dhe shpëtimit të njerëzve të rrethuar nga të katër anët me mëkatë.

Ndërkaq, duhet thënë se mirëkuptimi ndaj mëkatarit është çështje individuale. Ndryshe, mirëkuptimi ndaj të metave dhe padrejtësive që duke kaluar nga individi në shoqëri në një mënyrë që i shkelin të drejtat e personit dhe që e shkatërrojnë qetësinë dhe lumturinë e shoqërisë, vështrimi i tyre me falje është i papranueshëm. Veç kësaj, vështrimi nga njerëzit që





e jetojnë fenë sipërfaqësisht, i mëkatarëve me ndjenjë zemërimi, pa dyshim që nuk është aspak i gabuar. Për ta, qëndrimi larg mëkatarëve është i domosdoshëm për ta mbrojtur zemrën nga dëmet që mund të lindin nga afrimi me mëkatarët. Sepse, te personat që e jetojnë jetën me indiferentizëm, mëkatet u vijnë vetes të këndshme si një muzikë e ëmbël dhe mund të kryhen lehtësisht pa ua ndjerë peshën. Për këtë shkak, meqë trajtimi nga mëkatari i mëkatit të vet me lehtësi bëhet shkak edhe për t'i cënuar kriteret hyjnore, edhe për ngjijtjen e atyre mëkateve në zemër si sëmundje ngjijtëse, përbën një rrezik të përgjithshëm. Pra, mirëkuptimi ndaj mëkatarit nuk duhet bartur te mëkati dhe armiqtësia ndaj mëkatit nuk duhet shpërthyer te mëkatari.

Fjala e fundit që mund të themi pas të gjitha këtyre, është hadithi profetik:

“Lehtësoni, mos vështirësoni! Përgëzoni, mos neveritni!” (Buhari, *Ilm*, 11)

Natyrisht, me kusht që të mos dëmtohet thelbi i fesë dhe që të mos dilet nga rruga e drejtë!..

O Zot! Duke na i mbushur zemrat me urtësitë hyjnore, na bëj nga njerëzit e vërtetë të pasionit hyjnor! Na i bëj zemrat burim të mëshirës, dhembshurisë dhe ndihmës për krijesat për hir të Krijuesit! Dhe na i ndërro mëkatet dhe të metat me mirësi dhe bukuri!

Zoti ynë! Duke na bërë të veprojmë sipas të fshehtës “mëshira ime e kapërcen ndëshkimin tim” dhe të ecim gjithmonë në rrugën e faljes, na bashko me grupin e njerëzve të mirë!

Amin, ashtu qoftë!..





PJESA E TRETE




MARIFETULLAH ose NJOHJA INTUITIVE E ZOTIT dhe DHUNTITE HYJNORE

A. MARIFETULLAH (njohja intuitive e Zotit)

1. Individualiteti i lartë
2. Atributet hyjnore dhe shfaqjet e tyre
3. Marifetullah dhe shfaqjet e individualiteteve

B. DHUNTITE HYJNORE


1. Dituria hyjnore (ilmu'l-ledun)
 2. Zgjuarsia (firaset)
 3. Aftësia e administrimit dhe parashikimit mrekullor (tasarruf-keramet)
 4. Endrrat besnike
- 



"Kush njuh veten, njuh edhe Zotin e vet!"



MARIFETULLAH ose NJOHJA INTUITIVE E ZOTIT dhe DHUNTITE HYJNORE

 Allahu është aq i dukshëm saqë nga intensiteti i dukjes mbetet i padukshëm!



A. MARIFETULLAH (njohja intuitive e Zotit)

1) INDIVIDUALITETI I LARTE

Deklarata në vijim e Profetit (s.a.s.) shpreh pamundësinë e konceptimit të natyrës së Individualitetit të Zotit:

“Mendoni mbi krijesat e Allahut, mos mendoni mbi Individualitetin e Tij, sepse ju kurrë nuk mund ta përcaktoni (denjësisht) vlerën e Tij!” (Dejlemi, *Musned*, II, 56; Hejthemî, *Mexhmau'z-Zevaid*, I, 81)

Fundja, edhe njohuritë mbi Allahun, të cilat, duke e çuar njohjen njerëzore në klimën e besimit e të kulturës shpirtërore¹, e bëjnë atë të arrijë dritën e orientimit shpirtëror, domethënë, të gjejë rrugën e drejtë, nuk janë njohuri mbi natyrën e Individualitetit të Tij, por mbi atributet e Tij, sepse Allahu i Lartë (Zoti) s'ka të bëjë me kohën dhe hapësirën, nuk është i kufizuar në kohë dhe hapësirë dhe qëndron mbi kohën dhe hapësirën². Kurse, meqë njohja njerëzore është e kushtëzuar nga koha dhe hapësira dhe e kufizuar në kohë dhe hapësirë, logjika njerëzore mund të veprojë vetëm me anë të mbresave të marra nga bota materiale. Për ta konceptuar dhe përceptuar diçka, duhet që ajo diçka të ketë në botën e dukshme një të

1 Në këtë pjesë e cila titullohet “Marifetullah ve İlahi Mevhibeler” (Njohja intuitive e Zotit dhe dhuntitë hyjnore), do të kemi të bëjmë me tre koncepte kryesore që nisen nga e njëjta fjalë dhe nga i njëjti koncept bazë: *irfan*. *Irfan* është njohuria dhe kultura shpirtërore dhe metafizike; *arif* është personi i pajisur me kulturën shpirtërore dhe metafizike; *marifet* është njohja shpirtërore dhe metafizike e Allahut (Zotit), e cila ka karakter intuitiv ose mund të shpjegohet në këtë mënyrë me anë të koncepteve me të cilat gjykojmë dhe veprojme ne.

2 Këtu në origjinal është përdorur fjala arabisht *munezzeh* që ne e përkthym në shqip në mënyrë të perfrazuar si më sipër.





ngjashmen e vet, gjurma e së cilës të ekzistojë në mendje. Kurse Allahu (Zoti) karakterizohet nga atributi i pangjashmërisë me krijesat³. Ky atribut shpreh pangjashmërinë ndaj çdo gjëje të shfaqur *pas*, ndryshimin absolut, përsosmërinë absolute dhe epërsinë absolute ndaj çdo gjëje të shfaqur (krijuar) *pas*, në mënyrë akcidencele. Kjo e vërtetë logjike është rezultat i përceptimit dhe njohjes së përsosmërisë së rregullit që sundon në gjithësi. Shkaku i parë i aftë për të krijuar një gjithësi të tillë, pra, Zoti Krijues, kurrë nuk mund të krahasohet me veprën e vet. Ai zotëron një përsosmëri, madhështi dhe fuqi eprore ndaj të gjitha krijesave. Dhe, meqë kështu duhet të jetë, ky fakt është një domosdoshmëri racionale e logjike. Prandaj, arsyetimi mbi natyrën individuale të Allahut (Zotit) të pangjarë e të pashoq s'është, për njeriun, as i mundur e as i drejtë!

Përgjegjësia jonë ndaj Allahut të Lartë është që, duke u nisur nga atributet, ta kuptojmë dhe pranojmë ekzistencën e Individualitetit të Lartë. Të kësaj natyre janë edhe shembujt dhe shpjegimet që na paraqet Zoti në Kur'an mbi veten e vet. Në ajetin kur'anor thuhet:

“Allahu është drita (nuri) e qiejve dhe e tokës. Drita e tij i përngjet kandilit. Ai kandil ndodhet brenda një qelqi që është një yll që shndrit si margaritar. Vaji i atij kandili merret nga një dru ulliri të begatë që s'ka të ngjarë as në lindje, as në perëndim, dhe është i tillë që mund të ndriçojë edhe pa iu dhënë flakë! Dritë mbi dritë! Allahu ndriçon kë të dëshirojë! Allahu u jep shembuj njerëzve që të kuptojnë. Ai ka dijeni për çdo gjë!” (en-Nur, 35)

Po të shihet me vëmendje, me anë të shembëllimit në ajet, në fillim, njohja njerëzore gatuhet me mbresa që mund t'i kuptojë, pastaj, me anë të një të vërtete përtej imagjinatës dhe njohjes, duke e çliruar dhe abstraktuar nga ato mbresa, thuhet, me anë të një shprehjeje më koncize, **“dritë mbi dritë”**. Pra, kërkohet të thuhet se drita e Zotit nuk përbëhet prej disa lloj dritërash të kufizuara siç mund të pandehet nga metafora e parashtruar në ajet, dhe as njëra prej tyre ose të gjitha, por një dritë në mënyrë të pakufizuar mbi çdo dritë, një dritë pamundësisht të kufizueshme e të njohshme. Por jo çdo njeri mund ta shohë argumentin ose provën e vërtetë, t'i kuptojë argumentet e Zotit dhe të arrijë atë që dëshiron Zoti. Sepse përceptimi i të dukshmes varet sa nga drita po aq dhe nga ekzistenca e syrit (receptorit) që e përcepton atë. Sepse, ndërsa çdo gjë e mundshme për t'u parë me sy, është e dukshme për çdo njeri që ka sy të aftë për të parë në sajë të dritës, nuk është e dukshme për të verbërit. Prandaj, shpirti që sheh

3 Ky është atributi individual i antagonizmit të Zotit eternal ndaj qenieve të krijuara akcidencele. Në origjinal, në kllapa është shënuar trajta arabishte e këtij atributi: *muhalefetun li'l-havadih*.





është, po aq sa drita që e tregon ekzistencën dhe të vërtetën, një element i pamënjaueshëm për të vëzhguar, sepse vetëm shpirti që sheh ka aftësi për të njohur dhe kuptuar!

Nga ana tjetër, fakti që Zoti e cilëson në ajet veten “Nur” (Dritë) dhe thotë se “Allahu është drita e qiejve dhe e tokës”, është shprehje e faktit se qenia që e ka krijuar tërë botën, që e tregon këtë gjithësi të gjerë, që i bën të ditura të vërtetat e panumërta të fshehta e të dukshme dhe që i gëzon sytë dhe zemrat, është vetë ai, sepse po të mos ishte ajo dritë e lartë (ai nur i lartë) i Zotit, asgjë nuk do të dihej e nuk do të gjendej, asnjë e vërtetë nuk do të kuptohej dhe asnjë gëzim nuk do të mbushte zemrën.

Në këtë kontekst, të gjitha dritërat (nuret) që janë faktori i vetëm i shfaqjes dhe vëzhgimit të qenieve, janë identitetet i një shfaqjeje të asaj drite (të atij nuri) të lartë. Si rrjedhojë, gradët e dritave (nureve) në qiej kanë edhe shembëllimin e tyre në botën tokësore. Për shembull, po qe se rrezet e diellit bien mbi hënë dhe prej aty, në pasqyrën e varur në murin e një shtëpie mbi tokë, pastaj mbi pasqyrën tjetër në murin tjetër, pastaj mbi sipërfaqen e një ene me ujë dhe, më në fund, në tavanin e dhomës, më e fuqishmja e këtyre është drita (nuri) e diellit si burim i parë, pastaj drita e hënës, pastaj drita e pasqyrës së parë, pastaj drita e pasqyrës së dytë, pastaj drita e ujit dhe, më në fund, drita e reflektuar në tavan. Dhe në të gjitha, drita që ndodhet më pranë burimit është më e fuqishme se ajo që ndodhet më larg burimit. Si kjo është edhe gradualiteti i dritërave në qiejt e tjerë. Pra, drita (nuri) që shfrytëzohet është më e fuqishme se drita që jep mundësi për shfrytëzim (drita e burimit është më e fuqishme se drita e reflektuar, drita e reflektuar dy herë është më e dobët se drita e reflektuar një herë). Kështu, duke u nisur nga fundi drejt burimit, dritërat vijnë duke u bërë më të fuqishme gjersa arrijnë te drita më e madhe dhe e pasosur, e cila është drita (nuri) e Allahut të Lartë.

Shfaqja dhe njohja e çdo gjëje ndodh vetëm me nxjerrjen e saj në dukje dhe njoftimin e saj nga Allahu i Lartë që është ndriçuesi i qiejve e i tokës, sepse pa dritën (nurin) e Tij, shfaqja dhe dukja e qenies është e pamundur. Ndërkaq, njeriu që sheh blerimin e pranverës nën dritën e ditës, përballë ngjyrave të ndryshme që duken në sytë e tij, thotë se “nuk ka parë gjë tjetër veç blerimit”, futet mes pranverës dhe blerimit pa e dalluar dritën që, në të vërtetë, ia siguron shikimin e tyre. Mirëpo të gjitha ngjyrat i ka dalluar në sajë të dritës. Në këto kushte, drita ka mbetur e fshehur pikërisht nga intensiteti i dukjes së saj.

Duke u nisur nga kjo e vërtetë, kompetentët e kulturës shpirtërore dhe të njohjes intuitive (marifet) thonë kështu:





“Në të vërtetë, Allahu nuk është i fshehtë, por është i padukshëm për kapacitetin dhe aftësinë tonë dalluese për shkak të intensitetit të shfaqjes së Tij.”

Hz. Hydaji thotë:

*Shfaqja i është bërë perde dukjes së Tij;
A kërkon për dritën tjetër provë ai që ka sy?*

E shprehur ndryshe, po qe se në një dhomë ndizet një dritë prej pesë mijë vatësh, meqë drita me këtë intensitet e kapërcen qindra herë kapacitetin e shikimit (përceptimit) të syrit të njeriut, njeriu nuk sheh dot asgjë nën këtë dritë. Në këto kushte, sigurisht që Zoti i Lartë që zotëron një dritë pafundësisht të fuqishme e të papërceptueshme nga kapaciteti i syrit të njeriut, është i padukshëm për syrin e njeriut. Për ta shprehur këtë ide, Kur’ani ka thënë kështu për besimtarët:

“Ata që i besojnë të padukshmes...” (el-Bakara, 3)

Por për njerëzit tejpamës kjo është një e padukshme e tillë që, me anë të intensitetit të shfaqjes së dritës së saj, është me e dukshme se qeniet më të dukshme!

Ne jetojmë me ajër por nuk e shohim dot atë megjithëse na ka rrethuar nga të gjitha anët! Ne e ndjejmë atë vetëm duke marrë frymë. Prandaj, megjithëse nuk e shohim dot, jo vetëm që s’e mohojmë, por, me një domosdoshmëri jetësore, themi:

“Po të mos jetë ajri, nuk jetojmë dot!”

Si ne janë edhe gjallesat e ujit. Edhe ato, ndërsa ndodhen mes ujit të lumit ose detit, nuk e dallojnë ujin ose ujin nuk e shohin si diçka të veçantë pikërisht sepse uji i ka rrethuar nga të gjitha anët.

Kjo do të thotë se ne mund ta dallojmë diçka po ta kemi përballë, prapa, djathtas ose majtas. Por po të na rrethojë nga të gjitha anët, zhvishet nga të gjitha kushtet anësore (dimensionet) dhe shfaqja e ekzistencës së saj e kapërcen përceptimin tonë dhe, kështu, mbetet e fshehtë për sytë tanë të kufizuar nga dimensionet. Po të mos ishte kështu, për shembull, po qe se ajri do të ishte i dukshëm për sytë, jeta do të bëhej e pamundur për t’u jetuar. Sepse, në një mot me mjegull, të gjitha qeniet dhe objektet e tjera do të bëheshin të padukshme. Pra, dukja e një qenieje (objekti) që na rrethon ne nga të katër anët, është shkak për mosdukjen e qenieve (objekteve) të tjera. Prandaj Zoti ka mbetur i fshehtë për sytë në këtë botë. Po të ishte i dukshëm, për shkak të bukurisë së Tij dhe për shkak të faktit që ai do të na





kishte rrethuar nga të katër anët, ne nuk do të shihnim dot asgjë tjetër dhe atëherë, natyrisht që nuk do të kishte jetë të kësaj bote!

Atëherë, Zoti që është një qenie transcendentale, domethënë, përtej përceptimit dhe imagjinatës, është edhe i fshehtë, edhe i dukshëm. Më saktë, i fshehtë si individ, i dukshëm si shfaqje.

Është i dukshëm sepse të gjitha qeniet formohen nga drita (nuri) i Tij.

Është i fshehtë sepse sytë nuk kanë fuqi ta shohin Dritën (nurin) e Tij.

Është i dukshëm sepse çdo gjë tjetër veç Tij shfaqet vetëm me anë të attributeve të Tij.

Është i fshehtë sepse nuk ka të ngjashëm, sepse dija e njeriut përgjithësisht kalon nëpër njohjen e materies me anë të të kundërtave. Për këtë shkak, është mjaft e natyrshme që ai që nuk ka të kundërt dhe që kurrë s'ndryshon, të mbetet i fshehtë.

Gjithsesi, asnjë qenie (krijesë) e vetëdijshme nuk e ka kapacitetin e mjaftueshëm për ta përceptuar dhe njohur një qenie të tillë. Është për këtë arsye që besimi nuk përbën zotërim të së vërtetës së Individualitetit të Tij, por pranim të qenies (ekzistencës) së Tij. Sepse qenia apo mosqenia e një gjëje është tjetër gjë, kurse konkluzioni mbi natyrën ose cilësinë esenciale të asaj gjëje është tjetër gjë.

Nga ky këndvështrim, Zoti e ka pajisur njeriun me mendje (arsye) vetëm sa për ta kuptuar qenien apo mosqenien e individualitetit hyjnor, kurse, duke e mbushur botën e vëzhgueshme me shfaqje të attributeve të tij, i ka dhënë mundësinë që, me anë të tyre, ta njohë autorin duke u nisur nga vepra. Shembulli i mëposhtëm e reflekton bukur këtë të vërtetë.

Një ditë, Xhunejd Bagdadi pa se shumë njerëz po vraponin për diku me kureshtje dhe nxitim të madh. Ai i pyeti ata:

“Për ku po shkoni kështu me nxitim dhe emocion?”

Ata iu përgjigjën:

“Paska ardhur një dijetar prej aksh vendi, që e provoka ekzistencën dhe njësinë e Allahut të Lartë me një mijë e një prova! Po shkojmë për të përfituar nga provat e tij! Po deshe, eja dhe ti!”

Duke i vështruar me një buzëqeshje të mrudhur, Xhunejd Bagdadi u tha:

“Në gjithësi ka prova të panumërta të dëshmisë hyjnore për sytë që shohin, për veshët që dëgjojnë dhe për zemrat që ndjejnë. Zoti vetë ka shumë e shumë dëshmi për veten e vet. O njerëz! Po qe se është dikush i cili, pavarësisht nga të gjitha këto, ka akoma dyshim, le të shkojë! Në zemrën tonë nuk ka thërrime dyshimi!”

Shkurt, për sytë që shohin, Zoti ka dhuruar te njeriu që është esenca e gjithësisë, te gjithësia që është një Kur'an pa fjalë, dhe te Kur'ani që është





gjithësia pa fjalë, shfaqje të panumërta të attributeve hyjnore. Veç kësaj, për të përfituar prej këtyre, ka dërguar profetë si ndihmës dhe udhërrëfyes. Dhe me ndërmjetësinë e profetëve, ashtu siç vërehet në një masë të caktuar në Kur'an, i ka paraqitur të vërtetat e botës së dukshme e të padukshme në formë "fjale" në përshtatje me nivelin njohës të njeriut.

Si rrjedhojë, brenda mundësive të fjalës, mbi Allahun mund të themi në mënyrë thelbësore këto:

Në realitet, Qenia Absolute është e papërkufizueshme. Qenia Absolute nuk mund të karakterizohet me asnjë atribut përveç atyre me të cilat karakterizohet vetë. Madje edhe vetë cilësimi që i bëjmë ne me anë të njohjes sonë të kufizuar si "absolute", e kufizon (e përkufizon) atë, por jemi të detyruar të themi kështu që të kemi mundësi të tregojmë për të, ndërkaq që Allahu (Qenia Absolute) është krejt i ndryshëm nga çfarëdo që t'i shkojë ndërmend njeriut nëpërmjet këtij cilësimi.

Fakti që Qenia Absolute e cila është hyjni, i tregon (i shfaq) atributet e veta, është domosdoshmëri e individualitetit të vet. Krejt siç e reflekton një kandil i ndritshëm dritën e vet. Të gjitha qeniet janë të fiksuara në dijen e Qenies Absolute në formën e një përmbledhjeje të tyre dhe gjithësia është një shfaqje e kësaj të vërtete. Qeniet e kësaj bote të cilën e quajmë "bota e dëshmisë"⁴, ekzistojnë relativisht sepse asnjëra nuk mund të ekzistojë vetvetiu. Ato konsiderohen ekzistente si shfaqje të attributeve, veprave, konkluzioneve, fuqisë dhe aftësisë krijuese të Qenies Absolute. Ndërsa Individualiteti Hyjnor i shfaq në të gjitha qeniet aftësinë krijuese, fuqinë, urtësinë, masën paravepruese, administrimin dhe atributet e veta, bota ekzistente kurrë nuk është shfaqje e Individualitetit Hyjnor. Pra, bota ekzistente është shfaqje jo e Individualitetit Hyjnor, por e attributeve hyjnore.

Për rrjedhojë, Individualiteti Hyjnor është më i shenjtë e më i pakushtëzuar se çdo gjë tjetër. Po të mos ekzistojë dielli, nuk ekziston as drita e tij, ndërkaq që drita e diellit ka ekzistencë më vete dhe nuk është diell. Ta dish dhe njohësh çdo gjë si Atë vetë, do të thotë ta pranosh gjithësinë dhe botën ekzistente si zot (hyjni), gjë që i hap rrugë materializmit i cili "njëshin" e mendon si "çdo". Ja, nga kjo ide fikse si një mendësi e gabuar dhe fantaziste ka buruar bindja e quajtur panteizëm e parashtruar nga Platoni. Edhe nëse disa kanë dashur ta tërheqin edhe Unitetin e Qenies brenda këtij sistemi botëkuptimor dhe e kanë pranuar si të tillë, sufitet e vërtetë e kanë kundërshtuar dhe hedhur poshtë gjithmonë këtë bindje të shtrembër. Sepse, megjithëse dihet që çdo gjë ekziston me dhe në sajë të





ekzistencës së Tij, besimi i vërtetë është Uniteti i Qenies⁵, individualiteti i së cilës është i pavarur nga çdo gjë. E thënë ndryshe, gjithësia përbëhet nga shfaqja e attributeve të Zotit, por individualiteti i Zotit nuk është gjithësia, sepse krijuesi kurrë nuk shfaqet në formë (trajtë) krijese. Opinioni se krijuesi shfaqet në formë (trajtë) krijese është mohim (kufr-blasfemi) i hapur. Sepse Zoti është *muhalefetun li'l-havadith*, i kundërt me të gjitha krijesat (i ndryshëm nga të gjitha krijesat). Pra, nuk ka të ngjashëm dhe partner, nuk i përngjet asnjërës prej krijesave. Prandaj ai është i ndryshëm nga të gjitha llojet e përshkrimeve antropomorfike. Dihet se, duke u larguar nga kjo e vërtetë, hebrenjtë kanë shkuar aq larg sa t'i thonë biri i Zotit Uzejr, kurse krishterët, Isait. Si një përgjigje hyjnore për të gjitha këto shfaqje keqkuptimesh e shkarjesh ideore që njeriu i ka prodhuar në klimën e tij imagjinare e fantaziste dhe pastaj është ngritur t'i besojë, Allahu i Lartë thotë kështu:

“Ata (idhujtarët, politeistët dhe heretikët) nuk e njohën dot Allahun ashtu siç duhej. Në ditën e kiametit, e gjithë faqja e tokës do të jetë nën administrimin e tij. Qiejt do të mbështillen me dorën e fuqisë së Tij. Ai është i lartë dhe s'ka të bëjë me gjërat që ia përshkruajnë politeistët!”
(ez-Zumer, 67)

Nisur nga kjo, Fjala e Njësisë-Tevhid (La ilahe il'lallah – Nuk ka zot tjetër veç Allahut) e cila përbën themelin e besimit islam, është, në të vërtetë, mohimi me zemër, me anë të shprehjes **la ilahe – nuk ka zot tjetër**, i të gjitha besimeve dhe konsideratave të gabuara mbi Zotin dhe, në vazhdim, me anë të shprehjes **il'lallah - veç Allahut**, shtresim në zemër i botëkuptimit dhe besimit të drejtë mbi Allahun, Zotin transcendental. Në Kur'an thuhet:

“... Allahu që veç Tij nuk ka zot tjetër. Ai është i gjallë dhe në këmbë. Ai nuk dremet e nuk fle. Çdo gjë në qiej e në tokë është e Tij...” (el-Bakara, 255)

“... Nuk ka asgjë që t'i ngajë Atij. Ai dëgjon dhe sheh.” (esh-Shúrá, 11)

⁵ Në origjinal: Vahdeti Vuxhud. Uniteti i Qenies është një konsideratë mistike e sistemuar nga Muhjiddin ibni Arabiu (560/1162 – 638/1240). Është edhe një konsideratë tjetër mbi këtë çështje, “Uniteti i Dukjes” (Vahdeti Shuhud) e Imam Rabbaniut (971/1563 – 1034/1624) i cili është konsideruar “Novatori i Mijëvjeçarit të Dytë (Hixhri)” (Muxheddid-i Elf-i Thání). Në të vërtetë, këto dy pikëpamje nuk janë tjetër veçse vështrim i të njëjtës gjë nga dritare të ndryshme, me fjalë të tjera, që të dyja janë konceptim dhe shpjegim i dallimit mes natyrës së atributit “Qenie” të Zotit dhe qenies/ekzistencës që mundemi ta shohim në këtë botë. Me një ndryshim, që Vahdeti Vuxhud është ta ndjesh tevhidin (njësinë, unitetin e qenies së Zotit), kurse Vahdeti Shuhud është t'i vëzhgosh shfaqjet e tevhidit. Në esencë, këto janë gjendje shpirtërore dhe nuk duhen ngatërruar me interpretimet filozofike racionale.





“(O i Dërguar!) Thuaju: **“Ai Allahu është një i vetëm. Allahu është samed⁶. Nuk është i lindur dhe nuk ka lindur⁷. Dhe s’ka të përngjarë.”** (el-Ihlas, 1-4)

Në fakt, njohja jonë mbi Individualitetin Hyjnor është vetëm njohja e Tij dhe nënshtrimi ndaj Tij në kuadrin e mbresave dhe kuptimeve që marrim nga bota jonë. E thënë ndryshe, çfarëdo kapacitetesh që të zotërojë dhe i çfarëdo niveli shpirtëror që të jetë njeriu në këtë botë të përkohshme (relative) dhe brenda këtyre dimensioneve relative, është krejt i paaftë për ta njohur Individualitetin Hyjnor!

Siç bëhet e ditur në Kur’an, kur Musai (a.s.) bisedoi me Zotin në malin Sina, ndjeu një kënaqësi të madhe shpirtërore dhe, me shfaqjen hyjnore që shijoi, e harroi veten. Duke harruar se ku ndodhej, pothuaj doli jashtë kohës dhe hapësirës. Mes një pasioni dhe dalldie të thellë, i lindi një dëshirë e fuqishme për ta parë individualitetin e lartë të Allahut dhe ia shfaqti Atij këtë dëshirë. Allahu i Lartë i tha: **“Len terani – ti kurrë nuk mund të më shohësh!”** Dhe ia sqaroi se le t’ia hidhte vështrimin malit dhe, në qoftë se do të mund ta shihte, edhe Atë vetë do të mund ta shihte! Sipas rivajeteve (haditheve), nga pas pengesave të panumërta, mbi mal u reflektua një shfaqje e dritës (nurit) së Zotit dhe mali shpërtheu në flakë. I tmerruar, Musai (a.s.) u mpak dhe e humbi vetëdijen. Kur erdhi në vete, ngaqë e kuptoi se e kishte kaluar masën, bëri pendesë duke e madhëruar Zotin.⁸

Ja, edhe kjo e vërtetë kur’anore është një argument i hapur i faktit që, në lidhje me njohjen e Individualitetit Hyjnor, njeriu është i dënuar me një dobësi dhe paaftësi absolute!

Megjithëkëtë, siç bëhet e ditur në hadithet profetike, besimtarët do ta sodisin Individualitetin Hyjnor në xhennet siç sodisin hënën e plotë në këtë botë. Mes kësaj të vërtete dhe të vërtetës që parashtruar më lart, nuk ka kontradiktë, sepse kushtet e tokës me kushtet e xhennetit, parajsës, nuk janë identike. Pra, në xhennet, besimtarëve do t’u jepet një kapacitet dhe mundësi e veçantë që do t’ua bëjë të mundur ta vëzhgojnë ose sodisin Individualitetin Hyjnor. Kështu, fakti që i Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk u la i kufizuar brenda kushteve të kësaj bote, por iu hap gjoksi nga Xhebraili përmes një operacioni sublim, në një kuptim, kishte për qëllim t’i përfizonte atij një strukturë dhe kapacitet për t’i përballuar detyrat e larta që do t’i jepeshin. Përndryshe, me një strukturë njerëzore normale, mundësia e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) as këto detyra nuk do t’i përballonte dot, as një shfaqje të tillë të lartë e sublime si miraxhi!

6 Samed: i vetëmjaftueshëm.

7 Nuk ka lindur kënd tjetër, nuk ka pjellë të tij, nuk u përngjet qenieve që kanë pjella.

8 shih. Kur’ani, A’raf, 143.





Përfundimisht, ata që mundën të lartësohen **nga besimi (iman) në mirësi (ihsan)**, janë ata që meritojnë të arrijnë të vërtetën (hakikat) si dhe njohjen intuitive (marifet) të Zotit pikërisht nën dritën e këtyre të fshehtave hyjnore. Njerëz të tillë bëhen të zgjedhurit dhe esenca e gjithësisë. Këta janë njerëzit e përkryer të vërtetë. Ata vazhdimisht mallëzohen për botën e përjetësisë, domethënë, për bashkimin me Qenien Absolute dhe e kërkojnë Atë. Fakti që kanë rënë në këtë botë kufizimesh, në këtë botë të ekzistencës relative, është pothuaj si kurbet për ta. Por, në këtë botë, ata janë çliruar nga ekzistenca e tyre e vdekshme, kanë njohur ekzistencën e tyre nëpërmjet ekzistencës së Zotit dhe vullnetin e vet ia kanë dorëzuar vullnetit të Zotit!

**Zoti na e bëftë të lehtë të gjithëve besimin më të drejtë e më të qartë!
Dhe na e zbukuroftë lidhjen besimore me punë të mira sipas pëlqimit të Tij!
Dhe, duke na bërë fqinj të të dashurit të Tij, na nderoftë me soditjen e Bukurisë së Individualitetit të Tij!**

Amin, ashtu qoftë!





Personi që sheh me dritën e Zotit, te molekula sheh përjetësinë, te pika e ujit vëzhgon tërë oqeanin! (Poeti Mevlana)



2. ATRIBUTET HYJNORE DHE SHFAQJET E TYRE

Individualiteti i Zotit është një, kurse atributet e tij nuk mbarojnë me të numëruar. Pra, atributet e tij nuk kanë një numër të caktuar, por të pafund. Vetëm Ai vetë i di të gjitha atributet e tij. Ndërkaq, një pjesë e attributeve u janë bërë të ditura profetëve, kurse një pjesë - si nëntëdhjetë e nëntë emrat - u janë bërë të ditura njerëzve të tjerë. Edhe dijetarët njohin shumë attribute që nuk përfshihen në nëntëdhjetë e nëntë emrat.

Të gjitha atributet e njohura e të panjohura para së gjithash janë për të shprehur faktin se krijuesi i vetëm i gjithësisë është një qenie transcendentale, domethënë, mbinatyrale dhe përtej imagjinatës, i pastër nga atributet relative që shprehin mangësi dhe i karakterizuar nga attribute përsosmërie.

Atributet hyjnore klasifikohen në dy kategori:

- a) Individuale (dhatí)
- b) Pozitive (thubutí)

Ndërkaq, është e pamundur që ndonjëri nga atributet e mësipërm të mungojë ose që këtyre t'u shtohet ndonjë atribut tjetër i papërshtatshëm me to.

Përsosmëria e qenies së Zotit rrjedh nga fakti që Zoti është i gjallë, i përhershëm dhe me **jetë absolute**. Jeta si atribut i Zotit nuk është lloji i jetës biologjike e kundërta e vdekjes biologjike, por një jetë krejt e posaçme vetëm për Të. Kjo specifike karakterizohet kështu në Kur'an:

"... zotërues i jetës së vazhdueshme, për të Cilin nuk ka vdekje..."
(el-Furkan, 58)⁹

Dituria e Zotit nuk është produkt mendimi dhe ideje. Rregullsia dhe harmonia tejet e imtë saqë nuk do të mund ta arrinte ta realizonte asnjë



⁹ Originali i ajetit është kështu: "Ve tevvel al el hajjil'ledhi la jemutu...", "Dhe bëj për dorëzanës Atë i cili është gjithmonë i gjallë e i pavdekshëm...". Përkthyesi.



mendje dhe vullnet, që vërehet në këtë gjithësi, është prova më besnike e faktit se ç'dije të pafund zotëron Allahu, Zoti i vetëm i gjithësisë! Në këtë gjithësi, edhe zbulimin më të vogël njeriu mundet ta arrijë me kontributin e një numri të papërcaktueshëm njerëzish gjatë shekujve dhe si përfundim të shumë e shumë dijeve dhe rregullave. Për shembull, ndërlihdja me anë të telefonave celularë që sot është përhapur shumë, është arritur vetëm kaq shumë kohë pas krijimit të njerëzimit dhe pas një eksperience kaq të gjatë! Të tilla janë edhe përparimet e tjera. Mirëpo këto zbulime, shpikje si dhe të panjohurat ende të pazgjidhura janë specifika të vendosura në rregullsinë e gjithësisë në një çast me anë të dijes së Tij hyjnore.

Shembulli i mëposhtëm e shpreh bukur ndryshimin e pafund mes dijes së Zotit dhe dijes së krijesës.

Gjatë udhëtimit kur Hizri (a.s.) i tregoi Musait (a.s.) ngjarje të çuditshme me kuptim të fshehtë, një trumcak u ul në anë të anijes ku kishin hipur ata. Pastaj trumcaku mori ujë me sqep nga deti. Duke ia tërhequr vëmendjen mbi këtë veprim, Hizri (a.s.) i tha kështu Hz. Musait:

“Pranë dijes së Allahut, dija jote, ime dhe e të gjitha krijesave është sa uji që mori ky trumcak nga deti!” (Buhari, *Tefsir*, 18/4)

Nën dritën e këtyre të vërtetave, poeti Mevlana, duke iu drejtuar njeriut, e shpreh kështu urtësinë e zbatimit praktik të attributeve hyjnore **dije, dëgjim dhe shikim** te njeriu:

“Zoti e bëri të njohur se është i ditur (alim), domethënë, se “e di çdo gjë shumë mirë”, në mënyrë që ti të frikësohesh dhe, kështu, të mos shkaktosh ngatërresa dhe të mos tentosh për të prishur dhe shkatërruar!”

“Zoti e bëri të njohur se është dëgjues (semí), domethënë, se “e dëgjon çdo gjë shumë mirë”, në mënyrë që ti të mbyllësh buzët ndaj fjalëve të shëmtuara e të këqija!”

“Zoti e bëri të njohur se është shikues (basír), domethënë, se “e sheh çdo gjë shumë mirë”, në mënyrë që ti mos e ngatërrosh veten me të këqija të fshehta!”

Edhe të gjitha fjalët që ekzistojnë janë nga një shfaqje më vete të atributit **fjalë** (kelam) të Zotit. Kështu, Allahu i Lartë e shfaq fuqinë e Tij të pafundme në atributin *fjalë* (folës), veçanërisht, emrin e Tij të lartë e të nderuar e bën të përmendet me anë të gjuhëve të panumërta. Nga atributi *fjalë* (folës), Ai i ka dhuruar një gjuhë të posaçme çdo krijese, përfshi edhe ato të pandehura si jo të gjalla. Në Kur'an thuhet:

“Shtatë qiejt, toka dhe çdo gjë që ndodhet në to e madhërojnë Atë. Nuk ka asgjë që të mos e madhërojë Atë me falenderim, por ju nuk mund ta kuptoni mënyrën e madhërimit të tyre...” (el-Isra, 44)

Pa dyshim, meqë të gjitha aktet e madhërimit bëhen me anë të emrave, mjeti i vetëm me anë të të cilit njeriu ka mundësi ta njohë Allahun e Lartë, janë shfaqjet e attributeve hyjnore në fushën e njohjes sonë.





Po të mbahet parasysh se, kur i mendojmë kuptimet e këtyre attributeve, ato provojnë individualitetin që atribuojnë (cilësojnë, karakterizojnë), atributet janë *emra*. Pra, me anë të attributeve Allahu i Lartë është i cilësuar (karakterizuar) në atë gradë, sa ato janë për Të në gradën e emrave. Kjo ndodh edhe te njerëzit. Kur një person cilësohet (karakterizohet) në shkallë të lartë me anë të një atributi, ai atribut kthehet në emër dhe përdoret për të si emër. Për shembull, Ebu Hanife është cilësuar si “Imami i Madh” (Imami Adham) dhe pastaj, ky atribut i përdorur në mënyrë shumë të dendur është kthyer në emër të dytë për të.¹⁰

Për rrjedhojë, *shfaqjeve të attributeve hyjnore* u thuhet edhe **shfaqje të emrave**. Në këtë kontekst, me ajetin

وَاللَّهُ الْأَسْمَاءَ الْحُسْنَىٰ

“Emrat më të bukur janë të Allahut...” (el-A’raf, 180), Zoti i ka pohuar atributet e Tij si *emra* dhe e ka paraqitur veten për njohjen njerëzore me anë të emrave hyjnorë.

Robi e siguron lidhjen me hyjnoren (hyjnoritetin) me anë të emrit (të hyjnores apo hyjnoritetit). Kjo e vërtetë tregon se emri i Allahut është një element i pashmangshëm për karakterizimin specifik (tenzih) të Tij dhe realizimin e raportit përkatës të robit ndaj Tij. Prandaj, aktet e mira ose të këqija të kryera nga rob i ndaj Zotit drejtohen jo ndaj të vërtetës hyjnore, por ndaj emrit hyjnor. Kështu, e vërteta hyjnore mbetet gjithmonë specifike (munezzeh)¹¹.

Me të vërtetë, po të mos ishte emri i posaçëm i Zotit, njeriu do ta kishte të vështirë të rregullonte lidhjet dhe raportet ndaj Tij. Sepse njeriu është mësuar ta shohë ekzistencën e gjërave te emrat e tyre dhe ta shprehë me anë të emrave të tyre. Prandaj, pasi e krijoi Ademin (a.s.), Zoti ia mësoi emrat e të gjitha gjërave dhe me këtë shprehu epërsinë e Ademit (njeriut) ndaj engjëjve. Sepse ta dish (ta njohësh) emrin e një qenieje, në një kuptim, do të thotë ta njohësh edhe ekzistencën individuale të saj. Me të vërtetë, po të mos e njihnim ne Zotin me anë të emrave të Tij të lartë, ç’do të mund të dinim për Të?

Pra, njeriu është gjithmonë nevojtar për emrat që përcaktojnë veçantitë e Zotit. Në situata të ndryshme që përjeton, çdo rob kërkon ta thërrasë Zotin e vet me anë të një emri të përshtatshëm. Po të mos ishin këta emra,

10 Për këtë rast dhe të gjitha rastet e ngjashme, ne shprehemi kështu në shqip: “Ebu Hanife është mbiquajtur Imami i Madh”. Përkthyesi.

11 E pandikuar nga raporti i krijuar nga rob i ndaj Zotit. Përkthyesi.





lidhja e robit me Zotin do të mbetet shumë e mangët, mbase nuk do të bëhej e mundur. Mund të thuhet se këta emra janë pohime që plotësojnë gjer në një farë shkalle paaftësinë shprehëse të robit përballë individualitetit hyjnor dhe hyjnitetit, e thënë ndryshe, janë çelësa që hapin pamundësitë e shpirtit njerëzor. Sepse vetëm përmendja e emrave të Allahut, ushqen besimin, bën të ndihet prania hyjnore, shton dashurinë dhe pasionin ndaj Tij, e bën robin të përshtirshëm ndaj Tij, e bën robin të ndjejë interesim dhe konkurrencë ndaj atyre që ndodhen në lartësinë e Tij, duke e bërë robin të heqë dorë nga kjo botë dhe shijet dhe kënaqësitë e saj të përkohshme, e orienton atë te e përhershmeja, si dhe ia nxit dëshirën për t'u kthyer dhe bashkuar me Zotin. Këto dobi i tregojnë edhe fakti që lutjet dhe dhikret e këshilluara nga Profeti (s.a.s.) në situata të ndryshme, janë të mbushura me emrat e Allahut.

Besimtari i cili ndodhet në kushte shumë të vështira, i cili është shumë nevojtar ndaj mëshirës hyjnore, duke kërkuar ndihmë nga Zoti i tij, kërkon një shprehje që do ta përmbledhë gjendjen e tij dhe kapet pas emrave "Rahman dhe Rahim" (Mëshirues dhe Shpërblyes). Duke u shtypur nën peshën e mëkateve dhe duke e ndjerë se i është këputur lidhja ndjesore, kërkon një pretekst që do ta afronte te Zoti dhe mbështetet te emrat "Gaffar dhe Settar" (Falës dhe Mbulues i mëkateve). Duke e vëzhguar fuqinë dhe madhështinë hyjnore që shfaqen në gjithësi ose në shpirtin e tij, robi një pohim që do t'ia shprehte ndjenjën dhe intuitën të pamundura për t'u shprehur në libra, dhe, duke thënë "Allahu Ekber" (Allahu është më i madhi), shpirti i tij i lëkundur gjen vendosmëri dhe qetësi. Shkurt, robi, në situata të ndryshme të tij, me anë të attributeve të ndryshme të Zotit, hap portat e drynosura të shpirtit, qetëson dhe plotëson shumë përplasje e nevoja.

Është për këtë arsye që Zoti e ka bërë të njohur veten në përputhje me të vërtetën, por në një mënyrë të kuptueshme për njerëzit. Pra, ka një shkak personal njerëzor që Zoti e prezanton veten me një sërë attributesh, si Alim, Hakim, Kadir, Gafur, etj., dhe që njeriu e njeh Atë si të tillë. Sepse një pjesë të këtyre cilësive njeriu i gjen edhe te vetja pavarësisht se në nivel tejet të kufizuar. Dhe kjo është një dhunti (mevhibe) hyjnore e favorizuar për besimin dhe orientimin e njohjes njerëzore.

Në një pamje, shfaqja e attributeve dhe akteve të Allahut është identiteti i "konsideratës hyjnore ndaj mendësisë njerëzore dhe botëkuptimit njerëzor". Shfaqja e shpjegon atë që shfaqet. Por ky shpjegim (shtjellim, sqarim) realizohet në individualitetin e Tij jo siç është, por në gjendjen e përshtatur (në gjendjen e konsideratës) ndaj njohjes sonë. Nën dritën e kësaj të vërtete, Hz. Mevlana thotë kështu:

"Personi që sheh me dritën e Zotit, te molekula sheh përjetësinë, te pika e ujit vëzhgon tërë oqeanin!"





Kurse Hz. Ibrahim Gylsheni, duke e rrokur këtë imtësi, këndon në këtë mënyrë:

I dashur, ç'është kjo që je oqean brenda këtyre pikave?

I dashur, ç'është kjo që je diell i ndritshëm brenda këtyre molekulave?

Përgjigja e kësaj pyetjeje ndodhet e fshehur në këto fjalë të Hz. Mevlanait:

"Kush mund ta kuptojë Zotin, për urtësinë e të cilit nuk bëhet pyetje? Kush mund ta rrokë të vërtetën e asaj pune? Këto fjalë që po them, janë fjalë të detyruara të thëna vetëm për të treguar!

Në të vërtetë, puna e fesë nuk është gjë tjetër veç habitjes, mahnitjes dhe admirimit. Por ky admirim nuk është t'i kthesh shpinën kibles (drejtimit) të së vërtetës për shkak se mendja nuk e arrin plotësisht atë, përkundrazi, është të biesh në mahnitje si i dehur dhe i dalldisur pas mikut!

Sepse po ramë në gjumë, do të thotë se kemi rënë në dalldi me ashkun për Zotin, jemi bërë të dehurit e Tij. Po të ndodhemi zgjuar, përjetojmë sa e sa të fshehta në eposin e shkruar prej Tij!

Në qoftë se qajmë, jemi re e Tij e mbushur plot dhunti e begati. Po të qeshim, bëhemi shkreptima e ndritshme e Tij!

Po qe se zemërohemi dhe hyjmë në luftë, kjo bëhet shfaqje e madhështisë së Tij, në të kundërt me persekutimin e Tij. Po qe se pajtohemi dhe kërkojmë falje, kjo është dalje në shesh, dukje e dashurisë së Tij!

Kush jemi ne në këtë botë të errët? Ne jemi nga një qenie-hije më vete, nga një hiç më vete. Jemi si shkronja elif që nuk bashkohet me asnjë shkronjë, që nuk merr asnjë shenjë pikësimi. Çdo lëvizje, çdo qëndrim i rrjedhur prej nesh është shfaqje e emrave dhe e attributeve hyjnore të Tij!"

Motivi që e kredh Hz. Mevlananë në një det të tillë habie dhe mahnitjeje, janë shfaqjet e emrave dhe attributeve të Zotit, te vetë Ai dhe në gjithësi, shfaqje të larta e të amshuara në nivel marramendës për njeriun. Ja, pra, kjo e vërtetë, domethënë, shumëllojshmëria e emrave të Allahut e lehtëson kuptimin e shumëllojshmërisë së akteve të Tij, shpreh pakufishmërinë e përmbytjes së hyjnitetit të Tij, e bën Atë të pastër nga mendësitë e ngushta dhe kufizuese. Veçanërisht cilësitë antagoniste bëhen një pengesë e efektshme ndaj mendësive dhe botëkuptimeve që bartin prirjet për ta kufizuar hyjnitetin. Dikush dëshiron ta shohë Zotin vetëm të jashtëm e të dukshëm (Dhahir - Eksternal). Ashtu është, por, në të njëjtën kohë, Zoti është i brendshëm dhe i padukshëm (Batn - Internal).

Allahu i Lartë është "xhamiu'l-eddad", bashkuesi i cilësive antagoniste në qenien e Tij.

Kjo lartësi hyjnore ka shkaktuar që të gjitha qeniet të jenë të ndryshme nga njëra-tjetra. Sipas kësaj, cilësitë që mund t'i nxërë njohja njerëzore, konceptohen në sajë të antagonizmit mes tyre. Për më tepër, sa më i plotë





dhe i theksuar të jetë antagonizmi, aq më e qartë dhe e kthjellët bëhet njohja.

Nga ana tjetër, në botën tonë, antagonizmat dhe antagonistët nuk qëndrojnë bashkë, por prirën drejt asgjësimit të njëri-tjetrit dhe njësimi (unifikimit)¹². Kjo është një cilësi e lindur nga origjina e vetme e qenies (ekzistencës) dhe që është vepruese në mënyrë absolute edhe në botën fizike, edhe në fushën e të vërtetave metafizike. Me fjalë të tjera, është domosdoshmëri e asaj që quhet “adetullah”, zakon i Allahut. Ashtu siç drita me errësirën, nxehtësia me ftohtësinë kanë prirje njësimi (unifikimi) duke e asgjësuar njëra-tjetrën, edhe marrëdhëniet reciproke shpirtërore që shfaqen në meditim dhe emocionim, janë, gjithashtu, domosdoshmëri të këtij ligji hyjnor. Ndërkaq, antagonizmat dhe antagonistët në Individualitetin Hyjnor nuk kanë prirje për ta asgjësuar njëri-tjetrin siç ndodh në botën tonë, por kanë kapacitetin dhe aftësinë për të qëndruar së bashku. Në një vështrim, asnjë atribut i Zotit nuk përmban në vetvete antagonist. Pra, Zoti ka jetë, por jeta e tij nuk e përmban antagonistin vdekje siç ndodh te krijesat (te qeniet e krijuara, të vdekshme). Zoti është i qenë (ekziston) dhe qenia (ekzistenca) e tij nuk e përmban antagonistin mosqenie (mosekzistencë). Zoti është i ditur, por jo dhe i paditur, domethënë, Zoti është i pastër nga antagonisti i diturisë që është padituria (injanca). Zoti i plotëson nevojat (e krijesave), por është i pastër nga nevojtaria. Të gjitha atributet hyjnore të tilla janë.

Nisur nga kjo, meqë ne nuk kemi fuqi për ta njohur përmbajtjen absolute tëtributeve antagonistë në nivelin e Allahut dhe meqë kemi mundësi për të menduar vetëm me anë të mbresave të marra nga bota që hyn në fushën tonë të vëzhgimit, njohja dhe analiza e cilësisë së përmendur më sipër i kapërcejnë mundësitë tona. Këtë mund ta tregojmë me këtë shembull:

Nga një kabllo elektrike, sipas llojit dhe mundësisë së konsumatorit, mund të marrim dy rezultate antagonistë me njëra-tjetrën: nxehtësi nga soba elektrike dhe ftohtësi nga frigoriferi. Po qe se këto rezultate i marrim në të njëjtën dhomë duke mundësuar marrëdhënien mes tyre, nxehtësia dhe ftohtësia do ta asgjësojnë në një masë të caktuar njëra-tjetrën. Të gjitha këto pasoja nuk shfaqen në vetë kablлон elektrike që është burimi i tyre.

12 Në këtë botë fizike, antagonizmat dhe antagonistët ekzistojnë më vete vetëm në gjendje potenciale (gjendje mungese ekuilibri) me prirjen që, duke e prishur këtë gjendje, të bashkohen dhe, kështu, të formohet ekuilibri i cili më sipër shprehet me fjalën njësim (unifikim). Gjendja e kalimit nga gjendja potenciale në ekuilibër quhet gjendje kinetike (në lëvizje). Gjatë gjendjes kinetike përftohet punë dhe energji. Ndërkaq, duhet theksuar se kurrë nuk mund të arrihet një ekuilibër i qëndrueshëm, gjë që do të thoshte eliminim i antagonizmit dhe i vetë jetës në këtë botë. (Përthyesi)





Sipas kësaj, meqë Zoti i ka pajisur të gjitha qeniet me një kapacitet dhe mundësi të caktuar, ato i bëhen pasqyrë shfaqjes së emrave brenda këtij kuadri dhe lufta mes antagonistëve me njëri-tjetrin vazhdon në mënyrë të përjetshme nga e shumta te e pakta duke bartur shprehjen e sigurimit të një epërsie.

Kjo do të thotë se në botën tonë, lufta mes të kundërtave (antagonistëve), në të vërtetë, ka për synim jo më shumë një operacion eliminimi, por një operacion sigurimi epërsie, sepse meqë çdo cilësi antagoniste mbështetet në një ose disa emra hyjnorë dhe meqë emrat hyjnorë janë të përjetshëm, ky antagonizëm nuk mund të eliminohet.

Përfundimi i natyrshëm i këtij mendimi është se, ndërsa te muslimanët shfaqet në gjendje epërsie atributi "Hadî" (Orientues) i Allahut, te mohuesit (qafirët) shfaqet në gjendje epërsie atributi "Mudil" (Çorientues). Në këto kushte, në botën tonë, edhe antagonizmi besim-mohim (iman-kufr) do të vazhdojë të ekzistojë gjer në kiamet. Është e pamundur që lufta mes antagonistëve, duke kaluar përtej epërsisë, të konkludohet me eliminimin e plotë të njërit, sepse shfaqja e emrave hyjnorë është e pandërprerë dhe e përjetshme.

Një përfundim tjetër i kësaj është ky: Sadoqë të jenë të fuqishëm, mohuesit (qafirët) nuk munden ta asgjësojnë besimin. E njëjta e vërtetë është e vlefshme edhe për besimtarët. Kjo e vërtetë që e prekëm për besim-mohimin si një fushë veprimtarie njerëzore, është e vlefshme edhe për të gjitha antagonizmat dhe të gjithë antagonistët në gjithësi.



Nga ana tjetër, gjithësia e formuar nga kompozimet e shfaqjeve të të gjithë emrave hyjnorë, nuk është e vetmja përsa i përket kësaj dukurie. Kjo ndodh edhe me **njeriun** dhe **Kur'anin**.

Ndërsa në këtë dukuri shfaqjeje gjithësia përbën një botë praktike, Kur'ani është një kompleks të vërtetash ku të gjitha të vërtetat e gjithësisë janë shprehur në trajtë "fjale" (kelam). Kurse njeriu, në këtë formim, krejt si gjithësia, është në nivelin e thelbit, bërthamës, kuintencës¹³ së gjithësisë për sa i përket shfaqjes tek ai të të gjitha emrave hyjnorë. Është si rrjedhojë e kësaj që njeriu është konsideruar "botë e vogël"¹⁴.

Është esenciale që antagonizmat në emrat hyjnorë të ekzistojnë edhe te njeriu që është mjedisi i shfaqjes së plotë të tyre. Sipas kësaj, te besimtari ku atributi hyjnor "Hadî" është në epërsi, të ekzistojë detyrimisht pak gjë edhe nga atributi hyjnor "Mudil". Besimi i një personi të tillë është rezultat

¹³ Në origjinal: zübde (osm.).

¹⁴ Në origjinal: âlem-i sağir (osm.); sipas terminologjisë filozofike, "mikrokozmos"





i epërsisë të ai person i atributit që është faktor i kësaj. Kurse te mohuesi (qafiri) ndodh e kundërta.

Një rezultat i natyrshëm i kësaj cilësie është që te çdo besimtar (mumin) ekziston pak a shumë mundësia e kalimit për në mohim (kufr) dhe te çdo mohues (qafir), e kalimit për në besim (iman). Për rrjedhojë, jetesa e besimtarëve “bejne’l-havfi ve’r-rexha”, pra, “mes frikës dhe shpresës” është një çështje e rëndësishme. Sipas kësaj, besimtarët nuk duhet të harrojnë se ekziston mundësia që në çdo çast t’u rrëshqesin këmbët.

Krahas kësaj, duke mos harruar se mund të vijë një ditë që edhe te mohuesi (qafiri) më i ashpër të dalë epror atributi hyjnor “Hadí”, mohuesi duhet pranuar si bashkëbisedues (partner) nën dritën e kësaj shprese dhe mundësie.

Në hadithin profetik, duke tërhequr vëmendjen mbi këtë specifikë, thuhet:

“Një person kryen për një kohë të gjatë akte xhenneti, pastaj aktet e tij mbyllën me një akt xhehennemi. Kurse një person kryen për një kohë të gjatë akte xhehennemi, pastaj aktet e tij konkludohen me një akt xhenneti!” (Muslim, Kader, 11)

Ja, për këtë, zemra e çdo besimtari duhet të ndodhet mes frikës dhe shpresës dhe ai duhet ta bëjë shenjë dalluese të vetën parimin hyjnor të shprehur në urdhrin e Zotit:

“... adhuroje Zotin tënd gjersa të të vijë fakti (vdekja)!” (el-Hixhr, 99)

Është për shkak të fshehtësisë së kaderit për sa i përket besimit (iman) dhe mohimit (kufr), që edhe optimizmi absolut (siguria absolute), edhe pesimizmi absolut janë mohim (kufr). Sepse askush nuk mund ta dijë se ç’do t’i ndodhë në frymën e fundit. Sepse përveç profetëve dhe personave të shënuar prej tyre (si dhjetë të përgëzuarit¹⁵), për askënd tjetër nuk ka ndonjë garanci.

Siç e shprehëm edhe më lart, ndërsa atributet antagonistike ndodhen te individualiteti hyjnor të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe në qetësi, këtotribute të Zotit shfaqen në botën tonë të provës me cilësinë e prirjes për të dalë eprorë ndaj njëri-tjetrit, pra, si dalja, kohë më kohë, eprorë e të orientuarve (besimtarëve) me shfaqjen e emrit hyjnor “Hadí” dhe shtimi, kohë më kohë, i mohuesve me daljen epror të emrit hyjnor “Mudil”. Madje, pavarësisht nga përpjekjet e jashtëzakonshme të profetëve, mohuesit dhe mëkatarët kanë ekzistuar gjithmonë në shoqëri; edhe në periudhat kur kanë mbretëruar dhe sunduar mohuesit dhe mizorët, besimtarët kanë vazhduar të ekzistojnë duke e ruajtur dhe mbrojtur besimin e tyre.

¹⁵ Në original: ashere-i mubeshshere.





Eshtë e fiksuar në Kur'an që, ndërsa As'habi Uhdud hidheshin në hendeqet e mbushura me zjarr, krishterët e parë jepnin shpirt ndër dhëmbët e luanëve, Habibi Nexhar gjuhej me gurë nga një fis mizor, kurse magjistarët e Faraonit vareshin me këmbë e duar të prera në degët e hurmës sepse i kishin shprehur besimin Musait (a.s.), të gjithë këta, duke mos e dobësuar besimin edhe në këto rrethana, madje, patën luftuar gjer në frymën e fundit në emër të besimit dhe qenë bashkuar si dëshmorë me Zotin e tyre duke u lutur:

رَبَّنَا أفرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَتَوَفَّنَا مُسْلِمِينَ

"... Zoti ynë! Na jep durim dhe na e merr shpirtin si muslimanë!"

(el-A'raf, 126)

Nga këto të vërteta, na del një përfundim besimor dhe edukativ. Sipas tij, sado të jetë i ashpër dhe i vendosur dikush në mohim, askush s'ka të drejtë ta pengojë apo ta përjashtojë atë nga ftesa e Islamit. Sepse mund të vijë një çast që ai, duke i dhënë mundësi shfaqjes së atributit hyjnor "Hadi" në nënvetëdijen e vet, të pësojë një ndryshim në personalitet. Pra, edhe te mohuesi më i tërbuar ekziston mundësia e orientimit. Këtë të vërtetë Zoti e ka shprehur duke i porositur Hz. Musain dhe të vëllain, Hz. Harun, të cilët i kishte ngarkuar me detyrën për ta ftuar Faraonin në rrugë të drejtë, kështu:

فَقُولَا لَهُ قَوْلًا لَّيِّنًا لِّعَلَّهُ يَتَذَكَّرُ أَوْ يَخْشَى

"Thojini atij fjalë të buta! Ndoshta dëgjon këshillë ose frikësohet nga Allahu!" (Taha, 44)

Pa asnjë dyshim, ky ajet kur'anor, në të njëjtën kohë, na ofron neve një metodë të mrekullueshme për kumtimin e Islamit. Kjo metodë ka dy parime bazë:

1) T'i kumtohet e vërteta bashkëbiseduesit me një stil shprehës të butë që nuk do t'ia nxiste atij egoizmin.

Me të vërtetë, edhe nëse përballë mrekullive të Musait (a.s.), shpesh herë Faraoni u prir të besonte, njerëzit e mjedisit iu bënë pengesë. Edhe ai vetë, duke ndjerë krenari për vetveten dhe mendjemadhësi, nuk besoi. Por pastaj, kur ishte duke u mbytur në ujërat e Detit të Kuq, në një çast dobësie dhe pesimizmi, deshi të kapej pas atributit hyjnor "Hadi" dhe tha:

"Edhe unë besova se me të vërtetë nuk ka zot tjetër veç Zotit që i





besojnë të bijtë e Izraelit. Edhe unë jam musliman!” (Junus, 90)

Por ky besim në çast agonie i Faraonit që kishte jetuar gjatë gjithë jetës duke e kërkuar shfaqjen e atributit “Mudil”, nuk u pranua dhe ai mizor i pangopur kaloi në jetën tjetër, ahiret, si mohues (qafir).

Ndërkaq, kjo metodë është mbështetur duke u përmendur edhe në një ajet tjetër:

“(O i Dërguar!) Ti fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe përpiku me ta në mënyrën më të mirë!” (en-Nahl, 125)

2) Kumtesa përfshin të gjithë njerëzit pa parë gjendjen ku ndodhen.

Faraoni jo vetëm ishte një mizor dhe fatkeq që nuk afrohej te besimi, por, në të njëjtën kohë, ishte edhe një kriminel i cili, për ta asgjësuar Musain (a.s.), kishte vrarë mijra foshnja! Megjithëkëtë, u bë bashkëbisedues i kumtimit hyjnor. Për më tepër, në ajetin kur’anor u urdhërua:

“Thojini atij fjalë të buta, ndoshta dëgjon këshillë ose frikësohet nga Allahu.” (Taha, 44)

Kjo deklaratë hyjnore parashtron domosdoshmërinë e përgjithësimit të kumtimit hyjnor për të gjithë njerëzit pavarësisht nga gjendja ku ndodhen.

Kështu, Profeti (s.a.s.) i pati folur Ebu Xhehlit me herë të tëra, kurse Ebu Xhehli, megjithëse e pati pranuar haptazi me ndërgjegje profetësinë e Hz. Muhammedit (s.a.s), nuk e pati pohuar atë për shkak të epërsisë së egoizmit dhe mendjemadhësisë. Por kjo sjellje e lartë e Profetit (s.a.s.) pati qenë bërë pretext për orientimin e shumë personave, si Omer bin Hattab, Ebu Sufjan, Hind dhe Vahshi të cilët në fillim patën qenë armiq të Islamit.

Ja, ky këndvështrim siguron mundësinë e realizimit të një bukurie, butësie dhe delikatese të lindur sa nga marrja parasyshe e situatave praktike si në shërbimet islame, si dhe në të gjitha marrëdhëniet njerëzore, po aq edhe të situatave të mundshme. Ja, ky është këndvështrimi themelor i vërejtur si faktori më i pjekur e i begatë në sjelljet e mistikëve.



Zoti ka dëshiruar në mënyrë volitive që pranimi me zemër dhe pohimi me gojë i ekzistencës individuale dhe unitetit të Tij të plotësohet me adhurime si një domosdoshmëri, kjo, e natyrshme dhe e ndërgjegjshme e lindur nga ky besim, dhe mundësinë për ta realizuar këtë, ua ka favorizuar, ndër krijesat, vetëm njerëzve dhe xhindve. Ndërkaq, meqë i ka pajisur njerëzit dhe xhindët me aftësi njohëse dhe analizuese, Zoti i ka konsideruar ata përgjegjës në raport me nivelin e aftësisë njohëse dhe analizuese të tyre.

Megjithëse xhindët janë në numër më të shumtë se njerëzit dhe, për rrjedhojë, në ajetet kur’anore ku përmenden së bashku me njerëzit,





përmenden para tyre, pozita më e lartë për sa i përket nderit dhe dinjitetit, u përket njerëzve. Megjithëkëtë, njerëzit dhe xhindet janë së bashku në përgjegjësinë e adhurimit që është qëllimi final i krijimit të tyre. Këtë specifikë, Zoti e ka përmendur në Kur'an me këtë ajet:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Unë i krijova njerëzit dhe xhindët vetëm për të më adhuruar mua!”

(edh-Dharijat, 56)

Allahu i Lartë, mëshira e të Cilit ka epërsi ndaj ndëshkimit të Tij, nuk i ka lënë njerëzit dhe xhindët vetëm me fuqitë e mendjes (arsyes), njohjes, analizës dhe apelimit, me të cilat i pajisi për kryerjen e detyrës së adhurimit, për të cilën i bëri përgjegjës, por, përveç këtyre, i ka favorizuar edhe me ndihma hyjnore. Ndërsa gjithësia me të gjithë elementët e saj është një ekspozitë argumentesh dhe provash për ekzistencën e Zotit, i ka ndihmuar ata me një karvan profetësh dhe prijësish të përkryer për t'ua lehtësuar njerëzve dhe xhindve vështirësinë e kuptimit dhe njohjes së Tij me anë të mendjes (arsyes) nëpërmjet këtyre argumenteve dhe provave. Me të vërtetë, me qëllim që asnjë individ të mos mbetet jashtë kësaj ndihme shtesë, Zoti e ka filluar atë qysh me njeriun e parë duke e kurorëzuar profet Hz. Ademin, atin e njeriut. Ndërkaq, për shkak se njeriu është epror ndaj xhindve, të gjithë profetët kanë dalë nga njerëzit dhe disa prej tyre janë ngarkuar me detyrë si profetë edhe mbi xhindët.

Ndërsa kumtesa e profetëve ka qenë e njëjtë për sa u përket të vërtetave teorike, konkluzionet shoqërore, duke ndjekur një ecuri paralele me zhvillimin e jetës njerëzore, kanë arritur përkryerjen tek profeti i kohës së fundit dhe me anë të Kur'anit të dërguar atij. Kur'ani nuk ka për t'u abroguar por ka për të vazhduar gjer në kiamet si një mrekulli shprehjeje. Meqë profeti Muhammed (s.a.s.) është ngarkuar me detyrën profetike edhe për botën njerëzore, edhe për botën xhindore, ai titullohet edhe “rasulu'th-thekalejn”, që do të thotë “profet i dy botëve”.

Gjithësia e cila formohet me anë të sintezave të emrave hyjnorë, është një vend ekspozimi marramendës i fuqisë hyjnore. Me zhvillimin e dijeve dhe shkencave, shfaqjet mrekullore të artit hyjnor konceptohen në mënyrë më të thellë dhe gjithëpërfshirëse dhe bëhen hapa më të mëdha drejt kuptimit dhe njohjes së fuqisë së Allahut të Lartë. Të gjitha veprimtaritë shkencore të kohës sonë, nga kërkimet kozmike, në përparimet e shënuara nga shkencat gjenetike e gjer te mrekullia kompjuterike, janë të tilla që e vërtetojnë konkluzionin tonë. Prandaj në Kur'an është thënë:

“... nga robtë, vetëm dijetarët frikësohen (ashtu siç duhet) nga Allahu!” (Fatir, 28)





Me çdo përparim që shënon shkenca, i ofron njohjes njerëzore një argument të ri nga fuqia dhe madhështia hyjnore. Me këtë cilësi, gjithësia është një sistem të vërtetash të pafundme të përgatitura për zbulim nga njohja njerëzore. Me këtë gjendje, gjithësia është pothuaj një poezi e paderdhur në fjalë dhe një libër i hollësishëm. Ata që, duke respektuar urdhrat hyjnorë, zotërojnë hollësi në dije dhe shkencë, duke i kapërcyer të vërtetat e reflektuara në rreshta, nisin të lexojnë me një kompetencë shpirtërore urtësitë dhe të fshehtat në librin e gjithësisë.

Shkencat e natyrës dhe ato teknike përpiqen ta sistemojnë rregullsinë hyjnore që sundon në gjithësi, nën emërtimin “ligjet e natyrës”. Por ata që zotërojnë imtësitë në dituri, duke i rrokur këto të vërteta të quajtura “ligjet e natyrës”, nga një pikë më gjithëpërfshirëse, arrijnë te dëshira volitive hyjnore¹⁶ që sundon në gjithësi.

Edhe njeriu që është një “mikrokozmos”, pra, një gjithësi e vogël, ashtu si gjithësia, është një sistem të vërtetash të pafundme të ofruara njohjes njerëzore. Kjo është urtësia e cilësimit të njeriut si “kuintesencë”¹⁷, pra, si thelbi ose fara e gjithësisë. Ashtu siç ndodhen në farë të përqëndruara (të koncentruara) të gjitha veçoritë e llojit e të brezit, ashtu dhe te njeriu janë vendosur në mënyrë të përqëndruar (të koncentruar) ose embrionale gjithësia dhe të gjitha të fshehtat dhe të vërtetat e Kur’anit.

E shprehur ndryshe, Zoti i Lartë, qenia dhe ekzistenca e të Cilit nuk ngjajnë me qenien dhe ekzistencën e krijesave të Tij, konceptimi i individualitetit të të Cilit është i pamundur, por i Cili e ka lënë hapur rrugën e njohjes së veprës dhe artit të vet, e ka krijuar njeriun si “zëvendës”¹⁸ mbi tokë, e ka bërë atë më të nderuarin e krijesave dhe i ka dhënë ekzistencë në cilësinë e thelbit të gjithësisë. Sipas të vërtetave të përqëndruara (koncentruara) te vetja e tij, njeriu është një gjithësi e vogël. Prandaj edhe shkenca, para së gjithash duhet t’ia bëjë të njohur veten njeriut dhe, duke ia treguar qëllimin final të qenies dhe ekzistencës, t’ia hapë dyert drejt njohjes intuitive të Zotit¹⁹.

Poeti Junus Emre e shpreh kështu qëllimin e vërtetë të ditorisë:

*Dituri do të thotë të dish,
Do të thotë veten të kuptosh;
Nëse ti veten s’e kupton,
Ç’të duhet kaq shumë të lexosh?*

16 Në origjinal: murad-i ilahije.

17 Në origjinal: zübde-i kâinât (osm.).

18 Në origjinal: halife (osm.), kalif.

19 Në origjinal: marifetullah, njohje intuitive e Allahut (Zotit), përsiatje mistike.





*Mos thua j lexova e kuptova,
Mos thua j u binda e adhurova;
Nëse ti Zotin dot s'e kupton,
Të gjitha këto janë fjalë të kota!*

Kjo vlerë dhe pozitë e posaçme që Allahu i Lartë ia ka favorizuar njeriut, e ka gjetur shprehjen më shumë në veprat e ndjenjave të prodhuara nga botët e gjera të mjediseve mistike. Vepra e njohur me këtë temë e poetit të shek. XVIII, **Sheh Galibi**, është ndër të parat që të vijnë ndërmend nga veprat që e përshkruajnë njeriun me vlerat për të cilat është i denjë. Në këtë poezi, poeti i drejtohet kështu njeriut:

*Tek ti është thesari i enigmës së dashurisë, tek ti,
Tek ti është burimi i bukurive të madhësisë, tek ti!*

*Sa e sa gjendje të fshehta ka gjithashtu tek ti,
Talenti shpirtëror, tek ti; aftësia, tek ti, e vërteta, tek ti!*

*Po e vure re, toka e qielli, xhehennemi dhe xhenneti janë tek ti,
Rezidenca hyjnore dhe engjëjt janë tek ti, gjithsesi, tek ti!*

*Shihe këndshëm veten se thelbi i gjithësisë je ti,
Njeriu, bebja e syrit të të gjitha qenieve je ti!*

Shkurt, njeriu është një esencë shfaqjesh të zbritura në këtë botë të vdekshme nga të vërtetat madhërisht të shkëlqyera të Zotit të Lartë që njohja njerëzore përpiqet ta konceptojë vetëm me rrugën e kalimit nga shkaku te shkaktari, nga vepra te autori, nga arti te artisti. Me këtë meritim, njeriu është vetë gjithësia në një formë shfaqjeje të posaçme, si dhe i vetmi kandidat për t'u bërë Kur'an i gjallë!

Ndërkaq, kërkimet dhe studimet shkencore nuk e kanë arritur ende mbi njeriun atë nivel dhe sukses që kanë arritur në zbulimin dhe njohjen e të fshehtave të gjithësisë. Shkaku i kësaj është se njeriu përbëhet nga sinteza e shpirtit me trupin dhe se për shpirtin, njeriut i është dhënë pak njohuri sepse i tillë ka qenë vlerësimi hyjnor për këtë çështje. Është për këto shkaqe që, me botën e tij të brendshme, njeriu paraqet ende një të fshehtë më të madhe se gjithësia. Ndërsa njohuria mbi trupin e njeriut paraqet një ndryshim dhe zhvillim shumë të madh në krahasim me një mijë vjet më parë, studimet mbi shpirtin nuk kanë ndjekur dot një ecuri paralel me këtë. Ky eveniment cilësor është identiteti i mbështetjes së një të vërtete kur'anore në ajetin:

"Të pyesin ty për shpirtin. Thuaju: "Shpirti është element i urdhrit të Zotit tim, kurse juve ju është dhënë pak njohuri!" (el-Isra, 85)





Gjithësia është thurur në një mënyrë sistematike me rregulla jashtëzakonisht komplekse e të përsosura që u themi adetullah ose sunetullah, zakoni ose tradita e Allahut. Në të njëjtën kohë, këto janë ligje me kuptim si të botëve fizike, ashtu dhe të botëve metafizike, të cilat provojnë dijen dhe fuqinë e pafundme të Zotit. Veçoritë e pandryshueshme e të përbashkëta të këtyre ligjeve me kuptim janë nga një ajet (provë, argument) më vete që dëshmojnë se vënësi i tyre është një qenie e vetme dhe më vete, dhe se gjithësia si vepër ka dalë nga një dorë e vetme. Islami e fton njeriun që, ashtu siç i lexon ajetet e Kur'anit, t'i shohë edhe këto shfaqje në librin e gjithësisë. Sepse Zoti ua bën të njohur veten robve të vet me anë të urtësive, mësimave dhe enigmave në krijimin e tyre. Në Kur'an thuhet:

"A nuk shohin ata faqen e tokës? Atje nga çdo çift i bukur bëmë të mbijnë shumë bimë!" (esh-Shuara, 7)

"Pa shih veprat e mëshirës së Allahut se si e ringjall tokën pas vdekjes! Pa dyshim, Ai do t'i ringjallë edhe të vdekurit. Ai ka mundësi për çdo gjë!" (er-Rum, 50)

"Ai që ka krijuar shtatë qiejt me rregull dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Ti nuk mund të shohësh asnjë parregullsi në krijimin e Allahut që është Mëshirues. Ktheji sytë dhe shih: A mund të shohësh ndonjë gjë të prishur? Ktheji sytë gjithandej dhe shih dhe sytë do të kthehen tek ti të paftë e të lodhur!" (el-Mulk, 3-4)

"A nuk shohin njerëzit se si është krijuar deveja, si është ngritur qielli, si janë ngulur malet dhe si është shtrirë toka?" (el-Gashije, 17-20)

"A nuk shohin qiellin që kanë mbi krye, si e kemi ngritur dhe si e kemi pajisur? Në të nuk ka asnjë të çarë!" (Kaf, 6)

Është një e vërtetë e qartë se në këtë gjithësi pa anë e pa fund ekziston një rregullsi dhe harmoni që të lë pa mend. Kjo rregullsi dhe harmoni vazhdon të ekzistojë dhe veprojë qysh nga krijimi i gjithësisë pa u shmangur aspak brenda ekuilibrit të përvetshëm të llogarive tejet të përsosura, të imta e të ndjeshme. Si rrjedhojë, dihet se, po qe se në boshtin e tokës nuk do të kishte një anim prej 23.5 gradësh nga rrafshi horizontal, nuk do të krijoheshin stinët. Atëherë, vendi me verë do të mbetej verë e përhershme, kurse vendi me dimër do të mbetej dimër e përhershëm. Ose po qe se distanca mes nesh dhe diellit do të ishte diçka më e madhe, e gjithë sipërfaqja e tokës do të kthehej në zonë akullnajash, ose po të ishte diçka më e vogël, e gjithë sipërfaqja e tokës do të përvëlohej nga nxehtësia. Cilësi si kjo vë në shesh të vërtetën se të gjithë trupat qiellorë janë programuar në atë mënyrë që ta bëjnë jetën të mundur.

Përgjithësisht, sytë që shohin, e dallojnë se, përballë sundimit dhe administrimit hyjnor, kjo botë është vetëm një grimcë nga miliarda e trilionat grimca pluhuri që notojnë në kozmos. Malet, fushat, oqeanet dhe





njeriu ndodhen brenda kësaj pike pluhuri. Ja, pra, me këtë dobësi, jashtë adhurimit ndaj Zotit, njeriu është identitet i një hiçi!

Fuqia dhe madhështia e Zotit te njerëzit, toka dhe qiejt që i krijoi me një mekanizëm llogaritjeje shumë të hollë, në mënyrë të denjë për famën e vet, do të kuptohet më mirë së bashku me diturinë që përparon:

“Dhe do t’ua tregojmë atyre ajetet tona në horizonte dhe në veten e tyre që ta kuptojnë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A s’të mjafton ty Zoti yt si dëshmitar?” (el-Fussilet, 53)²⁰

Me të vërtetë, sa më shumë të përparojnë kërkimet dhe studimet mbi gjithësinë, aq më në mënyrë gjithëpërfshirëse njihen delikatesat e **Kur’anit**, sepse çdo zbulim i ri i shkencave të natyrës, jo vetëm ka ardhur duke e vërtetuar më tej Kur’anin, por këto zbulime disa herë i kanë sqaruar ajetet kur’anore të vështira për t’u kuptuar.

Kështu, përballë ajeteve kur’anore që tregojnë për etapat e krijimit të njeriut, dijetarët e matur të fushave të tilla, si embriologjia, anatomia dhe biologjia, kanë mbetur të mahnitur dhe të detyruar për ta pohuar të vërtetën. Në Kur’an, në lidhje me formimin e njeriut në mitrën amësore, thuhet kështu:

“Me të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një esencë (e kulluar) nga balta. Pastaj e kthym atë në embrion në një vend të ruajtur mirë. Pastaj embrionin e bëmë vezë të fekunduar. Pastaj vezën e kthym në një kafshatë mish. Kafshatën e mishit e shndërruam në eshtra dhe eshtrat i

20 Këto ajete të Kur’anit mbi etapat e krijimit e kanë lënë të habitur edhe Prof. Dr. Marshall Xhonsonin, i famshëm për kërkimet e tij në fushën e anatomisë. Atij ia kanë tërhequr vëmendjen shumë veçanërisht njohuritë e dhëna në ajet mbi veçoritë e kafshatës së mishit: “Një **kafshatë mish** (mudga)...” E trajtësuar pikërisht sipas renditjes së dhëmbëve. Të duket sikur sheh gjurmët e dhëmbëve të mbetura mbi mishin e kafshuar... E gjitha, një centimetër (pothuaj një kafshatë). Në kafshatën e mishit (mudgë) janë të pranishme të gjitha veçoritë e njeriut, vetëm se disa aktive, kurse disa të tjera, që s’kanë kaluar ende në aktivitet. Mjekësia nuk gjen dot një shprehje për ta treguar këtë gjendje. Po të thotë se organet bëjnë punë, ka që s’bëjnë; po të thotë se nuk bëjnë punë, ka që bëjnë. Por Kur’ani, duke e karakterizuar këtë si një **kafshatë mish të paformë** (me organe të formuara pjesërisht) (el-Haxh, 5), me një shprehje që i përmban të gjitha informacionet mbi mudgën, e ka lajmëruar këtë të vërtetë qysh para shumë shekujsh. Prof. Marshall i cili në fillim e pati hedhur poshtë pa diskutim Kur’anin dhe, më pas, pati mbetur i detyruar ta pranonte plotësisht, përballë këtyre të vërtetave është detyruar të shprehet kështu: “Po, ky Kur’an i cili u bën dritë dijetarëve, është zbritur nga Zoti. Kur t’i vijë koha, të vërtetat e tij do të zbulohen kështu një nga një e do të dalin në shesh. Dhe do të vërtetohet ajeti: **“Eshtë një kohë kur do të vërtetohet çdo lajm** (nga të vërtetat e panumërta të njoftuara nga Kur’ani). **Së afërmi, edhe ju do ta mësoni të vërtetën!”** (el-En’am, 67) (shih Abdülmeçid Zindâni, *Kur’an’da İlmî Mûcizeler*, f. 31-36)





veshëm me mish. Pastaj, atë, me një mënyrë tjetër krijimi, e bëmë njeri. I lartë është Allahu, krijuesi më i mirë!” (el-Mu’minun, 12-14)

Meqë Kur’ani nuk është një libër i kufizuar me shkenca të tilla, si astronomia, botanika, biologjia dhe gjeologjia, ndërkohë që karakterizohet nga lakonizmi²¹ i shprehjes, nuk ka për detyrë të bëjë shpjegime të detajuara për shkencën dhe teknikën. Vetëm se çdo zbulim i ri në fushën e shkencës dhe teknikës, duke i mbështetur urtësitë, mësimet dhe të vërtetat e prekura nga Kur’ani jo haptazi por në mënyrë sinjifikative, shërben që mesazhet hyjnore të bëhen çdo ditë që kalon më të qarta. Bota ku këto të vërteta zënë vend në trajtën më të qartë dhe të detajuar, është gjithësisht. Shkaku i kësaj është se, megjithëse të vërtetat e pranishme te njeriu në trajtë thelbësore dhe të koncentruar, zënë vend në Kur’an në mënyrë pak më të hapur, prapëseprapë shumë konkluzione kanë mbetur të mbuluara.

Lakonizmi i Kur’anit ka për shkak përmbajtjen te ai të të vërtetave të pafundme. Po qe se të vërtetat e dala në shesh me punë shkencore do të zinin vend në Kur’an në trajtë të hapur dhe të detajuar, nga kjo do të lindnin dy pengesa:

a) Duke u nisur nga niveli shkencor i periudhës që jetonin, njerëzit do ta kishin të vështirë t’i pranonin të vërtetat në fjalë dhe do të rrëshqisnin në rrugën e mohimit. Si domosdoshmëri e mëshirës dhe mirësisë së Tij, Allahu ua ka favorizuar të vërtetat njerëzve duke i mbuluar në një mënyrë që të bëhen të kuptueshme kur t’u vijë koha.

b) Po qe se të gjitha të vërtetat do të zinin vend në Kur’an në trajtë të hapur dhe të detajuar, përmbajtja e tij do të zgjerohej tejte, aq sa, pa bërë fjalë për mësimin përmendësh, leximi i tij gjer në fund do të bëhej i pamundur. Duke deklaruar se në Kur’an është shënuar si thelb çdo e vërtetë në gjithësi, Allahu thotë:

“(O i Dërguar!) Ne e zbritëm këtë libër si shprehje të qartë të çdo gjëje, orientues, mëshirë dhe përgëzim për muslimanët!” (en-Nahl, 89)

“... çdo gjë e njomë dhe e thatë është në këtë libër të qartë!” (el-En’am, 59)

Kurse me ajetin si më poshtë, Allahu i ka ftuar robtë e vet të mendojnë mbi të vërtetat e shënuara në Kur’an:

“A nuk po mendojnë ata mbi Kur’anin? Apo i kanë zemrat të drynosura?” (en-Nisa, 82)

Po qe se duhet thënë sipas shprehjes hyjnore, Kur’ani është **furkan**, diferencues. Pra, Kur’ani është një libër i bekuar që vë në shesh dallimin mes orientimit dhe çorientimit (rrugës së drejtë dhe rrugës së shtrembër), mes së mirës dhe së keqes, mes dritës dhe errësirës, dhe që e bën të qartë

21 Në original: cevâmiu'l-kelim.





diferencimin mes këtyre. Ai jep rezultat sipas qëllimit dhe kapacitetit të atyre që merren me të, si dhe me aq sa ç'i mundësohet çdokujt si pjesë nga dhuntitë hyjnore. Me ajete kur'anore është e fiksuar se kur Kur'ani trajtohet me një zemër të paintriguar, besimi forcohet me njohjen e provave krejt të reja. Në Kur'an thuhet:

“Besimtarët e vërtetë janë ata që, kur përmendet Allahu, u dridhen zemrat, kur u këndohen ajetet e Allahut, u forcohet besimi, dhe që mbështeten vetëm te Zoti i tyre!” (el-Enfal, 2)

Nga ana tjetër, edhe atyre që e shohin Kur'anin me paramendim negativ, u shtohet çorientimi. Sepse, siç ndodh që, po u pa një gjë me dashuri, të gjitha bukuritë të ajo bëhen më të qarta, në të kundërt, ndodh edhe që, po u pa me paramendim negativ, te ajo nuk mund të vërehet asgjë e mirë. Krejt si vështrimi i Islamit nga Ebu Xhehli. Njerëzve të tillë, kur e këndojnë Kur'anin, meqë nuk arrijnë dot te lartësia sublime e tij, u forcohen ndjenjat e mohimit dhe ateizmit ndërsa lëkundën në paqartësi dhe dobësi. E thënë ndryshe, ata ndodhen në një gjendje acarimi që u përngjet zemërimit dhe bërtitjeve të atyre që bien të mundur nga një kundërshtar që s'e duan aspak. Si rezultat, u shtohet edhe ndëshkimi që e meritojnë. Në lidhje me këtë specifike, në Kur'an thuhet kështu:

“Ne po zbesim një Kur'an të tillë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse mizorëve veçse u shtohet disfata!” (el-Isra, 82)

“... Thuaju: “Ai (Kur'ani) është orientim dhe shërim për ata që besojnë. Sa për mosbesimtarët, në veshët e tyre ka shurdhëri (pengesë për ta dëgjuar të vërtetën), prandaj (Kur'ani) u vjen i mbyllur e i pakuptuar. Ata janë si njerëzit që u thirret nga shumë larg!” (el-Fussilet, 44)

Siç shihet, është e fiksuar me deklaratë hyjnore se Kur'ani, ndërsa është udhëzues i rrugës së drejtë për të bindurit, mohuesve (qafirëve) që mbyllin sytë me kryneqësi ndaj atij dielli të së vërtetës, vetëm sa ua shton mohimin dhe disfatën!

Prapë, për njerëz të tillë, në Kur'an thuhet:

“(O i dashuri im! Ata që të kundërshtojnë ty,) a nuk shëtitën fare mbi tokë? (Po qe se do të shëtisnin duke parë për të marrë mësim,) zemrat do t'i ndjenin dhe veshët do t'u dëgjonin! Por nuk janë sytë që qorrohen, por zemrat ndër gjokse!” (el-Haxh, 46)

Siç e shprehëm më lart, gjithësia është një sistem qeniesh të formuara me sintezën e shfaqjeve të attributeve hyjnore, kurse Kur'ani është, në këtë sistem qeniesh, reflektimi në fjalë i të vërtetave ekzistuese dhe të përqëndruara (të koncentruara). Dhe njeriu si thelbi, përmbledhja dhe, në një farë mënyre, fara e këtyre të dyve (gjithësisë dhe Kur'anit), përmban, në një masë të caktuar, nga të gjitha shfaqjet antagonistë.





Zoti që e ka krijuar gjithësinë me gjithçka përmban, me anë të sintezave të shfaqjeve të emrave hyjnorë, shfaqjet e plota e të përkryera të këtyretributeve ia ka caktuar në pjesë vetëm njeriut. Ky është edhe shkaku që e bën njeriun “krijesë të nderuar”²². Edhe njeriu, sipas kapacitetit të vet, është i karakterizuar me attribute antagoniste. Njeriu qesh dhe qan, dashuron dhe urren, etj. Pra, në qenien e njeriut është i pranishëm edhe atributi “mëshirë”, edhe atributi “përdhunë”. Prandaj nga njeriu mund të shfaqet edhe mirësi e bujari, edhe zemërim, urrejtje e furí. Te njeriu, ndjenjat e butësisë dhe ashpërsisë janë vazhdimisht në gjendje baticë-zbaticë.

Shkurt, njeriu është bërë pjesëtar i shumëtributeve të Allahut. Ndërkaq, gradët e shfaqjeve të këtyretributeve paraqesin një ndryshim të pafund nga njeriu në njeri. Marrja pjesë nga gradët e shfaqjeve në tërë amplitudën e tyre të vlerave formon shkallëzimin e karakterit njerëzor.

Për shembull, te çdo njeri ka patjetër pjesë nga shfaqja etributeve **Rahman** (mëshirues) dhe **Rahim** (mirëbërës, shpërblyes) të Allahut. Kjo pjesë ndryshon në vlera, pra, paraqet një gradualitet nga njeriu në njeri. Ndërsa te dikush, këto attribute janë vetëm për veten e tij ose, më e shumta, për njerëzit e afërm të familjes ose mjedisin shoqëror, pra, ndërsa dikush tregohet i mëshirshëm dhe i mirë vetëm për veten e vet ose, më e shumta, për njerëzit e afërm të familjes, te dikush përfshin tërë njerëzimin, madje, edhe kafshët. Për shembull, shfaqjen e plotë të atributit “Rahman” mund ta ilustrojmë me ngjarjet e mëposhtme.

Gjatë një udhëtimi nga një vend në një tjetër, Bejazit Bistami ulet nën hijen e një peme dhe ha bukë. Pastaj, pasi ngrihet dhe bën mjaft rrugë, sheh mbi torbën e bukës një milingonë dhe thotë:

“E largova nga vatani këtë krijesë të Allahut!”

Dhe kthehet pas dhe e lë milingonën nën atë pemë.

Ja dhe një shembull tjetër mëshire i papërkufizueshëm:

Ndërsa Seri Sakatí (k.s.) po u shpjegonte në mësim nxënësve hadithin që thotë se “*ai që nuk merr pjesë në hallet e besimtarëve, nuk është prej tyre*” (Hakim, *Mustedrek*, IV, 352; Hejthemi, *Mexhmau'z-Zevaid*, I, 87), në klasë hyn me emocion një nxënës dhe i thotë:

“Mësues, lagjja juaj u dogj, u bë hi, vetëm shtëpia jote shpëtoi!”

I gëzuar, Seri Sakatí tha: “Elhamdulillah, lavdëruar qoftë Allahu!”.

Por pas tridhjetë vjetësh i tha kështu një miku:

“Duke thënë, atëherë, “elhamdulillah”, unë, qoftë edhe për një çast, mendova vetëm veten duke mbetur larg halleve dhe vuajtjeve të atyre që kishin pësuar fatkeqësi! Ja, ka tridhjetë vjet që po bëj pendesë për këtë!”

22 Në original: eshref-i mahlukat.





Për rrjedhojë, po qe se mëshira dhe dashuria, si një pikë qendëruese, pavarësisht nga kush dhe prej ku është filluar, arrin të marrë një zhvillim drejt përfshirjes së të gjitha krijesave, e bën personin besimtar të plotë e të përkryer, e shprehur ndryshe, dashnor të vërtetë. Edhe sikur dashuria të ketë nisur si një lule që zë gonxhe, me prirjen dhe tërheqjen ndaj dashurive të përcaktuara, në çastin kur përgjithësohet drejt të gjitha krijesave si rrjedhojë e Krijuesit, orientohet për t'u bërë **ashk** (pasion) i vërtetë.

Për sa kohë që kufijtë e interesimit dhe lidhjes mëshirore dhe dashurore të quajtur **ashk hyjnor**, nuk përparojnë drejt një horizonti të pafund, kjo mëshirë dhe dashuri nuk mund të shprehet në trajtë ashku. Ndoshta mbetet në etapën e trajtave fillestare të saj të quajtura relativisht **ashk metaforik**.²³

Sintezat e shfaqjeve të emrave hyjnorë kanë rezultuar formimin e karaktereve të ndryshme sa numri i njerëzve. Ashtu siç ndodh që rezultati i dalë nga përzjerja e bojave të ndryshme anon nga ngjyra që ka marrë pjesë në sasi më të madhe në përzjerje, ashtu dhe sinteza e shfaqjeve të emrave hyjnorë paraqet një përmbajtje me ngjyrim atë emër ose atribut që mbizotëron në sintezë. Ky eveniment cilësor, jo vetëm e ka bërë të domosdoshme shumëllojshmërinë e tarikateve për zënien e një rruge në përputhje me karakterin e personit dhe sigurimin më të lehtë të përparimit, por edhe ka vënë në shesh nevojën e një metode edukative të ndryshme për edukimin e secilit myrid²⁴.

Me të vërtetë, edhe karakteret mund të futen në një klasifikim të përgjithshëm sipas cilësive themelore dhe sunduese. Krejt siç ndahen krijesat në kategori të ndryshme: njerëz, kafshë, bimë dhe jogjallesa. Por ndryshimi mes vlerës më të lartë dhe më të ulët të një cilësie çfarëdo që zotërojnë dy qenie të të njëjtës kategori, mund të jetë më i shumtë se ndryshimi mes dy kategorive të ndryshme. Për shembull, distanca dhe shkallëzimi nga njeriu i shkallës më të ulët gjer te njeriu i shkallës më të lartë është më i dukshëm dhe i theksuar se nga kafsha te njeriu. Elementi që formon një ndryshim kaq të madh është ndryshimi shumë i madh te shfaqjet që mbisundojnë në sintezë. Kjo vëzhgohet si në cilësitë pozitive, ashtu dhe në ato negative. Mes atij që ndodhet në shkallën më të ulët të padrejtësisë dhe përdhunës ose mohimit (kufr) dhe atij që ndodhet në kulm të këtyre cilësive, ekziston një ndryshim cilësor marramendës.

Për shembull, një mohues (qafir) i shkallës më të ulët te i cili ka përparësi atributi "Mudil" (çorientues) jeton në mënyrë të ulët (shpirtërisht të varfër e të mjerë) brenda kufijve të jetës së vet. Atij s'i intereson besimi (imani) i

23 Në origjinal, respektivisht *ilahi ashk* dhe *mexhazi ashk*.

24 Nxënës vullnetar i rrugës mistike.





besimtarëve. Por, siç ka ndodhur me Ebu Lehebin dhe personat e ngjashëm, ashpërsimi i gradës së mohimit (kufr) e çon personin gjer në luftë kundër Profetit dhe njerëzve të mirë të lartësuar shpirtërisht. Edhe përdhuna është si kjo. Zemra e një gjuetari që gjuan jo për t'u ushqyer por për kënaqësi dhe dëfrim, me kohë ngurtësohet dhe dhuna e ushtruar prej tij ndaj gjallesave të tjera duke i vrarë ato për kënaqësi e dëfrim, shkon gjer në sadizëm. Fakti historik i vrasjes në cirk nën kthetrat e luanëve i krishterëve të parë nga mbretërit e Romës dhe i vëzhgimit prej tyre të këtyre skenave sadiste me të qeshura e kënaqësi, është një model ilustrues i përcaktimit kur'anor:

“بَلْ هُمْ أَضَلُّ”, **“Ata janë më të ulët se kafshët!”**



Shumëllojshmëria e pafundme mes shfaqjeve që janë subjekte sinteze si në materien natyrore, ashtu dhe te njeriu, tregon se njëri prej ligjeve themelore të kësaj gjithësie është “dallueshmëria” (ndryshimi, diferencimi). Përpjekja për t'i bërë të barabartë (të njëjtë, të ngjashëm, të padallueshëm, të padiferencueshëm) jo tërë elementët e gjithësisë, por qoftë edhe dy qenie me njëra-tjetrën, nuk është gjë tjetër veçse preokupim i kotë! Sepse si domosdoshmëri e shfaqjeve të pafundme të emrave hyjnorë, në gjithësi nuk ka binjakë. Siç nuk mund të ketë dy njerëz binjakë identikë në përbërje dhe kuptim, siç nuk mund të ketë dy pemë binjake identike në numrin e degëve, gjetheve dhe frutave!

Aftësia për t'i konceptuar Allahun, njeriun dhe gjithësinë nga kjo perspektivë themelore (horizonti i vështrimit), i përfton njeriut pjekurinë për t'i duruar (toleruar) kundërshtarët, madje, shpesh, për t'i trajtuar ata me mëshirë dhe mirëkuptim. Ja, pra, tasavvufi ose mistika islame është pjekuria për të mund t'i parë me një afërsi dhe mirëkuptim të tillë edhe cilësitë ndaj të cilave ata që s'kanë marrë dot pjesë prej saj, përgjithësisht zemërohen. Kjo është një virtyt i përfutur nga aftësia për ta njohur urtësinë e pamjes së jashtme (dukjes).

Ndërkaq, ky virtyt dhe kjo pjekuri na përftojnë neve shumë epërsi. Para së gjithash, na sigurojnë që mëkatarin ta trajtojmë me keqardhje në vend të zemërimit, që mohuesin ta trajtojmë me butësi dhe shpresë duke menduar privimin e tij. Ky virtyt dhe kjo pjekuri na japin forcë dhe guxim në kumtimin e besimit. Ato na sigurojnë t'i shohim ata si persona nevojtarë për paralajmërim dhe orientim siç janë të tillë të verbërit përballë rreziqeve. Na sigurojnë ta kuptojmë palogjikshmërinë e zemërimit para mëkatarit të atyre që ndejnë dhimbje kur shohin një zog krahëthyer. Duke marrë vrull, ndjenjat tona të dashurisë dhe mëshirës i kapërcejnë lidhjet dhe interesimet fafeshnore të lindura nga raportet martesore dhe fitojnë një zhvillim në drejtim të përfshirjes së të gjithë njerëzimit. Në një shoqëri të formuar nga





njerëz të tillë, krimet dhe zëniet ia lënë vendin ndihmës së dhembshur, shtohet numri i njerëzve të mirë, shumica e të cilëve ka mbetur në të shkuarën. “Moral i lavdërueshëm”²⁵ i realizuar prej tyre duke marrë për model Profetin (s.a.s.), përgjithësohet me sa të ketë mundësi. Të gjitha trajtimet ndaj njerëzve me të meta fitojnë pjekuri siç shihet në këtë shembull të shkëlqyer.

Njëri prej figurave të njohura të historisë së mistikës dhe njëri prej shehëve të Belhit, Hatemi Esamm (k.s.) është një personalitet i shquar i cili, duke e holluar frymën (egon) dhe shpirtin me anë të edukatës moralo-shpirtërore të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), arriti ta ngjisë moralin e vet në një shkallë të lartë. Megjithëse e kishte shqisën e të dëgjuarit njaft të shëndoshë, u bë i dëgjuar me llagapin “Esamm”, “Shurdh”, gjë që mbështetet në një ngjarje tejet mësimdhënëse.

Një ditë, te ai shkoi një grua për t’i paraqitur një ankesë. Sapo kishte filluar t’ia tregonte hallin, nga gruaja doli aksidentalisht në mënyrë të pavetëdijshme një zhurme e shëmtuar. Gruaja shkriu si qiri, pothuaj mori fund. Kurse Hz. Hatemi, me qëllim që gruaja të mos turpërohej e të mbetej ngushtë, bëri sikur s’kishte dëgjuar, vuri dorën në vesh dhe i tha duke bërëtitur:

“Motër, më kanë lënë veshët, fol me zë më të lartë! Nuk të dëgjoval..”

Kështu, duke menduar se veprimi i saj nuk ishte vënë re, gruaja u qetësua. Pastaj filloi ta ritregonte hallin me zë më të lartë.

Siç rrëfëhet, pas kësaj ngjarjeje, me qëllim që gruaja të mos e merrte vesh të vërtetën dhe të prekej, Hz. Hatemi vazhdoi të sillej si i rënduar nga veshët për pesëmbëdhjetë vjet me radhë gjersa vdiq ajo. Prandaj u bë i famshëm me llagapin **Hatemi Shurdh**.

Sigurisht, është e pamundur që delikatesa e lartë e sjelljes dhe niveli i moralit të pasqyruar në këtë shembull të kalohen në jetë vetëm me anë të njohurive të marra nga librat! Kjo delikatesë dhe ky virtyt të shpalosur nga Hz. Hatemi mund të shpjegohen me faktin që ai kishte arritur të përçonte në moralin e vet pjesën e marrë nga atributi **Settaru’l-ujub** (mbulues i të metave) të Zotit. Sjellje të tilla janë emërtuar, veçanërisht në mistikë, si **pajisje me moralin e Allahut**.

Nisur nga kjo, miqtë e vërtetë të Allahut, të zhytur në atributet e larta të Tij, ia nënshtrojnë vullnetin e vet vullnetit të tij. Ata e konsiderojnë me vend vullnetin e Zotit dhe në këtë rrugë e orientojnë mjedisin e vet. Në këtë kontekst, shembulli i mëposhtëm është shumë domethënës.

Një ditë, Hz. Sunbul Sinan i pyeti kështu myridët e vet:





“Bijtë e mi! Ta zëmë se Zoti jua jep juve drejtimin e kësaj gjithësie, ç’bëni?”

Çdo myrid tha mendimin e vet. Dikush tha:

“Të gjithë qafirët i asgjësoj!”

Dikush tjetër tha:

“I zhduk të gjithë pijanecët!”

Një tjetër tha:

“Nuk lë të gjallë asnjë njeri që pi cigare!”

Ndërkaq, myridi që më vonë u bë dijetari Muslihiddin Efendi, vazhdonte të heshte. Më në fund, shehu iu drejtua atij:

“Biri im! Po ti, ç’do të bëje?”

Myridi iu përgjigj plot edukatë kështu:

“Imzot! Zoti na ruajtë, a mos ka ndonjë të metë në vullnetin dhe drejtimin e Zotit që unë të mendoj dhe të dëshiroj gjë tjetër? Përgjigjja ime është se edhe unë do të vazhdoja të bëja të njëjtën gjë!”

Shumë i kënaqur nga përgjigjja e myridit të vet, Hz. Sunbul Sinan tha:

“Ja, tani e gjeti puna qendrën e vet!”

Pas asaj dite, Muslihiddin Efendiu vazhdoi të përmendej si “Merkez Efendi” (Zotëria Qendër) dhe, pas mësuesit të vet, atij iu dha amaneti shpirtëror.

Edhe Ibrahim Haki Erzurumi, sikur të bënte përmbledhjen e kësaj situatë, e shpreh kështu atribuimin e çdo gjëje vullnetit të Zotit:

*Gjithë punët të zgjedhura i ka,
Për njëra-tjetrën të denja i ka;
Çfarëdo të bëjë, sukses po ka;
Ta shohim Zotin tonë se ç’bën,
Çfarëdo të bëjë, të bukur e bën!*

Shkurt, të bëhesh i merituari këtyre situatave të bukura e të larta është e mundur me veshjen në origjinë me shfaqjet etributeve të Allahut. Në të kundërt, nuk na mbetet ndryshim nga copa e letres që s’di gjë për shkrimin e shkruar apo vizatimin e vizatuar mbi të. Sa bukur shprehet poeti Mevlana:

“Po qe se vizaton mbi letër një njeri të dëshpëruar, si portreti, ashtu dhe letra s’dinë gjë as për dëshpërimin, as për gëzimin!

Në pamje, portreti është i dëshpëruar, por as portreti, as letra nuk dinë asgjë për dëshpërimin. Edhe portreti i njeriut që qesh nuk di gjë që po qesh!”

Prandaj, ne, edhe sikur të kemi merituar shumë shfaqje tëtributeve hyjnore si rrjedhojë e nderit që jemi njerëz, po qe se nuk dimë gjë për to,





i ngjajmë asaj letre dhe atij portreti të thatë! Prandaj, të gjitha atributet e përkohshme dhe relative që na janë dhënë neve për provë, duhet t'i shkrijmë në shfaqjen e attributeve të larta të Zotit. Ne duhet ta dimë se përmbajtja e të gjitha attributeve që i përkasin individualitetit të Tij të lartë, paraqesin një gjerësi dhe pafundësi të papërkufizueshme. Të gjitha ato janë të paraqena e të pafundme. Të gjitha janë absolute tek Ai dhe karakterizohen nga pafundësia. Pra, asnjë atribut i Zotit nuk ka kufi dhe breg. Nisur nga kjo, dituria, fjala, krijimi dhe të gjitha vetitë e Tij, me cilësinë që kanë, janë të papërngjasueshme e të pashpjegueshme. Kurse veçoritë tona dhe të botës sonë janë edhe të kufizuara, edhe të fundme. Ato janë identitetet e një hijeje dhe perëndimi. Me këtë gjendje, njeriu i cili ende nuk e njeh veten plotësisht, gjithsesi e ka të pamundur t'i njohë denjësisht atributet e Zotit, atributet që janë të posaçme vetëm për Të! Ashtu siç nuk e njohim dot të vërtetën dhe natyrën e individualitetit të Allahut të Lartë, as të vërtetën dhe natyrën e attributeve të Tij nuk i njohim dot plotësisht.

Ata që e njohin këtë të vërtetë dhe e kuptojnë se të gjitha atributet e veta, si shikimi, dëgjimi, kuptimi, të folurit, etj., janë shfaqje thërmijore të attributeve të Allahut të Lartë, jetojnë në klimën e asgjësisë me begatitë e marifetit, njohjes intuitive të Zotit, dhe, duke u shkrirë brenda kënaqësisë së thellë të besimit, thonë:

لَا مَوْجُودَ إِلَّا هُوَ

“Nuk ka qenie tjetër veç Tij!”

Ata gatuhën me urtësinë **“O Zot, Ti je ashtu siç je!”**

Në këtë mënyrë, ata, me një zemër të paqëtuara të çliruar nga çdo lloj iluzioni dhe lëkundjeje, takohen me Zotin e tyre dhe shkruhen në librin e të urtëve.

Një dervish e pyeti Bejazid Bistamiun:

“Imzot, cilët janë emrat më të mëdhenj të Allahut?”

Ai iu përgjigj:

“Biri im, cili emër i Allahut është i vogël? Mos u bëj indiferent: të gjithë emrat e Allahut janë të mëdhenj! Po qe se dëshiron prej Tij të ta pranojë kërkesën, kujdesu ta mbrosh zemrën nga pushtimi i vaniteteve! Emrat e Tij nuk shfaqen në zemrat indiferente. Por zemrës së ndriçuar me dritën e Tij, Allahu ia hedh vështrimin çdo çast me shumë e shumë emrat e Tij!”

Kështu, në shumë ajetë, emrit të Allahut i jepet atributi “i lartë”:

“Dhe madhëroje emrin e lartë të Zotit tënd!” (el-Vakia, 96)





Profeti (s.a.s.) e ka zbatuar këtë urdhër duke thënë gjatë namazit, në ruku, “subhane rabbijel adhim” (madhëruar qoftë Zoti i Madh) dhe, në sexhde, “subhane rabbijel a’la” (madhëruar qoftë Zoti i Lartë).

Allahu im! Për hir të emrave të tu më të bukur, veçanërisht për hir të emrit tënd të posaçëm, na mundëso neve pjesë nga e fshehta e njohjes tënde dhe e dashurisë për ty!

Amin, ashtu qoftë!





Njeriu i përkryer që arrin njohjen intuitive të Allahut (marifetullah), meqë ndodhet nën shfaqjen e dashurisë dhe afërsisë ndaj Zotit, prirjet egoistike tek ai “digjen” ashtu siç digjet letra nën thjerrëz!



3) MARIFETULLAH DHE SHFAQJET TE INDIVIDUALITETET²⁶

Marifetullah është një dituri hyjnore e pakufishme, e pafundme, që përmban fshehtësitë dhe urtësitë në tërë gjithësinë. Përkufizimi i kësaj diturie me kuptimin e saj të plotë është mbi mundësitë njohëse të njeriut. Ndërkaq, çdo njeri, në raport me mundësitë, kapacitetin dhe përpjekjet e veta, merr pjesë dhe ndjen kënaqësi nga kjo dituri. Prandaj, Profeti (s.a.s.) ka thënë:

لَا أُحْصِي ثَنَاءً عَلَيْكَ أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَيَّ نَفْسِي

“(Allahu im!) Jam i dobët dhe i paaftë të të lavdëroj Ty siç je i denjë për lavdërim! Ti je ashtu siç e ke lavdëruar vetë veten!” (Muslim, Salat, 222)

Edhe shprehjet e mëposhtme të rrëfyera si hadith i shenjtë (kudsí), tregojnë për rëndësinë e njohjes së Allahut (marifetullah):

“Unë isha një thesar i fshehtë, desha të njihesha dhe krijova krijesat që do të më njihnin Mua!”²⁷

Pas Kur’anit dhe haditheve të Profetit (s.a.s.), nuk ka më të bukur se sjelljet dhe shprehjet e robve të vërtetë të Zotit që kanë arritur njohjen

26 Titulli origjinal është: Marifetullah ve Ariflerdeki Tecelliler (Marifetullah dhe shfaqjet e tij te arifët). Siç është shpjeguar edhe në vende të tjera të këtij teksti kur është bërë fjalë për këtë çështje, fjalët *irfan* (kulturë shpirtërore), *arif* (inteligjent shpirtëror, njeri i pajisur me kulturën shpirtërore), *marifet* (njohje intuitive e shpirtërore) dhe *marifetullah* (njohje intuitive e shpirtërore e Allahut) vijnë nga e njëjta rrënjë. Për t’iu shmangur një titulli të gjatë, ne bëmë formulimin si më sipër duke pasur parasysh me fjalën *personalitetet*, pikërisht *arifët*, personalitetet e kulturës shpirtërore si njohës të Zotit.

27 shih. Axhluni, *Keshfu’l-Hafa*, II, 132.





(marifet) e Tij, sepse sjelljet dhe fjalët e tyre janë të brendshme²⁸ dhe me burim hyjnor, jo të fituara. Prandaj ata quhen “trashëgimtarë poetikë”²⁹. Zemrat e njerëzve që vëzhgojnë sjelljet e atyre robve të vërtetë dhe që dëgjojnë fjalët e tyre, mbushen me begati shpirtërore e frymëzim, zelli u shtohet, të fshehtat nisin t’u bëhen të qarta, pastrohen nga lëkundjet djallëzore dhe pasionet materiale.

Një pjesë e këtyre miqve të Zotit kanë attribute të Hz. Ademit, një pjesë kanë attribute të Hz. Ibrahimit, një pjesë kanë attribute të Hz. Musait, një pjesë kanë attribute të Hz. Isait dhe një pjesë tjetër kanë karakter muhammedian.

Cilësitë dalluese të personave me karakter muhammedian janë marifeti (njohja intuitive e shpirtërore), muhabbeti (afërsia dhe dashuria shpirtërore) si dhe tevhidi (besimi monoteist në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë). Mes këtyre personave bujarë ka të tillë që janë të paatribueshëm ngaqë kanë përqëndruar në vetvete të gjitha cilësitë dalluese. Pra, janë të pashpjegueshëm.

Zoti u ka falur këtyre robve të dashur shfaqje të ndryshme sipas gjendjes së tyre. Në këtë kontekst, dikë e ka bërë Shah Nakshibend, një det zelli dhe përpjekjeje të pangjashëm e të pafund në veprime e në marifetullah; dikë, si Mexhnunin, e ka bërë të përsillet nëpër shkretëtirën e ashkut; dikë e ka shëtitur nëpër luginat e mahnitjes; dikë e ka lënë pa gojë përballë madhësisë hyjnore; dikë, si Junus Emrenë, e ka bërë bilbil të ashkut; dhe dikë si poeti Mevlana, e ka bërë një det kuptimesh, nga gjuha e të cilit shpërthejnë urtësi dhe shpërndahen gjithandej margaritarë të rrallë!

Të gjithë të urtët (velinjtë) që Zoti i bëri të merituar të këtyre shfaqjeve të ndryshme, i pajisi në klimën e miqësisë me diturinë e marifetit dhe ia fali njerëzimit si udhërrëfyes.

Njeriu i përkryer që arrin njohjen intuitive e shpirtërore të Allahut (marifetullah), meqë ndodhet nën shfaqjen e afërsisë dhe dashurisë së Zotit, tek ai “digjen” (nga shfaqjet e kësaj afërsie dhe dashurie) prirjet sensitive e egoistike siç digjet letra nën thjerrzë e vendosur në vatrën ku mblidhet tufa e rrezeve të diellit që e përshkon atë. Kështu, pasi që ky njeri shndërrohet në një qendër tërheqjeje dritësore hyjnore³⁰, edhe njerëzit e tjerë, në mënyrë të pavullnetshme, e duan dhe e respektojnë atë. Ndërkaq, meqë ai e ka shpëtuar veten nga darët e komplimentave dhe lidhjeve të përkohshme e të vdekshme, nuk bie në vorbullën e attributeve të përbuzura, si krenaria, mendjemadhësia dhe dukja. Ai është së bashku me Zotin mes popullit. Ai

28 Në origjinal: *deruní*, internale, të zemrës, të botës së brendshme ndjesore.

29 Në origjinal: *verethetu'l-enbija*.

30 Në origjinal: *nuraní*.





jeton me ndjenjat e respektit ndaj urdhrave hyjnorë (tadhim li emrillah) dhe dhembshurisë ndaj krijesave të Allahut (shefkat li halkillah). Ndërkaq, si domosdoshmëri e afërsisë dhe dashurisë ndaj Allahut, kurrë nuk tregon afërsi, dashuri dhe prirje ndaj mizorëve dhe mosmirënjohësve që janë e kundërta e përkryerjes së tij, vetëm se, si domosdoshmëri e mëshirës së tij, i vjen keq edhe për ta dhe lutet për orientimin e tyre!

Pasuria dhe kapitali dhe të gjitha kapitalet që i përkasin kësaj bote, atij i duhen vetëm për t'i dhënë, për të bërë mirësi me to. Njeriu i përkryer ia ka kushtuar veten njohjes së Allahut (marifetullah) dhe për t'u bërë konfident i Allahut (vasili il'lallah). Tashmë ai është një rob i vërtetë që nuk u kushton vëmendje halleve dhe vuajtjeve të kësaj bote!



Poeti Mevlana Xhelaledin Rumi e shpreh bukur me anë të kësaj rrëfenje faktin se shpirtrat, frymët dhe kapacitetet ndryshojnë nga njeriu në njeri, se çdo njeri i sheh në pasqyrën e vet shpirtërore nga kënde të ndryshme qëndisimat e gjithësisë veç e veç dhe se edhe brenda turmave, madje, ndodhen së bashku me Allahun:

“Një sofi, për t'u mbushur me hare e për t'u kredhur në meditim, shkon në një kopësht të stolisur. Përballë bukurive të kopshtit, dehet. Pastaj i mbyll sytë dhe kridhet në vëzhgim të brendshëm dhe meditim.

Një person i paditur dhe indiferent që ndodhej aty, pandeh se sofiu fle. Ai habitet me gjendjen e sofiut, mërzitet dhe i thotë:

“Ç'fle, more? Hapi sytë dhe shih pjergullat e rrushit, pemët që kanë çelur lule dhe barërat që kanë jeshiluar, vështro veprat e mëshirës së Allahut!”

Edhe sofiu i jep këtë përgjigje:

“O i paditur e indiferent! Dije mirë këtë se vepra më e madhe e mëshirës hyjnore është zemra. Të tjerat jashtë saj janë si hije të kësaj vepre të madhe. Mes pemëve rrjedh një përrua. Në ujin e kulluar të tij sheh reflektimet e pemëve të të dy anëve...”

Ato që duken të reflektuara në ujë, janë një kopësht imagjinar. Kopshtet e vërtetë janë në zemër, sepse zemra është vendvëzhgimi hyjnor. Reflektimet e gjërave të bukura të kopshtit ndodhen në vendin e kësaj bote prej uji dhe balte!

Po qe se gjërat e kësaj bote nuk do të ishin reflektimi i selvisë së haresë në botën e zemrës, Zoti nuk do t'i thoshte kësaj bote imagjinare vend mashtrimi.

Në ajetin e 185-të të sures Al-i Imran thuhet:





“... Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër veçse një mall (shitblerjeje) që të mashtron!”

Të paditurit dhe indiferentët dhe ata që, duke e pandehur këtë botë xhennet (parajsë), thonë “ky është xhenneti (kjo është parajsja)!” , ngopen me pamjen që reflekton përroi.

Ata që rrinë larg prej kopshteve të vërteta, domethënë, larg prej të urtëve (evlijave), duke u prirë drejt atij iluzioni, vetëmashtrohen.

Një ditë, ky gjumë indiferentizmi merr fund. Sytë hapen, e vërteta duket. Por ç’dobi ka ajo pamje në frymën e fundit?

Ç’lumturi për atë që ka vdekur para se të vdesë, shpirti i të cilit ka marrë aromë nga e vërteta e këtij kopshti!..”

Me të vërtetë, po qe se dikush nuk u jep vlerë shijeve frymore (egoistike) të kësaj bote dhe i heq sytë prej saj, Allahu (xh.xh.) ia kullon shpirtin dhe ia ndriçon zemrën.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) pati thënë:

“Zemra brenda së cilës futet nur (dritë hyjnore), hapet dhe zgjerohet!”

E patën pyetur: “O i Dërguari i Allahut, cila është shenja e kësaj?”

Dhe ai u qe përgjigjur kështu:

“Të largohesh nga bota e përkohshme, t’ia japësh zemrën vendbanimit të ahiretit që është i përjetshëm dhe të përgatitesh për vdekjen para se të vdesësh!”
(Taberi, *Tefsir*, VIII, 37)

Njerëzit e Allahut të cilët janë udhëtarët besnikë të rrugës së nderuar të marifetit (njohjes së Allahut), me fjalë të tjera, zemrat e miqve të Zotit, janë si guaskat e sedefa që formojnë margaritarë të mëdhenj prej pikave të shirave të prillit. Ata nuk mungojnë t’i bëjnë, me favorin e Allahut, zemrat e papërpunuara që tregojnë afërsi ndaj tyre, guaska të sedefa margaritarësh, mjafton që këto kërkesa të mund ta dallojnë pikën e shiut që fshihet në guaskë!

Në kritikën e *Methnevisë* thuhet:

“Allahu që zotëron fjalën, i tha resë në vesh një të fshehtë dhe nga syri i resë u derdhën lot si nga tullumbi i ujit. I tha trëndafilin në vesh një të fshehtë dhe e zbukuroi atë me salltanete ngjyrash dhe aromash. I tha gurit në vesh një të fshehtë, e bëri atë rubin mes mineralit. Pra, duke u shfaqur me atributin “i këndshëm”, lëshoi ujë nga reja, trëndafilin e zbukuroi dhe gurin e bëri të çmuar.

Edhe trupit të njeriut i dha një të fshehtë dhe njerëzit e marifetit të cilët e ruajnë atë të fshehtë, i lartësoi duke u dhënë pavdekësi. Këta miq të Zotit që marrin frymëzim nga bota hyjnore, shpëtuan nga kurmi dhe arritën ta njohin të fshehtë e konfidencës ndaj Zotit.”

Pa asnjë dyshim, këto të fshehta janë e fshehta e dashurisë (muhabbet) e cila është mbështetje për njohjen (marifet) në gjendje shfaqjesh të





ndryshme, e fshehta e dashurisë (muhabbet), në klimën e begatë të së cilës është fshehur përkryerja dhe bukuria e çdo gjëje.

Në miqtë e Zotit të nivelit të lartë, shfaqjet individuale të dashurisë masivizohen e ngurtësohen. Dashuria individuale (personale) është kur dikush do (dashuron) në mënyrë të pavullnetshme dikë të vdekshëm dhe kur ngre një lidhje dashurie. Kjo dashuri është metaforike. Kurse dashuria individuale (personale) e vërtetë është një pasion i tillë ndaj Zotit dhe gjendja e shkrirjes (humbjes) në Të.

Miqtë e Zotit që janë të merituar të shfaqjeve të kësaj dashurie individuale (personale), nuk janë persona që gëzohen kur u jepet diçka dhe që u dobësohet dashuria kur persekutohen. Tregimi figurativ në vijim përbën një shembull të bukur të dashurisë individuale (personale).

Mevlana Xhamiu (k.s.) tregon:

Në rrethin e kuvendit të Plakut tonë Mevlana Sadeddin Kashgariut ishte një i ri. Te ky i ri, përkorësia, tërheqja në vetvete dhe pasioni hyjnor ishin në gradën më të lartë. Si unë, edhe ai ishte dhënë pas një bukurosheje të vdekshme. Kështu, vlerën që e kishte grumbulluar në zemër, brenda një çasti e kishte bartur në atë anë.

Kishte marrë një dhuratë prej ari dhe margaritarësh, e kishte lënë në rrugën nga kalonte ajo bukuroshja dhe ishte fshehur në një skaj me qëllim për ta ruajtur që të mos e merrte dikush nga kalimtarët e tjerë. Ia thoshte mendja se e dashura do të kalonte andej, do ta vinte re dhuratën dhe do ta merrte, por pa e ditur se nga kush dhe si. Kur e mora vesh si qëndronte puna, i thashë:

“Ç’punë të çuditshme që po bën! Gjënë e marrë me gjithë ato mundime po e lë në rrugën e saj! Edhe sikur ta shohë e ta marrë, ajo s’do ta dijë se nga kush është lënë aty dhe pse. Të paktën bëj diçka që ta dijë se e ka prej teje!”

Duke u dridhur e derdhur lot, m’u përgjigj:

“Ç’po thua? A mos pandeh ti se unë s’e di që po bëj një punë të çuditshme? Por unë nuk pres asgjë për këtë që po bëj. Sepse nuk dua që ajo të më mbetet nën detyrimin e mirënjohjes për dhuratën që po i bëj!”

Kjo përgjigje më bëri të dridhem. Po qe se dashuria metaforike për një vdekëtar shpalohej një thellësi, delikatesë dhe bukuri sjelljeje si kjo, kush e di se ç’shfaqjeve të larta të njohjes së Zotit (marifetullah) u bëhen vend reflektimi ata që meritojnë “dashurinë personale”!

Duke shpjeguar këto etapa të zemrës, Mevlana Xhelaleddin Rumi është shprehur se, në kulmin e diturive formale në medresenë selçukase, ka qenë “mësimdhënës” dhe, si gjendje, “i papjekur”. Pastaj, kur ka merituar shfaqjet e njohjes së Zotit (marifetullah) dhe të fshehtat në gjithësi kanë





filluar t'i bëhen të qarta, "është pjekur". Dhe, kur është humbur (shkrirë) në dashurinë individuale (personale), "është djegur"!

Arritja e njohjes intuitive e shpirtërore të Allahut (marifetullah), është e mundur vetëm me anë të një besimi të ngopur dhe duke fituar një kompetencë për shfaqjet hyjnore të aftë për t'u pranuar nga njohja njerëzore.

Allahu im! Na e mundëso ta plotësojmë me dinjitetin e duhur të drejtën e amaneteve që na ke favorizuar! Bëna ne zotërues të punëve të mira në atë gradë që në ahiret të meritojmë mëshirën tënde më të lartë! Na i bëj zemrat vend ku të reflektohen shfaqjet madhështore e të shkëlqyera të dashurisë për Ty! Dhe, duke na bërë ta njohim të fshehtën e "krijimit të përkryer" që ua fale robve të tu si shfaqje të dashurisë dhe mëshirës tënde, na i ringjall dhe na i zbukuro zemrat me vesën e mëshirës tënde!"

Amin, ashtu qoftë!





*M*eritimi i dhuntive hyjnore varet nga konsistenca³¹ e zemrës.



B. DHUNTITE HYJNORE³²

Të gjitha qeniet përveç Allahut janë krijuar me shfaqjen e atributit “Latif” (Favorizues) të Allahut, domethënë, me anë të favorit të Tij. Asnjëri nga krijesat nuk është bërë ekzistent me të drejtën e vet dhe duke paguar për këtë. Trupat e vdekshëm dhe relativë të qenieve si dhe të gjitha cilësitë dhe mundësitë të varura nga urtësitë e krijimit të tyre janë krejtësisht nga një dhunti hyjnore më vete. Kjo do të thotë se e tërë ekzistenca është identiteti i favorit, bujarisë dhe mirësisë së Zotit!

Ndërsa ekzistenca e çdo gjëje të krijuar dhe cilësitë që u janë dhënë atyre në zotërim, janë, në të vërtetë, nga një “dhunti hyjnore”³³, këtë shprehje ne e përdorim për meritimet-dhuratë³⁴ të atyre që kanë hyrë në rrugën e tasavvufit, mistikës islame, në raport me distancat që kanë kapërcyer ata në këtë rrugë. Personat me kapacitet ndër njerëzit e zakonshëm, duke përparuar në këtë rrugë, fillojnë të zotërojnë pa kaluar ende në jetën e pasme, ahiret, një sërë favoresh dhe aftësish të shquara. Edhe nëse në fillimin e këtyre meritimeve, me përdorimin e vullnetit të pjesshëm njerëzor, bëhet fjalë për një lindje të drejte (istihkak), meqë, në fund të fundit, favori është epror ndaj të drejtës së fituar (istihkak), është bërë zakon që këto të konsiderohen thjesht dhunti hyjnore duke e përdorur për to vetëm fjalën “mevhibe”, dhuratë, dhuntí. Sepse dallimi i madh këtu mes të drejtës së fituar dhe meritimit ka lindur prirjen për ta supozuar të drejtën e fituar (istihkak) si “të paqenë”. Kjo pikëpamje nuk është dhe fort e gabuar po të kihet parasysh se edhe mundësia personale si mbështetje për të drejtën e fituar (istihkak) është, në fakt, një dhuratë ose dhunti (mevhibe) hyjnore!

31 Në origjinal: kıvam, konsistencë: pjekuri, njëtrajtshmëri, përputhshmëri, qëndrueshmëri.

32 Në origjinal: mevhibe: dhuratat dhe favoret hyjnore.

33 Në origjinal: mevhibe-i ilahijje (osm.).

34 Në origjinal: vehbî olan nâilıyyetleri (turq).





Disa persona me kapacitet që arrijnë nivel shpirtëror me edukim mistik, në këtë udhëtim moralo-shpirtëror bëhen të merituar të shumë shfaqjeve përkryerjesh. Kështu, për disa miq të Zotit, urtësitë qartësohen dhe nyjet enigmatike zgjidhen një e nga një. Të panjohurat nisin të zbulohen, misteret, të triumfohen. Fanitjet dhe frymëzimet³⁵ në një zemër të paqëtuar (selim), e drejtojnë robin drejt Zotit dhe thelbit të së vërtetës. Me reflektimin në zemër të shumë të vërtetave të Levhi Mahfudhit³⁶ që i përkasin të ardhmes, shihen ëndrra besnike që vërtetohen (realizohen). Robi arrin një vështrim të zgjuar dhe një meditim të pjekur, me anë të të cilave parandjen në çdo gjë dëshirën volitive hyjnore.

Këto situata të arritura pas përpjekjeve të sinqerta vetëm si rezultat i favoreve dhe mirësive hyjnore, kanë edhe shumë forma shfaqjesh të tjera të ndryshme. Dihet se emërtimi si dituri i këtij meritimi është “ledunijat” (e dhënë nga Zoti). Edhe pse informacionet dhe dijet *ledunní* kanë një përmbajtje që e kapërcen njohjen dhe aftësinë përfshirëse njerëzore, ata që, me favorin dhe bujarinë e Zotit, bëhen pjesëtarë të kësaj diturie, arrijnë një njohje dhe intelekt përgjithësues në raport me përparimin që kanë shënuar. Dhe, tani, le të përpiqemi ta shpjegojmë përmbajtjen e *diturisë ledunní* me aq sa e lejojnë mundësitë njerëzore dhe oportunitetet fetare.



35 Në original: *sünûhât ve ilhâmlar*. Synuhat janë fanitjet apo manifestimet ndjesore-shpirtërore që ndodhin edhe zgjuar, edhe në ëndërr.

36 Tabela e Kujtesës; sipas konceptualitetit islam, në Levhi Mahfudh ruhet e shënuar e gjithë dija hyjnore duke përfshirë edhe fatin e njerëzve dhe të krijimit në përgjithësi.





Pasi ta dua robin tim, unë (pothuajse)
bëhemgjuha që i flet, zemraqë i ndjen,
veshi që i dëgjon, syri që i sheh, dora
që i zë dhe këmba që i ecën. Ia jap
patjetër ç'të më kërkojë. Po të mbështetet
te unë, e mbroj! (Buhari, *Rikak*, 38)



1. DITURIA HYJNORE (ilmu'l-ledun)

Kjo është një dituri e **bashkëlindur**³⁷ me njeriun, krejtësisht e dhënë e Zotit, e merituar vetëm me anë të favorit të Zotit.

Në Kur'an, për këtë dituri përdoret shprehja (مِنْ لَدُنَّا عَلْمًا) "**një dituri nga Ne, nga ana jonë**"³⁸. Nga kjo vjen edhe shprehja "**dituri hyjnore**"³⁹.

Në fakt, të vërtetat që Zoti ia ka bërë të ditura Profetit (s.a.s.), përbëjnë tri kategori. Nga këto, **të vërtetat e kategorisë së parë**, meqë mund të njihen vetëm me anë të dritës profetike, kanë mbetur si një e fshehtë mes Allahut të Lartë dhe të Dërguarit të Tij. Të vërteta të tilla Profeti (s.a.s.) nuk ia ka zbuluar askujt prej sahabeve, shokëve të tij.

Ekzistenca e të vërtetave të tilla mes Zotit dhe Profetit, zbulimi i të cilave është i palejueshëm e i pamundur dhe të cilat, edhe sikur të zbulohen, është e pamundur të kuptohen, merret vesh nga përmbajtja ose mënyra e shprehjes së disa haditheve profetike. Kështu, Profeti (s.a.s.) u ka thënë sahabeve:

"Po t'i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë!" (Buhari, *Kusuf*, 2; Muslim, *Salat*, 112).

Kurse në një hadith tjetër ka thënë:

"Ka çaste të tilla mes meje dhe Zotit, që nuk mund t'i kuptojë as ndonjë engjëll i afërt (i Zotit) dhe as ndonjë profet!" (Munavi, *Fejdu'l-Kadir*, IV, 8)

Është edhe **grupi i dytë i të vërtetave** të njoftuara Profetit nga ana e Zotit, të cilat mund të kuptohen saktë vetëm nga persona të aftë dhe kompetentë të lartësuar mendërisht e shpirtërisht, të mbiquajtur "të zgjedhurit" ose "të

37 Në origjinal: vehbí (*frëngj. inné*).

38 Origjinali i ajetit: min ledunná ilmá (Kehf, 65).

39 Në origjinal: ledünná ilim.





mbizgjedhurit''⁴⁰. Është një e vërtetë historike se të vërtetat e kësaj kategorie Profeti (s.a.s.) ua ka përcjellë disa sahabeve të mëdhenj, si Hz. Ebu Bekr dhe Hz. Ali. Pastaj, përcjellja e këtyre të vërtetave nga zemra në zemër është bërë traditë, sepse ekziston mundësia që, po të shkruhen, do të merren vesh edhe nga njerëz jokompetentë të cilët, për shkak se do t'i kuptojnë gabim, do të bien në gabime. Ndërkaq, personi i pajisur me kapacitetin e duhur në këtë drejtim, mban edhe po aq përgjegjësi. Për të mirën dhe shpëtimin e vet, personi është i detyruar ta përdorë dhe zhvillojë më tej kapacitetin e vet.

Të vërtetat e grupit të tretë të njoftuara Profetit nga ana e Allahut, janë të vërtetat kanunore⁴¹. Për njohjen e këtyre të vërtetave ka përgjegjësi besimore e praktike e gjithë bota njerëzore. Prandaj Zoti i ka përcaktuar këto të vërteta apo konkluzione duke mbajtur parasysh edhe njerëzit e nivelit më të ulët kulturor, në një mënyrë të mundshme për t'u kuptuar, besuar dhe zbatuar edhe prej tyre. Këto u duhen të gjithëve dhe i janë njoftuar botës për të caktuar përgjegjësitë e çdokujt.

Herë pas here, Profeti (s.a.s.) u bënte sahabeve sqarime mbi ngjarjet që kanë për të ndodhur gjer në kiamet, por shumica e sahabeve nuk i kuptonin dot, kurse një pjesë e tyre i harronin fare.⁴²

Por dihet se Profeti (s.a.s.) u ka njoftuar disa personave kompetentë, për të cilët folëm më sipër, një sërë të vërtetash të vështira për t'u kuptuar dhe se shumica e këtyre të vërtetave është përcjellë vetëm nga zemra në zemër. Sepse këto janë të vërteta jo vetëm të panevojshme për shumicën, por edhe që e kapërcejnë aftësinë rrokëse e njohëse të shumë vetëve. Është një traditë historike që vijueshmëria e njohurive të tilla mes njerëzve me kapacitetet përkatëse është realizuar jo me anë të komunikimit në masë, por shpesh nga zemra në zemër, pra, nga një individ kompetent në tjetrin.

Përveç Hz. Ebu Bekrit dhe Hz. Aliut, edhe Ibni Mes'udi, Ebu Hurejre, Muadh bin Xhebel dhe Harith bin Malik (r.anhum), nga sahabet, janë njohur me disa të fshehta të kësaj diturie të posaçme.



Allahu i Lartë u bën shumë favore të papara nga sytë e të pamatura dot nga mendjet zemrave të robve të cilët mbështeten siç duhet tek Ai, të cilët, vullnetin dhe dëshirat njerëzore ia nënshtrojnë vullnetit hyjnor. Zoti

40 Në origjinal: havâs, havâssu'l-havas.

41 Në origjinal: sher'í.

42 shih. Buhari, *Kader*, 4.





ynë i Lartë e ka bërë të ditur kështu në Kur'an se u ka favorizuar robve të tillë një dituri dhe urtësi të posaçme:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَتَّقُوا اللَّهَ يَجْعَل لَّكُمْ فُرْقَانًا وَيُكَفِّرْ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ
وَيَغْفِرْ لَكُمْ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ

“O ju që keni besuar! Po qe se druheni nga Allahu, Ai ju jep një furkan (një dituri, zgjuarsi dhe mendësi diferencuese mes së mirës dhe së keqes), ua mbulon mëkatet dhe ju fal, sepse Allahu është favorizues i madh!” (el-Enfal, 29)

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe besojini të Dërguarit të Tij që Ai t’ju japë dyfish nga mëshira e Tij dhe t’ju favorizojë një dritë, nën ndriçimin e së cilës të ecni...” (el-Hadid, 28)

Edhe në hadithin profetik është thënë:

“Atij që vepron me ato që ka mësuar, Allahu i Lartë ia mëson ato që s’di!” (Ebu Nuajm, *Hiljetu’l-Evlja*, X, 15)

Kurse një hadith kudsi ka këtë kuptim:

“Kush bën armiqësi ndaj një robi tim të urtë, unë i shpall luftë atij. Robi nuk mund të krijojë ndaj meje afërsi me ndonjë gjë më të pëlqyeshme se farzet (detyrimet) për të cilat e kam urdhëruar. Robi më afrohet mua pa pushim edhe me adhurimet suplementare (nafile) (të kryera përveç farzeve) dhe, më në fund, unë atë e dua. Dhe, pasi ta dua, bëhem veshi që i dëgjon, syri që i sheh, dora që i zë dhe këmba që i ecën. I jap ç’të më kërkoi dhe, po të mbështetet te unë, e mbroj!” (Buhari, *Rikak*, 38)

Siç shihet, adhurimet nafile të kryera me zemër me pasion, hare dhe ekstazë pasi të jenë kryer farzet me principialitet dhe sinqeritet duke respektuar etikën dhe elementët e tyre, përbëjnë pretekste për favore dhe mirësi të tilla të shkëlqyera të Zotit. Prandaj duhet të ruheni nga haramet dhe gjërat e dyshimta duke iu kundërvënë dëshirave të ulta të nefsit, dhe traditën profetike duhet ta bëjmë mënyrë jetese. Për të merituar këto favore, duhet t’i mbajmë kënaqësitë trupore në kufijtë e duhur dhe duhet ta zhvillojmë botën shpirtërore. Sepse kjo është një favor aq i madh, sa Zoti ia hap njeriut aftësinë njohëse të mbuluar me dobësitë njerëzore, ndaj të drejtës, të vërtetës dhe urtësisë. Në çdo qëndrim dhe lëvizje, njeriu hedh hap sipas vullnetit hyjnor. Ai arrin të bëjë vlerësime dhe parashikime të sakta. Shkaqet dhe pretekstet, pamjet sa për dukje nuk munden ta gënjejnë robin që e ka shkrirë vullnetin e vet në vullnetin e Zotit. Robi bëhet i aftë për të zbuluar fytyrën e brendshme të ngjarjeve dhe për të qenë parashikues.





Krahas vlerësimit dhe parashikimit të saktë me anë të frymëzimeve të ardhura në zemër, janë edhe mendimet e këndshme e të holla që vijnë në mendje dhe lindin në mendim, të cilat janë kuptime të brishta për njerëzit e zemrës, të cilat i njoftohen personit jo me fjalë, por shpesh me shenja dhe simbole. Këto janë quajtur **gjest** (gjeste)⁴³. Kuptimet përkatëse të shprehura me këto gjeste janë shenja dhe udhëzime të favorizuara nga Zoti i Lartë për robtë e Tij të mirë (salih) në rrugën e lartësimit moralo-shpirtëror.

Veç kësaj, Zoti mund t'u ndihmojë robve të mirë në gjendjet e vështira ku mund të kenë rënë, duke i paralajmëruar me anë të zërave të ardhura nga e panjohura. Kjo është quajtur **zë misterioz**⁴⁴, që do të thotë zë i ardhur fshehtas pa u kuptuar se nga dhe nga kush vijnë. Janë zërat që shfaqen në zemrën e udhëtarit të udhës mistike dhe që e ftojnë atë te Krijuesi.

Kjo ngjarje provon se dëgjimi i zërave misteriozë është i vërtetë.

Pas vdekjes së Profetit (s.a.s.), sahabet ranë në kundërshtim me njëri-tjetrin mbi çështjes se a duhej larë Profeti si njerëzit e tjerë gjer atëherë duke ia nxjerrë rrobat, apo mbi rroba. Atëherë, një zë nga e panjohura ka njoftuar se duhet larë pa ia nxjerrë rrobat.⁴⁵



Me ndërmjetësinë e profetëve, Allahu i Lartë u ka mësuar njerëzve “Librin”, “Urtësinë”⁴⁶ dhe gjërat e tjera që nuk i kanë ditur. Ky mësim është realizuar disa herë hapur dhe, disa herë, në mënyrë hyjnore me anë të frymëzimeve të ardhura drejtpërdrejt në zemër. Ndërkaq, këto situata, siç e shprehëm edhe më lart, ngaqë janë shfaqur me një cilësi të vështirë për t'u rrokur nga njohja njerëzore, janë bërë të panjohura për shumicën e njerëzve. Por fakti që dituria hyjnore (ilmi ledun) është e drejtë dhe e vërtetë, është e fiksuar në Kur'an dhe në traditën profetike.

Me të vërtetë, kjo ngjarje e treguar në Kur'an⁴⁷ dhe në disa hadithe të Profetit (s.a.s.), që ndodh mes Hz. Musait (a.s.) dhe Hizrit (a.s.), reflekton shkëndija të shkëlqyera nga përmbajtja e diturisë hyjnore.

Ushtria e Faraonit që ishte vënë në ndjekje të Hz. Musait dhe pasuesve të tij, ishte mbytur në Detin e Kuq mu në sy të tij të bijve të Izraelit. Pas këtij favorit hyjnor, Hz. Musai e mblodhi fisin dhe u bëri një predikim shumë oratorik dhe të zjarrtë. Zemrat e dëgjuesve u zbutën, sytë iu përplotën.

43 Në origjinal: latife (shum. letaif).

44 Në origjinal: hatif. Prandaj, edhe në arabishten moderne telefonit i thuhet “hatif”.

45 shih. Ebu Davud, Xhenaiz, 27-28; Ahmed b. Hanbel, VI, 267; Ibni Maxhe Xhenaiz, 10.

46 Në origjinal, përkatësisht, “Kitab”, “Hikmet”.

47 shih. Kehf, 60-82.





Njerëzit e fisit mbetën të mahnitur nga thellësia e diturisë dhe aftësisë predikuese të Musait. Njëri prej tyre, i dehur nga kjo bisedë, e pyeti:

“O lajmëtari i Zotit, a ka në botë njeri më të ditur se ti?”

I kënaqur shumë nga kjo lloj pyetjeje, Hz. Musai (a.s.), pa thënë “Zoti e di”, iu përgjigj:

“Jo, nuk njoh ndonjë të tillë!”

Në këtë mënyrë, Hz. Musai rrëshqiti ose bëri një gabim pa dashje⁴⁸. Zoti nuk e pa me vend përgjigjen dhe ia zbuloi Hz. Musait këto fjalë:

“Në vendin ku takohen dy detrat kam një robin tim që është më i ditur se ti. Atij i kam dhënë një dituri të posaçme (ledunnî - hyjnore)!”

Me dëshirën për ta mësuar këtë dituri, Musai tha:

“... do të shkoj pa u ndalur gjër në atë vendin ku bashkohen dy detrat dhe, po të duhet, do të eci me vite...” (el-Kehf, 60)

Pastaj doli në rrugë me të birin e motrës, Jusha bin Nun. Gjatë udhëtimit u përjetuan disa shfaqje. Më në fund, e gjetën njeriun që kërkonin. Ky takim përshkruhet kështu në Kur’an:

“Ndërkaq, gjetën një nga robtë tanë të cilit i patëm dhënë një mëshirë nga ana jonë dhe, gjithashtu, i patëm mësuar një dituri nga ana jonë!” (el-Kehf, 65)

Ky person i treguar Musait (a.s.) me anë të zbulesës, ndodhej i ulur mbi një shkëmb dhe hedhur sipër një hirkë jeshile. Hz. Musai iu afrua, e përshëndeti dhe i tha:

“Unë jam Musai.”

Hizri⁴⁹ (a.s.) i tha:

“Domethënë, ti je Musai, profeti i të bijve të Izraelit!”

Musai (a.s.) e pyeti:

“A ti je personi për të cilin jam njoftuar nga ana e Allahut se është më i dituri i njerëzve?”

Hizri (a.s.) iu përgjigj kështu:

“O Musa! Allahu të ka dhënë ty një dituri që s’është tek unë, kurse mua më ka dhënë një dituri që s’është tek ti!”

Atëherë, Musai i tha kështu Hizrit:

43 Në origjinal: *dhel’le* (lat. lapsus). Profetët janë të pafajshëm (inocentë), pra, nuk mëkatojnë, por ata mund të bëjnë gabime të vogla pa dashje, pra, mund të rrëshqasin. Këto gabime të përbëra nga fjalë dhe sjellje, tek ta ndodhin në mënyrë të pavullnetshme.

43 Në arabisht, fjala “hizër” (hidr) do të thotë “jeshil” ose “i jeshiluar”. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë: “Shkaku që Hizrit (a.s.) i është dhënë ky emër, është se, kur shtrihej mbi barëra të zverdhura, ato fillonin të jeshilonin!” (Buhari, *Enbija*, 27; Tirmidhi, *Tefsir*, 18; Dejlami, *Musned*, I, 345). Muxhahidi nga tabiinët, thotë: “Kur Hizri falte namaz, mjedisi përreth jeshilohej.” Siç kuptohet nga këto shprehje, ky nuk është emri i vërtetë i Hizrit, por një emër i dhënë atij më pas.





“A mund të lidhem pas teje që të ma mësosh edhe mua maturinë (diturinë dhe urtësinë që të çojnë te e vërteta) që ta ka mësuar Allahu ty?”
(el-Kehf, 66)

Në këtë mënyrë, Musai (a.s.) ia bëri të ditur Hizrit (a.s.) dëshirën për ta mësuar këtë dituri prej tij. Shihet se për marrjen e kësaj diturie, siç thuhet edhe në ajet, duhet që “nxënësi të lidhet pas mësuesit, ta ndjekë atë”, sepse dituria në fjalë do të kalojë nga zemra në zemër, gjë për të cilën kërkohet domosdoshmërisht një bashkëjetesë materiale-shpirtërore.

Musai (a.s.) kërkonte ta mësonte nga Hizri (a.s.) urtësinë e disa të vërtetave të pamundura për t’u kuptuar haptazi dhe drejtpërdrejt, të cilat atij i dukeshin të çuditshme. Por Hizri (a.s.) i tha:

“Ç’është e drejta, ti kurrë nuk do të mundesh të durosh duke qenë bashkë me mua! Si do ta durosh një dije që nuk ia njeh fytyrën e brendshme?” (el-Kehf, 67-68)

Në të vërtetë, me këto fjalë, Hizri (a.s.) bëri zbulimin e parë mbi gjendjen psikologjike të Hz. Musait dhe, gjithashtu, e njohu me të veçantën e vet, gjë që do të ndodhte në fund. Kjo dituri kërkonte një durim të madh, kurse Musai (a.s.) vinte nga një jetë shumë aktive. Mësimi që do të merrte Musai, ishte të shihte pozitën dhe dobësinë e vet përballë diturisë së të vërtetës hyjnore.

Kurse Hz. Musai (a.s.) me këmbëngulje i tha:

“Në dashtë Zoti, do të më gjesh të durueshëm. Nuk kam për të të kundërshtuar në asnjë punë!” (el-Kehf, 69)

Hizri (a.s.) i tha:

“Meqë do të më bindesh mua, po s’ të thashë gjë unë, s’do të më bësh asnjë pyetje!” (el-Kehf, 70)

Pastaj ecën së bashku përgjatë bregut. Më në fund, hipën në një gjemi që ishte pronë e dy vëllezërve. Hizri (a.s.) nisi ta shponte gjeminë e atyre njerëzve të mirë që s’u kishin marrë as pagesë. Musai (a.s.) i tha me emocion:

“A mos kërkon t’i mbysësh njerëzit e kësaj gjemie? Pse po e shpon gjeminë? Veç kësaj, të zotët e gjemisë janë të varfër, prej kësaj e nxjerrin bukën! Ç’kërkon nga gjemia e këtyre të shkretëve? Ç’është e drejta, bëre një punë shumë të çuditshme!”

Duke ia kujtuar paralajmërimin e mëparshëm, Hizri (a.s.) i tha:

“A nuk të thashë se nuk do të durosh dot të vish me mua?”

Atëherë, Musai (a.s.) i tha:

“Mos më kërko llogari për një gjë që e harrova, mos më nxirr vështirësi për këtë!”

Mu këtë çast, një trumcak u ul në anë të gjemisë dhe mori ujë nga deti me sqep. Duke ia treguar veprimin e trumcakut, Hizri (a.s.) i tha:





“Pranë diturisë së Allahut, dituria jote, imja dhe e të gjitha krijesave është sa uji që mori ky trumcak me sqep!”

Pas një kohe, ata zbritën nga gjemia dhe nisën të ecnin së bashku. Më në fund, takuan një djalë të cilin Hizri (a.s.) e vrau aty për aty. Musai (a.s.) i tha:

“Ja ku e vrave një jetë të pastër pa asnjë të drejtë! Me të vërtetë, bëre një punë shumë të keqe!”

Hizri (a.s.) iu drejtua përsëri me të njëjtat fjalë:

“A nuk të thashë se nuk do të durosh dot të vish me mua?”

I turpëruar shumë se nuk po e mbante dot fjalën e dhënë, Musai (a.s.) i tha:

“Po qe se të pyes për ndonjë gjë pas kësaj, mos më prano të të shoqëroj! Me të vërtetë, tani m’u mbaruan justifikimet që mund të nxjerr!”

Vazhduan të ecnin. Arritën në një fshat dhe kërkuan bukë nga fshatarët, por njerëzit e atij fshati jo vetëm që s’u dhanë gjë për të ngrënë, por edhe i trajtuan keq. Duke dalë nga fshati, Musai dhe Hizri panë një mur gjysmë të rrëzuar. Hizri (a.s.) e ngriti murin duke e thurur me qerpiç përsëpari. Kurse Musai (a.s.) i tha:

“Ti po u bën punë pa pagesë këtyre njerëzve që na pritën keq e s’na dhanë asgjë për të ngrënë! Po të deshe, mund t’u kërkoje shpërblim për këtë punë!”

Kurse Hizri (a.s.) i tha kështu:

“Tashmë erdhi koha të ndahemi nga njëri-tjetri. Tani do të të tregoj ty fytyrën e brendshme të tri ngjarjeve para të cilave ti u tregove i padurueshëm.

Gjemia që shpova ishte e njerëzve të varfër që bënin transport detar. Unë desha ta tregoj atë gjemi me të meta, sepse pas tyre ishte një mbret që grabiste të gjitha gjemitë e forta.

Djali që takuam, në të ardhmen do të bëhej njeri i ulët e i poshtër. Kurse prindërit i kishte të mirë. Unë pata frikë se mos ky fëmijë do të tregohej mosmirënjohës e do t’u shkaktonte mundime atyre. Unë desha që Zoti t’u falte atyre prindërve të mirë një fëmijë tjetër, të mëshirshëm e të mirë!

Kurse muri që ngrita, ishte i dy fëmijëve jetimë nga ai fshat. Babai i fëmijëve kishte qenë njeri i mirë. Nën mur ndodhej një thesar që u përkiste atyre. Zoti ynë dëshiroi që ata dy fëmijë të rriten dhe, si mëshirë nga Zoti i tyre ta nxjerrin thesarin. **As këtë veprim unë s’e bëra nga vetja.** Ja, kjo është fytyra e brendshme e ngjarjeve për të cilat ti s’u tregove dot durim!”⁵⁰





Mbi pikat e urta, mësimdhënëse dhe enigmatike të këtij rrëfimi janë thënë shumë gjëra dhe janë bërë shumë kritika. Disa prej mendimeve plot urtësi mbi këtë çështje mund t'i shprehim kështu:

Dituria hyjnore është vështrimi i ngjarjeve, përtej kushteve të jashtme (formale) dhe kriterëve njerëzore, me anë të kriterëve të një rregullsie të panjohur për shumë njerëz!

Për shembull, ndërsa në të gjitha dituritë, “pyetja” pranohet si çelësi më i rëndësishëm i mësimit, në diturinë hyjnore nuk ka pyetje, kundërshtim, diskutim dhe polemikë, përkundrazi, heshtje, durim dhe nënshtrim. Në këtë dituri shihen fundi dhe përfundimet e punëve. Ibrahim Haki shprehet kështu:

Zoti i bën të këqijat mirësi,
Mos pandeh se i bën tjetërkushi;
Kush kupton, atë vështron;
Të shohim Zotin se ç'bën:
Ç'të bëjë, bukur e bën!

Mos thuaj “pse kjo kështu”,
Ajo është siç është ashtu;
Prit, pa fundin e shikon;
Të shohim Zotin se ç'bën:
Ç'të bëjë, bukur e bën!

Në udhëtimin me gjemi, për të cilin flitet në rrëfim, vëllezërit e mirë (salih), pronarë të saj, nuk morën pagesë nga Hz. Musai (a.s.) dhe Hizri (a.s.). Në këtë mënyrë, vëllezërit u përballën me begatinë e madhe të një të mire të vogël të bërë miqve të Zotit. Me një dëm të vogël, anija e tyre shpëtoi nga grabitja. Pra, kapitali hallall me të cilin u bë një e mirë, nuk u humb.

Gjithashtu, fakti që duke u dëmtuar anija, u pengua grabitja e saj nga mbreti pirat, në kuptimin e vet sinjifikativ është interpretuar kështu: Po qe se njeriu e sheh si të pa të metë nefsën (egon) e tij që është anija që vozit në detin e jetëgjatësisë së tij, mund të bjerë moralisht dhe shpirtërisht në vorbullën e krenarisë dhe mendjemadhësisë, prandaj duhet të ruhet nga humbjet moralo-shpirtërore duke e pohuar vazhdimisht dobësinë dhe të metën e vet.

Edhe në vrasjen e djalit të pafajshëm nga Hizri (a.s.) ka urtësi. Dashurinë njerëzore por të pafajshme që njeriu ka në zemër për fëmijët, gruan, prindërit, vëllezërit dhe motrat, shokët e miqtë, duhet ta mbajë në nivelin e duhur pa e kaluar përtej dashurisë për Allahun, përndryshe, ajo e pengon njeriun nga synimi kryesor, madje, e nxjerr nga rruga.





Njëri nga emrat e lartë të Zotit është edhe **Rakib** (kundërshtar). Kjo do të thotë se, për robtë që do, Allahu i Lartë nuk pajtohet që në zemrat e tyre të bjerë qoftë edhe hija e dashurive të tjera mbi dashurinë ndaj Tij. Me fjalë të tjera, dashuria për Allahun nuk pranon ortak.

Mirëpo në kohën e tij, profeti Jakub (a.s.) e parandjeu dritën profetike në ballin e të birit Jusuf dhe në zemër i lindi një rrymë e fuqishme dashurie për të. Dashuria dhe pasioni i skajshëm i Jakubit (a.s.) për të birin preku durimin hyjnor. Prandaj Allahu i Lartë dëshiroi t'i jepte atij një vuajtje. Siç dihet, mes tij dhe të birit hynë vitet e gjata të ndarjes. Dashuria e tepërt pati si rrjedhojë një shkëputje të hidhur.⁵¹

Me rrugën e trashëgimit shoqëror, disa të vërteta të mëdha shndërrohen në mall konsumi të të gjithë popullit dhe reflektohen në produktet kulturore të përbashkëta të shoqërisë. Në të vërtetë, kjo ide e lidhur me dashuritë e idhujtarizuara është reflektuar në vargun popullor “dashuria e madhe sjell ndarje të shpejtë”!

Me të vërtetë, është shumë e urtë dhe mësimdhënëse që edhe prindërit e djalit që vrau Hizri (a.s.), sigurisht janë gëzuar kur u ka lindur djali, kurse janë mbytur në hidhërim kur u ka vdekur. Mirëpo, po të jetonte, djali do të shkatërronte, së bashku me të vetën, edhe jetën tokësore e shpirtërore të prindërve. Po qe se vendimi do të lihej në dorë të prindërve, ata kurrë s'do të deshin vdekjen e djalit. Por Zoti me mëshirën e tij të pakufishme, i cili e donte atë fëmijë më shumë se ç'e donin prindërit, duke ia marrë jetën atij e duke u dhënë prindërve në vend të tij një fëmijë tjetër të dobishëm, në të vërtetë i favorizoi prindërit. Ndërkaq, meqë fëmija vdiq ende i pafajshëm, edhe jeta shpirtërore iu ruajt së bashku me të prindërve. Pra, me anë të një favori të ardhur në trajtë persekutimi, është parapëlqyer dëmi i vogël ndaj një dëmi të madh.

E gjitha kjo do të thotë se vlerësimi i ngjarjeve nga njerëzit është përgjithësisht i gabuar ngaqë ata nuk e njohin urtësinë hyjnore.

Zoti ynë i Lartë thotë kështu në Kur'an:

وَعَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَعَسَىٰ أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ شَرٌّ لَّكُمْ
وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“... një gjë që s'ju pëlqen, shpesh mund të jetë e mbarë dhe e dobishme për ju, kurse një gjë që ju pëlqen, shpesh mund të jetë e keqe për ju. Allahu e di, ju s'mund ta dini!” (el-Bakara, 216)





Vrasja e një njeriu të pafajshëm është, natyrisht, një faj i rëndë dhe ligjërisht (kanonikisht) i ndëshkueshëm në të njëjtën masë dhe formë. Prandaj, shembulli i dhënë në këtë rrëfim, i realizuar në një mënyrë të pamiratur nga konkluzionet juridike (kanonike) dhe duke u mbështetur vetëm në dijen e brendshme, është i pazbatueshëm e i palejueshëm për bashkësinë muhammediane të ngarkuar me përgjegjësi për anën e dukshme të ngjarjeve dhe fakteve. Prandaj, edhe personat e mëdhenj të cilët zotërojnë diturinë e zemrës, nuk kalojnë në veprim pa u krijuar kushtet formale, nuk largohen nga bota e shkaqeve. Kufijtë e konkluzioneve juridike (kanonike) janë kritere të pashmangshme për të gjithë.

Musai (a.s.) është një profet me legjislacion dhe i ngarkuar me detyrën për ta vënë në zbatim atë. Kurse Hizri (a.s.) vepron brenda një dijeje të dhënë atij nga Allahu, pra, ato që bën, i bën jo me dëshirën e vet, por me urdhër të Zotit të vet. Prandaj, kundërshtimi i Musait (a.s.) ka për qëllim ruajtjen e kufijve të vënë nga Allahu. Është vetë Zoti ynë i Madh që ua bën të ditur njerëzve në Kur'an këtë ngjarje. Kjo do të thotë se, edhe nëse ngjarjet në këtë rrëfim duken, në pamjen e jashtme (formalisht) në kundërshtim me të vërtetat juridike (kanunore), janë, në të vërtetë, shfaqje të ndryshme që e plotësojnë njëra-tjetrën. Kur e mësoi të fshehtë të shfaqjeve, Musai (a.s.) e la kundërshtimin. Ai e kuptoi se sheriati (legjislacioni kanonik) është si trupi, kurse e vërteta, si shpirti. Meqë rregullat juridike i përfshijnë të gjithë dhe meqë shumica e njerëzve nuk i njohin të vërtetat e brendshme, përgjegjësia e njerëzve formohet vetëm sipas shkaqeve të jashtme.

Nga ana tjetër, fakti që, pavarësisht nga sjellja e keqe e fshatarëve, Hizri (a.s.) meremtoi një mur që i përkiste fshatit pa pritur ndonjë shpërblim, në të vërtetë ka për qëllim ta sqarojë se ç'detyrim i madh dhe ç'virtyt i lartë është mbrojtja e jetimëve. Veç kësaj, është edhe shprehje e të vërtetës se fitimi hallall nuk mund të humbasë. Me të vërtetë, fitimet hallall të robve të mirë (salih) mbrohen nga ana e Allahut, nuk humbasin.

H.z. Osmani (r.a.) jep këto të dhëna mbi thesarin e dalë nga poshtë këtij muri:

“Thesari ishte një tabelë e bërë prej ari. Mbi të ishin shkruar këto shtatë pika:

- 1) Çuditem me personin që, megjithëse e di se do të vdesë, qesh!
- 2) Çuditem me personin që, megjithëse e di se bota është e vdekshme, tregon interes për të!
- 3) Çuditem me personin që, megjithëse e di se çdo gjë është e caktuar me një kader (fat), dëshpërohet për gjënë që i ikën dore!
- 4) Çuditem me personin që, megjithëse e di se ka për t'u marrë në llogari, mbledh mall!





5) Çuditem me personin që, megjithëse e di zjarrin e xhehennemit, bën mëkat!

6) Çuditem me personin që, megjithëse e njih faktikisht Allahun, kujton tjetërkënd veç Tij!

7) Çuditem me personin që, megjithëse e njih faktikisht xhennetin, shpreson për rehati në këtë botë dhe që, megjithëse e njih shejtanin si armik, i bindet atij!" (Ibni Haxher el-Askalani, *Munebbihat*, 29)

Gjithashtu, në këtë rrëfim, në mënyrë sinjifikative, takimi i Hz.Musa (a.s.) me Hizrin (a.s.) në vendin ku takohen dy detrat, i tregon Hz. Musain det në diturinë formale dhe Hizrin det në diturinë e brendshme.

Lidhja e Hz. Musait (a.s.) pas Hizrit (a.s.) me qëllim për ta mësuar diturinë hyjnore është mjaft interesante për ngjashmërinë ndaj lidhjes dhe marrëdhënieve myrid-myrshid në tasavvuf. Nga ky këndvështrim mund të thuhet se dikush, edhe sikur të jetë i thellë sa Hz. Musai në dituri, kur të vijë puna për të mësuar një dituri që s'e ka, duhet që të përgjunjet me thjeshtësi dhe përvujtni para miqve të Allahut që janë mbretër të kuptimit, duhet të kërkojë orientimin e tyre!

E kanë pyetur Profetin:

"O i Dërguari i Allahut! Ç'të bëjmë kur të përballemi me një çështje, zgjidhjen e të cilës nuk e gjejmë në Kur'an dhe Sunnet?"

Dhe ai u është përgjigjur:

"Pyetini fakihët (të diturit) dhe abidët (adhuruesit) dhe kërkonin këshillën e tyre, mos veprojnë sipas mendimit tuaj vetiak!" (Hejthemi, *Mexhmau'z-Zevaid*, I, 178)

Dijetari, juristi dhe ideatori i madh imam Shafiiu, për të përfituar shpirtërisht nga Hz. Shejban Rai që ishte njeri i zemrës, binte në gjunjë me një etikë të madhe si nxënës para tij dhe këshillohej me të për disa çështje. Nxënësit e pyesnin:

"O imam! Kush është një dijetar si ti, e kush është Shejban! Ç'do të thotë ky respekt dhe kjo konsideratë kaq e madhe për të?"

Dhe imam Shafiiu iu përgjigjej:

"Bijtë e mi! Ky njeri di ato që s'i dimë ne!"

Edhe Ahmed b. Hanbel dhe Jahja bin Main e pyesnin Maruf Kerhiun për disa çështje.

Te mjeshtrit e kuptimit shkohet për të mësuar jo dituritë formale, por dituritë e zemrës, sepse ata janë prijës të rrugëve që çojnë te Allahu. Kështu, sa e sa dijetarë të mëdhenj të tefsirit, fikhut dhe hadithit kanë ndjekur tasavvufin, kanë bërë për prijës miqtë e Zotit për çështje të imta që nuk i kanë ditur. Si Ibni Abidini, Alusiu, etj.

Edhe njëri prej juristëve më të mëdhenj të botës, Imam Adhami Ebu Hanife, ka përfituar nga kuvendi i Hz. Xhafer Sadikut.





Kjo ngjarje që shpreh respektin e madh të Ebu Hanifesë për kompetentët moralo-shpirtërorë, është me shumë rëndësi.

Siç tregohet, një ditë, rruga e çoi Ibrahim bin Et'hemin, mik i Zotit, te Imam Adhami. Nxënësit përreth Ebu Hanifesë e vështruan Ibrahim bin Et'hemin në mënyrë nënvleftësuese. Ebu Hanife e vuri re këtë dhe i tha:

“Urdhëroni, imzot, mirëse erdhët, na e nderuat kuvendin tonë!”

Ibrahim bin Et'hemi u mjaftua duke përshëndetur me një pamje të turpëruar. Kur u largua, nxënësit e rrethuan Ebu Hanifenë dhe e pyetën:

“Nga ç’anë është i denjë ky njeri për ta nderuar kaq lart? Një person si ju, si i thotë atij “imzot”?”

Imami i madh Ebu Hanife u dha nxënësve këtë përgjigje që shprehte edhe thjeshtësinë e tij të madhe:

“Ai është i zënë vazhdimisht me Allahun, kurse ne, me llafet e kësaj pune...”



Nga ana tjetër, si në çdo specifike, edhe në marrjen e diturisë hyjnore duhen respektuar etika dhe elementët e vënë sipas caktimit hyjnor. Njëri prej rregullave më të rëndësishëm të kësaj etike është që robi të vishet me një thjeshtësi të vetëdijshme për dobësinë dhe asgjësinë e tij.

Kështu, Musai (a.s.) që është një ndër profetët e vendosmërisë së lartë dhe ka merituar titullin **Kelamullah**, të drejtën për t’u bërë bashkëbisedues i fjalës së Zotit, nuk ka thënë “më duhet të merrem me fisin tim dhe, për këtë, Teurati është i mjaftueshëm; fundja, unë jam bashkëbisedues i fjalës së Zotit, po t’ia kërkoj, ka mundësi të ma mësojë këtë dituri drejtpërsëdrejti...”, por duke shpalosur një thjeshtësi të thellë, i është nënshtruar vullnetit hyjnor. Në këtë mënyrë, i ka ofruar njerëzimit të së ardhmes një model nga përsosmëria e maturisë dhe sjelljes.

Edhe thënia e tij, **“për ta gjetur atë dijetar jam i vendosur të udhëtoj për vite të tëra”**, është një argument i hapur i kësaj. Kjo thjeshtësi e treguar nga Hz. Musai (a.s.) ndaj Hizrit (a.s.) është një model i bukur për këdo që kërkon dituri dhe aftësi shpirtërore.

Po të donte, Zoti i takonte menjëherë Hz. Musain me Hizrin (a.s.), por dëshiroi të takoheshin në fund të një udhëtimi të gjatë e me vështirësi. Kjo do të thotë se në këtë rrugë, brenda pasionit dhe ekstazës, duhet vendosmëri, qëndrueshmëri, zell si dhe favor hyjnor.

Në të njëjtën kohë, situatat e jetuara mes Musait dhe Hizrit tregojnë se edhe dituria e brendshme duhet marrë nga një mjeshtër në përputhje me shkaqet dhe metodën përkatëse. Pra, përgjithësisht, kjo dituri nuk arrihet dot pa shkak, pa udhëzues dhe pa prijës. Këtu bëjnë përjashtim vetëm ata





me karakter uvejsi⁵² si Vejsel Karaniu. Në këtë rrugë, për arritjen e synimit, ka nevojë për një vendosmëri të lartë dhe për një favor sublim.

Nga ana tjetër, fakti që Hz. Musai (a.s.) kërkoi të marrë dituri nga Hizri (a.s.), mund të sjellë ndërmend pyetjen: “Si mundet që një i urtë (veli) t’i japë mësim një profeti të madh?”

Ja, në këtë rast duhet parë me vëmendje specifika se fakti që Hz. Musai kërkoi të marrë mësim nga Hizri nuk do të thotë se Musai nuk zotëronte asnjë dituri dhe aftësi, se atij nuk i ishte favorizuar asnjë zbulim dhe frymëzim. Këtu kemi të bëjmë me rastin kur dikush merr mësim për një specifike nga dikush që është më i përgatitur në atë specifike.

Për shembull, kompetenca dhe aftësia e Arkitekt Sinanit në arkitekturë ka qenë, pa dyshim, më e lartë se e të gjithë mjeshtërve që kanë punuar në ndërtimin e xhamisë Sulejmanije. Ndërkaq, fakti që Arkitekt Sinani nuk dinte ta punonte mermerin sa një mjeshtër që punonte në atë xhami, nuk përbënte mangësi kompetence për të, sepse edhe mjeshtërit e mermerit punonin nën orientimin kompetent të tij në shkencën dhe mjeshtërinë e arkitekturës.

Nisur nga kjo, nuk mund të thuhet se Hizri (a.s.) ishte epror ndaj Musait (a.s.) vetëm pse qe për një kohë të shkurtër mësuesi i tij. Ndërkaq, këtu nuk kemi të bëjmë as edhe me një krahasim epërsie në vetvete, sepse, në vetvete, Musai dhe Hizri janë në pozita dhe drejtime aq të ndryshme sa që nuk mund të pranojnë krahasim. Urtësia në këtë çështje është t’i tregohet tërë njerëzimit se, para ditorisë hyjnore, të gjitha krijesat përfshi edhe profetët, janë të dobët.

Megjithëse janë njerëz, profetët janë persona të zgjedhur që kanë merituar të bëhen bashkëbisedues të zbulesës hyjnore. Këta rob të zgjedhur të Zotit nuk bëjnë mëkate. Ndërkaq, meqë janë edhe njerëz të dobët, rrallë mund të bien në gabime të quajtura rrëshqitje⁵³. Në këtë mënyrë, Zoti i bën ata ta shijojnë dobësinë e të qenit njerëz si për të qartësuar konkluzionin përkatës, si dhe për t’i bërë shembull për njerëzimin, dhe i edukon ata në një mënyrë cilësore shpesh të panjohur për ne. Edhe këtu, Musai (a.s.) do të kuptojë dobësinë e ditorisë që zotëron njeriu përballë pafundësisë së ditorisë hyjnore dhe do të shohë se ekzistojnë edhe shumë dije të tjera që nuk i janë njoftuar atij, ndërkaq që edhe njerëzimi i ardhshëm gjer në kiamet do të marrë shumë mësim nga rrëfimi për të.

Me të vërtetë, pavarësisht nga zotërimi i një fuqie dhe kompetence të madhe si profetësia, profetët, madje, kanë zotëruar njohuri aq sa u është

52 Në origjinal: Üveysî meşreb. Karakteri uvejsî (si i Vejsel Karaniut) konsiderohet karakteri i lidhjes dhe besnikërisë së lartë ndaj dikujt edhe në mungesë të tij.

53 Në origjinal: dhel’le.





dhënë si dhe kanë mundur ta njohin të fshehtën me aq sa ç'i ka favorizuar Zoti i Lartë. Edhe për sa i përket diturisë hyjnore (leduní), meqë kjo është e dhënë (vehbí)⁵⁴, ata dinë sa ç'u jep Zoti, jo më shumë. Kështu, siç përshkruhet në Gjylistanin e Saadiut, një person e pyet Hz. Jakubin:

"O profet i mençur me zemër të ndriçuar! E ndjeve kundërmimin e këmishës së Jusufit që nga Egjipti, po pse s'e pe dot Jusufin që po e hidhnin në pusin që e kishe mu pranë?"

Dhe Jakubi (a.s.) i përgjigjet:

"E dhëna hyjnore që meritojmë ne është si vetëtimat. Prandaj, në vartësi të dëshirës dhe vullnetit hyjnor, të vërtetat disa herë na bëhen të qarta, disa herë, na mbyllen!"

Kështu, duke i kërkuar mësim Hizrit (a.s.), Musai (a.s.) përdori shprehjen **"nga dituria që të është dhënë ty"**. Domethënë, dituria duhet t'i atribuohet Zotit e jo robve! Burimi absolut i të gjitha dijeve është Allahu i Madhnueshëm. Ai i fal nga ato atij që do dhe aq sa do. Për dhënie e disa dijeve bën si ndërmjetës disa shkaqe formale, kurse disa dije ia favorizon personalisht drejtpërdrejt zemrës së robit.

Nga ana tjetër, po qe se dikush që po agjëron, ha diçka për harresë, agjërimi nuk i priset. Krejt si kjo, kundërshtimi i Musait duke e harruar fjalën që i kishte dhënë Hizrit, nuk qe bërë pengesë për vazhdimësinë e udhëtimit të përbashkët të tyre. Mirëpo, megjithëse nuk ishte i detyruar ta bënte një gjë të tillë, Musai (a.s.) e kushtëzoi dijen që mund t'i vinte duke i thënë me emocion Hizrit (a.s.):

"Po qe se pas kësaj të pyes për diçka, mos më mbaj më pranë!" (el-Kehf, 76)

Kështu, dijet që mori ai mbetën të kufizuara me kaq!

Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë:

"Allahu e mëshiroftë Musain! Po qe se do të bënte durim, Allahu i Lartë do të na njoftonte me anë të tij ngjarje të tjera (të fshehta e të çuditshme)!" (Muslim, Fedail, 170; Buhari, Tefsir, 18/2)

Kjo do të thotë se, në këtë rrugë, durimi dhe maturia janë parim.

Njëri nga interpretimet e mistikëve lidhur me këtë rrëfim është kështu:

Siç rrëfëhet, i riu që e shoqëroi Hz. Musain në këtë udhëtim qe i biri i motrës dhe ndër të parët e atyre që i kishin besuar, Jusha bin Nun, i cili qe bërë zëvendësi i Hz. Musait pas vdekjes.

Edhe Profeti (s.a.s.) pati zgjedhur si shok rruge në udhëtimin e hixhretit Hz. Ebu Bekrin (r. a.) të cilësuar në hadithin profetik si *"i dyti i të dyve që kishin për të tretë Allahun"* (Buhari, As'habu'n-Nebi, 2) dhe personin më të

54 Pra, jo e fituar me mësim dhe përpjekje.





virtutshëm të ummetit. Këta shembuj e bëjnë të qartë rëndësinë e miqësive të vërteta për pëlqim të Allahut në rrugën moralo-shpirtërore.

Edhe ky rrëfim mbi Hz. Musain (a.s.), madje, i mbushur me një mijë e një të fshehta dhe urtësi, na shpalos neve vetëm disa shembuj nga përmbajtja e diturisë hyjnore!



Në një hadith, Profeti (s.a.s.) ka thënë kështu:

“Pa dyshim, unë i shoh ato që ju nuk i shihni dhe i dëgjoj ato që ju nuk i dëgjoni. Qielli pothuaj kërciti dhe është e drejta e tij të kërcasë. Sepse në qiell nuk ka katër gishta vend që një engjell të mos e vërë kokën për t’i bërë sexhde Allahut! Beto hem në Allahun që po t’i dinit të vërtetat që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë, do të dilnit nga shtëpitë e, duke u derdhur nëpër shkretëtirë, do t’i përgjërroheshit Allahut me zë të lartë!”

Ebu Dher Gifari (r.a.) që e përcjell hadithin, pas këtyre fjalëve ka thënë:

“Vallahi, unë u luta seriozisht të jem një copë dru i prerë!” (Ibni Maxhe, *Zuhd*, 19)

Përballë të vërtetave hyjnore (ledduní), edhe disa sahabë, ndjenjat e dobësisë në oqeanin e mahnitjes dhe tmerrit ku kanë rënë, i kanë ngarkuar mbi këto fjalë:

Hz. Ebu Bekri (r.a.): *“Sikur të bëhesha një kokërr hurma e çukitur nga zogjtë!”*

Hz. Omeri (r.a.): *“Sikur të bëhesha një fije bari! Sikur të isha asgjë!”*

Kurse nëna e besimtarëve, Hz. Aishe (r.anha) ka thënë: *“Sikur të isha një gjethe në këtë pemë!”*

Kjo gjendje që i përthyen më dysh ata përballë fuqisë dhe madhësisë së Allahut, është pozita e dobësisë dhe frikës⁵⁵.

Harith bin Malik el-Ensariu (r.a.) nga sahabët, shokët e Profetit, në kuvendin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) mbushej me emocion dhe jetonte në gjendje ekstaze. Një ditë në mëngjes, Profeti e pyeti:

“O Harithe, si u gdhive?”

Harithe (r.a.) iu përgjigj:

“Si një besimtar i vërtetë!”

Pas kësaj përgjigjeje, Profeti e pyeti kështu:

“O Harithe, çdo gjendje dhe e vërtetë ka një provë. Cila është prova e të vërtetës së besimit tënd?”

Harithe (r.a.) iu përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut, pasi hoqa dorë nga bota, ditët m’u bënë pa ujë e netët, pa gjumë. U bëra sikur ta shoh qartë arshin e Zotit tim. Jam sikur





i shoh ata të xhennetit që i bëjnë vizitë njëri-tjetrit dhe ata të xhehennemit që janë armiq të tyre!”

Atëherë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i tha:

“Kështu, o Harithe! Ruaje këtë gjendje! Ti je një njeri që Allahu ia ka ndriçuar dhe zbukuruar zemrën!” (Hejthemi, *Mexhmau'z-Zevaid*, I, 57)

Gjithashtu për Harithenë (r.a.), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

“Kush të dojë të shohë një person që Allahu ia ka ndriçuar dhe zbukuruar zemrën, le ta vështrojë Harithenë!” (Ibni Haxher, *el-Isabe*, I, 289)

Këtë ngjarje, poeti Mevlana e përshkruan në vargjet e tij me gjuhën e figurshme poetike në këtë mënyrë:

“Harithe (r.a.) kërkon leje nga i Dërguari i Allahut për t'ia treguar ç'ka parë dhe fillon të tregojë:

“O i Dërguari i Allahut! Ta nxjerr sheshit sot ditën e ringjalljes që njerëzit besojnë se do të ndodhë nesër! T'i zbuloj të gjitha të fshehtat e ngritjes nga varri dhe grumbullimit. Urdhëro t'i gris perdet e këtyre të fshehtave! Margaritari i urtësive hyjnore që kam përbrenda, të shkëlqejë si dielli i qiejve!”

O i Dërguari i Allahut! Urdhëro të tregoj se kush diti të mbetet si ari dhe perlat e vërteta mes zhulit dhe shëmtive të kësaj bote dhe kush u ndryshk me ngjyrën e kuqe e të zezë të mohimit!

Urdhëro t'i bëj të qarta nën dritën e pashuar të profetësisë të shtatë humnerat e dyfytyrësisë!

Urdhëro t'ia tregoj popullit rrobën që do të veshin hajdutët në ahiret dhe tingullin e daulleve që do të bien për profetët!

Urdhëro ta tregoj hauzin e Keotherit në gjendje të trazuar e të fryrë dhe uji i tij të spërkasë fytyrën e popullit dhe zhurma e tij të buçasë në veshët e popullit!

Të tregoj hapur se si vrapojnë përreth atij hauzi njerëzit e etur, se si supet e tyre prekin supet e mi dhe se si bërtitjet e tyre buçasin në veshët e mi!

Nga gëzimi, banorët e xhennetit takohen e përqafohen para syve të mi!

Kurse klithmat e dëshpëruara të banorëve të xhehennemit pothuaj do të m'i shurdhojnë veshët!

Këto janë një sërë shenjash që po i them nga thellësitë e shpirtit tim! Do të thosha edhe më, por kam frikë se mos më qorton i Dërguari i Allahut (s.a.s.)!..”

Kështu fliste ai i dalldisur në dehjen shpirtërore. Me një dalldi të paparë, e kishte humbur mendjen dhe ishte bërë gati t'i zbulonte të gjitha të fshehtat!

Për ta zgjuar nga kjo gjendje, Profeti (s.a.s.) e tërhoqi Hz. Harithenë për jake dhe i tha kështu:

“Eja në vete! Kapi frerët e gjuhës se u bëre të thuash fjalë që s'duhën thënë! Pasqyra e shpirtit të fluturoi jashtë këllëfit të trupit! Vetëm mos harro se t'i nxjerrësh sheshit të fshehtat që të janë besuar, do të thotë se nuk ke mundur t'i përvetësosh ato! Njëri nga emrat e Allahut është Settara (mbulues). Dije këtë dhe mos ia bëj fli lumturinë e pajisjes tënde me këtë cilësi një paaftësie përvetësimi të thjeshtë!”





Ashtu siç ka një ekuilibër hyjnor në çdo molekulë të gjithësisë, ashtu dhe njeriu, përballë shfaqjeve të botës shpirtërore, është i detyruar ta ruajë ekuilibrin dhe maturinë. Profeti ynë (s.a.s.) i cili është shembulli më i bukur në çdo drejtim për ummetin, bashkësinë e tij, edhe në pikën kulmore të lartësisimit shpirtëror, madje, nuk ka dalë jashtë mase, nuk e ka humbur orientimin.

Në disa kohë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) mbushej me një begati shpirtërore të tillë që ishte e pamundur ta duronte për një kohë të gjatë. Veçanërisht gjatë zbritjes së komunikimit hyjnor vuante jashtëzakonisht dhe djersitej shumë. Në disa çaste kur frymëzimi dhe ekstaza arrinin në kulm, kthehej në klimën njerëzore duke i thënë Hz. Aishesë:

"O Aishe, më pushtoi shpirti! Eja e bisedo pak me mua!"⁵⁶

Në të kundërt, kur dilte fituese bota materiale, e siguronte drejtpeshimin mes klimave njerëzore dhe shpirtërore duke i thënë Bilalit:

"O Bilal, Eja, na thirr në namaz që të lehtësohemi!" (Ebu Davud, *Edeb*, 78)

Siç qe tejet i matur në botën e brendshme, i Dënguari i Allahut (s.a.s.) edhe ndaj botës së jashtme është sjellë vazhdimi i ekuilibruar. Ai nuk ia pati treguar tjetërkujt veç kompetentëve të vërtetat e larta tej mendjes që ia pati favorizuar Allahu i Lartë. duke u mbështetur në rëndësinë e kësaj specifikë, Hz. Aliu (r. a.) ka thënë:

"Bisedoni me njerëzit në atë mënyrë që t'ju kuptojnë!" (Buhari, *Ilm*, 49) Kjo do të thotë që me njerëzit duhet folur jo gjer atje ku t'i arrijë mendja e folësit, por gjer atje ku ta rrokë mendja e tyre.

Ebu Hurejre (r.a.), në lidhje me këto të vërteta shpirtërore të fshehta, thotë se një sërë hadithe profetike nuk i ka përcjellë me drojtjen se populli s'ka për t'i kuptuar:

"Nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.), unë mësova përmendësh dy enë (plot me dije). Njëren prej këtyre e përhapja në popull, kurse po ta përhapja tjetrën, do të më pritej zverku!" (Buhari, *Ilm*, 42)

Profeti (s.a.s.) ka thënë kështu:

"Po t'ia jepni urtësinë tjetërkujt veç atij që e kupton, bëni padrejtësi!" (Darimi, *Mukaddime*, 34)

Me konceptimin e kundërt, kjo fjali do të thotë kështu:

"Po ta pengoni të fshehtën dhe urtësinë nga ata që e kuptojnë, bëni padrejtësi!"

Në ajetin kur'anor thuhet:

"Allahu ia jep urtësinë atij që do. Atij që i jepet urtësi, do të thotë se i jepen shumë mirësi. Vetëm ata që kanë mend, arsyetojnë dhe marrin mësim!" (el-Bakara, 269)





Njerëzit e mëdhenj e të matur, pjesën që u është dhënë nga dituria hyjnore nuk ua kanë propozuar mendjeve shterpë. Sepse këto të fshehta konfidenciale që mendja mbetet e paaftë për t'i rrokur, duhet të mbahen fshehur nga jokompetentët. Kështu, Hallaxhi Mansur⁵⁷ i cili i zotëronte këto të fshehta të posaçme që Allahu ua kishte favorizuar disa robve të vet, meqë zbuloi një tufë të vogël nga shfaqjet në zemrën e tij, mori dënimin kapital.

I kredhur në detin e unitetit të qenies dhe në një gjendje dehjeje dhe ekstaze, Hallaxhi Mansur u rrëmbye nga vorbullat e fuqishme e shfaqjeve dhe klithi: “Ene'l-Hak”, “Unë jam Zoti!” Derdhja në këtë mënyrë në fjalë e një të fshehte konfidenciale e intime u bë shkak që të matet me kriteret logjike të njerëzve dhe atëherë mendja nuk ka mundur ta masë këtë delikatesë.

Kjo gjendje e Hallaxhit është parë edhe tek shumë të urtë. Por kjo nuk është as përcaktim, as diagnostikim. Kjo është vetëm një gjendje kalimtare që shfaqet tek të urtët (velinjët) të cilët, duke qenë në pozitën fenafil'lah (shkrijë, humbje në Zotin), nuk e ruajnë dot kujdesin dhe maturinë, për pasojë, e humbin respektin ndaj arsyes. Në kushtet kur mendja (arsyeja) e braktis botën e kriterëve dhe analogjive të dukshme (formale e konkrete), pra, kur konsumohet, personit nuk mund t'i bëhet propozim (mocion) juridik, sepse sipas kriterit hyjnor, kushti i parë i përgjegjësisë ligjore-fetare është zotërimi i mendjes (arsyes). Kurse në fjalë dhe shprehje të tilla si ajo e Hallaxh Mansurit e përmendur më sipër, mendja (arsyeja) s'ka të bëjë aspak. Mendja (arsyeja) e ka krejtësisht të pamundur t'i kuptojë këto situata.

Meqë këto situata ndodhin kur fiton epërsi deliri⁵⁸, personave të tillë, me gjuhën e mistikës, u thuhet delirantë⁵⁹. Edhe nëse këto lloj situatash të tyre, të papërbalueshme nga kriteret formale, shihen të justifikueshme nga kompetentët, mospranimi i tyre nga njerëzit e zakonshëm nuk mund të

57 Është fjala për mistikun Mansur Pejzavi (857-922) i cili ka thënë shprehjen e famshme “enel hak” (unë jam Zoti) që u gjykua si blasfemi, për ç'shkak M. Pejzaviu u ekzekutua me vdekje.

58 Në origjinal: cezbe, emocion, entuziazëm dhe ekstazë mistike, gjendje delirante mistike.

59 Në origjinal: meczub, delirant. Është personi që e ka humbur mendjen përballë tërheqjes hyjnore, por i cili, në botën afektive, është i lidhur vazhdimisht pas Zotit. Edhe nëse personi në fjalë është përfshirë nga një gjendje e papranueshme e dënueshme për jetën njerëzore, për nga perceptimi afektiv dhe botëkuptimi i brendshëm (internal), ka kapërcyer shumë njerëz të zakonshëm. Është sikur të ketë rënë nën një tension të lartë të padurueshëm për vullnetin, aftësinë perceptuese, njohëse e logjike të njerëzve të zakonshëm. Këta njerëz janë edhe një nga shembujt në jetën njerëzore të dobësisë ndaj shfaqjeve të Individualitetit Hyjnor.





dënohet. Prandaj edhe për shprehjen përkatëse të Hallaxhi Mansurit është konkluduar në këtë mënyrë: “Edhe Hallaxhi ka të drejtë, edhe ata që e kanë ekzekutuar!” Është për këtë arsye që në tasavvuf, kujdesi dhe matura janë këshilluar shumë dhe është konsideruar e mirë dhe e pranueshme jo përpjekja për t’u bërë delirant, por tërheqës (interesant).

Siç rrëfëhet, xhelati Ebul Harith ka dalë para Hallaxhi Mansurit dhe i ka dhënë një goditje të fuqishme, aq sa viktimës i është bërë fytyra copë-copë. Në atë çast, Shibliu, duke u klithur atyre që i ndodheshin përreth me një motiv të pakuptueshëm, e ka copëtuar xhyben e vet dhe i ka rënë të fiktë.

Kjo shfaqje te Hallaxhi është një situatë. Pasi të kalojë kjo situatë, Zoti mbetet Zot dhe materia, materie. Sheh Shibliu thotë:

“Ne me Hallaxhin kaluam nga të njëjtat etapa. Mua më thanë “i marrë” dhe më lanë në hallin tim, kurse duke e quajtur atë të mençëm dhe veprimin e tij, të vetëdijshëm, e ekzekutuan!”

Prapë Shibliu tregon kështu:

“Pas ekzekutimit, natën, i shkova te varri. Aty fala namaz gjer në agim. Kur filloi të zbardhte, u përgjërova:

“O Zot! Ky ishte një robi yt besimtar dhe besnik ndaj individualitetit tënd të papërsëritshëm. Cila është urtësia e mynxyrave që i dhe këtij robit tënd?”

Në këtë mes, më rëndoi gjumi. Në ëndërr pashë se shpërtheu kiameti. Aty dëgjova këto fjalë të Zotit:

“I lëshuam në kokë këtë vuajtje sepse e përhapim të fshehtë tonë mes atyre që s’kuptojnë!”

Siç kuptohet edhe nga këto shprehje, është e pajustificueshme jo njohja e të fshehtës së të vërtetës duke qenë i shkrirë te Zoti, por zbulimi i saj për jokompetentët (për ata që s’kuptojnë) në gjendjen e dehjes shpirtërore ku mund të zvarrisë e fshehta e besuar. Të folurit poshtë e lart për mistikën e vërtetë dhe miqtë e Zotit duke i përgjithësuar disa teprime emocionale dhe raste përjashtimore të buruara nga mosrespektimi i këtij kriteri, është tejet i pajustificueshëm e i dëmshëm. Thënia e fjalëve të këqia për robtë e dashur të Zotit dhe mosmiratimi i vlerës së tyre shkaktohet nga injoranca dhe mungesa e tejpamësisë. Kurrë nuk mund të mendohet që një besimtar të mos i pranojë ata!

Prandaj, parimi më themelor në rrugën shpirtërore është lidhja e ngushtë pas kriterëve të shenjta, por edhe moskundërshtimi i të fshehtës së përjetshme. Krahas kësaj, duhet që kurrë të mos mos u jepet pjesë fjalëve nga të fshehtat konfidenciale dhe intime mes Zotit dhe robit të Tij.

Të gjitha këto janë shfaqje të jetuara në situatat e ekzstazës shpirtërore dhe përtej mendjes (arsyes). Me të vërtetë, kur këto situata të posaçme





kapërcehen dhe bëhet rikthimi në gjykimin e shëndoshë, ky tip teprimesh ia lë vendin qetësimit dhe heshtjes.

Ndërkaq, disa miq të Zotit, nën efektin e shfaqjeve përjashtimore që kanë mbisunduar në shpirtrat e tyre, janë zvarritur në një sërë sjelljesh jo të zakonshme. Por pasi janë zgjuar nga ajo botë ku mendja (arsyeja) dhe vullneti ikin dore, kanë vazhduar përsëri në orientimin e tyre bazë.

Një radhë, Xhunejd Bagdadin (k.s.) e pyetën:

“Disa të urtë (evlija), duke rënë në ekstazë, dalin jashtë të zakonshmes. Ç’thoni për këtë gjendje të tyre?”

Xhunejd Bagdadi (k.s.) dha këtë përgjigje:

“Lërin ata në hallin e tyre të kënaqen me Allahun e të qetësohen. Mos i dënoni ata përveç rasteve që sheriatit i ndalon haptas. Kini parasysh se kjo rrugë ua ka përcëlluar zemrën, zelli dhe përpjekja i ka lodhur dhe kanë përballuar shumë mundime. Këto ata i bëjnë për t’i kapërcyer situatat ku ndodhen. Dhe në këtë nuk ka ndonjë të keqe!”

Siç rrëfëhet, kjo lutje e bërë nga Hallaxhi Mansuri para ekzekutimit shpalos, në të njëjtën kohë, edhe nivelin e tij shpirtëror, principialitetin dhe sinqeritetin e tij:

“Allahu im! Robtë e tu janë mbledhur për të më vrarë të nisar nga afërsia ndaj Teje dhe besnikëria ndaj fesë. Fali ata! Sepse, po t’ua kishe favorizuar edhe atyre të fshehtat që m’i favorizove mua, nuk do të mendonin kështu për mua! Po t’i kishe fshehur edhe prej meje ato që ke fshehur prej tyre, unë nuk do të kisha bërë një denoncim të tillë. O Zot, fali ata, sepse ata po më çojnë mua në bashkimin me Ty!”

Thuhet nga ata që e kanë soditur gjendjen e Hallaxhit në botën e kuptimit, kur e prunë pranë trekëmbëshit, djalli i erdhi pranë dhe e pyeti:

“Ti the një **“ene”**⁶⁰, një **“ene”** thashë dhe unë. Si bëhet që për këtë shkak mbi ty bie mëshirë, kurse mbi mua, mallkim?”

Hallaxhi i dha djallit këtë përgjigje:

“Duke thënë **“ene”**, ti e pe veten mbi Ademin, tregove mendjemadhësi, kurse unë thashë **“enel Hak”** dhe e shkriva veten te Zoti. Mendjemadhësia që është egoizëm, është shenjë xhehennemi, kurse mohimi i egoizmit, domethënë shkrirja e qenies tënde te Zoti, është shprehja e qenies **“asgjë”**. Për këtë shkak, mua më zbriti mëshirë, kurse ty, mallkim dhe poshtërim!”

Ibrahim bin Fatik thotë se, kur shkoi për t’i bërë vizitë Hallaxhi Mansurit, ai i dha këto këshilla:

“Biri im! Disa njerëz besojnë në mohimin (kufr) tim, kurse disa janë të bindur për shenjtërinë (urtësinë) time. Ata që shpallin blasfeminë⁶¹ time,

60 Në arabishte, **“ene”** është përemri vetor **“unë”**.

61 Me fjalën **“kufr”** këtu kihet parasysh pikërisht blasfemia e Hallaxhi Mansurit, për të cilën ai u akuzua dhe u ekzekutua.





janë më të mirë para Zotit dhe vështrimit tim se ata që thonë se unë jam shenjtor (veli, i urtë)!”

Ibrahim bin Fatik i tha:

“Pse thua kështu?”

Hallaxhi Mansur iu përgjigj:

“Ata që besojnë se jam shenjtor, bëjnë kështu si pasojë e opinionit të mirë për mua, kurse ata që janë të bindur për blasfeminë time, e kanë nga besnikëria ndaj fesë. Personi që tregon besnikëri ndaj fesë është më i mirë në lartësinë e Allahut se ai që vetëm ushqen opinion të mirë!”

Kurse Hz. Mevlana që kalon shumë më tej se shfaqjet tek Mansuri, ka thënë:

“Edhe Hallaxhi, po qe se do të kishte dijeni për shfaqjet mes meje dhe Zotit tim, do të më zinte me gurë!”

Kjo dhe situatat e ngjashme janë shprehje të shpërthyer jashtë të shkrirjes dhe humbjes në Zotin. Këtë dukuri, poeti Mevlana e përshkruan në mënyrë të figurshme në vargjet e tij kështu:

“Kur ta shohësh lumin e jetës së pasosur, ujin që ke në qase, domethënë këtë jetë të shkurtër e të vdekshme, bashkoje me lumin e pavdekësisë! A ikën uji nga lumi?

Kur uji në qase të përzihet me ujin e lumit, shpëton nga qenia e vet dhe bëhet ujë lumi!

Atëherë, cilësitë e ujit të qases zhduken, por vetë mbetet dhe, pas kësaj, as pakësohet, as fëlliqet, as merr erë!”

Meqë ata si Mevlanai e të tjerë që kanë një zemër të gatuar e të ardhur në atë konsistencë shpirtërore, i kanë të gjitha ndjenjat dhe mendimet të kthyer e të prira ndaj urtësisë hyjnore, Zoti bëhet pothuaj syri i tyre që u sheh, dora që u zë...

Një mendimtar i dashuruar pas Mevlasasë, duke shprehur faktin që shumica e njerëzve janë të paaftë për t’i kuptuar situatat e tij të brendshme, thotë:

“Ne i kemi dëgjuar klithmat e ekstazës së Mevlana Xhelaledinit, por s’është e mundur t’i shohim thellësitë e detit të kënaqësisë dhe prehjes ku është zhytur, kurse shohim atë çka ai, duke u shkëputur nga fundi i detit, nxjerr në sipërfaqe. Ne rrokëm jo pasionin e Mevlasasë por vetëm klithjet me fjalë të atij pasioni. Kjo është gjithçka që u përpoqëm të shprehim me gjuhën tonë thuthuqe. Në detin e kënaqësisë dhe prehjes vetëm ai u kredh, kurse neve na mbetën zërat e dala nga furtuna e ekstazës së tij. Ajme, sa keq! Ne i pandehim ato për Mevlana!”⁶²





Pasioni dhe ekstaza janë oqean, janë një variacion hyjnor i njohur vetëm për ata që e njohin.

Po kështu, Muhjiddin Arabiut i cili një pjesë të kësaj diturie enigmatike e ka reflektuar në rreshta qoftë edhe në mënyrë simbolike, njerëzit e Allahut i kanë dhënë vlerë të madhe, kanë soditur të vërtetat e pakufishme në brendësinë e shprehjeve me fjalë dhe e kanë quajtur dhe përmendur atë si "Shehu i Madh". Kurse formalistët, ata që ndodhen jashtë dhe larg botës së brendshme, meqë nuk e kanë zgjidhur dot këtë ide, e kanë akuzuar atë për blasfemi!

Po qe se të mungojnë shokë e miq që të t'i durojnë dhe pranojnë të fshehtat, është më mirë të heshtësh. Sepse çdokujt i duhen thënë fjalë me aq sa t'ia rrokë mendja, ndryshe, t'i flasësh për urtësinë (hikmet) dhe aftësinë shpirtërore të njohjes së Zotit (marifet) dikujt që nuk kupton nga situatat shpirtërore, do të thotë ta përdhunosh të vërtetën!

Prandaj, Muhjiddin Arabiu (k.s.) ka thënë:

"Ata që nuk na kuptojnë, të mos i lexojnë veprat tona!"

Edhe Hz. Mevlana thotë kështu:

"Unë e thashë këtë të fshehtë në mënyrë të mbyllur e të përmbledhur, sepse, përndryshe, edhe gjuha e atij që do të përpiqej të bënte një shpjegim të gjerë, edhe mendja e dëgjuesit do të digjeshin!"

Gjithashtu, në *Mesnevinë* e tije cila u ofrohet mundësive dhe kapaciteteve tejet të ndryshme nga njëra-tjetra, poeti dhe mistiku Mevlana, me qëllim që mendjet e ngushta dhe shterpë të mos bien në rrugë të gabuara, të fshehtat hyjnore dhe të vërtetat abstrakte të vështira për t'u kuptuar ose i ka treguar me anë të rrëfimeve të thjeshta e konkrete, ose ua ka bërë të njohura vetëm kompetentëve duke i fshehur pas simboleve. Kështu, para syve të atyre që s'kanë thellësi afektive, ka ngritur pengesa që të mos i shohin dot delikatesat në kuptimet e *Mesnevisë*!

Mevlana Xhelaleddin Rumi (k.s.) thotë kështu:

"Vargjet e mia nuk janë vargje, por një botë kuptimesh. Edhe satira ime nuk është satirë, por moralizim. Rrëfimet e mia nuk janë fjalë të thjeshta e të zakonshme, por mësim. Të fshehtat e tyre kanë për qëllim të shpjegojnë e qartësojnë dhe t'i bëjnë të tjerët të kuptojnë!"

Hz. Omeri (r.a.) e tregon kështu një ngjarje të përjetuar nga ai vetë:

"Një ditë hyra te i Dërguari i Allahut Bashkë me Hz. Ebu Bekrin po bisedonin mbi unitetin hyjnor. Edhe unë u ula pranë tyre. Sikur të isha dikushi që s'di arabisht, nuk kuptova asgjë nga fjalët e tyre. Pastaj e pyeta Ebu Bekrin:

"Ç'do të thotë kjo? A kështu bisedoni gjithmonë ju me të Dërguarin e Allahut?"

Ebu Bekri m'u përgjigj:





“Po, disa herë, kur ndodhemi kokë më kokë me të Dërguarin e Allahut, kështu bisedojmë!”⁶³

Po qe se një njeri i nivelit të Hz. Omerit, për gjeninë e të cilit nuk mund të kihet dyshim, e ka pasur të vështirë ta kuptojë një bisedë të zhvilluar në gjuhën e nënës, mund të kuptohet lehtë se në ç’gjendje do të ndodheshin njerëzit e zakonshëm!

Ja, pra, nuk është dëshiruar që të vërtetat e shprehura në biseda të tilla të hidhen në rreshta të shkruar dhe, në këtë mënyrë, t’i përcillen publikut të gjerë, duke e parë një mundësi të tillë si tejet të pajustificueshme. Vetëm në këtë mënyrë është siguruar që të vërteta të tilla të mbeten të fshehta për njeriun e thjeshtë, ndërkaq që u janë përcjellë vetëm kompetentëve. Prandaj, kur flitet për njerëz që pandehet se kanë arritur përkryerjen shpirtërore, përdoret shprehja *قَدَّسَ اللهُ سِرَّهُ* “Allahu ia shenjtëroftë të fshehtën”.⁶⁴



Duke u nisur nga qëllimi dhe synimi përfundimtar i vet, tasavvufi ose mistika islame, meqë merret me botën afektive të njerëzve, në mënyrë të natyrshme është i detyruar ta përdorë edhe **dashurinë (muhabbet)**⁶⁵ e cila është shkak i krijimit të gjithësisë. Prandaj, tasavvufi është cilësuar edhe si **“rrugë e dashurisë dhe pasionit”**. Ndërkaq, meqë pasioni mistik për të cilin bëhet fjalë, është një entuziazëm, mund të pasojë në mënyrë të bashkënduar një rezultat të tillë si dobësimi i vullnetit, moskontrollimi i tërheqjes, ekstazës dhe emocionit.

Një shembull nga dashuria dhe afektiviteti i thellë mes të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe Xhafer Tajjarit (r.a.) është kështu:

Xhaferi (r.a.) u kthye në Medine së bashku me grupin që kishte emigruar në Etiopi. Me të mësuar se Profeti (s.a.s.) ndodhej në Hajber, pa qëndruar të pushonte, u nis me mall për atje. Kur e pa Xhaferin para vetes, Profeti, i mbushur me gëzim, i tha:

“Për se të gëzohem, për fitoren e Hajberit, apo për ardhjen e Xhaferit?” (Ibni Hisham, *es-Sire*, IV, 3)

Në kthim nga “umreja e shtyrë”⁶⁶, pas këshillimit me të afërmit mbi çështjen se kush do ta merrte përsipër kujdesin për Fatimen, vajzën jetime të kryedëshmorit Hamza, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ia la amanet

63 Për njohuri, shih Ahmed bin Abdullah et-Taberi, *er-Rijadu'n-Nadra*, II, 52.

64 Kaddasallahu sirrehu. Kuptimi i perifrazuar: Allahu ia mbajttë të pastër të fshehtën, botën e brendshme, nga çdo njollë moralo-shpirtërore!

65 Jo dashurinë sensuale por afeksionin shpirtëror.

66 Në origjinal: *umretu'l-kaza*. Profeti (s.a.s.) pati bërë nijet (qëllim) që të bënte umre në Qabe atë vit kur u nënshkrua Pakti i Hudejbijes, por nuk e realizoi dot. Ai e kreu atë umre si kaza (të shtyrë) një vit më vonë.





atë Xhafer Tajjarit dhe, duke e puthur në ballë, i tha duke i shfaqur një konsideratë të lartë:

"Sa më përngjet mua nga krijimi dhe morali!" (Buhari, *Megazi*, 43)

Para këtij komplimenti profetik, Xhaferi (r.a.) u emocionua aq shumë, sa, nga gëzimi i fuqishëm, e kapërceu vetveten. Si një fëmijë, nisi të luante e të rrotullohej si fluturat! (Ahmed b. Hanbel, *Musned*, I, 108)

Ja, pra, i tillë është njeriu! Ashtu siç mund të dehet e ta kapërcejë vetveten nga një kompliment i tillë i lartë por, në fund të fundit, njerëzor, fare mirë mund të shmanget nga bota materiale e të bjerë në ekstazë para favoreve në formën e shfaqjeve hyjnore! Kjo është krejt e natyrshme! Ndërkaq, e rëndësishme është që, qoftë edhe brenda atij rrebeshi emocional, të mos shpërthejë jashtë kushteve të pamënjueshme të të qenit njeri, ta ruajë ekuilibrin dhe orientimin!

Për ruajtjen e këtij ekuilibri në rrugët mistike, është nevoja e prijesisë dhe udhëzimit të njerëzve që kanë bashkuar në vetvete dijet formale me jetën shpirtërore.

Po qe se ata që janë ngarkuar me detyrën e orientimit nuk arrijnë forcën dhe nivelin e duhur në dijet formale, rreziku në rrugën e dashurisë dhe pasionit shpirtëror është përsëri i madh. Për ta mënjanuar dhe eliminuar këtë rrezik, në disa tarikate si nakshibendizmi, është bërë traditë që myrshidët (prijësit) të jenë njerëz që i njohin edhe dijet formale dhe, kështu, ata kanë mundur ta ruajnë veten nga rreziku në fjalë.

Metodat e edukimit të njerëzve të urtë të Zotit (evlijauallah) janë të ndryshme. Nakshizmi si një ndër rrugët e mëdha të tasavvufit ose mistikës islame, e edukon nxënësin ose udhëtarin e udhës mistike pa e rrezuar në gjendje deliri. Abdulhalik Guxhdevani thotë kështu:

"Po qe se Hallaxhi do të ndodhej në kohën dhe nën edukimin tonë, me lejen e Allahut, do ta ruanim nga rënia në delir!"

Kurse shpërthimet dhe teprimet emocionale që duken herë pas here në disa tarikate për shkak të intensitetit të entuziazmit dhe delirit, në vështrimin e shariatit përbëjnë "rëshqitje këmbë"⁶⁷. Këto tregojnë rrezikun që mund të lindin në teprim emocional dhe entuziazmi të cilët, në të vërtetë, janë të pranueshëm.



Është e qartë se, përveç cilësive të përbashkëta, profetët kanë edhe një sërë veçantish të posaçme për secilin. Në këto raporte janë edhe njerëzit e urtë të Zotit (evlijauallah) ndaj njëri-tjetrit. Për shembull, mund të kenë karakter të ashpër apo të butë, por që të gjithë, në botën e zemrës ose afektive,

67 Në konceptualitetin e së drejtës civile, kjo është ekuivalente me kundërvajtjen.





e njohin Zotin shumë ndryshe nga aftësia njohëse dhe përfshirëse e njeriut të zakonshëm dhe, duke u shmangur nga të gjitha gjërat e vdekshme dhe vetë vdekshmëria, përqipen me zell për t'iu afruar Atij. Në këtë fushë të pafund e të paanë të njohjes intuitive e shpirtërore të Zotit (marifetullah), janë vazhdimisht të vetëdijshëm për dobësinë e tyre. Ndërkaq, të gjithë këta, jo vetëm që s'ndodhen në të njëjtën etapë, por as nuk janë të ngarkuar me të njëjtën detyrë! Disa, në fund të rrugës mistike, kthehen te populli me përgjegjësinë për ta orientuar atë. Ashtu siç e kemi shprehur edhe më parë, si mësuesi që i jep mësim të shkallëzuar një fëmije, në marrëdhëniet njerëzore sillen sikur shumicën e të vërtetave që zotërojnë, nuk i dinë. Në mënyrë emfatike, njohja e diçkaje dhe sjellja e rezervuar pa e shfaqur atë njohje, shprehet si “padituri e kulturuar”⁶⁸.

Disa të tjerë, ngaqë nuk ngarkohen me detyrën e orientimit, vazhdojnë të mbeten në pozitën e mahnitjes dhe në gjendje qetësie të vazhdueshme. Këta janë si të pagojë përballë rrymave të fuqisë hyjnore. Kurse disa të tjerë të ngarkuar me detyrë përballë njerëzve, pothuajse kthehen në përrenj të rrëmbyer. Nga gjuha dhe zemra nisin t'u shpërthejnë të fshehtat dhe urtësitë hyjnore.

Gjithashtu, te disa të tjerë, këto situata nuk janë të vazhdueshme, por të ndërrueshme. Në jetën e tyre ndodhin faza të ndryshme. Si një shembull i këtyre situatave, njëra prej shfaqjeve tek Muhammed Parisa është kështu:

Muhammed Parisa, pas namazit të jatsisë qëndronte pak në oborrin e xhamisë dhe, pas një bisede të shkurtër, nisej për në shtëpi. Kurse disa herë, i shfaqeshin gjëra të tilla që pothuaj mbetej i ngrirë në oborrin e xhamisë gjer në namazin e agimit dhe atëherë hynte sërish në xhami. Gjatë kësaj kohe ai përjetonte një gjendje mahnitjeje të thellë.

Si mënyra e jetesës dhe afektiviteti i këtyre të urtëve (veli), ashtu dhe qëndrimet e tyre ndaj vdekjes kanë qenë të ndryshëm. Për shkak të përvëlimit me ashkun hyjnor, Mevlanai e ka konsideruar vdekjen si “takim me Zotin” dhe “nata e parë e martesës”, kurse Hasan Basriu (k.s.), për shkak të mbizotërimit tek ai të shfaqjes “hashjetullah” (frika nga Allahu), vazhdimisht pati jetuar me drojtjen se ç'do t'i ndodhte në frymën e fundit

Të gjitha çka dimë mbi diturinë hyjnore (leddunî), janë thërrime nga shfaqje të kësaj diturie të transformuara në fjalë para së gjithash te profetët dhe, pastaj, qoftë edhe pak, te robtë e zgjedhur të Zotit. Meqë e vërteta absolute e kësaj diturie ndodhet te Zoti, konceptimi i saj me kuptimin e vërtetë të fjalës është përtej kufijve të njohjes sonë!





Firaset është mundësia për t'i vëzhguar gjërat pas perdes, domethënë, të fshehtat e botës përtej. Sepse ata që munden të shohin brenda guaskës së sedeftë, dallojnë margaritarin!



2. ZGJUARSIA (firaset)

Firaset është një nur (dritë hyjnore) që Allahu i Lartë ua ka favorizuar zemrave të robve të dashur të Tij. *Firaset* është realizimi tek besimtari si një aftësi njohëse shpirtërore i cilësive, si mençuria, zgjuarsia dhe inteligjenca e lartë, parandjenja dhe parashikimi, kuptimi dhe gjetja (njohja).⁶⁹ Është parashikimi dhe përcaktimi i drejtë (i saktë) i fytyrës së brendshme të ngjarjeve, i mendimeve dhe ndjenjave (të të tjerëve) në sajë të ndjenjave të singerta të lindura në zemër dhe të frymëzimeve të merituar.

Profeti (s.a.s.) ka thënë:

اتَّقُوا فِرَاسَةَ الْمُؤْمِنِ فَإِنَّهُ يَنْظُرُ بِنُورِ اللَّهِ

"Ruhuni nga firaseti (zgjuarsia) e besimtarit, sepse ai sheh me nurin (dritën) e Allahut!" (Tirmidhi, *Tefsir*, 15) Pa dyshim, këtë zgjuarsi mund ta meritojnë ata që, duke u çliruar nga krenaria e frymës (egos), shohin me anë të nurit, dritës hyjnore të Allahut. Kjo cilësi dhe gjendje mendore-shpirtërore ka shumë shembuj në historinë e Islamit.

Sipas rrëfimit të vet, Hz. Enesi (r.a.), një ditë, duke shkuar për te Hz. Osmani (r.a.), sheh në rrugë një femër dhe bukuria e saj i ngulet në mendje. Me këtë mendim arrin te Hz. Osmani i cili, sapo e sheh, i thotë:

"O Enes! Je duke hyrë këtu me shenja zinaje (adulteri) në sy?"

I habitur tejet nga këto fjalë, Hz. Enesi i thotë:

"A po vjen vahj (revelacion) edhe pas të Dërguarit të Allahut?"

"Jo, - ia kthen Hz. Osmani, - kjo është një aftësi tejpamjeje dhe një **firaset** (shquarje, dallim) i saktë!" (Kushejri, *Risale*, 238).

69 Të gjitha këto cilësi mund të emërtohen me një fjalë: zgjuarsi. Ndërkaq, nuancat e veçanta, për pasojë, edhe kuptimi i plotë i kësaj fjale do të kuptohen gjatë shtjellimit në vijim të ngjarjeve në lidhje me këtë cilësi.





Dihet, gjithashtu, se, në kohën e vet, opinioni i Hz. Omerit (r.a.) në shumë çështje ka pasë qenë përputhur me ajetet e ardhur më pas.

Kështu, Profeti (s.a.s.) ka thënë për të:

*“Mes bashkësive që kanë jetuar para jush, ka pasur persona të cilëve u ka qenë dhënë frymëzim. Po që se edhe mes ummetit, bashkësisë sime, ka një të tillë, pa asnjë dyshim, ai është **Omeri!**”* (Buhari, *As’habu’n-Nebi*, 6)

Ebu Abbas bin Mehdi tregon kështu:

“Duke udhëtuar në shkretëtirë, pashë një njeri pa kacak uji që po ecte një radhë para meje kryezbuluar e këmbëzbathur. Mendova me vete se si e falte namazin ai njeri, apo te ai s’kishte abdest e namaz. Ndërkaq, njeriu m’u kthye dhe këndoi ajetin që thotë: **“Dijeni se Allahu i njeh ata që ndodhen mes jush, prandaj ruhuni prej Tij!”** (el-Bakara, 235) Unë i humba ndjenjat dhe u shemba përtokë. Kur erdha në vete, i kërkova falje Allahut pse e pashë njeriun me atë sy dhe vazhdova rrugën. Duke ecur, ai njeri m’u ngul prapë në sy. Me ta parë, zemra m’u mbush me frikë dhe mbeta i ngulur në vend. Njeriu m’u kthye dhe këndoi ajetin që thotë: **“Ai i pranon pendimet e robve, ua fal mëkatet dhe e di se ç’bëjnë!”** (esh-Shura, 25) Pastaj m’u humb nga sytë dhe nuk e pashë një herë tjetër më!”

Dhununi Misri (k.s.) tregon:

“Një ditë pashë një të ri që kishte hedhur sipër një rrobë të vjetër e të arnuar. Edhe pse nefsi (egoja) më ndjente neveri për të, zemra më dëshmonte se ai ishte një i urtë, shenjtor (veli). Kur po merresha me këto mendime i mbetur mes egos dhe zemrës, i riu ma kuptoi të fshehtë dhe, duke parë nga unë, më tha:

“O Dhunun, mos shih nga unë për të parë vjetërsinë e rrobës sime! Margaritari bëhet (formohet) brenda guaskës!”

Dhe u largua që aty duke u fshirë nga sytë!

Një i ri që merrte pjesë për herë të parë në kuvendin e Abdylhalik Guxhdevanit dhe që e fshihte se ishte krishter, e pyeti evlijaun:

“Cila është e fshehta e hadithit *“Ruhuni nga zgjuarsia e besimtarit, sepse ai sheh me dritën e Allahut”*?”

Hz. Abdylhalik Guxhdevani iu përgjig duke i thënë:

“Nxirre brezin që ke mbështjellë në mes⁷⁰ dhe bëhu Islam (nënshtrohu)!”

Para kësaj zgjuarsie të jashtëzakonshme, i riu dëshmoi para tij dhe u bë musliman.

Gjithashtu, rrëfëhet se Xhunejd Bagdadi (k.s.) ka përcaktuar me shikim të parë se një i ri me pamje muslimani ka qenë çifut dhe se së afërmi do të bëhej musliman.

Shkurt, firaseti është një e dhënë (dhunti) hyjnore që shtohet e pakësohet sipas gradës së besimit dhe devocionit në zemër.





Orientimi (istikamet) dhe përpjekja (gajret) janë më me vlerë se zbulime (keshf) dhe keramete të panumërta. Veç kësaj duhet ditur se, nëse zbulimi dhe kerameti nuk bëhen pretekst për ta shtuar respektin ndaj urdhrave të fesë, s'janë gjë tjetër veçse intriga e ngatërresa! (Mevlana Halid Bagdadi)



3. AFTESIA E ADMINISTRIMIT DHE PARASHIKIMIT MREKULLOR (tasarruf-keramet)

Zoti i Plotfuqishëm, kur dëshiron diçka në mënyrë volitive, thotë “**Kun**” (Bëhu!) dhe ajo bëhet. Ndërkaq, gjithashtu sipas dëshirës së Tij volitive, Allahu i Lartë ua ka lënë administrimin e disa ngjarjeve disa robve të Tij. Në të vërtetë, Allahu i Lartë i ka bërë robtë në fjalë mjete ose ndërmjetës në administrime të tilla, sepse ato nuk mund të realizohen pa ndërhyrjen e Allahut të Lartë me atributin *krijues* të Tij. Krejt siç ndodh me katër engjëjt e mëdhenj.

Nga engjëjt e mëdhenj, Xhebraili (a.s.) është ngarkuar me detyrën e komunikimit të vahjit (revelacionit hyjnor) për profetët; Mikaili (a.s.), me detyrën e drejtimit të dukurive të natyrës; Azraili (a.s.), me detyrën e marrjes së shpirttrave; Israfil (a.s.), me detyrën e fryrjes së Birit.

Sigurisht që Zoti mund t'i realizonte këto detyra edhe drejtpërdrejt, por Zoti i Lartë ua ka dhënë atyre me vullnetin e vet hyjnor këto detyra dhe kompetenca. Edhe fuqia dhe forca e engjëjve është, në fakt, nga fuqia e Zotit. Është Ai që ua ka dhënë atyre atë forcë. E tillë është edhe forca dhe kompetenca që zotërojnë të gjitha krijesat.

Allahu i Lartë u ka dhënë disa profetëve edhe disa kompetenca administrimi. Ndër këta është Sulejmani (a.s.) që njihje gjuhën e kafshëve dhe që urdhëronte erën dhe xhindët.

Edhe imamit të profetëve, Hz. Muhammedit (s.a.s.), i janë favorizuar shumë kompetenca të veçanta. Edhe disa nga personat e zgjedhur të ummetit, bashkësisë së tij, janë bërë pjesëtarë të këtyre kompetencave





me aq sa ç'ka dashur Zoti. Për shembull, thuhet shpesh se disa prijësa (velinj) të mëdhenj si Abdylkadir Gejlani dhe Ahmed Rifai kanë kryer disa administrime si në të gjallë, ashtu dhe pas vdekjes.

Administrimi (tasarruf) për të cilin po flitet, realizohet atëherë kur në një akt të kryer nga një person të cilit vullneti i vet nuk do t'i mjaftonte për ta kryer, merr pjesë Allahu i Lartë duke e shfaqur në atë akt atributin e Tij "Halik" (Krijues). Me fjalë të tjera, administrimi (tasarruf) si akt nuk ka ndonjë ndryshim nga një akt tjetër çfarëdo. Ndryshimi është te cilësia e tij përjashtimore në lidhje me individin ngaqë akti në fjalë nuk është i mundur për çdo individ.



Si një lloj i administrimit (tasarruf), keramet janë ngjarje të jashtëzakonshme tej fizike, për rrjedhojë, të pashpjegueshme me ligjet e natyrës, që duken te persona të lartësuar shpirtërisht në gradën *veli* (i urtë, prijës, shenjtor) si një dhuratë e Zotit dhe në përfundim të një besimi (iman), aftësimi njohjeje hyjnore (marifet) dhe devocioni (takva) të përkryer. Shkurt, kerameti është aftësi parashikimi dhe administrimi mrekullor të ngjarjeve. Ky lloj kerameti është kerameti demonstrativ (súrí). Kurse kerameti bazë në vështrimin e njerëzve të Allahut (ehlullah) është jetesa e orientuar. Me këtë kompetencë shpirtërore, miqtë e Zotit janë të ndryshëm nga njerëzit e tjerë për sa i përket mënyrës së vështrimit, mendimit dhe, madje, sjelljes.

Siç kuptohet edhe nga përkufizimi, kerametet e demonstruara nga evlijatë janë dy llojesh:

1) **Kerameti moralo-shpirtëror (maneví):** Duke përparuar në dije (ilm), moral (ahlak), adhurim (ibadet), aftësim njohjeje hyjnore (marifet) dhe devocion (takva), duke u lartësuar në nivel shpirtëror, është përfitim nga përmbajtja e ajetit (فَأَسْتَقِيمُ كَمَا أُمِرْتُ) "**Orientohu siç je urdhëruar**" (Hud, 112), shkurt, është orientim. Për shembull, megjithëse fjalët e dala nga goja e një të urti (veli) i cili ndodhet në rrugë të drejtë, pra, i orientuar, janë urtësi dhe orientim, ato fjalë thuhën me një stil të atillë që nuk prekin zemrën e askujt prej bashkëbiseduesve edhe sikur ato fjalë të jenë vërejtje për gabimin e personit përballë.

Është e pamundur që këto të arrihen me mendje dhe meditim. Allahu i Lartë ua dhuron këto vetëm robve të Tij të zgjedhur.

2) **Kerameti universal (kevní) dhe demonstrativ (súrí):** janë akte të jashtëzakonshme e mrekullore të realizuara në botën materiale, si kapërcimi i kufizimit hapësinor, sjellja në prani të sendeve që nuk ndodhen aty, detyrimi i kafshëve të egra për të kryer punë, etj.

Mistikët e vërtetë nuk kanë fort konsideratë për llojin e dytë të kerametit. Fundja, tregimi i një kerameti të tillë nuk është as një ndër





kushtet e gradës shpirtërore të urtësisë të cilësuar “veli”. Edhe kerametet universale dhe demonstrative, Allahu i Lartë ua favorizon disa robve që zgjedh. Vetëm se është thënë që tregimi i këtyre kerameteve pa qenë e nevojshme dhe e domosdoshme, është i papëlqyeshëm. Edhe i urti (veliu), me sa të ketë mundësi, nuk dëshiron të tregojë keramete të tilla. Sepse pas këtyre vijnë mahnitja dhe duartrokitja e popullit dhe njerëzit e paditur ose injorantë fillojnë ta presin çdo gjë prej atij të urti (veliu).

Sado që populli tregon interes për llojin e dytë të kerametit, në të vërtetë, i pranueshëm është lloji i parë. Sepse mistikët janë të një mendimi se “kerameti më i madh është orientimi (istikamet)”. Përpëlitet e një udhëtari të udhës mistike i cili nuk është i orientuar, janë të kota!

Mevlana Halid Bagdadi thotë:

“Orientimi (istikamet) dhe përpjekja (gajret) janë më me vlerë se zbulime (keshf) dhe keramete të panumërta. Veç kësaj duhet ditur se, nëse zbulimi dhe kerameti nuk bëhen pretekst për ta shtuar respektin ndaj urdhrave të fesë, s’janë gjë tjetër veçse intriga e ngatërresa!”

Kerametet kanë një qëllim final të lartë i cili, nëse mund të thuhet kështu, është orientimi i bashkëbiseduesve me anë të “efektit shok”. Ndërkaq, feja përbëhet prej propozimeve (mocioneve) ose përgjegjësive hyjnore dhe me këtë cilësi do të vazhdojë gjer në kiamet. Kurse gjërat e jashtëzakonshme e dëmtojnë cilësinë mocionale të fesë. Është për këtë arsye që, pa qenë të detyruar, as profetët e kanë përdorur mrekullinë, as të urtët (velinjtë) kanë bërë shfaqje kerameteshe.

Në përgjithësi, përfundimet e një kerameti të vërtetë janë këto:

- 1) Edukimi i nefsit (vetvetes, egos).
- 2) Pastrimi i zemrës nga veset dhe prirjet e shëmtuara dhe stolisja me begatinë hyjnore.
- 3) Zbulimi ndaj zemrës i të fshehtave dhe urtësive.

Nga ana tjetër, njëri prej mjeteve më të rëndësishëm të shfaqjes së kerameteve është njoftimi i robit nga Zoti i **emrit të madh**⁷¹ si një e fshehtë. Ndërkaq, kërkojmë ta prekim shkurt edhe temën e *emrit të madh* që zë një vend me rëndësi në diskutimin e dhuntive hyjnore.

Emri i madh është njëri prej emrave hyjnorë që e bën të pranueshme lutjen e bërë me të. Vetëm se momenti se cili është emri i madh ndër emrat e Allahut, është një e fshehtë dhe ka shumë hadithe lidhur me këtë specifikë. Mes këtyre, është e fuqishme pikëpamja se emri i madh është fjala “Allah” që është emri i individualitetit të lartë të Zotit dhe që i përmbledh në vetvete të gjithë emrat.

71 Në original: ismi adham.





Njëra nga konsideratat mbi këtë specifike është kështu: Meqë Zoti i favorizoi njeriut një pjesë nga fuqia e Tij në formën e frymës hyjnore⁷², shfaqjen më gjithëpërfshirëse të emrave hyjnorë e ka realizuar te “njeriu”. Njeriu i përkryer (kamil) është personi i cili, këtë emër hyjnor që është i pranishëm potencialisht⁷³ në krijimin e tij, duke e nxjerrë nga potencialiteti në akt, mundet të arrijë fatmirësinë për t’u pajisur me moralin e Allahut. Prandaj thuhet se, cili emër hyjnor të ketë përparësi te një njeri, ai emër është për atë njeri emri i madh. E shprehur ndryshe, te njeriu ku janë zhvilluar në mënyrë të dukshme ndjenjat e mëshirës dhe dhembshurisë, sundojnë shfaqjet e emrave “Rahman” dhe “Rahim” të Zotit tonë të Lartë. Për rrjedhojë, për këtë person, këta emra janë konsideruar emër i madh. Ndërkaq, aftësia e vërtetë është mundësia për ta shndërruar domosdoshmërinë e emrave të bukur të Zotit në moral të jetueshëm. Ndryshe, shumë vetë e lexojnë nga librat ose e thonë përmendësh emrin e madh duke u mjaftuar me kaq. Prandaj, ndërsa gjuha thotë “o Rahman”, “o Rahim”, zemra është e mangët nga mëshira, është e kotë të presësh që të realizohet gjëja e dëshiruar!

Kjo ngjarje e ndodhur mes Hz. Aliut (r.a.) dhe një beduini është shumë mësimdhënëse:

Një ditë, një beduin i varfër kërkon lëmoshë nga Hz. Aliu. Meqë atë çast nuk kishte mundësi tjetër, Hz. Aliu merr një grusht rërë, i këndon diçka dhe i fryn. Pastaj e derdh si flori në grushtin e beduinit. Beduini mbetet i mahnitur. Ai i lutet Hz. Aliut t’i tregojë se si e bëri atë gjë, se çfarë këndoi mbi rërë. Me mjaft qetësi, Hz. Aliu i thotë se kishte kënduar suren Fatiha. Shumë i gëzuar, beduini merr një grusht rërë dhe i këndon suren Fatiha, por rëra mbetet rërë! Beduini e pyet Hz. Aliun mbi urtësinë e kësaj. Dhe ai i përgjigjet shkurt kështu:

“Ky është një dallim zemre!”

Edhe Mevlanai përmend një rrëfim të tillë në *Methnevinë* e tij:

Një ditë, një person iu bë shok rruge Isait (a.s.). Duke shkuar së bashku, personi pa në një skaj të rrugës ca eshtra dhe iu lut Isait (a.s.):

“Ma mëso emrin e madh edhe mua që t’i ringjall këto eshtra e t’i ngre në këmbë!”

Hz. Isai iu përgjigj:

“Kjo punë nuk është puna jote! Për ta kënduar emrin e madh dhe për ta ringjallur të vdekurin, duhet të kesh një frymë më të pastër se shiu, të jesh më i kuptueshëm në adhurim se engjëjt! Emri i madh kërkon një gjuhë të kulluar dhe një zemër të pastër. Pra, një njeri që të mos ta ketë nefsën të

72 Nefha-i ilahí (osm.).

73 Në original: bilkuvve (arab.).





ngjyer me haram dhe, si engjëjt, të mos dijë ç'është kundërshtimi. Sepse, njeriut që e ka nefsin të pastër, i pranohet lutja. Zoti i Lartë e bën atë njeri ruajtës të thesareve. Për shembull, ta zëmë se ti more në dorë shkopin e Musait. Mirë, po a ke fuqi ti ta bësh atë kuçedër dhe ta urdhërosh? Vetë Musai qe frikësuar kur i qe bërë shkopi kuçedër dhe Zoti i pat thënë: **“Mos u frikëso, o Musa!”** (en-Neml, 10)

Ja, kështu, edhe ti, ç'dobi do të kesh po ta këndosh dhe ta mësosh përmendësh emrin e madh në qoftë se s'e ke frymën e Isait?"

Por ai njeriu indiferent e i paditur prapë nuk heshti por i tha:

“O Isa! Po s’e pata unë këtë fuqi, të paktën ti këndoji ato eshtra!”

Isait (a.s.) i erdhi shumë turp nga fjalët e atij kokëtrashi dhe tha:

“O Zot! Ç’është urtësia e kësaj këmbënguljeje? Cili është shkaku i kundërshtimit në këtë gradë të këtij kokëtrashi? Vetë e ka zemrën të vdekur, përpigjet ta ringjallë kufomën e tjetrit! Kurse atij që është vetë i vdekur, i takon ta ringjallë veten! Në vend që të lutet për ta ringjallur veten, përpigjet t’i ringjallë të tjerët! Ç’padituri e ç’indiferentizëm!”

Ja, pra, miqtë e vërtetë të Zotit janë njerëz që kanë arritur këtë pjekuri të zemrës. Prandaj, kur shfaqet ndonjë keramet nga robtë e urtë të Allahut, atyre u shtohen edhe më ndjenjat e falenderimit për dhuntitë dhe favoret e Allahut! Këto situata të tyre bëhen burim force për ta në përpjekjet e tyre. Të urtët (veli) të vërtetë kurrë nuk rrëmbehen nga ndjenja se jeta e ardhme e tyre, ahireti, është nën garanci për shkak të kerameteve të tyre. Përkundrazi, ata mbushen me ndjenjat e dobësisë, përlulësisë dhe nënvleftësisimit të vetvetes ndaj Allahut. Nga drojtja e rënies në krenari, mendjemadhësi dhe intrigë, janë vazhdimisht të frikësuar.

Me të vërtetë, është mjaft domethënës fundi i hidhur i Bel’am Bauras, të cilit Allahu ia pati njoftuar emrin e madh. Mes bijve të Izraelit, ky njihej si dijetar dhe i urtë. Por pastaj, si pasojë e mendjemadhësisë dhe vetëmashtrimit ndaj kësaj bote, e humbi atë gradë të lartë, madje vdiq pa besim. Kjo ngjarje është njoftuar në Kur’an në këtë mënyrë:

“Lexoju atyre (hebrenjve) lajmin mbi personin të cilit i dhamë nga ajetet tona, por që u largua prej tyre, prandaj dhe, duke e ndjekur shejtanin, u bë i harbuar. Po të deshim, sigurisht që, në sajë të këtyre ajeteve, e lartësonim. Por ai u zhyt në këtë botë dhe ra pas dëshirave të vetvetes. Gjendja e tij i përngjet krejt gjendjes së qenit. Edhe sikur ta ndjekësh, e nxjerr gjuhën e merr frymë; edhe sikur ta lësh, e var gjuhën e merr frymë. Ja, e tillë është gjendja e fisit që i përgënjeshtrojnë ajetet tona. Tregojua ngjarjen se ndoshta mendohen!” (el-A’raf, 175-176)

Për këtë shkak, konsiderata e tepruar ndaj një të urti (veli) që zotëron keramet, është parë tejet e pajustificueshme dhe e rrezikshme. Ky rrezik është edhe njëri nga shkaqet që miqtë e Zotit druhen të tregojnë keramet.





Keramenti nuk është një gradë fundore dhe nuk është tregues i gradës moralo-shpirtërore të të urtit (veliut). Ata miqtë e Zotit e dinë mjaft mirë se askush veç profetëve nuk është nën garanci. Ka njeri që kur i ka mbetur një pëllëmbë për të rënë në xhehennem, hyn në xhennet dhe ka njeri që, kur i ka mbetur edhe një pëllëmbë për të hyrë në xhennet, rrokulliset në xhehennem. Prandaj çdo besimtar duhet ta bëjë parim të jetës ajetin kur'anor që thotë:

"... dhe adhuroje Zotin tënd gjersa të të vijë fakti (vdekja)!" (el-Hixhr, 99)

Ashtu si në çdo çështje, edhe përballë favoreve hyjnore që shfaqen në formë kerameti, kriteri ynë i vetëm janë Kur'ani dhe Sunneti. Megjithëkëtë, është fakt që edhe kerameti është një e drejtë dhe e vërtetë e pamohueshme.

Disa nga **provat dhe argumentet e kerametit në Kur'an** janë kështu:

Veziri i Sulejmanit (a.s.), Asafi i pati thënë atij se **"do t'ia sillte fronin mbretëror të Belkizes sa hap e mbyll sytë"** (Neml, 40) dhe ky premtim qe realizuar.

Zekerija (a.s.) ishte ngarkuar me detyrën për t'u kujdesur për Hz. Merjemen e cila ishte mbyllur në faltore për t'u marrë me adhurim. Por, sa herë që hynte në faltore, shihte të mira të ndryshme pranë saj. Për ta mësuar urtësinë e kësaj, e pyeti Merjemen:

"Nga të vijnë këto furnizime ty?"

Dhe ajo i qe përgjigjur:

"Nga ana e Allahut..." (Al-i Imran, 37)

Gjithashtu, njoftimet në ajetet 24 dhe 25 të sures Al-i Imran mbi furnizimin e Merjemes drejtpërdrejt nga ana e Allahut janë argumente të Kur'anit mbi kerametin.

Kurse provat dhe argumentet në Sunnet janë të shumta.

Profeti (s.a.s.) ka thënë dhe ka shpjeguar se:

*"Tre vetë kanë folur qysh në djep. Këta janë: Isai, biri i Merjemes, fëmija i treguar si i Xhurejxhit dhe një fëmijë tjetër!"*⁷⁴

Në një hadith tjetër autentik është treguar për tre udhëtarë që kanë mbetur të mbyllur natën në një shpellë. Hyrja e shpellës ishte mbyllur nga një shkëmb i rrokullisur. Secili nga udhëtarët, duke mbajtur për pretekst një veprim të kryer më parë për hir të Zotit, bëri lutje dhe, më në fund, si një favor prej Zotit, hyrja e shpellës u hap.⁷⁵

Siç rrëfëhet, ndërsa ishte duke mbajtur hutbe, Omeri (r.a.) ka thënë: **"O Sarije, në mal, në mal!"** Kur e ka thënë këtë thirrje që s'ka pasur asnjë lidhje me temën e hutbes, personi i quajtur Sarije ishte duke luftuar një

⁷⁴ shih. Muslim, *Birr*, 8.

⁷⁵ shih. Buhari, *Edeb*, 5; *Enbija*, 53; *Dhikr*, 100.





muaj udhë larg Medines kundër armiqve të Allahut. Por Allahu (xh.xh.) i ka dhënë mundësi Sarijes ta dëgjojë zërin e Omerit (r.a.). (Ibni Haxher, *el-Isabe*, II, 3)

Shembuj të tillë në periudhën e sahabeve ka shumë.

Nga ana tjetër, si të kundërta të kerametit, mund të ndodhin disa dukuri të jashtëzakonshme, të ngjashme me kerametin e të urtëve, tek persona mohues, mëkatarë dhe sharlatanë. Dukuritë e jashtëzakonshme të shfaqura në përputhje me pretendimet e këtyre, janë quajtur **avancime (istidraxh)**.

Situata të tilla realizohen në sajë të një sërë stërvitjesh shpirtërore. Kjo do të thotë se është e mundur që, me anë të një sërë efektesh jashtëfetare, disa aftësi shpirtërore të kalohen nga gjendja potenciale, në akte praktike. Për shembull, fakirët indianë, përgjithësisht me anë të rrugës së përkorisë dhe asketizmit, arrijnë një fuqi të caktuar shpirtërore. Disa herë kjo arrihet duke përdorur magjinë ose xhindë shërbëtorë. Dallimi i ndryshimit mes dukurive ose shfaqjeve të tilla të jashtëzakonshme dhe kerametit është çështje kompetence në fushën përkatëse. Por mund të themi vetëm kaq që jeta e njerëzve të tillë nuk ecën brenda kriterëve të devocionit. Këta janë të mangët në ndjekjen e sunnetit të të Dërguarit të Allahut. Kjo është edhe pika e parë që duhet bërë kujdes.

Kështu, Xhunejd Bagdadi (k.s.) thotë:

“Po qe se shihni dikë duke fluturuar në ajër dhe gjendja e tij nuk përputhet me Librin dhe Sunnetin, dijeni se kjo është istidraxh⁷⁶!”

Personi tek i cili ndodh një çfarëdo dukuri e jashtëzakonshme si dhunti hyjnore⁷⁷, nuk mundet ta bëjë këtë në formën e shfaqjes, sepse miqtë e Zotit, ngaqë janë larg dukjes, nuk e tregojnë dukurinë e jashtëzakonshme pa mbetur të detyruar për këtë. Ata shfaqen para njerëzve me përsosmëri morale njerëzore që mund të merren si model. Ashtu siç pati ndodhur me Profetin (s.a.s.) i cili, për t’u bërë një model i përkryer për ummetin, bashkësinë e tij, në përgjithësi pati vepruar sipas prirjeve njerëzore duke treguar rrallë mrekulli në raste nevojë dhe me lejen e Allahut. Edhe miqtë e Zotit nuk ndahen as një fije nga rruga e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Për ta dalluar se ç’është kerameti e ç’është sharlatanizmi, mjafton vetëm të kihet kujdes ky moment!

Edhe Faraoni zotëronte aftësinë për të kryer veprime të jashtëzakonshme

76 Nga përdorimi i kësaj fjale në këtë fjali me përmbajtje të tillë, kuptohet se, në të vërtetë, kuptimi i fjalës “istidraxh” nuk është “avancim”, por “sharlatanizëm”. Në fakt, dukuri të tilla që përngajnë me hipnozën e përdorur në cirqe, s’janë gjë tjetër veçse lojë dhe sharlatanizëm.

77 Pra, pa stërvitje me synime të caktuara por në mënyrë të vetvetishme.





të tipit istidraxh. Gjatë gjithë jetës së tij katërqindvjeçare nuk ndjeu as dhe një dhimbje koke. Edhe dhëmbët i mbetën të shëndosha e të bardha. Kur zbriste një të tatëpjetë, këmbët e kalit i zgjateshin.

Aftësia për të treguar dukuri të jashtëzakonshme i jep mohuesit dhe mëkatarit krenari dhe mendjemadhësi. Ndërkaq, ia bën fundin edhe më të zi. Kur Musai e goditi me shkop Detin e Kuq dhe hapi rrugë në të, Faraoni që po e ndiqte pas me ushtri, iu kthye ushtrisë dhe i tha: “Pa shihni, nga drojtja prej meje, deti u kthye në rrugë!” Por kur hyri në atë rrugë, deti u rikthye në vendin e vet dhe ai u mbyt në të bashkë me ushtrinë!

Në hadithet e tij, Profeti (s.a.s.) ka thënë se edhe Dexhali do të përpiqet t’i mashtrorë njerëzit duke treguar dukuri të jashtëzakonshme.

Ndërkaq, ka edhe situata që shfaqen në kundërshtim me pretendimin e personit që kërkon të shfaqë një dukuri të jashtëzakonshme si avancim shpirtëror ose thjesht sharlatanizëm qoftë edhe të formës së hipnozës publike. Këto situata në disfavor të tyre, në terminologjinë e mistikës emërtohen “ihane”, (disfavore, ulje, poshtërime). Për shembull, ka ndodhur që mashtruesi-pretendent për profetësi, Musejleme, ka pështyrë në një pus me qëllim shtimin e ujit, kurse pusi është tharë krejtësisht.

Ashtu siç ka qenë i mundur realizimi i administrimit dhe kerametit në periudhën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe sahabeve, ashtu ka qenë i mundur edhe në periudhat e mëpastajme. Administrimet dhe kerametet e treguara nga të urtët (velinj) me qëllim për t’u dhënë kahje vullneteve të disa personave, kryhen me begatinë e profetit që ndjekin dhe, në të njëjtën kohë, janë një lloj vazhdimësie e mrekullive të tij.

Eshtë një e vërtetë historike që administrimet dhe kerametet e ndodhura si në shekullin e lumtur, ashtu dhe në kohët e mëvonshme, kanë qenë dhe janë bërë pretekste për shumë orientime. Kështu, shumë vetë që janë bërë dëshmitarë të këtyre lloj ngjarjesh, kanë thënë se, “kur shenjtori i një feje është i tillë, profeti i saj kush e di si do të jetë”, duke mbështetur, kështu, esencën e vërtetë të kerametit.

Disa shembuj të posaçëm mbi administrimin (tasarruf) dhe kerametin (parashikimin dhe aktin mrekullor)

Allahu i Lartë, krijuesi dhe sunduesi i gjithësisë e caktoi njeriun, krijesën më të nderuar, si zëvendës me qëllim që t’ia njohë ekzistencën, t’i bindet e ta adhurojë dhe ta rregullojë e sistemojë faqen e tokës. Kjo e vërtetë shprehet kështu në Kur’an:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً





“Kujto që Zoti yt u pati thënë engjëjve: “Unë do të krijoj mbi tokë një zëvendës”. (el-Bakara, 30)

Emërtimi i njeriut si zëvendës (kalif) në këtë ajet, ka këto kuptime:

“Nga vullneti, fuqia dhe atributet e mia do t’i jap atij disa kompetenca. Ai do të ketë të drejtë të bëjë disa veprime e të drejtore në emrin tim dhe si zëvendësi im. Ai do ta zbatojë ligjin në emrin tim. Në këtë gjë ai nuk do të bëhet i parë, ai nuk do ta zbatojë ligjin në emër të personit dhe individualitetit të vet. Ai do të jetë vetëm zëvendësi dhe ndihmësi im. Ai do të jetë i ngarkuar me detyrën që, me vullnetin e vet, të zbatojë vullnetin tim, urdhrat e mia, ligjet e mia. Pastaj, ata që do të vijnë pas tij, do të kryejnë të njëjtën detyrë si zëvendës të tij dhe, kështu, do të zbulohet e fshehta **“Ai (Allahu i Lartë) ju bëri juve zëvendës mbi tokë!”** (el-En’am, 165)⁷⁸

Si veprimet dhe mrekullitë e shfaqura te profetët, ashtu dhe veprimet dhe kerametet e dukura te miqtë e Zotit, janë shfaqje të së fshehtës së pozitës së njeriut si zëvendës i Zotit mbi tokë. Këtu po përshkruajmë vetëm disa prej shembujve të panumërt të kësaj shfaqjeje.

Mansur bin Abdullah e ka rrëfyer kështu ç’i ka ndodhur Ebu Abdullah ibni Xhel’lait.

Ibni Xhel’la thotë:

“Kisha shkuar në Medinen e Ndrirshme. Isha aq i varfër sa s’kisha gjë prej gjëje. Arrita te varri i nderuar i të Dërguarit të Allahut. E përshëndeta me selam dhe thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Ndodhem në varfëri të plotë! Të erdha si mik!...”

Pas pak më erdhi gjumë. Në gjumë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) më gostiti me një çyrek. E hëngra gjysmën dhe pastaj u zgjova. Gjysmën tjetër e gjeta pranë!”⁷⁹

Një ngjarje tjetër me kuptim të thellë të përjetuar pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), el-Utbi e tregon kështu:

“Po rrija pranë varrit të nderuar të Profetit (s.a.s.). Ndërkaq, erdhi një beduin dhe foli kështu:

“Paqe ty, o i Dërguari i Allahut! Dëgjova se Allahu i lartë ka thënë: **“Po qe se ata, kur i bëjnë padrejtësi vetes, vijnë tek ti dhe kërkojnë ndjesë dhe i Dërguari kërkon ndjesë për ta, do ta shohin se sa falës i madh që është Allahu!”** (en-Nisa, 64) Ja, pra, të erdha ty duke u penduar për mëkatet e mia dhe duke kërkuar falje dhe duke kërkuar prej teje të ndërhysh pranë Zotit tim për mua!”

78 Elmalılı, *Hak Dini*, I, 299-300.

79 shih. Kelabazi, *Taarruf*, përkth. S. Uludağ, f. 214.





Pastaj këndoi një poezi të ndjerë dhe u largua. Atëherë, mua më erdhi gjumë. Në ëndërr pashë Profetin (s.a.s.) që më tha:

“O Utbi! Arrije atë beduinin dhe përgëzoje se Allahu e ka falur!” (Ibni Kethir, *Tefsir, I, 532*)



Në rrethanat kur lufta e Çanakalasë ishte ashpërsuar shumë, majori Lutfi Bej bërtiste dhe i kërkonte ndihmë Profetit (s.a.s.):

“Na eja në ndihmë, o Muhammed, Libri po të humbet!...”⁸⁰

Se si u shfaq kjo ndihmë e kërkuar me sinqeritet nga i Dërguari i Allahut, e mbështet në mënyrë krejt të qartë ngjarja si më poshtë.

Viti 1928... Kishin kaluar plot 13 vjet nga fitorja e Çanakalasë.

Dijetari dhe njeriu i kulturuar e i hollë në sjellje, Xhemal Ogyt shkoi në Haxh. Në Medine ai gjen rastin të njihet me shumë persona të shquar. Njëri prej tyre ishte tyrbedari⁸¹ i Profetit (s.a.s.). Ky mik i Zotit ishte edhe një mik besnik i osmanëve. I mbante në gojë osmanët. Xhemal Ogyt Efendi nuk bën dot pa e pyetur:

“Pse kjo dashuri në këtë gradë?”

Tyrbedari i plakur i përgjigjet pa ngurruar asnjë çast:

“Vetëm një kujtim më mjafton mua për t’i dashur osmanët!”

Pas këmbënguljes së efendiut, e tregon kështu atë kujtim të pashoq:

“Në haxhin e vitit 1915 pati ardhur edhe një person nga dijetarët e Indisë. Ai ishte një mik i Allahut me botë të brendshme të pasur. Pas haxhit erdhi në Medine për t’i bërë vizitë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Dukej shumë i dëshpëruar. Kur e pyeta atë njeri të bekuar që nuk i shternin lotët e syve, m’u përgjigj duke derdhur lot më shumë:

“Pas shumë vitesh m’u bë e mundur të vij për ta vizituar Zotërinë e Botëve. Por po vërej se ai nuk ndodhet në vendin e vet! Apo mos më janë qorruar mua sytë e zemrës? Pse nuk e ndjej praninë e të Dërguarit të Allahut? Ja, prandaj jam kaq i dëshpëruar qysh se kam ardhur në Medine!”

Atë natë, tyrbedari plak sheh në ëndërr të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) dhe ia kujton thëniet e dijetarit indian. Pa e lënë shumë kureshtar, i Dërguari i Allahut ia shpjegon gjendjen:

“Po, ajo që ka ndjerë ai, është e drejtë! Tani unë nuk ndodhem në Medine! Unë jam në Çanakala... Nuk ma pranonte zemra t’i lija vetëm vëllezërit e mi ushtarë në gjendje të vështirë. Tani po u ndihmoj atyre!” (Gazeta Zaman, 18 mars 1918)

80 shih. Mehmet Niyâzi, *Çanakkale Mahşeri*, f. 352-355.

81 Tyrbedar: kujdestar i tyrbes.





Edhe pohimi i gjeneralit anglez Hamilton pas humbjes së tyre në Çanakala është si një dëshmi e rrëfimit të mësipërm:

“Ne na mundi jo forca materiale e turqve, por forca shpirtërore e tyre! Sepse atyre s’u kishte mbetur as barut për të qëlluar! Por ne vërejtëm se si u zbrisnin atyre forcat prej qielli!”

Këto lloj ngjarjesh janë të drejta kompetencash dhe veprimesh që Zoti u ka dhënë profetëve edhe pas vdekjes. Ata ndodhen në varre të gjallë në një formë që ne nuk mund ta kuptojmë me anë të mbresave tona të kësaj bote. Edhe hadithi në vijim e tregon qartë këtë.

Sipas rrëfimit të Evs bin Evs (r.a.), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

“Dita më e virtytshme për ju është dita xhuma. Prandaj atë ditë lutuni shumë për mua për paqë e mëshirë, sepse lutjet tuaja më tregohen mua!”

Atëherë, sahabet e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut, pasi të vdesësh e të mos mbetet asnjë gjurmë nga ti, si do të të tregohen lutjet tona?”

Dhe Profeti iu përgjigj:

“Allahu i Lartë ia ka ndaluar tokës t’i kalbë trupat e profetëve!” (Ebu Davud, Salat, 201; shih. Nesai, Xhuma, 5)

Kjo gjendje gjalljeje shfaqet edhe te dëshmorët (shehid). Në Kur’an, Zoti thotë:

“Kurrresi mos i pandehni të vdekur të vrarët (dëshmorët) në rrugën e Allahut! Përkundrazi, ata janë të gjallë dhe furnizohen pranë Zotit të tyre me të mira prej bujarisë dhe favorit të Tij!” (Al-i Imran, 169)

Por, pa dyshim, gjallja te profetët është e një niveli shumë më të lartë se te dëshmorët!



Edhe te miqtë e Zotit që janë trashëgimtarë të Profetit, shfaqjet e veprimtimit dhe kerametit kanë vazhduar të ndodhin gjer në ditët e sotme. Gjithashtu, disa nga rastet e panumërta prej tyre janë si më poshtë.

Ubejdullah Ahrar, duke e kapërcyer largësinë përkatëse, ka marrë pjesë në triumfin e Stambollit që nga Azia e Mesme. Këtë, stërnipi i tij, Haxhe Muhammed e përcjell kështu:

“Ditën e enjte pas dreke, Ubejdullah Ahrar, papritmas urdhëroi t’i përgatitej kali. Pastaj i hipi kalit dhe doli me vrap jashtë Samarkandit.

Një nxënës i shquar shpirtërisht i tij, i quajtur Sheh Mevlana, e ndoqi për një farë kohe. Ai lajmëroi se, pasi u kthye disa herë djathtas e majtas i hipur mbi kalë, Ubejdullah Ahrari humbi nga sytë. Pas një farë kohe, ai u kthye prapë. Nxënësit e pyetën për kuptimin e këtij udhëtimi të papritur.

Dhe ai u tha:





“Sulltani turk Mehmed Hani më kërkoi ndihmë. Dhe unë i shkova në ndihmë. Me lejen e Allahut, neve na ndriti fitorja!”

Nipi i Ubejdullah Ahrarit, Haxhe Abdylhadi i ardhur nga Horasani për ta vizituar Stambollin, tregon kështu:

“Kur shkova në Stamboll, sulltan Bajaziti II ma përshkroi figurën e tim eti, Ubejdullah Ahrarit, dhe më tha kështu:

“Im atë, Fatihu, më ka treguar: “Në çastet më të rënda të luftës, duke iu përgjëruar Zotit, i kërkova të më vinte në ndihmë njeriu më i shquar i kohës. I hipur mbi një kalë të bardhë, më doli para e më tha:

“Mos ki frikë! Fitorja është e jotja!”

Unë i thashë!

“Ushtarët e qafirëve janë shumë!”

Duke ma hapur xhyben para syve, më tha:

“Shih brenda!”

Dhe unë pashë brenda xhybes një ushtri që vinte si rrebesh i rrëmbyer!

“Kjo ushtri po të vjen ty në ndihmë!” - Më tha ai. Dhe vazhdoi:

“E, tani, nga maja e kësaj kodre bjeri tri herë daulles dhe jepi urdhër për sulm gjithë ushtrisë!”

Ashtu veproi! Edhe ai plak mori pjesë në sulmin e ushtrisë. Dhe u realizua fitorja e madhe që e ndante të vërtetën nga e shtrembra!..⁸²

Përgjithësisht, është një fakt historik që, gjatë luftës për triumfin e Stambollit, sulltan Mehmeti II, Ngadhujimtari, përfitoi nga bota shpirtërore dhe ndihma e të gjithë të urtëve (evlijave).

Posaçërisht, Hz. Akshemseddin ka dhënë shumë ndihma në fushat materiale e shpirtërore.



Një ngjarje në lidhje me administrimin mrekullor të jetuar nga Aziz Mahmud Hydaji, është kështu:⁸³

Ishte viti 1975. Në një kohë afër namazit të drekës, para tyrbes së Plakut të Nderuar kishte ardhur një i ri fytyrëdritë, me lëkurën ngjyrë gruri dhe

82 shih. Mevlânâ Sheyh, *Menâkıb-ı Hâce Ubeydullâh-ı Ahrâr*, vr. 4b-5a; Mecdî Mehmed, *Hadâiku's-Şakâik*, s. 272-273; Molla Câmî, *Nefehâtü'l-Ülns*, s. 764-765. Në origjinal: Fet'h-i mubin, fitorja e madhe që e ndante të vërtetën nga e shtrembra. Edhe historiografia botërore e pranon rënien e Kostantinopojës si ngjarje historike epokale që mbylli epokën e Mesjetës dhe hapi Epokën e Re.

83 Këtë ngjarje e kam dëgjuar personalisht nga Muharrem Kir Efendiu, shoku im i shkollës i viteve në Imam-Hatip, dhe një ndër imamët e xhamisë Aziz Mahmud Hydaji. Autori.





trup të lidhur. Atë çast, rastësisht hasi në imamin e xhamisë Aziz Mahmud Hydaji, të cilin e pyeti:

“Imzot, kam ardhur ta takoj Aziz Mahmud Hydajiu! Si mund të takohem me të? A këtu ndodhet tani?”

I habitur para kësaj pyetjeje, Muharrem Efendiu i tha:

“O bir, po, Aziz Mahmud Hydajiu është këtu!”

I gëzuar se dëgjoi që Prijësi i Nderuar ndodhej aty, i riu tha:

“Ju lutem, më takoni menjëherë me të!”

Por Muharrem Efendiu që nuk po i jepte dot kuptim kësaj sjelljeje, meqë ndodheshin pranë tyrbes, i tha përsëri:

“O bir, Aziz Mahmud Hydajiu është këtu!”

Edhe i riu e përsëriti kërkesën:

“Atëherë, më tako me të! Unë dua të takohem me të!”

Meqë ende s’po e kuptonte të riun, Muharrem Efendiu, për ta zgjidhur atë çështje, e pyeti:

“O bir, a e njeh ti Aziz Mahmud Hydajiu, a e di ti kush është ai?”

I riu që e kishte zemrën të pastër si dhe fytyrën, duke u habitur pse po zgjatej kaq shumë fjala dhe pse njeriu që kishte përballë nuk donte ta takonte me Mahmud Hydajiu, i tha:

“Unë e njoh nga afër Aziz Mahmud Hydajiu! Ai më ka ftuar këtu! Ne gemë marrë vesh me të për këtë vizitë! Ai e di se unë do të vija!”

Më në fund, Muharrem efendiu e kuptoi se sjellja dhe fjalët e të riut kishin një kuptim të veçantë, e pyeti:

“Im bir, si u morët vesh me të?”

I riu nisi t’i tregonte:

“Në vitin 1974, në aksionin e Qipros, unë bëja pjesë në komandon që desantoi nga ajri. Ne u hodhëm me parashutë kur dy anët po përlesheshin me njëra-tjetrën. Ndërkaq, era na çonte sa andej-këtej. Unë rashë në frontin armik. Në një zonë pyjore, mbeta mes dy zjarresh. Kur po mendohesha se si të bëja për të dalë nga ai rreth zjarri, më doli para një plak fytyrëndritur me pamje që të detyronte respekt. Ai më pa ëmbël me fytyrë të qeshur dhe më tha:

“O bir, këtu është vija e armikut. Ç’punë ke ti këtu? Pse ke hyrë i vetëm në këtë vijë?”

Unë i thashë:

“Or babë, s’erdha unë, më solli era!”

Plaku fytyrëndritë e tundi kokën lehtë dhe më tha:

“Edhe unë kam ardhur të luftoj! Jam dërguar këtu para jush. Këto vende i njoh mirë. Në ç’repart bën pjesë, o bir? Eja të të çoj tek të tutë!”

Së bashku, u vumë në udhë nën një zjarr të tmerrshëm të artillerisë. Kurse ai njeri i bekuar ishte krejt i qetë sikur po ecte në një udhë të qetë! E gjithë pamja dhe të gjitha sjelljet e tij më dukeshin të çuditshme. Më pyeti





për emrin, nga isha, etj. Pasi iu përgjigja për të gjitha ç'më pyeti, edhe unë, i bërë shumë kureshtar, e pyeta:

“Po ti, or babë, kush je?”

Ai më tha:

“O bir, mua më thonë Aziz Mahmud Hydajji!”

Pastaj unë i thashë:

“Or babë! Ti më bërë shumë të mira. Në u kthefsha shëndoshë në shtëpi, dua të vij ku të jesh të të bëj një vizitë si detyrim besnikërie! A po ma jep adresën?”

Ai njeri fytyrëqeshur më tha vetëm kaq:

“O bir, po të vish në Yskydar e të pyesësh për mua, kushdo ta tregon se ku ndodhem!”

Në këtë mes, kishim arritur te reparti im. Ia putha dorën me dashuri, respekt dhe mirënjohje të madhe! Dhe pastaj u ndamë. Unë shkova te komandanti.

Komandanti që më pa papritmas, u habit. Më pyeti me të bërtitur nga habia se si kisha mundur të shpëtoj nga ai rreth zjarri:

“Si munde të vish këtu?”

Unë i thashë:

“Më sollti një baba plak dhe i mirë!”

Pas mbarimit të luftës, u ktheva në shtëpi, në atë fshatin tim të largët. Por, meqë mirësia që më bëri Aziz Mahmud Hydajji, kurrë nuk më doli nga mendja, ja ku erdha në Yskydar për t'ia bërë vizitën e premtuar. Njerëzit që pyeta, më thanë se “Aziz Mahmud Hydajji ishte një person i bekuar” dhe më adresuan për këtu.”

Pasi mori një frymë, i riu ia përsëriti kërkesën Muharrem Efendiut:

“Imzot, ja, kështu u njohëm me Aziz Mahmud Hydajjiun! Tani ndihmomëni që të takohem me të!”

Duke e kuptuar, kështu, tërë çështjen, Muharrem Efendiu u prek. Për disa çaste nuk qe në gjendje t'i thoshte asgjë të riut që vazhdonte ta shihte ndër sy me lutje! Pastaj, pasi e mblodhi disi veten, me një zë të mbytur nga ngashërimi dhe pothuaj duke belbëzuar, i tha:

“Biri im, Aziz Mahmud Hydajji nuk jeton! Ai është një mik i madh i Zotit që ka jetuar mes viteve 1543-1628. Siç duket, të ka ftuar të vish për t'i kënduar një Fatiha! Ja tyrbja e tij!”

I riu besimtar që e dëgjoi këtë përgjigje, u prek thellë para të vërtetës. Qe përballur vetëm me tyrben e atij njeriu të madh që ia detyronte jetën dhe që kishte ardhur ta vizitonte në shenjë mirënjohjeje! Sapo e rroku kuptimin e ngjarjes së jashtëzakonshme që kishte përjetuar në fushën e luftës dhe





nisi të qante me ngashërim! Mbuloi fytyrën me pëllëmbët dhe qau, ashtu, thellë nga zemra për një kohë të gjatë...

Edhe imami i mihrabit⁸⁴ të Hydajiut po qante...

Kurse një kujtim i viteve të fëmijërisë të mikut të Zotit, Mahmud Sami Ramazanogllu, që e kemi dëgjuar personalisht nga goja e tij në kuvendet e tij, është kështu:

E motra dy vjeçe më e vogël i kishte këmbët të paralizuara. Në atë zonë ndodhej tyrbja e një miku të njohur të Zotit, i mbiquajtur Kapllanxhë Baba, të cilën populli e vizitonte shumë për të gjetur mbështetje për hallet. Një ditë, e ëma, e motra dhe ai vetë kishin shkuar te Babai në tyrbe. Aty e kishin kaluar natën. Natën, ishin zgjuar nga klithmat e të motrës. Nëna kishte vrapuar te e bija për të parë se ç'kishte ndodhur. Dhe vajza i kishte treguar plot emocion: Një Baba, duke dalë nga tyrbja, e kishte shkelur fort mbi këmbët!

Sami Efendiu tregonte se, pas asaj dite, e motra ishte ngritur në këmbë dhe kishte ecur lirisht gjer në vdekje pa ndjerë as dhimbje!



Të gjitha këto që u treguan këtu si dhe ndodhi të ngjashme me këto, janë favore hyjnore të jetuara me begatinë e kompetencës së administrimit dhe veprimit që Zoti ua ka dhuruar disa robve të Tij. Vetëm nuk duhet harruar se autori i vërtetë dhe absolut i ngjarjeve është Zoti vetë. Ndihma e Tij për njerëzit ka ardhur duke u realizuar gjer në ditët tona si nëpërmjet engjëjve, ashtu dhe nëpërmjet robve të Tij të urtë!



84 Mihrab: në xhami, vendi ku prin në falje imami. Këtu, me kuptim të figurshëm: altar.





Endrra (besnike) e besimtarit është njëra nga dyzet e gjashtë pjesët e profetësisë. (Buhari, *Tabir*, 26; Muslim, *Ruja*, 6)



4. ENDRRAT BESNIKE

Një nga dhuratat hyjnore janë edhe ëndrrat besnike ose të vërteta. Ato pranohen si njëra nga rrugët e zotërimit të të vërtetave të fshehta. Gjatë gjumit, marrëdhënia e njeriut me botën materiale zbrit në nivelin më të ulët, kurse ndjesitë e shpirtit të burgosur në trup fuqizohen. Duke u shpërndarë retë e frymës shtazore që i pengojnë peizazhet sublime, vështrimi kthjellohet. Në këtë mënyrë, disa personave të pastër shpirtërisht, të konsideruar *salih*, u mundësohet ta vëzhgojnë në ëndërr botën e fshehtë. Kurse saktësia e këtij zbulimi vëzhgohet më vonë, pas zgjimit.

Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë:

*“Nga profetësia (veçantitë profetike), ummetit i kanë mbetur vetëm sihariqet!”*⁸⁵

Kur e kanë pyetur sahabet se ç’janë sihariqet (mubeshshirat), ai u është përgjigjur:

“Endrrat besnike!” (Buhari, *Tabir*, 5; Muslim, *Salat*, 207-208)

Dukuria e sihariqit (mubeshshirat) është aftësimi i zemrës së besimtarit të sinqertë për t’i rrokur lajmet dhe sugjerimet e mira hyjnore gjatë gjumit.

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), duke e shpjeguar “sihariqin në këtë botë” për të cilin flitet në ajetin që thotë “Për ata (për besimtarët e bindur miq të Allahut) **ka myzhde edhe në këtë botë, edhe në ahiret**” (Junus, 64), thotë:

“Ajo që sheh muslimani ose që i tregohet, është ëndërr besnike!” (Tirmidhi, *Ruja*, 3)

Endrrat janë tre llojesh:

1) Endrrat djallëzore: Janë ëndrrat e sugjeruara nga djalli (shejtani) me synimin për ta trembur njeriun, për ta shqetësuar shpirtin ose për ta

85 Në original: mubeshshirat, lajmet e mbara, shenjat paralajmëruese të ndodhive të mbara.





dëshpëruar atë. Si shikimi në ëndërr i rrëzimit nga një vend i lartë ose i skenave me turbullira dhe fatkeqësira që ushtrojnë efekt mbi njeriun. Endrra të tilla janë pa bazë. Ai që sheh një ëndërr përgjithësisht të turbullt, që e kujton përgjysmë ose të përzjerë, nuk duhet t'ia tregojë askujt se ç'ka parë dhe duhet të mbështetet te Allahu nga provokimi i djallit.

2) Endrrat e para nën një ndikim të jashtëm: Janë pamje të reflektuara në ëndërr në vartësi të gjendjes dhe imagjinatës së personit. Si pirja ujë me shumicë nga një person që ka ngrënë gjëra shumë të kripura ose si reflektimi në ëndërr i një çështjeje që ia preokupon shumë mendjen personit. As këto nuk kanë shpjegime dhe janë pa bazë.

3) Endrrat besnike ose të vërteta: Endrra të tilla kujtohen qartë. Këto janë ose lajme të mira ose tërheqje vëmendjeje për personin nga ana e Zotit. Këto adoptohen në shpirtin e personit që fle me urdhrin dhe lejen e Zotit nëpërmjet disa engjëjve të cilët i konceptojnë nga Libri i Kujtesës (Levhi Mahfudh).

Endrrat besnike janë shkëndija të reflektuara nga Tabela e Kujtesës në të ardhmen. Para se t'i vinte profetësia, Profetit i vazhduan ëndrrat besnike për gjashtë muaj me radhë.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

"Me afrimin e kohës⁸⁶, ëndrra e besimtarit pothuaj nuk del aspak e rreme (realizohet siç e sheh). Endrra (besnike) e besimtarit është një nga dyzet e gjashtë pjesët e profetësisë⁸⁷. Ndërkaq, një gjë që i përket profetësisë nuk është gënjeshtër!" (Buhari, *Tabir*, 26; Muslim, *Ruja*, 6)

Endrrat besnike kanë nevojë për interpretimin e personit kompetent, domethënë, për zgjidhjen e shifrës nga personi kompetent. Edhe interpretimi i ëndrrës është një dituri e dhënë, një dhunti hyjnore. Pas namazeve, Profeti (s.a.s) disa herë dëgjonte dhe interpretonte ëndrrat që kishin parë sahabet dhe shpjegonte shfaqjet mbi të ardhmen të dukura në këtë formë.

Me të vërtetë, interpretimi i ëndrrave është një shkencë e mbështetur në disa rregulla. Personat kompetentë të kësaj shkence quhen "muabbir" (interpretues). Janë shkruar shumë vepra mbi interpretimin e ëndrrave me qëllim për t'u shërbyer njerëzve në përgjithësi. Nga këto, janë bërë të famshme veprat e quajtura "tabirname" të Ibni Sirinit dhe Muhjiddin

86 Kritikët e hadithit e kanë shpjeguar shprehjen "me afrimin e kohës" si "afër kiametit" ose "afër agimit" (në kohën e zbardhjes).

87 Specifika se ëndrra besnike është një e gjashtëdhjetekatra pjesë e profetësisë është shpjeguar kështu: Profetësia e profetit Muhammed (s.a.s.) ka vazhduar 23 vjet. Meqë gjashtë muajt e parë të profetësisë kanë qenë në formë ëndrrash besnike, kjo periudhë gjashtëmuajore përbën një të gjashtëdhjetekatrën pjesë të 23 vjetëve.





Arabiut dhe në përgjithësi duke mbajtur këta për bazë ose duke huazuar prej tyre, janë shkruar gjer më sot shumë libra të ndryshëm të këtij karakteri. Megjithëkëtë, interpretimi i ëndrrës duke u mbështetur vetëm në njohuritë e këtyre lloj librave, është e pajustificueshme, sepse mbështetja bazë e interpretimit të vërtetë është zbulimi shpirtëror (keshf). Prandaj, është e domosdoshme që interpretuesi i ëndrrës të ketë pushtet shpirtëror. Në të kundërt, ndodh rreziku i interpretimit të gabuar. Profeti (s.a.s.) ka thënë:

"... ëndrra vërtetohet sipas interpretuesit të parë." (Ibni Maxhe, *Tabir*, 7)

Prandaj, ëndrrat nuk duhet t'u tregohen jokompetentëve. Ndërkaq, edhe kompetentët e kësaj shkence kanë thënë: "Interpretimi i parë ka rëndësi, kurse të pastajmit mbeten të pavlerë!"

Siç shpjegohet në traktatin "Mizanu'n-Nufus"⁸⁸, shkencat e interpretimit të ëndrrave është dy llojesh: "subjektive" (enfusi) dhe "objektive" (afakí). Llojin subjektiv mund ta mësojë çdokush, njeri i zakonshëm ose i elitës. Pra, interpretimi i llojit subjektiv mund të mësohet duke e dëgjuar nga të tjerët ose duke i mbledhur nga vepra të ndryshme interpretimet e bëra në të kaluarën nga njerëz kompetentë. Në këtë mënyrë, ëndrrat që i përngjasin njëra-tjetrës mund të interpretohen duke u mbështetur në përvojat e kaluara.

Çdo qenie e shfaqur në ëndërr është si fjala në fjalor. E thënë ndryshe, është një gjuhë më vete. Në këtë gjuhë, kuptimi që i atribuohet qenies së parë në ëndërr, mbështetet mbi një lidhje të largët. Pra, nuk është fare pa mbështetje e pa shkak. Për shembull, gjarpëri është armik. Ky kuptim mbështetet në rrëfimin mbi Hz. Ademin (a.s.). Çdo qëndrim dhe lëvizje e parë të gjarpëri shpjegohet si qëndrim ose lëvizje e armikut. Por nëse gjarpëri duket i sheshtë ose i ngordhur, interpretohet si rrugë (jo si armik).

Nga ana tjetër, në interpretimin e ëndrrës luajnë rol shumë faktorë: ditët, stinët, koha e natës kur është parë ëndrra, etj. Për shembull, ndërsa ëndrra e parë gjatë dimrit vërtetohet vonë, ëndrra e parë afër mëngjesit del shpejt. Ndërkaq, meqë natyrat e njerëzve janë të ndryshme, këto interpretime shpesh herë janë të mangëta.

Interpretimi "objektiv" është shkencor, vetëm se është i posaçëm vetëm për elitën dhe ka nevojë për zbulimin shpirtëror (keshf). Sepse mundësia për ta diferencuar ëndrrën në "djallëzore" apo "hyjnore" është një cilësi që varet nga meritimi i përjetimit të fanitjeve hyjnore⁸⁹. Për më tepër, meqë i kanë natyrat të ndryshme, interpretimi i ëndrrave të dy personave që shohin të njëjtën ëndërr, mund të jetë shumë i ndryshëm nga njëri-

88 Ky traktat i Hafiz Hulusiut ndër mësuesit e xhamisë Bajazit, është shtypur në Stamboll në vitin 1305 h.

89 Në origjinal: sünuhât-ı İlähiyye (osm.).





tjetri. Kurse aftësia për ta kuptuar këtë delikatesë kërkon një kompetencë shpirtërore.

Kështu, te Ibni Sirin-i shkojnë dy vetë dhe i tregojnë se e kanë parë veten në ëndërr si hatibë duke mbajtur hutbe. Endërrën e njërit, Ibni Sirini e interpreton me kuptimin se ka për të shkuar në haxh, kurse ëndërrën e tjetrit me kuptimin se ka për t'u dënuar me vdekje. Me të vërtetë, pas një kohe, njëri shkoi në haxh, kurse tjetri u dënua me vdekje.

Një ngjarje e ndodhur në kohën e Profetit është kështu:

Një grua i drejtohet Profetit (s.a.s) me kërkesën për t'ia interpretuar ëndërrën. Ajo i thotë se kishte parë në ëndërr t'i thyhej trau kryesor i shtëpisë dhe t'i binte sipër.

I Dërguari i Allahut e pyet gruan nëse e kishte të shoqin dhe, nëse e kishte, ku i ndodhej. Gruaja i thotë se e kishte në udhëtim dhe se nuk ishte kthyer ende. Atëherë, Profeti i thotë se burri do t'i kthehej shpejt shëndoshë e mirë dhe se ajo do të gëzohej. Dhe ashtu ndodh!

Në periudhën e kalifatit të Hz. Ebu Bekrit, kjo grua sheh të njëjtën ëndërr ndërsa i shoqi ndodhej në udhëtim, dhe i shkon kalifit për t'ia interpretuar ëndërrën. Si Profeti, edhe ai i kërkon gruas të dhëna mbi të shoqin dhe pastaj i thotë se i shoqi kishte vdekur gjatë udhëtimit.

E hutuar dhe e shqetësuar, gruaja i thotë Ebu Bekrit (r.a.):

"Të njëjtën ëndërr, i Dërguari i Allahut ma pati shpjeguar se im shoq do të kthehej shëndoshë!"

Atëherë, Ebu Bekri i thotë kështu:

"E drejtë! Atij ashtu i ka qenë zbuluar, kurse mua kështu m'u frymëzua!"

Dhe, pa shkuar shumë, kuptohet se interpretimi që kishte bërë kalifi, kishte qenë i drejtë!

Meqë gjatë ëndërrës, në botën e shembëllimeve vëzhgohen shumë e shumë gjendje jashtë mendjes dhe arsyes, imagjinare dhe të papërcaktuara, interpretimi i drejtë i tyre është mjaft i vështirë dhe, madje, është i pamundur pa një inteligjencë shpirtërore.

Në Kur'an, Zoti thotë se këtë dituri ia kishte dhënë profetit Jusuf (a.s.).⁹⁰

Kështu, ndërsa ndodhej në burg, Jusufi (a.s.) kishte dëgjuar ëndrrat e një bukëpjekësi e të një verëshërbyesi të pallatit. Bukëpjekësi kishte parë në ëndërr sikur po çonte bukë me një tavllë që e mbante mbi kokë dhe zogjtë e kishin sulmuar dhe ia kishin ngrënë bukën. Jusufi e kishte interpretuar se bukëpjekësi do të dënohej me vdekje nga mbreti, kurse zogjtë do të uleshin mbi kufomën e tij dhe do t'ia çukisnin kokën. Kurse sakiu, verëshërbyesi,

90 shih. Jusuf, ajetet 6 dhe 111.





kishte parë në ëndërr sikur po i shërbente mbretit po në atë pallat dhe Jusufi e kishte interpretuar se mbreti do ta nxirrte nga burgu dhe ai do të vazhdonte t'i shërbente përsëri mbretit si saki.

Këto interpretime ishin vërtetuar pastaj.

Siç e shprehëm edhe më lart, një pjesë e madhe e shkencës së interpretimit të ëndrrave mbështetet në zbulimin shpirtëror (keshf). Prandaj, interpretuesi duhet të jetë në një nivel të caktuar shpirtëror. Kështu, gjatë kohës kur ndodhesha në shkollën Imam-Hatip të Stambollit, mësuesi ynë, i ndjeri Xhelaledin Oktem Efendi dikur kishte qenë një mjeshtër i vërtetë interpretimi ëndrrash. Ai thoshte se interpretimi i ëndrrës mund të bëhej me një zemër të pastër e të kulluar dhe e kushtëzonte saktësinë e interpretimit me devocionin e interpretuesit.

Mësuesi ynë, Xhelaledin Oktem (r.alejh), në vitet e rinisë kishte dhënë mësim në lice dhe kishte bërë jetë të devotshme me një zemër të gjallë. Në ato vite, ishte bërë i njohur me interpretimet e qëlluara që bënte. Pasi na tregonte shumë nga ato interpretime të gjetura, na thoshte:

“Erdhi një kohë që kjo perde u mbyll për mua. Sepse mësimet e fesë u hoqën. Kurse mua më caktuan mësues filozofie. Dhe me të filluar të notoja mes teorive filozofike, burimet e zemrës m'u thanë!”

Një tjetër shembull i njohur mbi ëndrrat besnike është kështu:

Poeti i Kaside Byrdes së famshme, imam Busiri, një ditë, duke shkuar për në shtëpi, has në rrugë një plak fytyrëdritë. Plaku e pyet:

“O Busiri! A e pe mbrëmë në ëndërr të Dërguarin e Allahut?”

Imam Busiriu i përgjigjet:

“Jo, nuk e pashë!”

Pas kësaj replike të shkurtër, plaku largohet pa thënë gjë tjetër. Por fjalët e tij i japin hov dashurisë dhe pasionit që ndjente poeti në zemër për Profetin.

Atë natë, imami e sheh në ëndërr Profetin dhe kur zgjohet, vë re se është i mbushur plot gëzim e kënaqësi!

Pas kësaj, shkruan shumë eulogji për Profetin dhe për dashurinë dhe pasionin për të!

Pas një farë kohe, imam Busiriu pëson një paralizë të njëjës anë të trupit dhe vjen në një gjendje që të mos ecë e të mos lëvizë dot. Atëherë shkruan Kaside Byrden dhe i lutet Zotit t'i japë shërim.

Atë natë që e përfundon kasiden, e sheh në ëndërr Profetin dhe ia reciton kasiden. Në fund, Profeti, me duart e bekuara ia fërkon gjymtyrët e paralizuar Busiriut. Si vepër e një dashurie të thellë të tij për Profetin, kur zgjohet, Busiriu vë re se është shëruar plotësisht dhe e falenderon Allahun!





Atë ditë në mëngjes, duke shkuar në xhami mes një gëzimi të papërshtkruar pse i ishte kthyer shëndeti, Busiriu has në rrugë Shejh Ebu Rexha-në. Ky i thotë:

“O Busiri! A po na e këndon kasiden që lavdëron të Dërguarin e Allahut (s.a.s.)?”

Imam Busiriu e pyet:

“Kasidet e mia ku lavdërohet i Dërguari i Allahut (s.a.s.) janë të shumta. Cilën dëshironi?”

Shejh Ebu Rexha i thotë:

“Dua atë që e këndove në prani të të Dërguarit të Allahut sepse pashë që ai mbeti shumë i kënaqur nga ajo!”

Imam Busiriu që e dinte se atë kaside ende s’e kishte dëgjuar askush, mbetet i mahnitur!⁹¹

Në botën islame vihet re se, me pretekstin e zbulimit (keshf), zgjuarsisë shpirtërore (firaset), frymëzimit (ilham) dhe ëndrrave besnike, shembujt e të cilëve janë të shumtë, shumë të fshehta të botës së fshehtë (të padukshme) u bëhen të qarta njerëzve besnikë. Mirëpo, ndërkaq, deklarata e ajetit në vijim është një e vërtetë hyjnore:

“... Në qiej e në tokë, askush veç Allahut nuk e di të fshehtën!” (en-Neml, 65)

Në këto kushte, është nevoja për një sqarim.

Në fakt, ky sqarim ndodhet në përmbajtjen e hadithit të shenjtë që thotë:

“... dhe, kur ta dua robin tim, unë bëhem, pothuaj, veshi i tij që i dëgjon, syri që i sheh, dora që i zë, këmba që i ecën...” (Buhari, *Rikak*, 38) Qendra e zbulimit dhe frymëzimit është shpirti që i ka fryrë Zoti njeriut. Edhe pse në trup shihet me syrin e ballit, përballë dritës hyjnore që ndodhet në sytë e ballit, perdet e të fshehtës hapen në atë masë që dëshiron Allahu. Në këto kushte, është përsëri Allahu që e tregon të fshehtën, sepse njeriu nuk ka mundësi ta shohë, ta dëgjojë e ta njohë të fshehtën! Njohja e njeriut është vetëm në sajë të njoftimit favorizues të Allahut!

Në Kur’an, Zoti thotë duke njoftuar se ia ka bërë të ditura Profetit disa të fshehta:

“(O i Dërguar!) **Këto janë nga lajmet e fshehta që t’i njoftuam ty me rrugën e zbulesës...**” (Al-i Imran, 44)

Ndërkaq, e fshehta është dy llojesh: **e fshehtë absolute dhe e fshehtë relative.**

91 shih. İlhan Armutçuoğlu, *Kasîde-i Bürde Manzum Tercümesi*, s. 7-10.





E fshehta të cilën nuk mund ta dijë askush tjetër veç Allahut, është **e fshehtë absolute**. Mundësia e dikujt për të ditur diçka nga e fshehta absolute nuk varet nga inteligjenca e tij. Njohja e saj mund të bëhet vetëm me njoftimin e Allahut, gjë që është sa favori i Tij. Kurse **e fshehta relative** është e njohur për dikë dhe e panjohur për dikë tjetër. Për shembull, sasinë e parave që ka dikush në xhep, e di vetëm ai vetë. Diçka që mund të jetë e fshehtë për disa, mund të mos jetë e fshehtë për disa të tjerë.

Këtu, e fshehta për të cilën bëhet fjalë për robtë e urtë (veli) të Allahut, është e fshehtë absolute, e cila mund të dihet me anë të njoftimit të Allahut dhe me aq sa ta bëjë të ditur Ai!



Miqtë e vërtetë të Zotit, sadoqë të tregohen të saktë në parashikimet dhe përcaktimet që bëjnë, nuk ngrihen të pretendojnë se zotërojnë zbulimin (keshf) dhe zgjuarsinë shpirtërore (firaset). Ka njerëz të tillë që, kur i sheh në fytyrë, të kujtohet Allahu. Nga gjuha u derdhen pika urtësie dhe afërsie shpirtërore hyjnore. Nëse mund të shprehemi kështu, nuk flasin por sikur i bëjnë të tjerët të flasin. Pavarësisht nga kjo, përballë favoreve të Allahut përkulen më dysh. Sepse njeriu është një qenie e dobët. Duke e kaluar masën, mund të kapet nga krenaria. Kurse kur njeriu e sheh veten mbi të tjerët, kjo është fatkeqësia më e madhe për të! Atëherë, për t'ia tërhequr vëmendjen robit, Zoti mund ta bëjë atë ta shijojë dobinë e tij.

Në të vërtetë, zgjuarsia shpirtërore, zbulimi dhe ëndrrat besnike janë një favor i Allahut për robtë e tij të mirë (salih) duke ua frymëzuar atyre të vërtetat.






PJESA E KATËRT

DISA ÇËSHTJE MISTIKE

- A. PRETEKSTUALITETI (TEVESSUL)**
 - B. BEGATIMI (TEBERRUK)**
 - C. VIZITA NE VARRE**
- 



"Zemrat kënaqen vetëm me përmendjen e Allahut!" (er-Rad, 28)



DISA ÇESHTJE MISTIKE



O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe kërkoni pretekst për t'iu afruar Atij!.. (el-Maide, 35)



A. PRETEKSTUALITETI (TEVESSUL)

Çdo lloj rruge dhe mjeti që e afron robin në qëllimin dhe synimin e krijimit të vet, është një **pretekst** (vesile) dhe kapja pas këtyre preteksteve për t'iu afruar Allahut, është emërtuar **pretekstualitet** (teveessul). Kurse me kuptimin më specifik, pretekstualitet do të thotë që, duke i bërë pretekst së pari emrat e bukur (esma-ul husna), Kur'anin, punët dhe aktet e mira, profetët dhe personat e mirë (salih) me shpresën se do të bëhen shkak për pranimin e lutjes, të kërkohet diçka prej Allahut, t'i bëhet lutje dhe përgjërime Allahut për përfitimin e diçkaje të dëshiruar ose largimin e diçkaje të padëshiruar.

Në ajetin e 35-të të sures Maide të Kur'anit, thuhet:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَابْتَغُوا إِلَيْهِ الْوَسِيلَةَ

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe kërkoni pretekst për t'iu afruar Atij!..

Në ajet, fjala *vesile* (pretekst) është përmendur me kuptim absolut, pa i bërë asnjë kufizim. Nisur nga kjo, me pretekstet që duhen kërkuar për t'iu afruar Allahut, janë namazi, agjërimi, xhihadi dhe punë të tjera të mira të ngjashme. Ndërkaq, disa mufessirë (komentues të Kur'anit), krahas këtyre që u përmendën, janë shprehur se edhe hyrja nën edukimin e një prijësi të përkryer (murshid-i kâmil) me qëllim për t'u pajisur me moralin e Profetit (s.a.s.), është një pretekst (vesile).

Roli dhe veprimtaria e dijetarëve (alim) dhe e njerëzve të mirë (salih) për ta kthyer dhe drejtuar robin në rrugën e Zotit, nuk është një veprimtari klerikale, por një orientim dhe paralajmërim. Është udhërrëfim për udhëtarët. Ndryshe nga kjo, në krishterizëm ka klerikalizëm. Sipas tyre, kleriku është në pozitën e një ndërmjetësi të detyrueshëm mes Zotit





dhe robit. Kurse Islami e kundërshton dhe e hedh poshtë këtë. Pra, nuk mund të përfytyrohet një person i tretë mes Zotit dhe njeriut. Njeriu (robi) personalisht dhe në çdo çast mund t'i drejtohet drejtpërdrejt Zotit dhe t'i falet Atij!

Ndërsa çështja qëndron kështu, duke supozuar se, siç ndodh në klerikalizëm, myrshidët hyjnë mes myridit i cili përparon në rrugën moralo-shpirtërore, dhe Zotit, janë krijuar disa kundërshtime ndaj kësaj detyre të myrshidëve. Mirëpo klerikalizmi është pamundësia e një personi për ta adhuruar Zotin në mungesë të klerikut. Detyra që kryejnë dijetarët (ulema) dhe shehlerët (meshajih) kurrë nuk mund të krahasohet me detyrën që kryejnë klerikët krishterë, priftërinjtë dhe murgjit.

Kritikat mbi këtë specifike janë fjalë të pavend dhe të pahijshme. Këto e shmangin natyrën dhe përmbajtjen e vërtetë të pretekstit dhe pretekstualitetit. Kundërshtime të këtij tipi dalin më shumë mes njerëzve jashtë mjediseve mistike, të cilët nuk i njohin me kompetencë situatat e prijësve të përkryer të vërtetë. Për një mendim të tillë, disa herë bëhen shkak gabimet në veprimet e një pjese anëtarësh që nuk i kanë përvetësuar dot ashtu siç duhet metodat mistike. Megjithatë, edhe kjo është e pamundur të konsiderohet e drejtë. Sepse, ashtu siç nuk është e drejtë që të kundërshtohet një çështje (kauzë) për shkak të dobësisë, pamjaftueshmërisë dhe, herë, qëllimit të keq të personit pjesëmarrës në atë kauzë, ashtu dhe nuk është e drejtë që, në këtë çështje, të metat e personave t'i atribuohen çështjes së tyre. Atribuimi i të metave të tilla personale vlerave të larta që ata pretendojnë se i përfaqësojnë, nuk mund të jetë e drejtë as logjikisht. Kështu, sot, asnjë njeri me mend në kokë nuk mundet ta bëjë përgjegjës Islamit për shkak të të metave dhe gabimeve të muslimanëve.

Ashtu siç e shpjeguam edhe më lart, myrshidët e vërtetë kryejnë në rrugët moralo-shpirtërore një detyrë të ngjashme me udhëzimin që kryejnë dijetarët e vërtetë në vënien në zbatim të diturive formale. Detyra e prijësve të përkryer (kâmil murshid) nuk është hyrja mes robit dhe Zotit, por, mbështetur në përvojën dhe kulturën e prijësit të përkryer, përpjekja për t'i paralajmëruar dhe orientuar njerëzit në rrugën që shkon për tek Zoti, për t'i shpëtuar ata nga rreziqet dhe dëmet dhe për të siguruar që ta kapërcejnë me paqe rrugën e tyre. Ashtu siç në udhëtim, mjetin e udhëtimit s'e kemi qëllim, por mjet, edhe prijësi i përkryer është një mësues i cili ia mëson dhe praktikon myridit, nxënësit, njohuritë dhe edukimin e zemrës (edukimin ndjesor-afektiv), si dhe ia stolis atij botën e brendshme me moralin e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Madje, disa myridë - nëse kanë të dhëna dhe kapacitete – duke përparuar me shpejtësi, mund ta lënë pas





në fund myrshidin e tyre i cili në fillim u pati treguar rrugën dhe u pati hapur para vetes horizonte. Sipas një krahasimi formal, siç ka ndodhur në rastin e Shems-i Tebriziu dhe Hz. Mevlanasë.¹

Pra, prijësit e përkryer, pavarësisht nga rëndësia dhe vlera që kanë, kurrë nuk janë qëllim, por vetëm mjet, ndërmjetës.

Në fakt, në një kuptim, pretekstualiteti është që, duke e bërë udhërrëfyes prijësin e përkryer, i cili është një besimtar i pjekur dhe me përvojë, të kërkohet ndihma e tij udhërrëfuese për të kaluar paqësisht nëpër rrugët e ngushta ku rrëshqitja e këmbëve është me mundësi të madhe, dhe të përfitohet nga orientimi dhe begatitë e tyre shpirtërore. Me një kuptim tjetër, pretekstualiteti është përpjekja për t'i përfutuar pranueshmëri lutjes duke ua paraqitur dëshirën prijësve shpirtërorë për hir të Zotit që ata e duan, dhe jo përpjekja për t'u atribuar shenjtëri robve të mirë të Zotit!

Imam Maliku (r.alejh) thotë:

“Në kërkesat dhe lutjet tuaja, bëjeni pretekst të Dërguarin e Allahut (s.a.s.)!..”

Imam Xhezeri (k.s.) thotë:

“Për pranimin e lutjeve tuaja, përdorini si pretekst profetët dhe njerëzit e mirë!”

Një hadith profetik i rrëfyer nga sahabi Osman bin Hunejf (r.a.), është kështu:

Një i verbër shkoi te i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Lutiu Allahut që të ma shërojë sëmundjen e syve! Më vjen shumë vështirë që i kam sytë të verbër!”

Profeti (s.a.s.) i tha:

“Po të duash, duro, se kjo është më e dobishme për ty!”

Kurse i verbri nguli këmbë:

“O i Dërguari i Allahut! Unë s’kam asnjë njeri që të më kapë për dore dhe kjo gjendje më jep shumë mundim mua! Të lutem, lutu për mua që të më hapen sytë!”

Atëherë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i tha kështu:

“Shko, merr abdest, fal dy reqate namaz dhe pastaj lutu kështu:

“Allahu im! Po të drejtohem Ty dhe po të lutem Ty bashkë me të dërguarin tënd Muhammed që është profeti i mëshirës! O Muhammed! Po i drejtohem Zotit tim bashkë me ty që të më plotësohet nevoja! Allahu im! Bëje atë ndërmjetës të lutjes sime!” (Tirmidhi, *Deavat*, 118, Ahmed b. Hanbel, *Musned*, IV, 138)

1 Shems-i Tebriziu i cili zbuloi oqeanin moralo-shpirtëror që ndodhej fshehur në shpirtin e Hz. Mevlanait (poetit Xhelaleddin Rumi), ishte pothuaj si shkëndia që pritej t'i vinte flakën një deti me naftë! Kjo ishte detyra dhe kompetenca e tij. Me të vërtetë, kur i vuri zjarrin këtij deti, u përball me një shpërthim shpirtëror aq të madh, sa edhe vetë mbeti mes atij oqeani flake!





Në rivajetin e Hakimit thuhet edhe se i verbri u ngrit në këmbë me sytë që i shihnin! (Hakim, *Mustedrek*, I, 707-708)

Nga ana tjetër, rrëfëhet se edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), në lutjet e tij, shpesh ka përmendur fjalinë:

بِحَقِّ نَبِيِّكَ وَالْأَنْبِيَاءِ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِي

“(Pranoma lutjen) në emër të së drejtës së të dërguarit tënd dhe të të dërguarve të tjerë!” (Hejthemi, *Mexhmau’z-Zevaid*, IX, 257)

Në një hadith tjetër, Profeti (s.a.s.) ka thënë kështu:

“Kur Ademi (a.s.) kreu gabimin i cili u bë shkak për nxjerrjen e tij nga xhenneti, pasi e kuptoi gabimin, tha:

“O Zot! Në emër të së drejtës së Muhammedit, kërkoj të më falësh!” Allahu i Lartë e pyeti:

“O Adem! Ku e di ti Muhammedin kur unë s’e kam krijuar ende atë?²”

Ademi (a.s.) i tha:

“O Zot! Kur më krijove dhe më fryve nga shpirti yt, e ngrita kokën dhe pashë të shkruar mes shtyllave të arshit fjalinë “La ilahe il’allah, Muhammedu’r-Resulullah” dhe e mësova se Ti e lidh me emrin tënd vetëm më të dashurin e krijesave!”

Atëherë, Allahu i tha kështu:

“Drejt fole, o Adem! Me të vërtetë, ai është për mua më i dashuri i krijesave! Lutmu mua në emër të së drejtës së tij. (Meqë m’u lute), edhe unë të fala! Po të mos ishte Muhammedi, Nuk do të të kisha krijuar ty!” (Hakim, *Mustedrek*, II, 672)

Nga ana tjetër, në traditën islame, lutja fillon me hamdele dhe salvele dhe mbyllet me to. Salvele është një lutje dhe përgjërëm drejtuar Zotit për Profetin (s.a.s.) Ekziston opinioni dhe bindja se lutja (salavati) e bërë për Profetin nuk hidhet poshtë, por pranohet. Nga kjo e vërtetë buron fakti që ne i stolisim fillimin dhe fundin e lutjeve tona me salat dhe selam. Kështu, futja e lutjeve tona mes dy lutjeve me pranueshmëri absolute bëhet me mendimin për të siguruar edhe pranimin e tyre.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) pa një njeri që, pas namazit, bëri lutje pa e lavdëruar dhe falenderuar Allahun dhe pa bërë salat dhe selam për Profetin e Tij. Atëherë, tha:

2 Zoti, i cili eternalisht ka ekzistuar i vetëm, kur dëshiroi të njihej në nivelin njohës të njerëzve dhe xhindve, krijoi vanitetet, pra, çdo gjë tjetër që ekziston përveç Tij. Në këtë akt krijimi, krijimi i parë është “Drita Muhammediane”. Është për këtë arsye që i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë: “Kur Ademi ndodhej mes shpirtit dhe kurmit, unë isha profet.” (Tirmidhi, *Menakib*, 1) Sipas kësaj, Drita Muhammediane, elementi esencial i Profetit (s.a.s.), ndërsa është e para në krijim, është e fundit në veshjen me kurm dhe dërgimin si profet. Në këtë shprehje bëhet fjalë jo për Dritën Muhammediane, por për Individualitetin Muhammedian të dërguar me attribute njerëzore.





"Ky njeri u nxitua!"

Pastaj e thirri njeriun dhe i tha kështu:

"Kur njëri nga ju ka për të bërë lutje, në fillim ta lavdërojë e falenderojë Allahun, pastaj t'i dërgojë salat dhe selam Profetit. Dhe pastaj të lutet si të dëshirojë!" (Tirmidhi *Deavat*, 64)

Fakti që në lutjen e tij, robi e kërkon gjënë e dëshiruar për hir të respektit dhe konsideratës që kanë para Zotit profetët dhe trashëgimtarët e tyre, evlijatë, pastaj njerëzit e mirë (salih) që kanë një pozitë të lartë te Zoti, fakti që robi i lutet dhe i përgjërohet Allahut të Lartë me këto ndjenja duke i bërë pretekst njerëzit e dashur të Tij, është njëri prej institucioneve me rëndësi në tërheqjen e mëshirës hyjnore dhe pranueshmërinë e lutjes. Vetëm se lutja është vetëm ndaj Allahut. **Prandaj, në lutje, duke bërë pretekst njerëzit e dashur të Allahut, duhet lutur dhe kërkuar jo nga personi i tyre, por vetëm nga Allahu i Lartë.** Përmendja në lutje e personave të dashur nga Allahu është një mënyrë e përdorur vetëm si pretekst për pranimin e lutjes.

Veç kësaj, edhe preteksti me anë të personave të mirë (salih) e të virtytshëm, në të vërtetë do të thotë t'i bësh pretekst ata me aktet e tyre të mira dhe vetitë e tyre të larta. Sepse pozita e lartë dhe vlerat e larta të tyre te Zoti e kanë shkakun pikërisht te këto akte të mira të tyre.

Nisur nga kjo, edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), duke kërkuar ndihmë dhe fitore nga Allahu, lutej me pretekstin e muhaxhirëve (mekasve) të varfër³ dhe thoshte kështu:

"Thirr mëni të dobëtit tuaj, sepse ju ndihmoheni dhe furnizoheni vetëm (me lutjen dhe begatinë) e personave të dobët nga ju!" (Ebu Davud, *Xhihad*, 70; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, V, 198)

Është e padyshimtë se lutja e bërë me pretekstin e këtyre njerëzve të mirë të cilët nuk kanë ndonjë pozitë dhe pasuri që do t'u jepte mundësi të fitonin konsideratë para syve të njerëzve, të cilët janë kokulur dhe zemërthyer, por kanë zemër të pasur sepse e kanë të ngopur dhe janë të kënaqur me atë që u ka dhënë Zoti, është më e denjë për pranim!

Është mjaft me kuptim ky rivajet i Malik bin Dinarit në lidhje me arritjen e pëlqimit hyjnor duke bërë pretekst zemrat e thyera e të hidhëruara:

"Në një nga lutjet e tij përgjëruese, Musai (a.s.) iu drejtua kështu Zotit:

"O Zot! Ku të të kërkoj ty?"

Allahu i Lartë i tha:

"Më kërko pranë zemërthyerve!" (Ebu Nuajm, *Hilje*, II, 364)

Siç rrëfëhet nga Enesi (r.anh), Hz. Omeri (r.anh), gjatë thatësirës që pati ngjarë në kohë të kalifatit të vet, e merrte pranë Hz. Abbasin (r.anh), ungjin

3 Shih. Buhari, *Xhihad*, 76; Taberani, *Muxhemu'l-Kebir*, I, 292.





e Profetit (s.a.s.), dhe duke e mbajtur për pretekst për rënien e shiut, i lutej Zotit kështu:

“Allahu im! Dikur të drejtoheshim ty duke bërë për pretekst Profetin dhe Ti na dërgoje shi, kurse tani të drejtohem ty duke bërë pretekst ungujin e tij dhe të lutemi: dërgona shi!”

Atëherë, binte shi dhe njerëzit merrnin ujin që u duhej. (Buhari, *Istiska*, 3)

Sipas një rivajeti tjetër, Hz. Omeri (r.anh) i është lutur Zotit gjatë dhe me një lutje të ngarkuar me ndjenja mes lotësh dhe me përlulje, kështu:

“Allahu im! Edhe retë, edhe shiu janë tek Ti. Dërgonai retë dhe lëshona shi!”

Pas kësaj lutjeje, retë e kanë mbushur qiellin shtresa-shtresa dhe njerëzit kanë marrë shiun e begatshëm për të cilin janë bërë të merituar. Pas kësaj dhurate hyjnore, Hz. Omeri (r.anh) u ka thënë njerëzve:

“O njerëz! I Dërguari i Allahut e donte të ungujin Abbas siç donte një fëmijë që ia përkëdhelte kokën, e respektonte atë dhe betimin e tij e quante betim të vetin. O njerëz! Përsëriteni edhe ju këtë dashuri dhe respekt që tregonte i Dërguari i Allahut për të ungujin Abdullah! Dhe bëjeni atë (në lutjet tuaja ndaj Allahut) pretekst për t’u mbrojtur nga çdo e keqe që mund t’ju bjerë mbi krye!” (Hakim, *Mustedrek*, III, 377)

Sipas Ibni Abdil Berr-it, edhe rivajeti i mëposhtëm paraqet një përbërje me karakter ndriçues të kësaj çështjeje.

Për të bërë lutjen e shiut, Hz. Omeri mori me vete edhe Abbasin, u ngjit në një vend të lartë dhe u lut kështu:

“Allahu im! Ne po të afrohem ty së bashku me të ungujin e Profetit tonë dhe dëshirojmë ta bëjmë pretekst atë. Kujdesu për të për hir të të dërguarit tënd! Me të vërtetë, Ti je kujdesur për dy fëmijë jetimë për hir të pastërtisë dhe mirësisë së prindërve të tyre!⁴ Të erdhëm Ty duke bërë pendesë dhe duke të kërkuar ndihmë!”

Pastaj, Hz. Omeri (r.anh), duke u kthyer nga njerëzit, këndoi këto ajete:

“Kërkoni falje nga Zoti juaj, sepse Ai është falës i madh, që të zbresë shi me bollëk mbi ju, që t’ju shtojë pasurinë dhe fëmijët, që t’ju falë kopshte e t’i bëjë lumenjtë të rrjedhin për ju!” (Nuh, 10-12)

Pastaj edhe Abbasi (r.anh) u ngrit në këmbë dhe u lut. Sytë e Hz.

4 Me këtë fjalë, Hz. Omeri (r.anh) aludon për ajetin që bën fjalë për ndërhyrjen e Hizrit (a.s.) ndaj Hz. Musait:

“Sa për murin, ai ishte i dy fëmijëve jetimë të këtij qyteti. Nën mur ndodhej një thesar që u përkiste atyre. Edhe i ati kishte qenë njeri i mirë. Zoti deshi që ata dy jetimë të arrijnë moshën e pjekurisë dhe ta nxjerrin thesarin e tyre. (Kjo është) mëshira e Zotit tim. Unë as këtë s’e bëra nga vetja ime. Ja, kjo është fytyra e brendshme e gjërave për të cilat ti nuk tregove dot durim!” (el-Kehf, 82)





Abbasit lëshonin lot si lumë. Pasi Allahu u fali shi me këtë pretekst, njerëzit thanë:

“Qofsh i bekuar, o saki i dy qyteteve të shenjta!”

Dhe nisën ta preknin Abbasin. (Ibn-i Abdi'l-Berr, *Istiab*, II, 814-815)

Kjo ngjarje është një argument i hapur që tregon pretekstualitetin e një sahabiu me një sahabi tjetër. Ndërkaq, sipas disave pretekstualiteti i një personi të mirë (salih) është i mundur vetëm sa kohë ai ndodhet në jetë, kurse pas vdekjes ai s'mund të përdoret si pretekst. Por kufizimi i pretekstualitetit të Profetit vetëm me kohën në të gjallë të tij është një pikëpamje e ngushtë personale që nuk e reflekton të vërtetën. Fakti që Hz. Omeri (r.anh) i lutej Zotit duke thënë “dikur të drejtoheshim ty duke bërë për pretekst Profetin”, tregon se pretekstualiteti i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) i përket edhe kohës në të gjallë të tij, edhe kohës pas vdekjes së tij. Fundja, edhe pretekstualiteti me anë të Hz. Abbasit e ka shkakun te fakti që ai ishte i ungji i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). E thënë ndryshe, pozita së cilës i atribuohet preteksti si rrjedhojë e qenies së tij i afërm i Profetit, është vetë Profeti, edhe pse i vdekur. Si kjo, edhe paraqitja si pretekst e disa prej evlijave të mëdhenj pas vdekjes është e mundur dhe e realizueshme.⁵

Njëri prej shembujve më të qartë të kësaj është ky:

Dijetarët dhe nevojtaret e vizitonin varrin e Imam Adhamit, njërit prej burrave të mëdhenj të selefi salihinëve, dhe, duke e paraqitur atë si pretekst, gjenin dobi. Kështu, njëri prej tyre, Imam Shafiiu, tregon:

“Kur kisha ndonjë nevojë, falja dy reqate namaz, pastaj shkoja te varri i Ebu Hanifesë dhe atje i lutesha Allahut. Me begatinë e tij, nevoja më plotësohej menjëherë!”⁶



Nga ana tjetër, edhe aktet dhe punët e mira janë pretekst për shpëtimin nga vështirësitë. Në hadithin profetik, Profeti (s.a.s.) tregon kështu për tre shokë nga popujt e shkuar, të cilët kishin dalë në rrugë:

“Tre shokët që i zuri shiu gjatë rrugës, futen në një shpellë për të kaluar natën. Në këtë mes, nga mali bie një shkëmb që e zë hyrjen e shpellës. Dhe ata thonë:

“Nuk kemi zgjidhje tjetër veçse t'i lutemi Allahut me anë të punëve tona të mira. Përveç Allahut, askush s'na shpëton dot prej këtu!”

Njëri prej tyre bën për pretekst bindjen ndaj prindërve. Shkëmbi lëviz pak nga vendi, por dalja nuk hapet. I dyti bën për pretekst frikën ndaj Allahut, nderin dhe virtytin e vet. Shkëmbi lëviz edhe pak nga vendi, por dalja përsëri nuk hapet

5 Për të dhëna të hollësishme mbi çështjen, shih Zekeriya Güler, “*Vesile ve Tevessül Hadislerinin Kaynak Değeri*”, İLAM Araştırma Dergisi, vëll. II, nr. 1, f. 83-132.

6 El-Hejtemi, *el-Hajratu'l-Hisan*, f. 94.





sa duhet. Pastaj, i treti i lutet Allahut duke bërë për pretekst respektin që kishite treguar ai gjer atëherë ndaj të drejtave të të tjerëve. Atëherë, shkëmbi rrëshqet plotësisht nga hyrja e shpellës, dalja hapet krejt dhe shokët dalin jashtë!”⁷

Një faktor tjetër që bëhet pretekst për pranueshmërinë dhe zbatueshmërinë e lutjes janë emrat e bukur të Allahut.

Edhe lutja ndaj Zotit për pranimin nga ana e Tij të një sërë kërkesash duke përmendur ose përsëritur shumë emrat hyjnorë, është një rrugë pretekstualiteti shumë e përhapur.

Në ajetin kur’anor thuhet:

“Emrat më të bukur janë të Allahut. Pra, lutiuni Atij me këto emra!”

(el-Araf, 180)

Hz. Aisheja (r.anha) tregon se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) lutej kështu:

“Allahu im! Të lutem Ty me emrin tënd më të bekuar e më të dashur për Ty, me atë emër që, kur bëhet lutje me të, Ti e plotëson atë lutje, që, kur kërkohet diçka me të, Ti e jep atë që të kërkohet, që, kur kërkohet mëshirë me të, Ti mëshiron dhe që, kur të kërkohet ndihmë me të për të shpëtuar nga shqetësimet, Ti jep rrugëdalje dhe lehtësi!”

Në vazhdim të këtij hadithi profetik, rrëfëhet se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e ka pyetur Hz. Aishenë (r.anha):

“O Aishe! A e dije se Allahu i Lartë ma ka mësuar emrin me të cilin, po të bëhet lutje, lutja pranohet?”

Aisheja (r.anha) i është përgjigjur:

“Nënë e babë t’u bëfshin fli, o i Dërguari i Allahut, mësoma ti!”

Dhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i ka thënë:

“Atë emër nuk duhet të ta mësoj, o Aishe!”

Hz. Aisheja është larguar, është ulur diku dhe, pasi ka ndenjur pak, është afruar, ia ka puthur kokën Profetit dhe i ka thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Të lutem, mësoma atë emër edhe mua!”

Dhe Profeti i ka thënë përsëri:

“Atë emër nuk duhet të ta mësoj ty, o Aishe, sepse ti nuk duhet të kërkosh me atë emër asgjë nga kjo botë!”

Se ç’ndodhi më tej, Hz. Aisheja (r.anha) e tregon vetë.

“Atëherë unë u ngrita, mora abdest dhe, pasi fala dy reqate namaz, iu luta Zotit kështu:

“O Zot! Po të thërres ty me emrin “Allah” dhe po të lutem. Po të thërres “el-Rahman”, “el-Berr” dhe “er-Rahim”. Po të thërres me të gjitha emrat e bukur që di e që nuk di. Dhe po të lutem ty që të më falësh e që të më mëshirosh!”

Pasi i thashë këto fjalë, i Dërguari i Allahut buzëqeshi dhe tha:





“Pa dyshim, ai emër ndodhet mes emrash që përmende ti në lutje!” (Ibni Maxhe, Dua, 9).

Edhe Enes bin Maliku (r.anh) rrëfen një hadith të tillë:

I Dërguari i Allahut dëgjoi një njeri të lutej me këto fjalë:

“Allahu im, po të lutem ty duke thënë: “Lavdërimi të përket vetëm ty, nuk ka zot tjetër veç teje, ti nuk ke shok, ti jep shumë të mira (Mennan); qiejt dhe tokën ti i ke krijuar (Bedi), ti je i madh dhe bujar!”

Atëherë, i Dërguari i Allahut tha:

“Vallahi, ky njeri iu lut Zotit me emrin e madh të Allahut, me atë emër që, kur bëhet lutje me të, Allahu i përgjigjet lutjes dhe, kur kërkohet një gjë me të, Ai e plotëson kërkesën!” (Ibni Maxhe, Dua, 9; Nesai, *Sehv*, 58)

Siç kuptohet nga ky dhe hadithe të tjerë, edhe përdorimi si pretekst i emrave hyjnorë është sunnet i Profetit.



Disa dijetarë kanë thënë se mes fjalëve *tevessul, istiane, istigathe, tesheffu, tevexhxhuh* dhe *tebruk*⁸ që, në përgjithësi, përmenden si terminologji të *tasavvufit, mistikës islame, nuk ka ndonjë ndryshim në përmbajtje*.⁹

Këto fjalë që kanë kuptimin e kërkimit të ndihmës, shprehin kërkesën për *himm*et (influencë) nga miqtë e Zotit qoftë para tyre, qoftë në mungesë të tyre, të cilët kanë kompetencë për të ndërhyrë dhe influencuar. Të kërkosh *influencim* (himm)et nga personat e mirë (salih) që besohet se ndodhen në gradë të lartë moralo-shpirtërore, do të thotë të kërkosh prej tyre të bëhen pretekst (vesile) në rrugën për të arritur synimin. Kjo realizohet prej tyre me anë të lutjeve, konsideratës dhe interesimit të afërt të tyre.

Fjala *himm*et (influencë, *influencim*) përdoret, në përgjithësi, për të shënuar ndihmën me anë të *influencimit* nga ana e robve të zgjedhur të Allahut, kurse për të shënuar ndihmën e Allahut, përdoren fjalë të tilla, si *nusret* dhe *tevfik*.¹⁰

Në fakt, është Allahu i Lartë që ndihmon ose që ka për të ndihmuar. Ta konsiderosh përdorimin e pretekstualitetit në lutjet drejtuar Allahut si kërkim ndihme nga dikush tjetër veç Tij, është diçka sa e pavend, aq dhe e pajustificueshme¹¹, sepse personi të cilit i drejtohet në pretekstualitet është vetë dhe vetëm Allahu i Lartë!

8 Përkatësisht: pretekstualitet, kërkim ndihme, lutje për ndihmë, meritim ndërmjetësimi, interesim (konsideratë), begatim.

9 shih. Subki, *Shifau's-Sekam fi Zijarati Hajri'l-Enam*, f. 133-134.

10 Kjo është një çështje e semantikës dhe e logjikës së gjuhës.

11 Këtu, fjalën *muvafik* të përdorur në origjinal e përkthym në mënyrë të perifrastuar me shprehjen *diçka sa e pavend, aq dhe e pajustificueshme* sepse pikërisht këtë kërkon të thotë dhe këtë e argumenton më poshtë.





Në ajetet kur'anore thuhet:

وَمَا النَّصْرُ إِلَّا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ

“... ndihma (nusret) është vetëm e vetëm te Allahu...” (en-Enfal, 10)

“Po t’ju ndihmojë Allahu, s’ka më kush t’ju mundë, por po t’ju lërë pa ndihmë, kush ka për t’ju ndihmuar pastaj? Tashmë besimtarët t’i besojnë vetëm Allahut dhe të mbështeten vetëm tek Ai!” (Al-i Imran, 160)

Abdullah ibni Abbas (r.anhuma) tregon:

Një ditë, kisha hipur në vithe të devesë së të Dërguarit të Allahut. Ai më tha: “O bir, do të të them disa fjalë që duhet t’i ngulësh mirë në mendje. Respektoje Allahun (respektoji urdhrat dhe ndalimet e Tij) që edhe Ai të kujdeset për ty e të të mbrojë! Në çdo punë vëre para Allahun (pëlqimin e Allahut) që ta gjesh para vetes Atë! Nëse kërkon një gjë, nga Allahu kërkoje! Nëse do të lutësh ndihmë, nga Allahu lute! Dhe dije mirë se edhe sikur të mblidhen tërë njerëzit e të përpiqen për të të ndihmuar, mund të të ndihmojnë vetëm me aq sa ç’e ka caktuar Allahu për ty dhe edhe sikur të mblidhen tërë njerëzit për të të bërë dëm, mund të të dëmtojnë vetëm me aq sa ç’e ka caktuar Allahu për ty!..” (Tirmidhi, Kijamet, 59)

Besimtarët jo vetëm e pranojnë kështu këtë të vërtetë, por edhe e pohojnë vazhdimisht në çdo rekat të namazeve të tyre në ajetin e sures Fatiha që thotë:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

“(Zoti ynë!) Vetëm Ty të adhurojmë dhe ndihmën vetëm prej Teje e kërkojmë!”

Në lidhje me ndihmën hyjnore të përjetuar në luftën e Bedrit, Allahu i ka thënë kështu të Dërguarit të Tij (s.a.s.):

“... dhe kur qëllove, nuk qëllove ti, por ishte Allahu që qëlloi!..” (el-Enfal, 17)

Pra, në të gjitha llojet e ndihmës dhe favorit të përjetuar nga njeriu, Allahu është autori i vërtetë dhe absolut!

Fakti që disa besimtarë, në lutjet e tyre të sinqerta të bëra me dëshirën për t’iu afruar Allahut, ndërkaq, pa pasur asnjë qëllim mohimi dhe herezie, shpresojnë ndihmën moral-shpirtërore të njerëzve të mirë (salih), bart një natyrë begatimi nga mëshira e shpresuar të zbresë me anë të thirrjes së tyre drejtuar saj. Kjo bëhet për shfaqjen e një lloj klime moral-shpirtërore, e frymëzimit dhe begatisë. Por çdo gjë bëhet vetëm e vetëm me dëshirën volitive të Allahut. Personi të cilit i kërkohet pretekstualitet, nuk është autori. Autori i vërtetë dhe absolut i akteve është Allahu, për rrjedhojë, ai që në të vërtetë ndihmon, është vetëm Ai!





Veprimi që bëjnë disa njerëz të cilët, në mungesë të njerëzve të mirë (salih) ose gjatë vizitës në varret e tyre, u drejtohen drejtpërdrejt atyre me lutje të tilla, si "O ti, filani, shëromë mua ose ma plotëso këtë nevojë!", është veprim jashtëzakonisht i gabuar dhe një kërkim ndihme (istigathe) që mund të çojë në politeizëm (herezi). Pa dyshim, edhe nëse për këto lloj lutjesh për ndihmë (istigathe) mund të bëhen një sërë interpretimesh, duhet ruajtur me forcë nga këto lloj veprimesh injorante të cilat mund ta trondisin thelbin mjaft delikat të tevhidit (besimit monoteist islam mbi Zotin). Këto lloj shprehjesh që lënë përshtypjen se në eliminimin e vështirësive, në drejtimin dhe administrimin e gjithësisë mund të ekzistojë aplikimi absolut edhe i dikujt tjetër veç Allahut, kurrë nuk duhen përdorur.¹²



12. Ata që thonë se këto lloj shprehjesh mund të përdoren, kanë pretenduar se në artin e oratorisë këto janë metaforë racionale (meczaz-i akli). Metafora racionale është atribuimi i aktit jo autorit të vërtetë të tij, por një gjëje që ka lidhje me të, si vendit, kohës, shkakut, etj. Sipas këtij arti letrar, për shembull, në ajetin "... dhe kur toka të nxjerrë jashtë të brendshmet, ..." (ez-Zilzal, 2), megjithëse është Allahu që i nxjerr jashtë të brendshmet që ka toka, akti nuk i është atribuar autorit të vërtetë, por vendit të aktit, por është aluduar Allahut.

Pra, edhe sufitet thonë se besojnë që personi që i kërkohet ndihmë nuk është autori i vërtetë, por ai që ndihmon në të vërtetë është Allahu, dhe se prej Tij kërkojnë. (Ndërkaq, edhe ata e pranojnë se, në të kundërt, kjo do të ishte herezi.)

Në lidhje me këtë, Muhammed Ebu Zehra thotë kështu:

"Fjalët e popullit të thjeshtë dhe të muslimanëve të paditur interpretohen me kuptimin më të afërt. E mira është jo të pengohen ata për ta vizituar varrin e Profetit, por të orientohen. E mira është jo të akuzohen ata për mohim apo herezi, por të sqarohen dhe mësohen. Pa dyshim, Allahu i Lartë do ta mbrojë tevhidin (besimin monoteist islam) gjër në kiamet. Profeti (s.a.s.), në kohët e fundit të jetës i ka përgëzuar besimtarët duke ua bërë të ditur se e kishte prerë shpresën se në atë vend shejtani do të adhurohej përsëri. Prandaj, Ibni Tejmije le të mos ketë frikë më për tevhidin!" (Ebu Zehra, *Ibnu Tejmije*, f. 326).

Edhe thirrjet (eksklamacionet) "medet ja Resulullah" (na shpëto, o i Dërguari i Allahut!) që përsëriten në letërsinë fetare me pretekste të ndryshme, kanë kuptimin e thirrjes drejtuar tij duke shpresuar shefaatin e tij (ndërrhyrjen e tij për falje) në ahiret (në jetën e pasme). Fakti që disa njerëz e shohin edhe këtë si shirk (herezi), është pa vend. Sepse, fundja, çdo besimtar beson qysh më parë se edhe shefaati i Profetit (s.a.s.) do të realizohet vetëm me dëshirën e Zotit!





Respekti që tregohet për kujtimet e shtrenjta të të Dërguarit të Allahut është produkt i afërsisë dhe dashurisë së ndjerë për të, i lidhjes ndjesore ndaj tij!



B. BEGATIMI (TEBERRUK)

Teberruk (begatim) do të thotë, në fakt, kërkim begatie. *Teberruk* (begatim) shpreh meritimin e begatimit dhe shtimit (shumimit) nëpërmjet diçkaje.

Begatimi me mbetjet ushqimore

Ngrënia-pirja e mbetjeve ushqimore (të ngrënshme ose të pijshme) të evlijave (evlijaullah-njerëzve të urtë, njerëzve të afërt të Allahut) është një prej mjeteve të përdorura për efekte shpirtërore. Edhe kjo situatë cilësore nuk është e pabazë dhe e llojit të pseudonovatorizmave (bid'at) siç pandehin disa. Në veprat e hadithit dhe ato bio-bibliografike (sijer) ka shembuj të ndryshëm mbi realizimin e kësaj disa herë në jetën e Profetit (s.a.s.).

Në kohë dhe mjedise të ndryshme, veçanërisht në fushatën e Tebukut, sahabet janë begatuar me mbetjet e bekuara të të ngrënave të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Kur në Tebuk u shfaq mungesë uji, Profeti pikoi pak ujë nga gishtërinjtë, pastaj nga gishti i madh rodhi ujë si burim, me atë ujë u mbushën calikët, pinë sahabet dhe u bë furnizimi me ujë i ushtrisë.¹³ Ky ujë i rrjedhur nga gishti i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) është, pa dyshim, më i mirë e më shërues se zemzemi, sepse ka rrjedhur nga gishtat e nurshëm të tij dhe nga kurmi i bekuar i tij.

Siç shprehen disa hadithe, kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) pinte qumësht, u jepte edhe sahabeve nga mbetja në enë, kështu, edhe tek ai që pinte ndodhte tejçim begatimi, edhe te qumështi ndodhte shtim dhe qumështi nuk pakësohej.

13 Këtë dukuri dhe ngjarje autori e shpjegon si *begatim* dhe për natyrën e saj përdor ndajfoljen *teberruken*, që do të thotë me *begatim*, në mënyrë *begatuese*.





Sehl bin Sa'd (r.anh) rrëfen kështu:

Të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) i kishin sjellë një shurup. Ai piu pak. Në të djathtë kishte një fëmijë, kurse në të majtë ishin ulur pleq nga sahabet. Duke iu drejtuar fëmijës me një delikatesë të pashoqe, i tha:

"A më lejon t'u jap të pijnë këtyre të mëdhenjve?"

Dhe ai fëmijë i mençur dha atë përgjigje të madhe që i habiti të gjithë dhe që mund të bëhet model për njerëzimin:

"O i Dërguari i Allahut! S'ia jap askujt pjesën që më jepet prej teje!"

Atëherë, Profeti ynë i dashur ia dha fëmijës shurupin që mbante në dorën e bekuar. (Buhari, *Eshribe*, 19)

Esmā binti Ebi Bekr tregon kështu:

Kur ndodhesha me barrë në Abdullah bin Zubejrin, emigrova pranë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Arrita në Medinë dhe bëra konak në Kuba. Aty lindi Abdullahu. Pastaj, bashkë me të, shkova te i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Ai e mori fëmijën në prehër dhe kërkoi një hurmë. Pasi e përtypi pak hurmën në gojë, një copë të vogël prej saj ia vuri fëmijës në gojë. Ajo u bë "kafshata" e parë që zbriti në stomakun e Abdullahut. I Dërguari i Allahut u lut dhe kërkoi nga Allahu begati për të.¹⁴

Ato ditë kur e mori si mik Profetin (s.a.s.), Ebu Ejub el-Ensariu gatuante gjellë dhe ai dërgonte. Kur kthehej gjella, kërkonte të dinte dhe pyeste se në ç'vende kishin prekur gishtat e Profetit të Botëve. (Muslim, *Eshribe*, 170-171)

Edhe Hz. Xhabiri (r.anh) na e përcjell kështu një kujtim nga ato kohë të vështira para luftës së Hendekut kur po hapeshin hendeqet përreth Medinës:

Duke gërmuar hendek, hasëm në një shkëmb shumë të fortë. Pasi sahabet shkuan te i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe ia paraqitën gjendjen, ai zbriti vetë në hendek. E mori kazmën në dorë dhe e goditi shkëmbin që u thërrmua si rërë. Ndërsa po ndodhte kjo shfaqje mrekullie, pamë se Profeti kishte lidhur gurë në bark nga uria. Me të vërtetë, s'kishim ngrënë gjë qysh prej tri ditësh që ndodheshim aty. Atëherë, unë i thashë:

"O i Dërguari i Allahut! Më lejo të shkoj gjer në shtëpi!"

Më dha leje dhe shkova. I thashë gruas:

"S'e duroj dot gjendjen e të Dërguarit të Allahut! A s'ka ndonjë gjë për të ngrënë në shtëpi?"

Gruaja më tha:

"Pak elb dhe një kec!"

Unë e thera kecin, kurse gruaja gatoi bukë elbi. E vumë mishin në tenxhere. Ndërsa buka piqej dhe mishi zjente, unë shkova te Profeti dhe iu luta:

¹⁴ shih. Buhari, *Akika*, 1.





“Kemi pak gjë për të ngrënë! Urdhëroni bashkë me nja dy vetë!”

Profeti (s.a.s.) më pyeti:

“Sa ushqim keni?”

Ia tregova.

“Edhe shumë qenka, edhe shumë e mirë! Thuaji gruas të mos e heqë tenxherenë nga zjarri dhe bukën nga furra gjersa të vijmë ne!” – Më tha. Pastaj iu drejtua shokëve: “Ngrehuni!” Muhaxhirët dhe ensarët u ngritën së bashku.

Unë shkova para në shtëpi dhe, i turbulluar pak nga dyshimi se a do t’u mjaftonte, vallë, ushqimi të gjithëve, i thashë gruas:

“Ja, Profeti (s.a.s) bashkë me muhaxhirët, ensarët e të tjerë, po vijnë!”

Gruaja më pyeti:

“A nuk të pyeti i Dërguari i Allahut se sa ushqim kemi?”

“Po, më pyeti!” – I thashë.

“Atëherë, rri i qetë!”

Profeti (s.a.s.) u tha të ardhurve:

“Hyni, mos u druani!”

Pastaj nisi të priste bukë, t’i vinte sipër një copë mish, ta njomte me lëng mishi dhe t’ia jepte secilit. Më në fund, të gjithë shokët u ngopën dhe mbeti edhe pak ushqim. Profeti iu drejtua time shoqeje dhe i tha:

“Hani prej kësaj, jepuni edhe komshinjve se uria e përfshiu tërë vendin!”

(Buhari, Megazi, 29; Muslim, Eshribe, 141)

Begatimi me sende

Është një e vërtetë se një send (objekt çfarëdo, rrobë, etj.) i cili na e kujton njeriun e dashur, duke na bërë të mendojmë për të e të prekemi në ndjenja, na e forcon lidhjen me të. Kjo dukuri është domosdoshmëri e një specifike përbërëse të natyrës njerëzore. Ndërkaq, është po kaq një e vërtetë historike se teprimi ekstrem në këtë ndjenjë dhe qëndrim arrin gjer në idolatri^{15,16}

15 Përdorëm fjalën *idolatri* dhe jo *idhujtari*, sepse *idolatri* është termi specifik që e emërtonte këtë çështje.

16 Kështu, në historinë e feve, *aberracioni* (shmangia) *bestyt* i quajtur fetishizëm që është adhurimi i gjërave të lëna nga heronjtë kombëtarë dhe atribuimi atyre hyjnit, është një aberracion botëkuptimor dhe shpirtëror historik i lindur nga përdhunimi i kufirit të natyrshmërisë së kësaj ndjenje dhe prirjeje njerëzore. Në këtë mes, le të sqarojmë se rrokja e koncepteve abstrakte është mjaft e vështirë. Është si rrjedhojë e kësaj vështirësie që një sërë njerëzish, për ta pranuar Krijuesin i cili është qenia më abstrakte, kanë përdorur rrugën e personifikimit të Tij në qenie lëndore (materiale). Nga kjo dobësi njerëzore ka lindur *idolatria*. Ndërkaq, të vërtetat abstrakte kanë shfaqjet e tyre jomateriale në personifikimet. Për njerëzit me gjykim të shëndoshë, e drejtë është rrokja e reflektimeve, jehonave dhe shfaqjeve të të vërtetave abstrakte në sendet fizike me qëllim për të kaluar nga vepra te autori. Kështu njihet edhe Allahu, edhe shpirti. E tillë qëndron çështja edhe për konceptet e tjera abstrakte.





Nga ana tjetër, përfshirja edhe e sendeve të njeriut të dashur, të cilat na e kujtojnë atë, në afërsinë dhe dashurinë ndaj tij, është një prirje njerëzore dhe e natyrshme. E rëndësishme është që kjo të mos çohet gjer në teprim. Me të vërtetë, konceptet abstrakte reflektohen te qeniet (sendet) konkrete si gjendje (situatë) dhe cilësi.

Shembulli më i gjallë i shfaqjes situacionale dhe cilësore te sendet, i përmendur në Kur'an, është ky:

Kur këmisha e Jusufit (a.s.) u nxuar nga Egjipti në rrugë për t'iu dërguar të atit, Jakubit (a.s.) tashmë të verbër, ky i fundit, i cili në atë kohë ndodhej në Palestinë, e kapi kundërmimin e këmishës dhe, pastaj, kur ia prunë dhe fërkoj sytë me të, filloi të shihte.¹⁷

Ky efekt i realizuar me anë të sendeve është një nga mjetet që përdor prijësi i përkryer për ta mbajtur nxënësin, udhëtarin e rrugës mistike, në një konsistencë të caktuar. Sepse përjetimi i njëkohshëm i këtyre reflektimeve e forcon lidhjen shpirtërore. Në të njëjtën kohë, kjo është edhe shprehje e traditës së shkëmbimit të dhuratave në sende të ndryshme.

Ndërsa ndodhej së bashku me sahabet në mëhallën Beni Saide, i Dërguari i Allahut i kërkoi ujë Sehl bin Sa'd-it:

"O Sehl, a po na jep ujë për të pirë?"

Sehli i solli Profetit një gotë¹⁸ ujë.

Siç duket, Sehli duhet ta kishte ruajtur atë gotë, që Ebu Hazm (r.anh) tregon kështu:

"Sehli e nxori gotën dhe na e tregoi dhe ne pimë ujë prej saj. Pastaj, Omer bin Abdulazizi iu lut Sehlit t'ia falte atë gotë të bekuar. Dhe Sehli ia dhuroi!" (Buhari, *Eshribe*, 30)



Sehl bin Sa'd (r.anh) tregon:

Një kadi i solli Profetit një hirkë.

"O i Dërguari i Allahut, dëshiroj të ta dhuroj ty këtë hirkë!" – I tha. Profeti (s.a.s.) e pranoi dhuratën dhe e veshi. Ndërkaq, njëri nga sahabet i tha Profetit:

"O i Dërguari i Allahut, ç'rrobë e bukur kjo, a po ma dhuron mua?"

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i tha: "Punë që bëhet!" Dhe ia dha hirkën menjëherë.

Pasi u largua Profeti, sahabet e tjerë e qortuan personin që ia mori hirkën Profetit:

17 shih. Kur'ani, Jusuf: 93-96.

18 Këtu është fjala jo për gotë si tonat, por për ndonjë lloj sapllakeje druri apo metali që përdorej atëherë për të pirë ujë.





“S’bëre aspak mirë! I Dërguari i Allahut e mori sepse kishte nevojë për të. Ti e di se po t’i kërkohet një gjë të Dërguarit të Allahut i cili është mëshirë për botët, kurrë nuk e kthen kërkesën prapë!”

Kurse njeriu tha kështu:

“Unë desha të begatohesha me të sepse e veshi i Dërguari i Allahut! Dhe kam shpresë që të qefinosem me të!” (Buhari, Edeb, 39)



Hz. Aisheja (r.anha) thotë:

“Në Mekë, për kurejshët nuk kishte gjë më të këndshme se fjetja mbi shtrat tezgë¹⁹.”

Kur i Dërguari i Allahut erdhi në Medinë dhe zbriti në shtëpinë e Ebu Ejubit, e pyeti:

“O Ebu Ejub, a s’ju ndodhet shtrat tezgë juve?”

Ebu Ejubi (r.anh) iu përgjigj:

“Jo, vallahi!”

Kur e mori vesh këtë Sa’d bin Dhurare nga ensarët i dërgoi Profetit (s.a.s.) një shtrat tezgë prej dru lisi të thurur sipër me fije liri dhe të mbështjellë me rrogoz.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) u preh mbi të gjersa u bartëm në shtëpinë tonë dhe e përdori atë gjersa vdiq.

Kur vdiq, mbi të u la e u qefinos dhe i shtrirë mbi të iu fal namazi i të vdekurit.

Pastaj njerëzit na e kërkonin atë tezgë për të bartur të vdekurit e tyre dhe gjenin begati me të.

Edhe kufomat e Hz. Ebu Bekrit dhe Hz. Omerit qenë bartur mbi atë tezgë.” (Belazuri, Ensabu’l-Eshraf, I, 525)



Një ngjarje tjetër është kështu:

Ebu Hurejre (r.anh) i cili është, ndër sahabet, ai që ka rrëfyer më shumë hadithe, ndodhej vazhdimisht pranë Profetit (s.a.s.) dhe ndiqte çdo qëndrim, çdo lëvizje e çdo veprim të tij. Një ditë, Ebu Hurejre (r.anh) iu ankua kështu Profetit (s.a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Dëgjoj shumë hadithe prej teje, por shumicën prej tyre s’e mbaj dot në kujtesë!”

Atëherë, Profeti (s.a.s.) i tha:

“Shtrihe rrobën përtokë!”

19 Emërtimi origjinal: serir (shtrojë), një lloj shtrati dërrase si tezgë i vendosur mbi kambaleca dhe i bartshëm.





Ai e shtriu.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) u lut për të, pastaj bëri sikur po merrte diçka në duar dhe sikur po e hidhte mbi rrobë. Pastaj i tha:

"Mblidhe rrobën!"

Ebu Hurejre (r.anh) e mblodhi rrobën dhe Allahu i Lartë i fali një kujtesë aq të fuqishme, sa aty e tutje ai s'harronte më asgjë! (Tirmidhi, *Menakib*, 46)



Ishte një sahabi me emrin Firas. Edhe ai donte të kishte një send nga të Profetit. Një ditë, kur shkoi pranë Profetit (s.a.s.) dhe e pa se po hante gjellë nga një enë që kishte para, iu lut t'ia falte atë enë dhe Profeti (s.a.s.) i cili nuk kthente prapë askënd, ia dhuroi enën.

Pastaj, Hz. Omeri (r.anh) shkante herë pas here në shtëpinë e Firasit dhe i thoshte:

"Pa na e sill atë enë të bekuar!"

Pastaj e mbushte me ujë zemzemi atë enë që e kishin prekur duart e bekuara të Profetit, i cili ishte Habibullah, i dashuri i Allahut, pinte sa ngopej dhe tepricën ia hidhte fytyrës e kokës. (Ibni Haxher, el-Isabe, III, 202)



Ebu Xhuhajfe (r.anh) tregon:

*I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në vapën e drekës u ngjit në Batha. Mori abdest dhe i fali namazet e drekës dhe iqindisë nga dy reqate. Para i ndodhej një heshtë e shkurtër. Në atë mes, pashë se njerëzit ishin ngritur, ia preknin Profetit (s.a.s.) duart e bekuara dhe pastaj fërkonin fytyrat. Edhe unë ia preka njërën dorë dhe atë dorë të bekuar e fërkova në fytyrën time. Por ç'të shoh? Dora e tij e bekuar ishte më e freskët se bora dhe më erëmirë se myshku! (Buhari, *Menakib*, 23)*



Duke na treguar për haxhin e Profetit (s.a.s.), Enes bin Maliku (r.anh) na e përshkroi kështu se si bënëin garë ata për t'u begatuar me flokët e tij:

Pasi i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e përfundoi gjuajtjen e shejtanit me gurë, theri kurbanin dhe u qeth. Berberi ia kapi flokët e anës së djathtë dhe ia shkurttoi. Profeti (s.a.s.) e thirri Ebu Talhanë dhe ia dha flokët atij. Pastaj berberi kapi flokët e anës së majtë. Profeti i tha: "Preji!" Dhe ai i preu. Profeti ia dha Ebu Talhasë duke i thënë:

"Ndaji këto mes njerëzve!" (Muslim, Haxh, 326)

*Enesi (r.anh) tregon: "E pashë të Dërguarin e Allahut që po e qethte berberi. Kurse sahabet e kishin rrethuar nga të gjitha anët si flutura. Ata donin që asnjë fije floku të mos binte përtokë, që çdo fije floku të binte patjetër në dorën e njërërit prej tyre!" (Muslim, *Fezail*, 75)*





Me të vërtetë, sahabet bujarë përjetonin një gjendje begatimi edhe me sendet e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), edhe me fijet e bekuara të flokëve dhe mjekrës së tij. Ata e patën bartur këtë emocion begatimi edhe në luftëra. Njëri prej shembujve të bukur të kësaj është fshehja nga Halid bin Velidi në çallmë e disa fijeve të bekuara nga flokët e Profetit. Siç rrëfëhet, në luftën e Jermukut, Halidi (r.anh) e pati humbur çallmën. Ai u dha urdhër ushtarëve t'ia gjenin çallmën. Por, megjithëse e kërkuan, nuk e gjetën. Halidi u dha urdhër prapë që ta kërkonin. Më në fund, e gjetën. Dhe panë se paskej qenë një çallmë mjaft e vjetër! Sahabet u habitën se pse kshte ngulur këmbë kaq shumë Halidi (r.anh) për atë çallmë. Atëherë, ai u tha:

“I Dërguari i Allahut (s.a.s.) kishte qethur flokët. Sahabet i rrëmbyen flokët. Edhe unë mora disa fije prej tyre dhe i vura brenda kësaj çallme. Dhe kjo u bë një begati aq e madhe për mua, saqë të gjitha luftërat ku shkova me të, i fitova! E fshehta e fitoreve të mia është afërsia dhe dashuria ime për të Dërguarin e Allahut (s.a.s)!” (Hejthemi, *Mexhmau'z-Zevaid*, IX, 349)



Këto ngjarje të zhvilluara para syve të sahabeve janë një argument tjetër i faktit që ndenjat mund të teçohen edhe te sendet, madje! E rëndësishme është zotërimi i një ngacmueshmërie ndjesore të aftë për të marrë begati nga ai reflektim me kusht që të mos kapërcehet kufiri për të cilin personi është i denjë.

Pas sahabeve, edhe selefi salihinët i vazhduan në kohët e tyre këto lloj praktikash në lidhje me begatimin. Një shembull i bukur i kësaj është ngjarja e zhvilluar mes imam Ahmed b. Hanbelit dhe imam Shafiut.

Nxënësi i imam Shafiut, Rabi bin Sulejman, tregon:

Një ditë, imam Shafiu më tha:

“Rabi, merre këtë letër, çoja Ahmed b. Hanbelit dhe më sill përgjigje!”

E mora letrën dhe shkova në Bagdat. Në namazin e mëngjesit u takova me Ahmed bin Hanbelin. Namazin e falëm së bashku. Pasi imam Ahmed bin Hanbeli u largua nga mihrabi, duke ia drejtuar letrën i thashë:

“Kjo është letra që ta dërgon nga Egjipti im vëlla imam Shafiu!”

Ai më pyeti: “A e di se për çfarë bën fjalë letra?”

“Jo!” – I thashë unë. Ahmed bin Hanbeli e zgjidhi vulën mbi letër dhe nisi ta lexonte. Menjëherë, sytë iu mbushën me lot. Unë e pyeta:

“O imam, qoftë për mbarë! Ç'shkruhet në letër?”

Ai më tha:

“Imam Shafiu e paska parë në ëndërr Profetin (s.a.s.), i cili i paska thënë:

“Shkruaj një letër Ahmed bin Hanbelit dhe bëji të fala nga unë. Ai do t'i nënshtrohet një intrige të madhe dhe do t'i kërkohet të thotë se “Kur’ani është i sajuar nga njerëzit!” Kurrsesi të mos i nënshtrohet kësaj kërkesë! Allahu do ta mbajë gjallë e do ta lartësojë emrin e tij gjer në kiamet!”





Unë i thashë:

“O imam! Ç’përgëzim i madh ky për ty!”

Atëherë, imam Ahmed b. Hanbeli, nga gëzimi, e nxori këmishën dhe ma dha mua. Pasi e mora përgjigjen, u ktheva në Egjipt. Letrën ia dhashë imam Shafiut. Imam Shafiu më tha:

“Ne s’duam të të dëshpërojmë duke ta marrë atë këmishë. Por, të paktën, fute atë në ujë dhe na e jep atë ujë neve që edhe ne të bëhemi, kështu, pjesëtarë të begatisë së kësaj këmishe!”²⁰



Fijet e flokëve të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) të ruajtura me shumë kujdes në minberet e xhamive, si një fllad i begatë i ardhur nga shekulli i lumtur gjer në ditët tona, vazhdojnë të jenë mëshirë për ummetin, bashkësinë muslimane. Respekti i treguar ndaj kujtimeve të çmuara të të Dërguarit të Allahut (s.a.s) si rrjedhojë e afërsisë dhe dashurisë pasionante të ndjerë për të, e forcojnë lidhjen ndjesore të ndjerë ndaj tij. Sa e sa besimtarë, të apasionuar pas Profetit, kanë përfituar nga begatia e këtyre kujtimeve të çmuara!

Shkëlqimi mbi gjashtëqindvjeçar i perandorisë osmane, shkëlqim që nuk i ka rënë në pjesë asnjë shteti islam, ka buruar nga rëndësia që u ka dhënë botës shpirtërore dhe vlerave shpirtërore. Fakti që, sipas një rivajeti të njohur, Osman Gaziu i cili pati bujtur një natë si mik në një shtëpi, nuk qe shtrirë natë për të fjetur ngaqë në atë dhomë ndodhej një Kur’an, fakti që sulltan Selimi i Rreptë i solli amanetet e shenjta në Stamboll me një veneracion të thellë, pastaj caktoi dyzet imamë që në mjedisin ku ndodheshin ato të këndohej pa ndërprerje Kur’an, gjë që vazhdoi të realizohej për shekuj me radhë, janë motivet shpirtërore themelore të lartësisë legjendare të shtetit osman!

Edhe mbajtja hapur sot në Stamboll për vizitorët e hirkës së Profetit (s.a.s.) dhe të amaneteve të shenjta në sarajin Topkapi është pretekst nderi dhe begatimi për kombin tonë dhe për botën islame!



20 Shih. Ibnu’l-Xhevzi, *Menakibu’l-Imam Ahmed bin Hanbel*, f. 609-610.





Unë jua pata ndaluar juve vizitën e varreve. Ndërsa tani i vizitoni, sepse vizita e varrit ju kujton ahiretin.

(Tirmidhi, *Xhenazet*, 60; Muslim, *Xhenazet*, 106)

Varrezat janë një shkollë urtësie dhe mësimi, kurse vizita e varreve është edukimi më me ndikim me anë të meditimit mbi vdekjen.



C. VIZITA NE VARRE

Gjatë rrjedhës së jetës, njeriu lëkundet pa pushim mes dy të kundërtave të frikshme, gëzimit të jetës dhe rrëqethjes nga vdekja. Pa u rrokur kuptimet e vërteta të jetës dhe vdekjes që janë në një rrjedhë të vazhdueshme, realiteti i njeriut nuk mund të konceptohet me të fshehtë e vërtetë dhe urtësinë e krijimit të tij.

Po qe se njohja e shtrënguar mes dy të të panjohurave të mëdha si “ardhja në botë dhe ikja nga bota”, nuk arrin në një konkluzion vlere që i përket kësaj bote dhe po qe se qëndrimet dhe veprimet nuk rregullohen sipas kësaj, nuk mund shpëtojë nga bota e hijeve mashtruese të kësaj bote kalimtare e të dalë në një udhëtim moralo-shpirtëror drejt vendit të të vërtetave.

Vdekja për besimtarin është një përshëndetje bashkimi që vjen nga Allahu dhe një kalim nga një gjendje mes gëzimeve, bukurive dhe konsideratave, në një gjendje tjetër. Kurse vdekja për mohuesit dhe mëkatarët është një dhënje shpirti brenda poshtërimit edhe vuajtjes dhe një furtunë ndëshkimi që shpëputet e vjen nga deti i zjarrtë i xhehennemit.

Kultura shpirtërore më me rëndësi e njerëzimit fillon me zgjidhjen e misterit nën dhé. Po qe se idetë, përpjekjet, kërkimet, thellësitë ndjesore dhe ndijimet e brendshme, nuk mblidhen rreth të vërtetës së vdekjes, e vërteta e këtij vendi misterioz të quajtur “varr” nuk mund të bëhet i qartë.

Me të vërtetë, në jetë janë dy këshilluesit më të rëndësishëm për njeriun. Njëri nga këta flet, tjetri hesht. Këshilluesi që flet është Kur’ani, ndërsa ai që këshillon me heshtjen e tij të thellë, është vdekja.

Mbështetur në këtë të vërtetë, gjyshërit tanë i kanë bërë varrezat në qendrat e qytetit dhe në hyrjet dhe daljet e xhamive, në mënyrë që nga





vdekja, e cila është njëri nga këta këshillues, të merret mësim i mjaftueshëm. Gjithashtu, në varre, si dru me moshë të gjatë kanë zgjedhur drurin e selvisë që verë-dimër ta mbajë ngjyrën pa u venitur dhe të simbolizojë pafundësinë e botës tjetër në këtë botë.

Nuk dihet që vdekja të ketë gjuhë, por ç'kuptime madhështore ka propozur ajo në një heshtje të thellë! Varret janë plot me adresat e prindërve, fëmijëve, të dashurve, kushërinjve, të afërmve dhe miqve, që e kanë konsumuar jetën e përkohshme!

Mbi botën e varrit e cila do të formësohet sipas asaj se jetuam apo jo një jetë në përshtatje me urdhrat e Allahut, Profeti (s.a.s.), duke u shprehur si më poshtë, ka aluduar mbi lidhjen dhe marrëdhënien e ngushtë mes vdekjes dhe jetës:

"Varri është ose një kopësht nga kopshtet e xhennetit, ose është një gropë nga gropat e xhehennemit!" (Tirmidhi, *Kiamet*, 26)

Me të vërtetë, varrezat janë një shkollë urtësie dhe mësimi, kurse vizita e varreve është edukimi më me ndikim me anë të meditimit mbi vdekjen.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) personalisht i ka vizituar shpesh varret e sahabeve që janë shpërngulur në ahiret përpara Tij, si një shembull besnikërie ndaj tyre, dhe është lutur për ta.

Kështu, Profeti (s.a.s.) i vizitonte varret e dëshmorëve të rënë në Uhud dhe thoshte kështu:

"Paqja qoftë për ju si shpërblim për gjërat që keni duruar! Sa vend i bukur është ahireti për ju!" (Taberi, *Xhamiu'l-Bejan*, XIII, 186 ; Ibn Kethir, *Tefsir*, II, 529).

Gjithashtu, ai herë-herë shkante te varrezat e përgjithshme, u jepte selam atyre dhe lutej kështu:

"O banues të vendit të besimtarëve! Paqja qoftë mbi ju! Me dashjen e Allahut, edhe ne do të bashkohemi me ju! Lus nga Allahu i lartë falje dhe paqe për ne dhe për ju!" (Muslim, *Xhenaiz*, 104)

Madje një mesnatë, kur Profeti (s.a.s.) po flinte në dhomën e Hz. Aishesë, e zgjoi Xhebraili (a.s.) dhe ia kumtoi urdhrin që kishte sjellë: Allahu i Lartë donte që ai të shkante te varret e përgjithshme dhe të lutej për të vdekurit.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) u ngrit ngadalë duke u përpjekur të mos e zgjonte Hz. Aishenë (r.anha). Sjellja e tij e bëri kureshtarë Hz. Aishenë që s'e kishte zënë gjumi ende. Pastaj, duke u vënë pas të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), e ndoqi deri te varrezat e quajtura Xhennetu'l-Baki.

Kur e pa Profetin (s.a.s.) duke bërë lutje me sytë që i rridhnin lot për popullin e tij u turpërua nga ajo që bëri. Ajo qëndroi edhe pak atje për të vëzhguar gjendjen entuziaste të Profetit të ndritur (s.a.s.). Pastaj u kthye me vrap në shtëpi, ra në shtrat dhe, duke e tërhequr jorganin te koka, bëri sikur po flinte. Profeti (s.a.s.) që u kthye në shtëpi menjëherë pas saj, kur e pa atë





duke marrë frymë thellë, e kuptoi si qëndronte puna dhe e qortoi:

"A pate frikë se Allahu dhe i Dërguari i Tij do të të bënin ty padrejtësi?" (Muslim, *Xhenazet*, 103) Dhe, kështu, e sqaroi se sjelljet e tij mbikqyreshin nga Allahu i Lartë.

Siç pati bërë shpesh vetë vizita të tilla në varre, Profeti (s.a.s.) i ka nxitur për këtë gjë edhe shokët dhe bashkësinë e tij me këto fjalë:

"Unë jua pata ndaluar juve vizitën e varreve. Ndërsa tani i vizitoni, sepse vizita e varrit ju kujton ahiretin!" (Tirmidhi, *Xhenazet*, 60; Muslim, *Xhenazet*, 106)²¹

Siç është vizita e varrit për vizitorin pretekst për të marrë mësim, është edhe për të vdekurin pretekst për mëshirë, sepse personi që ka hyrë në varr pret ndihmë si njeriu që ka rënë në baltovinë!

Ibn Abbasi (r.anhuma) rrëfen kështu:

Duke kaluar pranë dy varreve, Profeti (s.a.s.) tha për ta:

"Që të dy po ndëshkohen, por jo si pasojë e ndonjë mëkati të madh. Njëri nga këta merrej me thashetheme, ndërsa tjetri, kur urinonte, nuk ruhej siç duhet!"

Fill pas kësaj kërkoi një degë hurme të njomë. Atë e ndau më dysh dhe e mbollti te kokat e varreve të tyre. Pastaj e vazhdoi kështu fjalën e tij:

"Shpresohet t'u lehtësohet ndëshkimi derisa sa të mos thahen!" (Muslim, Taharet, 111)

Komentuesi Kurtubi e shtjellon kështu këtë hadith:

Pjesa "derisa të mos thahen" tregon se, sa të jenë të njoma, degët bëjnë tesbih, e përmendin Zotin duke e madhëruar. Kështu, dijetarët tanë kanë thënë: "Të vdekurit përfitojnë nga mbjellja e pemëve në varre dhe nga leximi i Kur'anit atje. Po qe se edhe mbjellja e një peme ua lehtëson mundimin të vdekurve, kush e di se sa përfiton besimtari nga këndimi i Kur'anit! Tek i vdekuri arrin edhe mirësia (sevabi) e gjësë që dhurohet për të vdekurin." (Kurtubi, *Tefsir*, X, 267).

Në veçanti, leximi i *Jasinit* për përfitimin e të vdekurve nga mëshira hyjnore që do t'u arrijë si rrjedhojë e leximit të Kur'anit, është një mënyrë veprimi që e dinë dhe e praktikojnë të gjithë.

Po kështu, në hadithet profetike thuhet:

"...Jasini është zemra e Kur'anit. Nëse dikush e lexon atë duke kërkuar pëlqimin e Zotit dhe ahiretin, patjetër që i falen mëkatet. Lexojuni edhe të vdekurve tuaj suren Jasini!" (Ahmed b. Hambel, *Musned*, V, 26).

"Kur të vdesë ndonjëri prej jush, çojeni në varr pa e vonuar shumë. Kur ta varrosni, njëri prej jush t'i lexojë te koka suren Fatiha dhe, te këmbët, pjesën

21 Në periudhën pagane paraislamike, njerëzit, duke menduar se shpirtat e etërve të vdekur fitonin shenjtëri, krenoheshin me këtë dhe i vizitonin varret. Me qëllim që të zhdukej ky zakon bestyt, në kohët e para e ndaloi vizitën në varre, kurse pastaj, pasi ky rrezik u zhduk, e lejoi vizitën në varre veçanërisht me qëllimin e meditimit mbi vdekjen.





e fundit të sures Bakara (Amene'r-rasulu)!" (Taberani, *el-Muxhemu'l-Kebir*, XII, 340; Dejlami, *Musned*, I, 284; Hejth7emi, *Mexhmau'z-Zevaid*, III, 44)

Ala bin el-Lexhlaxh ka përcjellë se i ati Lexhlaxh, nga sahabet, kur po vdiste, u ka lënë këtë porosi:

"Kur të më varrosni, thoni بِسْمِ اللَّهِ وَعَلَى سُنَّةِ رَسُولِ اللَّهِ (Me emrin e Allahut dhe të sunnetit të të Dërguarit të Allahut)²² dhe më hidhni dhé sipër. Te koka më lexoni fillimin dhe pjesën e fundit të sures Bakara. Pa dyshim, unë kam qenë dëshmitar se Abdullah bin Omeri e ka parë të bukur këtë praktikë!" (Bejhaki, *es-Sunenu'l-Kubra*, IV, 56)

Të tërheqin vëmendjen edhe fjalët që u ka thënë si porosi njerëzve përreth sahabiu Amr bin As (r.anh) kur po vdiste:

"Kur të më varrosni, prisni në krye të varrit tim aq kohë sa duhet për të therur një deve dhe për ta copëtuar mishin e saj, në mënyrë që, me praninë tuaj, të gjej mundësi për t'u mësuar me jetën time të re dhe të përgatis përgjigjet që kam për t'u dhënë të dërguarve të Zotit tim!" (Muslim, *Iman*, 192)

Neveviu i cili e përmend këtë hadith në librin e tij, ka përcjellë këto fjalë të imam Shafiut:

"Eshhtë *mustehab* (i pëlqyeshëm) këndimi i ajeteve dhe sureve të Kur'anit në krye të varrit, por hatmi i Kur'anit është më i bukur!" (Nevevi, *Rijadu's-Salihin*, 293)

Siç kuptohet edhe nga këto rivajete (rrëfime), vizita e varreve, lutja për paqe, mëshirë dhe falje për ata që shtrihen atje, kryerja e bamirësive dhe leximi i Kur'anit në emër të tyre, janë pretekste mëshire për të vdekurit. Në Kur'an, Zoti ynë na ka thënë të lutemi kështu për vëllezërit tanë besimtarë të cilët kanë kaluar në ahiret përpara nesh:

"Zoti ynë! Falna ne dhe vëllezërit tanë të besimit që kanë ardhur e shkuar para nesh! Dhe mos na lër në zemra asnjë urrejtje për ata që besojnë! Zoti ynë! Pa dyshim, Ti je shumë i dhembshur e shumë i mëshirshëm!" (el-Hashr, 10)

Ndërkaq, një specifike tjetër që duhet bërë kujdes në vizitën e varreve, është domosdoshmëria e shmangies nga disa praktika të gabuara dhe sjellje të sajura jashtëfetare (bid'at).

Edhe nëse dijetarët sunnitë kanë thënë e shkruar shumë gjëra mbi ruajtjen e besimtarëve nga nënvleftësimi dhe teprimi i skajshëm lidhur me vizitën e varreve, për fat të keq, gjer më sot, asnjëri prej qëndrimeve të skajshëm nuk është parandaluar dot.

Pastrimi nga nënvleftësimi dhe teprimi i skajshëm i vizitës së varreve, një praktikë, kjo, që e trazon mjaft mendjen e njerëzve me njohuri fetare

21 Me emrin e Allahut dhe sipas sunnetit (traditës) të të Dërguarit të Allahut po të dorëzojmë si amanet te Zoti!





të cekëta, si dhe i ndjenjave dhe sjelljeve lidhur me këtë praktikë, është një punë shumë e vështirë. Sepse pamjaftueshmëria e njeriut për t'i konceptuar të vërtetat abstrakte, e ka veshur vizitën e varreve – për disa – me një përmbajtje që mund të konsiderohet pothuajse herezi (shirk), si ndezja e qirinjve në kokë të varrit, lidhja e leckave dhe kërkimi drejtpërdrejt i ndihmës nga personi që shtrihet në atë varr. Kjo është shfaqje e një dobësie dhe pamundësie krejt si ajo e krishterëve të cilët, për shkak të pamjaftueshmërisë së vet për ta rrokur konceptin e një Zoti abstrakt, i kanë atribuar hyjnitë Hz. Isait, një profeti të pafajshëm! Nga ana tjetër, edhe pikëpamja e kundërt e skajshme, e cila e konsideron vetë aktin e vizitës së varreve si herezi (shirk), vë në shesh të njëjtin gabim, por në anën tjetër!

Si në çdo çështje tjetër, edhe në çështjen e vizitës së varreve, Islami merr për bazë parimin e maturisë. Siç u tregua edhe më lart, fjalët dhe praktikat e Profetit dhe sahabeve lidhur me vizitën e varreve na shpalosin neve se si duhet të sillemi në këtë çështje pa rënë në nënvleftësim apo teprim.

Ibni Abbas (r. anhum) tregon:

Pat vdekur nëna e Sad bin Ubades (r.anh). Ai shkoi te Profeti (s.a.s.) dhe e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut! Nëna ime vdiq në një kohë kur unë nuk i ndodhesha pranë. Nëse jap lëmshë në emër të saj, a i bën dobi asaj?”

“Po!” – I tha i Dërguari i Allahut (s.a.s.).

Atëherë, Sadi (r.anh) i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Bëhu edhe ti dëshmitar që kopshtin tim frutor e bëj sadaka në emër të nënës sime!” (Buhari, *Vesaja*, 15)

Prijësi ynë i rrugës së drejtë, Profeti Muhammed (s.a.s.) ka porositur:

“Kur njeriu vdes, i ndërpriten të gjitha aktet, me përjashtim të këtyre tri gjërave: *sadaka* së me veprim të përhershëm, diturisë nga e cila përfitojnë të tjerët dhe fëmijës së mbarë i cili lutet për të!” (Muslim, *Vasijet*, 14)

Këto hadithe profetike shprehin se besimtarët e vdekur do të shohin dobi nga aktet e mira që kanë bërë në të gjallë dhe nga mirësia e atyre akteve që vazhdon të veprojë edhe pas vdekjes së tyre, se, veç kësaj, do të mund të përfitojnë nga lutjet dhe mirëbërësitë e të afërmve të gjallë dhe vëllezërve muslimanë duke i nxitur këta të fundit që të veprojnë në këtë mënyrë.

Me të vërtetë, pas një besimtari që ka kaluar në jetën tjetër, ahiret, bëhen shumë të mira me qëllimin që mirësia e tyre t'i përkasë atij. Siç thuhet edhe në hadithin e mësipërm, për sa kohë që të vazhdojë të veprojnë mirësitë e një besimtari të vdekur, vazhdon edhe shpërblimi i tij dhe libri i punëve të tij nuk mbyllet. Punëve e mira dhe bamirësitë të kryera si detyrim besnikërie nga trashëgimtarët dhe miqtë e vërtetë për besimtarin i cili vdes duke i lënë lamtumirën kësaj bote e duke hyrë i vetëm në botën e varrit, janë ndër aktet më të çmuara e më të virtytshme.





Veçanërisht pagimi i borxheve të të vdekurit është një punë e mirë (ameli salih) e nxitur nga Profeti (s.a.s.). Kur i sillnin një të vdekur, Profeti (s.a.s.) në fillim pyeste nëse i vdekuri kishte borxhe dhe, pas pagimit të tyre, ia falte namazin e të vdekurit. Ky qëndrim është një mësim i çmuar mëshire për ne në lidhje me të vdekurit tanë.

Në këtë specifikë, në analogji me dhënien e shpërblimit (fidjes) në vend të agjërimeve të pambajtura dhe të pazëvendësuar për shkaqe vështirësie, imam Muhammedi ka një opinion (ixhtihad) të emërtuar “iskat-i salat” (reduktimi i namazit) me shpresën e faljes edhe të namazeve të pakryera. Sipas kësaj, për çdo kohë namazi të pafalur duhet plotësuar nevoja e ushqimit njëditor të një të varfëri ose dhënia e kundërvlerës së saj në monedhë. Ndërkaq, ky dhurim duhet të bjerë në dorë të të varfërit pa pësuar asnjë ndryshim në sasi. Nga ky opinion (si dhe konkluzion juridiko-fetar) i imam Muhammedit kuptohen tri dobi të rëndësishme:

- a) Nxitja e dhurimit dhe përfitimi i shpërblimit nga dhuruesi.
- b) Gëzimi i nevojtarëve dhe bërja e lutjes nga ana e tyre për të vdekurin.
- c) Shpresimi i faljes dhe i mëshirës së Zotit për të vdekurin.

Trajtimi i quajtur “iskat” (reduktim)²³ i bërë për të vdekurin, për fat të keq, në ditët tona, duke u larguar nga qëllimi i vërtetë me anë të zbatimit të “qarkullimit”, ka marrë një përmbajtje në kundërshtim me frymën e Islamit.

Kjo praktikë e emërtuar “devir”²⁴ është shndërruar në një farë mashtrimi. Me këtë lloj praktike të gabuar, bëhet përpjekje që një adhurim i

23 Në origjinal: iskat (reduktim). Kështu emërtohet reduktimi i borxheve adhurimore të namazit, agjërimit, kurbanit, etj. të një personi të vdekur duke dhënë lëmshë (sadaka) të varfërve e nevojtarëve.

24 Në origjinal: devir (qarkullim). Në vend të shumës së plotë që duhet dhënë, merret një shumë e vogël, mbështillet me beze dhe i jepet si dhuratë të varfërit. Pastaj ajo merret nga i varfëri prapë si dhuratë dhe ky këmbim vazhdohet gjersa të plotësohet shuma e plotë si kundërvlerë e borxhit. Kjo praktikë nuk ekzistonte në kohë të Profetit (s.a.s.), tabiinëve dhe tebe-i tabiinëve. Reduktimi është lejuar në fundet e shek. II Hixhri, kurse reduktimi me anë të qarkullimit, në shek. V Hixhri. Reduktimi me anë të qarkullimit i kthyer në zakon në kohën tonë dhe që pandehet se mbështetet në burimet e Islamit, është një lloj pseudonovatorizmi (bid’at) që përbën shkak për koprraci në dhurim dhe përtaci në adhurime. Prandaj, zakoni i qarkullimit duhet braktisur dhe sadakaja në emër të të vdekurit u duhet dhënë drejtpërdrejt të varfërve, duhen kryer bamirësi dhe, për faljen e gabimeve, i duhet bërë lutje Allahut të Lartë. Kështu, edhe veprohet në përputhje me sunnetin, edhe adhurimet pasurore-materiale, bamirësitë dhe lëmshat shkojnë tek nevojtarët e vërtetë. (Hayrettin Karaman, *Ebediyet Yolcusunu Uğurlarken*, s. 81-85)





pakryer të kompensohet me anë të një sjelljeje me pamje sadakaje në fakt të pakryer. Kjo bëhet kështu: Vihet në dispozicion një sasi parash me qëllim për ta pastruar nga borxhet e mundshme të namazit²⁵ që mund të ketë një person i vdekur dhe, ndërsa duhet që, sipas qëllimit të mirë, kjo sasi parash t'u jepet nevojtarëve (si sadaka), për fat të keq, shpesh herë, qarkullohet nga dora në dorë mes disa personave duke e shoqëruar këtë qarkullim me shprehjet *قَبْلُ* "e mora, e pranova" – *وَمِنْهُ* "e dhurova", duke menduar se, me këtë qarkullim, sasia e supozuar e dhuruar shumohet. Qarkullimi i një sasive të vogël parash me dhënie-marrje me një qëllim të paracaktuar mes disa personash dhe besimi se, me këtë mënyrë veprimi, shuma bazë shumohet sipas numrit të personave që marrin pjesë në këtë qarkullim, po kështu, edhe mirësia përkatëse, është një sajim i shëmtuar që mund të mashtrorë vetëm ata që e bëjnë. Sidomos është shumë e habitshme kur këtë mënyrë e përdorin njerëz të pasur, të cilët shpresojnë edhe të kenë përfitime shpirtërore prej saj. Për më tepër, për ata që e shohin këtë gjë nga jashtë, të cilët e konsiderojnë si tejet të paarsyeshme dhe, mos qoftë e thënë, si përpjekje për ta gënjyer Allahun, s'është gjë tjetër veçse preokupim me një punë të kotë.

O Zot! Na i përgatit qëllimet sipas pëlqimit tënd! Na mbro nga fundi i atyre të cilët, duke e dhënë veten pas kësaj bote, janë mbytur në një gropë ujë! Zoti ynë, o më mëshiruesi i mëshiruesve! Na i zbukuro e na i përsos jetën dhe vdekjen me begatitë, dhuntitë dhe bukuritë e larta që ua ke falur robve të tu të mirë, si dhe me anë të bashkimit me Ty!

O Zot! Na e mundëso të gjithëve ta shohim gjithësinë me vështrimin e dashurisë hyjnore, ta sodisim atë nga këndi i vetëdijes, ndjenjës, dridhjeve të ndërgjegjes dhe emocioneve të besimit, të arrijmë në klimat e faljes me vesën e pendimit të pikuar nga sytë dhe të arrijmë në praninë Tënde me faqe të bardhë dhe ndërgjegje të qetë!

Amin, ashtu qoftë!



25 Me *borxhe namazi* është fjala për namazet që një person i vdekur nuk i ka falur dot në të gjallë, ose namazet që i ka falur pa respektuar siç duhet kushtet e përsosmërisë së namazit, si principialiteti, sinqeriteti dhe përshpirtshmëria. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për namazet e pafalura për shkak plogështie dhe përtacie duke i besuar kompensimit të tyre me një mënyrë të tillë.





PJESA E PESTE

KESHILLA NGA MIQTE E SE VERTETES





Shih me sy të mirë!



Vërejtjet dhe këshillat e miqve të së Vërtetës janë reflektime nga klima e Kur'anit dhe nga bisedat e të Dërguarit të Allahut.



KESHILLA NGA MIQTE E SE VERTETES

Miqtë e së Vërtetës¹, të cilët e kanë përkryer botën e tyre të jashtme e të brendshme dhe, duke i ngjitur shkallaret e zemrës, kanë arritur përsosmërinë e sjelljes, janë njerëz që kanë merituar nderin të jenë “trashëgimtarë profetikë”. Ata janë kulme të përsosmërisë së orientimit dhe sjelljes profetike, të shpërndarë nëpër kohëra. E thënë ndryshe, janë udhëzues praktikë dhe konkretë për ata që s’kanë pasur nderin ta shohin Profetin (s.a.s.) dhe sahabet, shokët e tij.

Në hadithin profetik thuhet:

“*Dijetarët (të cilët e kanë përkryer botën e vet të jashtme e të brendshme dhe e kanë shndërruar diturinë e vet në kulturë) janë trashëgimtarë të profetëve!*” (Ebu Davud, *Ilm*, 1)

Te këta besimtarë të përkryer, të merituar të shfaqjeve materiale të emrave *Rahman* (mëshirues) dhe *Rahim* (shpërblyes) të Zotit, mëshira dhe dhembshuria janë bërë natyra e vërtetë e tyre. Gjithashtu, këta besimtarë të mirë (salih), duke shpëtuar nga egoizmi, kalojnë një jetë të tërë orientimi si të merituar të ndjenjës së vetëmohimit. Jeta e tyre orientuese vazhdon edhe pas kurmit të tyre të vdekshëm. Si të merituar të konfidencës hyjnore duke i përdorur si urë shpirtrat e vet në përfundim të vetedukimit, bëjnë përpjekje të vazhdueshme që edhe ummetin, bashkësinë e besimtarëve, duke e kaluar nga kjo rrugë, ta afrojnë te Zoti. Ata janë mësuesit e masave njerëzore që presin shpëtim. Ata janë heronj që bartin në ndërgjegje përgjegjësinë e një vëllazërie para Allahut dhe njerëzve!

Vërejtjet, paralajmërimet, këshillat dhe porositë e miqve të së Vërtetës, miqve të Zotit, janë reflektime nga bisedat e të Dërguarit të Allahut, sepse

1 Në origjinal përdoret fjala *Hak* me kuptimin e *Vërtetë* (e vërteta e vetme) dhe *Zot*. Gjatë interpretimit të kësaj vepre në shqipe, ne kemi përdorur, sipas vendit, edhe cilësimin *miqtë e Zotit*, edhe cilësimin *miqtë e së Vërtetës*.





ai është qendra e përfitimit shpirtëror. Bisedat plot emocione shpirtërore, vërejtjet, paralajmërimet dhe këshillat janë shkëndija të përcjella në mënyrë zinxhir nga ajo qendër. Kuvende të tilla të miqve të Zotit duhet të dihen si pasuri, sepse ata janë personalitete shembullorë të cilët, jetën profetike njëzetetrevjeçare të Profetit (s.a.s.) ia kanë reflektuar bashkësisë në mënyrë verbale, praktike dhe afektive.

Si fluturat që përsillen rreth burimit të dritës, me afërsinë dhe dashurinë për Zotin, miku i Zotit e ka bjerrë vullnetin aq sa, më në fund, Zoti është bërë syri që i sheh, veshi që i dëgjon. Ngaqë ndodhet nën shfaqjen e dashurisë dhe pasionit për Zotin, prirjet egoiste tek ai "janë djegur" krejt siç digjet letra nën thjerrën që i mbledh dhe i përqëndron mbi të rrezet e diellit! Kështu, ngaqë miku i Zotit shndërrohet në qendër tërheqjeje shpirtërore, njerëzit e tjerë e duan atë në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme dhe zemrat e tyre rrjedhin drejt tij. Vërejtjet, paralajmërimet dhe këshillat e tij bëhen melhem dhe shërim për shpirtrat!

Vërejtjet, paralajmërimet, orientimet dhe këshillat e miqve të Zotit, të cilët janë të merituar të këtij horizonti të lartë dhe të kësaj inteligjence moralo-shpirtërore, zotërojnë një vlerë dhe ndikim shumë më të madh në zgjimin e zemrave indiferente sesa këshillat e personave të paefektshëm në diturinë e tyre. Prandaj këshillat e tyre të begata duhen njohur si një dhunti që s'gjidhet dhe me këtë vetëdije u duhet dhënë zemër me sinqeritet dhe dashuri orientimeve të tyre që u dhurojnë shpirtrave qetësi. Ja, pra, disa shembuj nga këto këshilla të miqve të Zotit, të cilat, si kandilë orientimi, ndriçojnë rrugën e lumturisë së përjetshme:

Hasan Basri, *kuddise sirruh*²

(642 - 728)

O biri i Ademit! Besimtari i vërtetë, edhe nëse është gjer në fund i devotshëm, përsëri zgjohet me frikë. Në fakt, kjo i ka hije atij. Besimtari përsëri me të njëjtën frikë takohet me mbrëmjen. Po, ai gjithmonë është mes këtyre dy frikërave!

1) Mëkatet e kaluara. Ai nuk mund ta dijë se si do ta trajtojë Allahu për shkak të këtyre mëkateve.

2) Jeta e ardhme. Çfarë jete do të bëjë, si do ta japë frymën e fundit? Gjithmonë i mendon përgjigjet e këtyre pyetjeve.

O njerëz! Duke e kuptuar këtë të vërtetë, bëni punë të mira! Allahu dhe i Dërguari i Tij i shohin punët tuaja që bëni. Ju një ditë do të ktheheni





tek Allahu i cili e di të fshehtën dhe të dukshmen. Ja, atë ditë do t'ju njoftojë një nga një për ato që keni bërë!

Kini shumë kujdes zemrat tuaja! I ripërtërinini ato vazhdimisht duke e përmendur Allahun, sepse zemra ndryshket shpejt. Dhe frenojeni veten sepse ajo është shumë e papërmbajtur! Nëse nuk u bëheni pengesë dëshirave të këqija të vetes, vjen një ditë që ajo t'ju rrokullisë në një greminë të frikshme!

Ju nuk mund të bëheni zotërues të besimit të përkryer gjersa të mos keni hequr dorë nga qortimi i të tjerëve duke pasur vetë të meta. Atëherë, para se të shihni të metat e të tjerëve, hidhuni një sy të metave tuaja dhe fillojeni punën duke i rregulluar ato!

O njerëz! Kur'ani është shërim për besimtarët dhe udhëzues për të devotshmit. Kush bën siç thotë ai, orientohet dhe gjen rrugën e drejtë. Kush ia kthen shpinën atij, bëhet i fatkeq dhe zvarritet në fatkeqësi.

O biri i Ademit! Do të vdesësh i vetëm, do të ringjallesh i vetëm dhe do të japësh llogari i vetëm!



Malik Bin Dinar, *kuddise sirruh*

(vd. 748)

Përveç këtyre dy gjërave, nuk ka mbetur gëzim në këtë botë:

- 1) Të takohesh me vëllezërit dhe të kuvendosh me ta.
- 2) Të ngrihesh për namazin tehexhjud dhe në atë kohë të begatë të bësh shumë dhikr dhe këndim Kur'ani.



Xhafer Sadik, *kuddise sirruh*

(699 - 766)

Kur të bësh një punë të mirë (salih amel), nënvleftësoje para syve të tu dhe mbaje fshehtë, sepse, po e nënvleftësove, nuk të çon në vetëpëlqim. Po e fshehe, i plotësohen mangësitë, pra, i shtohen vlerat dhe virtytet. Ndërkaq, duhet të nxitohesh për të bërë punë të mira, sepse nefsi, vetja jote, e kapur pas ndonjë dobësie, mund t'i shtyjë për më tutje ato ose mund të bëjë të heqësh dorë prej tyre!

Po qe se dëgjon një gjë të papëlqyeshme për vëllanë besimtar, mendo me këmbëngulje se ai duhet të ketë ndonjë justifikim. Po të mos e gjes, mendo se mund të ketë ndonjë justifikim që s'e kupton dot ti dhe mbuloja të metën!





Sufjan Thevri, *kuddise sirruh*

(713 – 777)

Marrja e dijeve duhet bërë me qëllim për t'u bërë i bindur ndaj Allahut, për t'i zbatuar urdhrat e Tij dhe për t'u frikësuar prej tij. Epërsia e diturisë për sa i përket vlerës dhe virtytit rrjedh ngaqë ajo e bën njeriun zotërues të ndjenjave të larta.

Për ty është më me përfitim të shkosh në Horasan për të kumtuar fenë, sesa të qëndrosh në Mekë si banor.

Kushti i parë i domosdoshëm për diturinë është të kërkosh rrugët për ta gjetur atë. Pas gjetjes së dijes dhe përvetësimit të saj, vjen zbatimi i saj në praktikë. Pastaj, heshtja dhe meditimi. Pastaj, vështrimi i gjithësisë me shikim mësimnxjerrës!...



Xhunejd Bagdadi, *kuddise sirruh*

(vd. 909)

Kuvendi me Allahun, domethënë, qëndrimi bashkë me Të, bëhet me anë të një etike dhe edukate të bukur, me vazhdimësinë e gjendjes së impresionimit dhe vetëkontrollit.

Kuvendi me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) bëhet duke e ndjekur sunetin dhe mënyrën e tij të jetesës.

Kuvendi me evlijatë, të urtët, bëhet me anë të respektit dhe shërbiimit.

Kuvendi me njerëzit e shtëpisë bëhet me anë të moralit të bukur.

Kuvendi me miqtë bëhet duke qenë gjithmonë fytyrëqeshur dhe duke i gëzuar ata.

Kurse kuvendi me njerëzit e popullit bëhet me lutje dhe mëshirë ndaj tyre.



Imam Gazali, *kuddise sirruh*

(vd.1111)

Biri im, mbaje zemrën në gjendje absolutisht vigjilente në këto tre adhurime që mendja dhe zemra të mos të ndodhen në vend tjetër: kur të lexosh Kur'an, kur të përkujtosh Allahun dhe kur të falësh namaz. Në këto tri gjendje mos i ço, qoftë edhe për një çast, mendjen dhe zemrën në vend tjetër! Mos harro që je para Allahut! Përndryshe, po qe se je drejtuar nga kiblja, kurse mendja të ndjek gjëra të tjera, ky kthim e humb vlerën! Lidhe orientimin tënd me Qaben që është faltarja e parë ku ka lindur Islami dhe





zembrën tënde, pas Allahut! Veçanërisht, nëse dëshiron të bëhesh dijetar i kulturës shpirtërore (arif), prej dijetarëve, heshtja le të të jetë meditim, vështrimi, mësim dhe, dëshira, bindje, sepse këto tri veti janë shenjë dalluese i arifëve, dijetarëve të kulturës shpirtërore!

Biri im, ruaju jashtëzakonisht nga borxhi ndaj njeriut, sepse për shkak të një qindarke ikën sevapi i shumë adhurimeve që janë pranuar. Profeti (s.a.s.) nuk e falte namazin e të vdekurve që kishin borxhe. Qëllimi i kësaj ishte t'i bënte të pasurit të ndjenin mëshirë dhe t'ia falnin borxhin. Besimtari, kur merr borxh, nuk merr kot, por, nëse merr borxh prej nevojës me qëllimin për ta larë, Allahu e ndihmon atë. Madje, nëse mes përpjekjeve, vdes pa e paguar, Allahu do ta ndihmojë edhe në ditën e kiametit!

Duhet të falenderojmë edhe për belanë, sepse nuk ka bela të tjera veç mohimit dhe mëkateve, që në brendësi të tyre të mos ketë një mirësi që ti nuk e di. Allahu e di të mirën tënde më mirë sesa ti. Ka shumë gjëra që ti i konsideron të këqija, por që janë të mira për ty, dhe ka shumë gjëra që i ke konsideruar të mira, por që janë të këqija për ty. Rruga më paqësore është të jesh i kënaqur me vlerësimin hyjnor për ty dhe të mund të falenderosh në çdo gjendje!

Biri im, nëse ka ndonjë aspekt që duhet të bësh shumë kujdes, ajo është se me kë shoqërohesh. Dije mirë, se një shportë me mollë të mira, nuk mund ta bëjnë të mirë një mollë të kalbur që ndodhet në mes të tyre, por një mollë e kalbur mund t'i prishë të gjitha! Për këtë arsye, shoqërohu gjithmonë me të mirët (salih)!

Shoku i mirë i ngjan atij që shet vaj trëndafili dhe ose ti blen prej tij, ose ai të lyen me erë të mirë, ose, të paktën, duke ndenjur pranë tij, edhe ty të vjen erë e mirë! Njeriu rri me ata që do. Kë të kesh dashur në këtë botë dhe me kë të jeshë shoqëruar, me ta do të mblidhesh ditën e gjykimit. Atëherë, vazhdo të marrësh pjesë në kuvendet e dijetarëve që veprojnë me diturinë e tyre, dhe të njerëzve të mirë!

Biri im, çdo gjë në jetë ekziston sipas përpjesëtimit të bërë nga Allahu. Allahu, dikë e ka bërë të pasur, dikë të varfër, dikë të shëndoshë, dikë sakt, dikë dijetar dhe dikë e ka bërë të paditur. Vetëm kështu sigurohet rendi i kësaj bote. Kur të shohësh njerëz më poshtë se veten, mos u mburr dhe mos i shih ata si të pavlerë. Ti mund të ishe në vend të tyre dhe ata mund të ishin në vendin tënd. Ja pra, duke menduar kështu, bëhu shok me të varfërit. Gjithmonë mundohu të jesh zemërbutë ndaj tyre. Mbroje dinjitetin njerëzor dhe dinjitetin islam! Vetëm kështu arrihet lumturia. Nëse do qetësi në këtë botë dhe në ahiret, mos ngacmo e mos prek askënd! Kur të shohësh një më të ri sesa ti, shikoje me mendimin se *ai ka mëkate më pak se ti*, kurse kur të shohësh një më të madh në moshë sesa ti, shikoje me mendimin se *ai ka sevape më shumë se ti, se është më i çmuar me ato anë të tij që*





ti nuk i di! Kur të shohësh një dijetar, mendo: “Ky ka dije, e shpëton veten e tij!” Dhe kur të shohësh të paditurin, mendo: “Ky nuk di, Allahu e fall!” Kur të shohësh një qafir (mohues) madje, që akoma nuk dallohet se është në frymë të fundit, mendo: “Nëse Allahu e udhëzon atë, ai mund të dalë në praninë hyjnore me të gjitha mëkatet e tij të falura dhe i pastër!” Dhe mendo kështu për fundin tënd: “Vallë, si do të jetë fryma ime e fundit?” Sa më mirë ta njohësh veten tënde dhe ta shohësh të pavlerë, po aq do të lartësohesh në vlerë para Allahut!

Biri im, plotësoji me sa të kesh mundësi nevojat e vëllezërve të tu të besimit, sepse Profeti (s.a.s.) thotë kështu:

“Kush plotëson një nevojë të një vëllai besimtar, edhe Allahu i Lartë ia plotëson një nevojë atij!” (Buhari, *Medhalim*, 3)

Në një hadith tjetër, Profeti (s.a.s.) thotë: *“Kush mbulon një të metë të një muslimani, Allahu ia mbulon një të metë atij në këtë botë dhe në ahiret!”* (Muslim, *Birr*, 72)

Një që është i mençur, duhet t’i thotë vetes së tij: Kapitali im është vetëm jeta ime. Ky kapital është aq i vlefshëm saqë çdo frymëmarrje shpenzohet, kurrsesi nuk mund të merret prapë! Frymëmarrjet janë të numëruara dhe në pakësim të vazhdueshëm. Atëherë, vlerësoji shumë frymëmarrjet e tua dhe shikoje këtë botë të përkohshme, sikur do të vdesësh nesër. Të gjitha pjesët e trupit tënd ruaji nga harami dhe mbaju pas devocionit!

O Zoti im, na e përfundo jetën tonë me lumturi, na e cakto si pjesë shikimin e bukurisë tënde dhe pëlqimin tënd! Mos na e lër mangët kënaqësinë mëngjes e mbrëmje! Bëje devotshmërinë për ne ushqim dhe orientoje mbështetjen dhe besimin tonë tek Ti! Na bëj të qëndrueshëm ne në rrugën e vërtetë! Vetëm Ti je i denjë për adhurim! Të besoj Ty të pastër nga atributet relative! U bëra një ndër të padrejtët sepse s’ të adhurova ashtu siç duhet!

Lavdia dhe falenderimi qoftë për Allahun, Zotin e botërave! Falja dhe Paqja qofshin për Muhammed Mustafanë (s.a.s.)!



Abdulkadir Gejlani, *kuddise sirruh*

(1077 – 1166)

O bir, ty të duhet devotshmëria! Prandaj përpigu të kryesh domosdoshmëritë e devocionit në mënyrë që zemra të të shpëtojë nga armiqësia e brendshme dhe nga veset e shëmtuara, të të orientohet kah e mira!

O bir, kur të mbledhësh fitime, mos u bëj si personi që mbledh dru natën por nuk di se ç’zë me dorë! Kij kujdes për pjesën e pasurisë që kalon në dorën tënde, nëse është haram apo hallall, legjitime apo jolegjitime! Në





të gjitha veprimet e tua bashkohu me diellin e tevhidit (njësimit të Zotit) dhe takvasë (devotshmërisë)!

O bir, veprimi sipas Kur'anit, të lartëson në pozitën e Kur'anit dhe të vendos atje. Ndërsa veprimi sipas sunnetit, të afron ty te i Dërguari i Allahut. Me mbrojtjen ndjesore dhe moralo-shpirtërore të Profetit (s.a.s.), nuk ndahesh qoftë edhe për një çast nga mjedisi i zemrave të miqve të Allahut. Ai është që i zbukuron zemrat e miqve të Allahut!

O bir, ngrënia haram e vret zemrën, kurse ngrënia hallall e ringjall! Ka kafshatë që të preokupon ty me këtë botë, ka kafshatë që të preokupon ty me botën e pasme, ahiretin. Ka edhe kafshatë që të jep vlerë ty te Krijuesi i kësaj bote dhe i ahiretit!

O bir, bëhu shok me atë që të ndihmon ty në çështjen e luftës me veten. Gjindu në bisedat e tij. Mos u bëj shok me atë që të ndihmon të prishësh veten tënde. Së pari merru me veten tënde, bëhu i dobishëm për të dhe rregulloje atë. Pastaj merru me të tjerët. Mos u bëj si qiriri që ndriçon të tjerët, kurse vetë shkrihet e mbaron! O ti njeri që dëshiron të bësh punë të mira në rrugën e Allahut, bëhu i sinqertë, përndryshe lodhesh kot!

Orientimi i të tjerëve nuk bëhet me llafe, por realizohet me një besim dhe dëshirë të pastër nga zemra. Përsëri, të gjitha këto janë rezultate që mund të merren me mbyllje në vetvete, adhurim, përmendje të Zotit, përkoresi dhe vetëkontroll dhe jo rezultate që nuk shkojnë përtej së qeni formalitet dhe shtirje dhe që mund të arrihen me një sërë sjelljesh që kurrë nuk ndikojnë mbi shpirtin! Prandaj, gjuha dhe zemra, përmbajtja dhe dukja, fjala dhe e vërteta e udhëtarit të rrugës së Allahut duhet të jenë një dhe duhet të shprehin të njëjtën gjë!



Ahmed Rifai, *kuddise sirruh*

(1118 – 1182)

Zotërinj! Mundohuni ta bëni të hapur afërsinë me miqtë e Allahut, sepse ai që do mikun e Allahut, do Allahun, ai që i bën armiqësi atij, i ka bërë armiqësi Allahut!

Vazhdojeni dhikrin, sepse dhikri është një magnet për lidhjen hyjnore, është një pe i fortë për afërsinë hyjnore! Ata që e vazhdojnë përmendjen e Allahut, janë mirë me Allahun. Ai që është mirë me Allahun, është bashkuar me Të. Për të vendosur dhikrin në zemër, bëhet e mundur vetëm me begatinë e kuvendeve, sepse njeriu është në rrugën e mikut të tij!

Meditimi është puna e parë e Profetit tonë (s.a.s.). Po ashtu, para të gjitha farzeve, adhurimi i tij përbëhej prej mendimit mbi krijesat dhe të





mirat e Allahut! Në është kështu, edhe ju kapuni fort pas meditimit dhe bëjeni atë pretekst mësimi!

Kini kujdes! Mos u bëni si sita që miellin e hollë e lëshon poshtë kurse krundet i mban për vete. Kini kujdes që, kur nga goja juaj të derdhet urtësi, në zemrat tuaja mos të ketë hile dhe prishje. Përndryshe, do të jepni llogari sipas ajetit: **“A i urdhëroni njerëzit për të mirë dhe harroni vetet tuaja?”** (el-Bakara, 44)

Bëjini zemrat krejt të pastra, sepse pastrimi i zemrës është më i rëndësishëm se pastrimi i trupit. Në fakt, Allahu i Lartë nuk sheh rrobat, por zemrat! Duke ndjekur kufirin e orientimit, mos kërkoni dhe mos zgjidhni tjetër veç Allahut!

Zotërinj, i hapet dera atij që troket me thjeshtësi dhe qetësi! Dhe pranohet brenda! Kush hyn brenda kokulur, pritret me nderim!



Abdulhalik Guxhdevani, kuddise sirruh

(vd. 1189)

O bir! Po ta lë porosi që në të gjitha kushtet të mbështetesh në dijen, edukatën dhe devocionin! Lexoji librat e paraardhësve dhe ec në rrugën e sunnitëve (ehli sunnet vel xhemaat)! Mëso fikh dhe hadith dhe ik larg e më larg nga sofitet e paditur! Namazet fali patjetër me xhemat! Nëse në zemrën tënde ka prirje për famë, mos u bëj imam dhe muezin! Largohu nga fama sa të keshë fuqi! Në famë ka fatkeqësi. Gjithashtu, syrin të mos ta kesh te pozitat, mbaje veten vazhdimisht poshtë! Mos u bëj dorëzanës në punët që s’i përballon dot! Mos u përziej në punët e popullit që nuk të interesojnë ty. Mos u shoqëro e mos rri me administrues mëkatarë. Ruaj ekuilibrin në çdo çështje. Mos u kap shumë pas dëgjimit të zërit të bukur duke e humbur maturinë, sepse kjo e nxin shpirtin dhe në fund lind hipokrizia. Ndërkaq, edhe zërin e bukur mos e moho, se ezani dhe Kur’ani i ngjallin shpirtrat me të! Ha pak, fol pak, fli pak dhe ik nga indiferentët siç ikën nga luani. Në kohët e intrigave dhe përçarjeve, zgjidh vetminë! Rri larg nga ata që, duke dhënë fetva se ashtu ua kërkon interesi, bëhen shkak për nënvleftësimin e fesë, nga të pasurit kryelartë dhe të paditurit! Ha hallall, ki kujdes nga punët e dyshimta dhe ki kujdes devotshmërinë në martesë, përndryshe lidhesh pas kësaj bote dhe e dëmton fenë për hir të saj. Mos qesh shumë, veçanërisht ki kujdes mos të qeshësh me zë të lartë. Të qeshurit e shumtë e vret zemrën, por edhe buzëqeshjen mos e lër pas dore. Shikoji të gjithë me syrin e dhembshurisë dhe mos nënçmo kërkënd! Mos e zbukuro shumë pamjen tënde të jashtme, sepse përparimi yt i jashtëm vjen nga shkatërrimi yt i brendshëm. Mos debato, mos kërkto gjë prej askujt, ji i ngopur, ji i pasur





me atë që ke, ruaje dinjitetin tënd! Ji besnik ndaj atyre që janë munduar për ty dhe që të kanë edukuar, bëju shërbim atyre me pasurinë tënde, shpirtin tënd dhe ndrysho me gjendjen e tyre. Indiferentët që tregohen të pabesë, nuk gjejnë të mirë! Mos ano nga kjo botë dhe nga indiferentët që anojnë nga kjo botë! Zemra jote duhet të jetë gjithmonë e brengosur, trupi yt duhet të jetë gjithmonë i fortë për adhurim, syri yt duhet të jetë lotues dhe zemra jote duhet të jetë e butë. Puna jote le të jetë e pastër, lutja jote le të jetë përgjërimit, rrobat e tua, të thjeshta, shoku yt i rrugës le të jenë miqtë e Zotit, kapitali yt le të të jenë dituritë fetare të dukshme e të fshehta i jashtëm dhe i brendshëm le të jenë shkencat fetare, shtëpia jote, faltore dhe të afërmit e tu le të jenë miqtë e Allahut!



Feriduddin Attar, *kuddise sirruh*

(1119 – 1220)

Prano kërkimin e ndjesës të atyre që të lëndojnë. Atë që lëndon popullin, Allahu nuk e do. Një fetari nuk i shkon një natyrë e tillë. Ai i cili e plagos një zemër me dhunë, atë plagë e ka hapur në trupin e tij. Në shpirtat e atyre që mundin ta shohin të metën e vet, shfaqet një forcë!

Shenjat e mendjetrashësisë janë këto:

Të kërkosh gabimet e të tjerëve duke mos parë gabimin tënd. Të shprehësh bujari, kur në zemrën tënde ka shpërthyer fara e kopracisë.

Ai që nuk e kënaq popullin me moralin e tij, nuk ka asnjë vlerë në prani të Allahut.

Vizitoji të sëmurët, sepse kjo është tradita e Profetit (s.a.s.). Nëse ke mundësi, jepu ujë të eturve. Shërbeju njerëzve që janë në xhami. Interesohu për gjendjet dhe ndjenjat e jetimëve ashtu që Allahu të të nderojë ty, sepse një çast qarjeje e jetimit mjafton për dridhjen e arshit të lartë. Një dhunues që bën të qajë një jetim, bëhet dru për zjarrin e xhennemit. Ai që gëzon një jetim të sëmurë, i ka hapur vetes një derë të xhennetit.

Çfarë të japësh në rrugë të Allahut, ajo është pasuria jote e vërtetë. Ai që mbetet pas ka llogari për të dhënë!



Muhjiddin Ibnu'l-Arabi, *kuddise sirruh*

(1165 – 1240)

Nëse e ushtron zemrën tënde në dhikr, patjetër zemra do të të ndriçohet me dritën që do të japë dhikri! Ajo dritë siguron hapjen e syrit të zemrës!





Sillu me mëshirë dhe butësi ndaj robve të Allahut. Shpërndaje me shumicë mëshirën tënde ndaj të gjithë gjallesave. Mos thuaj: “Ky është bar, është pa shpirt, nuk ka dobi!” Po, ato kanë dobi dhe shumë të mira. Lëre krijesën në gjendjen e saj dhe trajtoje me mëshirën e Krijuesit!

Mos e kthe bosh atë që të kërkon diçka, merrja zemrën qoftë edhe me një fjalë të mirë dhe tregoji fytyrë të qeshur. Mendo se në të ardhmen do të takohesh me Allahun.

Mos të të bëjë kush për pasuri rob përveç Allahut, sepse ti je vetëm robi i Allahut që të pranon për rob.

Të përshëndesësh robtë besimtarë të Allahut, t’u japësh për të ngrënë dhe të interesohesh për ta, të tregosh dashuri për ta. Ta dish mirë se të gjithë besimtarët janë si një njeri dhe si një trup i vetëm.

Mësoje veten me xhemaat. Mundohu të qash nga frika ndaj Allahut. Lidhu pas litarit të Allahut. Trego interes ndaj atyre gjërave që i do dhe i pëlqen Allahu!



Hz. Mevlana Xhelaleddin Rumi, *kuddise sirruh* (1207 – 1273)

Allahu i Lartë i ka dërguar në botë profetët dhe të urtët si mëshirë për botërat, prandaj e këshillojnë popullin pa u bezdisur dhe pa u mërzitur. Për ata që nuk i dëgjojnë dhe nuk i pranojnë këto këshilla, luten: “O Zot! Të të vijë keq për këta! Mos ua mbyll këtyre derën e mëshirës!

Ti mblihd mendjen dhe dëgjoji me dëshirë këshillat e të urtëve! Dëgjoji dhe shpëto nga mërzia dhe frika, arrije rehatinë shpirtërore, fito siguri!

Pa e lënë rastin të të ikë dhe pa rënë në lëkundje, kape dorën e njeriut të përkryer i cili është çliruar nga mashtrimet e kësaj bote të vdekshme dhe ia ka dorëzuar plotësisht veten Zotit, në mënyrë që të shpëtosh nga intrigat e kohës së fundit, të kësaj bote të prishur!

Fjalët e të urtëve janë plot eliksir, si një lumë i pastër dhe i kthjellët. Sa ta kesh rastin në dorë, pi gjersa të ngopesh prej tij që në zemër të të çelin trëndafila e lule të tjera shpirtërore!

I nderuar, dije se edukata është si shpirt në trupin e njeriut. Në të vërtetë, edukata është drita e zemrës dhe e syrit të miqve të Allahut. Nëse dëshiron t’ia shpëtoj kokën shejtanit, hapi sytë dhe shiko se vrasësi i tij është edukata!

Hapi sytë dhe shikoje nga kreu në fund Kur’anin që është fjala e Allahut! Të gjitha ajetet e Kur’anit mësojnë edukatën, praktikojnë edukatën!

Ti jep ç’ke e ç’nuk ke, mall e pasuri jep dhe merr një zemër! Merr një zemër që ajo të të japë dritë dhe bukuri në varr, në atë natë sterrë të zezë!

Të ndodhesh një çast me një njeri që është mik i Zotit, vlen sa e gjithë





jeta! Kurse një qime që bie prej tij vlen sa një mineral i çmuar! Ndërkaq, ka edhe njerëz të tillë me zemër të ngurtë që janë e kundërta e miqve të Zotit, qo jo vetëm s'duhet ndenjuri dhe biseduar me ta, por, të mos i shohësh ata dhe të qëndrosh larg tyre, vlen sa pasuria e botës!

I thashë zemrës sime: "Mos ki dëshirë të ndodhesh në krye, por bëhu melhem mirësie! Mos u bëj gjemb që shpon! Nëse s'do të të vijë e keqe prej dikujt, mos u bëj fjalëkeq, mos u bëj mësues i të keqes, i tillë që mendon keq! Me tërë qenien ndodhu mes të mirëve!



Ibrahim Desuki, *kuddise sirruh*

(vd. 1277)

Biri im, ajo që të duhet ty, është të marrësh lutjen e të urtëve, të dëshirosh për mbarësi meritimin e mbrojtjes së tyre!

O ti që lexon dhe e mëson përmendësh Kur'anin! Mos u lavdëro shumë se e ke lexuar dhe mësuar atë përmendësh! Pa shikoje veten: a vepron sipas tij, apo jo?

Biri im, bëhu i qetë duke e lënë preokupimin me gjëra të kota si dialektika, citimet, fjalët e bukura! Zgjidh principialitetin dhe sinqeritetin, kryej punë të mira në këtë rrugë dhe mos bëj si të thotë nefsi (egoja)!

Shoqërohu me një person të tillë që të ketë mbledhur në vetvete sheriatin dhe hakikatin! Dhe mos harro se këta lloj njerëzish do të jenë ata që do të të ndihmojnë më shumë në këtë rrugë!

Biri im, dëshiroj që gjithmonë të veprosh me anë të sunnetit, traditës profetike! Dhe të respektosh edhe parimin e edukatës që është i nevojshëm në këtë rrugë!

Duhet të jesh trim. Të mos bëhesh si ata frikacakë që dridhen nga hija e tyre! Çfarëdo shqetësimi që të jetë, të të mos shtrijë menjëherë për tokë!

Mbushu me dashurinë e Zotit, madje ji në gjendje dalldie me të!

Bijtë e mi, nëse kërkoni të përgojoni dikë, përgojoni nënën dhe babain tuaj, sepse ata e meritojnë më shumë se të tjerët të marrin të mirat tuaja!

Allahu i Lartë sheh shtatëdhjetë e dy herë gjatë njëzetekatër orëve në zemrën e robve të Tij. Atëherë, mbajeni zemrën tuaj të pastër, të bukur dhe ndriçojeni, sepse aty është vendi ku shikon Zoti juaj!

O im vëlla! Në asnjë mënyrë të mos pandehësh se ke bërë diçka vetë! Dije se kur ke agjëruar, Allahu ta ka mundësuar të agjërosh. Kur ke falur namaz, Allahu ta ka mundësuar ta falësh, kur ke bërë një punë, Allahu ta ka mundësuar ta bësh. Nëse ke arritur shkallën e devotshmërisë, Allahu ta ka mundësuar ta arrish. Nëse ke realizuar diçka materiale, shpirtërore, Allahu ta ka mundësuar ta realizosh!

O biri im i dashur! Edhe sikur vepra jote të jetë sa vepra e tërë njerëzve dhe e xhindëve bashkë, kurrë mos thuaj "unë", sepse Allahu i le në varfëri





ata që thonë “unë”. Mos harro se, nëse pretendon për egoizëm, shkalla jote materiale dhe shpirtërore bie!



Bahauddin Nakshibend, *kuddise sirruh*

(1318 – 1389)

Rruga jonë është rruga e shpëtimit që ka treguar Allahu i Lartë, sepse kjo rrugë është respektimi i traditës profetike dhe ndjekja e sahabëve të nderuar. Për këtë arsye, në rrugën tonë, në pak kohë arrihet shumë fitim!

Rruga jonë është rruga e kuvendit dhe dashurisë, siç ishte kuvend rruga e sahabëve të nderuar. E mira dhe begatia janë në bashkim, ndërsa bashkimi bëhet me kuvend. Tërheqja për në vetmi mund të jetë rrezik për famë, ndërsa fama është shkatërrim.

Ata që janë në rrugën tonë, duhet të kenë kujdes për këto tri gjëra:

E para është edukata ndaj Allahut të Lartë, d.m.th., të jesh plotësisht në adhurim të jashtëm dhe të brendshëm, të zbatosh të gjithë urdhrat e Allahut, të largohesh nga të gjitha gjërat që i ka ndaluar Allahu, të nxjerrësh nga zemra çdo gjë tjetër veç Allahut të Lartë dhe t’i përdorësh dhuntitë në rrugën e Allahut!

E dyta është edukata ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Edhe kjo është t’i përshtatesh me dashuri Atij në adhurim, në vepra dhe në të gjitha sjelljet!

E treta është edukata ndaj mikut të Zotit që të ka orientuar.

Po qe se një ushqim çfarëdo është përgatitur dhe përftuar me indiferentizëm, zemërim ose pa dëshirë, në të nuk ka të mirë dhe begati, sepse në të ka gjetur rrugë nefsi (egoja) dhe shejtani (djalli). Te personi që e ha këtë ushqim, patjetër do të shfaqet një rezultat që e prish begatinë dhe kënaqësinë. Nga ushqimet hallall (legjitime, të lejuara e të bekuara) dhe të pastra të përgatitura pa u kredhur në indiferentizëm dhe duke e menduar Allahun e Lartë, shfaqet e mira. Shkaku që njerëzit nuk arrijnë dot të kryejnë akte dhe punë të pastra e të mira, është se nuk tregojnë kujdes për t’u ruajtur nga harami (gjërat jolegjitime, të palejuara e të pabekuara), nga gjërat e dyshimta dhe nga shkelja e të drejtave të personit. Pavarësisht nga kushtet, mundësia veçanërisht për të qenë i përsheptshëm dhe i qetë në namaz dhe për ta falur namazin me kënaqësi e duke derdhur lot, varet nga ngrënia e gjërave hallall, nga përgatitja e ushqimit duke e kujtuar Allahun e Lartë dhe duke e ngrënë atë sikur të ishe në prani të Tij! Personi i cili e ka ushqyer trupin me kafshatë haram, nuk mund të ndjejë hare nga namazi!

Në hadithin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) që thotë se “*Namazi është miraxhi i besimtarit*” (Sujuti, Kritikë e Ibni Maxhes, I, 313), aludohet për shkallët e namazit të vërtetë. Personi që ka qëndruar në namaz, duhet që, duke e thënë tekbinin iftitah (të fillimit), të jetë në gjendje kënaqësie e përshept-





shmërie si rrjedhojë e meditimimit mbi madhësinë dhe lartësinë hyjnore të Allahut të Lartë dhe të thellohet në këtë gjendje gjer në dalldi! Kulmi i kësaj gjendjeje i përket të Dërguarit të Allahut (s.a.s.)!

E vërteta esenciale e thënies së Fjalës së Njesisë “La ilahe il’allah” është të mos mbash në zemër askënd tjetër veç Allahut të Lartë, të mos krijosh idhuj në zemër! Zbatimi i konkluzioneve të Islamit, domethënë kryerja e urdhrave dhe shmangia nga ndalimet, lënia e haramëve, e gjërave të dyshimta, madje e mubaheve të tepërta, ndenjja larg përjashtimeve dhe përdorimi në sasi të domosdoshme i mubaheve, janë plotësisht dritë dhe kënaqësi. Në të njëjtën kohë, janë një mjet që të ngjit në shkallët e shenjtërisë dhe urtësisë shpirtërore (evlija). Me anë të këtyre arrihen gradët e shenjtërisë (velajet). Të gjithë ata që mbeten larg, mbeten se nuk u kushtojnë vëmendje këtyre por veprojnë sipas dëshirave të veta, ndërkohë që frymëzimi dhe begatia e Zotit vijnë për çdo çast.



Mevlana Halid Bagdadi, *kuddise sirruh*

(vd. 1826)

Të këshilloj ty, të mbështetesh në bindjen dhe devotshmërinë ndaj Allahut, të mos u shkaktosh mundime e vuajtje njerëzve kudo që të ndodhesh, veçanërisht, të sillesh më me kujdes në Qabe dhe në Xhaminë e Profetit!

Edhe në qoftë se të përgojnë, ti mos përgojo askënd! Mos merr asgjë nga pasuria materiale e ndonjë personi! Merr atë që e ka bërë sheriat hallall për ta marrë dhe përdore në rrugë hallall (legjitime, të lejuara e të bekuara)! Mos u kënaq duke shpenzuar për epshin ndërsa vëllezërit e tu të fesë janë të varfër e të uritur! Në asnjë mënyrë mos gënje! Askënd mos e nënvleftëso! Mos mendo se je mbi të tjerët! Në adhurimet ndjesore dhe trupore shpenzoje tërë fuqinë që ke! Krahas kësaj, bëje nefsin (egon) tënd që ta pranojë mendimin se “asnjëherë s’ka bërë ndonjë punë të mirë të pranueshme”! Sepse nijeti (qëllimi) është fryma e adhurimeve! Dhe nijeti është i mundur me ihlas (principalitet dhe sinqeritet). Kur principaliteti dhe sinqeriteti u duhen atyre që janë më të mëdhenj se ti, si të mos të duhet ty? Beto hem në Zotin e Lartë se, qysh më ka lindur nëna e gjer më sot nuk besoj të kem bërë qoftë edhe një të mirë të vetme e cila të jetë me vlerë dhe e pranueshme në lartësinë e Allahut dhe për të të mos jepet llogari!

Po qe se nuk e sheh nefsin tënd të falimentuar në të gjitha punët e dobishme, kjo është pika e fundit e injorancës! Po qe se e di si të falimentuar, mos e humb shpresën te mëshira e Allahut!





Musa Efendi, kuddise sirruh

(1918 – 1999)

Bota e zemrës dhe përkryerja e një besimtari shpalosen në sjelljet e tij. Disa prej këtyre bukurive më kryesore janë këto:

Të jetë gjithmonë i thjeshtë e modest, t'i dijë vlerat e kohës dhe frymës e të mos i shpenzojë kot ato, t'i dojë robtë e Allahut e të mos grindet me ta, t'i trajtojë bashkëbiseduesit sipas nivelit të tyre fetar, të jetë mbulues i fajeve të të tjerëve, të jetë i kujdesshëm ndaj hallallit dhe haramit dhe t'i shohë si të mëdha edhe mëkatet që çdokush i sheh të vogla, sepse ai që e sheh të vogël mëkatin e vet, mos qoftë e thënë, e ka parë Zotin të vogël!

Në rrugën e pëlqimit të Zotit tonë, ta stolisim kohën e zbardhjes me namaz, dhikër dhe lutje. Së pari t'u shërbejmë pjesëtarëve të familjes dhe të mëdhenjve të familjes. Duke e pakësuar afrinë me njerëzit e interesave të kësaj bote, të rrimë e të shoqërohemi me të mirët (salih). Duke u shërbyer fafesisit dhe nevojtarëve, t'i ndihmojmë ata si me fjalë, ashtu dhe materialisht! Më e rëndësishmja, të tregohemi të rreptë në haram dhe hallall! Veçanërisht të sillemi me kujdes edhe në punët e tregut e të dhënie-marrjeve në mënyrë që të mos humbim nga cilësitë e robit ndaj Zotit!

Të gjitha gabimet, hutimet e shkarjet na shfaqen në ato çaste kur ndodhemi indiferentë ndaj dhikrit. Tek ata që e vazhdojnë pa ndërprerje gjendjen moralo-shpirtërore të dhikrit, nuk ka hidhërim dhe dëshpërim të kësaj bote, madje nuk ka as gëzim të tepërt të kësaj bote! Kënaqësia dhe bujaria e vazhdueshme si dhe dhembshuria për krijesat e mbushin vendin e atij boshllëku. Pra, dashuri, vazhdimisht dashuri... Allahu i Lartë e zhyt në detin e dashurisë robin që e do Atë! Atëherë ai person i do ata që janë të denjë të duhen, aq sa ç'i bën Zoti të dashur!

Njeriu duhet ta quajë detyrë shumë të çmuar t'i shërbejë bukur për pëlqimin hyjnor shoqërisë së cilës i përket. Personi që i shërben jetës, rregullit dhe mirëqenies së një shoqërie, ka vlerën e një qenieje shumë të çmuar mes asaj shoqërie. Për rrjedhojë, edhe shpërblimi i tij është po aq i madh.

Në hadithin profetik thuhet:

سَيِّدُ الْقَوْمِ خَادِمُهُمْ

"Personi që i shërben një fisi, është më i madhi i atij fisi (për sa i përket meritimit të shpërblimit)!" (Dejlemi, Musned, II, 324)

Shumë persona, megjithëse bëjnë shumë adhurime, mbeten indiferentë ndaj vetisë së lartë të Zotit si "settaru'l-ujub", "mbulues i të metave", si dhe atributit të Tij si falës i gabimeve. Për këtë shkak, nuk përparojnë dot siç duhet. Mirëpo falja dhe mbulimi i të metave është ndër cilësitë më me





rëndësi të moralit të bukur! Ashtu siç na i mbulon e na i fal Allahu i Lartë të metat dhe gabimet neve, ashtu dhe ne duhet të jemi falës! Ata që kanë fituar dashurinë e Allahut, dinë të falin!

E gjithë aftësia është të mundim të qëndrojmë bashkë me Zotit në rrëmujën e kësaj bote dhe mes një mijë e një preokupacionesh të shumëllojshme. Kjo gjendje e këndshme është një dhuratë e Zotit për robtë e Tij. Po qe se do të mund ta mendonim në mënyrë të gjithanshme këtë detyrë tejet të lartë, do të shpëtonim edhe nga mashtrimi prej lojërave symbyllazi të kësaj bote!

Njëra nga dhuntitë më të mëdha të Zotit për robin është ta bëjë atë ta kuptojë dobësinë e vet. Ndoshta dhuntia më e madhe që fitova në këtë rrugë shpirtërore, qe mundësia për t'i parë gabimet e mia! E kuptova falimentimin tim para Zotit dhe, kështu, nuk më mbeti fuqi të shoh gabimet e të tjerëve dhe të merrem me ta! Lavdi Allahut, e falenderoj për të gjitha këto!..



Zoti ynë! Na mundëso edhe neve pjesë nga zjarri i dashurisë së zemrave të miqve të së Vërtetës! Dhe na e mundëso të orientohemi me vërejtjet, paralajmërimet dhe këshillat e begata të miqve të së Vërtetës, me ndihmën moralo-shpirtërore të të cilëve jemi ushqyer!

Amin, ashtu qoftë!





PJESA E GJASHTE



RREFIME MISTIKE DHE SHEMBUJ MESIMDHENES

Arsimimi i vërtetë
Metoda në edukimin moralo-shpirtëror
Ibrahim bin Et'hemi dhe sorkadhja
Të mos lëshosh njollë në rrugën e Zotit
Kerameti ose aftësia parashikuese
Ndikimi i zemrave indiferente
Porta e mikut
Bindje, shërbim, këshillë
Shërbim ndaj krijesave
Delikatesa te miqtë e Zotit
Vullneti në audiencë
Edukata dhe etika
Etika në shërbim
Sidomos edukatë dhe etikë
Moralit dhe shërbimi i një miku të Zotit
Ta dinë jo të vdekshmit, por i pavdekshmi!
Mos përbuz askënd!
Mos fyej askënd!
Gëzoje jetimin
Miqësia
Synimi i miqësisë
Nënshtrim i plotë
Të marrësh lutjen e besimtarit
Një i humbur nga mendja dhe ilaçi i zemrës
Fytyra engjëllore
Gjendja e zemrës në mirëbërësi
Akti i mirë që ngjitet në arshin e lartë
Ta dallosh gjithmonë të vërtetën
Mua më duhet bujari
Përgjegjësia e atyre që prijnë
Përgjigje ndaj ftesës së Allahut
Rëndësia e hallallit
Fitimi hallall



PERMBLEDHJE



Të kesh edukatë, o ti!



*M*iqtë e Zotit që arrijnë te Zoti në qendrën e miqësisë, mbeten përjetësisht miq të të gjithë njerëzimit!



RREFIME MISTIKE dhe SHEMBUJ MESIMDHENES

Siç e prekëm vende-vende në pjesët e mëparshme, meqë tasavvufi ose mistika islame është një dituri që ka të bëjë më shumë jo me fjalën se sa me përmbajtjen, pra, me përsosmërinë e përmbajtjes dhe sjelljes, është i mbushur plot me begati dhe bukuri që reflektohen nga klimat ndjesore (afektive) të evlijave, në jetë. Këto bukuri të reflektuara bashkëbiseduesve që në krye të herës nëpërmjet rrëfenjave dhe tregimeve me karakter legjendar, kanë marrë përsipër një rol të efektshëm orientues për robtë e Zotit me anë të aspekteve të tyre që i përftojnë pjekuri besimit, e përsosin moralin, u japin vrull burimeve të dashurisë dhe ashkut hyjnor dhe që ushqejnë ndjenja të larta si mëshirën, faljen dhe vetëmohimin. Kështu, rrëfenjat të cilat duken shpesh në Kur'an, përsa i përket faktit që ngjarjet e tyre janë sidomos nga brenda jetës, parashatrojnë efektin që do të ushtrojnë në zemra dhe japin një stil hyjnor në rrugën e pjekurisë shpirtërore të njeriut. Ja, pra, edhe ne, duke u mbështetur në këtë stil hyjnor, krahas që në pjesët para kësaj dhamë vende-vende shembuj të ndryshëm, u përpoqëm që të jepnim edhe disa shembuj konkretë për subjektet dhe të vërtetat që u përpoqëm të tregonim edhe në këtë pjesë dhe, kështu, të reflektonim gjendjen e të vërtetave mistike jo vetëm në rreshta, por edhe në gjokse. Veç kësaj, edhe interpretimin, komentin dhe specifikat që mund të thuhesh si tërheqje vëmendjeje mbi idetë dhe mësimet që përmbajnë këto rrëfenja, u përpoqëm t'i trajtojmë në mënyrë të përmbledhur. Shkurt, në këtë pjesë deshëm t'u parashatrojmë lexuesve disa pika nga bota morale dhe e virtyteve sa një det e mistikëve.

ARSIMIMI I VERTETE

H.z. Sami Efendi sapo kishte mbaruar Fakultetin e Drejtësisë të Akademisë së Shkencave. Një mik i Allahut të cilit i kishin pëlqyer shumë paraqitja dhe qëndrimi si dhe karakteri i tij, i tha:





“O bir, edhe ky arsimim është i mirë, po ti shih të plotësosh arsimimin e vërtetë. Të të regjistrojme në shkollën e kulturës shpirtërore¹ ku të mësosh dijet e zemrës dhe të fshehtat e ahiretit, jetës tjetër!”

Dhe shtoi:

“O bir, unë s’e di se ç’mësime bëjnë në atë shkollë, ç’u mësojnë nxënësve, por e di se **mësimi i parë i kësaj shkolle është të mos i lëndosh të tjerët, kurse mësimi i fundit, të mos ndjehesh i lënduar vetë!..**”

Ideja:

Është relativisht e lehtë të mos e lëndosh tjetrin, por e vështirë të mos lëndohesh vetë. Prandaj, të mos lëndohesh është e mundur vetëm me çefektizimin e shigjetave të helmuara të ardhura nga të vdekshmit dhe të ngulura në zemër, gjë që është në raport të drejtë me nivelin e përkryerjes së pastrimit të nefsit dhe purifikimit të zemrës. Kur Profetin e patën gjuajtur me gurë dhe e patën fyer rëndë në Taif, engjëjt i patën propozuar:

“O i Dërguari i Allahut! Po deshe, t’i përplasim këto dy male me njëritjetrin dhe ta shkatërrojmë popullsinë mizore të këtij vendi!”

Por Profeti i lartë i cili ishte dërguar si mëshirë për botët, jo vetëm s’e pranoi këtë propozim, por, mes ndjenjash dhembshurie e mëshire, e ktheu fytyrën e bekuar nga ana e Taifit dhe u lut që populli i atij vendi ta gjente rrugën e vërtetë.²

Edhe Hallaxhi Mansur, një i dashur i pasionuar pas Profetit, kur e patën gjuajtur me gurë, qe lutur:

“Allahu im! Këta nuk dinë! Fali ata para meje!”

Kjo është një gjendje e zemrës së paqëtuar të arritur si rezultat i arsimimit të vërtetë, domethënë, i edukimit moralo-shpirtëror.

Kur Ebul Kasem el-Hakimin e patën pyetur për atributet e zemrës së paqëtuar, pati thënë këto fjalë:

“Zemra e paqëtuar ka tri veti:

E **para**, është një zemër që nuk lëndon.

E **dyta**, është një zemër që nuk lëndohet.

E **treta**, është një zemër që e bën të mirën për pëlqim të Allahut pa pritur shpërblim...

Besimtari paraqitet në audiencën e Zotit me pastërti, se nuk ka lënduar askënd; me besë, se e ka pasë zemrën të drejtuar nga Zoti, prandaj nuk është lënduar nga askush; dhe me sinqeritet, pasi me punët e mira që ka kryer, nuk i ka bërë ortak Zotit asnjë vdekëtar...”

1 Në origjinal: irfân mektebi (turq.).

2 Shih. Buhari, *Bed’u’l-Halk*, 7; Muslim, *Xhihad*, 111.





Sa bukur shprehet poeti:

*Në këtë botë, o ashik, ky është synimi i njerëzve e xhindve:
As dikush të mos lëndohet prej teje, as ti prej të tjerëve!*



METODA NE EDUKIMIN MORALO-SPIRTEROR

Delikatesat për të cilat Hz. Shah Nakshibend pati bërë kujdes në specifikat e pastrimit të nefsit dhe purifikimit të zemrës në tasavvuf, i ka shprehur kështu:

“Ne e edukojmë myridin në mënyrën e duhur, domethënë, sipas gjendjes në të cilën ndodhet ai. Kur duhet, zgjedhim rrugën e tërheqjes shpirtërore, kurse kur duhet, rrugën e përvojës mistike. Ne e dimë se në zemrat e disave nga ata që vijnë në kuvendet tona, ka farëra afrimi e dashurie, kurse te disa të tjerë, jo, ose u janë kalbur nga lidhjet dhe interesimet materiale e subjektive. Ja, pra, detyra jonë është t’i pastrojmë këto lidhje të përkohshme e të vdekshme për të mbjellë në zemra farërat e dashurisë, kurse ata që i kanë zemrat të mbjella, t’i ujisim me zemzemin e të vërtetës (hakikat) dhe t’i bëjmë të jeshilojnë për t’i shndërruar në fidanë singeriteti dhe principialiteti (ihlas) me anë të diellit të njohjes intuitive (marifetullah) të Zotit.

Sa për sugjerimin e zikrit (dhikrit), ai është si t’i japësh dikujt në dorë një gur çakmaku. Pas kësaj, puna i mbetet myridit, domethënë, që ai ta përplasë diku gurin e çakmakut për të nxjerrë shkëndija për të ndezur pishën e ashkut, dashurisë hyjnore!”

Ideja:

Ashtu siç janë të ndryshme sëmundjet e trupit dhe rrugët e mjekimit të tyre, të tilla janë edhe sëmundjet e zemrës dhe shpirtit. Prandaj miqtë e Allahut, të zgjuar e tejpamës, në edukimin moralo-shpirtëror zgjedhin rrugën e diagnostikimit dhe mjekimit sipas gjendjes së bashkëbiseduesve të tyre. Dhe, kështu, ka ndodhur që Ibrahim bin Ed’hemi të porositet ta lërë fronin dhe kurorën, kurse sulltan Mehmeti, Ngadhunjimtari, të mos ta lërë fronin, por ta vazhdojë punën e tij edukuese e orientuese në atë pozitë ku ndodhet, duke i bërë këtë arsyetim:

“Po qe se ti e lë këtë detyrë dhe në vend tënd nuk vjen ndonjë më i denjë se ti, ke për të rënë nën faj!”

Dikë e vënë në provë me ujë e, dikë, me zjarr. Prandaj, ashtu siç është e detyrueshme që personi i sëmurë nga trupi duhet t’i dorëzohet mjekut dhe ta zbatojë recetën e dhënë prej tij, edhe mjekimi i sëmundjeve ndjesore të zemrës është po kaq i detyrueshëm, ndoshta, më delikat, sepse nën-





vleftësimi në mjekimin e trupit shkakton një dëm që i përket vetëm kësaj bote, kurse nënvleftësimi në mjekimin e zemrës shkakton një disfatë të përrjetshme.



IBRAHIM BIN ED'HEMI DHE SORKADHJA

Ibrahim Bin Ed'hemi ishte, në fillim, në Belh, një sundimtar i dhënë pas salltanetit dhe shkëlqimit. Për ta shpëtuar atë nga ky pasion dhe për t'ia rizgjuar ahiretin, njerëzit e shquar dhe mistikët e kohës i bënë herë pas here paralajmërimet me anë të ngjarjeve dhe shembujve mësimdhënës. Kështu, sipas rivajetit të njohur, një natë ai pati dëgjuar disa zhurma dhe zëra të çuditshme në çatinë e sarajit, nuk pati fjetur dot dhe pati bërë zë me kureshtje:

“Ç’po bëni ju atje?”

I pati ardhur një përgjigje e çuditshme:

“Kemi humbur devenë! Atë po kërkojmë!”

Ibrahim bin Ed'hemi qe nxehur:

“A kërkohet deveja në çati?”

Përgjigja qe me kuptim dhe e hapur:

“O Ibrahim! Ti e di se s’kërkohet deve në çati, por pse s’mendon se nuk mund të kërkohet lumturia e përrjetshme në këtë jetë që je duke bërë në pasuri dhe shkëlqim?”

Në krahasim me paralajmërimet e tjera mësimdhënëse, këto fjalë e prekën shumë Ibrahim bin Ed'hemin. Mirëpo, meqë pas një farë kohe edhe këtë e harroi, në mënyrën e tij të jetesës nuk u duk ndonjë ndryshim.

Ndërsa ditët ndiqnin njëra-tjetrën po njëlloj, një ditë, Ibrahim bin Ed'hemi doli bashkë me suitën për të gjuajtur sorkadhe. Një çast dhe u nda nga shoqëruetit. Kishte mbetur vetëm! Duke parë andej-këtej me vëmendje për të dalluar gjahun, në vesh i erdhi një zë: “Zgjuhu!” Por ai s’i dha rëndësi! I njëjti zë u përsërit edhe një herë, pastaj edhe një herë tjetër gjersa nga të gjitha anët nisën t’i thërrisnin:

“Zgjuhu vetë para se të të zgjojë vdekja!”

Ibrahim bin Ed'hemi edhe u habit, edhe u frikësua! Ndërkaq, përballë i doli një sorkadhe. Ibrahim bin Ed'hemin e kapi pasioni i gjahut për ta vrrarë atë kafshë nazemadhe! I harroi zërat e një çasti më parë, nxori një shigjetë, e tendosi harkun dhe mori shenjë. Sapo do ta lëshonte shigjetën, kur sorkadhja ia nguli sytë plot shprehje dhe i foli:

“O Ibrahim! A për të më gjuajtur mua të krijoi Allahu mëshirues?”





Ibrahim bin Ed'hemi u drodh nga koka te themrat! Sytë iu mjegulluan, u hodh nga kali dhe ra në sexhde! Bëri pendesë dhe iu lut Zotit:

“Allahu im që e ke të mirën dhe bujarinë pa fund! Vështroma edhe hallin tim! Që prej sa kohësh i paskam çuar kot frymët e jetës! Allahu im! Ki mirësi e ma laj zemrën dhe mos lër në të asgjë tjetër veç dashurisë për ty!”

Tashmë Ibrahim bin Ed'hemi i kishte hapur sytë ndaj një bote tjetër krejt të ndryshme, ishte zhytur në soditjen e një klime hyjnore! Ja, ishte kjo soditje që i kishte fshirë plotësisht te ai konsideratat e bukurive të tje-
ra! Kështu, rrobat mbretërore që i vishte çdo mëngjes me ceremoni dhe mbretërimi i Belhit që ia frynte gjoksin me krenari, e humbën, tashmë, tërë stolinë dhe shkëlqimin, shkurt, tërë rëndësinë, dhe filluan t'i dukeshin të huajtura!

Me sytë të njomur nga lotët e pendesës dhe me zemrën të djegur nga zjarri i pendimit, Ibrahim bin Ed'hemi mori udhët për në shkretëtirë. Kishte ecur mjaft kur takoi një çoban. I shkoi menjëherë pranë, ia dha pelerinën e vet mbretërore dhe, si shkëmbim, i mori zhgunin që e hodhi menjëherë mbi supe. Në atë çast ndjeu një lehtësim të madh! Kurse çobani kishte mbetur i ngrirë nga habia. Ai mendonte me vetvete: “Mbreti ynë duhet ta ketë humbur mendjen!..” Kurse Ibrahim bin Ed'hemi nuk e kishte humbur mendjen, përkundrazi, i kishin ardhur mendtë në kokë! Kishte dalë të gjuante sorkadhe, kurse Allahu i Lartë e kishte zgjuar me anë të një sorkadheje!..

Ideja:

Ata të cilët, kur u kërkohet të zgjedhin midis botës dhe ahiretit, zgjedhin ahiretin, bëhen të merituar të shpërblimeve të pafundme si mbretër të përjetësisë. Kurse ata që zgjedhin këtë botë, edhe nëse bëhen në këtë botë formalisht mbretër, në të vërtetë janë lypsarë të botës së përjetshme, të cilëve s'ka për t'u rënë gjë në dorë! Ja, pra, Ibrahim bin Ed'hemi i cili e kuptoi këtë të fshehtë, kur e pa se përmirësimi i tij kalonte vetëm nëpër braktisjen e sundimit, e bëri këtë sakrificë, e la fronin dhe u bë një mbret i përjetësisë! Kurse shkaqet paralajmëruese që i dolën para, janë, në një aspekt, begati e margaritarit të sinqeritetit dhe principialitetit që i ndodheshin në zemër. Më saktë, gjendja e tij shpirtërore u bë pretekst që t'i dilnin para shkaqet që do ta shtynin për të hedhur hapin drejt klimës hyjnore dhe meritimit të shfaqjeve sublime të Zotit, që t'i bëhej e lehtë sakrifica e madhe e braktisjes së mbretërimit dhe, më në fund, që ai të arrinte brenda një çasti shumë e shumë mirësi! Sa bukur e shpreh poeti këtë situatë:

*Kur shfaqet Zoti, çdo punë bëhet me lehtësi;
Zoti e bën shkaku, në çast e kthen në mirësi!*





TE MOS LESHOSH NJOLLE NE RRUGEN E ZOTIT

Kjo rrugë, domethënë rruga e tasavvufit, është një horizont i tillë i ndritshëm ku shfaqet drita e Zotit, që kurrë nuk pranon njollë! Ata që mundën ta shohin thelbin dhe frymën e kësaj rruge, kurrë nuk mund të gjejnë në të ndonjë situatë në kundërshtim me fenë e vërtetë!³

Kështu, në rrethin shpirtëror të Shah Nakshibendit kishte nxënës të panumërt nga të gjitha shtresat, nga populli e nga parësia. Edhe dijetarë të shquar të Buharasë, si Haxhe Jusufi, kishin dëshirë të madhe të merrnin pjesë në kuvendet e tij. Ndërkaq, disa nga dijetarët, duke e bërë këtë gjë pretext thashethemesh mes tyre, nisën të flasin për Bahaiddin Nakshibendin (k.s.) mbarë e prapë. Më në fund, një ditë, këta opozitarë u takuan me Hz. Nakshibend në një kuvend dhe paraqitën kritikën e tyre. Bahaiddini (k.s.) u tha:

“Ejani t’jua tregoj rrugën tonë. Po qe se ka në të ndonjë specifikë në kundërshtim me Kur’anin dhe sunnetin, na thoni të heqim dorë!”

Dijetarët që i dëgjuan thëniet e të urtit dhe që e shqyrtuan hollësisht këtë rrugë të lartë tasavvufi, para të vërtetave të larta për të cilat u bënë personalisht dëshmitarë, nuk gjetën dot gjë për ta kundërshtuar. Dhe, me respekt të plotë, thanë:

“Imzot, rruga jua qenka sirati mustakim⁴, s’kemi asnjë kundërshtim!”

Ideja:

Gjëja që kuptohet nga kjo ngjarje është se rruga e vërtetë e tasavvufit ose mistikës islame ndjek me konsekuencë të lartë dhe me ndjeshmëri ndjesore Kur’anin dhe Sunnetin. Edhe fakti që Shah Nakshibendi i cili, ndërkaq, u tregonte edhe nxënësve se në ç’mënyrë të vepronin, nuk hynte në konflikt me dijetarët mbi dijet formale, por kërkonte prej tyre t’i thonin nëse kishte diçka në kundërshtim me Kur’anin dhe sunnetin dhe të hiqnin dorë prej saj, ky fakt, pra, tregon për rëndësinë e orientimit në këtë rrugë. Prandaj, ajo që u takon nxënësve të kësaj rruge, është që, duke treguar të njëjtën ndjeshmëri, të mos lëshojnë njollë në këtë rrugë krejt të pastër. Ndërkaq, dijetarët për të cilët bëhet fjalë këtu, janë dijetarë të drejtë dhe jo ata që u janë prishur zemra dhe dituria, që, prandaj, veprojnë në të kundërt me rrugën e Zotit, e quajnë pa asnjë vlerë sinqeritetin, principialitetin dhe

3 Në origjinal është din-i mubin, feja diferencuese, feja islame që e ndan, e diferencon të mirën nga e keqja.

4 Sirati mustakim: rruga e drejtë, rruga e Kur’anit dhe e Profetit.





devocionin, ua mohojnë vlerat dhe virtytet miqve të Allahut dhe, sipas shprehjes së Kur'anit, i shesin ajetet e Allahut për një përfitim të vogël të kësaj bote!



KERAMETI⁵ OSE AFTESIA PARASHIKUESE

Një ditë, nxënësi i kërkuan Shah Nakshibendit t'u tregonte një keramet. Ai u tha:

"Keramenti ynë është i hapur. Ja, shihni! Me gjithë peshën e rëndë të mëkateve që kemi mbi supe, mundemi të qëndrojmë në këmbë, dhe të ecim mbi tokë! A ka mrekulli më të madhe se kjo?"

Pastaj, duke ua kujtuar nxënësve edhe një herë se e rëndësishme në tasavvuf nuk është keramenti, mrekullia, por orientimi, u tha kështu:

"Edhe po qe se dikush hyn në një kopësht me pemë dhe atje dëgjon që të gjitha gjethet me radhë e përshëndesin me fjalët, "O i zgjedhuri i Allahut, merhaba!", nuk duhet t'i vlerësojë këto zëra as formalisht, as në përmbajtje, përkundrazi, ta forcojë akoma më tepër zellin dhe vendosmërinë në adhurim dhe shërbim!"

Pas këtyre fjalëve, disa myridë i thanë:

"Imzot, sado që t'i mbuloni gjërat, edhe nga ju herë pas here shfaqen keramete!"

Ai monument i madh thjeshtësie tha:

"Ato që keni vënë re ju, janë kerametet e myridëve të mi!"

Sepse ai e fshihte aq shumë veten, saqë, kur qe gjallë, nuk i pati dhënë leje myridit Hysameddin Haxhe Jusufit t'ia shkruante fjalët dhe kerametet!

Parim:

Njerëzit e mëdhenj të Islamit kanë mundur të arrijnë në pozita të larta të merituara duke bërë si parim për vete në rrugën e Zotit gjithmonë orientimin dhe jo kerametin, mrekullinë. Ata kanë thënë se në sajë të kerametit nuk kanë fituar ndonjë vlerë më tepër se vlera e zogut që fluturon në ajër dhe e peshkut që vozit në ujë. Gjithashtu, ata e kanë shprehur me çdo rast se aftësia e vetme nuk është përpjekja për të imituar atë që bëjnë zogu me

5 Keramet do të thotë edhe mrekulli, sipas konceptualitetit mistik, shenjë mrekullie karakteristike për personin e shenjtë i cili, duke i kapërcyer ligjet e natyrës që e kufizojnë njeriun e zakonshëm, arrin të shohë, kuptojë, parashikojë dhe veprojë në mënyrë mrekullore.





peshkun, por për të jetuar në mënyrë të orientuar në rrugë të drejtë me një vetëdije të lartë adhurimi ndaj Zotit dhe për pëlqim të Tij, dhe e kanë treguar këtë me qëndrimet, sjelljet dhe veprimet e tyre!



NDIKIMI I ZEMRAVE INDIFERENTE

Në një ditë të bekuar të vitit 1340 hixhri, në xhaminë e Shën Sofisë në Stamboll po bëhej këndim Kur'ani dhe mevludi. Xhamia ishte e mbushur plot gjer në ballkonet. Aty ndodheshin dijetarë dhe nxënës. Hafizët më të shquar të ditës kishin nisur të këndonin Kur'an dhe mevlud.

Një person me vlera të larta shpirtërore, i quajtur Adil Bej, i hapur ndaj frymëzimit dhe komunikimit hyjnor, ishte ulur diku pranë katedrës dhe po dëgjonte...

Pak më pas, Adil Beu ndjeu një shtrëngim shpirtëror. U mërzi e u turbullua. Mirëpo nuk duhej t'i ndodhte kështu në atë atmosferë shpirtërore ku këndohej Kur'an dhe mevlud! Adil Beu vështroi me kureshtje përreth dhe vuri re se mu përballë i ndodhej dikush, një indiferent që të shkaktonte mërzi në zemër. Pa i rënë në të, kishin qëndruar ballëpërballë. Duke e kuptuar se shqetësimi dhe shtrëngimi shpirtëror i shkaktoheshin nga reflektimi tek ai i gjendjes shpirtërore të personit përballë, Adil Beu ndërroi menjëherë vend dhe u qetësua disi megjithëse ndikimin e tij nuk e hoqi dot edhe për një farë kohe.⁶

Ideja:

Ashtu siç ndodh që nga njerëzit e mirë (salih) të reflektohet në zemra qetësi e prehje, ashtu edhe ndodh që nga njerëzit indiferentë të reflektohet shqetësim dhe ankth. Ndërsa zemrat që shëtisin në trëndafilishte, dehen me një mijë e një aroma, zemrat që bien në mjedise të fëlliqura turbullohen nga kundërmimet e këqija. Prandaj, për mohuesit me zemra të kalbura dhe që lënë vazhdimisht gjurmë të këqija përreth, Zoti thotë:

“Kur t'i shohësh ata që kridhen në biseda poshtë e përpjetë mbi ajetet tona, qëndro larg prej tyre gjersa të kalojnë në një bisedë tjetër. Po qe se shejtani të bën të harrosh, pasi të kujtohesh, ngrehu dhe mos rri më me atë grup njerëzish të padrejtë e mizorë!” (el-En'am, 68)

6 Efekti i namazeve të falura varet nga gjendja e zemrave. Në suren Maun, Zoti thotë: **“Sa keq për ata që falin namaz por janë indiferentë ndaj namazit të tyre! Ata nuk janë të sigurtë as në punët e tyre!”** Prandaj është e natyrshme që në faltore të ndodhen edhe persona indiferentë, domethënë me zemër të sëmurë, madje edhe hipokritë.





Kuptimin e hollë të këtij urdhri hyjnor e kuptojnë më mirë robtë e vërtetë me zemër të ndjeshme, sepse me rritjen e ndjeshmërisë së zemrës, dimensionet thellohen, shikimet nisin t'i vështrojnë të vërtetat pas perdes, ndjenjat nisin t'i rrokin bëmat që nuk i dallon dot çdo njeri. Si shembull i kësaj, rasti i Sejfi Babait është mjaft domethënës:

Miku i Zotit, Sejfi Babai, i cili e donte shumë Sami Efendiun, ishte një person me vlera të larta shpirtërore, i hapur ndaj frymëzimit dhe komunikimit hyjnor. Ai rrinte në Topkapi. Një ditë, i kishte shkuar për vizitë Sami Efendiut (k.s.). Sapo hyri brenda, i ra të fikët dhe u rrëzua përtokë. Personi që do t'i urdhëronte mirëseardhjen dhe do ta shoqëronte brenda te Sami Efendiut, e spërkati me ujë, e sollti në vete dhe i tha:

“Të dërgojmë menjëherë të thërrasim një doktor!”

Ashtu, i dobët e i pafuqishëm, Sejfi Babai i ndërhyri:

“Jo, o bir! Mos thërrisni doktor! Gjendja ime s’ka lidhje me ndonjë sëmundje! Gjersa erdha nga Topkapia në Erenkoj, njerëzit e këqinj dhe ankthi i vendeve të këqija më preku keq dhe tani, saqo që u futa në këtë atmosferë shpirtërore krejt të pastër, zemra e lodhur s’e përballoi dot më të keqen. Por me begatinë e klimës shpirtërore të këtushme dhe me favorin e Sami Efendiut, mbretit të të diturve, pak më pas s’do të më mbetet më gjë!”

Shkurt, ashtu si efektet negative të indiferentëve shfaqen dhe e ngushtojnë zemrën, edhe efektet pozitive dhe të begata të njerëzve të mirë dalin në shesh dhe i japin prehje zemrës. Prandaj, njerëzit e zemrës, për ta mbrojtur gjendjen e vet ndjesore e shpirtërore, me sa të kenë mundësi duhet të rrinë larg indiferentëve dhe pranë të mirëve. Në lidhje me këtë, Hz. Daudi i përgjerohej kështu herë pas here Zotit:

“Allahu im, po të më shohësh se jam drejtuar për tek kuvendi i indiferentëve, m’i thyej këmbët pa arritur ende aty, që të mos mund të shkoj tek ata! Kjo do të ishte një favor i madh për mua!”



PORTA E MIKUT

Një ditë, Hz. Ebu Said Nishaburi u tha nxënësve:

“Përgatisni kuajt se do të shkojmë në kasaba!”

U bënë përgatitjet e duhura dhe prijësi bashkë me një grup nxënësish u vunë në udhë. Kur arritën në një fshat të Nishaburit, pyeti:

“Si e ka emrin ky fshat?”

Iu përgjigjën:

“Porta e mikut” – i thonë!”

Dhe Ebu Said (k.s.) vendosi të bëjë konak aty. Pasi qëndruan një ditë, disa nxënës e pyetën mësuesin:





“Imzot, sikur do të shkonim në kasaba! A nuk do ta vazhdojmë udhën?”

Ebu Saidi që e kishte të mbushur zemrën plot të fshehta shpirtërore, u tha nxënësve:

“Ashikut i duhet të kapërcejë shumë rrugë që të mund të arrijë te porta e mikut! Meqë ne kemi arritur këtu, domethënë, në portën e mikut, ku të shkojmë?”

Dhe ndenjen aty dyzet ditë e dyzet net. U përjetuan shumë situata shpirtërore dhe shumë vetë nga njerëzit e fshatit, duke u bërë të denjë për pendesë me bisedat e bekuara dhe të begata të Ebu Saidit (k.s.), u bënë nxënës të tij. Ja, pra, ideja e vërtetë e “portës së mikut” për të cilën e pati fjalën prijësi dhe mësuesi shpirtëror Ebu Said ishte kjo, fitimi i zemrave... Sepse miku mund ta hapte portën e pallatit të pëlqimit hyjnor vetëm duke dërguar aty një zemër të fituar!..

Ideja:

Hapja e portës së mikut (Zotit) duke fituar një zemër është bërë tipari dallues më i madh i miqve zemërpërvëlur të Zotit dhe një parim dashurie në zinxhirin e punëve të mira (ameli salih) për ta përgatitur veten për takimin e madh. Nisur nga kjo, Hz. Shah Nakshibendi e kryente me aq delikatesë dhe me aq përpjekje të posaçme detyrën e orientimit për të cilën kishte përgjegjësi, saqë interesohej për çdo gjendje të nxënësve të vet. Kur ky prijës i madh shkonte për t’i bërë vizitë dikujt, pasi e pyeste për shëndetin, e pyeste edhe për familjen, farefisën, kafshët, madje edhe për pulat! Kështu, ai përpiqej t’ia fitonte zemrën. Kur në një kuvend përgatitej gjellë, u jepte vetë nga ajo gjellë atyre që e kishin përgatitur...



BINDJE – SHERBIM – KESHILLE⁷

Një person i mirë (salih) që ndiqte bisedat e Davud Taiut, i tha Maruf Kerhiut:

“Kurrresi mos e braktisësh bërjen e punëve të mira, sepse puna të afroton ty me pëlqimin e Zotit!”

Marufi e pyeti:

“Për çfarë e ke fjalën me “punë”?”

Personi i tha:

“Në çdo situatë të ndodhesh në bindje ndaj Zotit, t’u shërbesh muslimanëve dhe t’u japësh këshilla atyre!”





Thelbi i fjalës:

Adhurimi i pakët i bërë me **bindje** (itaat) dhe nënshtrim është sa malet më i mbarë e më i dobishëm te Zoti se adhurimi i bërë pa bindje dhe nënshtrim, sepse adhurimi nis me bindje dhe nënshtrim. Me të vërtetë, a s'u dëbua shejtani nga selia e lartë jo për mungesë adhurimi por për mungesë bindjeje dhe nënshtrimit?

Kurse **shërbimi** (hizmet) është një virtyt i tillë që, profetët dhe të urtët, ato personalitete të lartë të cilët janë kapur fort pas tij, nuk e kanë lënë atë as në sëmundje, madje as në shtratin e vdekjes! Kjo është një pikë referimi e mjaftueshme për njerëzit e pajisur me kulturë shpirtërore për të kuptuar se si duhet kapur dhe mbajtur fort pas shërbimit. Shkurt, shërbimi është shenja dalluese e zemrave të mëshirshme e bujare!

Besimtari i formuar është njeri i shërbimit dhe, i çliruar nga qenia e tij e vdekshme, është një ushtar zemre që e pranon vendin e vet mu në fund të karvanit të shërbimit. Ai ndodhet pranë të vuajturve dhe të sëmurëve, rreth të rënëve në zi, në kokë të të pashpresëve, si mik i të vuajturve dhe i të vetmuarve.

Sa për **këshillën** (nasihat), kjo është një cilësi vetëm e njerëzve që mund të japin këshillë, sepse këshilla ka efekt në raport të drejtë me sa zbatohet nga ai që e jep. Për këtë shkak, nuk është me vend që kushdo të japë këshillë. Të drejtë kompetente për të dhënë këshillë kanë ata që janë të denjë për këtë, domethënë personat që zotërojnë stilin shprehës dhe moralin profetik. Krahas kësaj, përgjegjësia dhe pasojat e shmangies nga këshilla kur zotërohet kjo kompetencë, janë të mëdha, sepse në porosinë profetike theksohet:

"Feja është këshillë!" (Buhari, *Iman*, 42)

Është për këtë arsye që braktisja e këshillës deklarohet në suren "Asr" si shkak disfate. Natyrisht, këtu përfshihet edhe mosdëgjimi i këshillës, pra, edhe mosdëgjimi i këshillës është shkak disfate.

Përfundimisht, udhëtarët e udhës së Zotit duhet t'i bëjnë parim për vete **bindjen**, **shërbimin** dhe **këshillën** dhe duhet të tregojnë zell e të bëjnë përpjekje për të fituar pëlqimin e Zotit!



SHERBIM NDAJ KRIJESAVE

Kur vdiq Pertevnijal Valide Sulltan, nëna mbretëreshë, e cila pati ndër-tuar Xhaminë Valide (Xhamia Zonjë) në zonën Aksaraj të Stambollit, një person i mirë (salih) e pa në ëndërr në një pozitë të mirë dhe e pyeti:

"A mos të ngjiti Allahu në këtë pozitë për xhaminë që ndërtove?"





“Jo!” – Iu përgjigj nëna mbretëreshë.

I habitur, personi e pyeti përsëri:

“Atëherë, me ç’punë arrite në këtë gradë?”

Dhe nëna mbretëreshë i dha këtë përgjigje tejet mësimdhënëse:

“Ishte një ditë me shi të dendur. Ne po shkonim për vizitë në xhaminë Ejub Sulltan. Pranë rrugës pashë një mace të vogël e të dobët që po përpëlitej në një pellg me ujë të formuar në skaj të kalldrëmit. E ndala pajtonin dhe i thashë motrës shoqëruese⁸ që kisha pranë:

“Shko e merre këtë mace të vogël se, ndryshe, ka për t’u mbytur!”

Kurse motra më kundërshtoi:

“Aman, mbretëresha ime, do të ndyhem i edhe ti, edhe unë!”

Për të mos ia thyer asaj, unë zbrita vetë nga pajtoni, u futa nëpër baltë dhe e shpëtova macen. Ajo dridhej. M’u dhimbs, e mora në prehër dhe e ngroha mirë e mirë. Pa kaluar shumë, e mjera u gjallërua!

Ja, për mëshirën që tregova për atë mace të vogël ma fali Allahu këtë pozitë të lartë!”

Ideja:

Ruga e ngjitjes për në qiellin e pjekurisë ku mund të arrijë shpirti njerëzor kalon nëpër shkallaret e mëshirës dhe shërbimit. Prandaj çdo musliman duhet t’i bëjë mëshirën dhe shërbimin natyrë të vërtetë të tij dhe kjo duhet të jetë shenja dalluese e tij!



DELIKATESA TE MIQTE E ZOTIT

Musa Efendiu (k.s.) tregon:

“Ishte stina e haxhit. Mësuesi i nderuar Sami Efendi dhe bijtë ndodheshim në Mekën e Nderuar, në shtëpinë e turkestanasit Abdussetar Efendi në zonën Xhijad afër Qabes. Dhoma e Efendiut ndodhej përballë sokakut, kurse tonat, me drejtim nga brenda.

Një kohë dreke, Efendiu na nderoi duke e hapur derën e dhomës sonë dhe na tha:

“Siç duket, dikush jashtë ka nevojë për ushqim!”

I varfëri unë, menjëherë përgatita ushqimet dhe dola, por s’pashë askënd! U ktheva duke pandehur se nevojtar i s’kishte pritur dhe kishte ikur.

8 Pranë nënave të sulltanëve dhe zonjave të pallatit shërbenin gratë zezake sudaneze. Osmanët i punësonin me përparësi në pallat gratë sudaneze sepse ishin të pastra, të ndershme e të virtutshme.





Nuk kishin kaluar tetë-dhjetë minuta kur Efendiu u duk përsëri në derë:

“Ai nevojtar i erdhi prapë dhe po sheh nga dera!”

Kur i mora prapë ushqimet dhe dola jashtë, pashë një kafshëz me gjuhën jashtë që po shihte nga dera, pra, një qen të uritur! Menjëherë ia zbraza ushqimet para siç ishin. Duhej të ishte uritur shumë që i hëngri të gjitha aty për aty!”

Ideja:

Ja, e tillë është delikatesa dhe thjeshtësia te njerëzit e mëdhenj. Zotëria e tij, Sami Efendi nuk e kishte përmendur qenin me emrin e vet si kafshë, por kishte përdorur fjalën “person”. Madje, shpesh herë, edhe për kafshët, në vend të fjalës “krijesë” përdorte shprehjen “robi i Allahut”.

Bukuria morale e treguar për krijesat për shkak të Krijuesit është, në të vërtetë, një bukuri zemre e lidhur sinqerisht pas Krijuesit, pra, një zemër e paqëtuara (kalb-i selim) e ofruar Atij!

Ai që arrin të ketë një zemër të paqëtuara, arrin burimin e pashtershëm të miqësisë hyjnore. Tashmë ai ndjen vazhdimisht një kënaqësi hyjnore, sepse zemrat e paqëtuara janë vende ku shfaqet Zoti. Zemra të tilla janë kryevepra të mëshirës dhe bujarisë!



VULLNETI NE AUDIENCE

Përhapet një thashetheme se Sheh Muhammed Nurul Arabiu nga mistikët e kohës së fundit, kishte mohuar vullnetin e pjesshëm, domethënë, **vullnetin njerëzor!**⁹ Kur e dëgjon këtë, Sulltan Abdylmexhid Hani urdhëron që prijësi shpirtëror të thirret në mësimet që zhvilloheshin në audiencën sulltanore dhe që atje ai të pyetet për këtë çështje. Urdhri i sulltanit zbatohet dhe Sheh Muhammed Nurul Arabiu thirret në audiencë. Pastaj, atje, kur u pyet për thelbin e kësaj çështjeje, ai dha këtë përgjigje:

“Sigurisht që tek njeriu, robi i Zotit, ka një vullnet të pjesshëm. Ky është edhe burimi i përgjegjësisë. Vetëm se jo te gjithkush dhe në çdo kohë. Për shembull, unë sigurisht që kam një vullnet të pjesshëm. Por erdha me urdhër të padishahut. Kurse nuk e kam në dorë të ngrihem e të iki. Na thuhet “eja”, vijmë, na thuhet “shko”, shkojmë. Kjo do të thotë se, në këtë rast, në një specifikë të caktuar, vullneti im nuk ekziston. Gjithashtu, meqë ndodhem në audiencë të padishahut, lëvizjet dhe veprimet që mund të

9 Në origjinal: khuz’í irade, vullnet i pjesshëm; besherí irade, vullnet njerëzor.





bëj janë të kufizuara. Edhe disa njerëz, ashtu si në këtë shembull, jetojnë vazhdimisht me vetëdijen se ndodhen në audiencën e Zotit të tyre. Kurse shumë të tjerë, megjithëse Allahu ndodhet në çdo vend i pranishëm dhe vëzhgues¹⁰, vetëm në namaz e pranojnë se ndodhen në audiencën hyjnore¹¹. Mirëpo ata që janë lartësuar në një gradë shpirtërore të caktuar, jetojnë me vetëdijen se ndodhen në çdo çast në audiencën hyjnore. Tani ejani dhe vlerësojeni ju se ka apo s'ka tek këta njerëz vullnet të pjesshëm!" Meqë padishahut i pëlqeu përgjigjja, i bëri dhurata Sheh Muhammed Nurul Arabiut.

Thelbi i fjalës:

Robi zotëron një vullnet. Ky vullnet ose kjo fuqi i është dhuruar atij nga Zoti. Ndërkaq, ndërsa vullneti i Allahut të Lartë është i pranishëm në çdo eveniment, miratimi dhe pëlqimi i tij janë vetëm në mbarësi dhe dobi. Synimi i mësuesit është që nxënësi i tij të pajiset me njohuri dhe të kalojë klasën. Po qe se nxënësi nuk përpiqet e nuk mëson, mësuesi s'ka ç' të bëjë. Gjithashtu, detyra e mjekut është ta shërojë të sëmurin. Por po qe se i sëmuri nuk e zbaton recetën e dhënë, bëhet vetë përgjegjës për rezultatin negativ që zhvillohet pas kësaj. Mjekut nuk mund t'i vihet asnjë faj.

Nga ana tjetër, dorëzimi i vullnetit tonë personit në audiencën e të cilit ndodhemi, bëhet pretekst për përfitim e një rezultati më të madh se gjëja e dorëzuar. Me fjalë të tjera, po qe se robi ia dorëzon, brenda kriterëve të principialitetit dhe sinqeritetit¹², shikimin e vet vështrimit të pafund të Zotit, duart, dorës së fuqisë së Tij, gjuhën, atributit të amshuar "fjalë" të Tij dhe veshët, dëgjimit transcendental të Tij, si rezultat, shikimi, dëgjimi, përcëptimi dhe aftësia njohëse e robit bëhen krejt tjetër. Ai kurrë nuk mbetet i privuar nga gjërat që ka dhënë, përkundrazi, çdo gjë që ka dorëzuar i kthehet, nga pafundësia, me shumë e shumë dhunti të pafundme! Eshhtë për këtë arsye që, për robtë e mirë (salih) të cilët munden t'i dorëzohen vullnetit të lartë me vetëdijen se ndodhen vazhdimisht në audiencën hyjnore, Zoti thotë kështu në hadithin e shenjtë¹³:

"... dhe bëhem syri i tyre që sheh, veshi që u dëgjon, dora që u prek..." (Buhari, *Rikak*, 38)



10 Në origjinal: hâzır ve nâzır (turq.).

11 Në origjinal: huzur-i ilahî.

12 Në origjinal: ihlas.

13 Hadith kudsî me idenë të frymëzuar Profetit dhe të shprehur me fjalët e tij njerëzore.





EDUKATA DHE ETIKA

Davud Tai tregon kështu:

“Njëzet vjet u ndodha bashkë me Hz. Ebu Hanifenë. Gjatë kësaj kohe vura re me vëmendje dhe kurrë nuk pashë që të rrinte kokëzbuluar ose të zgjaste këmbët me qëllim çlodhjeje as kur kishte njeri tjetër pranë, as kur ishte vetëm. E pyeta:

“Ç’ të keqe ka t’i zgjasësh këmbët kur je vetëm?”

Më tha:

“Eshtë më e virtytshme të rrish me edukatë para Zotit!”

Thelbi i fjalës:

Ata që ndodhen para mbretit ose para një personi të një pozite të lartë, nuk mund të sillen siç sillen jashtë, por bëjnë përpjekje për të shfaqur qëndrime dhe sjellje në përshtatje me vendin dhe pozitën ku ndodhen. Me fjalë të tjera, të ndodhesh para dikujt do të thotë të sillësh me edukatën dhe etikën e duhur. Edhe njerëzit e afërt të Zotit (ehlullah), ngaqë jetojnë me vetëdijen se ndodhen çdo çast para Allahut, kurrë nuk e lënë pas dore edukatën dhe etikën e qëndrimeve dhe sjelljeve. Prandaj, kjo gjendje qëndrimi dhe sjelljeje e edukuar dhe etike përfshin gjithë jetën e tyre. Ata janë njerëz të kulturuar me zemra të vetëdijshme të cilët e shohin pa pengesë, drejtpërdrejt, në çdo kohë e në çdo vend dhe e ndjejnë pa ndërmjetësim material se ndodhen në prani të të dashurit të tyre! Ata e jetojnë çdo çast të tyre me vetëdijen e ndodhjes bashkë me Allahun, si konfidentë të së fshehtës:

وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ

“Kudo që të ndodheni, Ai (Allahu) është bashkë me ju!” (el-Hadid, 4)

Duam të themi se disa vetëm në namaz e ndjejnë se ndodhen para Allahut dhe kjo ndjenjë i shtyn ata në një qëndrim dhe sjellje të edukuar dhe etike të paktën në masën që kërkojnë elementët përbërës të namazit. Kurse njerëzit e afërt të Allahut, ngaqë e përjetojnë këtë ndjenjë çdo çast, edhe jashtë namazit kanë qëndrime dhe sjellje si në namaz. Kështu, si për t’i lartësuar të tillët, është urdhëruar:

الَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ دَائِمُونَ

“(Ata që falin namaz) të cilët kanë vazhdimshmëri në namaz.” (el-Mearixh, 23)

Domethënë, jo vetëm që s’e lënë namazin, por vazhdimisht ndodhen si në namaz.





ETIKA NE SHERBIM

Ebu Abdullah Rugandi thotë:

“Kurrsesi mos e shih të vogël e të parëndësishëm një shërbim që të jepet për ta kryer! Sepse shërbimi është shërbim dhe një shërbim që të duket ty i parëndësishëm, mund të jetë, për shkaqe të ndryshme, shumë i rëndësishëm para Allahut. Është e panjohur për ne se në ç’shërbim ndodhet miratimi dhe pëlqimi i Allahut! Prandaj vazhdo të kryesh çdo lloj shërbimi gjersa të arrish qëllimin e Allahut, domethënë, pëlqimin e Tij! Në këtë mes, mirësitë, dhuntitë dhe meritat që të jepen, vetëm le të ta shtojnë falenderimin dhe shërbimin!”

Thelbi i fjalës:

E rëndësishme është jo vetëm ta kryesh një shërbim, por, në të njëjtën kohë, ta kryesh me principialitet dhe sinqeritet si dhe në mënyrën më të bukur. Prandaj, edhe synimet e atyre që kërkojnë të kryejnë shërbime, duhet të jenë jo për të bërë shërbime, por për t’u sjellë në atë mënyrë që të fitojnë pëlqimin e Allahut. Ndryshe, të kryesh shërbime që do të të siguronin konsideratën e tjetërkujt, domethënë, të personave që do të të sillnin post, pozitë dhe përfitime materiale, dhe t’u kthesh shpinën shumë e shumë shërbimeve të tjera jashtë këtyre, do të thotë falimentim i përjetshëm! Në dukje, njerëz të tillë formojnë konsideratë për njëri-tjetrin, por vështrimi i mëshirshëm i Zotit mbi ta ngrihet dhe pastaj shfaqet ndëshkimi hyjnor. Sepse specifika që ka rëndësi në shërbim është jo përfitimi në këtë botë i rezultateve të shkëlqyera në sy të qenieve të vdekshme, por kryerja e akteve dhe shërbimeve që do ta bënin personin mbret shpirtëror në botën e përtejme!

Duke u nisur nga kjo, çdo udhëtar i udhës mistike duhet ta vlerësojë çdo shërbim si shpërblim për veten e tij. Mundet që në një shërbim që çdokush e sheh si të vogël e të parëndësishëm, të jenë fshehur shpërblime dhe suksese të mëdha hyjnore që s’i nxënë qiejt e toka! Sepse ndonjëherë, me qëllim për të provuar principialitetin dhe sinqeritetin tonë, Zoti i fsheh detrat që ia kërkojmë, brenda një pike uji, dhe i mat zemrat se nga drejtohen!



SIDOMOS EDUKATE DHE ETIKE

Ibni Ata (k.s.) thotë kështu:

“Ata që përparojnë në këtë rrugë shpirtërore, nuk kanë arritur në këtë lartësi vetëm me adhurime të tilla të detyrueshme (farz) si namazi dhe





agjërimi. Përkundrazi, përveç kryerjes së këtyre adhurimeve pa të meta, janë lartësuar me akte, qëndrime e sjellje të çmuara e të virtytshme. Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

“Më i afërti ndaj meje në ditën e kiametit do të jetë ai më i miri në shprehje dhe moral!” (Tirmidhi, *Birr*, 71)

Thelbi i fjalës:

Sa bukur që e shpreh poeti:

Edukata na qenka kurorë nga drita e Zotit;

Vëre atë kurorë, shpëto nga çdo belá!

Edhe një poet i kulturës shpirtërore thotë kështu:

Mes njerëzve të zemrës kërkova e kërkova;

Çdo shprehje e mirë qenkësh, sidomos edukata!

Heronjtë e vërtetë të edukatës, etikës dhe moralit janë profetët dhe të urtët. Gjithashtu edhe ata që dinë si t’i ndjekin këto personalitete, të cilët tregojnë dëshirë volitive për të zotëruar një moral të lartë. Esenca e moralit s’është gjë tjetër veç pjekurisë fetare. Morali është shpëtimi i njeriut nga vetitë shtazore dhe stolisja me tiparet njerëzore. Në të vërtetë, të jesh musliman do të thotë të zotërosh moralin islam, është të mund t’i bartësh bukuritë e larta në qëndrimet dhe sjelljet e tua!

Shkurt, po qe se vështrohet me syrin e mendjes dhe urtësisë, shihet se tema që zë vendin më të madh e më esencial në Kur’an, është tema e edukatës dhe moralit. Edhe rrëfenjat historike që përmbahen në të, madje, kanë për synim sugjerimin e moralit, domethënë, të përsosmërisë së qëndrimeve e sjelljeve!

Poeti Mevlana thotë:

“Zemra ma pyeti mendjen: “Ç’është besimi?” Dhe mendja m’i pëshpëriti zemrës në vesh: “Besimi është edukatë!”

Prandaj, personat pa edukatë nuk i bëjnë të keqe vetëm vetes. Ata, ndoshta, për shkak të paturpësisë së tyre, i vënë zjarrin gjithë botës!”



MORALI DHE SHERBIMI I NJE MIKU TE ZOTIT

H.z. Ahmet Rifai e përshëndeste me selam çdo person që shihte. Po të dëgjonte se në një fshat apo kasaba dikush ishte sëmurë, i shkonte për vizitë në rastin më të parë. Të verbërit që i haste gjatë udhëtimit për në këto





vizita, i kapte për dore dhe i çonte gjer aty ku donin të shkonin. Po të takohet me ndonjë plak, e ndihmonte në bartjen e ngarkesave që kishte në duar dhe i këshillonte ata që kishte përreth me këtë porosi të Profetit (s.a.s.):

“Kush e respekton dhe e ndihmon një plak, edhe Allahu, kur të plakët, i gjen dikë që ta respektojë dhe ndihmojë!” (Tirmidhi, Birr, 75)

Kur kthehet nga udhëtimet jashtë qyteti, hynte në pyll, priste dru, ia ngarkonte gomarit dhe i sillte në qytet. Atje ua shpërndante drutë të vejava, të varfërve dhe nevojtarëve.

Ai vraponte në ndihmë të të sëmurëve, invalidëve, ua pastronte këmbët, rrinte me ta, bisedonte, ushqimet ua çonte me duart e veta dhe i ushqente. Pastaj kërkonte lutjet e tyre. Kurse myridëve të vet u thoshte:

“Vizita e këtyre të mjerëve nuk është mustehab, por vaxhib!”

Një ditë, pati kaluar pranë disa fëmijëve që po luanin. Disa prej tyre, duke u frikësuar nga impresionimi shpirtëror i Ahmed Rifaiut, ikën. I urti vrapoi menjëherë pas tyre, i kapi dhe i përqafoi me një dhembshuri dhe dashuri të madhe! Pasi ua fitoi zemrat në këtë mënyrë, kërkoi falje prej tyre:

“Bijtë e mi! Po e shihni se edhe unë jam një rob i dobët i Zotit! Po t’ju kem frikësuar, të ma bëni hallall!”

Shkurtimisht:

Ruga e njohjes intuitive të Zotit (marifetullah) ku fitohet pëlqimi i Zotit dhe bashkimi me Të, i ngjan një flete krejt të bardhë. Por edhe të gjitha gjërat që shkruhen aty janë krejt të bardha dhe ato i këndon vetëm Zoti i lartë. Prandaj, njerëzit e Allahut (ehlullah), gjatë gjithë jetës përpiqen që mbi atë fletë të mos pikojë asnjë njollë e zezë, pra, tregohen aq të vëmendshëm sa të mos i bëjnë keq asnjë milingone dhe, për të merituar pëlqimin hyjnor, ia ofrojnë moralin dhe shërbimet Zotit vazhdimisht në gjendje të pastër. Sepse Zoti urdhëron:

إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ

“... Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen dhe janë të pastër!” (el-Bakara, 222)



TA DINE JO TE VDEKSHMIT, POR I PAVDEKSHMI!

Në vitet e para të historisë së Islamit, në dyert e disa të varfërve të Medinës, një person i panjohur linnte çdo mëngjes nga një thes me ush-





qime. Por një mëngjes, kur të varfërit që u lihej thesi me ushqim u zgjuan, panë se në dyert e tyre s'kishte më ushqime. Duke menduar me kureshtje për shkakun, u dëgjua një zë prekës salaje dhe Medina e Ndritshme u trazua nga vdekja e Zejnel Abidinit, nipit të Hz. Aliut (r.anh).

Detyrat e fundit ndaj këtij biri profetik nisën të bëheshin me kujdes. Kur radha erdhi për larjen e kufomës së bekuar, personi që do ta bënte këtë detyrë të nderuar, u habit kur pa në shpinë të të vdekurit plagë të mëdha që kishin mbledhur ujë. Ai s'e kuptoi shkakun. Kurse kur i pyeti të afërmit, një person i shtëpisë profetike që ndodhej aty dhe e njihnte këtë të fshehtë, tregoi këto:

"Hz. Zejnel Abidin, çdo mëngjes bartte në shpinë thasët me ushqime të përgatitur më parë, i linte në dyert e të varfërve dhe kthehej pa e parë askush. Kështu, njerëzit nuk e dinin se kush i linte këta thasë. Plagët që patë në shpinë të tij janë plagë të formuara nga bartja e thasëve!"

Ideja:

Ata që i kryejnë aktet vetëm për pëlqim të Zotit të Lartë, përpiqen t'i fshehin ato nga njerëzit si të ishin një e fshehtë e ndaluar për t'u zbuluar dhe përhapur. Në aktet e paraqitura popullit megjithëse i përkasin Zotit, nuk mbetet asnjë vlerë që të mund t'i dërgohet Zotit, sepse ato i veshin një mijë e një egoizma duke filluar me çudinë dhe krenarinë. Prandaj, në qoftë se çdo akt i mirë (salih) i bërë në rrugën e Zotit bëhet me mendimin "për ta parë jo të vdekshmit, por Ai që është i përjetshëm", është i pranueshëm dhe shpërblimin e akteve të tilla nuk mjaftojnë kalema e nuk arrin bojë për ta shkruar!

Ç'lumturi për ata heronj pa emër por të vërtetë të cilët, duke bërë përpjekje për t'i kënaqur robtë e Allahut me shërbime të sinqerta e vetmohuese, ndjekin jo dëshirën e egos së tyre, por pëlqimin e Zotit!



MOS PERBUZ ASKEND!

Rrëfëhet se:

Një ditë, Isai (a.s.), bashkë me një person nga të bijtë e Izraelit i cili pandehej si njeri i mirë (salih), doli jashtë qytetit. Ndërkaq, një burrë i njohur mes njerëzve si mëkatari u ishte ngjitur pas me një përulësi të madhe. Kur bënë pushim për t'u çlodhur, mëkatari, i kredhur në një ndjenjë turpi dhe pendimi të sinqertë, u ul zemërthyer diku veç tyre dhe, duke u mbështetur në faljen e lartë të Allahut, mëshiruesit të mëshiruesve, u lut kështu:

"Zoti im! Për hir të këtij profeti të lartë, falmë mua!"





Kurse personi i pandehur si njeri i mirë, kur e vuri re njeriun e njohur për mëkatat të lutej, e nënvleftësoi, e përbuzi dhe, duke ngritur duart drejt qiellit, iu përgjërua Zotit në këtë mënyrë:

“Allahu im! Nesër, në ditën e kiametit, mos më grumbullo bashkë me këtë njeri!”

Pas kësaj, Zoti i komunikoi kështu Isait (a.s.):

“O Isa, thuaju robve të mi se ua pranova lutjet të dyve! Robin tim mëkatat me qafë përkulur e fala dhe e caktova me ata të xhennetit. Kurse personin që njerëzit e pandehin për të mirë, nuk e caktova me ata të xhennetit meqë nuk deshi të qëndronte bashkë me robin tim që e fala!”

Ideja:

Me përjashtim të atyre mbi të cilët ka rënë mallkimi dhe ndëshkimi i Allahut, përbuzja e robve të Allahut pavarësisht nga shkaku, është një krim i zemrës. Kurse ata që e kryejnë këtë krim, janë zemra të ngurtësuar e të papjesë, që ndodhen larg afërsisë dhe dashurisë hyjnore! Në fakt, dikush, duke e nënvleftësuar dhe përbuzur tjetrin, ka përbuzur dhe shkatërruar veten! Me të vërtetë, Profeti (s.a.s.) porositi:

بِحَسْبِ امْرِئٍ مِنَ الشَّرِّ أَنْ يَحْقِرَ أَخَاهُ الْمُسْلِمَ

“Atij që e sheh vëllain e fesë me nënvleftësim dhe përbuzje, kjo gjë i mjafton si mëkat!” (Muslim, Birr, 32)

Sa bukur e thotë poeti:

*Njerëzit e hallakatur mos i përbuz o zahid;
Ka rrënoja që fshehin thesare nën vete!*



MOS FYEJ ASKEND

Hamdun Kassar (k.s.) thotë:

“Kur të shohësh ndonjë të dehur që ecën bjer e ngrihu, ki kujdes, në asnjë mënyrë mos e dëno atë se, ka mundësi që edhe ti të kapesh nga një bela e tillë!”

Thelbi i fjalës:

Në botëkuptimin mistik, në orientim ka mëshirë dhe dhembshuri, jo fyerje, përbuzje dhe nëpërkëmbje të tjetrit. Sepse Zoti deklaroi se robi i Tij është një enigmë e fuqisë së Tij. Për këtë shkak, në mënyrën e vështrimit të





mëkatarit esenciale është ideja e shpëtimit nga humbja të një margaritari të rënë në baltë! Kurse përbuzja është që margaritarin e humbur ta humbësh për së dyti. Prandaj, Zoti, me qëllim që robtë e tij të mos bien në këtë gabim, shprehet në ajetin kur'anor si më poshtë dhe, duke e bërë matjen e mëkateve të robve një çështje të posaçme për vete, i ka ndaluar njerëzit të futen në këtë çështje:

“O besimtarë! Një grup njerëzish të mos tallen me një grup tjetër, sepse mundet që të tjerët të jenë më të dobishëm se ata vetë! Edhe disa gra të mos tallen me disa gra të tjera sepse mundet që të tjerat të jenë më të dobishme se ato vetë!..” (el-Huxhurat, 11)

Nga ana tjetër, shpesh herë është vënë re se edhe ata që shajnë dhe përbuzin të tjerët, kanë rënë në të njëjtin mëkat dhe në të njëjtën gropë dhe kjo gjendje është bërë proverbiale me shprehjen:

“Mos qesh me komshiun se të bie edhe ty në kokë!”



GEZOJE JETIMIN!

Seri Sakatiu tregon kështu:

“Një ditë bajrami, pashë Maruf Kerhiun duke mbledhur bërthama hurmash nëpër sokakë. E pyeta se ç’do të bënte me ato bërthama. Ai më tha:

“Këtu pashë një fëmijë të vogël që po qante. Kur i shkova pranë dhe e pyeta pse po qante, më tha se s’kishte rroba si rrobat e shokëve dhe lodra si lodrat e shokëve. Dhe nisi prapë të qante. Ma copëtoi zemrën! Prandaj po mbledh bërthama hurmash që t’i shes dhe t’i blej atij fëmije rrobat dhe lodrat që do!..”

Këto fjalë ma copëtuan edhe zemrën time, prandaj e luta prijësin:

“Po të më lejosh, do të merrem unë me atë fëmijë, mund të rrih i qetë!”

Pastaj e mora me vete fëmijën dhe ia plotësova nevojat.”

Gjendjen shpirtërore që iu krijua me begatinë e këtij akti të mirë (ameli salih), Seri Sakatiu e shpreh kështu:

“Me begatinë e këtij shërbimi m’u shfaq në zemër një dritë e tillë që me të meritova gjendje krejt të tjera dhe shijova sa e sa kënaqësi shpirtërore!”

Ideja:

Kujdesi për jetimët dhe gëzimi i tyre është një punë e mirë (ameli salih) e madhe që nxitet shumë fetarisht dhe që ka shpërblim të madh. Premtimi në këtë specifikë i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) ka një përmbajtje që i deh





zemrat e dashuruara me dashurinë hyjnore:

“Me personin i cili e mbron jetimin e vet ose një jetim të dikujt tjetër, unë do të jem kështu pranë e pranë!”

Rrëfyesi i këtij hadithi, Malik bin Enes, i zgjati të bashkuar gishtin tregues me gishtin e mesit siç kishte bërë edhe Profeti (s.a.s.)! (Muslim, *Zuhd*, 42)

Kurse në një hadith tjetër thuhet kështu:

“Po qe se dikush, vetëm për pëlqim të Allahut, ia fërkon kokën një jetimi, do t’i jepet një sevab për çdo fije floku që ia prek dora!” (Ahmed b. Hanbel, *Musned*, V, 250)

Me fërkimin e kokës për të cilin bëhet fjalë në hadithin profetik, është fjala për interesimin për çdo çështje materiale e shpirtërore të tij.



MIQESIA

Sehl bin Ibrahim tregon kështu:

“Me Ibrahim bin Et’hemin ishim miq. Një radhë më kishte zënë një sëmundje e rëndë. Atëherë Ibrahim bin Et’hemi e shpenzoi çdo gjë që kishte në dorë për shëndetin tim. Pastaj fillova të shërohesha. Në këtë mes i kërkova ca gjëra që m’i donte zemra. Meqë s’i kishte mbetur më gjë në dorë, kishte shitur gomarin dhe ma plotësoi dëshirën. Pasi u shërova, m’u desh gomari për të shkuar diku dhe e pyeta:

“O Ibrahim, ku është gomari?”

“E shita!” – më tha Ibrahim bin Et’hemi.

Meqë shëndeti nuk ma lejonte të ecja në këmbë, i thashë:

“Mirë, po tani me se do të udhëtoj?”

Ai mbreti i të urtëve m’u përgjigj:

“Do të të mbaj në shpinë, o vëlla!”

Dhe më mbajti në shpinë tre konaqe rrugë!

Ideja:

Në ditë të mira e të bukura, plot dhurata e gostira, çdokush të bëhet mik! Por miqësia e vërtetë shfaqet në ditë të vështira, dhe atëherë, vlera e saj nuk matet me asgjë! Prandaj, e fshehta e shenjtërisë në këto ditë plot të këqija të kësaj bote është të bëhesh mik i Allahut, i të Dërguarit të Tij dhe i besimtarëve të mirë (salih), si dhe të mbetesh mik i tyre!

Nga ana tjetër, vetmohimi dhe sakrifica e bërë sidomos për vëllain besimtar që ndodhet në vështirësi e nevojë, tërheq mëshirën e Zotit. Sepse Zoti është pafundësisht mëshirues dhe shpërblyes për robtë e Tij dhe pro-





fetin Muhammed (s.a.s.) e ka dërguar si mëshirë bër botët. Në hadithin profetik thuhet:

"Allahu mëshirues tregon mëshirë për njerëzit e mëshirshëm e të dhembshur!"

(Ebu Davud, *Edeb*, 58)



SYNIMI I MIQESISE

Abdullah bin Mubarek kishte bërë udhëtim me një person me vese të këqija. Pasi udhëtimi mbaroi dhe ata u ndanë, Abdullah bin Mubarek nisi të qajë nga zemra. Miqtë që u çuditën me këtë, e pyetën:

"Pse po qan? Ç'është ajo gjë që po të dëshpëron kaq shumë?"

Ai mik i Zotit me vlerë të madhe hoqi një herë me ngashërim, pastaj, me sytë e njomur tha:

"Me gjithë atë udhëtim të gjatë, nuk ia ndreqa dot shokut të udhës shprehite dhe veset e këqija! Nuk e zbukurova dot moralin e atij të pashpres! Dhe mendoj: Mos vallë nga të metat e mia nuk u bëra dot i dobishëm për të? Po qe se ai nuk u orientua dot nga ndonjë gabim i im, ç'do të bëhet halli im nesër? "

Dhe u mbyt në lot!

Ideja:

Miqësitë duhet të ngrihen vazhdimisht mbi një synim të dobishëm shpirtëror. Sipas kësaj, afërsia dhe miqësia me njerëzit e mirë (salih) duhet të ngrihet me synimin për të përfituar prej tyre, kurse afërsia dhe miqësia me persona të dobët shpirtërisht, madje me të meta, për t'u bërë i dobishëm për ta. Sepse miqësitë larg dobisë shpirtërore dhe të mbuluara thjesht me indiferentizëm, do të thotë një dëm që ka për të t'i shkatërruar të dy botët. Dhe më i lehti i këtij dëmi është përjetimi i një rezultati që përshkruhet në proverbën:

"Më thuaj me kë rri, të të them cili je!"

Nga ana tjetër, stili që duhet të ndiqet duke i orientuar personat me të meta, nuk duhet të jetë poshtërim i tyre përballë një rezultati negativ, por vetëkritikë e orientuesit me mendimin se mos ka të meta te ai vetë. Sepse po qe se orientuesi nuk e ka futur dot në rrugë të drejtë bashkëbiseduesin për shkak të gabimeve dhe të metave të veta, llogaria dhe përgjegjësia e kësaj bëhet shumë e rëndë. Synimi nuk është të bëhesh perde, por t'i hapësh perdet për ta treguar të vërtetën!





NENSHTRIM I PLOTE

Siç bëhet e ditur nëpër rivajete, kur Zoti e dërgoi profetin Musa (a.s.) te faraoni, e urdhëroi:

“Shko te faraoni se ai e teproi shumë...!” (Taha, 24)

Meqë Musai (a.s.) nuk kishte se kujt t’ia linte amanet për formë pjesëtarët e familjes dhe tufën, tha:

“O Zot! Ç’do të më bëhen njerëzit e shtëpisë dhe bagëtitë?”

Atëherë, Zoti, duke ia kujtuar se ishte **“më i dobishmi i ruajtësve”**, iu përgjigj kështu:

“O Musa! Pasi më gjete mua, ç’kërkon tjetër? Ti vrapo të kryesh urdhrin tim! Lidhu pas meje dhe trego nënshtrim! Po të dua, e bëj ujkun çoban të dhenve dhe engjëjt, roje të familjes tënde!

O Musa! Ç’është kjo që po e vret mendjen? Kur jot ëmë të hodhi në det, kush të shpëtoi? Pastaj kush të çoi përsëri te nëna jote? Pate vrarë njërin pa dashje dhe faraoni ishte vënë në ndjekje tënde dhe kishte vënë një-rëz për të të vrarë. Kush të mbrojti ty atëherë?”

Musai (a.s.) edhe dëgjonte, edhe në fund të çdo fjalie thoshte:

“Ti, Ti, Ti, o Zot!”

Ideja:

Sigurisht që Musai (a.s.), si të gjithë profetët, ishte në kulmin e nënshtrimit. Por meqë profetët janë personalitete shembullorë dhe modele për njerëzit, Zoti bën të shfaqen mbi ta disa specifika të rëndësishme për ne dhe, duke treguar se si duhet të sillemi në këto situata, na i orienton zemrat. Edhe ajo që kërkohet të tregohet në këtë rrëfenjë, është sqarimi se përballë urdhrave të Allahut të Lartë që është Zoti i botëve, asnjë justifikim njerëzor s’mund të ketë vlerë. Sepse Ai është e vetmja fuqi që mund të plotësojë çdo lloj ndihme, mirësie dhe mbrojtjeje për të cilat mund të kenë nevojë ata që tregojnë vendosmëri për të çuar në vend urdhrin e Tij! Po qe se robi, me principialitet dhe sinqeritet, tregon zell për t’i kryer urdhrat e Zotit në përputhje me pëlqimin e Tij, vë re se Ai është, në çdo situatë, dashamirës dhe ndihmëtar i tij. Kështu, ai Mbrojtësi Absolut e rriti Musain (a.s.) në pallatin e faraonit, Ibrahimin (a.s.) e futi mes trëndafilave në mes zjarreve të Nemrudit, shokët e shpellës, ata djem të mirë, i mbrojti për mbi 300 vjet në gjumë nga e keqja e mizorëve dhe Muhammed Mustafanë (s.a.s.) e mbrojti nga sa e sa rreziqe, veçanërisht e fshehu nga sytë e armiqve në shpellën e Thevrit. Sa bukur e thotë poeti:





*Nga askush nuk pres ndihmë, mbrojtësi të më jetë Hudá;
Unë atë e bëj dorëzanës: "Vallahu hajrun hafizá" ...¹⁴*

Rahmetí



TE MARRESH LUTJEN E BESIMTARIT

Ishte një ditë kur Maruf Kerhi ndodhej i agjëruar. Afër kohës së iqindisë, vuri re se një saká, ujëshitës, duke kaluar nëpër pazar, lutej:

"Allahu e trajtoftë me mëshirën dhe begatinë e Tij atë që pi nga ky ujë!"

Dhe menjëherë iu afrua dhe e prishi agjërimin duke pirë nga uji i tij. Ata që ndodheshin përreth, i thanë:

"Imzot, pse e prishe agjërimin?"

Maruf Kehri u tha:

"Desha të meritoj begatinë e lutjes së ujëshitësit!"

Pas vdekjes, e panë Maruf Kerhiun në ëndërr dhe e pyetën:

"Si të trajtoi Allahu?"

Dhe morën këtë përgjigje:

"Me lutjen e pastër të sakait, ujëshitësit, Zoti më fali. Ai më trajtoi me mëshirë!"

Ideja:

Sa e sa njerëz të vetmuar me zemrën bashkë me Allahun ka që, disa herë, lutjet e tyre kanë më efekt se adhurimi nafile. Por duhet thënë se agjërimet nafile të prishura nga një vlerë më me rëndësi, duhet të bëhen kaza (të përsëriten) më pas. Sepse tashmë ato kanë vlerën vaxhib. Specifika që kërkohet të tregohet këtu, është se më e rëndësishmja duhet parapëlqyer ndaj të rëndësishmes. Sepse vjen çasti që në shumë gjëra që duken të vogla, mund të gjenden dobi të mëdha! Nga ana tjetër, ashtu siç mund të ndodhë që nën rrënoja të jenë fshehur thesare, edhe mes robve ka nga ata që duken si gërmadha por në përmbajtje janë margaritarë, ndaj të cilëve nuk duhet ndenjur indiferent.

Sa bukur që shprehet poeti:

*Këdo që sheh, dije Hizr; çdo natë dije natë Kadri;
Fytyrën ktheje e shiko: tetë xhennetet e Tij të janë gati!*

Rahmetí

14 Hudá: Zoti. Vallahu hajrun hafiza: Allahu është mbrojtësi i të mirës!





Profeti (s.a.s.) ka thënë:

“A t’ju tregoj kush janë të xhennetit? Meqë edhe janë të dobët, edhe shihen si të dobët nga populli, janë njerëz që askush s’u vë rëndësi, por, po të betohen se “kështu ka për t’u bërë”, janë njerëz që Allahu ua plotëson kërkesat!

A t’ju tregoj se kush janë të xhehennemit? Ata janë njerëz zemërgurë, të trashë, koprracë dhe mendjemëdhenj që ecin duke u krekosur!” (Buhari, Ejman, 9; Muslim, Xhennet, 47)



NJE I HUMBUR NGA MENDJA DHE ILAÇI I ZEMRES

Bejazid Bistamiu e pyeti një mjek të cilin e gjeti duke përgatitur ilaçe:
“O mjek, a ka ilaç për sëmundjen time?”

Mjeku e pyeti:

“Ç’është sëmundja jote?”

Bejazid Bistamiu iu përgjigj:

“Sëmundja e mëkatit!..”

Duke i ngritur duart lart në shenjë pamundësie, mjeku i tha:

“Unë ilaçin e sëmundjes së mëkatit nuk e njoh!”

Në atë mes, në fjalë u përzje një i ri mendjehumbur që ndodhej aty. Ai i tha Bejazid Bistamiut:

“Or babë, ilaçin e sëmundjes tënde e di unë!”

“Po ma thuaj, o djalë!” – I tha me gëzim Bejazid Bistamiu.

I riu që populli e njihje si “mendjehumbur” por që, në të vërtetë, ishte një “arif”, njeri i shtënë aq thellë pas kulturës shpirtërore sa që dukej sikur e kishte humbur mendjen, e përshkroi kështu ilaçin e mëkatit:

“Merr dhjetë dërrhem rrënjë pendimi dhe dhjetë dërrhem gjethe pendese dhe futi në havanin e zemrës. Pastaj rrihi aty me tokmakun e tevhidit dhe kaloji nëpër sitën e maturisë. Pastaj gatoji me lotët e syve dhe piqi në furrën e ashkut! Nga melhemi që do të dalë, kështu, merr çdo ditë nga pesë lugë dhe s’ka për të të mbetur shenjë nga sëmundja!..”

Bejazid Bistamiu që e kishte ndjekur me vëmendje përshkrimin e djalit, hoqi në shpirt dhe i tha:

“Më ju lumtë atyre që duke e pandehur veten për të mençur, u thonë “mendjehumbur” arifëve si ti!..”

Ideja:

Kur për robin vlen më shumë vështrimi i Zotit sesa i njerëzve, për të hapen rrugët e përkryerjes dhe diturisë së thellë shpirtërore (irfan).





Atëherë, shikimi, dëgjimi dhe ndijimi i tij paraqet një të fshehtë dhe thellësi krejt tjetër. Ndonjë nga robtë e tillë bëhet Veysel Karani dhe njerëzit, duke mos ditur gjë dhe në indiferencë të plotë, i thonë “mendjehumbur”. Kurse ai, në të vërtetë, është bërë i merituar i miqësisë së posaçme të Allahut dhe Profetit!

Nga ana tjetër, kjo rrëfenjë reflekton begatinë që përmbahet në urdhrin hyjnor, **“Bëhuni bashkë me të mirët (salih)!”** (et-Tevbe, 119) Siç u pa tek i riu i cili ishte një “arif”, njohës i dijes dhe kulturës shpirtërore, edhe recetat e dala nga gjokset e të gjithë njerëzve të mirë (salih), duke u dhuruar shërim shumë e shumë sëmundjeve shpirtërore, i lidhin zemrat në mënyrë të pastër dhe të shëndoshë pas Zotit. Fakti që këtu, Bejazid Bistamiu i cili, megjithëse kishte një zemër të gjallë e të pastër, kërkon ilaç zemre, është jo vetëm shfaqje e thjeshtësisë tek ai, por edhe qëllim për ta mjekuar zemrën e mjekut me të cilin hyri në bisedë!



FYTYRA ENGJELLORE

Po ktheheshim nga Bursa në Stamboll së bashku me të ndjerin Sami Efendi dhe të ndjerin tim atë, Musa Efendi (k.s.), që ndodhej në shoqërim të tij. Në Jallovë u afruam të futeshim në radhë me makinën tonë për të hipur në traget. Nëpunësi që po merrej me futjen e rregullt në radhë të automjeteve pa i dhënë mundësi ndonjë çrregullimi, kur po na tregonte vend për makinën tonë, iu kapën sytë pas Sami Efendiut dhe Musa Efendiut që rrinin në sediljet e pasme. Nëpunësi qëndroi i shtangur. Pastaj u afrua dhe pa më me vëmendje brenda nga xhami i makinës. Mori frymë thellë dhe tha:

“Allah, Allah, ç’botë e çuditshme! Ka fytyra si engjëj, ka fytyra si Nemrudi!..”

Përfundimisht:

Kjo ngjarje tregon se shenja e miqësisë me Allahun është ndriçimi nga Ai i zemrave dhe fytyrave me dritë hyjnore. Shkurt, njerëzit e afërt të Allahut, të urtët e quajtur në gjuhën e tasavvufit, mistikës islame, evlijaulah, janë portrete përjashtuese që të kujtojnë Allahun. Sepse rruga e tyre është rruga e Allahut. Ata mbështeten mbi moralin e Muhammed Mustafait (s.a.s.), prijësit të lartë të karvanit të së vërtetës. Me të vërtetë, veç të tjerash, fytyra dhe pamja e tij, pa pasur nevojë për fjalë, tregonin se ai ishte një ftues i Allahut! Kur një nga dijetarët më të shquar të hebrenjve, Abdullah bin Selami, e pati parë atë, pati thënë:





“Kjo fytyrë nuk mund të jetë fytyrë gënjeshtari!” (Tirmidhi, *Kijame*, 42; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, V, 451)

Dhe vetëm për këtë shkak besoi, deklaroi besimin në Islam!

Prandaj, çdo njeri, në çdo vend, në çdo mjedis që të shkojë apo ku të lëvizë dhe veprojë, vazhdimisht dhe pa fjalë, thotë disa gjëra pozitive ose negative, lë një mijë e një mbresa dhe, në mënyrë të vëmendshme apo jo, bëhet objekt i vështrimeve të panumërta. Kushedi se sa njerëz që nuk i njeh apo s’ka për t’i njohur, duke vështruar se si ulet e ngrihet, si rri e si lëviz, si flet, si vështron e si sillet ai, domethënë gjendjen e tij, e pëlqen dhe, duke e gjetur të përshtatshëm për natyrën e vet, e merr si model!

Duhet ditur se gjithësia është burim i kënaqësisë hyjnore. Kjo e panjohur e bukur që i thonë njeri, është shfaqje mrekullore e kënaqësisë hyjnore. Njerëzit e mirë (salih) dhe të përkryer (kamil) në përmbajtjen e kënaqësisë hyjnore janë njerëzit e pavdekshëm sepse ata, si rezultat i faktit që kanë bërë një jetë model për njerëzimin, vazhdojnë të jetojnë edhe pasi u vdes kurmi!



GJENDJA E ZEMRES NE MIREBERESI

Musa Efendiu (k.s.) tregon:

“Po udhëtonim bashkë me Sami Efendiun. Në Yrgyp, një person na e ndaloi makinën dhe i kërkoi para për cigare. Pavarësisht nga kundërshtimi i pazë i disa shokëve, Sami Efendiu tha:

“Meqë kërkon, i duhet dhënë!”

Dhe i dha.

I varfëri që kish mbetur i kënaqur nga ky qëndrim, e ndërroi qëllimin dhe tha:

“Tani do të shkoj e, me këto para, do të marr bukë!”

Dhe u largua me gëzim!”

Ideja:

Veprimet dhe sjelljet e bëra vetëm për hir dhe pëlqim të Allahut, ndikojnë mbi zemrën e bashkëbiseduesve dhe ua zbukurojnë moralin. Prandaj në mirësitë që do të bëhen, nuk duhet harruar se është e rëndësishme më shumë jo gjendja e zemrës së bashkëbiseduesit, por e tonës. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë:

Një herë, një njeri tha:

“Unë patjetër do të jap një sadaka!”





Natën doli nga shtëpia me gjënë që do ta jepte si sadaka, dhe, pa e ditur, ia la në dorë një hajduti. Të nesërmen, njerëzit filluan të përfllisnin:

“Çudi! Mbrëmë i kanë dhënë sadaka një hajduti!”

Kur i dëgjoi këto fjalë, njeriu tha:

“Allahu im! Lëvduar qofsh ti! Unë patjetër kam për të dhënë edhe një sadaka tjetër!”

Prapë, pasi u err mirë, mori gjënë që kishte për ta dhënë si sadaka dhe doli jashtë. Përsëri, pa e ditur, ia la në dorë një kurve!

Të nesërmen njerëzit filluan thashethemet:

“Gjë që s’bëhet! Mbrëmë i kanë dhënë sadaka një kurve!”

Kurse njeriu tha:

“Allahu im! Lëvduar qofsh që më dhe mundësi të jap një sadaka, qoftë edhe një kurve! Unë prapë kam për të dhënë sadaka!”

Natën e tretë doli prapë me sadakanë në dorë të cilën, këtë radhë, prapë pa e ditur, ia la në dorë një të pasuri!

Të nesërmen, njerëzit folën më me çudi:

“Ç’punë është kjo? Mbrëmë i paskan dhënë sadaka një të pasuri!”

Kurse njeriu, si dhe herët e tjera, e falenderoi Zotin:

“Lëvduar qofsh ti, Allahu im, që më dhe mundësi të jap sadaka qoftë edhe një të pasuri!”

Pas këtij sinqeriteti, njeriut iu tha kështu në gjumë:

“Sadakaja që i dhe hajdutit, ndoshta do ta bëjë atë të turpërohet e të heqë dorë nga hajdutëria! Kurva ndoshta do të heqë dorë nga ajo që bën, dhe do të bëhet grua e ndershme! Edhe i pasuri, duke marrë mësim nga kjo, do të kujtohet t’u shpërndajë të varfërve nga pasuria që i ka dhënë Allahu!” (Buhari, Zekat, 14; Muslim, Zekat, 78)

Prandaj, ai që jep sadaka, duhet të jetë falenderues ndaj Zotit, sepse efekti i sadakasë shfaqet sipas sinqeritetit të atij që e jep!



AKTI I MIRE QE NGJITET NE ARSHIN E LARTE

Myridi që kryente shërbimet personale të Hz. Davud Tai, i tha një ditë atij:

“Poqa pak mish, a nuk po urdhëroni?

Dhe meqë mësuesi heshti, shkoi dhe e sollti mishin.

Mirëpo Davud Tai (k.s.), duke parë mishin që ia kishin vënë para, e pyeti:

“Ç’lajm ka nga filan jetimë, biri im?”





Duke hequr një ofshamë të heshtur si për të treguar se s'ishin në gjendje të mirë, iu përgjigj:

“Siç e dini, Imzot!”

Kurse ai mik i madh i Zotit i tha:

“Atëherë, këtë mish dërgojua menjëherë atyre!”

Myridi i singhtë i cili dëshironte që ushqimin e përgatitur ta hante mësuesi, këmbënguli:

Por Davud Tai s'e pranoi:

“Biri im! Po ta ha unë këtë mish, del jashtë e bie poshtë, kurse po ta hanë jetimët, ngjitet në Arshin e Lartë!”

Ideja:

Siç është e pamundur për diellin që të mos ngrohë, edhe për shpirtrat e lartë është po aq e pamundur që të mos ndjejnë dhimbje për njerëzit, që të mbeten të pandjeshëm ndaj vuajtjeve dhe mundimeve të tyre. Mëshira është një margaritar hyjnor i përhapur në tërë gjithësinë. Kurse zemra e miqve të Zotit është thesari i pashtershëm i mëshirës. Në vështrimin e tyre, duke lënë mënjanë interesimet e vdekshme të cilat, në vështrimin e tyre, ushqejnë egon, fitimi që do të arrijnë ata që do t'i përjetësojnë aktet dhe punët e tyre me sjellje të bukura që ushqejnë shpirtin, është edhe i përjetshëm, edhe më i bukur. Fitimet më të çmuara që mund të shtjerë në dorë njeriu në këtë botë, janë vetëm këto akte të mira (ameli salih). Kurse fitimet e tjera janë amanete të përkohshme që rikthehen një e nga një. Kështu, në hadithin profetik tregohet:

Familja e Profetit kishte therur një dele. Pasi shpërndanë në shumë vende, Profeti pyeti se ç'kishte mbetur dhe Hz. Aisheja i tha:

“Vetëm një kockë shpatulle mbeti!”

Atëherë, Profeti i tha:

“Pse s'thua, o Aishe, se, përveç një kocke shpatulle, e gjitha u bë e jona!”

(Tirmidhi, Kijame, 33)



TA DALLOSH GJITHMONE TE VERTETEN

Abdylkadir Gejlaniu e tregon kështu një ngjarje që i pati ndodhur:

“Një ditë, para syve m'u shfaq një dritë që e zuri tërë pamjen. Duke parë se ç'ishite ajo, nga drita më erdhi një zë:

“O Abdylkadir, unë jam Zoti yt. Nga punët e mira që ke bërë gjer më sot jam aq i kënaqur, sa pas kësaj haramet t'i bëra hallall ty!”





Por pa mbaruar mirë zëri, unë e kuptova se ishte i shejtanit të mallkuar dhe i thashë:

“Shporru që aty, o i mallkuar! Drita që më tregove s’është gjë tjetër për mua veçse një errësirë e përjetshme!”

Atëherë, shejtani më tha:

“Me urtësinë që të ka falur Zoti, më shpëtove nga dora! Kurse unë kam nxjerrë nga rruga me qindra vetë!”

Dhe u largua!

I ngrita duart drejt selisë së lartë dhe i vetëdijshëm për favorin e Zotit, e falenderova!”

Njëri nga xhemaati që e kishte dëgjuar, e pyeti:

“Ej, Abdylkadir, ku e kuptove se ai ishte shejtani?”

Abdylkadir Gejlaniu (k.s.) iu përgjigj:

“Ngaqë më tha se haramet m’i kishte bërë hallall!”

Ideja:

Në çdo kohë e në çdo vend ka pasur gjithmonë nga ata që janë përpjekur për ta turbulluar fenë e Allahut. Por në periudhat kur kjo veprimtari arrin në kulm, për çdo besimtar, aftësia diferencuese, domethënë, nevoja për ta ndarë të drejtën nga e shtrembra, të drejtën nga e gabuara, të vërtetën nga gënjeshtra, të mirën nga e keqja dhe të bukurën nga e shëmtuara, fiton një rëndësi më të madhe! Sot po përjetohen shfaqje të tjera të rrëfenjës së mësipërme dhe shumë persona me prapamendime, të hequr si njerëz të ditur, po përpiqen t’i bëjnë dëm shoqërisë duke i treguar hallallet e Islamit si haramet dhe haramet si hallalle. Prandaj, sjellja e zgjuar dhe aftësia dalluese e Abdylkadir Gejlaniut paraqet rëndësi të madhe për ne. Në thelb, parimi i Gejlaniut është mjaft i hapur: **Zoti kurrë nuk u jep të tjerëve një të drejtë që nuk ia ka dhënë të dërguarit të vet. A profetët e dinë se ç’janë hallalli dhe harami, e drejta dhe e shtrembra, e bukura dhe e shëmtuara, apo shejtani dhe pasuesit e tij midis njerëzve të cilët hiqen si të ditur?** Fjala e Zotit për njerëz të tillë të paditur dhe indiferentë është shumë e ashpër:

“(O i Dërguar), **thuaje** (atyre): **A mos po kërkonit t’ia mësoni Allahut fenë tuaj** (që jua ka dërguar Ai vetë)?” (el-Huxhurat, 16)



MUA ME DUHET BUJARI

Bejazid Bistami tregon kështu:

“Një ditë do të kaloja nga një breg i lumit Tigër, në bregun tjetër. Kur arrita në breg, të dy brigjet u bashkuan për të më bërë udhë. E mblodha veten menjëherë dhe i thashë lumit:





“Betohem se unë nuk gënjem nga kjo! Sepse varkarët e nxjerrin njeriun matanë për gjysmë akçe. Kurse ti kërkon punët e mira të mira të tridhjetë vjetëve! Por unë kurrë s’mund t’i çoj kot këtu punët e mira që kam përgatitur për ditën e ringjalljes, për gjysmë akçeje! Mua më duhet Bujari, jo mrekullia!”¹⁵

Ideja:

Kerameti i cili, si veprim, i pëlqen egos, vetes, është një çështje mbi të cilën miqtë e vërtetë të Zotit kanë qëndruar me ndjeshmëri të madhe. Çmimi i lënies mënjantë të kerametit është ose të përballosh një lodhje të përkohshme, ose të bësh një shpenzim të vogël, ose të mbetesh i panjohur në sytë e njerëzve. Kurse pranimi i kerametit do të thotë, disa herë, humbje e të gjitha punëve të mira (ameli salih) të kryera, gjë që është falimentim i zemrës i cili e çon njeriun duarbosh në lartësitë hyjnore. Prandaj, të gjithë arifët, prijësit shpirtërorë të pajisur me diturinë dhe kulturën shpirtërore, me përjashtim të rasteve kur i tillë ka qenë vullneti hyjnor, kurrë nuk janë prirur ndaj kerametit që do të thotë fitim i pëlqimit dhe vlerësimit të njerëzve, por gjithmonë janë përpjekur të fitojnë pëlqimin e Zotit, i cili është krijuesi, bujari dhe mrekullibërësi.

Në këtë kontekst, Sehl bin Abdullah et-Tusteriu, njëri prej prijësve të mëdhenj shpirtërorë (evlijaullah), shprehet kështu:

“Kerameti më i madh është t’i ndërrosh veset e këqija me shprehi të mira! Mbi gjithçka, disa keramete janë si lodrat që u jepen fëmijëve që qajnë për t’i marrë me të mirë. Këtë e dëshirojnë jo prijësit shpirtërorë dhe të urtët, por të paditurit dhe indiferentët! Këta, me kerametet marrin veten me të mirë dhe kalojnë kohën duke i bërë edhe shumë të tjerë të gënjenen e të kalojnë kohën me to!”

Prandaj, gjithmonë, çështja më e rëndësishme është zbatimi i urdhrit të Zotit:

“Tregohu sinqerisht ashtu siç je (urdhëruar të jesh)!” (Hud, 112)



PERGJEGJESIA E ATYRE QE PRIJNE

Një ditë, Hz. Ebu Hanife has një fëmijë që po ecte përmes baltës. Duke i buzëqeshur me mëshirë dhe dhembshuri, i tha:

15 Në origjinal kjo fjali është kështu: “Mua më duhet Kerim, jo keramet!” Në këtë fjali, me fjalën Kerim të paraqitur me shkronjë të madhe, nënkuptohet Zoti, për pëlqim të të cilit Bistami i ka bërë punët e mira, kurse fjala keramet përdoret me kuptimin “mrekulli”. Për kuptimin e gjerë të fjalës “keramet” shihni shënimin në rrëfenjën “Kerameti ose aftësia parashikuese”.





“O bir, ki kujdes, të mos rrëzohesh!”

Me sytë që i shndërrisnin nga zgjuarsia, fëmija u kthye nga imami dhe i dha këtë përgjigje që s’pritej prej tij:

“O imam, rrëzimi im është i thjeshtë se, po të rrëzohem, dëmtohem vetëm unë! Në fakt, ju duhet të keni kujdes sepse, po ju rrëshqiti këmba juve, ka për t’u rrëshqitur edhe atyre që vijnë pas jush dhe do të rrëzohen e, pastaj, për t’i ngritur në këmbë të gjithë ata do të jetë shumë e vështirë!”

Imami që mbeti i mahnitur dhe admirues ndaj fjalëve të fëmijës, nisi të qante dhe u tha kështu nxënësve:

“Po qe se në një çështje ju arrin ndonjë provë apo argument më i fuqi-shëm, mos më ndiqni mua më në atë çështje. Ky është në Islam treguesi i përkryerjes. Edhe dashuria dhe besnikëria që keni ndaj meje vetëm në këtë mënyrë del në shesh!..”

Ideja:

Qëndrimi në radhët e para në rrugën e Zotit, është edhe i begatshëm, edhe me përgjegjësi. Sepse, ashtu siç ndodh që bukuritë e atyre që ndodhen në radhët e para ndikojnë mbi mjedisin, mbi ata që u ndodhen pas ose përreth, ashtu ndodh që edhe gabimet dhe shëmtitë e tyre, duke u kup-tuar drejt nga ata që u ndodhen pas ose përreth, gjejnë përhapje. Prandaj, njerëzit e mëdhenj të fesë si Imam Adhami, me fetvatë që kanë dhënë, kra-has respektimit të kushteve të fetvasë, e kanë vazhduar jetën vazhdimisht brenda kritereve të devocionit (takva). Kështu, kur e patën parë një herë duke pastruar një papastërti shumë të vogël në rrobë, i kanë thënë:

“O imam! Sipas fetvasë që keni dhënë, kjo njollë shumë e vogël nuk është pengesë për namaz; atëherë, pse mundoheni dhe pastroni?”

Kurse imami u përgjigjet:

“Ajo është fetva, kjo takva!”

Ja, pra, parimi i vetëm i cili të gjitha përgjegjësitë e mëdha ose të vogla ndaj Zotit dhe popullit do t’i kthejë në miratim dhe kënaqësi në botën e përjetshme!”



PERGJIGJE NDAJ FTESES SE ALLAHUT

Hasan Basri (k.s.) thotë kështu:

“Delja është më e ndjeshme se njeriu. Kur i bën zë çobani, ajo e lë ku-llojtjen dhe mban vesh. Atëherë, ç’duhet t’i themi njeriut i cili s’merr mësim nga kjo e vërtetë dhe mbetet indiferent ndaj ftesës së Allahut?”





Thelbi i fjalës:

Ftesat janë lloje-lloje. Kur i thuhet dikujt “eja”, është ndryshe po qe se ai që e thërret është dikush që s’e do, është ndryshe po qe se ai që e thërret është miku, është akoma më ndryshe po qe se është e ëma, pa le po të jetë i dashuri apo e dashura! Prandaj, përgjigjja ndaj ftesës së Allahut duhet të jetë me një entuziazëm të papërsëritshëm dhe me një hare nënshtrimi të thellë. Veçanërisht, duhet ta masim vazhdimisht në peshoren e besnikërisë dhe dashurisë ndaj Zotit gëzimin dhe harenë e zemrës ndaj ftesës “Ejani në namaz!” *حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ* që mbush pesë herë në ditë qiejt dhe tokën!

Sa bukur shprehet poeti Mevlana:

“Mbushu me mend! Meqë Zoti të fton, për t’i shkuar kësaj ftese, bëje edhe kokën, madje, këmbë dhe vrapo!”

Sepse kur të thotë Ai “eja!”, e lartëson njeriun, i jep entuziazëm moralo-shpirtëror, i fal të mira të pafundme, përhap të mira të përjetshme, ngre sofrë të begata!”



RENDESIA E HALLALLIT

Njëri nga nxënësit e pasur të Ebu Abbas Nihavendiut, i cili merrej me tregti, shkoi te mësuesi dhe e pyeti se kujt do të ishte më me vend t’ia jepte zeqatin. Ebu Abbas (k.s.) i tha:

“Jepja atij ku të të vendosë zemra!”

Pasi mori përgjigjen dhe u largua nga mësuesi, nxënësi hasi në rrugë një të verbër që po lypte. Zemra iu ngroh dhe vendosi se do të ishte e përshatshme t’ia jepte zeqatin të verbërit. Prandaj nxori qesen me florinj që e kishte caktuar për zeqat dhe ia dha. Lypsari e rrëmbeu menjëherës qesen dhe u largua. Nxënësi i cili të nesërmen kaloi nga e njëjta rrugë, pa se i verbri të cilit ia dha zeqatin një ditë më parë, po bisedonte me një të verbër tjetër. Në vesh i ranë këto fjalë:

“Dje, një djalë beu më dha një qese plot me florinj. Edhe unë, shkova në mejhane dhe u rrumbullova mirë!”

Kjo gjendje e mërziti keq nxënësin dhe e çorientoi. Shkoi drejt e te Ebu Abbasi. Sapo do t’ia paraqiste ngjarjen, Ebu Abbasi, pa i dhënë rast të fliste, i zgjati një akçe që e kishte fituar nga shitja e qylafit, që ta jepte si sadaka. Dhe e porositi kështu:

“T’ia japësh personit të parë që do të të dalë para!”

Pa mundur të thotë asnjë fjalë, nxënësi u largua për ta kryer detyrën. Siç i kishte thënë mësuesi, ia dha akçen njeriut të parë që takoi. Ndërkaq, me një kureshtje që po e brente nga brenda, u vu në ndjekje të personit.





Njeriu shkoi në një lagje të jashtme të qytetit dhe u fut në një gërmadhë. Pastaj nxori nga poshtë rrobës një turtull të ngordhur dhe e la në tokë. Dhe, sapo do të ngrihej për t'u larguar, nxënësi i doli para dhe e pyeti:

"O trim! Për Allahun, më thuaj çdo të thotë kjo? Ç'ishte ai turtulli që hodhe këtu?"

Duke pasur para personin që i kishte dhënë akçen, njeriu iu përgjigj duke belbëzuar:

"Ka shtatë ditë që s'kam gjetur gjë për t'u çuar fëmijëve që të hanë! Unë dhe gruaja kemi duruar, por fëmijëve s'u ka mbetur më durim! Megjithëkëtë, kurrë nuk do ta bëja dot që t'ua zgjasja njerëzve dorën për të lypur! Kur po përpëlitesha mes një mijë e një mundimesh, gjeta atë turtull të ngordhur që e pe edhe ti. Isha i detyruar t'ua çoja fëmijëve për ta ngrënë! Në zemër, i lutesha Allahut: "O Zot, bëme një të mirë për hallin tim!" Kur erdhe ti dhe ma dhe atë akçen! Edhe unë, duke e falenderuar Zotin, e lashë atje atë zog të ngordhur dhe tani do të shkoj në Pazar dhe do t'u blej diçka fëmijëve..."

I habitur nga kjo gjendje, nxënësi shkoi menjëherë te mësuesi Ebu Abbas. Pa thënë nxënësi asnjë fjalë, mësuesi i tha kështu:

"Biri im, domethënë se nuk ke parë me kujdes nëse në fitim të është përzier apo jo ndonjë gjë haram. Prandaj, siç e pe, zeqati të shkoi në pije! Sepse gjërat e fituara, nga të kenë ardhur, atje kthehen. Kështu, në kundërshtim me qesen tënde me florinj, kalimi i akçes sime në dorë të një njeriu të mirë do të thotë se ajo është fituar vetëm me punën e dorës, domethënë, me hallall!"

Ideja:

Çdo gjë, fiton ose humb vlerë sipas specifikave pozitive ose negative që zotëron. Kjo e vërtetë bëhet më e dukshme në çështjet e hallallit dhe haramit. Prandaj, të vjetrit, për mallin dhe pasurinë thoshin:

"Ç'vjen nga haj-i shkon në hu!"

Kjo merr dy kuptime. I pari, "ç'vjen prej Allahut i cili është Hajj, i gjallë, shkon prapë te Allahu, për të cilin përdoret përemri Hú, Ai." Kuptimi i dytë është se "fitimet e përzjera me dyshime dhe harame, të cilët fitohen për havaje, domethënë, pa mund, shkojnë përsëri në hava, domethënë, bosh!" Shkurt, ndërsa hallalli bëhet pretekst për hallall, harami bëhet shkak për haram. Duke u shprehur rreth kësaj ideje, Ebu Bekr Verrak tha kështu në një bisedë:

"Kur ngrihem në mëngjes, shoh njerëzit dhe e kuptoj se cili ha hallall e cili, haram!"

E pyetën:

"Si e kupton këtë?"





Ai e shpjegoi kështu:

“E di që, nëse dikush, sapo ngrihet në mëngjes, e preokupon gjuhën me fjalë të kota, thashetheme dhe sharje, kjo ndodh nga që ha ushqime haram. E di dhe se, kur dikush sapo ngrihet në mëngjes, e preokupon gjuhën me përmendjen e Allahut, fjalën e njësisë dhe pendesa, ushqimi që ha ai është nga rrugë hallall. Sepse edhe hallalli, edhe harami reflektohen në veprimet dhe aktet e njeriut sipas veçorive që kanë...”



FITIMI HALLALL

Imami Ebu Hanife ishte një njeri i pasur që merrej me tregti dhe që kishte pasuri të madhe. Por meqë preokupohej me dituri, punët tregtare i zhvillonte me një person që e kishte caktuar zëvendës, kurse vetë kontrollonte nëse tregtia zhvillohej apo jo brenda kuadrit të hallallit. Dhe ishte aq i ndjeshëm në këtë specifikë, sa që një radhë e kishte dërguar ortakun Hafs bin Abdurrahman për të shitur tekstil duke i thënë:

“O Hafs, malli ka këto e këto të meta. Këto ia thuaj edhe myshterit dhe mallin shite me këtë çmim të lirë!”

Edhe Hafsi e shiti mallin me çmimin e caktuar nga Imami, vetëm se pa ia treguar myshterit të metat nga harresa. Kur e mësoi këtë, Ebu Hanife e pyeti Hafs bin Abdurrahmanin:

“A e njeh myshteriu që bleu copën?”

Pasi Hafsi i tha se nuk e njihte, imami, me dyshimin se mos fitimi hallall do të njollosej, tërë fitimin e nxjerrë nga shitja e mallit e ndau si sada-ka. Ja, pra, ky devocioni i tij i solli bereqet të madh tregtisë së tij materiale e shpirtërore!

Ideja:

Për ta kuptuar nëse dikush është me zemër të pastër, i sinqertë dhe i orientuar në rrugën e drejtë, i duhen parë më tepër se adhurimet që bën, me ç’zemër dhe vetëdije i bën. Me fjalë të tjera, duhet parë me kujdes nëse veçanërisht sjelljet i ka në përshtatje me moralin islam dhe nëse fitimin e ka apo jo hallall. Në këtë kontekst, kur dikush qe lavdëruar, Hz. Omeri (r. anh) i pati bërë lavdëruesit tri pyetje:

“A ke bërë ndonjëherë me të fqinjësi, udhëtim apo tregti?”

“Jo!” – Qe përgjigjur ai.

“Në është kështu, mos e lavdëro, sepse ti s’e njeh atë si duhet!”

Prandaj, Sufjan Sevri (k.s.) ka thënë:





“Fetarizmi i personit është në raport të drejtë me legjitimetin (hallallë-kun) e bukës që ha!”

Një ditë atë e patën pyetur për vlerën e faljes në radhën e parë dhe ai qe përgjigjur duke tërhequr vëmendjen për kafshatën hallall:

“O vëlla, ti shih se ku e fiton bukën! Pasi të kesh fitim hallall, falu në atë radhë që dëshiron!”

Rëndësinë dhe begatinë e mospërzjerjes së haramit në fitim duke i kushtuar vëmendje fitimit hallall në tregti, i ndjeri im atë, Musa Efendi (k.s.) e tregonte me këtë ngjarje:

“Kishim një komshi jomusliman. Ai u bë musliman më vonë. Një ditë, kur e pyeta shkakun pse ishte bërë musliman, më tha këto:

“U bëra musliman me pretekstin e moralit të bukur në tregti të Rebi Mollait që e kisha komshi toke bujqësore në Axhibadem. Molla Rebiu ishte një person që e siguronte jetesën duke shitur qumësht. Një ditë në mbrëmje erdhi tek ne dhe na tha:

“Urdhëroni, ky qumështi është juaji!”

Unë u habita:

“Si ka mundësi? Unë nuk kam kërkuar qumësht nga ju!”

Ai njeri i ndjeshëm dhe delikat më tha:

“Pa e vënë re unë, njëra nga bagëtitë kishte hyrë në kopështin tuaj dhe po kulloste. Prandaj ky qumësht është juaji! Por jo vetëm kaq. Unë do të vazhdoj t’jua sjell qumështin e bagëtisë gjersa bari që ka ngrënë te ju t’i dalë plotësisht jashtë trupit!”

Unë ia prita:

Fjalë për t’u thënë janë këto, komshi? E ç’farë hëngri? Bar! I qoftë hallall!”

Por Molla Rebiu s’u bind! Ai nguli këmbë në të vetën:

“Jo, jo, s’është punë që bëhet! Qumështi i saj është haku juaj!”

Dhe vazhdoi të na sjellë qumështe gjersa u bind se “e kishte larë de-tyrimin”!

Ja, pra, kjo sjellje e atij njeriu të bekuar më preku me të tepërt. Si rezultat, m’i ngriti perdet e padijes dhe indiferentizmit mbi sy dhe në shpirt më lindi dielli i rrugës së drejtë!

Thashë me vete:

“Feja e një njeriu me një moral të tillë të lartë, pa dyshim që është një fe e lartë! Nuk mund të kihet dyshim mbi drejtësinë e fesë që përgatit njerëz të tillë delikatë, të drejtë, të përkryer e të pastër!”

Dhe thashë Fjalën e Dëshmisë dhe u bëra musliman!”

Këto rrëfenja plot urtësi vënë në shesh në mënyrë krejt të qartë se sa korrektë dhe të kujdesshëm duhet të jemi në çështjen e fitimit hallall dhe të





haramit. Sepse fitimi hallall është një nga parimet themelore të devocionit (takvasë). Mbështetur mbi këtë, në hadithin profetik është thënë:

“Tregtari fjalëdrejtë, i ndershëm dhe i besueshëm është bashkë me profetët, besnikët dhe dëshmorët!” (Tirmidhi, *Buju*, 4)

Sepse tregtari zemërmadh i cili fiton tiparin e barazisë së pozitës me profetët, besnikët dhe dëshmorët, ndërsa bëhet pretekst qetësie dhe begatie për mjedisin, edhe për vete fiton meritimin e dy lumturive: të kësaj bote dhe të botës tjetër! Ndërkaq, ata që munden nga ambicja materiale e kësaj bote, edhe nëse duken sikur po mbretërojnë në këtë botë, nuk e shpëtojnë dot veten nga varfëria dhe mjerimi i përjetshëm në botën tjetër!

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë kështu:

“Vjen një kohë që njeriu nuk interesohet aspak nëse mallin e ka fituar hallall apo haram!” (Buhari, *Buju*, 7, 23).

Përfundimisht, në ditët tona kur janë shfaqur me të tepërt indiferentët për të cilët bëhet fjalë në hadith, dhe të cilët i pengojnë zemrat që përpiqen për të hequr dorë nga haramet, sado që të përpiqen, respektimi i hallallit është çështja më e rëndësishme dhe adhurimi më i madh!

Zemrat të cilat, duke e kryer këtë adhurim të madh, i binden urdhrin të Allahut, i nënshtrohen Atij dhe kërkojnë pëlqimin e Tij, si trëndafilat që, duke u çliruar nga gjembat çelin ngjyra-ngjyra, bëhen burime dobie dhe begatie. Në kundërshtim me këtë, zemrat e kredhura në gjëra të dyshimta, futen mes gjembash që janë e kundërta e trëndafilave dhe bashkohen me ta duke u shndërruar në burim të mijra të këqijave, madje, të foleve të imoralitetit. Zoti na mbrojtë! Amin, ashtu qoftë!





Tasavvufi është një përjetim, vetëm ai që e shijon, e di!..



PERMBLEDHJE

Në komunikimin e Zotit për Profetin (a.s.) si në ajetin e mëposhtëm, ka urtësi të panumërta:

“(O i Dërguar!) **Atë** (Kur’anin) **e zbriti Xhebraili në zemrën tënde që të jesh nga paralajmëruesit!**”¹⁶ (esh-Shuara, 193-195)

Dhe thelbi i këtyre urtësive është e vërteta se të gjitha njohuritë e zgjedhura, veçanërisht dituria dhe kultura hyjnore, mund të gjejnë zhvillim e lulëzim vetëm në klimën e zemrës. Pra, çdo e vërtetë diturore i zbulon kuptimet dhe bukuritë e brendshme vetëm me ndërmjetësimin e zemrave në shtrat ashku, dalldie dhe frymëzimi. Në këtë kontekst, këndvështrimi si më poshtë i tasavvufit ngrihet gjithmonë po mbi këtë të vërtetë:

“Dituria është parim, por synimi i këtij parimi është akti i mirë (ameli salih), gjë që është e fshehur, shkurt, në enigmën *tadhim li emrillah* (zbatimi i urdhrave të Allahut duke e madhëruar posaçërisht Atë) dhe *shefkat li halkillah* (dhembshuri për të gjitha krijesat). Në të kundërt, dituria është identiteti i një mundimi të padobishëm!”

Me fjalë të tjera, të gjitha njohuritë librore në të vërtetë i ngjajnë një fare. Ashtu siç farërat mbeten me vite të tëra farëra në qoftë se lihen në hambar pa u mbjellë, edhe njohuritë librore mbeten pa produkt në qoftë se nuk vihen në punë por lihen në rreshtat ku ndodhen dhe librat vetë, në raftë. Në kundërshtim me këtë, farërat e mbjella në tokë mbijnë e hapen sipas llojit dhe cilësive, gjer te ato fara që bëhen një rrap i madh! Krejt në këtë mënyrë, edhe farërat e diturisë të mbjella në dheun e zemrës, i shndërrojnë zemrat në kopshte vlerash morale e shpirtërore dhe atëherë arrihen frytet e vërteta të diturisë dhe kulturës shpirtërore!

16 Në origjinalin e ajetit është fjala **inzar** që e kemi përkthyer si më lart. Inzar quhet urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja duke i frikësuar dhe paralajmëruar njerëzit me rrezikun e përfundimeve të hidhura në botën e përjetshme.





Është për këtë arsye që Kur'ani është zbritur në gjoksin e bekuar të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe sahabet e nderuar, orientimet dhe njohuritë hyjnore i kanë lexuar jo më shumë në rreshtat e Kur'anit, sesa në botën e zemrës së Dritës së Ekzistencës! Kështu, sytë dhe zemrat e tyre janë ndriçuar me shumë e shumë shfaqje të larta e të pashoqe të fjalës hyjnore në atë gjoks të bekuar dhe të vërtetat e larta e të brendshme të Islamit, enigmat dhe urtësitë e tij, me të gjitha bukuritë, janë reflektuar në shpirtat e tyre! Në një vështrim, sahabet kanë deklaruar besimin duke mbetur të mahnitur dhe admirues të personalitetit dhe karakterit përjashtimor në gjendje Kur'ani të gjallë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe janë bërë si flutura drite përreth tij. Ja, pra, edhe tasavvufi ose mistika islame, duke përfutuar nga ky reflektim, ka bërë për parim ta mbajë gjallë e ta bëjë të jetueshëm Islamit në klimën e shpirtit e të begatisë hyjnore si dhe ka treguar zell e përpjekje për t'i bartur rrezatimet dritësore të reflektuara nga zemra-burim drite e Profetit (s.a.s.), te njerëzit e Allahut (evlijauallah), nëpër shekuj dhe breza!

Nga ky këndvështrim, aspekti juridik-vendimor (fetva) i fesë përbën shtyllat kryesore të një ndërtese, kurse aspekti i devocionit (takva) janë elementët plotësues rreth atyre shtyllave bashkë me elementët e bukurisë dhe hijeshisë. Tasavvufi i cili nga një anë i bashkon më një këto dy veçori, nga një anë tjetër, si shtesë ndaj aktit të bukur dhe përsosmërisë morale, shtjellon njeriun, jetën dhe gjithësinë dhe siguron me anë të një urtësie më të gjerë, njohjen dhe zbatimin e përgjegjësive. Prandaj, në temat *muhabbetullah* dhe *marifetullah*, tasavvufi ka cilësinë e një dritareje shpirtërore të hapur në zemrat e robve për kah miraxhi.

Siç e prekëm edhe kur i erdhi vendi, tasavvufi është identiteti i mundësisë për ta përjetuar Islamit në përmasat e principialitetit dhe sinqeritetit (ihlas), devocionit (takva), adhurimit të përkushtuar (zuhd), mirësisë (ih-san), vetëllogarisë (murakabe), çiltërsisë (samimijet), nënshtrimit (teslimijet) dhe afërsisë dhe dashurisë ndaj Zotit (muhabbet). Dhe çështja më me rëndësi e tij është jo aq parashtrimi i këtyre të vërtetave, sesa reflektimi i tyre në jetën tonë në raport me mundësitë dhe kapacitetet tona! Dijetarët e parë të konsideruar salihë, pas çdo predikimi dhe këshille dhe pas çdo bukurie hyjnore e morali të lavdërueshëm, theksonin se **“të thuash, është e lehtë, të dëgjosh, është e lehtë, por është shumë e vështirë të veprosht ashtu siç duhet”** dhe bënë sugjerime në rrugën e arritjes së zemrave në përkryerje.

Po ta shohim nga kjo dritare, në një vështrim, edhe të shkruash është lehtë, edhe të lexosh. Vetëm se është tejet e vështirë që, duke jetuar siç duhet, ato bukuri t'i bësh shenja dalluese të jetës. Me fjalë të tjera fjalëzën **“duro”** as gjuha që e thotë, lodhet, as veshi që e dëgjon, as dhe syri që e





lexon. Mirëpo, kur vjen puna që kjo fjalë të shfaqet në zemrën e nënshtuar ndaj dhimbjeve të panumërta, ndaj shumë brengave të rënda, vuajtjeve, sëmundjeve dhe shqetësimeve të shumëllojshme, njerëzit mbuloohen nga djersa dhe në të shumtën e rasteve parapëlqejnë të mos durojnë. Prandaj, e gjithë çështja është jo veç mësimi për vete dhe për të tjerët i njohurive mistike, por aftësia për t'i sjellë ato në gjendjen e një eliksiri jete dhe lumturie të zemrës sonë.

Në Kur'an, duke i ftuar robtë të bëjnë punë të mira (ameli salih), Zoti thotë:

“Allahu që i ka krijuar jetën dhe vdekjen për të provuar se cili nga ju do të bëjë punët më të mira...” (el-Mulk, 2)

Po të vihet re me kujdes, në ajet nuk thuhet “kush do të mësojë më mirë”, “kush do të tregojë më bukur” apo “kush do të dëgjojë më mirë”, por deklarohet e vërteta e **adhurimit më të mirë** që shprehet këtu me **ameli salih**.

Prandaj, synimi themelor i tasavvufit ose mistikës islame është t'i bëjë gonxhet e zemrës të lulëzojnë me anë të zemzemit të kulturës shpirtërore (irfan), ujit parajsor keuther dhe eliksirit të devocionit (takva) dhe t'ua mundësojnë robve bashkimin me Zotin (vasll-i il'lallah) pa rënë në disfatë në këtë botë e cila është një shkretëtirë mosnjohjeje e indiferentizmi. Ata që e kuptojnë dhe e jetojnë këtë të vërtetë, kanë arritur ta kuptojnë dhe jetojnë tasavvufin. Siç kanë thënë të mëdhenjtë e tasavvufit,

“Tasavvufi është një përjetim, vetëm ai që e shijon, e di!..”

Shkurt, me ato që treguam gjer këtu, gjëja thelbësore që deshëm të themi mbi tasavvufin është adhurim i Allahut në mënyrën më të mirë e më të bukur dhe përgatitje serioze për në botën e përjetshme. Pra, tasavvufi është aftësia për ta përjetuar pozicionin dhe detyrën e robit ndaj Allahut në mënyrën më të bukur. Sepse Zoti e ka krijuar njeriun që njeriu ta adhurojë. Prandaj, tasavvufi s'është gjë tjetër veç eliminimit të pengesave që e pengojnë adhurimin dhe sigurimit të mundësive që i bëhen pretekst adhurimit. Duke lidhur shumë e shumë plagë, tasavvufi i shndërron shumë e shumë toka të thara në toka të bleruara dhe trëndafilishte, dhe shumë e shumë zemra-gërmadhë, në saraje të stolisura! Shkurt, tasavvufi është një rrugë e cila, robtë që janë duke shkuar nga kjo botë kurbeti për në botën e bashkimit hyjnor, i bën para Zotit të merituarit e pozitës dhe konsideratës **بِعَمِّ الْعَبْدِ “ç'rob i mirë”!**

E gjithë çështja është që, duke u zhveshur nga qenia dhe pretendimi subjektiv, të mundesh të jetosh si një **asgjë para madhështisë hyjnore!** Kjo ndjenjë e cila ia mëson dhe praktikon robit dobësinë dhe dorëzimin, është një gjendje aq e lartë dhe sublime, saqë e lartëson zemrën në kulmet e përsosmërisë. Zemrat që jetojnë në pallatin e qenies asgjë, kurrë nuk bien në





inJORIM dhe mJERIM, përkundrazi, seriozë dhe autoritarë, në raport me sa të vishen me thjeshtësi dhe modesti, meritojnë pozita të larta para Zotit. Ja si shprehet poeti:

*Fara s'begatohet po s'ra në tokë;
Kë bie në tokë e rrit mëshira hyjnore...*

Zoti ynë! Bëna edhe ne nga ata për të cilët Ti thua “ç’rob i mirë!”! Allahu im! Bleroji me mëshirën tënde të pafundme zemrat tona që, duke hyrë në klimën e asgjësimit para Teje, përpiqemi t’i mbrojmë nga thasësira e egoizmit dhe pretendimit! Na bëj që fjalët të na përputhen me përmbajtjen dhe përmbajtja, me fjalët! Çelnai ndër zemra gonxhet e të vërtetës që patëm guximin t’i vëmë në penën tonë të varfër me shfaqjet e atributit tënd të amshuar “fjalë”! Bëna të gjithëve ndër ata që i do, bashkë me grupin e të mirëve dhe ringjallna bashkë me ta! Mos na ndaj nga gjurma e ndritshme e Profetit! Dhe bëna të merituarit e shefaatit të tij të madh! Dhurona gjendjen dhe moralin që Ti e pëlqen dhe na e mundëso gjithmonë të kryejmë ato punë që Ti i pëlqen! Na i rregullo të gjitha ndjenjat me pëlqimin tënd të nderuar! Dhe na largo nga qëndrimet dhe sjelljet që s’i pëlqen! Dhe na bëj të jetojmë në rrugën e drejtë gjer në frymën tonë të fundit! Dhe na e bëj këtë veprën tonë të pavlerë pretekst për dobi, mbarësi, urtësi, drejtësi dhe afërsi!

Amin, ashtu qoftë!





PERMBAJTJA

PARATHENIE	7
------------------	---

PJESA E PARE

PERBERJA E TASAVVUFIT OSE MISTIKES ISLAME	13
---	----

A. LINDJA E TASAVVUFIT	13
B. PERKUFIZIMI I TASAVVUFIT	29
C. TEMATIKA E TASAVVUFIT	46
D. QELLIMI I TASAVVUFIT	48
E. NEVOJA E TASAVVUFIT	51
F. MARREDHENIET E TASAVVUFIT MESHKENCAT DHE ARTET	66
1. Tasavvufi dhe shkencat e tjera islame	66
a. Tasavvufi dhe Kelami	67
b. Tasavvufi dhe Tefsiri	69
c. Tasavvufi dhe Hadithi-Sijeri	71
d. Tasavvufi dhe Fikhu	73
2. Tasavvufi dhe shkencat e natyrës	75
3. Tasavvufi dhe Letërsia	78
4. Tasavvufi dhe Artet e Bukura	81
a. Muzika	81
b. Arkitektura	83
c. Bukurshkrimi i Kur'anit	84
5. Tasavvufi dhe Filozofia	87
G. DIJA E DOBISHME	91

PJESA E DYTE

EDUKIMI MISTIK (UDHA DHE UDHETIMI MISTIK)	99
---	----

A. NEFSI DHE PASTRIMI I TIJ	103
1. Natyra e nefsit	103
2. Pastrimi i nefsit (tezkije)	108
3. Gradët e nefsit	121
a. Nefsu'l-Emmare (urdhërues, imponues)	121





b.	Nefsul-levvame (pendestar)	127
c.	Nefsu'l-mulheme (i frymëzuar)	129
d.	Nefsu'l-mutmainne (i ngopur e i kënaqur)	132
e.	Nefsur-radije (nefsi në pajtim me Zotin)	134
f.	Nefsu'l-merdijje (Zoti në pajtim me nefsin)	136
g.	Nefsu'l-kamile (i përsosur)	137
B.	ZEMRA DHE KULLIMI I SAJ	139
1.	Natyra e zemrës	139
2.	Llojet e zemrës	145
3.	Purifikimi i zemrës (tasfije)	153
a.	Ushqimi hallall	154
b.	Pendimi dhe lutja	157
c.	Këndimi i Kur'anit dhe ndjekja e konkluzioneve të tij	161
d.	Kryerja e adhurimeve me përspirtshmëri	165
e.	Gdhirja e netëve	173
f.	Zikrullah dhe murakabe	176
g.	Ndjenja e afërsisë ndaj Resulullahut dhe salavati sherife	181
h.	Meditimi mbi vdekjen	187
j.	Qëndrimi me njerëzit e mirë Salih dhe besnikë sadik	192
k.	Pajisja me një moral të bukur	200
4.	Vështrim mbi gjithësinë me një zemër të kulluar	205
C.	PARIMET THEMELORE NE EDUKIMIN MISTIK	211
D.	PRIJESI I PERSOSUR DHE METODAT E ORIENTIMIT	218
1.	Prijësi i përsosur	218
2.	Metodat e orientimit	226
a.	Ndjenja e afërsisë (muhabbet) dhe lidhja shpirtërore (rabita)	226
b.	Biseda (sohbet)	235
c.	Shërbim (hizmet)	241
d.	Prirja (tevexhxhuh)	248
e.	Lutja (dua)	252
E.	STILI MISTIK	255
1.	Stili i orientimit dhe mëshirës	255
2.	Stili i butësisë dhe dhembshurisë	264

PJESA E TRETE

MARIFETULLAH ose NJOHJA INTUITIVE E ZOTIT dhe DHUNTITE HYJNORE	275
---	-----

A. MARIFETULLAH (njohja intuitive e Zotit)	275
1. Individualiteti i lartë	275





2. Atributet hyjnore dhe shfaqjet e tyre	284
3. Marifetullah dhe shfaqjet e individualiteteve	308
B. DHUNTITE HYJNORE	314
1. Dituria hyjnore (ilmul-ledun)	316
2. Zgjuarsi (firaset)	341
3. Aftësia e administrimit dhe parashikimit mrekullor (tasarruf - keramet)	343
4. Endrrat besnik	358

PJESA E KATERT

DISA ÇESHTJE MISTIKE	367
A. PRETEKSTUALITETI (TEVESSUL)	367
B. BEGATIMI (TEBERRUK)	378
C. VIZITA NE VARRE	386

PJESA E PESTE

KESHILLA NGA MIQTE E SE VERTETES	395
--	-----

PJESA E GJASHTE

RREFIME MISTIKE dhe SHEMBUJ MESIMDHENES	413
---	-----

Arsimimi i vërtetë	413
Metoda në edukimin moralo-shpirtëror	415
Ibrahim bin Et'hemi dhe sorkadhja	416
Të mos lëshosh njollë në rrugën e Zotit	418
Kerameti ose aftësia parashikuese	419
Ndikimi i zemrave indiferente	420
Porta e mikut	421
Bindje, shërbim, këshillë	422
Shërbim ndaj krijesave	423
Delikatesa te miqtë e Zotit	424
Vullneti në audience	425
Edukata dhe etika	427
Etika në shërbim	428
Sidomos edukatë dhe etikë	428
Morali dhe shërbimi i një miku të Zotit	429
Ta dinë jo të vdekshmit, por i pavdekshmi	430





Mos përbuz askënd	431
Mos fyej askënd	432
Gëzoje jetimin	433
Miqësia	434
Synimi i miqësisë	435
Nënshtrim i plotë	436
Të marrësh lutjen e besimtarit	437
Një i humbur nga mendja dhe ilaçi i zemrës	438
Fytyra engjëllore	439
Gjendja e zemrës në mirëbërësi	440
Akti i mirë që ngjitet në arshin e lartë	441
Ta dallosh gjithmonë të vërtetën	442
Mua më duhet bujari	443
Përgjegjësia e atyre që prijnë	444
Përgjigje ndaj ftesës së Allahut	445
Rëndësia e hallallit	446
Fitimi hallall	448
PERMBLEDHJE	451
PERMBAJTJA	455





BIBLIOGRAFIA

Abdurrahman Güzel, Mustafa Tatçı,
Yunus Emre, Ankara, 1991.

Abdülbaki Gölpınarlı,
Mesnevi ve Şerhi, I-VI, İstanbul, 1973-1974.

Abdulkadir Geylani,
el-Fethu'r-Rabbani (trc. Yaman Arıkan), İstanbul, 1987.

Abdulkerim el-Xhili,
İnsan-ı Kamil (trc. Abdülaziz Mecdi Tolun, haz: Selçuk Eraydın,
Ekrem Demirli, Abdullah Kartal), İstanbul, 1998.

Abdulgahid Zindani,
Kur'an'da İlmi Mucizeler (trc. Resul Tosun), İstanbul, 1995.

Axhluni, İsmail bin Muhammed,
Keshfu'l-Hafa, MI, Beyrut, tarihsiz

Adem Ergül,
Kalbi Hayat, İstanbul, 2000.

Ahmed bin Abdullah bin Muhammed et-Taberi,
er-Riyadu'n-Nadra, Beyrut, 1996.

Ahmed bin Hanbel,
el-Musned, I-VI, İstanbul, 1992;
Kitabu'z-Zuhd, (nşr. Muhammed Said Besyuni Zaglul) Beyrut, 1986.

Ahmed Davudođlu,
Sahih-i Muslim Tercüme ve Şerhi, I-XII, İstanbul, 1979.

Ahmed er-Rifai,
Onların Alemi (trc. Abdülkadir Akçiçek), İstanbul, 1996.





Ahmed Taşgetiren,
Altın Öğütler, İstanbul, 1992.

Ali bin Huseyin Vaiz-i Kashifi,
Reshat Aynu'l-Hajat (thk. Ali Asgar Muinijan), I—II, Tahran, 1977.

Ali Can Tatlı,
Zühd Açısından Hadislerde Dünya (Basılmamış Doktora Tezi),
İstanbul, 1996.

Ali Himmet Berki,
Açıklamalı Mecelle: Mecelle-i Ahkam-ı Adliye, İstanbul, 1982.

Ali Özek, Hayrettin Karaman, Ali Turgut, Mustafa Çağrırcı, İ. Kafi
Dönmez, Sadreddin Gümüş,
Kur'an-ı Kerim ve Türkçe Açıklamalı Meali, Suudi Arabistan, 1992.

Beladhuri,
Ensabu'l-Eshraf, Mısır, 1959.

Beyhaki, Ebu Bekir Ahmed bin el-Husejn,
es-Sunenu'l-Kubra, (tarihsiz) Daru'l-fikr; **Kitabu'z-Zuhdi'l-Kebir**,
Beyrut, 1996.

Beydavi, Ebu Said Nasruddin Abdullah bin Umer,
Envaru't-Tenzil ve Esraru't-Te'vil, I-IV, Beyrut, (tarihsiz).

Buhari, Ebu Abdillan Muhammed bin Ismail,
el-Xhamiu's-Sahih, I-VIII, İstanbul, 1992.

Darimi, Ebu Muhammed Abdullah bin Abdirrahman,
Sunenu'd-Darimi, I-II, İstanbul, 1992.

Dejlemi, Ebu Shuxha Shiruje bin Shehridar,
el-Firdevs bi-Me'thuri'l-Hitab, Beyrut, 1986.

Ebu Davud, Suleyman bin Esh'as es-Sixhistani,
Sunenu Ebi Davud, I-V, İstanbul, 1992.





Ebu Nasr es-Serraxh et-Tusi,
el-Luma' (trc. H. Kamil Yılmaz), İstanbul, 1996.

Elmalılı, M. Hamdi Yazır,
Hak Dini Kur'an Dili, I-X, İstanbul, 1971.

Esad Sahib,
Mektubat-ı Mevlana Halid, (trc. Dilaver Selvi, Kemal Yıldız),
İstanbul, 1993.

Ethem Cebecioğlu,
Tasavvuf Terimleri ve Deyimleri Sözlüğü, Ankara 1997.

Feriduddin Attar,
Tedhkiretu'l-Evliya (haz. Süleyman Uludağ), İstanbul, 1985.

Ferit Devellioğlu,
Osmanlıca-Türkçe Ansiklopedik Lügat, Ankara, 1997.

Gazali, Ebu Hamid Muhammed bin Muhammed,
İhju Ulumi'd-Din, I-VI, Beyrut, 1990.

Hakim, Ebu Abdillah Muhammed bin Abdillah en-Nisaburi,
Mustedrek ale's-Sahihayn, I-V, Beyrut, 1990.

Hasan Basri Çantay,
Kur'an-ı Hakim ve Meal-i Kerim, I-III, İstanbul 1996.

Hasan Kamil Yılmaz,
Anahatlarıyla Tasavvuf ve Tarikatlar, İstanbul, 2000.

Hayrat Neşriyat İlmî Araştırma Merkezi Meal Hey'eti,
Kur'an-ı Kerim ve Muhtasar Meali, İstanbul, 2001.

Hayrettin Karaman,
Ebediyet Yolcusunu Uğurlarken, Ankara, 1999.

el-Hejthemi, Nureddin Ali bin Ebi Bekir,
Mexhmau'z-Zevaid ve Menbau'l-Fevaid, IX, Beyrut, 1988.





Ibn-i Ataullah Iskenderi,
el-Hikemu'l-Ataijje (trc. Saffet Yetkin), Ankara, 1963

Ibn Xhevzi, Ebu'l-Ferexh Abdurrahman bin Ali bin Muhammed,
Menakibu'l-Imam Ahmed bin Hanbel, (thk. Abdullah bin Abdulmuhsin et-Turki) Kahire, 1409.

Ibn Haxher el-Askalani, Shihabuddin Ahmed bin Ali.
Hedju's-Sari Mukaddimetu Fethi'l-Bari Sherhi Sahihi'l-Buhari, I-XXVIII, (tarihsiz). Daru'l-Fikr, Fuat Abdalbaki neşri;
el-Isabe fi Temyizi's-Sahabe, Mısır, 1379;
Munebbihat, İstanbul, 1960.

Ibn Hibban, Ebu Hatim el-Busti,
el-Ihsan bi-Tertibi Sahihi Ibn Hibban (tertib: Ibn Belban), I-X, Beyrut, 1987.

Ibn Hisham,
es-Siretu'n-Nebevijje, Bejrut, 1992.

Ibn Kethir, Imaduddin Ebu'l-Fida,
Tefsiru Kur'an i'l-Adhim, I-V, Beyrut, 1988;
el-Bidaje ve'n-Nihaje, I-XV, Kahire, 1993;
es-Siretu'n-Nebevijje, I-IV, Kahire, 1964

Ibn Maxhe, Ebu Abdillallah Muhammed bin Jezid el-Kazvini,
Sunenu Ibn Maxhe, İstanbul, 1992.

Ibn Abdalberr, Ebu Umer Jusuf bin Abdullah bin Muhammed,
el-Istiab fi Marifeti'l-Ashab, I-IV, Kahire, (tarihsiz).

Ibn Ethir, Muhammed bin Abdulkerim bin Abdulvahid esh-Sheybani,
el-Kamil fi't-Tarih, I-XIII, Beyrut, 1965.

İbrahim Canan,
Hadis Ansiklopedisi, I-XVIII, İstanbul, (tarihsiz).

İlhan Armutçuoğlu,
Kaside-i Burde Manzum Tercumesi, Konya, 1983.





Imam Malik,
Muvatta, I–II, İstanbul, 1992.

İsmail Fenni Ertuğrul,
Vahdet-i Vucud ve İbn-i Arabi (haz. Mustafa Kara), İstanbul, 1991.

İsmail Hakkı Bursevi,
Ruhu'l-Bejan, I-X, İstanbul, 1969;
Kenz-i Mahfi, İstanbul, 1727.

Kadir Mısıroğlu,
Kulliyat, Sebil Yayinevi.

Kelabazi, Taxhu'l-Islam Ebu Bekir Muhammed bin Ishak Buhari,
et-Taarruf li-Mezhebi Ehli't-Tasavvuf (trc. Süleyman Uludağ),
İstanbul 1992.

Kurtubi, Ebu Abdillan Muhammed bin Ahmed,
el-Xhami li-Ahkami'l-Kur'an, I-XX, Beyrut, 1985.

Kusheyri, Abdulkerim,
er-Risaletu'l-Kusheyriyye, Beyrut, 1990.

M. Aziz Lahbabi,
İslam Şahsiyetçiliği (trc: İ. Hakkı Akın), İstanbul, 1972.

Mahir İz,
Tasavvuf, İstanbul, 1969;
Yılların İzi, İstanbul, 1975.

Mahmud Sami Ramazanoğlu,
Külliyat, Erkam Yayınları.

Makdisi, İzzuddin Abdusselam,
Sırların Çözümü ve Hazineselerin Anahtarları (trc. Hayri Kaplan),
İstanbul, 2001.

Mexhdi Mehmed,
Hadaiku'sh-Shakaik, İstanbul, 1853.





Mexhmuu'l-Hadis, Şam Mektebetu'z-Zahiriyye Kutüphanesi, no: 59.

Mehmed Doğan,
Büyük Türkçe Sözlük, İstanbul, 1994.

Mehmed Niyazı,
Çanakkale Mahşeri, İstanbul, 1999.

Mevlana Şeyh,
Menakıb-ı Hacı Ubeydullah-ı Ahrar, Bayezid Devlet Kütüphanesi,
Bayezid bölümü, nr: 3624.

Molla Xhami,
Nefahatu'l-Uns (sad. Abdülkadir Akçiçek), İstanbul, 1981.

Muhammed Abid el-Xhabiri,
Arab-İslam Kültürünün Akıl Yapısı, İstanbul, 1999.

Muhammed b. Abdullah el-Hani,
Adab, İstanbul, 1995.

Muhammed Ebu Zehra,
Ibn Tejmijje Hajatuhu ve Asruhu ve Fikruhu, Beyrut, (tarihsiz).

Muhammed Es'ad Erbili,
Mektubat, (sad. H. Kamil, Yılmaz, İrfan Gündüz), İstanbul, 1983;
Risale-i Es'adiyye, Dersaadet, 1924.

Muhammed Esed,
Kur'an Mesajı (trc. Cahid Koytak, Ahmet Ertürk), I-III, İstanbul, 1999.

Muhammed Fuad Abdulbaki,
el-Mu'xhemu'l-Mufehres li-Elfazi'l-Kur'ani'l-Kerim, Kahire, 1988.

Muhammed Hamidullah,
İslam Müesseselerine Giriş, İstanbul, 1981.

Muhammed Salih ez-Zerkan,





Fahrud-din er-Razi ve Arahu'l-Kelamiyye ve'l-Felsefiyye, Beyrut, 1963.

Mustafa Kara,
Metinleriyle Günümüz Tasavvuf Hareketleri, İstanbul, 2002.

Munavi, Muhammed Abdurrauf,
Feyzu'l-Kadir Sherhu'l-Xhamii's-Sagir, I- VI, Beyrut, 1994.

Munziri, Abdulazim bin Abdulkavi,
et-Tergib ve't-Terhib, IV, Kahire, 1934.

Muslim, Ebu'l-Huseyin bin Haxhaxh el-Kusheyri,
el-Xhamiu's-Sahih (thk. Muhammed Fuad Abdalbaki), I-III, İstanbul, 1992.

Necip Fazıl Kısakürek,
Veliler Ordusundan 333, İstanbul, 1976;
Reshahat (Sheyh Safiyyuddin), İstanbul, 1995.

Nesai, Ebu Abdirrahman Ahmed bin Shuayb,
Sunenu'n-Nesai, I-VIII, İstanbul, 1992.

Nevevi, Ebu Zekeriyya Yahya bin Sheref,
Riyadu's-Salihin, Beyrut, t.s. Riyazu's-Salihin (tercume ve şerh:
Yaşar Kandemir, İsmail Lütfi Çakan, Raşit Küçük), I-VIII, İstanbul, 1997;
Şerhu Sahih-i Muslim, I-XVIII, Mısır, 1981.

Nurettin Topçu,
Mevlana ve Tasavvuf, İstanbul, 1998.

Osman Nuri Topbaş,
Külliyat, Erkam Yayınları.

Ömer Rıza Doğrul,
İslamiyetin Geliştirdiği Tasavvuf, İstanbul, 1948.

Razi, Fahrud-din Muhammed bin Umer,
Mefatihü'l-Gayb (et-Tefsiru'l-Kebir), I-XXXII, Beyrut, 1990.

Roger Garaudy,





İslam'ın Vaad Ettikleri (trc. Nezih Uzel), İstanbul, 1983.

Rudani, Imam Muhammed bin Muhammed bin Suleyman,
Xhem'u'l-Fevaid (trc. Naim Erdoğan), İstanbul, 1996.

Sadık Dana,
Külliyat, Erkam Yayınları.

Selçuk Eraydın,
Tasavvuf ve Tarikatlar, İstanbul, 1994.

Sejjid Sherif Xhurxhani,
Kitabu't-Ta'rifat, Beyrut, 1990.

Suat Yıldırım,
Kur'an'da Uluhiyyet, İstanbul, 1987.

Suyuti, Ebu'l-Fazl Xhelaeddin Abdurrahman bin Ebu Bekir,
el-Xhamiu's-Sagir, Mısır, 1306;
Sherhu's-Sudur bi-Sherhi Hali'l-Mevta ve'l-Kubur, İstanbul, 1986;
Sherhu Ibn Maxhe, Karaçi, (tarihsiz).

Subki, Takijjuddin Ebu'l-Hasen Ali,
Shifau's-Sekam fi Ziyaret-i Hayri'l-Enam, Mısır, 1318.

Süleyman Ateş,
İslam Tasavvufu, Ankara, 1972.

Süleyman Uludağ
Tasavvuf Terimleri Sözlüğü, İstanbul, 1991.

Şefik Can,
Mesnevi Tercümesi, I-VI, İstanbul, 1997.

Sheyh Eshref Ali Tanevi,
Hadislerle Tasavvuf (haz. Zaferullah Davudi, Ahmed Yıldırım),
İstanbul 1995.





Sheyh Sadi Shirazi,
Bostan, İstanbul, 1995.

Shihabu'd-din Ahmed bin Haxher el-Hejtemi el-Mekki,
**Hajratu'l-Hisan fi Menakibi'l-İmami'l-A'dham Ebu Hanifeti'n-
Nu'man**, Beyrut, 1403/1983.

et-Taberani, Ebu'l-Kasım Suleyman bin Ahmed,
el-Mu'xhemu'l-Kebir, I-XXV, 1983.

Taberi, Ebu Xhafer Muhammed bin Xherir,
Xhamiu'l-Bejan an Te'vili Ajati'l-Kur'an, Beyrut, 1995.

Tahiru'l-Mevlevi,
Şerh-i Mesnevi, I-XIV, İstanbul, 1963-1973.

Tehanevi, Muhammed A'la bin Ali,
Keshafu İstılahati'l-Funun, Beyrut, 1861.

Tirmidhi, Ebu Isa, Muhammed bin Isa,
Sunenu't-Tirmidhi, I-V, İstanbul, 1992.

Vakidi,
Megazi, Mısır, 1948.

Zekeriya Güler,
“Vesile ve Tevessül Hadislerinin Kaynak Değeri”, İLAM
Araştırma Dergisi, Ocak-Haziran, 1997, c. 2, say. 1, s. 83-132.







